

Flori Bruqi

LEKSIKON ENCIKLOPEDIK
I AKADEMISË SHQIPTARE AMERIKANE

AKADEMIA SHQIPTARO-AMERIKANE
E SHKENCAVE DHE ARTEVE



THE ALBANIAN AMERICAN ACADEMY
OF SCIENCE AND ARTS



NEW YORK, PRISHTINË, TIRANË, SHKUP

Për botuesin
Flori Bruqi

Kryeredaktor
Dibran Fylli

Redaktor përgjegjes
Hakif Bajrami

Redaktor gjuhësor
Fatmir Halimi

Recensent
Naim Kelmendi
Nijazi Halili

Korrektor
Abdullah Troshupa

Radhitja kompjuterike dhe dizajni
uniART Creative

© të drejtat e rezervuara nga “Flomed”

LEKSIKON ENCIKLOPEDIK
I AKADEMISË SHQIPTARE AMERIKANE
SHKENCË, ART, KULTURË, LETËRSI

1





NË VEND TË HYRJES

PËR LEKSIKONIN ENCIKLOPEDIK TË AKADEMISË
SHQIPTARE AMERIKANE TË SHKENCAVE DHE ARTEVE

Botimi i parë i “Leksikonit enciklopedik” për akademikët dhe Akademinë Shqiptare Amerikane të Shkencave dhe Arteve shpresojmë që do t'i plotësojë zbrazëtirat në zhvillimin e shkencës, kulturës dhe letërsisë shqiptare, ngase një leksikon i tillë nuk ka ekzistuar deri më sot.

Pas tranzicioneve demokratike në trojet shqiptare dhe diasporë, zhvillimi i shkencës, letërsisë, artit etj., mori hov si kurrë më parë.

28 Nëntori i vitit 1995 shënoi një kthesë historike, pasi që me këtë datë u themelua edhe Akademia e Shkencave Shqiptare Amerikane në New York. Themelues të Akademisë janë Prof. Dr. Skënder Kodra, Dr. Ulvi Vehbiu, Dr. Adem Harxhi, Dr. Namik Shehu, Mentor Mata, Sanie Selita etj.

Akademia në fakt është një institucion mbarë kombëtar, ngase ka anëtarë nga Prishtina, Peja dhe Tetova e Presheva, nga Tirana, Gjirokastra, Shkodra, nga Çamëria e Malësia dhe nga Diaspora.

Bashkërisht në këtë Akademi organizuam një sërë aktiviteteve shkencore dhe kombëtare si fjala vjen; Konferenca kushtuar 600 vjetorit të lindjes së Heroit kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeut, 70 vjetorit të lindjes së shkrimtarit të shquar Ismail Kadare. Konferenca për gjuhën e njëzuar shqipe, ku senatori i gjuhës dhe kulturës kombëtare prof. Peter Prifti mbrojti me argument origjinale rëndësinë historike të Kongresit të Drejtshkrimit në Tiranë 1972, kundër qëndrimeve subjektive, politike dhe antishkencore të Arshi Pipës.

Akademia e Shkencave dhe Arteve Shqiptare Amerikane në Nju Jork punimet e veta shkencore i ka botuar në revistën shkencore të Akademisë “Dituria” dhe revista tjera prestigjioze. Ndërsa në vitin 2019 kjo Akademi i botoi dhe përuroi në Prishtinë dy libra të autorëve nga Kosova: Dibran Fylli *”Tokë e mbjellë në Varre”* (Krimet Serbe në Kosovë 1998-1999), si dhe librin e Jahja Llukës *”Përmbledhje shkrimesh”*.

Është përgatitur për botim libri i parë *”Leksikoni enciklopedik”*, i cili sadopak do t'i plotësojë zbrazëtirat që janë hetuar në zhvillimin e shkencës, letërsisë, artit, kulturës etj, ngase një leksikon i tillë biografik dhe bibliografik deri me tash nuk ka ekzistuar.

Shkencëtarët, shkrimtarët dhe artistët tanë, edhe pse jetuan dhe krijuan në rrethana të caktuara, ata identitetin kombëtar e dëshmuan me veprat e tyre, me përmbajtjet e veprave, me personazhet, me ambientin, e madje edhe me deklaratat e tyre se janë shqiptarë.

Gjatë shkrimit të këtij leksikoni, për 4 vjet pandërprerë na kanë përcjellë edhe probleme të ndryshme në grumbullimin, verifikimin dhe sistemimin e të dhënave.

Rritja në numër e anëtarëve të Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencës dhe Artit me seli në Nju Jork, Tiranë, Prishtinë e Shkup, ka sjellë prej kohësh nevojën e një enciklopedie, ku të pasqyrohet kontributi i anëtarëve të kësaj Akademie që jetojnë në trojet shqiptare dhe në diasporë.

Libri “Leksikon enciklopedik” vjen si një kontribut i çmuar i kësaj akademie, që nga themelimi i saj në vitin 1995 e deri më sot.

Pas një pune të mundimshme dhe të suksesshme, autori më bashkëpunëtorët e tij ka arritur që t’i japë lexuesit Enciklopedinë biografike dhe bibliografike të akademikëve të Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencës dhe Artit, si dhe disa intelektualëve tjerë që kanë lënë gjurmë në shkencë, letërsi dhe art.

Në këtë mënyrë kemi një tablo të plotë të këtyre autorëve dhe veprave të tyre në Shqipëri dhe Kosovë, Maqedoni dhe Malin e Zi, në Luginën e Preshevës, Medvegjës, Bujanocit, Çamërisë dhe në Diasporë. Autori së bashku me stafin redaksional ka punuar me dashuri dhe përkushtim në mbledhjen e këtyre biografive dhe bibliografive të njerëzve të shquar të trojeve shqiptare dhe të diasporës.

Shumë prej tyre nuk rrojnë më, ndaj edhe marrja e informacionit ka paraqitur vështirësi. Mirëpo këmbëngulja e stafit tonë ka bërë që asnjë prej anëtarëve të Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencave dhe Arteve të mos mungojë, madje të mos mungojë asnjë vepër e tyre. Kjo tregon seriozitet dhe përgjegjësi, kur merr përsipër të shkruash vepra të përmasave të tilla madhore.

Nuk kanë hyrë në “Leksikon enciklopedik” ata që nuk kanë vepra shkencore, letrare etj., të botuara, si dhe ata që nuk i kanë dërguar më kohë biografitë dhe bibliografitë e tyre.

Njerëzit e interesuar do të kenë mundësinë të njihen, jo vetëm me shtrirjen gjeografike ku veprojnë këta autorë, por edhe me prurjet shkencore që ata kanë sjellë në të gjitha fushat e dijes njerëzore.

Ky libër enciklopedik do t’u vijë në ndihmë mësuesve dhe nxënësve, pedagogëve dhe studentëve, kërkuesve të rinj shkencorë dhe gjithë atyre që janë të interesuar të thellojnë dijet e tyre.

Bashkëveprimi dhe shtrirja gjeografike, ku veprojnë këta autorë ka sjellë një përbashkim të vlerave të krijuara, kanë nxitur njëri-tjetrin për t’u thelluar më tej në fushat ku ata krijojnë apo hulumtojnë.

Rezultatet kanë qenë të kënaqshme dhe lexuesi do të shohë prurjet e secilit autor në fushën përkatëse, sidomos në mjekësi, inxhinieri, shkencë ekzakte, letërsi dhe albanologji, të cilat lidhen drejtpërdrejtë me identitetin e kombit tonë, i cili në rrjedhë të mijëvjeçarëve ka lënë gjurmët e tij.

Ka qenë dhe është detyrë e anëtarëve të kësaj Akademie të thellojnë punën kërkimore shkencore në fusha të shkencave ekzakte, mjekësisë, teknologjisë, albanologjisë etj., duke shkuar në thellësi të mijëvjeçarëve.

Kjo Enciklopedi është hartuar në atë mënyrë, që edhe lexuesit e zakonshëm, por edhe studiuesit e fushave të ndryshme të kenë mundësinë që të njihen me arritjet e secilit autor dhe të përzgjedhin prej tyre atë që ata kërkojnë. Në këtë botim janë përfshirë një numri të konsiderueshëm autorësh, të cilët kanë sjellë kontribute të rëndësishme në të gjitha fushat e dijes, duke filluar me arritjet në shkencat natyrore dhe veçanërisht në fushën e mjekësisë, në albanologji dhe gjuhësi, në histori dhe filozofi, në art dhe letërsi, në ekonomi, teknologjisë, jurispondencës e në çdo sferë tjetër të dijes njerëzore.

Artikujt dhe studimet e këtyre autorëve përfshijnë figurat më të rëndësishme historike, që u kanë dhënë emrin e tyre ngjarjeve më kulmore të historisë sonë.

Kjo enciklopedi përfaqëson një vepër shkencore. Në kumtesat dhe studimet e këtyre autorëve do të gjejmë botën shqiptare në gjithë dimensionin e saj historik, nga lashtësia e deri në ditët e sotme. Prandaj, mund të themi se kjo vepër ka identitet të spikatur kombëtar.

Një nga figurat qendrore të kësaj akademie ka qenë kryetari i saj Prof. Dr. Skënder Kodra, Ph. D, i cili mundi të bashkojë dijen shqiptare dhe më gjerë, të shtrirë në pesë shtetet ballkanike, ku shqiptarët janë pjesë e rëndësishme e tyre edhe në diasporë, pasi që ky kontribut shqiptar po ngrihet vazhdimisht drejt nivelit botëror.

Tashmë Akademia Shqiptare Amerikane e Shkencave dhe e Artit me seli në Nju Jork, Tiranë, Prishtinë e Shkup është bërë epiqendra e mendimit akademik që prodhohet në trojet shqiptare, duke sjellë gjallëri dhe freski në fushë të artit dhe shkencave.

Akademia Shqiptare Amerikane e Shkencave dhe Arteve është mbështetur fort mbi arritjet e deri tanishme të dijetarëve shqiptarë, i ka parë kontributet e tyre akademike shkencore e letrare si arritje të çmuara dhe i ka vlerësuar ato vazhdimisht.

Por çdo arritje është njëkohësisht pikënisje nga ku fillon e ngrihet një arritje tjetër. Në këtë kuptim, duke ruajtur vlerën e arritur, janë bërë

përpjekje për arritje të reja dhe që këto kontribute akademike janë të rëndësishme sidomos në fushë të Mjekësisë, Albanologjisë etj.

Albanologjia ende nuk e ka thënë fjalën e saj përfundimtare, sepse kërkohen studime të thelluara në gjuhësi dhe antropologji, në histori dhe arkeologji, në besimet pagane, të cilat kanë emërtime pellazgjike dhe që kanë bashkëjetuar me shqiptarët deri në ditët e sotme.

Akademia Shqiptare Amerikane e Shkencave dhe Arteve, si akademi e trojeve shqiptare dhe e diasporës, u ka dhënë një ndihmesë të çmuar shkencave ekzakte dhe atyre shoqërore, veçanërisht në fushë të albanologjisë, ku gjithnjë e më shumë, anëtarët e kësaj akademie kërkojnë të depërtojnë në atë histori, e cila nga historianët quhet para ilire.

Nëse për grekët historia para helene apo pellazgjike është e dokumentuar prej autorëve të antikitetit dhe helenët nuk kanë pasur asnjë lidhje gjenetike me pellazgët; shqiptarët e sotëm ruajnë tradita dhe zakone, që e kanë zanafillën nga ajo periudhë dhe autorët e antikitetit i emërtojnë pellazgjike, siç është adhurimi për lirin e shenjtë, apo adhurimi për malin e Tomorit, të cilat ishin rite dhe kanë përcaktuar identitetin e asaj popullsie, që quhej popullsi pellazge. Disa nga studimet që janë marrë me periudhat para ilire janë të nivelit akademik dhe përbëjnë arritje të këtij institucioni në botën akademike shqiptare.

Disa nga arritjet e Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencave dhe Arteve, kanë prekur në thellësi sferat e dijes njerëzore, aty pasqyrohet qartë identiteti ynë kombëtar, autoktonia e shqiptarëve në trojet e veta, marrëdhëniet me popujt e tjerë, prej të cilëve ka dhënë dhe ka marrë çfarë shoqëria njerëzore ka arritur në shkencë dhe arte dhe që kanë shërbyer për një ecje të sigurt të njerëzimit drejt progresit dhe përparimit shoqëror. Aty do të gjesh të pasqyruara marrëdhëniet e popullit tonë nga qytetërimet e lashta mesdhetare deri në ditët e sotme.

Në studimet e autorëve që janë marrë me historinë e shqiptarëve dhe të trojeve të tyre del në dukje se uniteti i shqiptarëve ka pasur në themel tolerancën dhe harmoninë midis tyre, tipare që janë manifestuar në të gjitha fushat e jetës.

Në këtë enciklopedi do të gjesh autorë me veprimtari të gjerë dhe me vlera të spikatura në fushën e mjekësisë, teknologjisë, biznesit, gjuhësisë të cilat konsiderohen studime të mirëfillta shkencore, duke i dhënë një shtysë të mëtejshme shkencës shqiptare në veçanti.

Raportet e gjuhës shqipe me gjuhët e popujve fqinj, që nga antikiteti deri në ditët e sotme janë dëshmi e sigurt e ekzistencës së shqiptarëve në

trojet ku jetojmë sot që nga kohët parahistorike. Këto studime gjuhësore janë shoqëruar me një dokumentacion të pasur dhe me burime të drejtpërdrejta nga autorë shqiptarë dhe të huaj që janë marrë me origjinën e shqiptarëve dhe gjuhës shqipe.

Letërsia shqipe është gjetur në këto vitet e fundit në kuota të lartësuar që qëndrojnë denjësisht përkrah letërsisë botërore. Ajo shkruhet brenda trojeve shqiptare, por dhe jashtë tyre në diasporë.

Pavarësisht se ku shkruhet dimensionin e saj artistik ka rrokur gjithë dimensionin e hapësirës botërore.

Ajo troket në çdo portë ku brenda saj ka një qenie njerëzore që lufton për ta bërë botën më të bukur dhe më të mirë.

Letërsia shqipe i ka kapërcyer kufijtë e trojeve të saj, çmohet e vlerësohet ngado, në çdo veprimtari që ka brenda saj përmasën botërore. Personazhet e letërsisë shqipe aq sa individualizojnë njeriun e shtrirjes gjeografike ku ata veprojnë, po aq lehtësisht u përgjigjen vlerave universale që mbart njeriu i kohëve moderne.

Veprat e artit, sidomos piktura, kanë shtegtuar anë e kënd botës dhe kanë përcjellë botën e pasur shpirtërore të shqiptarit, model nëpër kohëra i shpirtit paqësor dhe liridashës.

Në këtë leksikon enciklopedik ku përfshihen më shumë se 300 autorë të trojeve shqiptare dhe diaspora janë përfshirë të gjitha fushat e dijes njerëzore si shkencë, art, kulturë e letërsi.

Do të gjejmë personalitete të spikatura me kontribute shkencore dhe artistike që janë ngritur vazhdimisht drejt nivelit evropian dhe botëror. Duke lexuar bibliografitë e këtyre autorëve, lexuesi do të gjejë fushën e interesit të tij, do t' u drejtohet lehtësisht bibliotekave dhe librarive.

Ky botim do ta bëjë më të lehtë punën e studentëve dhe pedagogëve, të studiuesve dhe kërkuesve shkencorë.

Duke lexuar këtë libër enciklopedik do të vijë më e plotë pamja e gjithë arritjeve shkencore dhe artistike të deritanishme të realizuara nga Akademia Shqiptare Amerikane e Shkencave dhe e Arteve dhe të gjithë atyre shkrimtarëve dhe studiuesve që kanë bashkëpunuar me këtë institucion prestigjioz të trojeve shqiptare dhe në diasporë.

Akademik Flori Bruqi
mars 2020

Shkencë, Art, Kulturë, Letërsi



Science, Art, Culture, Literature

ADEM DEMAÇI (1936-2018)



Adem Demaçi u lind, zyrtarisht, më 26 shkurt 1936, kurse, si mësojmë nga romani “Libër për Vet Mohimin”, që ka pjesërisht edhe karakter autobiografik, u lind, në të vërtetë, në kosimet e dyta, dikund në korrik. Që nga lindja, me sa shihet, si çdo njeri i madh, do ta ndjekin vazhdimisht skajet e tipit shkurt-korrik. Derisa për njëren palë (për shqiptarët) do të jetë engjëlli mbrojtës i çështjes shqiptare, për palën tjetër (për serbët) do jetë satanai. Nëse lufta për liri shënon shkallën më të lartë të emancipimit kulturor të individit dhe të popullit, atëherë mund të thuhet me gjithë mend se Adem Demaçi është artikulusi më i kulluar dhe më i fuqishëm i aspiratave liridashëse të popullit tonë.

Adem Demaçi u rrit në një familje të varfër në Prishtinë. Babai, Zeqiri, i vdiq shumë herët nga tuberkulozi, kur Demaçi nuk i kishte mbushur as plot tetë vjet. Gjithë barra e familjes ra mbi të vëllain e tij të madh, Maliqin, i cili si gazetashitës, ia doli me shumë vështirësi të siguronte kafshatën e gojës për familjen tij, informatë kjo që mund të merret edhe nga tregimi i Demaçit “*Një Natë Bajrami*”. Por pas pesë, apo gjashtë vjetësh, i vdiq edhe i vëllai Maliqi, po ashtu nga tuberkulozi. Atëherë, për t’i mbajtur në jetë dy fëmijët e mbetur, Ajshen dhe Ademin, nënë Nazifja iu qep vekut dhe duke endur pëlhura të ndryshme, arriti t’i ushqente disi fëmijët, madje edhe ta shkollonte Demaçin, te tregimet “Vegjëtarja”, “Vegjëtarja në treg”).

Demaçi do ta mbarojë shkollën fillore në Prishtinë më 1946, ku do ta kryejë edhe Gjimnazin real. Studimet në Degën e Letërsisë Botërore do t’i ndjekë plot pesë semestra në Universitetin e Beogradit, por do të detyrohet t’i ndërpret për shkak të sëmundjes së nënës. Ndaj, u kthye në Prishtinë dhe gjeti punë në veprimtarinë botuese të ndërmarrjes “Rilindja”.

Burgosjes së tij të parë, më 19 nëntor 1958, do t’i paraprijë shpërngulja me dhunë e shqiptarëve në Turqi (“*Kthimi*”, “*Mestani*”), aksioni i armëve dhe Procesi i Prizrenit. Demaçin do ta goditë sidomos burgosja e gazetarit të devotshëm Sedat Dida, e cila do të ngjallë frikë e panik në mesin e punëtorëve dhe gazetarëve të “Rilindjes”. Në procesin gjyqësor të marsit të vitit 1959 të Gjyqit të Qarkut të Prishtinës, Demaçi do të dalë hapur me kërkesën që pa bashkimin e Kosovës me Shqipëri, nuk do

të ketë paqe në Ballkan. Për këto qëndrime të tij u dënua me 5 (pesë) vjet burg të rëndë. Gjyqi Suprem i Serbisë ia vërtetoi dënimin në 3 (tre vjet), të cilat i vuajti në kazamatën e Sremska Mitrovicës.

Pas lirimit nga burgu, nuk e linin të zinte punë, me qëllim që t'u kallnin edhe më shumë datën të tjerëve për pasojat që mund të kishin. Për më tepër, me ardhjen e Hrushçovit në Shkup, pas tërmetit të vitit 1963, Demaçin e izoluan dhe e mbajtën në burg përgjatë gjithë kohës sa qëndroi Hrushçovi në ish-Jugosllavi.

Megjithatë, në fillim të viteve '60, në disa qytete të Kosovës, si në Pejë, Gjakovë e gjetiu ishin krijuar organizata të ndryshme, që luftonin në mbrojtje të kauzës kombëtare. Duke parë disponimin e masës për t'iu kundërvënë terrorit dhe dhunës së shtetit totalitar, veçmas politikës së egër antishqiptare, Demaçi bëri çmos që të formohej Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, si dhe hartoi (bashkë me Ramadan Shalën, tash të ndjerë) Statutin dhe Programin e Lëvizjes. Lëvizja formoi komitetet e saj në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Mitrovicë, Gjilan, e cila ndërmoi një varg aksionesh për ngritjen e flamujve kombëtarë, u përpoq të vinte kontakte me lëvizjet e ndryshme revolucionare dhe ta propagandonte sa më shumë çështjen e pazgjidhur kombëtare të shqiptarëve në Ballkan. Megjithatë, kjo LRBSH u zbulua mjaft herët dhe Demaçi si kryetari i saj u dënua me 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burg të rëndë, të cilat në fillim i vuajti në Nish, e pastaj për ta larguar sa më shumë nga familja, e dërguan në Pozharevc, ku në kohën e ish-Jugosllavisë kishin vuajtur dënimet shumë atdhetarë shqiptarë, midis të cilëve edhe Azem Bejta. Po e theksojmë këtë fakt, sepse kjo mbase do të jetë arsyeja që Demaçi të shkruajë në shtator të vitit 1969 dramën e parë me titull "Popu" (shkurtim i fjalëve po-litika dhe pu-shka), dorëshkrimin e së cilës e nxori nga burgu Xhafer Mahmutxhiku, kryetar i Komitetit të Prishtinës, në një arkë me dy kapakë.

Pas ndryshimeve dekorative politike në ish-Jugosllavi më 1966, dënimin ia zvogëluan në 10 (dhjetë) vjet, të cilat i vuajti ditë më ditë deri më 8 qershor 1974.

Për herë të tretë ra në burg më 6 tetor 1975, në procesin e montuar politik dhe u dënua përsëri me 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burg të rëndë, vite këto të cilat do t'i vuajë në burgun famëkeq të Stara Gradishkës. Më 21 prill 1990, me urdhrin e Kryesisë shtetërore të ish-Jugosllavisë, lirohet pesë muaj e gjysmë para se ta kryente dënimin e plotë.

Janë proverbiale fjalët e tij pas daljes nga burgu: *"Që nga 21 prilli i këtij viti ndodhem në burgun më të madh në botë, që e njeh historia e*

njerëzimit - në burgun e Kosovës, ku më se dy milionë Shqiptarë nga regjimi hegjemonist-shovinist-terrorist janë zhveshur nga të gjitha liritë dhe të drejtat më elementare njerëzore e kombëtare”.

Për Demaçin, pas daljes së tij nga burgu u zhvilluan shumë debate, emisione e dokumentarë televiziv, si në Kosovë, ashtu edhe në hapësirat e ish-Jugosllavisë. Me Adem Demaçin u zhvilluan mijëra intervista nga gazetarët e gazetave shqiptare, ballkanike, evropiane, por edhe të Amerikës së largët. Të gjitha këto së bashku krijuan figurën monumentale të quajtur “Adem Demaçi”, duke pasur parasysh të gjitha aspektet si politike, historike, sociale e artistike të shoqërisë sonë që lidhen rreth tij.

Si luftëtarit më të paepur për lirinë e mendimit, si mbrojtësit më këmbëngulës të lirive dhe të drejtave të njeriut, Paramenti Evropian, më 4 dhjetor 1991, i dha Çmimin Saharov. Të theksojmë se këtë çmim deri më tash e kishin marrë: Saharovi, emrin e të cilit e mban, Dubçeku, Nelson Mandela, Marçenko, Aung Sun, disa nga të cilët (Mandela, Aung Su) u bënë më vonë edhe fitues të çmimit Nobel. Me këtë rast, në Parlamentin Evropian, Demaçi tha se duke më nderuar mua, keni nderuar popullin tim të shumëvuajtur, por gjithmonë liridashës, paqedashës e krenar.

Më 1993, Klubi i Rektorëve Universitarë në Madrid, Demaçit i dha Çmimin Special për Paqe, kundër racizmit, ksenofobisë, për qëndrim paqësor e tolerant dhe për përpjekje për të ndërtuar një të ardhme të mbështetur në të drejtat e njeriut dhe në shumësi kulturore, që do t'u bënin të mundshme grupeve etnike të ish-Jugosllavisë të jetonin së bashku në paqe e harmoni... Dhe kjo ndodhi pikërisht në kohën, kur qarqet shoviniste serbe e akuzonin për luftë nxitje?!

Në shkurt të vitit 1994, pesë anëtarë të Parlamentit të Norvegjisë e kandiduan shkrimtarin Adem Demaçi për çmimin Nobel për letërsi. Në shtator 1994 u kandidua sërish-tani për çmimin Nobel për Paqe, me ç'rast theksoi se ky është një nder për mua dhe një mirënjohje për popullin shqiptar. Ndërkaq, më 14 dhjetor 1995 Adem Demaçit iu dorëzua Çmimi për të Drejtat e Njeriut i Universitetit të Oslos. Demaçi, duke shprehur falënderimin për këtë çmim, tha: *“Këtë mirënjohje nuk e kuptoj vetëm si mirënjohje të punës dhe të luftës sime për të drejtat e popullit tim, por edhe si dëshirë të qeverisë e të inteligjencës paqedashëse norvegjeze që t'i tërheqë vëmendjen opinionit të gjerë ndërkombëtar për problemin e Kosovës”.* Prandaj, Adem Demaçi i kalon kufijtë e një simboli vetëm kombëtar, ai është personalitet dhe figurë globale, që bashkë me dy personalitetet e kohës së tij Nelson Mandela dhe Vasllav Havell mbyllën

historinë e përpjekjeve të popujve për liri e çlirim kombëtar të shek. XX.

Ndërroi jetë më 26 korrik 2018 në Prishtinë, Kosovë, në moshën 82-vjeçare. Sot Adem Demaçi prehet në Panteonin shqiptar.

Krijimtaria letrare

Adem Demaçi krijimtarinë letrare e filloi gjatë viteve të '50-ta në revistën letrare "Jeta e re" drejtuar nga Esad Mekuli, dhe më 1958 shkroi romanin e tij të parë *Gjarpinjtë e gjakut* që trajton temën e gjakmarrjes në viset shqiptare të Shqipërisë dhe Kosovës.

1. "Gjarpinjtë e gjakut" (roman), Jeta e Re, 1958.
2. "Gjarpinjtë e gjakut dhe novela të tjera" (zgjedhje), Nju-Jork, 1983.
3. "Gjarpinjtë e gjakut" (ribotim), "Zëri i Kosovës", Zvicër, 1984.
4. "Gjarpinjtë e gjakut" (ribotim), "Lumi", Lubjanë, 1984.
5. "Gjarpinjtë e gjakut" (i kthyer në gjuhën letrare), Prishtinë, 1990.
6. "Kur Zoti harron" (vëllim me tregime), Zëri i Rinisë, Prishtinë, 1990.
7. "Libër për Vet Mohimin" (roman), botoi autori, Prishtinë, 1994.
8. "Libër për Vet Mohimin" (ribotim), RBP AS, Skien Norway, 1994.
9. "La metamorfosi di Vet Mohim" (përkthyer nga N. Vlora), Romë, 1995.
10. Adem Demaçi, "Tung, vargu im", "Rilindaj", Prishtinë, 2002.
11. Adem Demaçi, "Heli dhe Mimoza", botoi autori, Prishtinë, 2006.
12. Adem Demaçi, "Dashuria kuantike e Filanit", Prishtinë, 2007.

Librat me intervista:

1. "Kosova flet vetë" (M. Emërllahu), "Zëri i Rinisë", Prishtinë, 1990.
2. "Njëzet e tetë vjet - as i gjallë, as i vdekur" M. Hanzhek), Lubjanë, 1990.
3. "Republika e Kosovës është shpallur në zemrën e popullit tim" (vëllim me intervista), "Zëri i Kosovës", Zvicër, 1990.
4. "Dhjetë mijë ditë robëri" (intervistoi F. Radonçiq), Danas, Zagreb, 1990.
5. "Kosova në udhëkryq", "Albanian Esperanto-Institut", Tiranë, 2005.

Shënim: Libri i tregimeve "Kur Zoti harron" ishte gati që në vitin 1958, por botohet pas plot 32 vjetësh. Në atë kohë botohen edhe dy fragmente: "Maliqi" dhe "S'ka paqe ndër kasolle" të romanit "S'ka paqe ndër kasolle", të cilin ia konfiskoi dhe nuk ia ktheu kurrë më policia.

Më 1969 autori shkruan dramën, si e përmendëm edhe më lart: "Politika dhe pushka", e cila u botua në vitin 1982 së bashku me kompletin e veprave të tij.

Për veprën letrare të Demaçit kanë shkruar: Nermin Vlora Falaski, Rexhep Qosja, Sadri Fetiu, Arben Hoxha, Teki Dërvishi, Rexhep M. Shala, Ramadan Musliu, Shaip Beqiri, Shkëlzen Maliqi, Abdullah Konushevc, Fatmir Halimi etj.

ABDYL KADOLLI (1946-2019)



Profesor Abdyl Kadolli u lind më 10 nëntor 1946 në fshatin Bukosh të Therandës.

Kishte mbaruar studimet themelore dhe ato pasuniversitare më 1974 për letërsi, në Prishtinë. Është shkrimtar, kritik, eseist e publicist, i cili tërë jetën u përpoq të japë ndihmesën e tij në shumë fusha, duke bërë përpjekje të vazhdueshme për të arritur në qëllimin parësor-lirinë dhe bashkimin e kombit. Abdyl Kadolli ishte intelektual dhe njeri me diapazon të gjerë. U angazhua në periudhat më të ndjeshme në veprimtari që gati do t'i kushtojnë me jetë. Pos punës si pedagog, publicist, shkrimtar, eseist, kritik, ai në vitet '90 të shekullit të kaluar do të bëjë një punë të veçantë si sekretar i Forumit të Intelektualëve Shqiptarë me seli në Prishtinë, me ç'rast do të rrëmbehet, do të torturohet e do të kërcënohet nga policia sekrete serbe për veprimtarinë e tij atdhetare dhe do të hidhej në shpatet e Gërmisë për t'ia ndalur veprimtarinë e tij. Por, përkundrazi, ai do të punojë e do të angazhohet veçanërisht pas këtij veprimi me tërë mundin e vullnetin për të dalë nga prangat e pushtuesit.

Si rezultat i punës së tij me përkushtim është vepra publicistike “Ora kombëtare” (“Ars”, Prishtinë, 2001), që do ta shohë dritën në vitin 2001. Ai ka botuar dhe vëllimin poetik “Këmisha e zjarrit” (“Rilindja”, Prishtinë, 1998), por ka lënë në dorëshkrim edhe disa vepra të pabotuara.


Abdyli gjatë viteve '80-ta e më pas është angazhuar edhe me ndihma materiale për të realizuar një varg aksionesh të veprimtarëve të lëvizjes çlirimtare. Këto dy dekadat e fundit ishte anëtar i Kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës dhe redaktor e kryeredaktor i revistës letrare të LSHK-së “Metafora”, të cilën e realizoi me profesionalizëm e përkushtim të veçantë, madje duke lënë shumë punë personale anash.

Ndihmesa e tij e dalluar ka qenë edhe në organizimin e manifestimeve tona letrare e kulturore, sidomos në dy takimet që tashmë janë tradicionale, festivali ndërkombëtar i poezisë “Drini poetik”, që mbahet më 9 e 10 qershor në Prishtinë, Prizren e Kukës dhe takimi letrar “Esad Mekuli” që mbahet në Prishtinë.

Shumë herë ka qenë anëtar jurie e pjesëmarrës në aktivitete letrare në Kosovë, në Shqipëri e në mjedise të tjera.

Vdiq në Prishtinë më 16 prill 2019.

ABDULLAH KONUSHEVCI (1958-2013)



Abdullah Konushevci u lind më 1 maj 1958 në Prishtinë. Njihet si njëri ndër shkrimtarët më të shquar shqiptar. Në Prishtinë mbaroi shkollimin fillor, të mesëm dhe të lartë. Studio letërsinë krahasimtare në "Universitetin e Zagrebit" . Punoi në gazetën e studentëve "Bota e re" dhe në gazetën "Rilindja". Pas mbylljes së "Rilindjes" (1990), kishte mbetur pa punë.

Ka botuar me qindra artikuj dhe recensione për letërsinë e shkruar dhe gojore, pra kryesisht është marrë me studime të çështjes së gjuhësisë dhe onomastikës, si dhe ka përgatitur për shtyp një numër të madh veprash e revistash letrare. Shumë poezi të tij janë përkthyer në anglisht, spanjisht, gjermanisht, rumanisht, sllovenisht, kroatisht, sllovakisht dhe turqisht. Ishte laureat i shumë çmimeve kombëtare për letërsinë, ishte dhe autor i disa teksteve shkollore për letërsi.

Konushevci si njohës i mirë i gjuhës angleze, gjatë jetës së tij është marrë edhe me përkthime, ku ka përkthyer disa prej autorëve të letërsisë botërore, si: Hemingëay, Tagore, Ludo Hupperts etj.

Për veprat e Abdullah Konushevcit kanë shkruar: Sylejman Syla, Xhemail Mustafa, Ibrahim Rugova, Kujtim Rrahmani, Vehap Shita, Hysni Hoxha, Ali Aliu, Abdyl Kadolli, Flori Bruçi, Merxhan Avdyli, Sabri Hamiti, Ramadan Musliu, Rushit Ramabaja, Milazim Krasniqi, Ismail Belaj, Ismail Syla, Salih Bytyçi, Emin Azemi, Nazif Zejnullahu, Medi Memishi, Rrustem Geci etj. Vdiq në Prishtinë me 30 nëntor 2013.

Abdullah Konushevci, ishte dhe do të mbetet ndër profilet më të kultivuara intelektuale albanologjike, një nga penat më të mprehta, i cili me erudicion dhe saktësi ka lënë gjurmë të përjetshme në letërsinë shqipe. Vdekja e hershme e Abdullahut, është humbje e madhe e familjes dhe miqve të tij, është humbje e një talenti, intelektualit dhe dijetari.

Konushevci ishte një krijues i ndershëm, me atë ndershmëri që mirrej me letërsinë po aq ndershmëri kishte me miqësinë. Konushevci ishte punëtor i pa epur, ishte në kulmin e dijes letrare i cili do të arrinte shumë, sikur nga jeta të mos e ndante vdekja në kohën më të mirë, kur ne dhe letërsia pritnim shumë nga ai. Jeta është një shpresë, një luftë për të arritur diçka madhore, megjithatë jeta tretet si hije, pa ia ditur kohën as vendin...Madje vdekja sikur i ngatërron kohët, godet rend e pa rend, godet

njerëz në kurorën e rinisë, kur ishin të pregaditur për hove dhe vllugje suksesesh. Kështu u godit Konushevci, një intelektual i shquar i letrave shqipe, i cili kishte shumë ëndrra, por sëmundja e rëndë dhe e pashëruar ia preu ëndrrat për gjysmë. Vdekja e Konushevcit është një humbje e madhe për shoqërinë dhe letërsinë tonë kombëtare.

Vëllime me poezi

1. Pasqyrë dhe diell (poezi, "Rilindja", Prishtinë, 1979),
2. Rënia e mollës (poezi, "Rilindja", Prishtinë, 1981),
3. Pad jabuke (serbisht, "Jedinstvo", Prishtinë 1982),
4. Qerrja e diellit (poezi, "Rilindja", Prishtinë, 1983),
5. Loja e strucit (poezi, "Rilindja", Prishtinë, 1987),
6. Të qenët të mosqenë (poezi, "Rilindja", Prishtinë, 1990),
7. Pikat AD (poezi, "Papyrus", Prishtinë, 2002),
8. Dashni dhe vdekje (poezi. "Nositi", Prishtinë, 2011),
9. Lutje dashurie (poezi, "Nositi", Prishtinë, 2012).

Tekste shkollore dhe kritikë letrare

10. Gjuha shqipe XI (libër shkollor, "Dukagjini", 2004, 2009)
11. Demaçi, vepra letrare (monografi, "Nositi", Prishtinë, 2008)
12. Për poezinë (kritikë letrare, "Nositi", Prishtinë, 2008)
13. At Gjergj Fishta 1871-1940 (monografi, përgatiti për shtyp Abdullah Konushevci, NOSITI, Prishtinë, 2011)
14. Romani 'Gjarpinjtë e gjakut' i Adem Demaçit (artikuj të zgjedhur letrarë nga Abdullah Konushevci, kritikë letrare), NOSITI, (2011)

Përkthime nga anglishtja

15. Rabindranath Tagore: Gitangjali dhe Mbledhja e frutave (botoi "Rilindja", Prishtinë, 1988);
16. Ernest Hemingëay: Dielli lind përsëri (botoi "Rilindja" në vazhdime, Prishtinë, 1989);
17. Ikona e lotëve (film dokumentar" (prodhim i vitit 2006), përkthyer nga shqipja në anglisht
18. Ludo Hupperts: Koncerti dhe tregime të tjera, (botoi Shtëpia botuese "Nositi", Prishtinë, 2008).

Përkthime nga kroatishtja

19. Teofrasti: Karakteret ("Rilindja", 1983),
20. M. Slaviček: Pse të mos jemi derisa jemi ("Rilindja", 1990),
21. Grup autorësh: Historia e letërsisë botërore, V ("Rilindja", 1989) dhe
22. Milan Shufflay: Histori e shqiptarëve të Veriut ("Nositi", 2009), etj.

ABDULLA MEHMETI



Prof. Abdulla Mehmeti u lind në Shipkovicë të Tetovës, më 2 janar 1962. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme në gjimnazin e Tetovës. Arsimin e lartë e kreu në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë - Dega Letërsi dhe Gjuhë Shqipe. Studimet pasuniversitare në fushën e kulturologjisë i ka ndjekur në Universitetin e Shkupit. Ka kryer kurse dhe specializime të tjera në fushën profesionale.

Gjatë studimeve në Prishtinë ka marrë pjesë aktive në lëvizjen studentore dhe në demonstratat e vitit 1981. Për bindjet e tij politike është dënuar me burg. Si i përndjekur politik nga ish-regjimi komunist jugosllav është privuar nga të drejtat për shkollim të mëtejshëm, punësim dhe veprimtari publike.

Me fillimin e proceseve demokratike, në vitin 1990, bashkë me intelektualë të tjerë dhe ish të burgosur e të përndjekur politik e ka udhëhequr këshillin rajonal në aksionin popullor për pajtimin e gjaqeve dhe hasmërive mes shqiptarëve në fshatrat e Malësisë së Tetovës.

Në janar të vitit 1990 e ka përgatitur programin dhe udhëhequr këshillin nismëtar për themelimin e Bashkësisë Kulturore Shqiptare, në gjithë hapësirën etnike shqiptare nën ish Jugosllavi, por me pavarësimin e Maqedonisë më 1991, kjo e drejtë u kufizua me ligj. Kuvendi themelues i kësaj organizate u mbajt më 19 gusht 1990, në Shipkovicë të Tetovës. Pushteti i atëhershëm themelimin dhe fillimin e veprimtarisë së kësaj organizate kulturore dhe atdhetare e luftoi me të gjitha mjetet dhe në të gjitha format, duke ngritur edhe proceseve gjyqësore të montuara për nismëtarët dhe aktivistët e saj.

Në vitin 1991, në kuadër të Bashkësisë Kulturore Shqiptare në Maqedoni e ka iniciuar mbajtjen e simpoziumit shkencor “Shqiptarët e Maqedonisë”, i cili i zhvilloi punimet në Medresenë “Isa Beu”, në Kondovë të Shkupit, më 20, 21 dhe 22 dhjetor të vitit 1991. Punimet shkencore të këtij simpoziumi kanë shërbyer si Platformë për zhvillimin e veprimtarisë politike, kulturore, arsimore dhe veprimtarive të tjera shoqërore dhe kombëtare të shqiptarëve në Maqedoni, në përpjekjet e tyre për liri, barazi dhe ndërtimin e një shoqërie të lirë e demokratike.

Në dhjetor të vitit 1993 e ka përgatitur Platformën për hapjen e Universitetit Shqiptar në Maqedoni, në të cilën janë përfshirë strategjia,

taktika dhe aktivitetet për themelimin, ngritjen dhe afirmimin e këtij institucioni të parë të arsimit universitar në gjuhën shqipe në Maqedoni. Pas një sërë aktivitetesh disamujore kjo ide u kurorëzua me sukses në Kuvendin themelues të Universitetit Shqiptar në Maqedoni (nga themelimi: Universiteti i Tetovës, sipas selisë së tij), i cili u mbaj më 4 qershor 1994, në sallën e konferencave të Kuvendit komunal të Tetovës.

Gjatë viteve 1994-1998, ka iniciuar dhe organizuar dhjetëra manifestime shkencore, arsimore, kulturore dhe artistike, si: simpoziume, tribuna shkencore, debate, tryeza të rrumbullakëta, festivale artistike dhe letrare, ekspozita, akademi për ngjarje dhe personalitete të shquar të historisë dhe kulturës kombëtare, si dhe ka nxitur dhe botuar një varg veprash të rëndësishme shkencore dhe letrare, nga autorë të njohur shqiptarë, përmes edicionit të botimeve të Bashkësisë Kulturore Shqiptare në Maqedoni. Në vitin 2002/2003 u punësuar profesor i gjuhës dhe komunikimit në shkollën e mesme “Moshë Pijade”, në Tetovë.

Në vitin 2007 u punësua në marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin e Tetovës, me detyrë për themelimin dhe organizimin e Seminarit të Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqiptare në kuadër të këtij Universiteti. Pas disa muajve e inicioi themelimin e këtij Seminari, si njësi akademike e Universitetit, i cili u mbajt për herë të parë në qytetin e Ohrit, me pjesëmarrjen e studiuesve shqiptarë të albanologjisë.

Veprimtaria ideore, shkencore dhe krijuese

Deri më tani ka publikuar me qindra punime shkencore dhe publicistike, artikuj, analiza politike dhe studime për kulturën, historinë, gjuhën dhe letërsinë shqipe, në shumë gazeta, revista dhe publikime të tjera. Ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore, simpoziume, tribuna dhe manifestime të tjera shkencore, në vend dhe jashtë vendit.

Nga viti 1990 deri më sot, ka përgatitur dhe publikuar një sërë programe dhe platforma për punën dhe veprimtarinë e disa organizatave dhe institucioneve kulturore, arsimore dhe shkencore, si dhe memorandume, rezoluta, deklarata dhe akte të tjera për çështjen e shqiptarëve në Maqedoni dhe çështjen shqiptare në përgjithësi.

Është autor i disa veprave shkencore dhe publicistike, të cilat pritet të publikohen në kompletin e veprave në 20 vëllime, ndër të cilat edhe monografia për Universitetin e Tetovës dhe monografi të tjera shkencore dhe vepra publicistike, për historinë, gjuhën, kulturën, jetën shoqërore dhe lëvizjen politike të shqiptarëve në Maqedoni, dhe jo vetëm...

ABDULLAH TROSHUPA



Abdullah Troshupa u lind më 26 nëntor 1953 në Ribar të Madh të Lipjanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen dhe Fakultetin e Filologjisë, Dega Letërsi dhe Gjuhë Shqipe i kreu në Universitetin e Prishtinës.

Nga viti 1978 e deri më 1996 ka punuar në Ndërmarrjen Tregtare “Duhani”, në Prishtinë. Nga shtatori i vitit 1996 e deri në pensionimin e tij, në vitin 2018, punoi profesor në SHFMU “Hasan Prishtina” në Llugaxhi të Lipjanit.

Me krijimtari letrare ka filluar të merret që nga viti 1972, ku vazhdon edhe sot. Shumicën e vjershave i ka botuar në gazeta dhe revista të Kosovës dhe Shqipërisë. Shkruan poezi, dramë për fëmijë dhe të rritur, si dhe monografi.

Veprat letrare:

1. “Porosia e vëllait” e botuar më 1995 në Prishtinë,
2. “Dallgët e shpresës” më 2006,
3. “Cigareshitësja” dramë për fëmijë më 2008,
4. “Kush më sollti në jetë”, 2011,
5. “Një det kujtimesh” 2016,
6. “Ora e gjyshit” 2017
7. “Zhvillimi i arsimit nëpër etapa kohore në Llugaxhi”
(Monografi, botuar në vitin 2018),
8. “Rinjohja” përmbledhja e tij e tetë (Dramë).

Në dorëshkrim ka një përmbledhje me poezi, si dhe një Monografi, që priten së shpejti të dalin në shtyp.

Gjatë karrierës së tij ka dëshmuar rezultate të shkëlqyera, si në shkollë, po ashtu edhe në komunën e Lipjanit. Është kryetar i Klubit letrar “Fazli Grajçevci”, që nga themelimi. Kështu që falë angazhimit të tij, në komunën e Lipjanit ka nxjerrë 23 krijues të rinj, të cilët kanë botuar vepra me poezi e tregime. Vepra e tij, “Cigareshitësja” i është skenuar në Kukës nga Aktorët Amatorë të Teatrit të Kukësit. Ai disa herë është shpërblyer nga vetë nxënësit si dhe Drejtorja e shkollës dhe ajo komunale.

Në kuadër të Klubit “Fazli Grajçevci” ka botuar shtatë numra të revistës “Aurora”, ku është edhe Kryeredaktor. Kjo revistë është e hapur për të gjithë anëtarët e saj dhe për krijuesit e tjerë, sidomos për krijuesit e rinj, të cilët kanë nevojë për përkrahje dhe promovim të krijimtarisë së tyre

në çdo manifestim kulturor që mbahet në Komunën e Lipjanit. Pra, revista i mirëpret krijimet nga të gjitha hapësirat ku jetojnë e veprojnë njerëzit e penës, të fjalës së bukur dhe kulturës lipjanase në përgjithësi. Kështu që synimi i revistës “Aurora”, është përfaqësimi dhe krijimi i opinionit publik letrar e kulturor në hapësirat ku jetojnë e veprojnë lexuesit tanë. Revista në fjalë tashmë është bërë tradicionale, sepse kjo është duke i përfshirë të gjithë krijuesit lipjanas.

Abdullah Troshupa gjatë punës së tij, në shkollën ku punoi, i nxori në dritë dhjetë numra të revistës shkollore “Kanarina”. Nga kjo revistë e mirëpritur nga Drejtoria e shkollës si dhe vet nxënësve pati mjaft sukses, sepse brenda kësaj periudhe, fal kësaj reviste, nga kjo shkollë dolën dy krijuese të reja me veprat e tyre me poezi si dhe me tregime. Ai ka organizuar orë letrare në shkollë jo vetëm me nxënës, por edhe me shkrimtarë të shumtë nga “Karvani i Shkrimtarëve për fëmijë Agim Deva” si me: Rifat Kukajn, Agim Devën, Gani Xhafollin, Xhevat Sylen, Ibrahim Kadriun, Hasan Hasanin, Jonuz Fetahun, Ramadan Mehmetin etj. Po ashtu edhe në kuadër të Drejtorisë së Kulturës në Lipjan ka udhëhequr “Javën kulturore”. Në këtë Javë kulturore merrnin pjesë të gjithë krijuesit e Komunës së Lipjanit. Poezitë më të mira shpërbleheshin nga Kryesia e Klubit. Abdullah Troshupa që nga viti 2004 organizon takimet letrare “Gjurmë të Gjeçovit” që mbahen për çdo vit në Janjevë. Në këtë manifestim kanë marrë pjesë studiues të shumtë, të cilët i kanë paraqitur kumtesat e tyre, po ashtu para lexuesve ishin edhe anëtarë të Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës si dhe anëtarët e klubit Letrar “Fazli Grajçevci”. Duhet veçuar Orën letrare “Ditët e Diasporës”, të mbajtura në Amfiteatrin e Shpellës së Mermerit në Gadime, ku morën pjesë shkrimtarë nga të gjitha anët e botës, si nga: Amerika, Zelanda e Re, po ashtu edhe nga Evropa. Troshupa është marrë edhe me skenë teatrore me nxënës aktorë, me të cilët shfaqi lojëra skenike, jo vetën në shkollë, por edhe në “Qendrën Korrektuese” në Lipjan. Është skenarist i filmit dokumentar “Zjarri që ndan dy epoka, “Shtëpitë-shkolla”, Gjimnazi “Sami Frashëri” Prishtinë. Është përfshirë në Leksikonin për fëmijë të Odhise Grillos, në leksikonin e Hasan Hasanit, në Fjalorin Enciklopedik “Autorë të letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj (1886-2017), autor Astrit Bishqemi - Migena Arllati si dhe në Antologjinë “Lulëkuqet e Lirisë”, autor, Dibran Fylli.

Është anëtar aktiv i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës dhe fitues i disa çmimeve letrare për poezi. Jeton dhe vepron në Prishtinë.

ABDURRAHMAN SHALA (1922-1994)



Abdurrahman Shala u lind më 25 tetor të vitit 1922 në Vushtrri dhe i përket gjeneratës së parë të kinematografisë kosovare. Ishte aktor, producent e skenarist filmi. Ishte drejtor i parë i studios së parë filmike “Kosova Film” dhe themeloi e udhëhoqi disa vjet Unionin e Artistëve të Filmit të Kosovës (UAFK), deri në vitin 1990.

Shala në fund të Luftës së Dytë Botërore, si partizan dhe si epror në një burg të Prishtinës, kishte ndal rutinën e vrasjes së shqiptarëve. Prandaj, janë pak njerëz në Kosovë, të cilët aktorin e madh kosovar, Abdurrahman Shala e njohin ndryshe, sepse ai përveç që ishte brilant në disa role filmi e dramash, pra ishte dinjitoz edhe në dramën e madhe Luftës së Dytë Botërore.

Në librin 'Vdekja e kolonisë', shkrimtari Ibrahim Berisha shkruan për guximin e madh të Abdurrahman Shalës, i cili ua shpëtoi jetën qindra shqiptarëve nga partizano-çetnikët në fund të Luftës së Dytë Botërore.

Filmografia:

- Para shiut (1994)
- Njeriu prej dheut (1984)
- Proka (1984)
- Përroi vërshues (1981)
- Tre vetë kapërcejnë malin (1981) (TV)
- Kur pranvera vonohet (1980) Seri televizive
- Era e Lisi (1979) Seri televizive
- Dervishi dhe vdekja (Dervis i smrt) (1974)
- Sutjeska (1973)
- Si të vdiset (1972)
- Beteja në Neretvë (Bitka na Neretvi) (1969)
- Uka i Bjeshkëve të Nemuna (1968)
- Kozara (1963)
- Kapedan Lleshi (1960)
- Të shtëna në qiell (1958), si dhe shumë role tjera në Teatër dhe filma, të gjitha të realizuar me sukses të lartë.

Skenarist filmi

- Brigada e VII e Kosovës (1974)
- Uka i Bjeshkëve të Nemura (1968)

ADEM KICAJ



Adem Kicaj, u lind në Grejkoc të Therandës më 18.07.1961. Gjatë viteve të gjimnazit të shkollës së mesme, ka luajtur në teatrin e Prizrenit, aty ku kaloi edhe i madhi, Bekim Fehmiu. Për katër vite, sa ishte gjimnazist, u mor vetëm me artin e dramës. Në teatrin e Prizrenit luajti gjithashtu disa role me rëndësi. U specializua për aktrim në Sarajevë, te dramaturgia, profesoresha G. Muzafëri, me poemën-dramë “Jama”-“Humnera”, dhe u diplomua me rolin e fantazmës. Me t'u kthyer nga Sarajeva, punoi me disa studentë të SHLP “Xhevdet Doda” të Prizrenit , dy drama e një komedi: ”Vëllazëri e interes” te Kristo Floqit dhe ”Bashkëshortët”, te Muharrem Qenës, si regjisor.

Punoi e bashkëpunoi me të ndjerin regjisor Fetah Mehmetin, Luljeta Çekun, Luan Kryeziun, Xhevdet Dodën, e shumë aktorë të tjerë.

Adem Kicaj, në vitin 1991, detyrohet, si i përndjekur nga pushteti i atëhershëm, të migroi në Zvicër.

Në Zvicër, Ademi kishte arritur si aktor dhe regjisor i pjekur. Me të vajtur në Zvicër kontakton me krijues të artit, gjithashtu filloi ta zhvillonte artin skenik të dramës dhe të filmit.

Me ndihmën e një kardinali katolik zviceran, në teatrin e kishës në Lenzburg të Aarut, Ademi përgatit, në ato vite, për komunitetin shqiptar, dramën “Hija e vdekjes”, ku njëherit ishte edhe autor i dramës, ku i jepet mundësi financiare për të studiuar gjuhën e skenës, teatrit dhe filmit në Cyrih, në mediumin “JOB TV”, në Zvicër, për 4 vjet rresht.

Kështu Adem Kicaj u specializua edhe duke studiuar për teatër dhe film, në shkollën për teatër e regji: “Internacional Film Theater Produktion”- IFTP, klasi e Peter U.Ksaba, ku u diplomua dhe mori titullin docent-pedagog, në Zug të Zvicrës.

Në vitin 2000 do të punësohet si aktor rezident pranë “Theater Maralam” dhe “Forum Zentrum” në Cyrih. Ademi këtu gjatë angazhimeve të tij aktorese, merr kontakt me ajkën e aktorëve zviceranë më të spikatur, duke lozur role në teatër dhe në film.

Po në këtë vit ai hapë shkollën-dega e aktrimit në gjuhën shqipe “Aleksandër Moisiu”, ku nga kjo shkollë do të dalin disa gjenerata aktorësh shqiptarë , këtu në Zvicër.

Adem Kicaj është edhe korreograf dhe mësues vallëzimi latin etj.

Filmografia dhe rolet në gjermanisht:

1. "Keller Film", dhe skenarist.
2. "Birth of the princ"(film, regjisor dhe scenarist).
3. "Dilema", (film dhe aktor)
4. "Strall", (film dhe aktor)
5. "Generation", (film-rolu kryesor në film)
6. "Skripo 333", (skenarist kryesor).
7. "Ven der Hahn singt", (skenarist kryesor).
8. "Heidi und Peter", (film i shkurtër, dhe regjisor)
9. "Ales vird gut", (film-aktor)
10. "Geige und liebe", (dokumentar, asisten regjisor)
11. "Tod in der gertneri", (film-aktor)
12. "Tod der einer erztin", (film-aktor).
13. "Diktatori Hitler"
14. "Che Gevara"
15. "Napoleonin"
16. "Othello"
17. "Aleksandër Moisiu"
18. "Hidhërimi dhe gëzimi"
19. "Forriku i dreqit"
20. "Metafora".

Filmat për TV, gjermanisht dhe shqip:

1. "Brezi", (film-aktor)
2. "Bodrumi", (skenarist e aktor)
3. "Amaneti", (film-komedi, skenarist e regjisor)
4. "Lambyrinth", (serial tv-aktor)
5. "192", (serial tv-aktor)
6. "Roco", (serial tv gjermanisht, aktor)
7. "Sunreis", (serial tv-aktor.
8. "Spurwekchsel", (aktor)
9. "Lost of found", (film tv-aktor)
10. "Kthetra", (novelë televizive -regjisor-ideator).

Aktori e regjisor i Adem Kicaj ka bërë edhe shumë recitale si dhe shumë monologje, të cilat i përshtaten kohës dhe aktualitetit tonë në kohën e sotme, por edhe për heronjtë e të gjitha kohërave.

Adem Kicaj, aktor/regjisor, aktualisht është drejtor artistik në TV "Ari" në Olten si dhe aktor e regjisor në teatrin zviceran e njohur "Theater Maralam" në Cyrih të Zvicrës.

ADEM AVDIA



Adem Kamber Avdia u lind në qytetin e Kukësit, më 15 qershor, të vitit 1956.

Arsimimin e mesëm të përgjithshëm e kreu në qytetin e Kukësit me rezultate të mira. Në vitet 1976-1980 kreu studimet në Akademinë e Mbrojtjes, ku mori titullin “Oficer aktiv”, duke shërbyer në radhët e Forcave të Armatosura të RSH, deri në vitin 2006 dhe për arsye të ristrukturimit të Forcave të Armatosura doli në rezervë. Gjatë periudhës së shërbimit në Forcat e Armatosura ka punuar në sektorin e komuni-kimit, aty

ku kishte studiuar, por edhe në sektorë të Personelit apo si Këshilltar ligjor i Njësisë Ushtarake.

Në vitin 2001 ka përvetësuar gjuhën gjermane dhe ka kryer një kualifikim afat mesëm për sektorin e komunikimit në Gjermani.

Në revistën “Mbrojtja”, por edhe në gazetat “Luftëtari” e “Ushtria” gjejmë vazhdimisht shkrime të tij.

Këtu spikasin shkrime si; mbi “Luftën elektronike”, mbi “Shpërndarjen e radiovalëve”, apo edhe studime të mirëfillta për organizimin e komunikimit në rajonin, ku vepronte dhe shërbente njësia e tij, ku ai komandonte.

Nuk kanë munguar shkrimet që kanë pasqyruar luftën e vitit 1999 në Kosovë.

Adem Avdia në shkrimet e tij ka dalë me përfundime e konkluzione të vyera se si duhet të organizohet komunikimi dhe si duhet të shmangim ndërhyrjet reciproke të reparteve në luftim me kundërshtarin përballë.


Në shtypin e kohës gjejmë edhe artikuj tematikë, me problemet që kalonte ushtria dhe rruga se si mund të dilej me zgjidhje.

Ka botuar librin monografik “*Fejzallarët në vështrimin tim*”, ku paraqet jo thjeshtë personat fizik të fisit, por nëpërmjet tyre luftën dhe përpjekjet e popullit të Lumës për liri e pavarësi, që nga koha e Tanzimatit e deri në çlirimin e vendit.

Libri i dytë i tij është me poezi “*Unë dhe Ti në 55 poezi*”, ku është pasqyruar përvoja e tij ndër vite, përjetimet njerëzore dhe intelektuale.

Ka në botim librin “*Ushtria-përjetime në mjegullnajë*”, ku nëpërmjet tregimeve, skicave e humorit të hollë pasqyron jetën e thjeshtë ushtarake, larg asaj jete të pasqyruar në media dhe në shtypin e kohës.

ADEM HARXHI



Dr. MD. Adem Harxhi u lind më 16 janar 1936 në Gjirokastrë. Në vitin 1960 diplomoi në Fakultetin e Mjekësisë dhe caktohet Pedagog në Klinikën e Neurologjisë së Fakultetit. Ai ngriti të parin repart të okulistikës (syrit), që u shërbente rrethëve në Gjirokastrë, në Sarandë, në Tepelenë dhe në Përmet.

Në vitin 1969 emërohet drejtor i spitalit të Gjirokastrës duke ushtruar edhe detyrën e mjekut okulist, detyra të cilat i mbajti deri në vitin 1986, kur u emërua mjek pranë ambasadës së Shqipërisë në Budapest-Hungari.

Për shumë vite, deri sa u largua nga Gjirokastra, ka qenë pedagog i Fiziologjisë dhe Anatomisë në degët e “Biologjisë” dhe në atë të “Çiklit të Ulët” të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë.

Në fushën e organizimit shëndetësor, Dr. MD. Adem Harxhi ka botuar dhe referuar shumë në shtypin vendës, tema shkencore, kudo nëpër rrethet e Shqipërisë.

Në vitin 1993 emigroi familjarisht në ShBA, ku për asnjë moment nuk u shkëput nga studimet e mjekësisë.

Në vitin 1994 është ndër nismëtarët, së bashku me Prof. Dr. Skënder Kodra dhe Prof. Ulvi Vehbiu, që kërkuan nga shteti i New Yorkut lejen për të themeluar Akademinë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe të Arteve. Pas aprovimit të saj, ai është zgjedhur dhe vazhdon të jetë nënkryetar i kësaj Akademie dhe Kryeredaktor i revistës së Akademisë së Shkencave dhe Arteve Shqiptaro-Amerikane “*Ditura*”, në New York.

Në vitin 2000, duke qenë në emigrim, botoi librin “*Janë Sytë e Tu*”, një libër me karakter shkencor popullor, me të cilin vënte në dijeni shqiptarët për rezultatet e operacioneve në sy me laser dhe heqjen e syzave. Gjatë qëndrimit në emigracion, pati mundësinë të punojë në një fushë që ka qenë pasioni i tij i vjetër, në fushën e seksualitetit dhe seksit.

Pas një studimi shumëvjeçar dhe duke përfutur nga eksperiencia e disa prej klinikave më të mira të seksterapisë në Amerikë, gjatë vitit 2002, Dr. MD. Adem Harxhi shkroi traktatin “*Seksualiteti dhe Seksi*”

Me insistimin e tij dhe duke rezistuar, u angazhua në edukimin seksual të njerëzve në një nga stacionet televizive të vendit - “*Gjeli Vision*”.

Në këtë mënyrë Dr. MD. Adem Harxhi u bë pionier në fushën e edukimit seksual të njerëzve në Shqipëri.

Ai ngriti në Tiranë shoqatën “*Respekt, për problemet seksuale*”, që synon edukimin seksual të njerëzve veçanërisht të rinisë. Në vitin 2003, boton një libër shumë të vlefshëm dhe shumë interesant me titull: “*Fëmijët duan të dinë për seksin*”. Në këtë libër gjenden përgjigjet për rreth dyqind pyetje që prindërit dhe fëmijët i kanë drejtuar doktor Adem Harxhit.

Ne vitin 2011, boton librin “*Në sinkron me natyrën*”. Në këtë libër Dr. MD. Adem Harxhi u jep përgjigje shumë pyetjeve që lidhen me faktin se si influencon jeta e shëndetshme seksuale në shëndetin e grave, veçanërisht, në shfaqjen e kancerit të organeve gjinitale dhe gjirit.

Në Televizionin “24 News” të Tiranës, emisionet e tij janë shumë të njohura “*Linja kuqe*”, ku shikuesit bëjnë pyetje të drejtpërdrejta.

Në vitin 2004 Televizioni Qendror i Lubjanës Slloveni, realizoi një emision televiziv me Dr. Adem Harxhin për problemet e seksit, si një eksperiencë të vlefshme për Slloveninë.

Në shtator të vitit 2015 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të Gjirokastrës iu dha titulli “*Qytetar Nderi*” për doktorin e shkencave andragogjike Adem Harxhi.

Veprat e botuar:

1. Fëmijët duan të dinë për seksin
2. Janë sytë e tu
3. Në sinkron me natyrën
4. Seksualiteti dhe seksi
5. Nëpër xhunglën
6. Seksi është gëzim seksual
7. Te mësojmë për seksin
8. Tim biri

Adem Harxhi, përveç kontributit për themelimin e Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencave dhe Arteve, ai krahas aktiviteteve që i kishte në këtë Institucion Shkencor, punoi edhe shumë punime, studime shkencore në fushën e mjekësisë...

ADEM MIKULLOVCI



Adem Mikullovcu u lind në vitin 1030 në Vushtrri, Kosovë, bënë pjesë në plejadën e aktorëve të ish-Teatrit Popullor Krahinot (tashmë Teatri Kombëtar i Kosovës).

Pas ndërprerjes së studimeve në Akademinë për Teatër dhe Film në Beograd në vitin 1968 kthehet në Prishtinë dhe fillon punën në teatër. Prej vitit 1968 e deri në korrik të vitit 1990, Adem Mikullovcu bëri një karrierë me 45 role kryesore, si dhe 70 role të dyta në shfaqje teatrore. Rolet më të dalluara i realizoi në shfaqjet: “Duke pritur Godonë”, “Po shkoj për gjah”, “Njeriu që pa vdekjen me sy”, “Dashuria”, “Hotel Kashta”, me rekord shikueshmërie, “Fundi i botës”, “Miza në vesh”, “Erveheja” etj. Mikullovcu gjithashtu ishte regjisor i disa shfaqjeve në teatër, si: “Pas vdekjes”, “Mosha e bardhë”, “Dan Shejtani”, “Engjëlli i stacionit”, monodrama “Bihorasit”, “Ti mos u përziej”, komedia “Shtrati”, “stend up” komedia “Përgjuesi” etj.

Filmografia:

Proka (1984), aktrim
Kur pranvera vonohet (1980)
Era dhe Lisi (1979)
Sulmi i kuq (1974)
Kur isha ushtar (Kad sam bio vojnik) (1969)
Vakti e han kashtën I (2009)

TV produksion:

Kafeneja jonë (2004-2013), serial humoristik
Oda e Junikut, film televiziv, Regji/aktrim
Duke pritur Godonë (1977), dramë - aktrim
Ditari i Lec Pazhecit (1975), komedi - aktrim
Qesh e ngjesh (1982)
Burleska, komedi
Çka ka shpija (2014), aktrim

Videoproduksion:

“Mahmutovitët dhe Rexhepovitët”, “Vjeshtë e zyrtë e profesor Nexhatit”, “Kur do të kthehet Remziu”, “Katunar e sheherli”, “Mëhalla jonë”, “Qëndresa Sadri Ilapjani”, “Të gjithë me në (2000)”, “Mësuesi”, “Një pallto për babin tim në burg”, “Një buqetë buzëqeshje”...

ADEM ZAPLLUZHA




Adem Zaplluzha u lind më 1943 në Prizren, shkollimin fillor dhe atë të mesem i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Ka filluar të merret me shkrime që nga moshë rinore.

Me shkrime është marrë shumë herët, ku botimet e para i ka që nga viti 1957. Është fitues i shumë shpërblimeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Ka të butuar gjithsejtë 189 libra kryesisht me poezi. Në maj të vitit 2013, Klubi i Artistëve dhe i Shkrimtarëve të Durrësit, ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe.

Veprat letrare

1. "Puthje", poezi, "Rilindja", Prishtinë, 1974. 2. "Ecjet e viteve të mëdha", poezi, 3. "Çamarrokët e Thepores", 4. "Muret", 5. "Morfologjia e dhembjes", 6. "Ai vjen nesër", 7. "Letër nga mërgimi", poezi, 8. "Letër nga mërgimi", 9. "Udhëndarja", 10 "Thirrje e gjakut", 11. "Asgjë sikur molla", 12. "Vesa në lotin tim", 13. "Puthja e gozhduar", 14. "Kashelasha në vargje", 15. "Pema e bekuar", E përkthyer rumanisht, 16. "Bajraktarët e vatanit", 17. "Hijet e ndryshkura", 18. "Stuhi në Kutulishte", 19. "Posa ikte nata", 20. "Loja e myshqeve", 21. "Lumëbardhi dhe gjëma", 22. "Metafora e heshtjes", 23. "Hyji në Prekaz", 24. "Sinorët e hinores", 25. "Don Kishoti dhe Rosinanti", 26. "Zjarri i dashurisë", 27. "Kur likenet vallëzojnë", 28. "Ditari në vargje", 29. "Tingujt që nuk përfundojnë", 30. "Shtegu i mallit", 31. "Korniza e thyer", 32. "Zgjimi i gjëmës", 33. "Vallja mistike", 34. "Merre kodin", 35. "Letër atdheut", 36. "Tejdukshmëria e shiut", 37. "Përtej teje", poezi, 38. "Sa afër e sa larg", 39. "Vallja e zanoreve", 40. "Ikja e eshtrave", 41. "Kalorësit e mjegullave", 42. "Hingëllimat e shiut", poezi, 43. "Kur pemët i ndërrojnë këmishët", 44. "Mirëmëngjesi Imzot", 45. "Kafshimi i mikut", 46. "Atje tej maleve", 48. "Portat e shpresës", 49. "Në dhomën time gjysmë të errët", 50. "Kinse Lojë Shahu", 51. "Për çdo dekadë nga një baladë", 52. "Fusha e mëllenjave", 53. "E kujt është kjo vetmi", 54. "Mos pyet për adresën e lumit", 55. "Stoli në parkun vjetër", 56. "Urori i stralltë", poezi, 57. "Po të mos ishte fjala", 58. "Thyerja e urave", 59. "Trokëllimat në gjumin e dallgëve", 60. "Në flokët e dëborës", 61. "Një grusht nostalgji", 62. "Kur filluan të flasin njerëzit", 63. "Kur stinët kapërcejnë fshehurazi", 64. "Lisi në rrënjët e veta", si dhe shumë libra tjerë.

ADEM ZEJNULLAHU



Prof. Dr. Adem Zejnullahu, studiues i letërsisë gojore dhe i letërsisë së shkruar shqipe, shkrimtar e profesor universitar. U lind në Banjskë, komuna e Vushtrrisë.

Kreu shkollën normale, studimet e larta të gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Universitetin e Prishtinës (1972); po aty studimet pasuniversitare, ku mbrojti doktoratën në shkenca filologjike (1986). Deri më 1982 punoi mësimdhënës i gjuhës dhe letërsisë shqipe në shkolla të ndryshme të Prishtinës dhe në Mitrovicë. Prej vitit 1982-2010 punoi në Institutin Albanologjik të Prishtinës, në fillim hulumtues i pavarur, këshilltar shkencor dhe përgjegjës i degës së folklorit për disa vjet. I është kushtuar studimit të krijimtarisë gojore dhe prozës së shkruar, këngëve popullore historike dhe baladave popullore.

Veprat letrare:

- ”Kur zgjohen ernat”, “Rilindja”, Prishtinë, 1969
- ”Mote hiri”, “Rilindja”, Prishtinë, 2000
- ”Zogu i stuhive” (vjersha për fëmijë), Prishtinë, 2001
- ”I vetëm me ëndrrën”, “Faik Konica”, Prishtinë, 2007
- ”E di vetëtima”, “Faik Konica”, Prishtinë, 2009
- ”Erërat e mbarsura me mjegull”, Prishtinë, 2011
- ”Dhembje shiu”, Prishtinë, 2012
- ”Njëqind fabula “, Prishtinë, 2012
- ”Me ty çel trëndafil” (vjersha për fëmijë dhe të rinj), 2014
- ”Kush ia di udhën erës” (vjersha për fëmijë dhe të rinj), 2017
- ”Deri në fund“, Prishtinë, 2018
- ”Krijime alegorike në prozën popullore”, Prishtinë, 2018
- ”Prozë popullore”, Prishtinë, 2018
- ”Lekurëharta ime”, Prishtinë, 2019

Veprat shkencore:

- ”Krijimtaria gojore dhe proza e shkruar shqiptare në Jugosllavi”, 1987
- ”Disa vërejtje për poezinë popullore”, IAP, Prishtinë, 1996
- ”Hulumtime në letërsinë popullore”, IAP, Prishtinë, 2005
- ”Këngë dhe shkrime”, IAP, Prishtinë, 2009
- ”Vuajtja dhe qëndresa në këngë historike”, IAP, Prishtinë, 2010
- ”Këngë, ngjarje dhe vështrime”, IAP, Prishtinë, 2012, etj.

AFRIM SPAHIU



Afrim Spahiu, Profesor, drejtor fotografie dhe producent arti, u lind në Dibër të madhe me 3 maj 1951. Jeton në Prishtinë, Kosovë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, ndërsa studimet e larta në Akademinë për Teatër, Film dhe Televizion në Universitetin e Zagrebit, në klasën e prof. Nikola Tanhofer. Në vitin 1975-1976 punoi si kinematograf filmi në Radio Televizionin e Prishtinës (RTP). Më 1976-1999 ishte drejtor fotografie në Kosovafilm. Më 1981-1983 punoi bashkëpunor profesional në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, ligjëroi lëndën e Fotografisë në katedrën e Dizajnit. Që nga viti 1975-2010 punoi drejtor fotografie, menaxhues dhe realizues i disa projekteve artistike, komerciale, fotografi për katalogë, kalendarë dhe prezantime në media. Ligjëroi lëndën Fotozhurnalizmi në Fakultetin e Gazetarisë "Faik Konica" në Prishtinë. Më 2003, ishte Drejtor ekzekutiv dhe koorganizator i Fotomaronës të I-rë, Prishtinë. Prej 2002-2005, themeloi, ligjëroi dhe menaxhoi Institutin e Fotografisë dhe filmit "Gjon Mili" në Prishtinë. Në vitin 2005, Kuroi ekspozitën ndërkombëtare të fotografisë artistike "Gjon Mili", edicioni V, në Galerinë Kombëtare të Arteve në Prishtinë.

Prej vitit 1981-2018, është anëtar dhe kryetar i shumë Jurive profesionale, kombëtare dhe ndërkombëtare, në fushën e filmit dhe arteve pamore. Prej 2007-2009, ligjërues dhe trajnues profesional në Institutin e Medias të Kosovës (IMK) në Prishtinë. Prej 2007-2019, ligjëroi si prof. i angazhuar lëndën: Fotografia Analoge dhe Dixhitale/Fotografia Filmike dhe Televizive, në Universitetin AAB Prishtinë dhe Universitetin Shtetëror të Tetovës. Më 2007 fiton titullin Magjister Arti nga Universiteti i Zagrebit.

2012-2018. Selektor dhe bashkëkoordinator në shtatë edicione të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit – TIFF ODA – Tetovë.

2013 - Kuroi Ekspozitën personale: Petrit Ukëhajdaraj - fotografi artistike. 2013 - Anëtar i Jurisë në TIFF (Tirana International Film Festival), edicionit XI. 2013 - Kuroi Ekspozitën personale: Arben Lllashtica - fotografi artistike. 2014 - Punëtori (Workshop): Fotografia digjitale - Universitetin Shtetëror të Tetovës.

2017 - Anëtar i Jurisë në Bienalen ndërkombëtare të fotografisë "GJON MILI", edicioni XV.etj

Drejtor Fotografie:

- "117", Dokumentar me metrazh të shkurtër, (1977).
- "Dita e mërgimtarëve", Dokumentar (1978).
- "Shota", Dokumentar (1979).
- "Gjyshi", Dokumentar (1980).
- "Loja e rufaiëve", Dokumentar, "Ah Xho", Dokumentar.
- "Gjurmët e bardha", Film artistik.
- "Me arbëreshët e Italisë", Dokumentar (1981).
- "Lepuri me pesë këmbë" (1982),
- "Përroi vërshues", Film artistik. (1983) "Proka", Film artistik (1986).
- "Kolonel bunker", Film artistik (1996).
- "Lule të kuqe, Lule të zeza", Film artistik (2002).
- "Trishtimi i zonjës Shnajder", Film artistik (2005).
- "Anatema", Film artistik (2006). "Banka",
Film i shkurtër artistik (2008).
- "Gomarët e kufirit", Film artistik (2008-2009).

Ekspozita vetjake të fotografisë artistike:

- Në vitin 1973, Pallati i Kulturës, Dibër e Madhe, Republika e Maqedonisë.
- Më 1985, Galeria Kombëtare e Arteve në Prishtinë, Kosovë. 1986 - Photo Gallery, Novi Sad, Vojvodinë.
- Më 1986, Art Gallery Ricard Jakopic, Lubjanë, Slloveni.
- Më 1986, Photo Gallery, Piran, Slloveni.
- Më 1987, Art Gallery Dom Mladih, Sarajevë, Bosnje Hercegovinë.
- Më 1993, Caffe Art Gallery - Pejë, Kosovë.
- Në vitin 2013, Galeria Kombëtare e Kosovës, Prishtinë.
- Më 2014 - Galeria e Ministrisë së Kulturës "Qafa", Prishtinë.
- 2019, Galeria Kombëtare e Maqedonisë Veriore "Çifte Hamam", Shkup.

Çmimet:

- Çmimi për fotografinë më të mirë nga ekrani TV - Emisoni Maksimetar TVB. - Beograd, Ex-Jugosllavia (1969).
- Çmimi për fotografinë më të mirë nga SHAAK (Shoqata e Artistëve Aplikativë të Kosovës) 1977.
- Çmimi GRAND PRIX për filmin "117" në Beograd, Ex-Jugosllavia në Festivalin XXIV të Filmit Dokumentar dhe Metrazhit të Shkurtër 1977.
- Mirënjohje "Milton Manaki", Festivali XXVII jugosllav i Filmit Dokumentar dhe i Metrazhit të Shkurtër, Beograd. 1980. Etj.
- Afrim Spahiu jeton dhe vepron në Prishtinë.

AG APOLLONI



Prof. Ag Apolloni u lind më 13 qershor 1982, në Kaçanik. Shkollën fillore dhe gjimnazin i ka kryer në vendlindje, kurse studimet për Dramaturgjri dhe studimet për Letërsi, i ka mbaruar në vitin 2005, në Universitetin e Prishtinës. Për shkaqe ekonomike, në vitin 2006 ka ndërprerë studimet në Filozofi dhe për dy vjet rresht. Në vitin 2008, Ag Apolloni merr titullin Master i Shkencave Filologjike, kurse në 2012 merr titullin Doktor i Shkencave Filologjike.

Ag Apolloni aktualisht është profesor në Universitetin e Prishtinës, ku punon që nga viti 2008.

Apolloni ka punuar si gazetar, redaktor dhe kryeredaktor në disa gazeta ditore, revista letrare dhe kulturore në Prishtinë.

Në vitin 2010 e ka riaktivizuar dhe e ka udhëhequr për tre vjet revistën më të vjetër letrare në Kosovë, “Jeta e Re” (e themeluar më 1949), e cila ka qenë mbyllur më 2006. Në vitin 2013, themelon revistën kulturore “Symbol”, në të cilën ka realizuar intervista me: Linda Hutcheon, Jonathan Culler, Rita Dove, Raoul Eshelman, Gottfried Helnwein, Andreas Huyssen, Mieke Bal, D. M. Thomas, Javier Cercas etj.

Tekste dhe vepra të Apollonit janë përkthyer në disa gjuhë, si: anglisht, gjermanisht, italisht, çekisht, maqedonisht, serbisht etj.

Veprat -Romane:

-Ulurima e Ujkut (2013). - u shpall romani më i mirë i vitit 2013, (çmimi “Rexhai Surroi”). Zazen (2014)

Poezi:

-Zomb (2009), - u shpall libri më i mirë poetik i vitit nga Ministria e Kulturës e Republikës së Kosovë në vitin 2010.

Drama:

Drama: Stefani, Halloween, Judita, Mat (2010), Hamleti simbas Horacit (2017), u shpall drama më e mirë e vitit nga Teatri Kombëtar i Kosovës, Skenderbeu: Manuskripti i Marlout (2018)

Kritikë:

-Parabola postmoderne (2010)

-Paradigma e Proteut (2012).Libri më i mirë kritik i vitit nga MKRS, për librin “Paradigma e Proteut” (2013)

-Koferi i Konicës (2016) dhe **Non-fiction:** Mesjeta ime (2019).

AGIM ÇAVDARBASHA (1944-1999)



Prof. Agim Çavdarbasha u lind në Pejë, më 24.03.1944. Shkollën e Mesme të Artit figurativ e kreu në Pejë. U diplomua në Degën e Skulpturës në Akademinë e Arteve, në Beograd. Në vitin 1969 hapi ekspozitën e parë në Galerinë e Shtëpisë së Rinisë në Beograd dhe mori Çmimin “Talentët e Rinj” të gazetës “Borba”. Më 1970 u bë anëtar i SHAF të Kosovës dhe mori pjesë pothuaj në gjithë ekspozitat e saj. Më 1971 kreu studimet pasuniversitare në Akademinë e Arteve të Universitetit të Lubjanës, në klasën e prof. Z.

Kalin dhe mori Çmimin e Preshernit.

Më 1974 u zgjodh pedagog i Akademisë së Arteve Figurative të Universitetit të Prishtinës . Punoi një kohë në ShLP dhe themeloi degën e skulpturës. Më 1975 hapi ekspozitën personale të portreteve. Çavdarbasha realizoi një seri bustesh e shtatoresh të personaliteteve të shquara historike, si shtatoren e Sulejman Vokshit, Abdyl Frashërit dhe Ymer Prizrenit, kjo e fundit e punuar me një metodë unike, sipas kafkës së zhvarrosur bashkë me një antropolog hungarez.

Njihet si mjeshtër i rrallë në mellë, shkathtësi kjo që vërehet veçanërisht te skulpturat e derdhura në bronz.

Në vitin 1978 mori Çmimin e Dhjetorit të Kuvendit të Kosovës dhe Çmimin e Sallonit Pranveror të SHAFK.

Nga viti 1985 nisin shqetësimet me shëndetin. Ai qëndroi një vit në spitalin e Lubjanës. Atelieja e Çavdarbashës në rrethinat e Prishtinës u shndërrua në një nga ambientet e shquara artistike, në të cilën në kohën e represionit mbi shkollat shqipe mbante dhe mësim.

Ka marrë pjesë në disa simpoziume të skulpturës bashkëkohore.

Është ideator i Simpoziumit të Skulpturës Bashkëkohore të Universitetit të Prishtinës,.

Më 1994 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ndërsa më 1996, anëtar i rregullt.

Më 1995 qëndroi katër muaj në shtëpinë e Heinrich Böll-it në Langenbroich të Gjermanisë, në kopshtin e së cilës edhe sot ndodhet një nga skulpturat e realizuara atje.

Në vitin 1995 e shpalli, Galeri të Hapur, atelienë e tij në fshatin Çagllavicë. Vdiq në Prishtinë më 20 tetor 1999, pas shumë shqetësimeve me shëndetin, pa e ndërprerë punën deri në çastet e fundit të jetës.

Veprimtaria Artistike - Ekspozitat e pavarura:

- Beograd, Galeria e Shtëpisë së Rinisë, 1969.
- Prishtinë, Ekspozita e portreteve, Foajeu i Teatrit Popullor, 1975.
- Lubjanë, “Mala Galeriija”, 1979.
- Prishtinë, Galeria e Arteve, 1981.
- Zagreb, Galeria “Forum” (bashkë me M. Mulliqin), 1982.
- Prishtinë, Klubi i Artistëve, 1986.
- Grozhnjan (Kroaci), Galeria KO, 1989.
- Prishtinë, Instituti Albanologjik, 1991.
- Grozhnjan (Kroaci), Galeria KO, 1991.
- Gjatë viteve 1992-1995, u hapen disa ekspozita me punimet e Agimit në kafe-galeritë e Prishtinës, Pejës dhe Prizrenit.
- Tiranë, Qendra Ndërkombëtare e Kulturës, në kuadër të takimeve “Ditët e kulturës shqiptare të Kosovës”, 1993.
- Langenbroich, (Gjermani), Heinrich Böll Haus, 1995.
- Eifel (Gjermani), 1995.
- Prishtinë, Galeria “Dodona”, 1997.
- Ekspozita e portreteve, Restaurant-Galeria “Hani i 2 Robertëve”, 1997,
- Prishtinë, Galeria e Arteve e Kosovës, 2001.

Ekspozitat më të rëndësishme kolektive:

Në vitin 1971, Me grupin AAF, Lubjanë, në “Mestna Galeria”.

Në vitin 1972, Bienali IX i Aleksandrisë, në Egjipt.

Në vitin 1973, Salloni i Tetorit, Beograd dhe Bienali i Plastikës së vogël, në Murska Sobota, Slloveni.

Në vitin 1975, Bienali i Plastikës së vogël, në Murska Sobota, Slloveni.

Në vitin 1977, Me grupin “Junij”, në Lubjanë dhe në Kranj, Slloveni.

Çavdarbasha u paraqit me ekspozita edhe në: Murska Sobota, Gjermani e në Paris, Hungari, Rumani, Bullgari, Zelandë të Re, Maribor, etj.

Agim Çavdarbasha, ishte dhe mbeti njëri ndër mjeshtrit më të spikatur të Arteve figurative, të skulptures bashkëkohore dhe pedagog i shquar në Akademinë e Arteve. Nuk mund të flitet për artet figurative e sidomos për skulpturën bashkëkohore e të mos përmendet emri i tij, sepse në këtë fushë çdo gjë lidhet me emrin e Agim Çavdarbashes...

AGIM RAMADANI (1963-1999)



Agim Ramadani u lind në fshatin Zhegër të Komunës së Gjilanit, më 3 maj të vitit 1963. Të parët e familjes së tij vinin nga Malësia e Karadakut, pikërisht nga fshati Depcë afër Preshevës.

Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, të mesmen, shkollën teknike në Gjilan, në vitin 1980, ndërsa Akademinë Ushtarake-drejtimi i komunikacionit në Zagreb të Kroacisë, ku edhe punoi si ushtarak.

Me fillimin e luftës në Kroaci, ai braktisi Armatën Jugosllave, aty ku punonte si oficer dhe më vonë migroi në Zvicër, ku fitoi statusin e emigrantit politik.

Agim Ramadani, në vitin 1998 pranohet anëtar nderi në Akademinë Evropiane të Arteve. Ndonëse kishte të rregulluar statusin e emigrantit, në vitin 1998, Agim Ramadani iu përgjigj thirrjes së atdheut, duke u radhitur në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Gjatë luftës çlirimtare u dëshmuua si strateg i lartë dhe udhëheqës i mirë e i dashur për ushtarët e vijave të frontit. Ishte njëri ndër hartuesit e planit për thyerjen e kufirit shqiptaro-shqiptar, gjë të cilën e realizoi me sukses bashkë me shokët e tij të luftës. Agimi ishte i pari që shkuli gurin-piramidën-kufitare në Koshare. Pas thyerjes së kufirit, në pjesën e Kosovës, tek vendi i quajtur Zharret, ra heroikisht- duke mos vdekur kurrë. Agimi njihej me emrin konspirativ-Katana dhe llogaritet si një nga heronjtë më të njohur të historisë së re shqiptare. Në Gjilan, para Teatrit, i është ngritur shtatorja, në të cilën janë komponuar të gjitha elementet artistike dhe ushtarake të komandant Katanës.

Agim Ramadani me poezi dhe pikturë është marrë që nga shkollimi i mesëm. Përderisa poezitë e tij, sa ishte gjallë, i mbetën të shpërndara nëpër revista të ndryshme, shumë prej tyre mbetën edhe në dorëshkrim, të cilat u botuan pas rënies së tij në një vëllim poetik me titull: “Një jetë tjetër”, të botuar në Prishtinë, në vitin 2002. Si piktor, Agimi organizoi Ekspozita kolektive e personale në disa vende në Kroaci.

Po ashtu është përfaqësuar në disa leksikone e antologji të shkrimtarëve shqiptarë, të botuara pas vitit 2000.

Agimi la pas vetes tre pasardhës, djemtë Jetonin dhe Edonin, si dhe vajzën Laurinën.

AGRON FICO



Prof. Dr. Agron Fico është lindur më 10 maj të vitit 1934, në qytetin e Gjirokastrës, ku edhe mbaroi gjimnazin “Asim Zeneli”, me medalje ari, si dhe më pas kreu studimet e larta në Universitetin e Tiranës. Prej disa kohësh ai gëzon titullin “Qytetar Nderi i Gjirokastrës”. Ai është shtetas amerikan dhe jeton në Nju Jork e Tiranë.

Prof. Dr. Agron Fico albanolog, gjuhëtar, studiues i etnokulturës. Anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve të Shqipërisë.

Nënkryetar i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave e Arteve në New York. Ka publikuar; “Profesor në Tre Kontinente”, “Diaspora e Rilindur”, “Rilindja e Shqipërisë Etnike”, “Beautiful America-Mozaik shkrimesh”, “Zbulimi i Eposit Shqiptar në Harvard-Albert B. Lord”. Me propozim të profesorëve të Universitetit të Gjirokastrës; Prof. dr. Gëzim Sala, Prof. dr. Gëzim Rredhi, Prof. as. dr. Merita Gjokutaj, Prof. as. dr. Spiridhulla Poçi dhe Prof. as. dr. Jaho Cana, dhe me miratim të Senatit Akademik, titulli “Doctor Honoris Causa” për albanologun Argon Fico, u akordua me motivacionin; *“Intelektual me veprimtari kërkimore-shkencore e universitare mbi 50-vjeçare; me ndihmesa të njohura në disa disiplina të shkencës kombëtare shqiptare; që, me ngulmim profesional, vullnet dhe pasion të përhershëm dhe me vështrime bashkëkohore, ka shënuar prurje dhe arritje shkencore të vlerësuara ndër vite, veçmas në etnokulturë dhe folklor”*. Studimet e Profesor Agron Ficos përbëjnë një pasuri dhe një pikë referimi për të gjithë komunitetin shkencor shqiptar në fushën e gjuhësisë.

“Profesor në tre kontinente”, SHBA 2004; “Diaspora e Rilindur”, Tiranë 2006; “Rilindja e Shqipërisë Etnike”, Tiranë 2009, “Beautiful America - Mozaik shkrimesh”, Tiranë 2014; “Zbulimi i Eposit shqiptar në Harvard”-Albert B. Lord” Tiranë 2016. Ndërkohë që në këtë kontribut të tij përfshihen edhe shumë botime shkollore dhe universitare, mes të cilave: Gjuha Shqipe (metodë për studentët amerikanë), Unë flas Shqip (metodë e gjuhës shqipe për të huaj), Metodë e Gjuhës Shqipe (tekst për studentët kinezë) katër vëllime, 1962-1965, Metodë e Gjuhës Shqipe (tekst për specialistët kinezë), 1963, Historia e Shqipërisë (tekst për studentët amerikanë, anglisht), 1997, si dhe një mori studimesh tjera.

AGRON BEKA



Prof. Dr. Agron Beka u lind më 14 janar 1967 në Vushtri. Shkollën fillore dhe të mesme e kreu në Vushtri , Fakultetin juridik e kreu në Universitetin e Prishtinës (1992). Studimet e magistraturës i kreu në Fakultetin juridikë në Prishtinë . ndërsa në vitin 2013 mori gradën akademike Doktor i Shkencave Juridike në Universitetin Publik të Shkupit. Është Profesor i Asociuar dhe Dekan i Fakultetit Juridik të Universitetit Publik "Isa Boletini" në Mitrovicë. Ka ligjëruar në disa institucione të arsimit universitar , në programet: Juridik, Kriminalistikë , Siguri, Politika Publike dhe Menaxhim.Ka përvojë 28 vjeçare në fushën juridike dhe akademike. Është anëtar i disa redaksive të revistave shkencore në nivel ndërkombëtar dhe vendor. Ka botuar disa libra nga fusha juridike dhe letrare. Nga viti 2003 është anëtar i LSHK-së.

Veprat shkencore dhe letrare:

- 1."Abuzimet në lëmin e qarkullimit të pronës së paluajtshme në Kosovë” botuar në vitin (2007);
2. "Noteria dhe Kadastri në Kosovë" (2009);
3. "Vrasjet, Krimi i organizuar, Terrorizmi"(2013 - bashkautor);
4. "Krimi i organizuar në urbanizëm dhe qarkullim të pasurive të paluajtshme" (2015);
- 5."Taktika Kriminalistike" (2017 - bashkautor);
- 6."Antiterrorizmi"(2020-bashkautor);
- 7."Viktimologjia"(2020);
- 8."Korrupsioni"(2020-bashkautor);
- 9."The Detection and Evidence of Abuses in the Field of Real Estate Turnover in Kosovo"(2019);
10. “Money Laundering” (2019);
13. "Crime in Urbanisation and Real Estate Turnover in Kosovo and Human Rights" (2018);
- 14."Gjykata Speciale në Kosovë - Dështim apo Drejtësi Ndërkombëtare"(2017);
- 15."Qarkullimi i parave me prejardhje të paligjshme”(2017);
- 16."Trajtimi i dënimit me vdekje sipas burimeve juridike gjatë historisë"(2016); e tjera.

AGRON SHELE



Agron Shele u lind, më 07.10.1972, në fshatin Leskaj, rrethi i Përmetit. Pas shkollës 8-vjeçare, përfundoi studimet e mesme dhe të larta në Tiranë. Që në moshë të re ka qenë i pasionuar dhe impresionuar pas letërsisë, rrugë të cilën e bëri lajtmotiv të jetës dhe përgjegjësi të zhvillimit intelektual të tij.

Është autor i disa veprave letrare në gjininë e prozës (roman), gjininë e poezisë dhe asaj të Kritikës Letrare (Esse). Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Botës (IWA) me qendër në Ohajo (SHBA), anëtar i Poetëve Bashkëkohorë të Globit (WPS), Poets del Mundo, si dhe përfaqësues për UMP- WUP, Shqipëri. Është Kryetar i Bordit Drejtues Galaktika Poetike "ATUNIS".


Proza dhe poezia e tij kanë tërhequr vëmendjen e kritikës letrare, për tematikën psiko-sociale dhe risinë krijuese, si pjesë e mesazhit artistik, por dhe individualitetit kreativ të shfaqur, është publikuar në shumë gazeta, revista letrare kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe është përfshirë në shumë antologji botërore. Është fitues i disa çmimeve letrare në Itali, Meksikë, Amerikën Latine etj.

Aktualisht jeton në Belgjikë dhe vazhdon me përkushtim publikimin e vlerave letrare universale. Ka një sërë publikimesh në fushën e prozës, poezisë dhe kritikës letrare. Është autor i prezantuar me vepra letrare në gjuhën shqipe, gjuhën italiane dhe gjuhën angleze.

Vepra letrare:

1. Hapat e Klarës (roman)- Shtëpia Botuese "Marlin Barleti", 2003
2. Përtej perdes gri (roman), Shtëpia Botuese "Marlin Barleti", 2006
3. Imazh i rremë (roman), Shtëpia Botuese "Marlin Barleti", 2007
4. Pasazh i pafaj (poezi), Shtëpia Botuese "Marlin Barleti", 2008
5. Kur heshtja flet (poezi), Shtëpia Botuese "ADA", 2018
6. White stones (poems), Demer Prees (Holland), 2018
7. "Rime Sparse" (poesie) - Il suono di due voci poetiche del Mediterr (Poesie di Agron Shele e Claudia Piccinno), Amazon -2018
8. Ngjyrimet universale (Ese I), Shtëpia Botuese "ADA", 2014
9. Ngjyrimet universale (Ese II), Amazon, 2018. etj.

AHMET KELMENDI (1929-2016)



Prof. Mr. sc. Ahmet Kelmendi është i lindur në Pejë, në vitin 1928 të shekullit të kaluar. Një kohë punoi mësues në Drenicë, ndërkohë kreu studimet në Fakultetin e Filologjisë - degën e Albano-logjisë, në Universitetin e Beogradit dhe pastaj punoi profesor në Gjimnazin e Pejës.

Për përhapjen e arsimit dhe të ditorisë në Drenicë, prej pesë mësuesve të shpallur doajenë, Ahmet Kelmendi ka qenë i pari.

Pas mbarimit të studimeve pasuniversitare nga fusha e gjuhësisë në Universitetin e Zagrebit, u zgjodh profesor në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prishtinës, ku punoi deri sa u pensionua.

Prof. Ahmet Kelmendi ishte dhe mbeti njëri nga gjuhëtarët, që iu përkushtua lëvrimin të gjuhës shqipe, për pesëdhjetë vjet me radhë, bashkë me Prof. Idriz Ajetin, Prof. Besim Bokshin, Isa Bajçincën etj.

Ahmet Kelmendi ishte pjesëmarrës i Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, i mbajtur në Tiranë më 20-25 nëntor 1972.

Përveç veprimtarisë që përmendëm Ahmet Kelmendi është edhe autor i teksteve Shkollore nga Gjuhësia. Ai, ndër të tjera, me kolegët e tij Prof. dr. Latif Mulaku dhe Prof. Mazllum Hasimja, ka publikuar katër gramatika të gjuhës shqipe, dy për shkolla fillore dhe dy për shkolla të mesme. U mor me gjuhësi dhe nga kjo fushë botoi një varg punimesh dhe veprash shkencore, si: “Thyerja e burgut të Pejës - Gjah, masakër e kasaphane e paparë mbi të burgosurit shqiptarë më 11 gusht 1946”.

Profesor Ahmeti mblodhi dhe botoi një vepër tejet të rëndësishme për kulturën tonë kombëtare: "Histori e Gramatologjisë Shqiptare I" (1635-1944) të profesor Jup Kastriotit (1980). Në këtë vepër janë përmbledhur 99 gramatika të autorëve shqiptarë dhe të huaj. Profesi i Zagrebit, akademik Radoslav Katiçiq ka thënë se popujt të tjerë, edhe më të zhvilluar, nuk kanë një vepër të këtillë të historisë së gramatologjisë.

Ishte një atdhetar, veprimtar shumëvjeçar i arsimit, shkencës e kulturës, studiues e botues, mbi të gjitha një fanatik i standardit të gjuhës shqipe letrare. Pas një veprimtarie të gjatë gati shtatëdhjetëvjeçare profesori Ahmet Kelmendi si misionar i arsimit shqip dhe i gjuhës sonë standarde, mbetet një ndër personalitetet më të shquara të kombit tonë, i cili i dha shumë arsimit, shkencës dhe kulturës shqiptare...

AHMET MALOKU



Prof. Dr. Ahmet Maloku, PH.D është i lindur në Lisockë, Komuna e Kamenicës.

Shkollimin fillor dhe të mesëm e ka përfunduar në Gjilan me sukses shembullor, për të cilën disa herë është shpërblyer. Fakultetin e shkencave të kriminalistikës i ka përfunduar me notë mesatare 9.89, në Fakultetin e Kriminalistikës, drejtimi i Kriminologjisë dhe Studimet e Sigurisë, të Universitetit të Sarajevës, në katedrën e kriminalistikës, ku fitoi titullin kriminalist i diplomuar. Fakultetin Juridik (me notë mesatare prej 9.50)

dhe studimet master (me notë mesatare prej 9.0), i përfundoi në Fakultetin Juridik të kolegjit “AAB- RIINVEST” të Prishtinës. Për suksesin e treguar gjatë studimeve ishte bursist, si studenti më i mirë i gjeneratës së tij.

Prof. Dr. Ahmet Maloku në studimet pasuniversitare ka përfunduar dy doktorata:

Doktoratën e parë e ka përfunduar në Universitetin e Travnikut - Bosnje dhe Hercegovinë, në Fakultetin Juridik, të katedrës penale, me temë: *“Bashkëpunimi ndërkombëtar për luftimin e krimit të organizuar transnacional”* me Mentor - Prof. Dr. Nedžad Korajlić, ku mori titullin, *Doktor i Shkencave Juridike në fushën penale.*

Kurse doktoraturën e dytë e ka përfunduar në Universitetin publik e Sarajevës - Bosnje dhe Hercegovinë, në Fakultetin e kriminalistikës, Kriminologjisë dhe Studimet e Sigurisë, në katedrën e Kriminologjisë, me temë *“Dezorganizimi social dhe karakteristikat e kriminalitetit në rajonin e Gjilanit (Kosovë) në periudhën 2010-2014”*, me Mentor: Prof. Dr. Alisabri Shabani dhe ka marrë titullin *Doktor i Kriminologjisë*, që njëherit bëhet doktori i parë i kriminologjisë në Kosovë, e në trojet shqipfolëse.

Me 13 nëntor 2018 prof.dr. Ahmet Maloku ka përfunduar specializimin dhe është certifikuar nga Ohio Northern University - SHBA, në pedagogji ligjore.

Më shumë se dhjetë vite është profesor në institucione të ndryshme të arsimit universitar në Kosovë, si dhe jashtë Kosovës;

Ka punuar profesor në fakultetin juridik në Kolegjin “Gjilani” në Gjilan nga viti 2012, ndërsa dekan i këtij fakultetit ka qene nga 1 tetori i vitit 2013 deri me 30 shtator 2018.

Po ashtu është profesor universitar në studimet posdiplomike në nivelin master dhe doktoratë në Universitetin e Travnikut, në Fakultetin Juridik në Bosnjë Hercegovinë.

Kurse nga 1 tetori i vitit 2017 është zgjedhur profesor në Universitetin Internacional të Novi Pazarit, dega në Presheve. Gjithashtu, nga 1 tetori i vitit 2018 (e tutje), është profesor në kolegjin “ILIRIA”-Prishtinë, ku e mbanë edhe pozitën e rektorit në kolegjin “ILIRIA”-Prishtinë.

Anëtar i rregullt (2016) i International Association of Penal Law–AIDP/IAPL. Paris-Francë. Anëtar i rregullt (2016) i European Society of Criminology - University of Lausanne ESC - ICDP Sorge - BCH - Switzerland. Anëtar i rregullt (2017) i The International Society of Criminology (ISC) - The International Society of Criminology was established on July 16, 1937 in Rome. Anëtar i rregullt (2017) i World Society of Victimology (WSV) - In Consultative Status With the United Nations ECOSOC and Council of Europe. Anëtar i bordit (2018) i revistës shkencore ILIRIA International Review. Publicher/Verlag. Holzkirchen, Germany. Anëtar i bordit (2013) i revistës shkencore “Norma”- Gjilan, botuar nga Kolegji Universitar “Gjilani”- Gjilan (2013). Etj.

Veprat:

- 1.”Sociologjia”, 2019.
- 2.”Friga nga kriminaliteti”, 2019.
- 3.”Patologjia sociale”, 2019.
- 4.”Fjalor terminologjik i viktimologjisë”, 2019.

Publikime shkencore dhe profesionale

- 1.“Alcoholism as a pathological social problem in the region of the municipality” Gjilan-Kosovo, 2015
2. “Nasilje nad ženama u porodici u regionu Gnjlane”, 2015
- 3.“Fear of Voilence and Criminality in the Region of Gjilan, Kosovo”,
4. “Bashkëpunimi Ndërkombëtar Policor në luftimin e krimin të organizuar”, 2015
5. “Kodi i të burgosurve”, 2015
6. Të arriturat dhe sfidat e shteteve te Ballkanit në rrugët e integritimit Evropian”, 2015
- 7.“Karakteristikat e organizatave kriminale transnacionale”, 2016
- 8.”Marrëdhënia ndërmjet veprës penale dhe dezorganizimit social”, Prishtinë, 2016, etj.

AHMET QERIQI



Prof. Ahmet Ali Qeriqi u lind më 24.12. 1947 në fshatin Krojmir të Drenicës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, tetëvjeçaren dhe të mesmen medresenë Alaudin, i mbaroi në Prishtinë. Ka kryer studimet universitar në Prishtinë.

Prof Ahmet Qeriqi, që i ri, përballet me xhelatët e regjimit. Ai e lexonte saktë shpirtin e zemëruar të popullit, varfërinë e padurueshme, shpërnguljet, dënimet e pareshtura për gjuhën shqipe dhe flamurin, si dhe festat për figurat historike të shqiptarëve.

Për veprimtari antijugusllave ka qenë i dënuar në nëntor të vitit 1965, maj 1975, shtator 1980 dhe në shkurt të vitit 1983.

Prej shtatorit të vitit 1973 deri më 2 prill të vitit 1981 ka punuar mësimdhënës i gjuhës shqipe në Ferizaj dhe në Prishtinë.

Pas lirimit nga burgu prej vitit 1988 e deri në pranverë të vitit 1998, ka punuar në zdrukthtari dhe ndërtimtari. Prej vitit 1973 merret me publicistikë dhe studime të fushave të ndryshme.

Ka bashkëpunuar me të përditshme, Bujku dhe revistat Bota e Re, Zëri i Kosovës, Kosova e Lirë, 24 orë, Fokusi etj.

Profesor Ahmet Qeriqi, ishte përgjegjës dhe anëtar i stafit të Radios Kosova e Lirë, e UÇK-së. Radio Kosova e Lirë kishte filluar transmetimin më 4 janar të vitit 1999, nga malet e Berishës.

Të botuara:

“Meditime në arrati”, Prishtinë, 2002, “Në gjurmim të lashtësisë”, Prishtinë, 2002, “Milush Kopiliqi, serb apo shqiptar?”, Prishtinë, 2003, “Burgu”, Prishtinë, 2004, “Luftëtarët e NDSH-së”, Prishtinë, 2005.

Veprat në dorëshkrim:

-Kronikë lufte I (30.5.1998-3.1.1999), Kronikë lufte II (4.1.1999-24.6.1999), Vegimtari, roman, Vehabiu, novelë, Dy kahe... publicistikë.

Prej janarit të viti 1999 Ahmet Qeriqi drejton Radion Kosova e Lirë. Lidhur me fondin e lajmeve të transmetuara gjatë lutës Radio Kosova e Lirë e ka ruajtur tërë arkivin, të cilin, në vitin 2009 i ka botuar në tri vëllime.

Jeta dhe vepra e shkrimtarit, luftëtarit, eseistit, dhe atdhetarit, Prof. Ahmet Qeriqit, është pjesë e Kosovës së përgjakur, pjesë kryengritëse e të gjithë vullnetarëve të lirisë, pjesë e misionit të shenjtë për ribashkimin e trojeve shqiptare. Jeton dhe vepron në Prishtinë.

AKIL KOCI



Prof. Akil Koci është i lindur më 1 shtator 1936 në Prizren. Kompozimet e para i beri rreth viteve 1955 si nxënës i shkollës së mesme muzikore në Prizren, andaj disa vepra të atëhershme të tij janë tashëm vepra antologjike si; “Vashës” 1956, “Macja e vogël”, 1959, “Prizreni i Lulzuem” 1959, “Zambaku i Prizrenit” 1961 dhe shumë këngë të tjera.

Përherë të parë filloi të punoi si mësues në shkollën Normale të Prishtinës. Aty ai udhëhoqi korin e asaj shkolle.

Studimet e larta i kreu në Akademinë Muzikore të Sarajevës, më pas punësohet në Fakultetin e Arteve, Universiteti i Prishtinës. Si student ishte përfitues i bursës DAAD në Akademinë e Kölnit, ku nga atje vazhdoi kursin për muzikë elektronike te K. Stockhausen, në Stuttgart, mandej në klasën e E. Karkoschka, në Nürnberg, te kompozitori Baumgartner. Të gjitha këto i realizoi si bursist i Bashkësisë Krahinore të Shkencës së Kosovës.

Shumë vepra të tij të atëhershme u ekzekutuan në koncerte të shumta kur studionte si, në Stuttgart dhe gjetiu. Gjatë viteve 1979/1981 kryen studimet pasuniversitare dhe fiton shkallën e tretë në muzikologji, në Akademinë e Muzikës në Sarajevë, ku edhe e merr titullin e Magjistrisë të Muzikologjisë. Pas specializimeve rikthehet në Prishtinë dhe rifillon punën si ligjërues i lëndës; “Njohuri e Literaturës Muzikore” në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, meqë emërohet Docent e më vonë edhe Profesor.

Prof. Akil Koci është një ndër kompozitorët më aktivë të Kosovës. Akil Koci është edhe mjeshtër i muzikës aleatorike. Vepra e parë e tij në stilin aleatorik është “*Filigranët I*”, për nëntë instrumente.

Me veprën e tij “*Filigranët II*” për herë të parë e prezanton Kosovën në një festival të nivelit të lartë. Akil Koci mori pjesë në Festivalin e emisioneve të Radiodifuzionit të Jugosllavisë në Ohër, po ashtu mori pjesë edhe në “*Tribunën e Muzikës Avangarde*” në Paris, (1973) nën patronatin e Kombeve të Bashkuara.

Veprat e tij janë incizuar dhe transmetuar në më shumë se 70 radio stacione, mes të cilave Radio Prishtina, BBC, DW, Zagreb, Koln Shtuttgart, Paris programi III, Gjenevë etj.

Prof. A. Koci ka marrë pjesë në shumë kongrese, konferenca dhe

simpoziume kombëtare, gjithashtu ka qenë redaktor në botimin e Enciklopedisë muzikore të Entit Leksikografik Miroslav Kerlezha, Zagreb. Ai mori pjesë edhe në botimin e Leksikonit Muzikor të Enciklopedisë, të Cankarjeve Založbe, në Lubjanë, në funksionin e redaktorit.

Mes të tjerash ka qenë një prej themeluesve të Shoqatës së Kompozitorëve të Kosovës, kryetar i Rinisë Muzikore të Kosovës, kryetar i Shoqatës së Artistëve Muzikorë, nënkryetar dhe kryetar i Lidhjes së Kompozitorëve të ish-Jugosllavisë, kryetar i Pleqësisë për Arsim dhe Kulturë të Komunes së Prishtinës, kryetar i Bashkësisë Kulturore –Arsimore, themelues dhe kryetar shumëvjeçar i Skenës Muzikore të Prishtinës, një prej themeluesve të Akordeve Muzikore dhe drejtor shumëvjeçar i saj, një prej themeluesve të Ditëve të Muzikës Kosovare dhe kryetar shumëvjeçar i saj. Gjithashtu ka qenë anëtar i shumë Jurive kombëtare dhe ndërkombëtare, e shpesh edhe kryetar i tyre si, Akordet e Kosovës, Festivali i Opatisë, si dhe anëtar i komisionit të Evropizionit në Gjenevë. Aktualisht është anëtar i Shoqatës së Kompozitorëve të Britanisë së Madhe që nga viti 1995, anëtar i Shoqatës Gazetarëve 2001, anëtar i “British Music Informacion Centre” dhe anëtar i Akademisë Britanike të Kompozitorëve dhe Shkrimtarëve Muzikorë, si dhe anëtar i Shoqatës së Kompozitorëve të Kosovës dhe të Kroacisë.

Kompozitori Akil Koci njihet gjithashtu edhe si publicist, intelektual. Veprimtaria e tij publike është e njohur, jo vetëm në rrethet kombëtare, por edhe ndërkombëtare.

Prof. A. Koci është fitues i shumë çmimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, ndër të cilat përmendim Shpërblimi i Dhjetorit të Kosovës (1971), Shpërblimi i Nëntorit i qytetit të Prishtinës. Me veprat dhe kompozimet e tij është autor i shumë shpërblimeve të para të Akordet e Kosovës (Okarina e Artë -1972 dhe dy shpërblimeve të dyta më 1968).

Akil Koci u vlerësua edhe me Shpërblimin e Shoqatës së Kompozitorëve të Kosovës për baletin e parë kosovar *'Sokoli e Mirusha'* -1979, Shpërblimin e parë për vepra korale, të shpallur nga Collegium Cantorum, me veprën *"Mes njerëzve"* dhe shumë shpërblime të tjera. Është fitues i Pllakates dhe Diplomës, "Qytetar i Merituar" dhe "Qytetar Nderi" i Komunes së Prishtinës (1974).

Që prej fillimit të viteve '90-ta, prof. A. Koci jeton në Londër, ku edhe ka themeluar Qendrën muzikore "Koci Contemporary Arts Center", në vitin 2001.

ALBAN DACI



Dott. Mag. Alban Fatos Daci u lind në Zall-Kalis të Slllovës, në rrethin e Dibrës, më 12 qershor 1984. Shkollën e mesme të arsimit të përgjithshëm e kreu te “Arben Broci”, në Tiranë.

Në vitin 2008, ka kryer Laurea Triennale për Marrëdhënie Ndërkombëtare e Diplomatike në Universita degli Studi di Genova në Itali.


Në vitin 2010, ka kryer me cum laude Laurea Magistrale për Marrëdhënie Ndërkombëtare e Diplomatike po në Universita degli Studi di Genova.

Është gazetar për çështjet e rajonit dhe të Diplomacisë, politolog, studiues, kryetar i organizatës shqiptare “Nuova Generazione Albanese”, godëill ambasador i Komitetit Ndërkombëtar “Kolombo” për Republikën e Shqipërisë, anëtar i Lëvizjes Federaliste Europiane (Seksioni i Gjenovës), Sekretar për arsimin i Aleancës Kuqëzi dhe ka marrë pjesë në shumë evenimente e konferenca shkencore të organizuara nga kjo lëvizje. Ka bashkëpunuar me organet kryesore të shtypit të shkruar në vend, si: “Koha Jonë”, “Shekulli”, “Ndryshe”, “RD”, “Tirana Observer”, “Nacional, Lajm”, “Nënë Shqipëria”, “Tema”, “Lajm”, “Telegraf”, “Integrimi”, “Dibra”, gazeta e “Shqiptarëve në Britani”, “Standard”, “Ballkan”, “Albania”, “Balli i Kombit”, “Bota Sot”, “Sot”, il giornale “La Gazzetta di Monferrato”, “Sicilia Millennium”, “Metropol”, “Dire Online” (Revista e Departamentit European të Kërkimeve në Università degli Studi di Genova), “Kuvendi” (Revista e përmuajshme, që botohet në Miçigan të USA nga shqiptarët që jetojnë prej vitesh atje), Agjencia Kombëtare e Lajmeve (www.noa.al) dhe në shumë faqe të tjera, si dhe në mjaft mail-lista shqiptare dhe në emisione të rëndësishme televizive në stacione të ndryshme shqiptare.

Deri tani ka botuar tri libra të fushës së marrëdhënieve ndërkombëtare e diplomacisë, si: “Europa dhe shqiptarët” (prill, 2011), “Europa në marrëdhëniet ndërkombëtare” (shtator, 2011) dhe “Kuç e Zi” (nëntor 2012). Ka botuar gazetën “Arbëria” në Itali.

Në vitin 2017, është anëtarësuar në Akademinë Shqiptare Amerikane të Shkencave dhe Arteve.

ALEKS BUDA (1911-1993)



Aleks Buda është i lindur në Elbasan më 7 shtator 1911, ishte bir i Dhimitër Taq Budës. I ati ishte farmacist, delegat i Elbasanit në Kongresin e Manastirit, në atë të Elbasanit dhe deputet në dy legjislatura në Kuvendin Kombëtar. Një ndër financuesit e Shkollës Normale të Elbasanit. Aleks Buda mësimet e para i nisi kur ishte 7 vjeç në shkollën fillore të qytetit të lindjes. Pa kryer klasën e dytë i vijoi studimet në Lecce të Italisë.

Më 1920 bashkë me dy vëllezërit e tij shkon me studime në Austri. Atje plotësoi filloren dhe kreu më 1929 gjimnazin në Salzburg. Më tej ndoqi studimet në Universitetin e Vjenës, në Institutin Ballkanistik (1930 - 1935), ku mori mësim nga profesorë të njohur si, Karl Patsch, Reiniger dhe Norbert Jokl. Gjatë kësaj periudhe u aktivizua në Shoqërinë e studentëve shqiptarë Albania të Vjenës, së bashku me Lasgush Poradecin, Skënder Luarasin, Eqrem Çabejn, Krist Malokin, Qemal Butkën etj., duke qenë edhe bashkëpunëtor i revistës “Dialëria” të kësaj shoqërie.

Në vitin 1938 u kthye në Shqipëri, ku së pari punoi si arsimtar në Gjimnazin e Tiranës (që nga shtatori 1939), ndërsa më 1940 transferohet në Liceun e Korçës.

Në fund të viti 1941 shkoi në Itali në Universitetin e Padovës pranë profesorit të njohur Karlo Taljavini për t'u kualifikuar në fushën e gjuhësisë së përgjithshme ballkanike dhe të shqipes, por pas një viti kthehet në atdhe, për shkak të luftës.

U lidh me lëvizjen Nacional-Çlirimtare dhe më 1944 zgjidhet nënkryetar i Këshillit ANÇI të qarkut të Elbasanit.

Menjëherë pas Çlirimit të vendit punoi si drejtor i Bibliotekës Kombëtare (1945-1946), por shpejt (1946) u bë një nga organizatorët e Institutit të Shkencave, ku punoi si përgjegjës i seksionit të historisë, sociologjisë dhe ekonomisë.

Aty ndihmoi në krijimin e sektorëve të arkeologjisë dhe të historisë së lashtë, të historisë së Mesjetës dhe të artit mesjetar, të historisë së kohës së re, të etnografisë etj. Së bashku me kolegët e sektorit të tij, bënë të mundur publikimin e studimeve e arritjeve në fushën e arkeologjisë e të etnografisë, që u ekspozuan në Muzeun arkeologjik-etnografik të përruar në vitin 1947.

Fitoi përvojë si pedagog i historisë që në fillimet e Institutit pedagogjik dyvjeçar (1946); më 1955 u bë një nga organizatorët dhe studiuesit më me përvojë të Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë, i sapokrijuar.

Me krijimin e Universitetit të Tiranës më 1957, Aleks Buda do të ishte një nga themeluesit e katedrës së historisë dhe të kursit të historisë së Shqipërisë në këtë Universitet.

Viti 1972 qe një vit i veçantë për jetën shkencore në Shqipëri, njëherazi edhe për Aleks Budën: U themelua Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Në mbledhjen e parë të asamblesë (1973), të çelur nga akademiku Eqrem Çabej, Aleks Buda zgjidhet kryetar i Akademisë, detyrë që e mbajti deri në fund të jetës, pasi u rizgjodh dy herë.

Aleks Buda vdiq pas një sëmundjeje të rëndë, në Tiranë më 7 korrik 1993.

Vepra

Veprimtaria kryesore e tij ishte studimi i historisë, veçanërisht në fushën e historisë mesjetare shqiptare dhe të Rilindjes Kombëtare.

Ai është bashkautor dhe redaktor përgjegjës i tekstit të “Historisë së Shqipërisë vëllimi I” dhe autor i disa studimeve për periudha të ndryshme të Historisë së Shqipërisë, sidomos për atë të “Skënderbeut”, për etnogjenezën e popullit shqiptar, si dhe autor i shumë shkrimeve publicistike.

Aleks Buda ka shkruar edhe hyrjen 18-faqesh të botimit të veprës së Marin Barletit, "*Rrethimi i Shkodrës*", e cila u përthye nga Henrik Lacaj dhe u botua në Tiranë në vitin 1962.

Aleks Buda është bashkautor i Vëllimit të dytë të librit "*Historia e Shqipërisë*", e botuar në vitin 1965.

Në hartimin e "*Fjalorit enciklopedik shqiptar*" (1985), e para vepër enciklopedike shqiptare, ku si kryeredaktor i këtij libri dha një ndihmesë të çmuar në konceptimin dhe udhëheqjen shkencore.

Tituj dhe dekorata:

“Mësues i Popullit”

“Çmimin e Republikës të shkallës së parë”,

“Urdhrin e Lirisë” të klasit I, etj.


Presidenti i Republikës së Austrisë e ka dekoruar atë me:

“Medaljen e madhe të artë”, në vitin 1990, medalja më e lartë që jep Austria për shtetasit e huaj.

Këshilli i qarkut të Elbasanit e ka nderuar pas vdekjes, në vitin 2002 me titullin: “Qytetar Nderi”.

Si dhe shumë çmime, tituj e dekorata tjera.

ALEKSANDËR MOISIU (1879-1935)



Aleksandër Moisiu u lind në Trieste, më 2 prill të vitit 1879. Prindërit e aktorit të shquar shqiptar ishin nga vende të ndryshme, i ati Konstandin Moisiu nga Kavaja, ndërsa e ëma, Amalia De Rada, nga jugu i Italisë. Më bashkimin e prindërve të tij aktori e kaloi pothuaj gjithë rininë e tij, në qytetin e Durrësit dhe më pas të Tiranës, kurse nga Shqipëria u larguar në moshën 20-vjeçare për t'u zhvendosur së bashku me nënën dhe dy motrat e tij në Vjenë të Austrisë.

Më kalimin e kohës qyteti austriak, përveç se ishte shtëpia e tij e re, u bë edhe stacioni i parë i karrierës së tij. Aty aktori i madh shqiptar, Aleksandër Moisiu pati fatin të njihej me aktorin austriak që në atë kohë përjetonte një sukses mjaft të konsiderueshëm.

Xhosef Kainz, i cili e ndihmoi shumë aktorin tonë për hapat e tij të para në botën e aktrimit. Më pas aktori i shquar shqiptar merr vendimin të zhvendoset në Pragë, e më pas edhe në Berlin, ku aty përsëri ka fatin të njihet me një aktor tjetër të suksesshëm, Maks Reinhardin.

Pikërisht në këtë vend, aktori i shquar shqiptar vlerësohet me çmimin e parë nga dramaturgu dhe kritiku Anatoliy Lunacarski, për interpretimin e tij tek Odipusi. Ky vlerësim përbën edhe çmimin e parë në karrierën e madhe të Moisiut, si dhe nismën e një periudhe të re plot vlerësime e interpretime të suksesshme.

Aktori i madh shqiptar vazhdon të interpretojë në rolet më të spikatura të asaj kohe, si:

- "Hamlet" në Teatrin Popullor të Vjenës, në vitin 1922,

- "Fedra" e Leo Tolstoit dhe

- "The alive Cadaver", në Berlin në 1922.

Aleksandër Moisiu vazhdoi të aktrojë vazhdimisht në veprat më të spikatura, duke arritur majat e teatrit botëror me përzgjedhjen e tij në rolin e Romeos në veprën e famshme Shekspiriane "Romeo dhe Xhulieta", në 1907-ën, duke lënë të gjithë të shtangur me aftësitë e tij interpretese.

Aleksandër Moisiu, një legjendë aktrimi

Aktori shqiptar, Aleksandër Moisiu, i cili karrierën e tij e filloi në Austri, e zhvilloi në Berlin e në tërë botën, ndërsa e përfundoi në Itali, mbetet një ndër figurat më të rëndësishme të kulturës shqiptare. Moisiu, i cili vdiq në vitin 1935, në Vjenë, mbetet një ndër aktorët më të mëdhenj të

Evropës, me emrin e të cilit përmblihet i gjithë spektri i literaturës evropiane për teatrin, duke filluar që nga tragjedia antike greke e deri te koha moderne.

Moisiu i madh pati një jetë të trazuar, një fillim të vështirë dhe më pas një karrierë brilante. Biografia e Aleksandër Moisiut është e mbushur me një mori faktesh të shkëputura nga arkivat e vendeve të ndryshme, nëpër teatro, nëpër shtypin e kohës, si dhe janë shkruar me qindra monografi dhe biografi për të.

Kontakti i parë i Moisiut të ri me artin, ishte kur e ëma e futë rrugës së kantos, në muzikë, por nuk u hodh menjëherë në rrugët e tij. Për disa kohë ai punoi në një varrezë të Vjenës dhe mendohet se pikërisht kjo e ka ndihmuar atë të realizojë në mënyrë të përsosur skenat e vdekjes.

“Askush nuk vdiq aq shpesh dhe aq mrekullisht bukur në skenë sa Moisiu. Vetëm tek “Kufoma e gjallë” e Tolstoit, gjatë viteve 1913-1935, ai ia veshi vetës me plumb mbi 1500 herë”, - thotë Schaper në librin e tij.

Ndërsa vetë aktori, për realizimin e skenave të vdekjes, do të thoshte:

“Ajo që më shtynte ishte një vrull i nëndheshëm për të bërë gjënë e duhur në çastin e duhur”.

Ishte dhjetor 1903, kur për herë të parë, në listën e programit teator, renditej emri i Moisiut. Shumë shpejt do të fitonte zemrat e publikut me rolet e tij në dramat:

- “Elektra” e Hugo fon Hofmanstalit,
- “Papagalli i gjelbër” i Artur Shniclerit,
- “Azili i natës” i Maksim Gorkit.

Pas tre vjetësh, ai do të bëhet protagonist i Teatrit të Dhomës (vetëm më 2-3 aktorë) dhe do të luante në disa pjesë, që bënë bujë në atë kohë, për idetë iluministe, sidomos:


- “Zgjimi i pranverës” i Frank Vedekindsit dhe
- “Fantazmat” e Henrik Ibsenit. Ishte pikërisht “Fantazma”, e cila do ta ngrit Moisiun në pedestalin e aktorit të madh.

Në vitin 1912, zëri i tij i mrekullueshëm artistik, në interpretimin e monologjeve:

- “Faustit” të Gëtes,
- “Prometeut” dhe monologun e
- “Hamletit” të Shekspirit, do të incizohet në pllaka gramafoni, duke e bërë të pavdekshëm edhe zërin e tij.

Aleksandër Moisiu mbetet ikona e artit skenik evropian e botëror...

ALEKSANDËR STIPÇEVIÇ (1930-2015)



Prof. Albanologu, studiuesi, bibliografi dhe arkeologu, Aleksandër Stipčević, u lind në Arbanas të Zarës, më 10 tetor 1930. Lindi në një familje arbëreshe të ardhur rreth 300 vjet më parë në Zarë, nga fshati Ana e Malit në Mal të Zi.

Shkollën fillore e të mesme e kreu në Zarë dhe më pas studioi në Zagreb për Arkeologji.

Origjina e familjes ishte një nga arsyet që, kur ishte student i arkeologjisë në Universitetin e Zagrebit, kishte vendosur të merrej me ilirët, dhe këtë e ka rrëfyer edhe në një intervistë të dhënë për mediat kosovare: *“Me ilirët kam vendosur të merrem që kur isha student i arkeologjisë. Ata vazhdimisht më kanë preokupuar, në radhë të parë për shkak se kam menduar e mendoj se nuk mund të studiohet e kaluara e Ballkanit, madje as e tashmja pa njohjen e elementit ilir. Gjithçka që ka ndodhur në Ballkan prej kohës së mesme e këndeje, në një farë mënyre, është ndërtuar mbi atë shtresë që ne e quajmë ilire. Pra çdo tregim për Ballkanin fillon me ilirët.”*

Aleksandër Stipčević u nda nga jeta në vitin 2015, në moshën 85-vjeçare. Ai ishte anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, dhe ka pasur korrespondenca të rregullta edhe me akademikët e Shqipërisë. Nga shteti shqiptar për kontributin e tij është vlerësuar me medaljen “Naim Frashëri” dhe me urdhrin “Gjergj Kastriot Skënderbeu”. I kujdesshëm në burimet e autorëve antikë, ai ka sjellë të dhëna të interesante nga zbulimet arkeologjike, por edhe ato etnografike të lidhura me jetën e përditshme e doket ilire.

Nga thellësia e shekujve ai ka nxjerrë në dritë të dhëna për muzikën, vallet dhe për gjuhën e ilirëve. Aleksandër Stipčević drejtoi për një kohë të gjatë Bibliotekën e Akademisë së Shkencave të Kroacisë, duke dhënë një kontribut të shquar në përpunimin metodik e shkencor të librit. Është autor i Bibliografisë ilire, i Bibliografisë antike të Jugosllavisë etj. Për punën gjysmë shekullore dhe formimin enciklopedik të tij dëshmon edhe botimi i veprës “Povijest knjige” (Historia e librit), Zagreb 1985, f.560, shoqëruar me shumë ilustrime, e përkthyer në shqip dhe botuar në Prishtinë, 1988 e në Tiranë 2000.

Në vitet e fundit të veprimtarisë shkencore Prof. Aleksandër Stipčević, ia kushtoi kërkimin e tij shkencor trashëgimisë kulturore,

shpirtërore e gjuhësore të vendlindjes së tij, gjë që është pasqyruar në përmbledhjen me studime “Kultura tradicionale e arbëreshëve të Zarës”, Prishtinë 2012, f. 438, një vepër e shkruar me dashuri për vlerat dhe traditën e të parëve të vet. Vepra kërkimore shkencore 50-vjeçare e Prof. A. Stipçeviçit për ilirët, për arbanasit e Zarës dhe më gjerë, është një gur i fortë themeli në historinë e studimeve ilire.

Aleksandër Stipçeviç në gjuhën shqipe

Libri i parë i tij “Gli Iliri”, Milano 1966, u përkthye në shqip nga Prof. Zef Mirdita dhe u botua në Prishtinë, 1967 nga Shtëpia Botuese “Rilindja”. Në këtë libër A. Stipçeviç ka mundur të japë një pamje më të plotë të historisë dhe të kulturës ilire dhe ka arritur të bëjë një sintezë të gjithë asaj që ishte thënë e shkruar për ilirët.

Prof. Aleksandër Stipçeviç vazhdoi ta ripunojë, ta plotësojë e zgjerojë veprën e tij “Ilirët”, e cila ka sot 9 botime e ribotime në katër gjuhë të ndryshme (italisht, kroatisht, shqip e anglisht). Varianti i fundit dhe më i ploti është “Ilirët, historia, jeta, kultura e simbolet e kultit”, 2002, botimet Toena. Në këtë libër trajtohet emri ilir, etnogjeneza ilire, kufijtë etnikë e topografia e fiseve ilire, kolonizimi grek, shtetet kryesore ilire, luftërat iliro-romake dhe ilirët nën pushtimin romak.


Libri i tij më i fundit në gjuhën shqipe është “Kultura tradicionale e arbëreshëve të Zarës”. Libri i tij është vepër shkencore dhe monografi e shkruar me mjeshtri, mbi dukuritë e veçanta të arbëreshëve të Zarës, grupit etnik që banojnë në vendbanimin shumë afër Zarës, të cilët e kanë ruajtur gjatë gati tre shekujve (300 vjet) veçoritë e theksuara të tyre. Stipçeviç ka lënë pas dhjetëra vepra e qindra artikuj në lëmi të albanologjisë, duke u bërë një nga mbrojtësit më të flaktë të tezës se, shqiptarët ishin pasardhës të ilirëve. Edhe pse sipas tij kishte ende shumë për të kërkuar në këtë drejtim, ai ishte i bindur në vërtetësinë e kësaj teze.

Veprat:

Prof. Stipçeviç ka shkruar rreth 230 punime shkencore e profesionale, në kroatisht, shqip, italisht, anglisht.

Veprave të tij më të rëndësishme janë: “Ilirët”, “Arti i ilirëve”, “Ilirët: historia, jeta, kultura”, “Simbolet e kultit tek ilirët”, “Bibliografia e ilirëve”, “Interpretime albanologjike”, “Historia e librit”, “Censura në biblioteka”, “Bibliografia antike e arkeologjisë në Jugosllavi. B.1-2”, “Censori i përsosur”, “Bibliografia e Arbëreshëve të Zarës”, “Përmendoret kulturo-historike në Arbanas” etj.

ALI BERISHA



Ali Sh. Berisha u lind më 20.06.1949, në fshatin Llukar, komuna e Prishtinës.

Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin, SHLP-Dega e Albanistikës, Fakultetin filologjik - Dega Letërsi dhe gjuhë shqipe, në Universitetin e Prishtinës.

Nga viti 1971 e deri në vitin 1976 punoi në Normale të Prishtinës. Nga 2 shkurti i vitit 1976 e deri më 5 korrik 1990 punoi në Televizionin e Prishtinës. Në vitin 1992 dhe 1993 punoi në Qendrën për Informim të Kosovës, kurse nga viti 1993 e tutje u punësua arsimtar i gjuhës shqipe në Shkollën fillore “Zenel Hajdini” të Prishtinës.

Me fillim të vitit 2003, si shumë ish-koleg të tij, u rikthye në Radiotelevizionin e Kosovës, ku punoi deri në gusht të vitit 2005, e më pas migroi në Gjermani.

Për pjesëmarrje në demonstratat e vitit 1968 dhe për udhëheqjen e referendumit për pavarësi në Kodrën e Trimave, më 1991 vuajti në burgun e Prishtinës.

Me kultivimin e poezisë u mor qysh si gjimnazist dhe vazhdon edhe sot. Kultivoi prozën e shkurtër për fëmijë, si dhe shkroi tregime për të rritur, të cilat i botoi nëpër gazetat dhe revistat e kohës. Nga viti 1990 u mor me hulumtime trashëgimore e historike.

Veprat letrare:


1. Dua ta pres lirinë (rrëfjeza për fëmijë), botuar në vitin 1996
2. Krizantemë për Nëntorin e Tretë (poezi), botuar në vitin 1997
3. Bashkia e Llukarit (monografi), botuar në vitin 1998
4. Bashkia e Llukarit II - Masakratë serbe në Bashkinë e Llukarit (monografi), botuar në vitin 2000
5. Dhembje e krenari (poezi), botuar në vitin 2001
6. Flijimet për tokën e lirë në Gallapin e Prishtinës (monografi), 2002. (Kjo monografi është njëherit edhe pjesa e VI e projektit “Gallapi i Prishtinës”), botuar në vitin 2002.
7. Ujë dhe prush (poezi), botuar në vitin 2003
8. Gurë me rrënjë (roman historik), botuar në vitin 2004
9. Alfabeti i shpirtit (poezi), botuar në vitin 2004
10. Globi (roman për fëmijë), botuar në vitin 2004

11. Turbulencë (poezi), botuar në vitin 2004
12. Kuvendi i mbretërisë së lodrave (poezi për fëmijë), 2008
13. Gallapi i Prishtinës I, botuar në vitin 2008
14. Gallapi i Prishtinës II, botuar në vitin 2009
15. Gallapi i Prishtinës III, botuar në vitin 2009
16. Muza e dhembjes (poezi), botuar në vitin 2010
17. Gallapi i Prishtinës IV, botuar në vitin 2010
18. Gjyshi ka siklet (poezi për fëmijë), botuar në vitin 2011
19. Gallapi i Prishtinës VII, botuar në vitin 2012
20. Çlirimi i shpirtit (poezi), botuar në vitin 2012
21. I kujt është dielli (tregime), botuar në vitin 2013
22. Gallapi i Prishtinës V, botuar në vitin 2014
23. Gallapi i Prishtinës VIII, botuar në vitin 2014
24. Gjyshja dhe mbesa (poezi për fëmijë), botuar në vitin 2015
25. Rrëfimi për gërshërët (poezi), botuar në vitin 2015
26. Gërshërët (poezi), botuar në vitin 2015
27. Ahmet Sylja-Shtimja (monografi), botuar në vitin 2016
28. Loti i padukshëm (poezi), botuar në vitin 2016
29. Hije në mjegull (roman), botuar në vitin 2016
30. Plis nën rrashtë (poezi), botuar në vitin 2016
31. Orkide n'dritare (poezi), botuar në vitin 2017
32. Ora e Gjergjit, botuar në vitin 2018
33. Unazat e pavdekësisë, botuar në vitin 2018
34. Ora e Gjergjit (Ribotim me plotësime), botuar në vitin 2018
35. Etje e prushtë, poezi, botuar në vitin 2019
36. Fluturzana (Poezi për fëmijë), botuar në vitin 2019
37. Kali i zi, (poezi), botuar në fillimvitin 2020.

Ali Sh. Berisha, edhe pse që nga viti 1990, mund të thuhet se është edhe hulumtues i trashëgimis historike të popullit shqiptar, ai grumbulloi fakte të pakontestueshme, hulumtoi arkivat e pahapura, duke publikuar në librat e tij publicistiko-historik krimet e forcave serbe në Prishtinë dhe rrethinë, sidomos vrasjet, ekzekutimet dhe masakrat e kryera nga forcat ushtarake e policore serbe gjatë viteve 1998/1999, të publikuara detajisht në librin; “Bashkia e Llukarit II - Masakratë serbe në Bashkinë e Llukarit”.

Veprat e Ali Berishës “Gallapi i Prishtinës”, janë punuar mirë, me fakte e dëshmi dhe të botuara në tetë (8) cikle, të cilat janë të mirëpritura nga lexuesit dhe studiuesit...

ALI DACI



Ali Daci, shkrimtar shqiptar nga Mali i Zi, u lind më 3 dhjetor 1959 në Dacaj të Rozhajës nga prindërit Nezir Daci e Begie Nikçi.

Klasët e para të filltores i kreu në fshatin e lindjes në gjuhën serbe, ndërsa katër të fundit në shqip pranë shkollës në Novosellë, kurse të mesmen e kreu në Pejë dhe vazhdoi studimet për Gjuhë dhe Letërsi shqipe në SHLP «Bajram Curri» në Gjakovë. Pas kryerjes së studimeve u kthye në katund dhe punësohet mësimdhënës ku punon akoma sot. Përveç si arsimues i brezave, Ali Daci përcjell dhe është aktiv në lëvizjet shoqërore brenda shqiptare dhe më gjerë në Ballkan e Evropë, ku merr rolin e prijësit për ndryshime dhe ardhmëri. Më 09 shtator 1990, bashkë me intelektualë të tjerë, vendosin dhe themelojnë në Tuz, Lidhjen Demokratike në Mal të Zi, subjekt politik i cili u lakmua edhe nga joshqiptarët. Këtu zgjidhet në krye të partisë në fjalë, Dega në Rozhajë, detyrë të cilën e ushtron edhe sot.


Ali Daci është veprimtar i Konferencës Shkencore për të Djalhtën Shqiptare. Është bashkëpunëtor i RZMZ-Redaksia në gjuhën shqipe dhe pas luftës dy vjet me radhë ka qenë korrespondent i Radio Pejës.

Bashkëpunoi me gazetatat dhe shtypin e kohës, ku më së shumti shkroi për gjendjen dhe pozitën e shqiptarëve në Mal të Zi e Sanxhak, si dhe dha fillet e para të veprimtarisë humane- atdhetare të Mulla Jakup Kombit, Aqif Blytës, Xhemail Konicës...

"Shtigjet e përgjakura" është libri i tij i parë, kurse ka botuar në bashkautorësi me Rrahman Jasharin veprën me titull "*Zemër e madhe në Malësi*", (2006), '*Mali i Zi fsheh krimin tash 19 vite*' (2018).

Ali Daci në librin e tij "*Shtigjet e përgjakura*", në 250 faqe shënime, sjellë dëshmi e fotografi rrëqethëse për 18 prillin e vitit 1999, kur forcat vrasëse serbo-malazeze me uniforma paramilitarësh e ushtarësh, kishin vrarë e masakruar brenda kufirit administrative të Malit të Zi 21 civilë, gra, burra e fëmijë, të ikur nga trojet e tyre të shtyrë nga dhuna e urrejtja e shfrenuar serbe. Strehë për refugjatët nga Kosova, përveç Rozhajës, ishte edhe Plava e Gucia, Tuzi, Tivari, Ulqini, Kraja etj., gjithandej ku janë trojet shqiptare në Mal të Zi, autori, jo vetëm se ishte dëshmitar, por gjatë kohës së luftës në Kosovë, ishte kryetar i Këshillit emergjent për pritjen, strehimin e refugjatëve (të përndjekurve) nga Kosova ...

ALI HADRI (1928-1987)



Akademik Prof. Dr. Ali Hadri, u lind më 3 mars 1928 në Lushnjë. Shkollën fillore dhe të mesmen i mbaroi në Gjakovë, kurse diplomoi në Fakultetin Filozofik të Beogradit, në vitin 1956 dhe po aty kreu edhe magjistraturën, në vitin 1960. Disertacionin e doktoratës “Lëvizja nacionalçlirimtare në Kosovë 1941-1945”, e mbrojti në Fakultetin Filozofik të Prishtinës në vitin 1970. Ishte dekan i Fakultetit Filozofik të Prishtinës, profesor ordinar i Universitetit të Prishtinës, dhe drejtor i Institutit të Historisë të Kosovës.

Ishte drejtor i revistës “Përparimi”, kryeredaktor i revistës “Gjurmime albanologjike” (seria historike) dhe kryeredaktor i revistës “Kosova”.

Për shumë vite i drejtoi studimet pasuniversitare dhe në magjistraturë dhe doktoratë.

Akademik Ali Hadri ishte kryetar i Lidhjes së Shoqatave të Historianëve të Jugosllavisë dhe bashkëpunëtor i një numri revistash historike.

Në fushën e shkencës së historisë botoi me qindra punime shkencore, duke filluar nga viti 1957. Ali Hadri, përveç kësaj nxori nga botimi dhjetë vepra monografike dhe shumë tekste të historisë së popullit shqiptar për shkolla fillore dhe për shkolla e mesme. Ka marrë pjesë me referate e koreferate në simpoziume dhe në tubime të tjera shkencore.

Në pjesën më të madhe punimet e tij trajtojnë probleme të historisë së popullit shqiptar, të historisë së Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës, të historisë së Kosovës midis dy luftërave e të tjera.

Dy herë e mori Çmimin Krahinor të Dhjetorit; u dekorua me Urdhrin e Meritave për Popull me Rreze të Argjenda dhe me Urdhrin e Punës me Flamur të Kuq. Vdiq në Pejë, më 2 dhjetor 1987.

Botimet:

- “Pasqyrë e historisë nacionale shqiptare”, Prishtinë, 1960.
- ”Autonomna Pokrajina Kosovo”, Beograd, 1967.
- ”Kastriot Skenderbek i njegova epoha”, Shkup, 1968.
- ”Lëvizja nacionalçlirimtare në Kosovë, 1941-1945”, Prishtinë, 1971.
- ”Narodnooslobodila?ki pokret na Kosovu 1941-1945”, Beograd, 1973.
- ”Kritikë historiografike I”, Shkup 1973.

- “Gjakova në Lëvizjen nacionalçlirimtare”, Prishtinë, 1974.
- “Këshillat nacionalçlirimtare në Kosovë 1971-1945”, Prishtinë, 1974.
- ”Narodnooslobodilacki odbor na Kosovu 1941-1945”, Prishtinë, 1975.
- ”Ali Kelmendi (1900-1939)”, Prishtinë, 1984.
- ”Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave”, ASHAK, 2003.


Punime të tjera:

- Pjesëmarrja e popujve të Kosovë-Metohisë në Luftën Nacionalçlirimtare dhe në revolucionin popullor të Jugosllavisë, Përparimi, 1957, nr. 6, f. 357-374.
- Pjesëmarrja e popujve të Kosovë-Metohisë në Luftën Nacional-çlirimtare dhe në revolucionin popullor të Jugosllavisë, (vazhdim), Përparimi, 1957, nr. 7-8, f. 456-467.
- Beteja e Sutjeskës, Përparimi, 1958, nr. 6, 7. 380-385.
- Lufta iliro-romake dhe kryengritja e madhe e ilirëve, Përparimi, 1958, nr. 7-8, f. 491-496.
- Lëvizja nacionalçlirimtare e Gjakovës, Përparimi, 1958, nr. 9, f. 604-617.
- Lëvizja nacionalçlirimtare e Gjakovës (vazhdim), Përparimi, 1958, nr. 10, f. 679-692.
- Mbledhja II e Këshillit Antifashist të Çlirimit Nacional të Jugosllavisë AVNOJ-it, Përparimi, 1958, nr. 11-12, f. 739-745.
- Lëvizja punëtore në vendet jugosllave në fund të qindvjetëshit të shek. XIX, Përparimi, 1959, nr. 2, f. 95-104.
- Partitë dhe organizatat socialdemokrate në vendet jugosllave, Përparimi, nr. 3-4, f. 169-180.
- Partia Komuniste e Jugosllavisë prej vitit 1919-1929, Përparimi, 1959, nr. 5, f. 288-302.
- Partia Komuniste e Jugosllavisë prej vitit 1919-1941, Përparimi, 1959, nr. 6, f. 371-384.
- Partia Komuniste e Jugosllavisë - organizuese dhe udhëheqëse e Luftës Nacionalçlirimtare dhe e revolucionit popullor, Përparimi, 1959, nr. 7-8, f. 451-464.

Ali Hadri, përveç këtyre punimeve, pas vete la edhe një numër të madh punimesh dhe vepra tjera me vlerë historike.

Në këtë bibliografi nuk janë përfshirë tekstet e historisë për shkollat fillore dhe të mesme, si dhe artikujt e shumtë të botuar në gazetatat e revista të ndryshme shqiptare si: “Rilindja”, “Fjala”, “Jeta e Re”, “Zëri i rinisë”, “Jedinstvo”, etj.

ALI PODRIMJA (1942-2012)



Ali Podrimja, u lind më 28 gusht 1942, në Gjakovë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje, ndërsa Fakultetin Filozofik, Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, në Universitetin e Kosovës. Në vitin 1966 punësohet në gazetën e përditshme “Rilindja”, në rubrikën e kulturës. Më 1976, në Edicionin e Botimeve “Rilindja”, udhëheq bibliotekat: Poezia shqipe, Letërsia botërore dhe Letërsitë e ish-bashkësisë jugosllave. Ishte anëtar i LSHK-së dhe i PEN-it shqiptar.

Në vitin 1996 u zgjodh anëtar korrespondent i ASHAK, ndërsa në vitin 2000 zgjidhet anëtar i rregullt.

Me shkrime filloi të merret qysh si gjimnazist. Poezinë e parë Arabja e botoi në revistën “Jeta e re” nr. 4, 1957. Po kjo revistë në vitin 1961, Podrimjes ia botoi dhe librin e tij të parë “Thirrje”. Në përkthim të poetit Esat Mekuli u botua, me plotësime, edhe në gjuhën serbokroate, më 1968.

Pos poezive, Podrimja shkroi ese e tregime. Bashkëpunoi me të gjitha revistat e fletushkat në gjuhën shqipe brenda dhe jashtë atdheut. Ishte fitues i shpërblimeve të ndryshme letrare. Në vitin 1999, në Shtutgart të Gjermanisë, u nderua me çmimin e mirënjohur letrar Nikolas Linau. Librat e tij janë botuar, ribotuar dhe përkthyer në disa gjuhë. Ishte prezent në shumë manifestime ndërkombëtare.

Ali Podrimja është autor i më shumë se dhjetë vëllimeve me poezi dhe mbahet sot nga kritika si përfaqësuesi më tipik i poezisë së sotme shqiptare dhe si një poet me emër dhe në shkallë ndërkombëtare.

Botën e vet poetike poeti e artikulonte përmes një sistemi figurativ të konsoliduar (veçanërisht me simbolin dhe metaforën) dhe me një shkallë mjaft të lartë ndjeshmërie. Poezia e tij është epitomë e hermetizmit ku metaforat përbëhen nga disa nivele dhe nën-nivele kuptimore. Manifestimi i kësaj forme poetike u bë i domosdoshëm për poetin, sepse i shërbeu si mburojë kundër sulmeve ndaj ish-pushtetit serb në Kosovë. Pas pavarësisë së Kosovës, poezia e tij rifitoi lirizmin dhe ndjenjën poetike, por pa mundur të dalë krejtësisht nga stili i ngjeshur tradicional shqiptar.

Vdiq më 21.07.2012 në Lodëve të Francës, pasi që atje kishte shkuar të merrte pjesë në festivalin e poezisë Voix de la Méditerranée.

Botimet:

-”Thirrje”, poezi, Jeta e Re, Prishtinë, 1961 ; Naim Frashëri, Tiranë, 1972.

- "Loja nën diell", tregime, Jeta e re, Prishtinë, 1967.
- "Dhimbë e bukur", poezi, Rilindja, Prishtinë, 1967.
- "Sampo", poezi, Rilindja, Prishtinë, 1969; dhe Shkup 1980.
- "Hija e tokës", Bota e Re, Prishtinë, 1971.
- "Torzo", përmbledhje poezish, Rilindja, Prishtinë, 1971; Botimi i dytë, pasthënia Ibrahim Rugova, 1979.
- "Folja", përmbledhje poezish, Rilindja, Prishtinë, 1973.
- "Credo", përmbledhje poezish, Rilindja, Prishtinë, 1976.
- "Poezi", lektyrë shkollore, Prishtinë, 1978, 1985.
- "Drejtpehimi", poezi e zgjedhur, parathënia Ibrahim Rugova, Rilindja, Prishtinë, 1981.
- "Lum-lumi", poezi, Rilindja, Prishtinë, 1982, 1986, 1990; Toena, Tiranë, 2003, botimi IV dhe V, , 2003 ; Libri Shkollor, Prishtinë, 2012.
- "Fundi i gëzuar", poezi, Rilindja, Prishtinë, 1988.
- "Zari", poezi, Rilindja, Prishtinë, 1990.
- "Në bisht të sorrës", poezi, Art-Pena, Prishtinë, 1994.
- "Buzëqeshja në kafaz", Tiranë, 1994 ; Dukagjini, Pejë, 1995.
- "Tkurrja e Atdheut", ese dhe të paharruarat, Konica 95, Tetovë, 1996; Toena, Tiranë, 2004.
- "Libri që nuk mbyllet", ese, Rilindja, Prishtinë, 1997.
- "Ishulli Albania", Rilindja, Prishtinë, 1998; poezi e zgjedhur, parathënia Visar Zhiti, Onufri, 2004 ; botimi plotësuar, AIKID, Prishtinë, 2006.
- "Burgu i hapur", Rilindja, Prishtinë, 1998.
- "Harakiri", ese, shënime nga esnafi dhe një miniroman, Rilindja, Prishtinë, 1999.
- "Dielli i zi", ese, Rilindja, Prishtinë, 2000.
- "Poema", Enti i Teksteve, Prishtinë, 1979, parathënia Hysni Hoxha.
- "Poezi", Naim Frashëri, Tiranë, 1986,
- "Litari i ankthit", poezi e zgjedhur, parathënia Bashkim Kuçuku, Toena, Tiranë 2002.
- "Antologji personale", Ora, Tiranë, 2002.
- "Kush do ta vrasë ujkun", Alba-Ass, Tiranë, 2002
- "Te guri i Prevezës", parathënia Bashkim Kuçuku, Arbëria, Tiranë, 2003.
- "Letra nga të vdekurit", ese dhe persiatje, Toena, Tiranë 2004.
- "Pikë e zezë në blu", poezi, Onufri, 2005. etj

Ali Podrimja ka libra të botuar në shumë gjuhë të huaja të përkthyer dhe të botuara nga shumë shtëpi botuese të huaja...

ALI PREBREZA



Dr. Ali M. Prebreza, u lind më 15.II.1963, në Bardh të Madh, Fushë-Kosovë. Rrjedh nga një familje atdhedashëse dhe arsimdashëse.

Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen dhe fakultetin e mjekësisë, drejtimi i stomatologjisë, në Prishtinë, studimet post-diplomike në lëmin e kirurgjisë orale, po ashtu në Prishtinë. Para lufte punoi si arsimtar i kimisë-biologjisë në shkollën fillore të Bardhit. Ishte aktiv i ilegales dhe luftës kundër okupatorit serb nga ditët e para të daljes në dritë të UÇK-së.

Pas lufte, nga dhjetori i vitit 1999, u emërua drejtor i shtëpisë së shëndetit në themelim, nga viti 2001 punoi në KK Fushë-Kosovë si zëvendës drejtor, e më vonë nga 2003 deri në shtator të 2011 ishte drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “dr. Fatmir Krasniqi” Fushë-Kosovë. Tani kryen detyrën e udhëheqësit të shërbimit stomatologjik në QKMF, si kirurg oral.

Anëtar, kryetar dhe redaktor i grupit letrar “Shkëndijat e Arta”, Bardh i Madh. Tani është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës si dhe kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve “Naim Frashëri”, Fushë-Kosovë. Është anëtar i rregullt i Akademisë së shkencave dhe Arteve Shqiptaro-Amerikane, New York, Tiranë, Prishtinë dhe Shkup.

Vargjet dhe tregimet e Ali Prebrezës janë botuar nëpër shumë gazeta dhe revista.

Me shkrime është marrë që nga klasa e gjashtë. Ka pasur fatin e keq që krejt krijimtaria e paraluftës i është djegur. Ka të botuara deri më tani gjashtë libra me poezi, tregime dhe pjesë skenike për fëmijë dhe të rritur.

Veprat:

- “101 vjet vetmi”, poezi për rini dhe të rritur, 2005
- “Flamuri në gërshet”, pjesë skenike për fëmijë, 2009
- “Morri te doktori”, poezi për fëmijë, Shb ProkultPress, Prishtinë, 2016
- “Përtej dhimbjes”, poezi për të rritur, 2016
- “Kokëkashta”, poezi për fëmijë, 2017
- “Mirani ecën përsëri”, tregime për fëmijë, 2017
- “Në Prekaz lindi kënga”, poemë epike, 2017
- ”Therra me pambuk”, aforizma
- “Bota ka ende diell”, poezi, etj.

ALI SUTAJ (1937-1989)



Ali Sutaj, u lind më 1937, në Llukë të Epërme të Deçanit. Shkollën fillore e kreu në Deçan e Isniq, ndërsa shkollën normale e nisi në Gjakovë dhe e përfundoi në Prishtinë. Kreu studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Një kohë punoi mësues në disa shkolla të Deçanit. Që kur ishte nxënës në shkollën normale botoi shkrime në revistën "Zëri i rinisë" dhe raportonte nga komuna e Deçanit për gazetën "Rilindja".

Më 1961 u punësua gazetar në gazetën "Rilindje". Përveç lajmeve, raporteve, intervistave, shkroi shumë komente, vështrime, skica, ese dhe analiza nga fusha e politikës dhe letërsisë. Ali Sutaj ishte kryeredaktor i "Zërit të rinisë" dhe themelues me detyrë i gazetave-revistave: "Fjala", "Kosovarja", "Shkëndija", "Thumbi", "BAT", "Gep", "Bota e re"...

Vlerësohet si themeluesi i të gjitha revistave që kanë dalë në kuadër të "Rilindjes", madje jo rastësisht e quanin "baba" të tyre. Një kohë punoi në Komitetin Komunal të Prishtinës, prej nga pas vitit 1981, u rikthye në "Rilindje". Është autor i librit me ese "Mbresa", i botuar në vitin 1975 dhe i monografisë "Rilindja 1945-1985". Vdiç më 1989 në Prishtinë, dhe u varros në Llukën e Epërme të Deçanit.

Ali Sutaj ishte dhe mbetet "Korife i Gazetarisë kosovare", do të shkruante Ali Jasjqi. Ali Sutaj e niste një shkrim për internacionalizmin. Po aty e rrethakonte me shkronja të imta ndonjë fjalë të Fishtës, Naimit apo Lazgushit dhe më poshtë shkruante për fenomene, të cilat e përcillnin popullin e Kosovës, cep më cep, që nga pleqtë, fëmijët, nxënësit dhe intelektualët, me të cilët ishte çdo ditë dhe përkujdesej, së paku për ata gazetarë, të cilët kishin nevojë për të. Më duket, se asgjë nuk do të shkruaj, as nuk do t'ju them asgjë. Sepse fjalët s'më rrijnë në fjali as nuk përbëjnë ndonjë periudhë.

"Mbresa" (Rilindja, 1975) temë të cilën e diskutoi guximshëm në mbledhjen e Komitetit Krahinor të LK-së së Kosovës, më 1977 (kushtuar çështjeve të kulturës), ashtu siç thoshte edhe vetë - "banalisht, faqe dheut". Ali Sutaj shkroi; "letra poetëve", komente, por mbi të gjitha shkroi skica me lëng jete, ato që shënojnë datën, për njerëzit dhe gjakimet e tyre, sidomos me ato pyetjet si atij plakut 80-vjeçar gjatë korrijeve, në një arë të

- “Po rigon pak, po Zoti e bën mirë!”, do t’ia dredhojë tjetrën: “Po motin, si e keni?”, për të marrë përgjigjen e dytë -“Hambarët i kemi plot, por po druajmë për fëmijët!”.

Sot do të fliste për Konicën, Fishten dhe Prenushin, por edhe për Cvajgun, Shekspirin dhe Tolstoin. Do të citonte pak edhe profesor Anton Çetten dhe mandej, do të fliste edhe për luftën e fundit dhe UÇK-në. Do të shkruante me përkushtim për gjithë ata njerëz që ende nuk i kanë gjetur eshtrat e familjarëve të tyre. Në veçanti do të shkruante për Fehmi Aganin, por edhe për Bardhyl Qaushin. Për njerëzit e thjeshtë, plakun e urtë nga Shpenadija, Haxhi Tahirin, si për bariun Shaban Binakun që e rrahën policia serbe dhe vdiq pas pesë dite në Spitalin e Pejës, pse mbante fotografinë e Ibrahim Rugovës në xhep dhe thoshte, se; “...shkijet vetë po shkojnë në Serbi...”.

Ali Sutaj ishte gazetar dhe njeri i madh, dhe sot letrave shqipe iu mungon një pendë e tillë, që të shkruajë për të gjitha këto fenomene, që po e përcjellin shoqërinë tonë, në këto ditë kaq të rënda dhe me përsiatje dhe me shumë të panjohura. Ai kishte guxim të shkruante. Të lëmonte, por edhe të qëllonte me kamxhik, njëkohësisht. Të thumbonte, por edhe të thurte lavde, jo për ta bërë qejfin, por që të vetëdijesonte mendjen e lexuesit dhe jo vetëm të tij, por edhe të tjerëve përgjithësisht.

Ali Sutaj me shkrimet e tij mjeshtërore do të çilte derën dhe do ta gjente zgjidhjen në një kohe të re, që duket, se në fund të një stine sado të mërzitshme, do të ketë dalje nga rrethi vicioz, i gjithë këtyre përsiatjeve ballkanike.

Aliu e përdorte një thënie të moqme; “*Mocaniku-mocanikut, shoku -shokut nuk duhet t’i lavdërohet, sepse ata ja njohin njëri-tjetrit të mirat dhe të këqijat. Puna flet për virtytin dhe ndërgjegjen e njerëzve*”...

Sot, mocanikët e tij, shokët, bashkëpuntorët e fjalës e të penës, që gjenden aty ku botohen librat apo revistat, me siguri janë kujtuar, apo do të kujtohen që sot, nesër, t’ia mbledhin nëpër shtypin e asaj kohe të gjitha kujtimet, mbresat, skicat, meditimet dhe t’ia botojnë në një libër të veçantë. Pse jo edhe si monografi. Borxh ia kemi, borxh i ka edhe "Rilindja", ndonëse vepron në këto kushte kaq të rënda. Janë këto borxhe që duhet larë për jetën e tij dyzetyjeçare në gazetarinë dhe publicistikën tonë...

Se vjen një ditë, fjala e tij e pafund nuk harrohet, thotë bashkëvendasi i bacës Ali, shkrimtari Arif Molliqi nga Lluka e Epërme, emigrant në Hamburg-Gjermani...

ANTON PASHKU (1937-1995)



Anton Pashku u lind më 8 janar të vitit vitin 1937, në fshatin Grazhdanik të Hasit të Thatë, afër Prizrenit. Nëna Geta ishte nga Zyimi, kurse babai Tomi, bukëpjekës nga Karashëngjergji, fshat pak më larg Zyimit, rrëzë Pashtrikut. Shkollën fillore dhe pesë klasë të gjimnazit të ulët i kreu në Prizren, kurse tri klasat e gjimnazit real, bashkë me maturën, në Prishtinë. Që nga viti 1958 punoi në gazetën “Rilindja”, në fillim gazetar e më vonë redaktor i rubrikës së kulturës. Më 1973 u inkuadrua në Redaksinë e Botimeve të NBG “Rilindja”, redaktor i prozës dhe dramës. Anton Pashku ka qenë edhe redaktor i revistës letrare “Jeta e Re” dhe revistës “Fjala”.


Ka shkruar kryesisht tregime, romane, drama. Tregimin e parë e ka botuar më 1955 në revistën letrare “Jeta e Re”. Ishte i pranishëm në periodikun letrar, derisa vdiq.

Ishte anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës dhe nga viti 1993 anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Vdiq në Prishtinë dhe u varros në vendlindje, më 31 tetor 1995.

Veprat:

- “Tregime”, botoi: “Jeta e Re”, Prishtinë, 1961.
- “Nji pjesë e lindjes”, tregime, Rilindja, Prishtinë, 1965.
- “Kulla”, tregime, Rilindja, Prishtinë, 1968.
- “Sinkopa”, dramë, Rilindja, Prishtinë, 1969.
- “Oh”, roman, Rilindja, Prishtinë, 71.
- “Kjasina”, tregime të zgjedhura, Rilindja, Prishtinë, 1973.
- “Gof”, dramë, Rilindja, Prishtinë, 1976.
- “Lutjet e mbrëmjes”, tregime të zgjedhura, Rilindja, Prishtinë. 1978.
- “Oh”, roman, botimi i dytë, Rilindja, Prishtinë, 1979.
- “Tragjedi moderne”, drama, Rilindja, Prishtinë, 1982.
- Vepra të përmbledhura:* -1. Tregime fantastike, -2. Tragjedi moderne, -3. Oh, Rilindja, Prishtinë, 1986.
- Fièvre, traduit de l'albanais par Eqrem Basha et Christiane Montecot, Petite Véhicule, Paris, 2000.
- Fièvre, traduit de l'albanais par Eqrem Basha et Christiane Montecot, L'espace d'un instant, Paris, 2003.
- ”Tregime”, Camaj-Pipa, Shkodër, 2003. etj.

ARBEN BAJRAKTARAJ



Arben Bajraktaraj, është i lindur në Isniq, më 28 nëntor 1973. Shkollën fillore e kreu në “Liria” të Isniqit (tash “Isa Boletini”). Ndërsa shkollën e mesme e kreu në Maribor të Sllovenisë, ku mori dhe mësimet e para për teatër. Shkollimin e mëtejshëm e vazhdon në Paris, në “Acting International” me profesorin Robert Cordier.

Interpretoi rolin e Antonin Dolohovit në “Harry Potter dhe Urdhëri i Feniksit (2007) dhe “Harry Potter dhe shenjtoret e vdekur” (2011), me regji të David Yates-it, pastaj rolin e Markut nga Tropoja në filmin “Taken”(regjia Pierre Morel).

Mes tjerash interpretoi rolin e Starzynask-it në filmin “Çelësi i Sarës” (2010), që trajton fatin e një familjeje hebreje gjatë Luftës së II Botërore në Francë, pastaj rolin e Hardquanonn-it në adaptimin e romanit të Viktor Hygosë “Njeriu që qesh”(2012), në regji të Jean Pierre Amerist. Rolin e Darkos në filmin “Liria”(2009), të regjisorit Tonny Gatliff, si dhe ka luajtur në filmat ”Perënditë dhe njerëzit”, (çmimin “Grand Prix”, Kanë 2010), ”Polisse” (çmimin e jurisë, Kanë 2011) etj.


Në Kosovë ka luajtur rolin kryesor në filmin “Heroi” (2010), në regji të Luan Kryeziut, si dhe në filmat e shkurtër ”Ballkoni”, (2013) të L. Zeqirajt.

Arben Bajraktaraj ka luajtur edhe në shfaqje të shumta teatrore në Francë (“Cubat” e Schillerit, ”Ikja” e Gao Xinjangut, “Roberto Zucco” të Koltesit, “Atentati” i Yamina Khadra-së, “Superstar”, etj).

Arben Bajraktaraj, si aktor i madh shquhet edhe në Kosovë e Shqipëri, (“Udhëtimi në Unmikistan”, ”Radio Iliria”, etj).

Aktori kosovar që po bënë nam në Francë e më gjerë, vazhdon të mbetet me të dy këmbët në tokë. Me mbi 40 role filmike, në mesin e tyre edhe ai në “Harry Potter”, dhe në filmin “Taken”, Bajraktaraj vazhdon të mbetet jo shumë i njohur për Kosovën. Ai për këtë fakt edhe ec lirshëm rrugëve të Prishtinës, sepse, sipas tij nuk i ndodhë që ta ndalë dikush në rrugë, edhe pse e kundërta është me rrugët e Parisit. Ai në filmin artistik të metrazhit të gjatë “Heroi”, luan rolin kryesor. Pos filmit, ai ka edhe dhjetëra role në teatro të ndryshme, sikurse që është angazhuar edhe në reklama televizive. E veçantia e tij është se ai vjen nga Kosova, dhe prejardhjen e tij, ai e bartë të shënjuar në trupin e tij...

ARBEN PUTO (1924-2016)



Akademik Prof. Dr. Arben Puto është lindur në Gjirokastrë në vitin 1924. Mësimet e para i ndoqi në Liceun Kombëtar (francez) në Korçë (1935-1939) dhe pas mbylljes së tij vijoi në liceun klasik “Châteaubriant” në Romë.

Mori pjesë në Luftën Nacional Çlirimtare, fillimisht në Gjirokastrë e pastaj në Tiranë.

Pas çlirimit përfundoi shkollën e mesme në Gjimnazin “Qemal Stafa” të Tiranës (1946) dhe kreu studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Moskës (1951), në degën e së

Drejtës Ndërkombëtare Publike. Punoi në sektorin juridik të Ministrisë së Punëve të Jashtme (1951-1957). Pedagog në Fakultetin e Drejtësisë të UT (1957-1990), ku ka dhënë lëndën e së drejtës ndërkombëtare. Ka marrë pjesë aktive në proceset demokratike pas vitit 1990, duke kryesuar Komitetin Shqiptar të Helsinkit që nga krijimi (1990) dhe me ndërprerje deri në vitin 2000. Ka marrë Çmimin e Republikës të shkallës së parë.

U nda nga jeta në Tiranë më 11 nëntor 2016.

Është autor i një numri veprash në fushën e së drejtës ndërkombëtare dhe historisë së diplomacisë.

1. “E drejta ndërkombëtare publike”, vëllimi 1, 2 (1964, me ribotime);
2. “Karta e Kombeve të Bashkuara; Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare” (1993);
3. “Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut në përjasje me Kushtetutën e Shqipërisë”, (2003);
4. “Historia e Shqipërisë” (botuar në frëngjisht 1974, anglisht 1981);
5. “Historia e Shqipërisë” (vëll. III, 1983 dhe IV, 1984);
6. “Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914” (1978);
7. “Demokracia e rrethuar” (1990);
8. “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit”, vëll. I, 1867-1912 (1984);
9. “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së vëll. II, 1912-1918 (1987);
10. “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së vëll. III, 1919-1926 (2001);
11. “Nëpër analet e diplomacisë angleze”, (1976, botim i ripunuar, 2001);
12. “Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926”, 392 f. (2003);
13. “Shqipëria Politike 1912-1939” (2009);
14. “Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878 - 1912”, (2010);
15. “Demokracia e rrethuar”, (2010);
16. “Lufta italo-greke, diktatorë e kuislingë” (2011);
17. “Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e fuqive të mëdha: (1912-1914)”, 584 f., (2012); etj.

ARIF MOLLIQI



Arif Molliqi u lind në Llukë të Epërme të Deçanit, më 11 janar 1953.

Shkollimin fillor dhe gjimnazin i kreu në Deçan. Studioi në Universitetin e Prishtinës, për gazetari.

Në moshën e rinisë filloi të shkruajë dhe botoi poezi. Fillimisht shkroi satirë me pseudonimet Boksh Baruti, Topuz Bërryli, më vonë poezi, prozë dhe dramë.

Veprat:

1. "Simfoni për darkën e qenve", poezi, Prishtinë, 1994
 2. "Në udhëkryq pa zhurmë", (poezi), Toena, Tiranë, 1996
 3. "Loja e Sarkofagut", (dramë), Eurorilindja, Tiranë, 1998,
 4. "Psherëtimja e zareve", (poezi), Panteoni, Tiranë, 1999
 5. "Përplasje" (skica dhe mbresa), Fakti, Shkup, 2000
 6. "Premiera e një pranvere", (poezi), Rilindja, Prishtinë, 2000
 7. "Kafka e ujkut", (roman), Toena, Tiranë, 2001
 8. "Dëshmorët jetojnë pas vdekjes", (monografi), Prizren, 2002
 9. "Shënime nga arkiva e qytetit D.", (roman), F. Konica, Prishtinë, 2003
 10. "Pelegrinazh i ftohtë në qytetin D." (poezi) F. Konica, Prishtinë, 2004
 11. "Loja e dytë e Sarkofagut", (dramë) Rozafa, Prishtinë
 12. "Portretet i pambaruar", (poezi) Faik Konica, Prishtinë, 2006
 13. "Klubi Shqiptar Verrat e Llukës", Hamburg, (monografi), 2007.
 14. "Gruaja e vizatuar nudo" (roman) Faik Konica, 2008
 15. „Një hije bënte rrugë”, poezi, botoi „Faik Konica, Prishtinë 2009
 16. "Simfoni për darkën e Qenit", (roman), 2013, F. Konica
 17. "E dashura ime Eva", (poezi), ShB PA, Prishtinë, 2014
 18. "Kryeqyteti i lakuriqëve", (roman), Armagedoni, Prishtinë, 2017
 19. "Lluka e Epërme nëpër shekuj", (monografi), Armagedoni, 2017
 20. "Si kripën të kam dashtë", (poezi), Armagedoni, Prishtinë, 2018
- Autori është prezantuar edhe në disa libra dhe antologji:

Çmimet:

- „Zëri i rinisë“ 1983, për poezinë “Pjeter Bogdani”
Çmimi i parë, për poezi në konkursin e Zërit të K, 1998,
Çmimin e dytë për poezi të Zëri i K. 1999
Çmimin e parë të konkursit "Takimet e Azem Shkrelit"
Çmimin e parë për poezi kushtua “Jusuf Gërvalla” 2015, etj.

ARJAN HAMITI



Akademik prof. Dr. Arjan Hamiti, u lind në Peqin më 6 maj 1964. Studimet Universitare në Fakultetin e Mjekësisë i kreu në Universitetin e Tiranës (1982-1988).

Punoi si mjek në Librazhd (1988-1991), ishte Shef i Shërbimit spitalor në Peqin (1992-1993), specializoi për Mjek laborant, pranë QSUT në Tiranë (1997-2004), ishte shef i Laboratorit në Poliklinikën Nr.6, në Tiranë (1997-2004).

Në periudhën 2000-2001 kreu trajnimin në përdorimin e aparaturave bashkëkohore laboratorike si dhe kreu disa trajnime në përdorimin e aparaturave të sofistikuar laboratorike.

Nga viti 2004 është pedagog i jashtëm në Fakultetin e Shkencave mjekësore teknike, në Tiranë. Punon si mjek në DRSSH në Tiranë, në pozicionin Shef i KEMP-it (2005-2006).

Nga viti 2006 deri më 15 prill 2013, ishte mjek në ISSH në Tiranë (Kryetar i grupit të auditimit të KEMP-it rajonal).

Më 1 korrik të vitit 2014 ka mbrojtur titullin "Doktor i Shkencave" pranë Fakultetit të "Shkencave Mjekësore Teknike", në Tiranë.

Nga viti 2015 e tutje është pedagog i jashtëm në Universitetin Mjekësor Shtetëror të Tetovës.

Është i Dekoruar me titullin "Ambasador për Paqen" nga Universiteti Peace Federation, si dhe nga Akademia e Shkencave dhe Arteve Shqiptaro -Amerikane në New York, ku është edhe anëtar që nga viti 2016.

Në periudhën prej 1 korrik 2015 deri më 21 shtator 2019 ishte Administrator i Njesisë Bashkiake Nr.10 në Tiranë, kurse nga data 21 shtator 2019 e në vazhdim është Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Bashkësisë së Tiranës.

Prof. Dr. Arjan Hamiti është autor i mjaft shkrimeve dhe librave studimore shkencore.

Veprat:

- Librin epokal: "Anemia në sëmundjet kronike të veshkave", si dhe
- "Ekzaminimet laboratorike në pediatri", Tiranë, 2018 (bashkautor me Prof. Dr. Edmond Pistullin)

Nga viti 2004 e në vazhdim është pedagog i jashtëm në Fakultetin e

“Shkencave Mjekësore Teknike”, Tiranë. Për veprimtarinë bamirëse ndaj komunitetit të dhënë pranë Klinikës Mjekësore “HIPPOCRATI” është dekoruar me Titullin “Ambasador për Paqen”, nga Fondacioni “Universal Peace Federation”.

Ishte nga të parët që i fali shpirtin dhe zemrën ëndrrës së dëshiruar në vite. Dhe jo vetëm kaq, si intelektual bashkëkohor, demokracinë e konsideronte sfidë ndaj sistemit që u shemb; sfidë në dinjitet, në vlerë, në përpjekje, në arritje. Thelbi i mendimit dhe veprimit të tij ishte vetëm konkurrenca në vlera. Ai besoi dhe dëshmoi se njeriun në jetë e mban vetëm dija. Një miqësi me dijen nuk ka moshë, por mbetet e përjetshme. I qetë, i pjekur, shumë i kulturuar nuk pajtohej me asnjë devijim nga parimet e virtytshme dhe njerëzore, por mbante qëndrim.

Shpërthyes dhe autoritar në ndëshkimin e tij individual, sepse përherë qëndronte në vendin e nderit, sinqeritetit dhe dinjitetit. Kuptohet ai ishte individ dhe jo institucion, por idetë dhe praktika e tij mund t'i shërbenin shumë një institucioni, një misioni. Këto cilësi i manifestoi dukshëm edhe si Shefi KEMP-it, Tiranë në vitet 2006-2013.

Aktualisht, me botimin e ri synon të vlerësojë korrelacionin bio-mjekësor të Anemisë në Sëmundjet Kronike të Veshkave dhe trajtimin bashkëkohor të Anemisë tek të sëmurët me SKV.

Akademikë dhe profesor të shquar vlerësojnë veprën shkencore të Prof. Dr. Arjan Hamitit, që ju vjen në ndihmë mjekëve familjar.

Botimi më i ri i Prof. Dr. Arjan Hamitit është një udhërrëfytes, që nëpërmjet informacionit dhe përshkrimit të praktikave mjekësore bashkëkohore, do ndihmojë Mjekët familjarë dhe specialistët në diagnostikimin e hershëm të të sëmurëve me anemi në Sëmundjet Kronike të Veshkave.

Për Dr. Arjan Hamitin, *“Është e qartë, që trajtimi me Eritropoetinë (ilaç, sot i rimbursueshëm nga shteti) duhet të konsiderohet tek të gjithë grupmoshat, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës por, me depistimin dhe diagnostikimin e hershëm të SKV tek moshat e reja, përdorimi i Eritropoetinės merr një rëndësi të veçantë”*.

Në bazë të rezultateve të studimit jepen disa rekomandime për trajtimin e Anemisë tek të Sëmurët Kronikë të Veshkave që kanë si qëllim të ndihmojnë mjekun e shërbimit primar apo sekondar në identifikimin e të sëmurëve me SKV dhe të atyre që kanë nevojë për një mjekim specifik të Anemisë...

ARJETË MIFTARI



Arjetë Miftari, u lind me 20 .08.1986, në Ramun të Pejës. Shkollën fillore e përfundoi në vendlindje, ndërsa të mesmen në Shkollën e Artit “Odhesie Paskali”, në Pejë drejtimi Pikturë.

Arjeta ka përfunduar Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës, drejtimi Skulpturë.

Pas shkollimit u angazhua në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore në Kosovë dhe jashtë. Arjeta tani është Anëtare bordit në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore. Po ashtu ajo është Anëtare e Bordit në Këshillin e Drejtës në Galerinë Kombëtare të Kosovës. Krahas kësaj u mor edhe me pikturë, skulpturë, fotografi artistike edhe arkeologji, ku ajo ka marrë edhe frymëzimin për krijimin e veprave të jashtëzakonshme që ka realizuar tani në gjithë vendin. Që prej asaj kohe ka botuar herë pas herë brenda dhe jashtë Kosovës në shumë media të shkruara. Ka qenë pjesëmarrëse në shumë ekspozita, ku edhe është nderuar me çmime. Në vitin 2014 është nderuar me “Çmimin Skulptore e vitit për kontributin e dhënë në fushën e Artit dhe Trashëgimisë kulturore në Kosovë”. Arjeta nga viti 2003 ka dhënë kontribut në fushën e Artit dhe trashëgimisë kulturore në Kosovë dhe jashtë, duke u prezantuar mjaftë mirë përmes veprave dhe duke vënë në pah vlerat e Artit.


Ekspozita personale

Gusht 2012 Prishtinë, Dhjetor 2004 Maqedoni, Prill 2016 Prishtinë, Shkurt 2017 Berlin Gjermani, Mars 2017 Koln Gjermani, Dhjetor 2018 Paris, Francë, Shkurt 2019, Tiranë.

Çmimet:

“Skulptorja e vitit 2018”, Poleartja e Pegasi Albanien, Tiranë, Çmimi i parë për artin figurativ, Tiranë, 2013, Çmimi për Ekspeditën me të mirë, Kukaj 2012, Çmimi i parë për skulpturën më të mirë, Trento në Itali 2009, Çmimi i parë për nder të 28 nëntorit Istog, Çmimi i parë për skulptura me e realizuar Gjirokastër 2011, Flaka janarit Gjilan, 2016, Human-Gryka e Rugovës në Deçan, 2015, Salloni i Nëntorit, Gjilan, 2015, Galeria e Arteve, Tetovë, 2015, Instituti Albanologjik Prishtinë, 2015, Qendra Kulturore e Tiranës, 2014, Akademia Marubi Tiranë, 2012, Qendra Kulturore ASA Tiranë, 2014 Fryma e re pranverore Tiranë, 2010, Shtëpia e Kulturës në Ulqin, 2010, Galeri private në Poloni, 2001, Shtëpia e Kulturës Sarajevë, 2014, etj.

ARSHI PIPA (1920-1997)



Prof. Dr. Arshi Pipa Ph.D u lind në Shkodër më 28 korrik 1920 dhe vdiq në Uashington, më 20 korrik 1997. Ai ishte arsimtar, publicist, poet, gjuhëtar, kritik letrar, përkthyes dhe pedagog shqiptar. Ishte me prejardhje nga Libohova, u vendos në Shkodër dhjetëvjeçarin e parë të shek. XX. I ati ishte jurist i shkolluar në Stamboll, në kohën e Luftës së Parë Botërore.

Mësimet fillore dhe të mesme i mori në vendlindje, të parat te Kolegji Saverian e më tej për 8 vjet në Gjinnazin e Shkodrës në degën klasike, që e përfundoi më 1938.

Më 1936 me poezinë “Në lamën e luftës” fitoi çmimin e tretë në një konkurs poezie të shpallur nga e përkohshmja "Cirka". Më pas studioi Letërsi e Filozofi në Universitetin e Firencës.

U kthye në Shqipëri dhe nga viti 1941 deri në fund të vitit 1944 ligjëroi lëndën e filozofisë në Licetë Shtetërorë të Tiranës, Shkodrës dhe të Durrësit. Mori pjesë në Kongresin e Parë të Lidhjes në tetor të 1945, drejtuar nga Skënder Luarasi.

Për pak kohë, në vitin 1945, qe mësues i italishtes dhe i gjuhës shqipe në Kolegjin e Mësuesve, Tiranë. Pipën e arrestojnë më 27 prill 1947 dhe pas tyre u arrestuan edhe Preng Kaçinari me Pashk Gjeçin. Pipa është akuzuar dhe është dënuar me 20 vjet heqje lirie.

Vuajti në burgjet dhe kampet e shfarosjes, në Durrës, Vloçisht, Gjirokastër, Korçë, Tiranë, Burrel etj. Ai e shkroi librin me poezi "Libri i Burgut". Familjen e shpërngulën disa herë. Në nëntor të vitit 1949 bashkë me 20 familje të tjera të persekutuarra i shpërnguli në disa shtëpi.

Arshi Pipa lirohet nga burgju më 26 prill 1956, dhe në 1957 arratiset bashkë me të motrën, Fehimen dhe vendoset në Sarajevë gjer më 1959.

Më 1958 emigroi në Shtetet e Bashkuara dhe në fillim punoi arkëtar në Nju Jork. Në vitin akademik 1960, drejtoi departamentin e gjuhës dhe në të njëjtën kohë jepte mësim filozofi, në “Kolegjin e Arteve të Lira” në verë të vitit 1961 dhe 1962.

Ka qene pedagog i gjuhës italiane në universitetin Kolumbia, në universitetin e Delfit, dhe profesor i asociuar i gjuhës italiane. Dha filozofi në Kolegjin e Arteve të Lira.

Në vitin 1966, drejtoi disertacionet për gradën e doktorit në filozofi (Ph.D). Nga viti 1966, ka qenë në fakultetin e Universitetit të Minnesota-s dhe Minneapolis.

Ai ishte drejtues i programit master i themeluar në vitin 1968 “graduate school” në gjuhën italiane. Me daljen në pension u vendos përfundimisht në Uashington, D. C., pranë së motrës.

Ai Gjithnjë ka qenë bashkëpunëtor i zellshëm i “Diellit”. Në pranverë të vitit 1991, Pipa u zgjodh kryetar i “Vatrës”, detyrë në të cilën qëndroi vetëm një vit, sepse në qershor të 1992-shit, nuk u rizgjodh.

Veprat:

Vëllimin e parë poetik me titull “Lundërtarët” e botoi në v. 1944.

Të dytin, “Libri i burgut” të shkruar në letra cigaresh, në burgjet e kampet e punës së detyruar, e botoi në Romë në vitin 1959.

Punë e burgut është edhe “Rusha”, botuar në Munich, 1968.

Më 1969, Pipa botoi në Munih antologjinë poetike “Meridiana”, një përzgjedhje nga botimet e mëparshme dhe disa poezi të pabotuara, si “Preludet”, shkruar në Firence dhe Tiranë më 1941.

Pipa ka lënë një trashëgimi të pasur në fushën e përkthimeve poetike nga latinishtja, italishtja, frëngjishtja, gjermanishtja, anglishtja.

Shumë studime për letërsinë dhe kulturën shqiptare dhe arbëreshe, ka botuar në shtypin e huaj.

Një kontribut të veçantë përbën veprimtaria e tij shkencore në fushën e folklorit, të folkloristikës dhe të gjuhësisë.


Gjatë viteve të burgut përgatiti një vepër me materiale folklorike të mbledhura nga të burgosurit, rreth 420 faqe i dorëzuar Institutit të Folklorit, në vitin 1957, dhe sot nuk gjendet.

Shkrime të kësaj natyre, Pipa botoi në gazetën “Dielli”, gjatë viteve 1991-1992, vite kur ai qe kryetar i “Vatrës” dhe editor i organit të saj.

Pipa shquhet edhe për veprimtari botuese në laminë e shtypit periodik. Ai ka qenë botues dhe kryeredaktor organesh letrare e shkencore.

Interesimet e tij për gjendjen në Shqipëri, Kosovë dhe për të gjitha trojet shqiptare dhe për të ardhmen e tyre kanë gjetur shprehjen e vet në botimin, e librit “Albanian Stalinsm. Ideopolitical Aspects”, e botuar në vitin 1990, libër ky i cili është mirëpritur e lexuar nga komuniteti shqiptar dhe ai ndërkombëtar në Amerikë dhe vende tjera. Arshi Pipa nuk ndaloi shkrimet, studimet e publikimet e tij shkencore deri në momentet e fundit të jetës së tij. Vdiq më 20 korrik 1997 në Uashington, D. C.

ASLLAN KRASNIQI



Asllan Krasniqi, fotograf, është i lindur më 10 tetor 1945 në Tugjec, Kosovë. Veprimtarinë e tij si fotograf autodidakt, e filloi në vitin 1963 duke fotografuar refugjatët e parë kosovarë të cilët, në atë kohë, strehoheshin përkohësisht në Maqedoni, për të ikur me pas në Turqi.

Në vitin 1966 u diplomua në kursin për fotografi (gjatë shërbimit ushtarak në Ajdovçin të Sllovenisë). Në vitin 1967 emigroi në Belgjikë ku vazhdoi veprimtarinë me emigracionin shqiptar.

Në vitin 1969 vazhdoi me korrespondencë kursin e Artit Fotografik në Paris. Qysh nga vitet e 70-ta, ai vazhdoi aktivitetin e tij si fotograf i pavarur, duke vizituar shumë vende të botës. Vendi i parë ku shkrepri aparati i Krasniqit, ishte Turqia, si në Stamboll, Bursë, e vende tjera ku ndodheshin shqiptarët.

Në vitet 1979, 1985 dhe 1992 ai bëri një cikël fotografish në SHBA ai në; New York, Uashington, (Shtëpinë e Bardhë), Los Anxhelos, Hollywood, Beverli Hills, Santa Monika, Universal Studio, etj, ku fotografoi kryesisht mjediset e refugjatëve shqiptarë, duke synuar të trajtojë gjithmonë tema dokumentare, sidomos evenimente historike, artistike dhe kulturore shqiptare.

Më pas ka fotografuar në Paris, Kanë, Monako, Londër, Vjenë, Barcelonë, Bukuresht, Budapest, Varshavë, Venecie, Vatikan etj.

Prej vitesh, si fotoreporter i pavarur, ka ndjekur dhe po ndjek nga afër të gjitha veprimtaritë dhe ngjarjet që kanë të bëjnë me Kosovën. "Sa herë që dëgjoj emrin Kosovë, ai ndodhej atje", si: në Parlamentin Evropian, në Bruksel, në Luksemburg, në Paris, në Bon, në Londër, në Rambuje, në Hagë, e personalitete tjera.

Krasniqi me aparatën e tij fokusoj edhe shumë personalitete që kanë dhënë kontribut për pavarësinë e Kosovës, si: William Walker, Bil Clinton, Kofi Anan, Haviar Solana, Jimi Chee, Olbrait, Toni Bler, Cuchner, etj.

Shqetësimi i përhershëm i Krasniqit ka qenë dhe mbetet pas-qyrimi fotografik i çdo gjurme të asaj që ndodh me popullin e tij. Është ndoshta i vetmi fotoreporter shqiptar nga diaspora, i pranishëm në ngjarjet e fundit të tragjedisë së popullit shqiptar të Kosovës, që ka shoqëruar rrugën dhe dhimbjen të atyre njerëzve që, me lot e me gjak, po i dëbonin nga trojet e tyre, si "EKSODI '99".

Nëpërmjet objektivit të aparatit të tij, gjatë periudhës prill-maj-qershor të vitit 1999, e deri në kthimin e tyre në vendlindje, Krasniqi ka fiksuar çaste nga jeta në kampet e refugjatëve në Belgjikë, në Turqi, në Shqipëri si ne: Kukës, Durrës, Tiranë, dhe Maqedoni (Çegran, Stankovec).

Arkivi i tij personal për Eksodin prej më shumë se 15.000 fotografish, vazhdoi të pasurohet edhe në muajt gusht e shtator të vitit '99, duke pasqyruar të gjitha shkatërrimet, djegiet e bëra nga okupatori serb, pamjet trishtuese të mbijetuarve shqiptarë anekënd Kosovës.

Me të njëjtin pasion, ka ndjekur edhe periudhën e pasluftës. Në këtë vazhdë, evenimentesh e tjera si ceremonia e funeralit të presidentit Ibrahim Rugova, për të ardhur tek dita e Pavarësisë, më 17 shkurt 2008, ditë të cilën fotografi Asllan Krasniqi, ashtu si mijëra shqiptarë të tjerë e përjetoi me shumë emocion duke fiksuar me qindra fotografi, të cilat do të mbeten të përjetshme në historinë e popullit shqiptar.

Ngjarja e fundit ishte përkujtimi i 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë. Asllan Krasniqi ka besim të plotë se i gjithë ky reportazh prej mbi 1.000.000 fotografish, i realizuar vullnetarisht, do të mbetet si një dëshmi e gjallë, që askush të mos e harrojë atë që ka ndodhur me popullin shqiptar, sidomos gjatë viteve 1998/1999.

Foto-ekspozitat:

Ai ka hapur mbi 50 ekspozita në qytete të ndryshme të Belgjikës, Kosovës, Shqipërisë dhe të Francës me tema të ndryshme:

“Eksodi ‘99”,

“Trojet e shqiponjave”,

“Pëllumbi i paqes”,


“Trojet shqiptare pa kufi” etj.

Dashuria për fotografinë dhe përkushtimi ndaj historisë dhe çështjes kombëtare kanë bërë që Asllani gjatë 56 viteve të punës së pandërprerë e të palodhshme, në raste jo të rralla duke lënë anash edhe shtëpinë, familjen e punën, e në të gjitha reportazhet pa ndonjë përfitim personal, të realizoi me qindra mijëra fotografi me vlerë artistike, kombëtare e historike.

Asllan Krasniqi është anëtar i shumë organizatave dhe shoqatave kombëtare e ndërkombëtare si: Anëtar i Organizatës Botërore të Shtypit Periodik, anëtar i Shoqatës së Gazetarëve në Shqipëri, anëtar i Shoqatës së Fotografëve “Gjon Mili”, si dhe i Akademisë Evropiane të Arteve.

Puna dhe përkushtimi i Asllan Krasniqit ndaj fotografisë bëri që ai sot të ketë afro një milion fotografi të realizuara mjeshtërisht...

ASLLAN QYQALLA



Prof. Asllan Qyqalla, u lind më 1 prill të vitit 1959 në Bardhin e Madh, Prishtinë.

Shkollimin fillor e mbaroi në vendlindje, Gjinnazin në Prishtinë, kurse Fakultetin e Filologjisë në Universitetin e Prishtinës, dega Gjuhë shqipe e letërsi. Në vitin 2014 në QSA ne Tiranë e regjistroi Disertacionin e doktoratës.

Në vitin 1984 u punësua mësimdhënës në Shkollën fillore në Bardh të Madh gjerë më 1994 ku edhe u zgjodh drejtor i SHF në Bardh të Madh . Më 1 gusht 2003 emërohet Drejtor në Qendrën e Kulturës, në Fushë-Kosovë, ku punoi gjerë në vitin 2015. Aktualisht punon si profesor në Shkollën e Mesme Profesionale në Fushë-Kosovë.

Është marrë me aktrim dhe regji. Ka përgatitur disa drama e komedi me aktorët e trupës teatrore të SHKA “Naim Frashëri”, SHKA “Bajram Curri”, Prishtinë, me studentët e FF, në Prishtinë, SHKA të studentëve “Ramiz Sadiku”, si dhe me "Radio Çakallën ", dhe me Trupën e aktoreve të rinj të Prishtinës. Është drejtor i Shoqatës së Krijuesve, letrarëve e artistëve “Naim Frashëri” në Fushë-Kosovë, si dhe Drejtor i Festivalit poetik “Malli Poetik i Kosovës”. Në prill të vitit 2017 ka mbajtur Simpoziumin Shkencor “Muhaxhirët në luginën e Anamoravës dhe Preshevës”. Më 1 gusht 2019, po ashtu ka mbajtur Simpoziumin e dytë shkencor “Muhaxhirët nëpër vite 1877/’78 -2018” në Institutin Albanologjikë në Prishtinë, në të cilin morën pjesë shumë studiues me Kumtesa të ndryshme, duke hapur foto ekspozitën me 140 fotografi të Muhaxhirëve.

Veprat letrare:

- “Bardhësi në Bardh” monografi, 1995
- “Nimfa e një zemre të lënduar”, tregime, 2014
- “Loti det dhimbjesh” poezi, 2016
- “Lora” poezi, 2017
- “A lombre des musse” poezi, Paris, 2018
- “My love“ poezi, anglisht, Bukuresht, 2018
- “Lora - Monamor” frëngjisht, Bukuresht, 2018
- “Anthology of Albanian poetry” Bukuresht, 2019
- “Gani Xhafolli-princ i letërsisë për fëmijë”, monografi, 2019

Asllan Qyqalla është anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe Arteve Shqiptaro-Amerikane në New York, Tiranë, Prishtinë dhe Shkup...

ASTRIT MEMIA



Prof. Asoc. Dr. Astrit Memia, u lind më 4 prill 1965, në Tropojë të Shqipëris. Shkollën e Mesme të Gjuhëve të Huaja “Asim Vokshi”, e kreu në Tiranë (1979-1983).

Është i diplomuar për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër (1985-1989). Në vitin 1994, specializoi për Mediat, në Varshavë të Polonisë, ndërsa në vitin 1994 specializoi në Radio “Evropa e lirë”, në Bruksel të Belgjikës. Po këtë vit kreu Specializim për Median Radiofonike dhe Televizive nga Zyra

Franceze e Realizimit dhe Shpërndarjes te Medias Radiovizive Ofredia, në Paris, të Francës (*Office Français de Realisation et de Diffusion Adio-Visuelle*).

Në vitin 1995 specializoi për Politikë Diplomaci, Turizëm dhe Media nga Internacional Federal Press, Berlin Gjermani, si dhe kreu specializimin në Shoqaten Kombëtare të Televizionit France 3 Grupi i Televizionit Francez (Societe Nationale de Television France 3 Groupe France Television) Paris, Francë (1996).

Në vitin 1998 dhe 2002 Specializoi për Diplomacinë Publike dhe Median në Radion France Internacional RFI, Paris, Francë), si dhe në Dubrovnik të Kroacisë (2002).

Në vitin 2005-2008, pranë Universitetit të Tiranës, kreu Fakultetin Juridik. Ka kryer Kolegjin rajonal për studimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë në Akademinë e Mbrojtjes, Tiranë (2007). Ishte mësues i Gjuhës Frënge në Shkollën “Sadik Rama”, në Tropojë (1983-1985).

Kryetar i stafit për trajnimin e mësuesve në Tropojës (1991). Gazetar i Politikës, Diplomacisë dhe Turizmit të Botës Shqiptare (1992-1998); Gazetar në Zyrën e Shtypit të PD-së në Shqipërisë (1998-2019).

Ndoqi studimet e doktoratës gjatë viteve 2003-2006, ku e fitoi titullin shkencor Doktor në Shkencat Politike dhe Diplomaci pranë Universitetit në Lejnitz, USA.

Në vitin 2010 mori thirrjen Akademike “Docent” (Dr), në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës. Pedagog në Universitetin Ndërkombëtar të Prizrenit (2010-2012) Kosovë.

Është autor i shumë librave, artikujve, analizave, referencave, tele-reportazheve, dokumentarëve, spoteve radiofonike dhe televizive.

Botimet:

1. “Njeriu dhe Natyra në Globalizëm”, 2010
 2. “Mikpritja Shqiptare dhe Epoka e Globalizmit”, 2018.
- Bashkëthemelues i Akademisë Diplomatike Shqiptare(2001).

Detyrat:

-Drejtor i Departamentit të Botimeve dhe Informacionit në Akademinë Diplomatike Shqiptare, si dhe nismëtar, Drejtor e Kryeredaktor i Revistës 2 Gjuheshë me ngjyra 72 faqe “Diplomacia”(2001-2004).

-Producent dhe ideator i Festivalit Ndërkombëtar “Imazhi Shqiptar” (2006-2019).

-Botues dhe kryeredaktor i Revistës periodike 6 gjuhësh (shqip-anglisht-frëngjisht-gjermanisht-italisht-spanjisht me ngjyra 72 faqe). Botim i Forumit Imazh & Media (2006).

-Botues dhe Kryeredaktor i Revistës periodike “Imazhi Shqiptar”.

-Sekretar i Përgjithshëm i Kolegjiut të Gazetës “Dardania”(2007)

-Ideator, bashkorganizator dhe lobues i Korridorit Adriatik-Alpe Pesë simpoziume dhe spot televiziv të materializuar me dokumentarin Korridori A-A Korridor Trans ballkanik (2002-2008).

-Konsulent e bashkëpunëtor i Revistës “Garda” organ periodik i Gardës së Republikës së Shqipërisë (2008).

-Anëtar i Bordit Editorial dhe Këshillit Shkencor të Revistës Shkencore (me ISSN) The Heritage - Botim i Universitetit Ndërkombëtar të Strugës,2010 (Maqedoni Veriore).

Redaktor Shkencor i Revistës Shkencore (me ISSN) Global Challenge botim i Akademisë Diplomatike Shqiptar (2012-2019).

Anëtar i Bordit Editorial të Revistës Shkencore Ndërkombëtare “Global Processes”.

Autor dhe bashkautor reportazhesh dhe emisionesh të medias së shkruar, radiofonike, televizive shqiptare dhe të huaja.

Astrit Memia është edhe realizues i disa dokumentarëve televizivë, të edituar në televizione të ndryshme.

Është anëtar i Lidhjes së Gazetarëve të Shqipërisë, që nga viti 1993, si dhe anëtar i Shoqatës ndërkombëtare të Gazetarëve në Bruksel, Belgjikë që nga viti 1994. Nga viti 2012 ushtron edhe profesionin e avokatit...

AVDUSH CANAJ



Avdush Canaj u lind më 12 qershor të vitit 1955 në fshatin Koretin të Dardanës. Në Gjilan e kryen shkollën fillore dhe të mesmen, ndërkaq Fakultetin Filozofik, Degën Letërsi dhe Gjuhë Shqipe në Prishtinë. Në vitin 1977 punoi në Radio Televizionin e Prishtinës (RTP) derisa e morën ushtar në APJ, në vitin 1972, dhe pas një viti, në përfundim të këtij shërbimi fatkeq, e hodhën para Gjykatës Ushtarake në Sarajevë si “intelektual i rrezikshëm për Jugosllavinë e Titos”, e dënojnë me 5 vjet burgim. Pas daljes nga burgu një kohë të gjatë ishte i pa punë. Në vitet e `90-ta, punoi si korrespondent për Radio Shkupin, kurse më vonë ligjëroi letërsinë shqiptare në SHFMU “Selami Hallaçi” në Gjilan. Në vitin 1998, disa reportazhe të tij për luftën në Drenicë, janë botuar edhe në përditëshmen gjermane Frankfurter Rundschau, përkthyer nga Barbara Langmack.

Vepra letrare e Avdush Canajt vlerësohet nga kritika për frymën e re, lirizmin e hollë e modernitetin që ka sjellë në letërsinë për fëmijë e të rinj.

Nga viti 2005 punon në Radio Televizionin e Kosovës, fillimisht në Programin për fëmijë e më pas në atë dokumentar. Janë të njohura emisionet e tij si: Libri i Hapur, filmat dokumentar e tjera.

Veprat letrare:

- “Gjeneral pa epoleta”, poezi, Rilindja, Prishtinë 1993,
- “Lepurushi i çokollatave”, tregime, Flaka, Shkup, 1994,
- “Gonxhja nga Jupiteri”, poezi, Rilindja, Prishtinë, 2000.
- “Zogu në derë”, poezi, Rilindja, Prishtinë, 2003,
- “A fle peshku me pizhame”, Rozafa, Prishtinë, 2008.
- “Mollë me syze”, poezi, Rozafa, Prishtinë, 2010,
- “Dallëndyshet e gjumit”, tregim-roman, Zef Serembe, Prishtinë, 2011,
- “Fluturat me sandale”, poezi, Rozafa, Prishtinë, 2013,
- “Ylli pikturon ëndrrën”, poezi, Rozafa, Prishtinë, 2015,
- “Porta e këngës”, poezi, Faik Konica, Prishtinë, 2017,
- “Planeti i buzëqeshjes”, poezi, Faik Konica, Prishtinë, 2018
- “Buzëqeshje prej dielli”, poezi, Faik Konica, Prishtinë, 2019.

Kritikët e kanë vlerësuar Avdush Canajn si mjeshtër i metaforave, i shqetësimeve të ëmbla të fëmijëve, i cili di si askush tjetër ta përkëdhel vargun poetik...

AVDUSH HASANI (1950-1997)



Avdush Hasani u lind në vitin 1950 në fshatin Pakashticë të komunës së Besianës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Besianë e në Mitrovicë, kurse studimet për artin dramatik në Prishtinë. Në vitin 1971 u inkuadrua në punë në Teatrin Popullor të Kosovës, bashkë me një brez të suksesshëm të artistëve të skenës shqipe, ku punoi deri në vitin 1990. Ndër rolet e para të realizuara, ishte roli i Halilit në shfaqjen “Halili e Hajria” në Besianë në vitin 1973.

Në teatër dhe në film, Avdush Hasani realizoi role shumë të suksesshme në shfaqjet:

Shfaqjet:

“Dasma e Përgjakur”, ”Verbërimi i Samsonit”, “Gjërat që s'preken”, “Zogu i diellit”, “Hamleti”, “Konfiteori”, “Vdekja më vjen prej syve të tillë” e shfaqje tjerë.

Rolet në teledrama:

“E shtëna në ajr” dhe “E kafshoja terrin”, si edhe në dramatizimin televiziv të tregimit “Nën çarr po rrinte vasha”.

Rolet në film:

“Gjurmë të bardha”, “Proka”, “Pikniku”, “Njeriu prej dheu”, “Përroi vërshues”, “Era dhe lisi” e role tjera. Avdush Hasani ishte një aktor i lindur. Ai shquhej për fizikusin e tij, zërin e thellë dhe kulturën e gjerë. Falë Avdush Hasanit ne pamë të gjallë Beselamin e Qosjes, Samsonin e Nolit, Akilin e Euridipit, Muj Klecin e Dedajt dhe Hysajt, Shpend Sokolin e Y. Shkrelit, etj. Avdushi foli në skenë, atje i tha të gjitha. Foli shqip, vetëm shqip, sepse ishte artist i etnosit, artist me profil total shqiptar. Bëri jetë të pagabuar skenike. Në heshtje ujiti dhe kultivoi edukacionin e vetëdijes kombëtare. Ai kishte orë një hije, një shpirt dhe një format aktori iliro shqiptar. Ishte jokomformist, aktor me vokacion të lindur dhe habitus të rrallë. Artist për Tempullin e Zotit, si i tillë ai ndërtoi shpirtin e kombit. Avdush Hasani ishte pasardhës i denjë i Aleksandër Moisiut i shkëlqyer në Teatrin kombëtar shqiptar të Prishtinës.

Pas shkallëzimit të dhunës së okupatorit serb në Kosovës dhe instalimit të sistemit të segregacionit serb në Teatrin e Kosovës, Avdush Hasani u largua nga puna dhe jetoi në azil në Gjermani. Me 2 janar 1997 në Gjermani vdiq aktori Avdush Hasani...

AVDYL KRASNIQI



Dr. Avdyl Krasniqi PhD, është lindur më 13 maj 1951, në Vranoc të Pejës. Shkollën fillore e kreu në Baran, ndërsa gjimnazin “11 Maj” (tash “Bedri Pejani”) në Pejë.

U diplomua më 02 qershor të vitit 1976, në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Një kohë punoi si mjek në Klinikë dhe në Dispanserinë e Mjekësisë së punës në Novobërdë. Specializoi për kirurgji në vitin 1982 në Zagreb.

Deri më 1990 punoi në repartin e kirurgjisë abdominal në Prishtinë. Magjistroi në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Zagrebit, ndërsa doktoratën e kreu në vitin 2001 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë.

Gjatë viteve 1994-1998, punoi si kirurg dhe udhëheqës i poliklinikës private në Pejë, disa muaj gjatë vitit 1998 ishte kirurg në Spitalin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Irzniq.

Ishte shef në repartin e kirurgjisë abdominale në Qendrën Klinike. Në vitin 2007 ka udhëhequr bordin ekzekutiv të QKUK-së.

Për aftësim profesional ishte në institucione të njohura jashtë vendit, në Qendrën e Kancerit në Tokio të Japonisë (1986), në Spitalin Universitar në Gjenevë (1994), në Spitalin e Kolegjit Mbretëror në Londër të Anglisë (1999), pastaj në Spitalin Universitar në Ohaio, SHBA (2000).

Publikimet shkencore:.

1. Avdyl Krasniqi, R. Binishi, D. Limani, A. Rrusta [Treatment of echinococcal hepatic cysts-experience with 79 patients], 1989

2. Faton T Hoxha, R. Binishi, Dalip Limani, Avdyl Krasniqi “Ultrasound and CT Scan Findings in Hydatid Liver Disease Compared to Intraoperative Findings”, 2002

3. Avdyl Krasniqi, Faton T. Hoxha, B. Nuhiu, Dalip Limani “Results of different surgical methods in management of hepatic hydatidosis”, 2006.

4. Lul Raka; Avdyl Krasniqi, Faton T Hoxha, Ilir Q Tolaj ”Surgical site infections in an abdominal surgical ward at Kosovo Teaching Hospital”, 2007.

5. Gazmend Spahija, Lul Raka, Gjyle Mulliqi, Avdyl Krasniqi “Prevalence of Nosocomial Infections in Adult Intensive Care Units at a Kosova Teaching Hospital”, 2008.

6. Burim Neziri, Sh. Krasniqi, Shqipe Devaja, Avdyl Krasniqi ”Expression

of nicotinic subtypes acethyl choline receptors within airway related vagal preganglionic neurons in ferrets”, 2008.

7.Muharrem Jakupaj, Burim Neziri, Avdyl Krasniqi “Vagotomy diminished airway constriction provoked by different doses of Eserine”

8.Avdyl Krasniqi, Lumturije Gashi-Luci, Selvete Krasniqi, Ismail Dreshaj “A comparison of three single layer anastomotic techniques in the colon of the rat”, 2008.

9.Avdyl Krasniqi, Faton T.Hoxha, Besnik Bicaj, Lumturije Gashi-Luci ”Symptomatic subserosal gastric lipoma successfully treated with enucleation”, 2008.

10.Selvete Krasniqi, Ahmeti Hoxha SA., Avdyl Krasniqi “Simultaneous laparoscopic cholecystectomy and removal of intrauterine device translocated to the right subdiaphragmalregion: a case report”, 2009.

11.Faton Hoxha, Shemsedin Isuf Hashani, Driton Komoni, Avdyl Krasniqi “Acute abdomen caused by ingested chicken wishbone: A case report”, 2009.

12.Avdyl Krasniqi, Gazmend Spahija, Shemsedin Isuf Hashani, Lumturije Gashi-Luci “Subtotal resection and omentoplasty of the epidermoid splenic cyst: a case report”, 2009.

13.Avdyl Krasniqi, Dalip Limani, Lumturije Gashi-Luci, Ismail Dreshaj ”Primary hydatid cyst of the gallbladder: A case report”, 2010

14.Avdyl Krasniqi, Astrit Hamza, Lulzim Salihu, Lumturije Gashi-Luci ”Compound double ileoileal and ileocecolic intussusception caused by lipoma of the ileum in an adult patient: A case report”, 2011.

15.Avdyl Krasniqi, Besnik Bicaj, Rifat Bajrami, Lumturije Gashi-Luci. Clinical features and treatment of gastric gist - our experience, 2012.

16.Avdyl Krasniqi, Besnik Bicaj, Dalip Limani, Rifat Latifi: ”The Role of Perioperative Endoscopic Retrograde Cholangiopancreatography and Biliary Drainage in Large Liver Hydatid Cysts,”2014.

17. Avdyl S. Krasniqi, Astrit R. Hamza, Valon A. Zejnullahu, Fatos Sada, Besnik Bicaj ”Penetrated sigmoid colon by air gun pellet could be life threatening: A case report Cited in Scopus” (Publication stage: In Press Uncorrected Proof International Journal of Surgery Case Reports Published online), 2014

18.Astrit Hamza, Avdyl Krasniqi, Pramod Kadaba Srinivasan, René Tolba: ”Gut-liver axis improves with meloxicam treatment after cirrhotic liver resection”, 2014. Etj.

AVNI DEHARI



Avni Dehari, u lind më 03 maj 1947, në fshatin Sllupçan, rrethi i Kumanovës.

Shkollën fillore e kreu në vendlindje. Shkollën e mesme, gjimnazin, e mbaroi në Preshevë, kurse u diplomua në Fakultetin e Filologjisë - gjuhë dhe letërsi shqipe, në vitin 1974, në Prishtinë.

Që nga viti 1969 e deri më 1981 e ushtroi detyrën e mësimitdhënësit të gjuhës dhe të letërsisë shqipe në Ferizaj, në Sllupçan, në Gjilan dhe në Kumanovë.

Si pasojë e masave diskriminuese antishqiptare nga serbo-maqedonomëdhentë, në nëntor të vitit 1981, u përjashtua nga Gjimnazi i Kumanovës dhe u detyrua të largohet nga vendlindja. Përkohësisht u vendos në Zvicër, ku qëndroi gati 19 vjet.

Në vitin 1999, për herë të parë pati mundësi të kthehet në vendlindje.

Një vit më vonë, së bashku me familjen, u vendos në Prishtinë.


Shkruan prozë e poezi për të vegjël dhe për të rritur.

Botimet:

1. “Dielli”, poemë për fëmijë, Biel, 1990;
2. “Arif Seferi - një jetë në shërbim të popullit”, monografi, Biel, 1993,
3. “Pas rrezes së diellit”, përmbledhje poezish për të rritur, Shkodër, 1994;
4. “Saja fluturuese”, libër për fëmijë në prozë, Tiranë, 1996;
5. “Hëna në dritare”, përmbledhje poezish për fëmijë, Prishtinë, 2005;
6. “Kënga e Drerit Fjalëpak”, libër për fëmijë në prozë, Prishtinë, 2010;
7. “Flokëhapëshuri”, libër për fëmijë në prozë, Prishtinë, 2011;
8. “Gjergji i Arbërisë”, (në ribotim: “Kobra-Gjergjat në drita përkrenarësh”, libër për fëmijë në prozë, Prishtinë, 2011;
9. “Nxin e qesh natyra”, përmbledhje poezish për fëmijë, Prishtinë, 2012;
10. “Dielli në qerre të re”, përmbledhje poezish për të rritur, Prishtinë, 2013;
11. “Gjergji i Arbërisë në Adrianopojë” (në ribotim “Udhëkryqi-Gjergji në drita përkrenarësh”), libër për fëmijë në prozë, Prishtinë 2014’
12. “Gjergjat në drita përkrenarësh”, trilogji për fëmijë dhe të rinj në prozë.
13. “Ringjallja e Prometeut -Ali Aliu Kelmendi”, monografi letrare, etj.

Avni Dehari është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, i cili, për krijimtarinë e tij letrare është shpërblyer disa herë me çmime në Manifestime të ndryshme letrare...

AVNI MULA



Avni Mula u lind më 4 janar të vitit 1928 në Gjakovë. Studimet e larta muzikore i kreu në Konservatorin “Çajkovski” të Moskës (1952-1957), ku u diplomua si këngëtar lirik. Karrierën artistike e nisi menjëherë mbas kthimit nga Moska si solist në Teatrin e Operës dhe Baletit, duke realizuar role kryesore të repertorit operistik të kohës, përmes së cilave u dallua për nivelin e lartë të zgjidhjeve muzikore-skenike.

Veçohen realizimet e figurës së Figaros te “Berberi i Seviljes”, figurës së Rosinit, tek “Eugjen Onjegin” të Çajkovskit dhe Gjetës, tek “Mrika” e Prenk Jakovës.


Veprimtarinë krijuese e nisi në gjysmën e dytë të viteve 1960, fillimisht në fushën e këngës e të romancës dhe më pas si autor i veprave të mëdha vokale-koncertale, kantata, poema vokale dhe skenike, ku veçohen Opereta “Karnavalet e Korçës” dhe Opera “Borana”.

Pjesëmarrja në festivale:

- Festivali i I-rë në RTSH, dhjetor 1962, me këngën "Kendoj".
- Ibrahim Tukiçi dhe Avni Mula me këngën "Jeta e re ne na pret".
- Gjoni Athanas dhe Avni Mula me këngën "Shpresë".
- Avni Mula merr pjesë në Festivali në RTSH me këngën "Ne stadium".
- Festivali në RTSH, dhjetor 1963, Avni Mula me këngën "Degjo o Hanë".
- Festivali në RTSH, dhjetor 1965, A. Mula me këngën "Valsi i lumturisë".
- Festivali në RTSH, dhjetor 1974, Avni Mula me këngën "Kënga zjarr".
- Festivali në RTSH, dhjetor 1976, A. Mula "Nënë moj do pres gërshetin".
- Festivali i XVI-të në RTSH, dhjetor 1977, kënga "Kasollja e Galigatit".
- Festivali në RTSH, dhjetor 1978, me këngën "Shqipëri o vendi im".
- Festivali në RTSH, dhjetor 1980, kënga "Për Ty çelin mijëra mëngjese".
- Festivali në RTSH, dhjetor 1981, me këngën "Me kujton ti ato vite".
- Më datë 9 shtator 2008, Liliana Kondakçi dhe Avni Mula publikojnë videoklipin "Udhetim ne pranvere". Më datë 2 shkurt 2009, Avni Mula publikon videoklipin "Vajza me kaçurrela"...

Është i vlerësuar për krijimtarinë që ai i ka sjellë para popullit. Ato pjesë dhe vepra që i ka kënduar me shumë kënaqësi, Avniu është duartrokatur nga publiku. Ka kënduar muzikën shqiptare dhe të huaj, e cila i ka falur shumë në jetën e tij, pasi jeta artistike e artistit Avni Mula ka qenë me plot vepra që do t'i qëndrojnë kohës...

AZEM SHKRELI (1938-1997)



Azem Shkreli, u lind më 10 shkurt 1938, në Rugovë të Pejës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa në Prishtinë ai vazhdoi shkollën e mesme për të vazhduar fakultetin Filozofik, degën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe.

Për shumë vjet ai ka qenë kryetar i shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, drejtor i Teatrit Krahinor në Prishtinë dhe themelues e drejtor i Kosova Filmit.

Poezitë e tij janë përkthyer në shumë gjuhë të huaja.

Shfaqja e Azem Shkrelit si poet, përpos që përputhej me ardhjen e talentit të fuqishëm, shënonte njëkohësisht kthesën e parë drejt hapjes dhe modernizimit të poezisë shqipe të pasluftës.

Shkreli u ngjiti natyrshëm në kulmet e poezisë së sotme shqiptare dhe këtë vend ai e konsolidoi dhe e përforcoi nga njëra vepër poetike në tjetrën, deri në atë të fundit, që e la dorëshkrim "Zogj dhe gurë", botuar më 1997. Azem Shkreli vdiq më 27 maj të vitit 1997.

Veprat letrare:

1. "Bulzat" (1960)
2. "Engjujt e rrugëve" (1963)
3. "E di një fjalë prej guri" (1969)
4. "Nga bible e heshtjes" (1975)
5. "Pagëzimi i fjalës" (1981)
6. "Nata e papagajve" (1990)
7. "Lirikë me shi" (1994)
8. "Zogjë dhe gurë" (1997),

Vepra "Bulzat" është e përbëre nga gjashte cikle: "Poema e pakthyeme", "Kallximi në tri kangë", "Akuarele", "Elegji", "Intimet" dhe "Hoje".

Prozë

- "Karvani i bardhë" (1961),
"Sytë e Evës" (1975),
"Muri përfundi shqipes"

Drama

- "Fosilet" (1968),
"Varri i qyqes" (1983), etj.

AZIZ REXHEPI



Prof. As. Dr. Aziz Rexhepi, u lind më 17 shkurt 1961 në fshatin Komogllavë të Ferizajt.

Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Ferizaj. Fakultetin si dhe Masterin i kreu në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës, kurse Doktoratën për Menaxhimet, i kreu në UET në Tiranë.

Në vitin 2005, ishte mësimdhënës i lëndëve të Ekonomisë në Shkollën Ekonomike në Ferizaj.

Në vitin 2012, ishte njeri prej hartuesve të plan-programeve për shkollat shqipe në kuadër të MASHT-it. Në vitin 2013, ishte Drejtor i Shkollës së mesme ekonomike “Faik Konica” në Ferizaj. Po kështu gjatë viteve 2011-2014, ka qenë ligjërues në Kolegjin Universitar “Vizioni për Arsim”, në Ferizaj.

Në vitet 2017/2018 ka punuar profesor i rregullt në Kolegjin Universitar “UBT”, Prishtinë, si dhe është mësimdhënës i rregullt në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, (USHAF) në lëndët e Menaxhmentit dhe Ekomomisë. Prof. As. Dr. Aziz Rexhepi, është anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe Arteve në New York.

Publikime shkencore:

-Hulumtimi empirik krahasues mbi stilet e vendimmarrjes në organizatat publike dhe private. (Revista shqiptare sociale ekonomike, Tiranë 2014).

-The managerial affection towards the application of motivation of personnel in small and medium enterprises in Ferizaj European academic April, 2016, Busau Rumania.

-Work satisfacion-comparision between public and private sector International Journal of Current, Madrid Spain February, 2016.

-Resources as a challenge in effective Motivation of Human decision making in SMEs in Kosovo European academic, March 2016, Rumania.

-The managerial affection towards the application of motivation of personnel in small and medium enterprises International Multidisciplinary Research Journal European Academic, Impact Factor: 3.4546, Madrid.

-Emprische Forschung der Mitarbeitermotivation in KMU in Ferizaj Academic Journal of Business, Economics and Accountancy Slov. 2016.

-Rëndësia e motivimit të personelit NVM-te e Ferizajit dhe procesi i vendimmarrjes, Hulumtimi dhe shkenca në shekullin e dytë të pavarësisë së Shqipërisë, etj.

BAJRAM IBRAJ



Dr. Bajram Ibraj, u lind më 28 mars të vitit 1964, në Lezhë. Shkollën 8-Vjeçare e kreu në Shëngjin Shqipëri. Më pas vijoi mësimet në Shkollën e mesme të përgjithshme “Hydajet Lezha”, në qytetin e Lezhës. Gjatë viteve 1983-1987 vijoi studimet në shkollën e lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Fakulteti Polici, në Tiranë, kurse studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës, i kreu gjatë viteve 1991-1995.

Më 24 tetor të vitit 1996, ushtron profesionin e Avokatit. Në periudhën shkurt 2012-dhjetor 2013, ka fituar titullin shkencor: Kandidat në Shkencat Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare nga Universiteti Emuni në Slloveni.

Më 1 prill 2017, ka marrë titullin shkencor: Doktor i shkencave, në shkencat sociale me profil shkenca politike në Marrëdhënie Ndërkombëtare, mbrojtur pranë Universitetit Evropian të Tiranës, Fakulteti Shkencave Sociale dhe Edukimit.

Në nëntor të vitit 2000 u kualifikua në planifikimin e përballimin e emergjencave civile në Republikën Çeke, si dhe përfitoi eksperiencë pune në planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile në Slloveni e Austri.

Në muajin shtator 2000 ka kryer një vizitë studimore në selinë e NATO-s dhe Komandën Supreme të Forcave të Armatosura në Evropë (SHAPE), Bruksel.

1987-1991 Zv.shef i Policisë Kukës. 1991-1993 Shef i Policisë Rendit, Shkodër. 1993-1995 Shef i Sek. Sigurimit, Banka e Kursimeve, Shkoder.

1995-1997 Jurist, Banka e Kursimeve Shkodër. 1997 Shef i Komisarariatit të Policisë Shkodër. 1997-2000 Shef i Sek. Shërbimeve të Rendit, MRP.

1999 I Plotfuqishëm i MRP në Kukës, për menaxhimin e situates së krijuar nga ardhja e kosovarëve. 2000 drejtor i Policisë së Rendit, MRP, 2000 drejtor i Policisë së Qarkut Lezhë, 2000-2002 këshilltar i Kryeministrit për Sigurimin Kombëtar. Nga viti 2002-2007 ka qenë drejtor i Përgji-thshëm i Policisë së Shtetit, si dhe kryetar i Bordit të Përafrimit të Legjislacionit për Politicë e Vendeve të Europës Juglindore...


Botimet shkencore:

- "Taktika të Ndërhryjeve të Policisë", 2005 (bashkautor).

- Studim për kundërvajtjet administrative në rrethin e Kukësit, 1984-1989.

- "Studim për vrasjet, plagosjet, sulmet dhe dëmtimet e punonjësve të Policisë së Shtetit, në dhe për shkak të detyrës, janar 1997- dhjetor 1999".
- Studim për "Sulmet e Dhunshme Kriminale ndaj Sistemit Bankar në Shqipëri, 2000-2012".
- "Doktrina Bush dhe Rreziku i Kërcënimit të Vlerave të Demokracisë".
- "Lufta në Irak, - armët e dëmtimit në masë, legjitimiteti i saj, mbështetja, kundërshtimet e bëra dhe pasojat e luftës".
- "Roli i Universiteteve në Përshpejtimin e Proceseve të Integritimit të Shqipërisë në BE"
- "Forcimi i Shtetit Ligjor dhe Rendit kundër Krimit të Organizuar»
- "Lufta në Irak, - a mund të parandaloheshin?"
- Konferencë Ndërkombëtare Shkencore - Ditët e Studimeve Shqiptare, organizuar më 03.05.2014
- "Qeverisja dhe Integrimi: Qeverisja, territori, përfaqësimi dhe legjitimiteti në integrim", referuar në Konferencën ndërkombëtare.
- "Qeverisja dhe Institucionet e Sigurisë në Republikën e Shqipërisë në periudhën 1991-2014", Revistën Shkencore të UE, Tiranë.
- "Qeverisja dhe Institucionet e Sigurisë në Republikën e Shqipërisë në periudhën 1991-2014", botuar në Global Challenge
- "Fall of Berlin Wall and Its International Impact" organizuar nga European Institute of Management Laë and Diplomacy and Albanian Diplomatic Academy Tiranë. Referuar në konferencën Ndërkombëtare, organizuar më 2 nëntor 2014 në Shkup
- Ditët e Studimeve Shqiptare, 24 - 26 Prill 2015
- "Krimi i Organizuar Transnacional dhe Globalizmi»
- "Parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë»
- "Cooperation between Albania and Kosovo and its impact in strengthening the rule of laë against Transnational Organized Crime, 2008-2015»
- "Disa probleme për të miturit në vendin tonë si viktimat e veprave penale»
- "Drejtësia për të Miturit, Realitete dhe Sfida", Tiranë
- "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur dhe llojet e veprave penale të kryera nga të miturit në Shqipëri"
- "Krimi Kompjuterik, Kërcënimi Kibernetik dhe Siguria Kombëtare", botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë, 2018...

BARDHYL ÇAUSHI



Prof. Dr. Bardhyl Çausi, u lind më 15 gusht të vitit 1936, në qytetin e Gjakovës. Shkollimin fillor e ka përfunduar në vendlindje, ndërsa shkollimin e mesëm në Prishtinë. Në vitin 1955/1956, e regjistroi fakultetin juridik në Universitetin Shtetëror të Beogradit, ndërsa pas përfundimit të semestrit të parë ishte transferuar në Universitetin Shtetëror të Shkupit në të njëjtin drejtim, ku kishte përfunduar studimet.

Pas përfundimit të studimeve universitare, ishte punësuar si referent në Gjykatën Komunale në Gjakovë. Në vitin 1967 u zgjodh kryetar i Gjykatës Komunale në Gjakovë, kurse në vitin 1969 u shkarkua nga ky funksion për ta përfunduar karrierën e tij në sistemin gjyqësor.

Në vitin 1969 u zgjodh si bashkëpunëtor i lartë për lëndën “E drejta romake” në gjuhën shqipe, drejtimi i atëhershëm Juridiko-ekonomik, ende pa u themeluar Universiteti i Prishtinës. Në vitin 1969 regjistron studimet pastdiplomike pranë Fakultetit Juridik të Universitetit të Beogradit në drejtimin Civilo-juridik deri në vitin 1972. Pas themelimit të Universitetit të Prishtinës, në vitin 1970 punësohet në Fakultetin Juridik asistent i lëndës së të drejtës romake. Në vitin 1978 e mbrojti temën e magistraturës pranë Fakultetit Juridik në Universitetin e Beogradit. Ndërsa, në vitet e 80-ta bëhet profesor i së drejtës romake. Në vitin 1989 mbron tezën e doktoratës me sukses të lartë pranë Fakultetit Juridik të Universitetit të Zagrebit në drejtimin civilo-juridik. Në vitin 1989 Prof. Dr. Bardhyl Çausi emërohet dekan i Fakultetit Juridik, duke qenë njëri ndër kundërshtuesit më të fuqishëm për suprimimin e autonomisë të Krahinës Autonome të Kosovës së bashku me akademikun Gazmend Zajmi. Ishte përkrahësi më i madh, së bashku me akademik Fehmi Aganin, për hartimin e Deklaratës së 2 Korrikut të vitit 1990 dhe hartimit të Kushtetutës së Kaçanikut, që e kishte hartuar akademik Prof. Dr. Gazmend Zajmi. Prof. Dr. Bardhyl Çausi ishte kryetar i parë i Shoqatës së Pavarur të Juristëve të Kosovës.

Bardhyl Çausi së bashku me disa intelektualë të tjerë të Universitetit të Prishtinës, në vitet e para pas themelimit të tij, ai në cilësinë e profesorit ishte përcaktuar të merrte pjesë si përfaqësues i Akademisë së Shkencave dhe Arteve në Kongresin e Drejtshkrimnit të Gjuhës Shqipe të mbajtur në Tiranë, më 20 deri 25 nëntor të vitit 1972...

BASRI LENJANI



Dr. Basri Lenjani, është i lindi më 02 gusht 1964, në Karaçevë të Kamenicës. Shkollën fillore e kreu në Karaçevë, Kamenicë (1979), Shkollën e Mesme të Mjekësisë, Dega e Infermierisë së Përgjithshme e mbaroi në Prishtinë (1983). Në vitin 1997 e kreu Fakultetin e Mjekësisë pranë Universitetit të Prishtinës. Në vitin 2004 e kreu Specialiali-zimin nga Mjekësia Emergjente në Prishtinë. Studimet posdiplomike nga Mjekësia Emergjente i kreu në Prishtinë (2008). Në vitin 2013 në Tiranë i kreu Studimet e Disertacionit, nga Mjekësia emergjente në Universitetin e Tiranës. Është Doktor i parë i Shkencave në Mjekësi Emergjente në Republikën e Kosovës.

Në vitet shkollore (1995-2002) punoi pedagog në Shkollën e Mesme të Mjekësisë "Dr. Ali Sokoli", Prishtinë. Ishte mjek i urgjencës së Ndihmës së shpejtë në Prishtinë (1999-2000). Mjek specialist emergjent në QKUK, Qendra Emergjente, Prishtinë (2004-2005). Drejtor në Klinikën Emergjente në QKUK, Prishtinë, 2005. Mësimdhënës në Universitetin Shtetëror të Tetovës, 2007-2009; Ligjërues i Kurseve të Ndihmës së Parë në Kryqin e Kuq të Kosovës, 2010; Asistent i angazhuar në Fakultetin e Mjekësisë dega Infermieri, 2010; Mësimdhënës në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, "Rezonanca", Prishtinë (2011-2012); si dhe funksione tjera.

Publikime shkencore:

1. "Përkujdesja shëndetësore", i dedikuar për shkollën e mesme të infermierisë, Libri Shkollor, 1998, ribotuar, 2000, 2002, Prishtinë.
2. "Pediatria me përkujdesje shëndetësore", tekst i dedikuar për shkollën e mesme të infermierisë, Libri Shkollor, 2000, ribotuar 2002, Prishtinë.
3. "Reanimacioni Kardiopulmonal, veprimet mjekësore dhe administrimi i medikamenteve", botim i veçantë, Prishtinë 2001.
4. "Urgjenca mjekësore", Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore, 2001.
5. Dr. Basri Lenjani MD. Mrs. "Ndihma e parë", Prishtinë, 2010.
6. Prof. Ass. Basri Lenjani MD. Mrs. PhD "Arresti Kardiak Reanimacioni Kardio pulmonal", Libri Shkollor, Prishtinë, 2014.
7. Prof. Ass. Basri Lenjani MD. Mrs. PhD "Dhënia e Barnave me rrugë parenterale dhe enterale dhe veprimet mjekësore emergjente", 2014.
8. Prof. Ass. Basri Lenjani MD. Mrs. PhD "Doracak i ndihmës së parë", Kryqi i Kuq i Kosovës, Prishtinë, 2015, etj.

BASRI SEJDIU



Dr. Basri Sejdiu u lind më 20 korrik 1962, në Mitrovicë, pas përfundimit të shkollimit fillor dhe të mesëm, në vitin 1982 regjistron studimet në Fakultetin e Mjekësisë në UP në Prishtinë.

Studimet i përfundoi më 1988, në vitin 1989 filloi punën si mjek i përgjithshëm në Mitrovicë deri në vitin 1997, kur edhe filloi specializimin në mjekësi interne.

Në vitin 2001 merr titullin specialist i mjekësisë interne, përderisa më 2010 mbroi titullin e magjistraturës në shkencat mjekësore.

Ka ndjekur trajnime profesionale për kardiologji invazive në Tuzell (Bosnjë dhe Hercegovinë), ku edhe është profilizuar për kardiologji invazive. Ishte udhëheqës i ekipit të parë të kardiologjisë invazive në Kosovë në vitin 2003, kur edhe ishte kryer koronarografia e parë.

Më 2010, ishte pjesë ekipit mjekësor që vendosi stentin e parë në QKUK. Në dhjetor të vitit 2017, Bordi Drejtues i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar, e cakton UD. Drejtor të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës.

Në muajin mars 2018, përmes konkursit publik zgjidhet në pozitën e Drejtorit SHSKUK.

Më parë, pra në periudhën kohore 2011 deri 2012, ishte UD. Shef i Repartit të Kardiologjisë Invazive, përderisa në vitin 2016 deri më 2017 ishte ud. drejtor i Klinikës së Kardiologjisë.

Aktualisht vazhdon ta ketë pozitën e drejtorit të përgjithshëm të SHSKUK-së.

Dr. Basri Sejdiu, në qershorin e vitit 2019 iu ka ndarë titulli “Ambasador i paqes”.

Sejdiu ka thënë se ndjehet i nderuar me titullin "Ambasador i Paqes", të cilin e ka pranuar nga Federata e Paqes Universale, në një ceremoni në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

“Ky është një vlerësim dhe motivim shtesë për punën e mëtutjeshme dhe angazhimin në shërbim të qytetarëve pa dallim.

Humanizmi është një vlerë e lartë, që secili prej nesh duhet ta kultivojë”, ka thënë Dr. Basri Sejdiu.

Ai ka shtuar se përkushtimi ndaj shëndetit të popullatës është gjëja më e shenjtë dhe vlerësimi si kjo e bëjnë krenar...

BEDRI HALIMI



Bedri Halimi, u lind më 5 mars 1963, në Kuk të Opojës (komuna e Sharrit). Ish i burgosur politik në burgjet serbo sllave (Goli Otok, etj). Ka të kryer Fakultetin e bujqësisë në Universitetin "Hasan Prishtina", në Prishtinë.

Është Kryeinspektor i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë.

Bedri Halimi ka botuar punime të shumta kulturore, letrare e shkencore (nga lëmia e agromisë) në revista të ndryshme të hapësirës shqiptare dhe më gjerë.

Botimet:

- "Ditar Dardanie", poezi, KL "Luigj Gurakuqi", Sharr, 1992
- "Plagë shpirti", poezi, KL "Luigj Gurakuqi", Sharr, 1995
- "Cubat fshehin Hënën", poezi, Gazeta "Rilindja", Prishtinë, 1999
- "Rugova - ngritja dhe rënia", publicistikë, Forumi i Krijuesve të Artit, Prishtinë, 2000
- "Kafshët e botës sime", poezi për fëmijë, "Rilindja", Prishtinë, 2001
- "Qëndresa kombëtare në Opojë dhe dëshmorët e saj", Klubi Letrar "Luigj Gurakuqi", Sharr, 2002
- "Haxhi Ymer Prizreni" (përgatiti për botim), revista "Sharri", 2006
- "Pemët, perimet dhe drithërat në mjekësinë popullore", studim, Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor e Republikës së Kosovës, botuar në Prishtinë, 2009
- "Karnavalet e djajve", poezi, botuar nga SHK "Ymer Prizreni", 2013
- "Dëshmorët e Opojës", 2014, monografi, Shoqata Kulturore "Ymer Prizreni", Sharr, 2014
- "Opoja - aspekti historik", monografi, (përgatiti për botim), Shoqata Kulturore "Ymer Prizreni", 2016
- "Haxhi Ymer Prizreni- figurë e shquar e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare", Shoqata Kulturore "Ymer Prizreni", Sharr, 2017
- "Panoramë opojane", poezi për fëmijë, "Fidani", Prizren, 2017
- "Opoja - aspekti folklorik", monografi (përgatiti për botim), Shoqata Kulturore "Ymer Prizreni", Sharr, 2017
- "Ecje nëpër furtunë", roman, SHK "Ymer Prizreni", Sharr, 2017

Që nga viti 1991 drejton dhe boton revistën për kulturë, art e shkencë "Sharri", në Sharr...

BEDRI TAHIRI



Prof. Bedri Tahiri u lind në Galicë të Drenicës më 1956. Mësimet e para i mori në vendlindje, ndërsa të mesmet në Gjimnazin e Skenderajt. Studimet i mbaroi në Universitetin e Prishtinës, dega Letërsi dhe Gjuhë Shqipe. Që nga janari i vitit 1980 ligjëron lëndën Gjuhë dhe Letërsi në Gjimnazin “Eqrem Çabej” të Vushtrrisë.

Krahas punës edukativo-arsimore dhe veprimtarive të tjera shoqërore, merret edhe me artin letrar. Me shkrime ka zënë të merret qysh herët. Shkrimet e tij letrare-historike-dokumentare-publicistike mund t'i gjesh nëpër faqet e revistave e të gazetave shqipe që dalin në Prishtinë, në Tiranë e në mërgatë.

Merr pjesë nëpër Simpoziume e Sesione shkencore me tema hulumtuese shkencore. Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, i Klubit të Shkrimtarëve dhe Artistëve të Durrësit, nënkryetar i Art Clubit “Rifat Kukaj”, i cili u themelua më 2014, bashkëthemelues i Klubit Letrar “Latif Berisha” në Vushtri etj.

Gjatë tërë kohës së luftës sonë çlirimtare qëndroi në shkrepat e Arbërisë së Vogël, përkrah luftëtarëve të lirisë, duke mbajtur shënime e ditar lufte dhe gëzon statusin e Veteranit të UÇK- së. Për suksese dhe të arritura në punën me nxënës, në krijimtari dhe në hulumtime shkencore, ka marrë shumë Dekorata, Mirënjohje, Falënderime e Plaketa.

Më 27 Nëntor 2007, Kompleksi Përkujtimor “Adem Jashari” i ka lëshuar një Falënderim për kontributin e dhënë, diku mbi 27. 000 euro, nga librat e shitur. Ndërkaq, më 26 gusht 2012, në Poetika mbarëkombëtare “Ndue Bytyçi 2012”, organizuar në Malin e Dajtit, gjegjësisht në Tiranë, u vlerësua me çmimin “Hasan Prishtina”.

Në Ditën e Çlirimit, më 17 qershor 2015, Komuna e Vushtrrisë e nderoi me çmimin “Pena e Artë”, ndërkaq, në vitin 2017, Klubi letrar “Latif Berisha” i Vushtrrisë e nderoi me Çmimin special “Pena e Fjalës”.

Në fundvitin 2017, Bashkimi i Shoqatave të Shkrimtarëve Shqiptarë, në Amfiteatrin e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, në Akademinë e Çmimeve Vjetore 2017, librin “Azem Bejtë Galica” (Botim i dytë i plotësuar) e vlerësoi: “Vepra më e mirë monografike”.

Në mars të vitit 2018 është pranuar anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe Arteve Shqiptaro-Amerikane në New York.

Veprat:


“Azem Bejtë Galica”, 1995, “Përmendorja që mungon”, 1997,
“Hys Popova - një yll në Yllësinë shqiptare”, 1998,
“Adem Jashari - legjendë e legjendave”, 1999, “Përjetësia”, 2000,
“Agu i lirisë” (e botuar dhe ribotuar dy herë), 2001,
“Drenica - një shekull trimërie” (e ribotuar tri herë), 2002,
“Përtëritja”, 2002, “Flakadanët e lirisë”, 2004,
“Drejtësia në sprovë” 2005,
“Azem Bejtë Galica (botimi i dytë i plotësuar), 2005,
“Flakadanët e lirisë 2”, 2006, “Nga Shqipëria në Shqipëri”, 2007,
“Flakadanët e lirisë 3”, 2007,
“Adem Jashari- legjendë e legjendave (botim i nëntë), 2008,
“Hasan Prishtina - Truri i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare”, 2008,
“Abdyl Krasniqi - frymëzës brezash”, 2009,
“Diferencimi “(Tregime), 2010, “Për Flamurin kuqezi”, 2010,
“Vesel Galica atdhetar dhe mentar i shquar”, 2010,
“Në Grykë të Valbonës”, 2011, “Flakadanët e lirisë 4”, 2012,
“Ramadan Bajraktari...” 2012, “Përsiatje recensionale”, 2013,
“Gur i diellit shenjtor”, 2013, “Atdhetarizmi jeton në përjetësi”, 2013,
“Përmendorja që mungon”, 2014,
“Toponimia e Galicës”, 2014,
“Jashar Jashari - Komandant Duraku, 2015,
“Ligjërime e përimtime”, 2015, “Lufta e Drenicës...”, 2015,
“Drenica- Djepi i trimërisë”, 2015,
“Përshtypje nga Franca”, 2016,
“Dimensione letrare”, 2017, “Metamorfoza”, 2017,
“Adem Jashari” - legjendë e legjendave, botimi i 10-të, 2018,
“Agimi i lirisë”, Prishtinë, 2018, “Flakadanët e lirisë 5”, 2018,
“Kamer e Murat Loshi në histori e në traditën gojore”, 2019,
“Poetika e të rrëfyerit”, 2019.

Të gatshme për botim:

- “Fehmi e Xhevë Lladrovci - të pandarë edhe në përjetësi”,
- “Xhemë Tërnafeçi - Sugari i Çetës”,
- “Çaste shpirti” (poezi),
- ”Rrëfime në veten e parë”, etj.

Gjeografia e veprave të krijuesit Bedri Tahirit është e plotë, ajo përfshin gjithë Trojet Etnike Shqiptare...

BEDRI ZAHITI (1950-2018)



Dr. Bedri Zahiti u lind më 10.07.1950 në Kçiq të Madh të Mitrovicës. Shkollën fillore e kreu në Skenderaj, të mesmen - gjimnazin e shkencave matematikore në Mitrovicë në vitin 1969.

Në vitin 1974 e kreu Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Specializimin e Mjekësisë Interne e kreu në vitin 1982 në Fakultetin të Mjekësisë në Universitetin e Beogradit. Subspecializimin nga Kardiologjia e kreu në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Beogradit.

Temën e Magjistraturës e përfundoi në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës, si dhe në vitin 2003 mbronë Gradën Doktor të Shkencave të Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës.

Gjatë studimeve në Fakultetin e Mjekësisë për 3 vite rresht ushtroi studentet e gjeneratave të më vonshme si “demonstrator” nga lënda e mikrobiologjisë të prof. dr. Osman Imami. Pas mbarimit të Fakultetit zgjidhet asistent pranë Instituteve dhe Katedrave në Fakultetin e Mjekësisë.

Ka ligjëruar lëndën e Mjekësisë Interne në shkollën e mesme të Mjekësisë në Mitrovicë. Pas luftës ka kaluar në Klinikën Interne në Shërbimin Kardiologjik në Departamentin e kardiologjisë të Klinikës Interne të QKUK-së në Prishtinë, dhe gjatë kësaj kohe ka mbajtur ligjërata, kumtesa shkencore, referime, si dhe shkruan për revistën, “Medicus”. Në kongresin e fundit të kardiologëve të Europës në Stockholm i është ndarë diploma “Fellow of the European Society of Cardiology (FESC)”. Me datën 29 qershor të vitit 2018, vdiq dhe u varros në fshatin Begaj.

Punime shkencore:

-G. Dragusha, A. Fusha, R. Manaj, B. Zahiti, “Ndikimi medikamentoz në zgjatjen e systoles elektrike te ethet reumatike”, (Banja e Klllokotit,1986)

-Bedri F Zahiti, “Fenomeni i Agut të mëngjesit tek dy të sëmurë në Shtëpinë e Shëndetit në Vushtri”. 1988,

-Bedri F Zahiti, Xh. Shkodra, S. Zahiti, “Sëmundja lumbo ishialgjike si shkaktar i apsentizmit tek punëtorët e komunës së Vushtrrisë”, 1988,

-B. Zahiti, S. Zahiti, “Vështrimi i gjendjes së tuberkulozit në komunën e Vushtrrisë”, 1988,

-B.Zahiti, S.Hyseni, S.Zahiti, XH.Shkodra, “Rëndësia dhe organizimi i Shërbimit të patronazhesh polivalente në Sh.Sh. në Vushtri, në zbulimin e sëmundjeve masovike kronike”. 1988, Brezovicë), dhe punime tjera.

BEDRI ZYBERAJ



Prof. Bedri Zyberaj u lind më 6.05.1963 në Drenoc të Rahovecit. Shkollimin fillor e ka kryer në vendlindje ndërsa atë të mesëm në Rahovec.

Studimet për Letërsi dhe Gjuhë Shqipe në Universitetin e Prishtinës, i ka mbaruar më 1988.

Tri vjet ka qenë bursist i Universitetit dhe në vitin e fundit të studimeve është shpërblyer me Mirënjohjen “Student i dalluar”.

Për shkak të diferencimit të atëhershëm ideopolitik, deri më 1993 ka qenë i papunë. Vetëm në vitin 1993 ka filluar të punoi në fshatin e tij të lindjes, ku ka qenë arsimtari i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, punë të cilën e ka vazhduar deri në vitin 1998.

Gjatë viteve 1998/1999 ka qenë pjesëtar i UÇK-së dhe epror i saj, ndërsa pas përfundimit të luftës, ka qenë i sistemuar në Akademinë e Mbrojtjes të TMK-së “Hamëz Jashari” në Prishtinë, me detyrën e pedagogut të lëndës Formim atdhetar, si dhe Komandant i shkollës ushtarake për oficerë të lartë.

Në vitin 2003, në Universitetin e Prishtinës, e ka mbrojtur temën e magjistraturës me titull “Fenomeni i luftës” në romanet “Për kë bie kambana” të Ernest Heminguejt dhe “Hasta la vista” të Petro Markos, dhe ka marrë gradën shkencore Magjistër i shkencave filologjike.

Prof. Bedri Zyberaj vazhdimisht ka treguar interesim për letërsinë, gjuhën dhe kulturën shqiptare.

Me krijimtari letrare merret nga vitet e hershme të rinisë dhe në vitin 1998, Shtëpia Botuese „Rilindja” në Prishtinë, ia ka botuar librin e tij të parë me poezi “Dromca vitesh”.

Nga viti 1990 e këtej ka botuar një mori shkrimesh (kritike dhe recensione) brenda dhe jashtë Kosovës, si dhe ka marrë pjesë me kumtesa e referate në tryeza e simpoziume dhe konferenca të ndryshme shkencore brenda dhe jashtë shtetit të Kosovës (Shqipëri, Poloni), ku është paraqitur me një kulturë dhe nivel të lartë shkencor.

Është anëtarë i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës që nga viti 2000. Në maj të vitit 2013 ka botuar librin me kritika dhe studime “Në gjurmë të arketipave”, botim i Institutit Albanologjik të Prishtinës.

Për një kohë ka qenë drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”. Aktualisht është ligjerues në Kolegjin AAB...

BEGZAD BALIU



Prof. Dr. Begzad Baliu, u lind në vitin 1966 në fshatin Makresh i Poshtëm Gjilan, ku mbaroi shkollën fillore dhe të mesme. Më 1992 mbaroi studimet në Universitetin e Prishtinës - Fakultetin e Filologjisë, Degën e Gjuhës dhe të letërsisë shqipe, ku mbaroi edhe studimet e magistraturës.

Në vitin 2000 magjistroi, ndërsa në vitin 2004 mbrojti disertacionin e doktoratës në Institutin Albanologjik të Prishtinës, institucion në të cilin punoi nëntë vite.

Në vitin 2005 filloi punën në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin e Edukimit, ku mori të gjitha thirrjet universitare, dhe u propozua anëtar në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Në këtë institucion ishte kryeredaktor i revistës shkencore “Educologia” dhe ligjëron në studimet themelore dhe master.

Në vitin 2008 Qendra e Studimeve Albanologjike e nominoi për çmimin vjetor, për veprën ”Gjendja e toponimisë shqiptare në Ballkan”, ndërsa në vitin 2009 bashkë me kolegë të Universitetit të Korçës dhe të Universitetit të Evropës Juglindore, organizojnë Konferencën e parë dhe themelojnë kolonën e botimeve universitare “Sociolinguistika shqiptare” (Korçë-Tetovë-Prishtinë).

Në vitin 2011 bashkëmentoron projektin e gjashtë studentëve polakë të masterit nga Universiteti i Varshavës, me titull: “Kosova e pavarur në sytë e të rinjve të saj (shoqëria - kultura - politika)”, ndërsa në vitin 2013, drejton ekipin e studentëve si anëtar i projektit “Eposi në pesë shtete të Ballkanit” dhe bartës i nënprojektit të tij “Eposi në ndërrijen kombëtare”, me të cilin Projekt mori çmimin special “EuropaNostra”, nga KE.

Ishte ligjërues dhe kumtues në disa universitete, konferenca shkencore kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, si në Universitetin e Turunit “Nikolla Koperniku”, Universitetin shtetror të Shkupit, Universitetin e Varshavës, Universitetin e Evropës Juglindore në Budapest, etj.

Tri dekadat e fundit i është besuar përgatitja e veprave studimore të Eqrem Çabejt, Jup Kastratit, Shefki Sejdiut, Zenun Gjocajt, Nuhi Veselajt.

Vepra të botuara në fushë të albanologjisë:

- “Gustav Majer dhe albanologjia”, Prishtinë, 2000; Tiranë, 2001;
- ”Vepra bibliografike e profesor Jup Kastratit”, Prishtinë, 2005;
- ”Semantika e fjalësit” (Vepra albanologjike e Zenun Gjocajt), 2009;

- "Kërkime albanologjike," Prishtinë, 2010;
- "Referenca albanologjike", Prishtinë, 2010;
- "Hulumtime albanologjike, Prishtinë, 2015;
- "Testamenti shkencor i Profesor Jup Kastratit", Prishtinë, 2016;
- "Rrapi shekullor - Akademik Idriz Ajeti", Prishtinë, 2016 (në shtyp);
- "Sprovë për një histori të albanologjisë", Prishtinë, 2016;
- "Studime për historinë e albanologjisë", Shkup, 2018;
- "Gjurmime albanologjike", Prishtinë, 2019.

Në fushë të onomastikës dhe të leksikografisë:

- Onomastika e Gallapit, (I), Prishtinë, 2016;
- Onomastika dhe dokumenti, Prishtinë, 2016;
- Gjendja e toponimisë shqiptare në Ballkan, Prishtinë, 2014;
- Onomastikë dhe identitet, Prishtinë, 2012;
- Onomastika e Kosovës - ndërmjet miteve dhe identiteteve, Pr, 2009;
- Regjistri i standardizuar i emërvendeve të Kosovës, Prishtinë, 2005;
- Demitizimi dhe standardizimi i onomastikës së Kosovës, Pr, 2006;
- Kontributi i Eqrem Çabejt në fushë të onomastikës, Prishtinë, 2000.

Në fushë të bibliografisë:

- Çabej 1, Prishtinë, 2006;
- Bibliografia përmbajtjesore e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën
- Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2008;
- Mbi autorësinë e veprës "Bibliografia e Skënderbeut", Prishtinë, 2005.
- Në fushë të studimit të letërsisë dhe të krijimtarisë letrare: Struktura e vlerave përfaqësuese, Prishtinë, 2014;
- Kujtesa letrare, Prishtinë, 2013;
- Peshë e komunikimit (bashk.), Prishtinë, 2010;
- Dhembje e bukur ,(bashk.), Prishtinë, 2012;
- Vareni kryengritësin e shenjtëruar, Prishtinë, 2010;
- Kafeneja ballkanike, Prishtinë, 1996 (e përkthyer edhe në kroatisht, italisht dhe në holandisht);
- Grua e dashuruar, Prishtinë, 1996;
- Mbileyimi i kujtesës historike, Prishtinë, 2019.

Vepra e tij është recensuar dhe vlerësuar nga studiues, si: Prof. Jup Kastrati, Prof. dr. David Luka, Akademik Gjovalin Shkurtaj, Prof. Shefki Sejdiu, Prof. dr. Petrit Kotorri, Prof. dr. Rami Memushaj, dr. Lubor Kralik, Prof. dr. Rexhep Doçi, Prof. dr. Shaban Sinani, Prof. dr. Zymer Neziri, Prof. dr. Tefë Topalli, Prof. dr. Zenun Gjocaj, etj.

BEHLUL BRESTOVCI



Prof. Dr. Behlul Brestovci, Ph.D, u lind më 10 mars 1941 në Gjilan. Shkollën fillore e kreu në vitin 1957 dhe gjimnazin në vitin 1961 në Gjilan. Studimet në Shkollën e Lartë për Pedagog Special në Beograd, më 28 qershor 1965, ndërsa në Zagreb i kreu studimet për defektologji më 6 janar të vitit 1968.

U magjistrua në Fakultetin e Kulturës Fizike në Universitetin e Zagrebit në "Shkencat kinezio-logjike" më 28 qershor 1975, me temën: "Analiza dalluese në dimensionet antropometrike dhe motorike ne mes personave qe belbëzojnë dhe atyre që nuk belbëzojnë", ndërsa disertacionin e doktoratës (PH.D) për defektologji e mbrojti në Fakultetin e Defektologjisë në Zagreb më 23 maj 1979, me temën "Disa raporte ndërmjet belbëzimit, motorikes dhe anksozitetit".

Ishte Kryeredaktor i revistës "Acta defectologica" (Zagreb, 1983-89). Punoi në Fakultetin e mjekësisë në Prishtinë, si dhe në Fakultetin e Kulturës Fizike në Prishtinë, docent nga 1982, profesor inordinar në Zagreb dhe në Prishtinë nga viti 1998. Ka mbajtur mësim për studimet pasuniversitare në Zagreb, Prishtinë, Lubjanë dhe Tuzëll. Kryesisht Prof. dr. Behlul Brestovci është marrë me diagnostifikimin e terapisë së të folurit dhe është njeri prej shkencëtarëve më të njohur në ish Jugosllavi, si dhe tash në Kroaci dhe në Republikën e Kosovës.

Librat shkencor:

- 1."Belbëzimi -të folurit, inteligjenca, antropometria, motorika, anksoziteti", (monografi shkencore) Zagreb - Rijeka, 1986
- 2."Belbëzimi -të folurit, inteligjenca, antropometria, motorika, anksoziteti", (monografi shkencore, Lidhja e Shoqatave të Defektologëve të Kosovës, Prishtinë, 1988
- 3."Diagnostikimi dhe rehabilitimi i belbëzimit" (monografi).

Projektet kërkimore - shkencore


- 1."Analiza dalluese te disa dimensioneve antropometrike e motorike të personat me pengesa somatpsikike dhe atyre pa pengesa", (1972-1973)
- 2."Hulumtim komparativ i aftësive psikolingusitike te fëmijët me pengesa somatopsikike artikulacije", (1976-1980)
- 3."Analiza e vokabularit dhe e gramatikës nga aspekti logopedik, si dhe përpilimi dhe evaluimi i instrumenteve matës për diagnostiken e të folurit,

- 4."Fëmijët dhe të rinjtë me pengesa në zhvillim në suaza të procesit të rregullt edukativo-arsimor", (1980-1981)
- 5."Karateristikat e rritjes dhe zhvillimit të dimensioneve antropometrike dhe motorike të fëmijëve të moshës 7 deri 14 vjet në Kosovë dhe mundësitë e përsheptimit të zhvillimit të tyre", (1988-1989)
- 6."Plani gjeneral urbanistik i Prishtinës deri në vitin 2000", (1981-1982)
- 7."Aplikimi i teknikave kompjuterike në mënjanimin e sjelljeve të padëshirueshme në aktivitete me persona të retarduar mentalisht", (1990-1991)
- 8."Çrregullimet e komunikimit foljor të fëmijët e shkollës fillore", (1995)
- 9."Diagnostifikimi i afazioneve", (1997)
- 10."Fëmijët e kategorizuar me të meta në zhvillim, analiza dhe realizimi i rekomandimeve të komisionit për kategorizim, si dhe mundësia për përpërimin e kësaj veprimtarie në Kosovë", (1989).

Punime shkencore:

1. Definicioni i belbëzimit, Defektologija.
2. Belbëzimi dhe dëgjimi i të folurit vetanak, Defektologija, 1972.
3. Te folurit e fëmijëve në shkollën fillore, Defektologija, 1972
4. Parashikimi i intensitetit të belbëzimit I, Defektologija, 1975
5. Parashikimi i intensitetit të belbëzimit II, Specijalna škola, 1976
6. Aspektet bashkëkohore në rehabilitimin e pengesave në të folur. Përmbledhje punimesh nga Ditët e para defektologjike të Kosovës, Brezovicë, (19-20. 1976)
7. Belbëzimi dhe ndërprerjet në procesin e të folurit, Defektologija, 1976
8. Klasifikimi i gabimeve në të folur të personat që belbëzojnë, Defektologija, 1977
9. Aplikimi i algoritmit të modifikuar të Johnsonit për grupimin hierarkik të tingujve të folur, Beograd, 1977
10. Disa karakteristika të Testit të Myklebustit për hulumtimin e të shprehurit verbal me shkrim, Zagreb, 1978
11. Disa raporte ndërmjet variablave kognitive dhe variablave të belbëzimit, Zagreb, 1978
12. Analiza dalluese në dimensionet antropometrike dhe motorike në mes personave që belbëzojnë dhe atyre që nuk belbëzojnë, Zagreb, 1975
13. Ndërlidhjet në mes belbëzimit dhe statusit intelektual, më koautorë: M. Ljubešić, Defektologija, 1979.
14. Diagnostikimi i belbëzimit, Symposia otorynolaringologica, si dhe 65 punime tjera shkencore...

BEHRAM HOTI



Prof. Behram Hoti, është i lindur në Likoc të Drenicës, komuna e Skënderajt, më 1 janar 1945. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, normalen në Prishtinë dhe Mitrovicë, studimet, Dega Gjuhë dhe Letërsi Shqiptare në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, ku edhe kreu studimet pasuniversitare.

Prof. Behram Hoti një jetë të tërë ia kushtoi çështjes kombëtare. Ishte dhe mbeti aktivisti më i përkushtuar i Lëvizjes për pajtimin e gjaqeve, si dhe i shumë Lëvizjeve dhe Organizatave që kanë në plan-programin e tyre ribashkimin e të gjitha trojeve shqiptare. Behram Hoti ishte pjesëtar i tri Luftërave Çlirimtare që u zhvilluan për çlirimin e popullit shqiptarë nga pushtuesi serb (1997-2001).

Veprat letrare:

- "Ligjërimet e mia", poezi, "Rilindja", Prishtinë, 1965
- "Pantomimë", tregime, "Rilindja", Prishtinë, 1983
- "Te kulla e Hajdinit", prozë, "Rilindja", Prishtinë, 1986
- "A është e premte", poezi, "Rilindja", Prishtinë, 1988
- "Mos ma mbyll derën", poezi, "Rilindja", Prishtinë, 1992
- "Lam Breznica", roman, Prishtinë, 1994
- "Lahuta e shqipeve", poezi, Prishtinë, 1994
- "Doktori i Anamalësisë", roman, Prishtinë, 1995
- "Anton Çetta, orakull i pajtimit", Prishtinë, 1996
- "Sinan Sali Qirezi", roman, Prishtinë, 1997
- "Me shqiptarët mërgimtarë në Slloveni", Prishtinë, 1998
- "Kuvendi i Bubavecit", kronikë, Prishtinë, 2000

Është autor edhe i këtyre librave:

- "Kosovë, ty të falëm gjaqe"; 12 poema për Kosovën;
- "Tridhjetë elegji për Ardian (Behram) Hotin"...
- "Moti i Madh i Kosovës", kronikë, Faik Konica, Prishtinë, 2012

Dorëshkrimet:

"Drenica e gjakut" roman, Prishtinë, 1998 dhe "Azem Bejtë Galica" roman, Prishtinë, 1998, u dogjën në shtypshkronjë (në shtëpinë e Ahmet Kelmendit).

Për krijimtarinë letrare të këtij autori vështrime, recensione, mbresa dhe kritikë letrare kanë shkruar disa personalitete të njohura letrare.

Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës...

BEJTULLAH DESTANI



Bejtullah Destani është i lindur më 13 gusht 1960, në Blaç të Opojës. Destani është studiues shqiptaro-britanik. Shkollën fillore dhe të mesme e kreu në vendlindje. Më 1980 ka filluar studimet në shkencat politike në Beograd. Më 1986 ka publikuar në Beograd, librin e tij të parë, “Bibloigrafi e Zgjedhur e Librave mbi Shqipërinë 1850-1984”. Ai në vitin 1991 emigroi në Londër, ku jeton dhe sot. Në vitin 2008 u emërua Sekretar i Parë i Ambasadës së Republikës së Kosovës, të sapa hapur në Londër, kurse në nëntor të vitit 2009 emërohet Ministër Këshilltar. Bejtullah Destani është njëri ndër studiuesit dhe hulumtuesit e historisë shqiptare në arkivat e Britanisë së Madhe, të Vatikanit, të Italisë, Turqisë, etj. Ka publikuar ose ka qenë bashkautor i disa librave të botuara jashtë Kosovës, në Britani të Madhe. Në vitin 1997, Bejtullah Destani themelon Qendrën bamirëse “Qendra për Studime Shqiptare”, në Londër dhe ka arritur të publikojë apo ri publikojë një numër të konsiderueshëm të veprave më të rëndësishme për studimet shqiptare.

Dy libra me vlera për historinë e vendit: “Letra shqiptare” nga Arthur Evans dhe “Kosova - një Histori përmes Dokumentave”, që u përgatit nga Robert Elsie dhe Bejtullah Destani. Librat përmbajnë prova dhe fakte të sakta, dokumenta origjinalë për disa nga ngjarjet më të rëndësishme të Ballkanit, Shqipërisë dhe Kosovës, material që forcon dhe ndihmon në seriozitetin e historiografisë shqiptare.

Veprat:

- “Shqipëria dhe Kosova, Kufijtë Politikë dhe Etnikë, 1867-1946”,
- Dokumente dhe Harta, Slough (sot Cambridge Archive Edition-Cambridge University Press) 1999
- “E Vërteta mbi Shqipërinë dhe Shqiptarët, Çështje Historike dhe Kritike”, nga Vaso Pasha, Londër 1999
- Harry Hodgkinson: “Skënderbeu”, Londër 1999
- “Korrespondencë e zgjedhur 1896-1942”, Londër 2000
- Wadham Peacock: “Shqipëria e Egër”, Londër 2000
- “Shqipëria dhe Shqiptarët, Artikuj dhe Letra të zgjedhura 1903-1944”, nga Edit Durham, Londër 2001
- Bejtullah Destani (editor): “Mali i Zi-Kufijtë Etnikë dhe Politikë 1840-1920” (2 vëllime), Londër 2001

- Dayrell R. Okley-Hill: “Një anglez në Shqipëri, Kujtimet e një Oficeri Britanik, 1929-1955”, Londër 2002
- Bejtullah Destani (editor): “Minoritetet Etnike në Ballkan, 1860-1971”, (6 vëllime), Slough 2004
- Duncan Heaton-Armstrong: “6 Muaj Mbretëri-Shqipëria 1914”, Londër 2004
- Bejtullah D. Destani (editor): “Minoritetet në Lindjen e Mesme, Minoriteti izraelit në Vendet Arabe, 1841-1974”, (3870 faqe të përmbledhura në 6 vëllime), Slough 2005
- Bejtullah Destani (editor): “Komunitetet Fetare në Jerusalem dhe Minoritetet në Izrael, 1843-1974”, (2900 faqe të përmbledhura në 4 vëllime), Slough 2005
- Gjergj Fishta (përkthyer nga R.Elsie): "Lahuta e Malësisë", Londër 2005
- Robert Elsie: "Historia e Letërsisë Shqipe", Londër 2005
- Bejtullah Destani (editor): “Komuniteti Kurd, 1918-1974”, (4 vëllime) Slough 2006
- Bejtullah Destani (editor): “Komuniteti Druzh, 1840-1974”, (4 vëllime), Slough 2006
- Owen Pearson: “Shqipëria në Shekullin e Njëzetë: Një Histori”, (3 vëllime), Londër 2006
- Bejtullah Destani (editor): “Minoritetet Myslimane në Vendet Arabe”, (4 vëllime), Slough 2006
- Clarisa de Waal: “Shqipëria sot”, Londër 2007; Bejtullah Destani (editor): “Minoritetet kristiane në Lindjen e Mesme”, (10 vëllime), Slough 2007
- Arthur Evans: "Iliria e Lashtë", Londër 2007
- Bejtullah Destani dhe Robert Elsie (editor): "Eduard Liri në Shqipëri", Londër 2008
- Fatos Lubonja: “Ridënimi”, Londër 2009
- Anna Di Lelio: "Beteja e Kosovës", Londër 2009;
- Bejtullah Destani dhe Jason Tomes (editor): "Miku më i Madh i Shqiptarëve-Aubrey Herbert dhe Krijimi i Shqipërisë Moderne", me parathënie të Noel Malcolm, Londër 2011
- Sir Arthur Evans: “Letra Shqiptare: Nacionalizmi, Pavarësia dhe Lidhja Shqiptare”, Londër 2011
- Komiteti Qendror Shqiptar i Korfuzit- dokumente historike 1883 - 1885»
- ”Shqipëria në prag të Konferencës së Paqes” - dokumente historike nga Departamenti i Inteligjencës Politike Britanike; etj.

BEKIM BERISHA (1966-1998)



Bekim Berisha i njohur me nofkën e luftës “Abe-ja”, u lind më 15 qershor 1966 në fshatin Graboc të Pejës. Rrjedh nga një familje bujare dhe liridashëse. Ishte njëri ndër luftëtarët më të dashur jo vetëm në Rrafshin e Dukagjinit, por në mbarë opinionin liridashës të Kosovës. Shkollën fillore e kreu në Gorazhdevc të Pejës, ndërsa shkollën e mesme të Artit, në Pejë. Në pamundësi që të vazhdojë studimet, u detyrua ta braktisë Kosovën. Stacioni i parë për mërgimtarin e ri nga Graboci i Pejës ishte Kroacia. Në fillim punoi si punëtor krahu. U mor me punë të rënda fizike, në mënyrë që të sigurojë ekzistencën, vetëm e vetëm që ta ndihmojë familjen dhe të regjistrohet në Fakultetin e Hotelierisë në Opati dhe atë të Veterinarisë në Zagreb. Të dy këto Fakultete i përfundoi me sukses. Sa qëndroi në Kroaci, Bekim Berisha mësoi gjashtë gjuhë të huaja, kështu që arriti të lexojë edhe literaturë të ndryshme, ekonomike, turistike e deri te ajo ushtarake.

Pas shpërthimit të luftës në Kroaci dhe në Bosnjë, Bekimi Berisha pa hezituar iu përgjigj ftesës vullnetarisht për luftë kundër këtij regjimi. Në këtë kohë Bekim Berisha jetonte në Holandë, por ai e la jetën perëndimore dhe u radhit përkrah luftëtarëve kroatë, përkatësisht njësiteve elite kroate.

Si luftëtar dhe strateg në luftën kundër serbëve në Kroaci, Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë kroate e dekoroi Bekim Berishën me gradën e Gjeneralit. Nga lufta e Kroacisë Bekim Berisha kalon në luftën e Bosnjës, përsëri kundër forcave serbe, duke marrë pjesë në shumë beteja të ashpra.

Situata pas luftës në Slloveni, Kroaci dhe Bosnjë tregonte qartë se nuk ishte e largët dita kur edhe në Kosovë do të fillonte lufta. Andaj Bekim Berisha në fillim të marsit të vitit 1998 me një grup shokësh mërgimtarë hyn në mënyrë ilegale në Kosovë, duke u sistemuar në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Zonën Operative të Drenicës.

Në fillim u sistemua në AçaREVË të Drenicës. Këtu filloi organizimin dhe përgatitjet e para me ushtarët e rinj për mësimin e artit ushtarak. Më 22 prill 1998 në AçaREVË Bekim Berisha me luftëtarë të tjerë të UÇK-së ngriti flamurin shqiptar dhe hapi Akademinë e parë Ushtarake. Mirëpo në këtë kohë luftimet në mes të forcave serbe dhe atyre të UÇK-së u ashpërsuan shumë në Zonën Operative të Dukagjinit. Bekim Berisha së bashku me dëshmorin Bedri Shala shkuan në Gillogjan të Deçanit, duke u bërë kështu

krah i fortë i komandes dhe luftëtarëve të Zonës Operative të Dukagjinit.

Këtu Bekim Berisha tregoi shkathtësi në përgatitjen ushtarake të ushtarëve të rinj, e sidomos edhe në bartjen, sigurimin dhe grumbullimin e armatimit. Luftëtari i UÇK-së Bekim Berisha, në Betejën e Junikut, më 29 maj 1998, u angazhua në mbrojtje të zonës së Dukagjinit.

Ai dha kontribut maksimal në mbrojtjen e këtij fshati, që të mos bie në duar të forcave serbe, të cilat e kishin rrethuar me një arsenal të madh ushtarak e njerëzor. Dhe, pikërisht rënia e Bekim Berishës në fushë të nderit, bashkë me luftëtarët trima Bedri Shalën, Elton Zherkën, Përmet Vulën, Bashkim Lekun etj. bëri që Juniku të bie në duar të forcave serbe.

Ishte kjo dita e 10 gushtit 1998 kur nga një predhë topi bie Bekim Berisha, duke hyrë në përjetësinë e luftës për çlirim të Kosovës nga forcat ushtarake e policore pushtuese serbe.

Për meritat dhe heroizmin e Bekim Berishës në luftë kundër regjimit të egër serb, që sundoi gati një shekull në Kosovë, Shtabi i Përgjithshëm i TMK-së, pas përfundimit të luftës, e gradoi me gradën Gjeneralmajor.

Bekim Berisha në fillim u varros në Junik. Më vonë u bë rivarrimi në vendlindje dhe aty iu ngrit lapidari që shndrit nure dhe është udhërrëfim për brezat e ardhshëm.

Ai është gjithashtu i vetmi person, i cili është dekoruar nga tre presidentë, nga ai i Shqipërisë, Kroacisë dhe i Kosovës.


Bekim Berishës në Kosovë iu janë ngritë 8 përmendore, Akademia Ushtarake e Kosovës e mban emrin e tij, një njësi ushtarake në Kosovë dhe një kazermë në Prishtinë.

Shkon në Kosovën e përfshirë nga lufta, dhe bëhet njëri prej komandantëve të parë të UÇK-së. Me kalimin e kohës arrin të bëhet Gjeneral i UÇK-së, dhe si i tillë jep jetën e vet në aksion heroik, kur u largua nga shokët e tij dhe krejt i vetëm nga një shtëpi rezistoi duke goditur tanket nga snajperi RPG. Të njëjtën ditë 10 gusht të vitit 1998 Bekim Berisha u vra në një shtëpi, të cilën tanket e shkatërruan plotësisht.

Patentat e Bekim Berishës:

- Mina antitank (të punuara në punëtorinë e UÇK-së në Ujmirë) 1998,
- Mina këmbësorike (punëdore nga e njëjta punëtori) 1998,
- Minahedhësi i kalibrit të veçantë (në punëtorinë e Rezallës së Re) 1998,
- Predha të minahedhësit (punëdore nga e njëjta punëtori) 1998,
- Tabelat e makinave për automjetet e UÇK-së, etj.

BEKIM FEHMIU (1936-2010)



Bekim Fehmiu ishte aktor teatri, televizioni dhe filmi jugosllav me origjinë shqiptare. Ai u lind më 1 qershor 1936 në Sarajevë dhe vdiq në 15 qershor 2010 në Beograd. Gjatë ditëve të shkollës së mesme ai luajti në Teatrin Rajonal në Prizren.

Ai u rrit në një familje patriarkale shumë-anëtarësh. Pas mbarimit të shkollës së mesme në Prishtinë, u regjistrua në Fakultetin e Shkencave Sociale në Beograd. Në vitin 1956 u regjistrua në Fakultetin e Arteve Dramatike në klasën e Profesor Mate Millosheviç. Ai u diplomua katër vjet më vonë dhe u bë aktori i parë i arsimuar, i përkatësisë etnike shqiptare në ish-Jugosllavi.

Përveç gjuhës shqipe Bekimi fliste dhe serbo-kroatishtisht, italisht, spanjisht, anglisht dhe frëngjisht.

Bekim Fehmiu u martua në tetor të vitit 1967, në Romë. Në korrik të vitit 1968, i lindi një djalë, Uliksi dhe më pas Hedoni.

Në fund të viteve 1980, në Beograd filloi një fushatë antishqiptare, kështu që ai vendosi të tërhiqej nga jeta publike. Ai e bëri shfaqjen e tij të fundit në vitin 1987.

Më 15 qershor të vitit 2010 Bekimi u gjend i vdekur në studion e tij, duke lënë një letër lamtumirëse familjes së tij, e cila shkruante: *"Unë iu dua aq shumë, por jeta nuk ka kuptim për mua më"*. Disa ditë më vonë, trupi i tij u dogj, dhe gruaja me djemtë e tij sollën pluhurin e trupit të tij, duke e hedhur në lumin Bistrica në Prizren, aty ku ai kaloi ditët e tij më të bukura të fëmijërisë dhe rinisë së hershme.

Ai e përshkroi jetën e tij në librin "Shkëlqim dhe frikë", të cilin e botoi në vitin 2001. Një tjetër vazhdim i autobiografisë së tij u botua nga familja e tij në vitin 2012.

Bekim Fehmiu u bë i famshëm me filmin "Mbledhësit e puplave", në vitin 1966. Deri në atë kohë, ai kishte studiuar dhe ishte bërë i njohur nga shumë shtëpi filmi nëpër botë. Ai është aktori i parë shqiptar i filmit dhe i teatrit, i cili ka luajtur me sukses në filmat dhe skenat e gjithë hapësirës së ish-Jugosllavisë.

Bekimi ka aktruar në 41 filma deri në vitin 1998. Ai ka pasur role në shqip, serbokroatisht, spanjisht, anglisht, në gjuhën frënge, në gjuhën italiane, maqedonisht e në gjuhë tjera.

Filmografia - Rolet:

- Dita e katërmbëdhjetë (Dan četrnaesti) 1960
- Portieri në dhomën e pritjes (Tu ne tueras point) 1961
- Sasha (Saša) 1962
- Nën të njëjtin qiell (Pod isto nebo) 1964
- Vajza (Devojka) 1965
- Klakson (1965)
- Armiku (Neprijatelj) 1965
- Kush qëllon do të hapet (Ko puca otvoriće mu se) 1965
- A Suitable Case for Treatment 1966
- Roj (Roj) 1966
- Vitet e nxehta (Tople godine) 1966
- Një kohë dashurie (Vreme ljubavi) 1966
- Vite të ngrohta (Tople godine) 1966
- Mbledhësi i puplave (Skupljači perja) 1967
- Shkaku i vdekjes të mos përmendet (Uzrok smrti ne pominjati)
- Odiseja (L'Odissea) 1968
- Aventurieri (The Adventurers) 1970
- Një kurth për Gjeneralin (Klopka za generala) 1971
- Dezertori (The Deserter) 1971
- Shpina e djallit (Đavolja kičma) 1971
- The Last Snows of Spring 1973
- Il testimone deve tacere 1974
- Permission to Kill 1975
- Black Sunday 1977
- Edukim special (Specijalno vaspitanje) 1977
- Dispоста a tutto 1977
- Eskadrionet e partizanëve (Partizanska eskadrila) 1979
- I vecchi e i giovani 1979
- Të kuq dhe të zinj (Crveni i crni) 1985
- Historia e fundit (Poslednja priča) 1987
- Un bambino di nome Gesù 1987
- Disperatamente Giulia 1989...etj

Ka interpretuar në shqip, serbisht, maqedonisht, turqisht, në gjuhën rome, në spanjisht, anglisht, frëngjisht dhe italisht. Bekim Fehmiu është një nga artistët më të mëdhenj shqiptarë, i cili ka lënë gjurmë në kinematografinë botërore...

BEQË CUFAJ



Beqë Cufaj u lind në Deçan më 3 dhjetor 1970. Shkollën fillore dhe atë të mesme i ka kryer në Deçan, kurse ka mbaruar studimet për Letërsi në Universitetin e Prishtinës. Më pas ai vazhdon të jetojë dhe punojë si shkrimtar e publicist në Gjermani. Është një nga autorët më të përkthyer dhe botuar në gjuhët e huaja. Esetë dhe tregimet e tij janë botuar në gjuhë të ndryshme dhe antologji evropiane, si: në gjermanisht, frëngjisht, anglisht, italisht, holandisht, kroatisht, serbisht, hungarisht etj. Shkruan kolumne të rregullta për gazetat: “Koha Ditore”, “Frankfurter Allgemeine Zeitung”, etj.

Botimet:

- "Balada Budallaqe", poezi, Shtëpia Botuese, Rilindja, 1994
- "205", tregime, Dukagjini, 1996
- "Kosova", ese dhe reportazhe nga Lufta e Kosovës, botuar në gjermanishte nga Zsolnay Verlag, Vjenë - Muni, 2000
- "Shkëlqimi i Huaj", Roman, Shtëpia Botuese, Dukagjini, 2003
- "Der Glanz der Fremde", Roman, botuar në gjermanisht nga Zsolnay Verlag, Vjenë Muni, 2005

Cufaj është ambasadori i tretë i Kosovës në Berlin, pas Vilson Mirditës dhe Skënder Xhakaliut. Është misioni më i madh diplomatik i Kosovës dhe krahas Gjermanisë mbulon edhe Danimarkën.

Por, që kultura do të zërë një vend të veçantë, kjo është diçka e vetëkuptueshme për shkrimtarin Cufaj: *"Ne jemi një komb i vogël që nganjëherë harron faktin që vetëm me kulturë mund të përfaqësohemi në këtë vend"*. Në zyrën e tij shih dy skulptura të vogla te këndi i pritjes. Ato quhen "Vertreibung" "Përndjekje" dhe "Versöhnung" (Pajtim), një dhuratë e skulptorit gjerman Armin Guthier (1931-2017) për Ambasadën e Kosovës. Për Cufajn simbol i një lidhjeje edhe më të veçantë mes dy vendeve që i bashkon përjetimi i luftës. Janë lidhje të veçanta mes Gjermanisë dhe Kosovës, duke pasur parasysh në radhë të parë 400 mijë qytetarët me prejardhje nga Kosova që jetojnë në Gjermani. Por, ka edhe shumë gjermanë që kanë qenë të angazhuar në Kosovë gjatë dy dekadave të fundit në kuadër të KFOR-it, EULEX-it, UNMIK-ut e të ngjashme. Ai do t'i sistemojë dhe t'i kanalizojë të gjitha këto lidhje në mënyrë që shtetasit e tij të zënë një vend sa më të rëndësishëm në këtë shtet të fuqishëm...

BEQIR KASTRATI (1911-1989)



Beqir Kastrioti u lind në vitin 1911, në Pejë, ku kreu edhe dy klasë të fillores në gjuhën shqipe.

Për shkaqe politike, bashkë me familjen ,emigroi në Shqipëri.

Vazhdoi gjimnazin në Shkodër, ndërsa diplomoi në degën e Normales.

Në vitin shkollor 1932-1933 emërohet mësues në shkollën fillore në Krumë të Hasit.

Deri në vitin 1941, në Krumë të Hasit do të jetë mësues, kryemësues, edukator, drejtor i shkollës dhe i konviktit “Kosova”.

Në pranverën e vitit 1941 ishte ndër mësuesit e parë të kualifikuar që erdhën në Kosovë për të hapur shkolla shqipe. Së pari ishte në Plavë, ku hapi kursin e shqipes, pastaj mësues dhe kryemësues në Deçan.

Më 1942 ishte drejtor i shkollës fillore ”Lidhja e Prizrenit” në Pejë, ndërsa më pas përgjegjës i arsimit, nënkryetar dhe kryetar i Këshillit Popullor të Pejës, instruktor i shkollave shqipe për Pejë. Gjakovë dhe Istog.

Më 1946 ishte drejtor i Shkollës Normale Shqipe në Gjakovë, si dhe mësime të ndryshme për lëndët historike, pedagogji, matematikë dhe muzikë. në po këtë shkollë.

Nga viti 1953, po në Gjakovë. ushtron detyra të ndryshme në arsim: drejtor i Gimnazit ”Hajdar Dushi”, themelues i Shkollës së Amvisnisë, mësime të ndryshme në Shkollën Ekonomike, drejtor i konvikteve për shkolla të mesme. Ishte themelues i Teatrit amator “Emin Duraku”, si dhe njëri ndër themeluesit e Universitetit të Punëtorëve në Gjakovë.


Nga viti 1958 është mësime të ndryshme në Normalën dhe Gjimnazin e Prishtinës, drejtor i konviktit të Normalës dhe këshilltar pedagogjik në Prishtinë. Ishte pjesëmarrës në Kongresin e Drejtëshkrimit më 1972 në Tiranë. Beqir Kastrioti, ishte kryetari i parë i Shoqatës së Veteranëve të Arsimit të Kosovës.

Është autor, bashkautor dhe përkthyes i disa teksteve shkollore, të matematikës, gjeometrisë, algjebërës, kimisë etj.

U mor edhe me poezi. Për punë të suksesshme pedagogjike mori shumë mirënjohje dhe dekorata të larta. Vdiq në Prishtinë më 1989.

Libër për pedagogun dhe veteranin e arsimit shqip në Kosovë kanë shkruar Ali Lllunji dhe Abdullah Vokri, me titull : ”Beqir Kastrioti- legjendë e arsimit kosovar“ (Botues “Libri shkollor”, Prishtinë , 2001)...

BEQIR MUSLIU (1945-1996)



Beqir Musliu u lind në Gjilan, Kosovë, në vitin 1945, vdiq në vitin 1996, në Prishtinë dhe u varros në Gjilan.

Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Gjilan, ndërsa fakultetin filozofik drejtimi i gjuhës dhe letërsisë shqipe në Prishtinë.

Gjenerata e Beqir Musliut në Gjilan patën për ideolog të shkrimeve dhe të jetës politike Rexhep Elmazin, andaj që në shkollë të mesme u mor në biseda informative dhe u burgos. Po në këtë kohë Beqir Musliu filloi të merret edhe me shkrime letrare. Në fillim me poezi e pastaj edhe me tregime, romane, drama e kritika letrare dhe dramaturgjike.

Mënyra e të shkruarit dhe metaforat e simbolet e përdorura në shkrimet e tij, atë menjëherë e renditën në rangun e shkrimtarëve me një perspektivë të theksuar.

Punimi i parë iu botua në revistën letrare “Jeta e Re”, të cilën e udhëhiqte Esat Mekuli. Po kjo revistë, tri vite më vonë, në vitin 1965, ia botoi edhe librin e parë.

Shkrimet e Beqir Musliut janë të një niveli të lartë dhe përdorin me mjeshtri të madhe metaforat dhe simbolet, andaj mund të quhet edhe shkrimtar i simboleve.

Puna e tij kryesisht ka të bëjë me gazetari, publicistikë dhe redaktim të revistave. Së pari punoi si gazetar e redaktor në revistën “Zëri i rinisë”, e pastaj edhe në “Fjala” të Prishtinës.

Së bashku me disa krijues të gjeneratës së vet, sa ishte student, nxori dhe redaktoi revistën letrare “Plejada”, e cila arriti të botohet vetëm deri në numrin 6, sepse pushteti i atëhershëm, duke parë ndikimin e krijimtarisë letrare në masën e gjerë, nuk e financoi dhe e shantazhoi për të mos u botuar.

Më vonë Beqir Musliu ishte anëtar i redaksisë, e një kohë edhe redaktor në revistën “Jeta e Re”.

Beqir Musliu është prezantuar thuaja në të gjitha antologjitë e poetëve dhe shkrimtarëve shqiptarë të kohës së tij e më vonë.

Punimet e tij janë përkthyer në gjuhën frënge, angleze, spanjolle, italiane, arabe, gjermane, hungareze, rumune, turke, sllovaqe, maqedonase, sllovene, serbe dhe kroate. Beqir Musliu ishte dhe mbeti shkrimtari më i dalluar i kohës së tij. Shkroi; poezi, prozë, dramë, ese etj.

Veprat - poezi:

- "Rima të shqetësuar" ("Jeta e re", Prishtinë, 1965),
- "Lulëkuqet e gjakut" ("Rilindja", Prishtinë, 1966).
- "Skënderbeu ose shqiponja e maleve" - kurorë sonetesh ("Jeta e re", Prishtinë, 1968),
- "Bukuria e zezë" ("Rilindja", Prishtinë, 1968)
- "Sezamet" ("Rilindja", Prishtinë, 1972)
- "Parabola" ("Rilindja", Prishtinë, 1976)
- "Darka e magjisë" ("Rilindja", Prishtinë, 1978)
- "Metafizika e Sfidimit",
- "Mandragora",
- "Klepsidra e Magjisë",
- "Martirium", "Magna Karta", "Ekzodus", "Kodeksi i Argasit".

Prozë:

- "Vegullia" - roman („Rilindja“, Prishtinë, 1979),
- "Mbledhësit e purpurit" - roman („Rilindja“, Prishtinë, 1982),
- "Kori i gjelave të vdekur" - tregime („Dukagjini“, Pejë, 2002),
- "Makthi" - roman („Faik Konica“, Prishtinë, 2004),
- "Amullia" - roman („Faik Konica“, Prishtinë, 2004),
- "Krupa" - roman („Faik Konica“, Prishtinë, 2004),
- "Skërluta" - roman („Faik Konica“, Prishtinë, 2004),
- "Ndeshrasha" - roman („Faik Konica“, Prishtinë, 2004),
- "Skënderbeu" - poemë („Faik Konica“, Prishtinë, 2004),
- "Orfeiana" - Shtatë Libra Anatema - („Faik Konica“, Prishtinë, 2004)

Dramë:

- "Shtirigani i Gjel-Hanit" - libër-teatër, tetralogji (Rilindja, Prishtinë, 1989),
- "Unë Halil Garria",
- "Faustiana",
- "Ora e Kukuvačkës",
- "Panairi i Gjilanit" (Dramë e Jahi Jahiut)
- "Rrakullima" -II- teatër-libër, tetrapтик (Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1990),
- "Murana",
- "Kori i Korbave",
- "Familja e Shenjtë", Teatri profesionist i Gjilanit, drama e Jahi Jahiut,
- "Antifona", etj.

BERAT LUZHA



Berat Luzha, është i lindur më 8 janar 1953, në Begracë të Kaçanikut. Shkollën fillore e kreu në vendlindje dhe në Kaçanik të Vjetër, gjimnazin në Kaçanik. Studioi për letërsi dhe gjuhë shqipe në Universitetin e Prishtinës.

Ka punuar në gazetën “Rilindja”, që nga viti 1976, si gazetar, redaktor dhe kryeredaktor.

Gjithashtu, ka qenë i angazhuar në gazetën ilegale “Liria” prej vitit 1980-1981, në gazetën “Bashkimi” në vitin 1991, si dhe në gazetën “Bashkimi sindikal” prej vitit 1997-1998.

Në vitet 1997-1998 kreu detyrën e zv/kryetarit të Kuvendit të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës.

Gjatë luftës udhëhoqi Drejtorinë për Informim Publik, në kuadër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ishte njëri nga themeluesit e medieve të luftës; agjencisë shtetërore informative “Kosovapress” dhe radios “Kosova e lirë”, si dhe drejtor i agjencisë së lajmeve “Kosovapress”.

Pas luftës, në korrik 1999, ka vazhduar punën si kryeredaktor i gazetës, dhe nga tetori i atij viti edhe i Radio-Rilindjes deri në dhjetor 2000.

Katër herë ishte i zgjedhur deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës: 1992, 2001, 2004 dhe 2007. Nga viti 2005 është anëtar i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës.

Në vitin 1996 themeloi Shoqatën e të Burgosurve Politikë të Kosovës, kryetar i të cilës ishte deri në vitin 2001.

Ishte zv/ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe anëtar i Këshillit Ekonomik - Social prej vitit 2012-2014 etj.

Ka qenë veprimtar ilegal prej viteve 1996-1981, pjesëmarrës i demonstratave të vitit 1981, i burgosur politik (i dënuar dy herë me gjithsej 22 vjet burg, i ka mbajtur nëntë).

Është pjesëmarrës i luftës çlirimtare të UÇK-së, nënshkrues i Deklaratës së Pavarësisë. Për kontribut të jashtëzakonshëm në luftë, Qeveria e Përkohshme e Kosovës i ka ndarë Urdhrin ”Adem Jashari”. Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës.

Botimet:

-“Këngë burgu - Këngë lirie”, poezi dhe

-“Një histori për Sylë Durmishin”, monografi.

BERIM RAMOSAJ



Prof. Dr. Berim Ramosaj, u lind më 4 qershor 1962, në Deçan. Studimet e larta i kreu në vitin 1983, në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Zagrebit. Pas studimeve kthehet në vendlindje dhe më 1984 filloi të punojë në Fakultetin Ekonomik në Prishtinë, fillimisht bashkëpunëtor e pastaj si ligjërues i lëndës së Menaxhmentit.

Magjistroi në Univeristetin e Zagrebit, në vitin 1985, kurse në vitin 1999 është zgjedhur Profesor Inordinar për lëndën e Menaxhmentit në Fakultetin Ekonomik të UP-së. Ligjëron edhe në studimet pasuniversitare në Fakultetin Teknik dhe Juridik të Universitetit të Prishtinës, si dhe në Universitetin e Europës Juglindore.

Në periudhën janari 2000 - shkurt 2003 ishte kryeshef i ekzekutivit (CEO) në Komunën e Prishtinës. Në vitin 2007 zgjidhet deputet i Kuvendit të Kosovës, ku ishte kryetar i Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e FSK-së. Në vitin 2009 është emëruar këshilltar i jashtëm i Presidentit. për ekonomi.

Ka publikuar 25 punime shkencore në revista shkencore me recension nga fusha e menaxhmentit.

Botimet:

- “Ndërmarrja dhe menaxhmenti ndërmarrës”, viti 1991,
- “Bazat e Menaxhmentit”, viti 1993, - (katër ribotime),
- “Udhëheqja dhe menaxhimi financiar i ndërmarrjes”, viti 1998 ,
- ”Menaxhimi financiar i ndërmarrjes ekonomike”, viti 2003 dhe
- ”Menaxhmenti kreativ&ldership”, viti 2006.

Është Profesor i rregullt në Universitetin e Prishtinës në Fakultetin Ekonomik, si dhe ligjëron në disa fakultete të tjera si; në Universitetin e Evropës Juglindore, Kolegjin “Iliria”, etj.

Berim Ramosaj deri më sot ka mbajtur disa pozita të profesorit në kolegjet dhe fakultetet tona private si: në Kolegjin “Iliria”, në Kolegjin “Dardania”, Fakultetin Ekonomik (2008-2011), në Universitetin Shtetëror të Tetovës, Fakultetin Ekonomik (1996-1999), Docent (Profesor Asistent) në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin Ekonomik (1995-2000), Asistent në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin Ekonomik (1984-1995).

Ramosaj doktoroi në Universitetin e Prishtinës në vitin 1994, ku mori titullin; “Doktor i Shkencave Ekonomike”...

BESIM BOKSHI (1930-2014)



Akademik Besim Bokshi, u lind në Gjakovë më 1930. Gjashtë klasë të mësimit fillor i kreu në Tiranë, dy të tjerat në Gjakovë. Pas gjimnazit në Prishtinë, ndoqi studimet në Katedrën e Albanologjisë në Beograd, ku vijoi studimet pasuniversitare në Drejtimin e gjuhësisë.

Tezën e doktoratës e mbrojti në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, në vitin 1977.

Ka ligjëruar gjuhë shqipe në Gjimnazin e Gjakovës, dhe në vitet 1961-1963 ka qenë drejtor i kësaj shkolle.

Ka qenë profesor në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Gjakovës dhe drejtor i saj. Ka punuar në Institutin Albanologjik të Prishtinës.

Nga viti 1974 është zgjedhur ligjërues në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës. Në vitet 1992-2001 ka ligjëruar lëndën *Hyrje në studimin krahasues të gjuhëve indoevropiane* në Shkallën e tretë të studimeve.

Ishte delegat në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe në Tiranë më 1973. Ka marrë pjesë në Kongresin e Studimeve të Evropës Juglindore në Ankara më 1978.

Në Universitetin e Jenës ka mbajtur ligjëratën për origjinën e mbaresave rasore të shqipes. Para ligjëruesve të Katedrës së Gjuhës e të Letërsisë Shqipe të Fakultetit Filologjik të Tiranës (1979).

Ishte anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Anëtar korrespondent, i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, u zgjodh në vitin 1991, ndërsa nga viti 1996 ishte anëtar i rregullt i kësaj akademie.

Më 2002 u zgjodh nënkryetar i Akademisë, ndërsa në vitet 2008-2011 ishte kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Vdiq në Gjakovë më 16 gusht 2014.

Librat e botuar:

“Në pritje”, (përmbledhje poezish), Jeta e re, Prishtinë, 1966

“Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes”, ASHAK, Prishtinë, 1980.

“Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike”, Rilindja, Prishtinë, 1984.

“Hije të këputura”, (Aforizma), Dukagjini, Pejë, 1996.

“Pjesorja e shqipes”, (Vështrim diakronik), ASHAK, 1998.

“Për vetorët e shqipes”, ASHAK, 2004.

“Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes”, ASHAK, 2010.
“Varia”, ASHAK, Prishtinë, 2014.

Studime dhe artikuj:

- Ndryshimi i strukturës së temave emërore të shqipes, Prishtinë.
- Postposition of Artikl in the Balkans Languages, Actes du Congrès
- International des Études Balkaniques et Sud-est Européennes, Ankara, mbajtur në vitin 1978 .
- Sur l'origine des pronoms possessifs en albanais, Recherches albanologiques, 3, 1984.
- Recostitution des différentes phases relatives à la postposition de l' article défini dans les langues balkaniques, Recherches albanologiques, 3, në vitin 1985.
- Politika gjuhësore në disa vise të Jugosllavisë, Gjuha shqipe 1, Prishtinë, 1987.
- Agense shqetësuese antivilizuese e makiaveliste, Rilindja, 16. VI, Prishtinë. 1990.
- Për format e diatezave, Studime, ASHAK, 4, 1997, Prishtinë, 1998.
- Në 80-vjetorin e lindjes së akademik Shaban Demirajt, Studime, ASHAK, 5,6,7, 2001.
- Për tri mbaresa vetore, Dardania sacra, 3, 2001, Prishtinë.
- Për trajtat e përemrave vektorë, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 19, 2002.
- Në 70-vjetorin e lindjes së Fehmi Aganit, Studime, ASHAK, 8-9, 2001-2002.
- Për format e vektorëve të vetës së parë e të dytë njëjës, kumtesë në
- Simpoziumin për nder të 95-vjetorit të lindjes së E. Çabejit - Gjirokastër, 2003, botuar në Eqrem Çabej dhe kultura shqiptare, Tiranë 2004.
- Për Waclaw Cimohowskin, me rastin e promovimit të veprës së tij
- “Për gjuhën shqipe”, 2004, botuar në Studime 11, ASHAK, 2005.
- Për Selman Rizën, me rastin e promovimit të katër vëllimeve të studimeve gjuhësore (Vepra I-IV) të Selman Rizës mbajtur në ASHAK, më 17. 06. 2005, botuar në Bota sot, 26.6.2005.

Akademik Besim Bokshi, gjatë gjithë karrierës së tij, bëri studime në fushë e gjuhësisë, duke qenë edhe kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës organizoi shumë Simpoziume për shënimin e datave dhe përvjetorëve të figurave të njohura letrare e historike...

BETIM MUÇO (1947-2015)



Prof. Dr. Betim Muço, u lind në Tiranë në vitin 1947. Studioi për fizikë në Universitetin e Tiranës. Punoi fillimisht si mësues në Krujë. Nga viti 1974 deri në vitin 2001 punoi si sizmolog në Institutin e Sizmologjisë të Akademisë së Shkencave në Tiranë, ku fitoi gradat Kandidat i Shkencave dhe Doktor i Shkencave, e më pas titullin Profesor doktor i sizmologjisë.

Në vitet 1990-1991 Betim Muço realizoi një program post-doktorurë, në Universitetin e Tokios, Japoni. Gjatë atyre viteve ai ka qenë edhe Konsull Nderi i Japonisë në Shqipëri.

Betimi Muço realizoi një sërë vizitash shkencore në universitete dhe institute prestigjioze evropiane. Në këto bashkëpunime dhe specializime ai i rrit vlerat e tij si shkencëtar, duke e ndjerë vetën të barabartë me shkencëtarët e tjerë. Në vitet 1993-1997, ai bëhet drejtor i Institutit të Sizmologjisë. Në këtë periudhë instituti i Sizmologjisë, në Shqipëri merr përmasa të reja, duke zgjeruar bashkëpunimin me institucionet më prestigjioze në botë. Mbas ndryshimeve politike, pas vitit 1997, Betimi hiqet nga drejtori dhe caktohet Përgjegjës i Rrjetit Sizmologjik, në Institutin e Sizmologjisë deri në vitin 2001. Ai ka qenë njohësi më i mirë i tërmeteve dhe i shkaqeve të tyre në Shqipëri dhe ka marrë pjesë në të gjitha studimet përkatëse, si: *“Sizmiciteti dhe Sizmotektonika e detit Adriatik”*; *“Studimi i Uljes së Tokës, lidhur me kushtet hidrologjike dhe gjeologo-inxhinierike, në rajonet e Sofies, Shkupit dhe Tiranës”*. Ishte koordinatori i projektit *“Vlerësimi i Potencialit sizmik për zonat e tërmeteve të mëdha të Evropës; “Sizmotektonika dhe Rreziku Sizmik i Shqipërisë”*.

Nga viti 2001 veprimtarinë e tij si shkencëtar i madhe e vazhdoi në SHBA. Ai punoi si konsulent i IRIS (Incorporated Research Institution for Seismology), që është Institucioni më i rëndësishëm i sizmologjisë në SHBA. Vlen të përmendim studimin e tij të fundit: *“Mundësia e një marrëdhënie shkakësore midis klimës dhe sizmicitetit ndërplakor, në rastin e zonës sizmike të Virginias”*, duke hapur një dritare të re edhe për studimet sizmologjike në Shqipëri. Pavarësisht punës intensive në SHBA, Betimi nuk e ka ndërprerë lidhjen me Shqipërinë. Ai ndërmori dy punime të rëndësishme si autor kryesor dhe koordinatori në *“Kuantifikimi i Tektonikës së sotme të Shqipërisë”*, si dhe koordinatori kryesor i projektit *“Harta dhe*

Vlerësimi i Gjeohazardeve (Rreziqeve Gjeologjike) të Ballkanit” shkalla 1:1.000.000. Një kontribut i madh i Prof. Dr. Betimi Muços është pajisja e rrjetit sizmologjik të Shqipërisë, me një rrjet modern satelitor të tipit VSAT (që e disponon edhe sot Departamenti i Sizmologjisë në Institutin e Gjeoshkencave -Tiranë).

Veprat shkencore:

- “Harta Neotektonike e Shqipërisë”, Shkalla 1:200.000, (1995)
- “Harta Sizmotektonike e Shqipërisë”, Shkalla 1:500.000, (2000)
- “Vlerësimi Probabilitar i Rrezikut Sizmik të Shqipërisë”,
Projekt i NATO-s, (2004)
- “Harta e Rreziqeve Gjeologjike të Shqipërisë”, Shkalla 1:200.000, (2005)
- “Harta dhe Vlerësimi i Gjeorreziqeve të disa vendeve të Ballkanit”,
Shkalla 1:1.000.000 (2008).
- “Sizmiciteti, Sizmotektonika dhe Vlerësimi i Rrezikut Sizmik të Shqipërisë”, (2010). Betim Muço ndërroi jetë më 15 janar 2015.

Krahas punimeve shkencore, Betimi nuk ka reshtur për 30 vjet së shkruari poezi, tregime, novela, ese dhe së fundi një roman.

Veprat:

- ”Rrugëve të atdheut” (1967)
- ”Etyde” (1972)
- ”Ekspres” (1975)
- ”Tregime” (1978)
- ”Kokrra gruri” (1978)
- ”Ditë që vështrojnë larg” (1982)
- ”Është se ç’na është” (1984)
- ”Ditëlindja e këngës” (1983)
- ”Plumbi i germave” (1986)
- ”Gjurma e vetëtimës” (1986)
- ”Bota në sytë e Dolës” (1986)
- ”Në udhën time” (1988)
- ”Hiroshima jashtë meje” (1995)
- ”Penda e pulëbardhës” (1996)
- ”Karusel” (1997)
- ”Sirtarët” (1999)
- ”Rrefenjat e Hamburgut” (2007)
- ”Bumerang” (2009)
- ”Mësimet e natës 101 përrallat e fëmijëve të mi” (2017), etj.

BILAL XHAFERRI (1935-1986)



Bilal Xhaferri është i lindur më 1935, në fshatin Ninat afër Konispolit, Babai i tij ishte pushkatuar si antikomunist më 1945. U rrit bashkë me të motrën në internim, ku aty edhe e kreu shkollë-min. Bëri një shkollë njëvjeçare si gjeometër. Më shkrime filloi të merrej që nga viti 1967. Xhaferri në veprën e tij nuk shfaqi kurrë mendime "dekadente" ose disidente. Më 1968, ai u shpreh në Lidhjen e Shkrimtarëve kundër romanit "Dasma" të Kadaresë, për këtë ai u qortua rëndë. Autoritetet komuniste nuk mund të lejonin që një person me "njolla në biografi", t'u shkaktonte turbullira, sado që mund të ishte komunist i zjarrtë. Iu hoq e drejta e botimit dhe u internua, Pas një mbledhjeje të Lidhjes së Shkrimtarëve, u kritikua bindshëm dhe u përjashtua.

Në vitet 1962-1963 botoi poezitë dhe tregimet e para në gazetën "Zëri i Rinisë", "Drita", në revistat "Nëntori", "Ylli", dhe më 1963 debutoi me romanin "Rrugë dhe fate". Më 1966 botoi poemën "Balada çame".

Më 30 gusht 1969, u arratis nga Shqipëria për në Greqi. Më 1970, shkoi në SHBA, ku deri më 1972 punoi në gazetën "Dielli". Më 1974 u vendos në Çikago, ku themeloi revistën "Krahu i shqiponjës", botim i Lidhjes Çame, të cilën e drejtoi, botoi dhe redaktoi për 39 numra në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Në të përkohshmen "Krahu i Shqiponjës", botoi shumë artikuj publicistikë, poezi, tregime, romane, skeçe, vizatime, karikatura, foto artistike, etj. Aty botoi fragmente të romanit "Trotuare të kundërta" dhe "Hëna e kantierëve". Në vitin 1986 vdes në Çikago.

Më 3 maj 1993 Presidenti i Republikës Sali Berisha e dekoroi me medaljen "Martir i demokracisë", gjithashtu edhe nga Presidenti Bamir Topi u dekorua me titullin e lartë "Nder i Kombit".

Botimet:

- "Njerëz të rinj, tokë e lashtë" (tregime, 1966)
- "Lirishta e kuqe" (poezi, 1967)
- "Dashuri e përgjakur" (1992)
- "Krastakraus" (roman, 1993)
- "Eja trishtim" (poezi, 1995)
- "Ra Berati" (1995)
- "Përtej largësive" (1996)...

BRANISLLAV SINADINOVSKI



Prof. Dr. Branislav Sinadinovski, është Akademik Profesor doktor i historisë shkrimtar, diplomat, nga Maqedonia e Veriut.

Është biri i Jakim Sinadinovskit, i cili gjatë kohës së LNÇ-së ka qenë i rreshtuar përkrah radhëve partizane në Shqipëri, me emrin Gjergj Pranga. Sinadinovski është shqiptar ortodoks dhe është me prejardhje nga Beliçica e Rekës së Epërme nga rajoni i Mavrovës në Maqedoni.

Ai është profesor universitar, i cili vite më parë u deklarua për prejardhjen e tij etnike dhe mbështetjes për krijimin e një Bashkësie Fetare të Shqiptarëve Ortodoksë në Maqedoni. Branko Sinadinovski është autor i më shumë se 40 librave.

Veprat:

1. "Palestinsko nacionalno pitanje i blisko istočna kriza"
2. "Jaser Arafat"
3. "Josif Bageri"
4. "Hasan Prishtina"
5. "Shqiptarët ortodoks në Republikën e Maqedonisë"
6. "Skënderbeu" etj.

Është anëtar i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Arteve në New York, Tiranë, Prishtinë dhe Shkup.

Prof. Dr. Branko Sinadinovski është themelues i "Bashkësisë fetare të shqiptarëve ortodoksë në Maqedoni".

Në librin e Branisllav Sinadinovskit për Skënderbeun, vëren diçka të veçantë nga librat e tjerë për këtë figurë të madhe kombëtare. Branisllavi e shkruan këtë libër me përkushtim të madh, dhe ai, siç duket nuk dëshiron të shkruajë për këtë vigan në mënyrë të mbyllur, në një rreth me të, por e nxjerr atë me rrënjë, që nga e kaluara e largët e tij, duke përshkruar të parët e tij në mënyrë gjithëpërfshirëse: si për genin, kulturën, gjuhën, zakonet, virtytet, duke e paraqitur shumë natyrshëm edhe trimëritë e të parëve të tij, gati të papërsëritshme në botë.

Duke folur për Gjergjin, Sinadinovski i përshkruan gjërat në hollësi rreth tij, Në mënyrë të thuktë, me plot fakte dhe argumente, Sinadinovski e paraqet komunikimin gjuhësor të kohës së Lekës së Madh dhe raportet mes popujve të këtyre hapësirave. Këto gjëra i paraqet me fakte të cituara, ashtu siç nuk i ka bërë asnjë shkrimtar apo studiues i këtij shekulli të fundit...

BUJAR DUGOLLI



Prof. Dr. Bujar Dugolli, u lind më 30 tetor 1969 në Nekoc, Komuna e Drenasit.

Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Glllogoc. Pas përfundimit të arsimit të mesëm, drejtimi elektroteknikë, u regjistrua në Universitetin e Prishtinës në Fakultetin e Elektroteknikës, në vitin akademik 1989/90, për të vazhduar në vitin akademik 1992/93, në Fakultetin Filozofik, Departamentin e Historisë, ku edhe diplomoi në vitin 1997.

Në të njëjtin fakultet përfundoi edhe studimet pasuniversitare, drejtimi Historia e Kohës së Re dhe mori titullin: Magjistër i shkencave të historisë më 29.03.2004. Disa vite me vonë, mori titullin "Doktor i shkencave të historisë", në Universitetin e Prishtinës.

Në vitin 1995 u zgjodh kryetar i Unionit të Pavarur të Studentëve të Fakultetit Filozofik, si dhe anëtar i Këshillit Shkencor - Mësimor. Më 4 shkurt 1997 u zgjodh kryetar i Unionit të Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës dhe në të njëjtën kohë edhe anëtar i Senatit të UP-së, deri në vitin 1999. Ka qenë anëtar i delegacionit negociator të Kosovës në procesin e Rambujesë - Parisit, 1999.

Nga korriku i vitit 2012 është zgjedhur dekan i Fakultetit Filozofik në Universitetin e Prishtinës. Bujar Dugolli, është profesor i rregullt në Universitetin e Prishtinës në Fakultetin Filozofik.

Botimet:

"Dokumente nga Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë".

" Disa të dhëna mbi fillimin dhe zhvillimin e kryengritjes së vitit 1910 në Kosovën veri-perëndimore".

"Roli i Isa Boletinit në Pengimin e hapjes së Konsullatës Ruse në Mitrovicë dhe vrasja e konsullit rus", 2015.

"Paraqitja e Luftës së Parë Botërore në tekstet e historisë në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni",

"Çështja shqiptare midis Perëndimit dhe Lindjes 1939- 1945 "

" Voskopoja qendër kulturore në Shqipërinë, e Ballkanin e shek. XVIII ",

" Kultura politike dhe Media ",

"Diskriminimi në Arsimin e lartë dhe rezistenca civile në Kosovë 1997-1998 ", si dhe punime tjera shkencore e historike.

BURBUQE BRUQI



Dr. Burbuqe Bruqi, është e lindur në Isniq të Deçanit më 23.12.1956. Shkollën fillore e kreu në vendlindje ndërsa gjimnazin në Deçan. Fakultetin e Mjekësisë e kreu në Prishtinë.

Specializimin nga anesteziologjia me reanimacion e fillon në vitin 1987 në QKUK, kurse në vitin 1991 përfundon specializimin në Qendrën Klinike Universitare në Zagreb. Prej vitit 1991 punoi në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Klinikën e Anesteziologjisë me mjekim intensiv. Tash është e punësuar në Spitalin Evropian orto-pedik në Prishtinë (Royal Medical Prishtinë) si anesteziologe me mjekim intensiv, që bën vlerësimin perioperativ të pacientëve, sipas rekomandi-meve dhe standardeve të ESA dhe ASA-së - administrim të anestezionit të përgjithshëm dhe regjional për operacione të planifikuara dhe urgjente; trajtimin e dhimbjes akute dhe kronike; trajtimin dhe kujdesin për të sëmurit kritik në njësitin e kujdesit intensiv. Ka të kryera shumë trajnime nga kjo lëmi në vende të ndryshme të Evropës. Ka të botuara një numër të madh abstraktesh shkencore të publikuara në kongrese, konferenca, seminare kombëtare dhe ndërkombëtare nga lëmia e anesteziologjisë dhe reanimimit. Dr Burbuqe Bruqi gjatë luftës ishte kryesorja në dhënien e ndihmës për të plagosurit. Ajo shërbeu në QKUK, ku shpëtoi dhe ndihmoi shumë luftëtarë të UÇK-së, si dhe ishte pjesëmarrëse në luftë me ekipet mjekësore në ZO të Drenicës dhe Llapit, gjatë vitit 1998-1999.

Punime të botuara:

1. Sh. Demaçi, S. Maliqi, F. Selimi, F. Çuperjani, A. Behluli, S. Bajrami, B. Bruqi, L. Vokri: "Gjakderdhja intrapleurale si indikator i ashpërsisë së traumës torakale ose korporale", Revistë Shkencore Ndërkombëtare e Shoqatës së Mjekëve Shqiptarë të Maqedonisë, 2011
2. First international conference for pain (ed by uems - eaccme, 2009)
3. Burbuqe Bruqi etj, Konferenca PHA-ASHP, 2009
4. A. Gecaj-Gashi, M. Hashimi, B. Bruqi, F. Sadal; Propofol vs isoflurane anesthesia-incidence of PONV in patients at maxillofacial surgery, 2010
5. A. Gecaj-Gashi, A. Hasani, B. Bruqi, Gj. Mulliqi-Osmani: "The Lancet Infectious Diseases", Balkan NDM-1: escape or transplant, August, 2011
6. A. Gecaj-Gashi, Z. Nikolova, B. Bruqi, A. Hasani; "Incidence of PONV-comparison between high flow and low flow anesthesia", Jun 2014.

ÇUN LAJÇI



Çun Lajçi u lindu më 18.12.1946 në Drelaj të Rugovës. Shkollën tetëvjeçare e kreu në Drelaj, Normalen në Prizren dhe shkollën e Lartë Pedagogjike - Dramën në Prishtinë.

Nga 1970 punoi si aktor i rregullt në Teatrin e Prishtinës. Çun Lajçi luajti mbi 200 role në Teatër, 30 role në filma artistik, si dhe dhjetëra role në seriale televizive. Dy herë u shpall aktori më i mirë në Takimet Teatrore “Joakim Vujiq”. Në Festivalin e teatrit “Prishtina Fest”, u shpall aktori më i mirë me shfaqjen “Hëna prej letre”, në regji të Fadil Hysës. Nga Ministria e Kulturës mori çmimin e karrierës. Gjithashtu nga Presidenca e Shqipërisë ka marrë çmimin “Naim Frashëri”.

Ai është një aktivist dhe lahutar i pasionuar, i cili ka shumë video dhe këngë, ku dramatizoi ngjarje të ndryshme politike dhe historike, për interesat tona kombëtare. Ai ka interpretuar shumë vargje nga “Lahuta e Malësisë”, si dhe dhjetëra monologje me tematika kombëtare e historike.

Çun Lajçi njihet për rolet e tij dhe profesionalizmin që e tregon gjithmonë, kur shfaqet përpara syrit të kamerës, teksa xhirohet.

Ai, vazhdon të jetë njëri ndër aktorët më të pëlqyer nga gjeneratat e ndryshme. Në familjen e tij, nuk është vetëm ai që ka shpirt artisti, është edhe bashkë-shortja e tij, e cila në filmin “Azem Galica” u nderua me rolin si nëna e Azem Galicës. Çun Lajçi, përveç aktrimit, është një këngëtar dhe shkrimtar i njohur. Me 43 vite karrierë mbi supe, Çun Lajçi, vazhdon ta ketë pjesë të jetës aktrimin. Së bashku me të tjerët, ai i përket brezit që shënuan teatrin, duke e bërë atë një art fisnik dhe me një mision të madh. Ai, gjithsesi, mbetet njëri nga aktoret më të gjithanshëm dhe më të adhuruar nga dashamirët e këtij arti suprem...

Veprat:

- “Zjarr i pashuar”
- “Fjalës nesër i bëhet vonë”
- “Kur fryjnë ernat”, roman
- “Përgjërim e fjalë”
- “Përfitim n'Andrra t'thyeme”, poezi
- “Ecje e plakun”
- “Bekimi i Plisit të Moisiut”
- “Bubulinë, ti letër e pashkrueme” etj.

DASHNIM HEBIBI



Dashnim Hebib, u lind më 12 qershor 1976, në fshatin Strezoc të Preshevës. Dashnim Hebib e mbaroi Fakultetin e Gazetarisë në Tiranë (1995-1999). Si student në Tiranë e ushtroi profesionin e gazetarisë në disa gazeta, që botoheshin në Shqipëri. Hebib ka kryer studimet pasdiplomike të Akademisë Diplomatike, si dhe Menaxhimin e Krizave në Tiranë. Ai në vitin 2011 mbaroi Magjistraturën në Diplomaci në UEJL-Tetovë. Dashnimi e kreu me sukses edhe Akademinë Ndërkombëtare të Kriminalistikës te i njohuri Avi Bleier, në Tel Aviv të Izraelit. Punoi disa vite redaktor në rubrikën 'diaspora' në të përditshmen “Bota Sot”, redaksia në Cyrih, punoi si korrespondent në Televizionin e Maqedonisë (TVM), drejtor i Albanian Media Center; redaktor i Agjencisë së Lajmeve "Kosova e Re", editor në gazetën "AMC Press", TV Diaspora-RTK, korrespondent i TVM (në gjuhën shqipe).

Nga viti 2013 e deri në fund të vitit 2015, ishte në projektin medial “Dialog Plus” me redaksi në Cyrih. Punoi edhe si zv. kryeredaktor në revistën mujore „Plisi“, që botohej në Zvicër. Shkrimet e Hebibit botohen nëpër shumë medime në atdhe e diasporë.

Aktualisht është Drejtor i Institutit Shkencor Helvetik të Evropës Juglindore me qendër në Zvicër dhe duke studiuar për doktoratë, cikli i tretë në Fakultetin e Shkencave Shoqërore Bashkëkohore, Programi studimor: Shkenca Politike në UEJL.

Veprat:

1. "Njëqind Orë Udhëtim", (përmbledhje poezish);
2. "Hënë e Fshehur", (poezi);
3. "Kohë me Shumë Vrima", (prozë);
4. "Lexim i Tokës", (poezi);
5. "Kosova, një Zjarr Amë", (poezi);
6. "Dialog me Gurin", (poezi, shqip-gjermanisht);
7. "Aristokracia e Shpirtit", (poezi, shqip-anglisht);
8. "16 Plumbat e Fjalës" (poezi);
9. "Intervista në Tranzicion I", (përmbledhje intervistash);
10. "Intervista në Tranzicion II", (përmbledhje intervistash);
11. "Intervista në Tranzicon III", (përmbledhje intervistash);
12. "Intervista në Tranzicion IV" (përmbledhje intervistash); etj.

DAUT DAUTI



Dauti Dauti u lind më 1960 në Kokaj të Gjilanit. Shkollën fillore e kreu në Prishtinë, kurse të mesmen, gjimnazin, në Gjilan. Ka kryer Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës, kurse studimet postdiplomike i kreu në Thames Valley University të Londrës, në degën e Unionit Evropian. Shkrimet e para i ka botuar në “Bota e Re”, pastaj ka vazhduar të shkruajë në revistën javore “Zëri”, për të cilën, nga viti 1994 e deri më 1999, ka qenë korrespondent nga Londra.

Gjatë vitit 1999-2001, ka punuar redaktor në IWPR (Institute for War and Peace Reporting) në Londër dhe ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 2000 deri në fillim të vitit 2002 ka shërbyer si Sekretar i Përgjithshëm i SHGK (Shoqata e Gazetarëve të Kosovës), organizatës së parë të pavarur të gazetarëve në Kosovë. Gjatë kësaj kohe (2000 – 2002) ka qenë edhe anëtarë i pavarur në KQZ (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve).

Gjatë vitit 2002 ka qëndruar në Dayton, në “Kettering Foundation”, ku ka bërë hulumtime shkencore në lidhje me median dhe demokracinë. Që nga ajo kohë, ka botuar një varg studimesh në fushën e gazetarisë, politikës dhe atë të shkencave juridike. Kohëve të fundit ka punuar në zyrën për informim të IOM (International Organisation for Migration) në Londër. Po ashtu, gjatë këtyre viteve, në Londër, me shkrime ka debatuar për çështjen e Kosovës në forum dhe media të ndryshme britanike dhe në media tjera botërore. Daut Dauti është i angazhuar në programin e hulumtimeve në University of Leeds në Britani të Madhe. Në Shkollën e Historisë të këtij universiteti, mbrojti disertacionin PhD me temën: “The British Foreign Policy and the Albanian Question 1876-1914” (Politika e jashtme britanike dhe çështja shqiptare 1876-1914).

Veprat:

”Reflektime Shqiptaro-Britanike”

”Lufta për Trepçën”

”Unioni Evropian - nga Ideja në Realitet”


”Building an Independent Media in Kosova”

“Asssemblies and Ancient Deliberation According to Code of L. Dukagjini”

“Çështja shqiptare në diplomacinë britanike, 1877-1880”, 2012, Shkup,

“Ngritja e mediave të pavarura në Kosovë”, etj

DAUT DEMAKU



Daut Demaku u lind më 13 tetor të vitit 1944 në Abri të Epërme të Drenicës.

Arsimin formal e ka përfunduar në Abri dhe në Likovc, të mesmin e të lartin në Prishtinë, kurse arsimin joformal, e ka përfunduar në Anwerpen të Belgjikës, në Qendrën Kulturore Hebreite, kurset kulturologjike “Për freskimin e dijes”.

Katër vite ishte kryeredaktor i gazetës së studentëve të Kosovës "Bota e Re", kurse një mandat kryetar i Lidhjes së Studentëve të Kosovës. Është shkrimtar i njohur shqiptar, i cili ligjëron i lëndën "Arti i mendimit pozitiv".

Një kohë të gjatë ishte redaktor në Redaksinë e Revistave të Rilindjes, redaktor i Kooperativës botuese të Librit Bujqësor në Prishtinë dhe së fundi edhe drejtor i Shtëpisë Botuese Rilindja.

I përkthyer në maqedonisht, serbisht, norvegjisht dhe anglisht.

Veprimtaria letrare:

“Brigjet e Thata” - 1967, “Plisat e Kuq” - 1969,
“Plisat e Kuq”, (ribotim në Tiranë) - 1971,
“Kapituj jete” - 1977, “Shi e Puh” - 1979,
“Buka” - 1981, “Bletaja” - 1976,
“Në mjaltishtë” - 1978, “Mote të thata” - 1983,
“Trëndafila pa gjëmba” - 1986, “Guralec në këpucë” - 1989,
“Tregime Shqiptare” - 1996, “Mendimi dhe Suksesi” - 1997,
“Magjia e Urtisë” - 2000, “Shenjat para kthesave” - 2002,
“Thuaji jetës mirë mëngjes” - 2003, “Rina dhe Gjyshi” - 2004,
“Aforizma” - 2005, “Tregime Shqiptare dhe Mendimi Pozitiv”.

Radiodrama:

“Trenat e mesnatës” - 1972,
“Selgjishtja është dëshmitare” - 1978,
“Ndryshoje vehten o njeri” - 2004.

Komedi:

“Servisi i shpirtit” - 1997, “Ulërima” - 2004.

Prozë:

“Tregime të sotme shqiptare” - 1968,
“Toka e përgjakur” - 1972, “Djepi i lashtë” - 1984,
“Lumturia” - 2016.

DEMIR RESHITI



Demir Reshiti, u lind më 24 qershor 1963, në fshatin Bresanë të komunës së Sharrit (Dragash, Kosovë). Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Sharr dhe Skenderaj, ndërsa Fakultetin Ekonomik, Fakultetin e Gazetarisë dhe studimet postdiplomike për gazetari në Universitetin e Prishtinës.

Shkruan kryesisht poezi, prozë dhe publicistikë. Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës.

Ka punuar si kryeredaktor, redaktor dhe gazetar në disa medime ("Rilindja", "Radio Kukësi", "Kosovapress", "Radio Sharr", "Zëri i Kosovës", "Epoka e Re", revista "Sharri", revista "Paqja", gazeta "Tribuna shqiptare", gazeta "Lajm"...)

Laureat i çmimeve të para për poezi për fëmijë në "Takimet e Gjeçovit" dhe në manifestimin tradicional "Ora e Tahir Deskut".

Në librin "Endje", janë përmbledhur studime të Reshilit, të botuara viteve të fundit, gjegjësisht përmbledhje poetike, vepra prozaike, monografi, publicistikë, ditarë, vepra të përkthyer, film e teatër.


Përmes këtij libri, ofrohen informacione të shkallës së lartë për veprat, për të cilat shkruan krijuesi Reshiti, duke i kushtuar rëndësi, gjuhës, nëpërmjet të cilës komunikon lirshëm me lexues të ndryshëm dhe arrin të thellohet në shtresat më të thella të veprave të cilave u qaset, duke na sjell vështrime mbi vepra të çmuara zhanresh të ndryshme.

Aktualisht, punon në Radio Kosovë.

Veprat:

- "Trung i ndarë", 1992
- "Ofshamë", 1995
- "Abetaka", 1995
- "Reshje nën Pikëllimë", koautor, 1996
- "Ngutëm ta kapërcej kohën", 2000
- "Libri i Mrekullive", 2001
- "Libri i Gjeneratës", monografi, 2009
- "Mik me Diellin", 2012
- "Luleborë Sharri, monografi - koautor", 2016
- "Libri i Mrekullive", vjersha të zgjedhura për fëmijë, 2017
- "Endje", kritikë letrare, 2019.

DERVISH ROZHAJA (1934-1996)



Dervish Rozhaja, u lind në Pejë, më 1934. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen më 1949 në Gjakovë, kurse Fakultetin e biologjisë e kreu në Beograd (1954). Gjatë vitit shkollor 1954/55 shërbeu si profesor i biologjisë në Shkollën Normale të Prishtinës. Në vitet 1955-1959 punoi si doktorant në Entin Fiziologjik të Fakultetit të Shkencave Natyrore në Beograd. U doktorua me temën “Aspekti bioenergjetik i adaptimit termik të anurave”.

Nga viti 1960 ligjëroi “Fiziologjinë krahasuese” në Katedrën e Biologjisë të Fakultetit të Shkencave Natyrore të Prishtinës, si docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar.

Ka qenë në specializime në Institutin Fiziologjik të Akademisë së Shkencave të BRSS në Leningrad (1962/63), si dhe në Institutin Neurologjik të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Kalifornisë në Los Anxhelos, në vitet 1973/1974.

Ka botuar në revistat shkencore të vendit dhe të jashtme 15 punime shkencore, nga fusha e adaptimit termik të shtazëve poikiloterme dhe termoregulacionit dhe hipotermisë së shtazëve homeoterme dhe heteroterme. Ka ushtruar funksionin e prodekanit (1960/62 dhe 1967/68), të dekanit të Fakultetit Filozofik (1968/69). Ka qenë rektor i Universitetit të Prishtinës (1970/1973) dhe kryetar i Bashkësisë së Universiteteve të Jugosllavisë.

Ishte delegat në Dhomën e Kombeve të Kuvendit të RSFJ-së dhe anëtar i redaksive të revistave “Dialektika” dhe “Acta physiologica Yugoslavica”. Akademik Prof. Dr. Dervish Rozhaja ishte nënkryetar dhe kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK).

Vdiq në moshën 62 vjeçare në Prishtinë (1996).

Punimet profesionale-shkencore:

1. “Temperatura dhe jeta”, Prishtinë, 1960.
2. “Adaptimi termik i qenieve të gjalla”, Prishtinë, 1962.
3. “The physiological meaning of thermal adaptation phenomena”, 1963.
3. “Prilog izucavanju termogeneze kornjaca u odnosu na termicku sredinu prilagodjavanja”, Prishtinë, 1964.
4. “Zakon, površine u termogenezi organizama”, Prishtinë, 1967.
5. Rozhaja, D. dhe Rizvanolli, Sh. “Dinamika normalizacii i hemicheskoj termoregulyacii depilirovanyh krysh, In: III. Vsesojuznaya konferenciya

ekologicheskoy fiziologiji (razdel obschie voprosy adaptacii), Novosibirsk, 1967.

6. Rozhaja, D.A. dhe Maslennikova, L.S.: "O voznikonovenii himicheskoy termoregulyacii u zolotistyn homyakov v ontogeneze in: Sravnitel'naya i vozrastnaya fiziologiya", Nauka, Leningrad, 1968.

7. Rozhaja, D.A., Rizvanolli, Sh. dhe Berisha, A. : "Gaseous exchange in turtles *Emys orbicularis* L. and *Testudo hermanni* Gmel in Hypoxia and Hypercapnia under confinement conditions", *Acta Biol. Med. Exper.*, 1976.

8. Rozhaja, D.A., Rizvanolli, Sh. dhe Berisha, A. : "Nitrogen gaexchange in turtles in hypoxia and hypercapnia under cofinement conditions", *Acta Biol. Med. Exper.* 1977.

9. Rozhaja, D.A., Rizvanolli, Sh. dhe Berisha, A. "Posthypoxyhypercapnic gas exchanges in turtles species. *E. orbicularis* L. and *T. hermani* Gmel.", *Acta Biol. Med. Exper.*, , 1977.

10. Rozhaja, D., A., Halili, F., Dërmaku, S., Berisha, A. dhe Rizvanolli, Sh.: "Blood catalase activity, in rats exposed to industrial air pollution", *Acta Biol. Med. Exp.* , 1978.

11. Rozhaja, D. , A., Dërmaku, S., Berisha, A., Rizvanolli, Sh. dhe Halili, F.,: "Blood reticulocytes and serum transaminias activitetes in rats exposed to industrial air pollution", *Acta Biol. Med. Exp.* 1978.

12. Rozhaja, A.D., Halili, F., Dërmaku, S. dhe Berisha, A. (1979):" Total lipids and chcolesterol in serum of rast expased to industrial lead contaminated conditions", *Acta Biol. Et Med. Exper.* , 1979.

13. Papovic, R. dhe Rozhaja, D.: "Effect of industrial pollutants on intestinal protist parasitic frog (*R. ridibunda*) fauna in the region of Kosovska Mitrovica town", *Acta Biol. Et Med. Exper.* , 1979.


14. Rozhaja, D.A., Dërmaku, S., Halili, F. dhe Berisha, A.: "Some biochemical characteristics of the blood sera of the turtle *Testudo hermanni*, Gmel. from the immediate surrounding of lead and zinc foundry in Zvecan", *Acta Biol. Et Med. Exper.* 1980.

15. Rozhaja, D. : "Covek i biosfera - covek u biosferi", 1980.

16. Rozhaja, D. dhe Halili, F. : "Histopathological changes of the testes of the laboratory rats exposed to air pollutants from lead metallurgy", *Acta Biol. et Med. Exper.* , 1981.

17. Rozhaja, D., Jablanovic, M. : "Zagadjivanje i zaštita životne sredine" (Tekst universitar), Enti për Botimin e Teksteve, Prishtinë, 1982, si dhe punimin e fundit të 18-in profesional shkencor...

DERVISH SHAQA (1912-1985)



Dervish Shaqa, u lind në Llukë të Epërme të Deçanit më 1912, vdiq më 11 prill 1985. Rapsod i shquar popullor dhe i njohur në të gjitha trevat shqiptare.

Dervish Shaqa deri në vitin 1956 jetoi në Kosovë, mirëpo në këtë vit iu desh të lëshonte Kosovën për shkak të përndjekjes nga aksioni i njohur "mbledhja e armëve", që ndërmerre në atë kohë Sigurimi i Punëve të Brendshme i UDB-së kundër shqiptarëve. Ai së bashku me kolegun e tij të këngës Demush Neziri, u vendosën në Rashbull afër Durrësit. Aty e vazhdoi shprehjen e ndjenjave nëpërmjet këngës, që për të ishte e vetmja mënyrë e shprehjes së dhimbjes që kishte për familjen dhe vendlindjen, që për të ishin të ndaluara. Këtë e shpreh në këngën "Kur ta ktheva Kosove shpinën, e lamë borë e gjetëm dimën".

Dervish Shaqa në Shqipëri e vazhdoi traditën e këndimit të historisë së vendlindjes së tij. Në Rashbull, arrin të themelojë e të udhëheqë grupin rapsodik. Po me këtë grup, në vitin 1968 prezantohet për herë të parë në Festivalin e Folklorit Kombëtar në Gjirokastrë. Këngët e tij, në atë kohë konsideroheshin si një thirrje për çlirim dhe kushtrim të popullit shqiptar kundër shtetit jugosllav. Pjesa më e madhe e regjistrimeve muzikore të bëra nga Dervish Shaqa dhe kolegu i tij gjenden në arkivin e Radio Tiranës.

Përpos këngëve popullore dhe të përpunuara nga ai vetë, për këngëtarin Dervish Shaqën ka kompozuar edhe kompozitori Tish Daija si këngën "Festë të madhe ka sot Shqipëria".

Diskografia:

"Ç`janë këto gjamë që i bjen era", "Prej Prokuplje deri n`Nish",
"Moj e mira porsi bora", Këngët për Azem dhe Shote Galicën,
"Kur ta ktheva Kosove shpinën", "Nak Berisha"
"Oj Kosovë, mos thuaj marova", "Të shtatë krajlat e rrehin teli"
"Kërsiti pushka, ushtoi mali", "Kur ta kthjem Kosovë shpinën"
"Kamer Loshi", "Kurrë Kosovë s'tu da gazepi"
"Isa beg po t'hrret nona", "Nak Berisha", "E kam pas një çiteli"
"N'verra t'Lukës, e n'qafë t'Morinës", "Haxhë Mustafa"
"Prej Podrimës po vjen haberi", "Pyet Kosova për një çikë"
"Kënga e Rexhës", "Haj medet për Lug t`Baranit"
"N'drrasë të vekut kush po kanë", "Moj e mira n`derë të stanit". etj.

DESTAN BAJRAKTARI (1928-2005)



Destan Bajraktari, u lind në Therandë, më 17. prill 1928. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, Progjimnazin e Ulët në Prizren, kurse Shkollën Normale në Gjakovë dhe Fakultetin Filologjik-Dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe në Prishtinë.

Destan Bajraktari, pas kryerjes së Shkollës Normale në Gjakovë, në vitin 1949-1950, kthehet në vendlindje, në Therandë, me ëndrrën e hershme që të bëhej mësues. Përkundër kësaj kishte pasur probleme të shumta që të punësohej, por pas shumë mundimesh, emërohet mësues në Gjimnazin e Ulët të Therandës, -Shkolla Tetëvjeçare “Vllaznim Bashkim”, tani “7 Marsi”, deri në vitin 1959. Në atë kohë ishte mësuesi i parë me diplomë në komunë të Therandës.

Regjimi totalitar serb në Kosovë e shpall person të rrezikshëm dhe pas shumë përgjimesh sekrete edhe e burgosin më 1959, duke e dënuar me 5 vjet e gjashtë muaj burg.

Pas lirimimit nga burgu atë nuk e pranojnë më në punë, në vendlindje, por as kurrkund tjetër në Kosovë. Që të mos dorëzohej para vështirësive të shkaktuara, por edhe për shkak të kushteve ekonomike, detyrohet që të kërkojë punë në Maqedoni. Atje shkon ilegalisht në gusht të vitit 1963, pas tërmetit të madh në Maqedoni, ku do të punojë për pesë vjet si mësues në fshatin Krushopek të rrethit të Shkupit.

Pas rënies së Rankoviqit Destani kthehet sërish në vendlindje dhe mezi që e pranojnë në punë në vitin 1967, si arsimtar i gjuhës shqipe në Duhël të Therandës.

Në vitin 1969, pas shumë peripeçive, punësohet në Shkollën Fillore. “Emin Duraku” në Prishtinë, ku edhe ishte vendosur me familje.

Më 1973, me Letrën e Byros Ekzekutive, atë e largojnë nga puna si të papërshtatshëm, që të punojë në arsim. Ai punësohet në bibliotekën e shkollës deri në vitin 1991, ku edhe pensionohet.

Ishte anëtar i rregullt i Shoqatës së Folkloristëve të Kosovës, që nga viti 1983-1984.

- Anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës.

- Anëtar i Shoqatës Mbarëkombëtare të Shkrimtarëve për fëmijë, në Tiranë.

- Bashkëpunëtor i jashtëm i Institutit Albanologjik, që nga viti 1953.

Destan Bajraktari vdiq më 2005, në Prishtinë, në moshën 77 vjeçare.

Vepra folklorike:

1. “Fjalë të urta dhe thënie popullore”, shënuar në Podrime, (10.905 njësi), 1974
2. “Fjalë të urta dhe thënie popullore shqipe”, më 1994, (42.525 njësi).
3. “Këngë popullore vajzash”, shënuara në Karshijak të Maqedonisë, botuar më 2001,

Destan Bajraktari ka në dorëshkrim anekdota, fabula, tregime dhe fjalorë fjalësh të rralla, që presin dorën e mbarshtrimit dhe të botimit. Destan Bajraktari ka shkruar edhe tekste shkollore, si “*Fletorja ime e punës*” për kl. e IV, 1972.

Veprat për të rritur:

- “Përmendore të së kaluarës”, 1994, “Lule e gjemba“, 1994,
- “Përpjekjet tona“, 1995, “Ndodhi në stuhi”, 1995,
- “Vilmë e qëndrime”, 1995, “Bregat e jetës”, 1996“,
- “Koha e bënë të vetën“ 1997, “Ngjarje të paharruara“, 1997,
- “Qëndresa”, 1998, “Gardhina”, 1996, “Trimat i nxjerrë koha e vet“, 1998
- “Drita ka nisur të dale”, 1999, “Shqiponjat hapën krahët”, 1999
- “Të përzënë”, 2000, “Trojet e rrënuara”, 2000,
- “Qieall pa diell”, 2000, “Trysni e paparë mbi kombin shqiptar“, 2002,
- “Ardhacakët e ikur“, 2003.

Veprat për fëmijë:

- “Kur piqen qershitë“ 1997, “Ecje dhe ngecje nëpër shtigje”, 1999,
- “Zemrat e shqetësuar“, 2000,
- “Lazdrimet fëmijërore“, 2000, “Shfaqja e madhe në pyje e livadhe“, 2000,
- “Zërat e këndshëm“, 2001, “Lulet e kopshtit tim” 2003,
- “Sythat e çelur”, 2003, “Lulet e njoma”, 2004,
- “Mali nga i cili rrjedh uji në dy dete”, 2004,
- “Gjëra të ngjara dhe të pangjara“, 2004, “Këndon bilbili,“ 2004.

Mirënjohje:

1. Mirënjohje për kontributin e dhënë në arsim. SHF. “Emin Duraku” Prishtinë-2004,
 2. Mirënjohje për kontributin e dhënë në folklor, 2006
 3. Mirënjohje: Emblema e artë për vepër jetësore, 2010.
- Që nga viti 2010 SHFMU në Therandë mban emrin e Destan Bajraktarit.

Presidentja e Republikës së Kosovës, Znj. Atifete Jahjaga, më 17 shkurt 2014 e dekoroi atdhetarin, profesorin, folkloristin dhe poetin Destan S. Bajraktarin me “Medalje Presidenciale e meritave”.

DIBRAN FYLLI



Dibran Fylli është i lindur më 29.09.1956, në AçaREVË të Skënderajt. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Mitrovicë, më pas regjistrohet në Shkollën e lartë, por për shkak të rrethanave të njohura të asaj kohe, detyrohet të ikë nga Kosova dhe vendoset në qytetin universitar të Sllovenisë, në Lubjanë, aty, ku edhe ndoqi studimet në Akademinë për Teatër, Radio, Film dhe Televizion (AGRFT), drejtimi regji e filmit dhe televizionit.

Gjatë qëndrimit të tij në Lubjanë, si student, ishte anëtar i Shoqatës shqiptare “Migjeni” dhe revistës “Alternativa”.

Në vitin 1993 kthehet në Kosovë për t’i vazhduar aktivitetet e tij artistike e atdhetare në shërbim të kombit e të atdheut.

Dibran Fylli iu bashkua radhëve të para të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke qenë udhëheqës i Njësitit të parë “Shkoza 2” në AçaREVË të Drenicës. Ishte pjesëmarrës në shumë beteja anë e kënd Kosovës, si dhe i plagosur në betejën e Llapushnikut, më 8 maj 1998.

Është themelues i Trupës Artistike Ushtarake “Hamëz Jashari” të UÇK-së dhe ideator, skenarist e organizator i Manifestimit Përkujtimor “Ai është i gjallë”-“Ditët e Përndritjës” tash “Epopeja e UÇK-së” (5, 6 dhe 7 mars - e njohur si Nata e Zjarreve).

Gjatë shërbimit të tij në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës ishte themelues dhe shef i Trupës Artistike Ushtarake “Hamëz Jashari” të UÇK-së dhe më pas edhe të TMK-së (1998-2002).

Dibran Fylli ishte ideator, skenarist e regjisor i Festivalit Folklorik „I këndojmë lirisë“, kushtuar komandant Mujë Krasniçit-Kapuçi, në Klinë, 6, 7 dhe 8 Qershor.

Është autor dhe skenarist i programit artistik “Ai është i gjallë” pjesa -I- dhe -II-. Dibran Fylli është poashtu autor i shumë skenarëve dhe organizator i dhjetëra Akademive Përkujtimore për Dëshmorët e kombit.

Është anëtar i kryesisë të Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, si dhe anëtar i Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencave dhe Arteve në New York, Prishtinë, Tiranë e Shkup.

Ishte i arrestuar nga gjykata e UNMIK-ut dhe i privuar nga liria për 4 vjet-1365 ditë, (i liruar i pafajshëm).

Vepra letrare:

1. “Të fala nga Stambolli”, përmbledhje poezish, Tiranë, 1998
2. “Drenica dikur dhe sot”-Argumente, Tiranë, 1998
3. “Ai është i gjallë”, Përmbledhje poezish, “Rilindja”, Prishtinë, 2000
4. “edhe kjo është pjesë e jetës” roman, Prishtinë, 2006
5. “Ditari i Tafruk Tafrukuci të Tafrukajve” komedi-humor, 2006
6. “Sharkia e Drenicës” këngë për Dëshmorët e UÇK-së, 2007
7. “1365 ditët e jolirisë”, Përmbledhje poezish - LSHK, Prishtinë, 2012
8. “Prekazi brezni trimash” kronologji në 7 gjuhë, Prishtinë, 2013
9. “edhe kjo është pjesë e jetës”, roman - ribotim, LSHK, Prishtinë, 2013
10. “Hasan Prishtina, stërnip i Avdullah Veliqit”, Prishtinë, 2013
11. “Sharkia e Drenicës” - ribotim LSHK, Prishtinë, 2014
12. “Tahir Meha-5 breza pushkë lirie”, kronologji, Prishtinë, 2014
13. “Hasan Prishtina, stërnip i Avdullah Veliqit”, ribotimi i dytë 2014
14. “Fryma e Lirisë”, përmbledhje poezish, Prishtinë, 2016
15. “Lulëkuqet e lirisë”, Antologji poetike, Prishtinë, 2015
16. “Penë e pushkë”, ditar i pashkruar, poezi, Prishtinë, 2018
17. “Tokë e mbjellë me varre”- Krimet serbe në Kosovë 1998/1999, publicistikë historike, “ProkultPress”, Prishtinë, 2019.

Publikime historike

1. “Hasan Prishtina dhe shkolla e parë shqipe në Kosovë”, monografi, (botimi i parë/236 faqe, Prishtinë, 2012)
2. “Prekazi brezni trimash -Ai është i gjallë”, kronologji, (botimi i parë/36 faqe, Prishtinë-Prekaz, 2012)
3. “Hasan Prishtina dhe shkolla e parë shqipe në Kosovë”, monografi, (botimi i dytë/245 faqe, Prishtinë, 2012)
4. “Prekazi brezni trimash -Ai është i gjallë”, kronologji, (botimi i dytë/36 faqe, Prishtinë-Prekaz, 2012)
5. “Tokë e mbjellë me varre - Krimet serbe në Kosovë 1998/1999”, Publicistikë historike, (botimi i parë/220 faqe, Prishtinë, 2019)
6. “Hasan Prishtina, stërnip i Avdullah Veliqit”, monografi, (botimi i tretë me plotësime/270 faqe, Prishtinë, 2019).

Çmime letrare

Çmimi “Metafora 1”, poezia e lauruar, Festivali ndërkombëtar “Drini poetik” 2012. Çmimi “Shën Jeronimi Ilir”, Vendi i parë, Takimet e “Dom Mikelit 2012”, Stubëll, 2012. Çmimi i Diasporës, Vendi i parë, Festivali Ndërkombëtar i letërsisë, Besianë, 2013. Vendi i parë Krijimtari letrare, për Ditën e Dëshmorëve, Malishevë, 2014.

Vendi i dytë - Manifestimi letrar “Malli poetik i Kosovës” 2014. Vendi i dytë - Krijimtari letrare, për Ditën e Dëshmorëve, Malishevë, 2015. Vendi i parë - Krijimtari letrare prozë, “Malli poetik i Kosovës”, Fushë-Kosovë, 2016.

Çmimi i parë (për tekst kënge), Konkursi poetik për Dëshmorin e kombit Bylbyl Breçani, Tiranë, 2019.

Fotografi dhe xhirime ekskluzive gjatë viteve 1997/1999:

-Mbi 200 fotografi dhe

-Mbi 400 minuta xhirime filmike nga terreni.

Filmografia:

-film artistik “Rrënjët”, (i realizuar në vitin 1995)

-film artistik në dy pjesë “Deri kur...?”, (i realizuar në vitin 1996)

-komedi “Kalanica e Kadiut”, (e realizuar në vitin 1996)

-film i shkurtër “Qyteti i zi”, (i realizuar në vitin 2014)

Rolet:

-Hazir Dema, filmi “Rrënjët”, Demë Sinani, filmi “Deri kur?”

-Tafrruku, komedia “Kalanica e Kadiut”,

-Babai, filmi “Vdekja në sy të motrës”,

-Bejtë Galica, filmi artistik i metrazhit të gjatë “Azem Galica”,

-Polic i serb, filmi artistik i metrazhit të gjatë “Azemi”

-Polic i serb, filmi i shkurtër “Qyteti i zi”, (pjesëmarrës në tri Festivale)

-I burgosuri, filmi artistik “Balkan Scam”

-Babai, filmi artistik “Koha e hakmarrjes”,

-Leka, serial televiziv “Vendlindja ime”

Filma dokumentar dhe monologje:


1. “Gjaku i Kosovës“, dokumentar për luftën e UÇK-së dhe shërimin e të plagosurve, (filmi është punuar gjatë luftës në TV Klan dhe është edituar ne TVSH e shumë televizione tjera më 1998)
2. “Organizimi i shëndetësisë gjatë luftës“, dokumentar i promovuar ne Simpoziumin Ndërkombëtar, (Prishtinë, 29.09.1999)
3. film dokumentar kushtuar jetës dhe veprës heroike të Dëshmorit të kombit Skënder Çeku, (Prishtinë, 2000)
4. film dokumentar kushtuar heronjve të kombit Nebih dhe Tahir Meha, kooproduksion me RTK, Prishtinë, 2001
5. dokumentar “Lindja dhe rrita e Bataljonit 40 të shëndetësisë të TMK-së“, (Prishtinë, 2001)
6. dokumentar “Thyerja e kufirit, ideal i bashkimit kombëtar“, kushtuar Betejës se Koshares (Prishtinë, 2001)

7. film dokumentar, "Akademia e Mbrojtjes Tempull i dijës ushtarake", (Prishtinë, 22 prill 2002)
8. film dokumentar, "Vepër, jo fjalë", (Klinë, 2008)
9. film dokumentar, kushtuar Dëshmorit Muhedin Morina, (Klinë, 2008)
10. "Fryma e lirisë zbutë dhembjen për liri", kushtuar Dëshmorit të kombit Faruk Elezi, (Klinë, 2008)
11. film dokumentar, kushtuar jetës dhe veprës së Dëshmorit të Brigadës 112 Arben Haliti, (Klinë, 2008)
12. "Jeta dhe lufta për liri", kushtuar Dëshmorit Avni Zhabota, (2008)
13. "Korbi, pjesë e betejave të përgjakshme për shthurjen e Jugosllavisë"- Mirush Dakaj, (Klinë-Prishtinë, 2008)
14. monolog kushtuar luftës çlirimtare të ZO të Pashtrikut, (2008)
15. "Krushqëzimi" kushtuar 24 Dëshmorëve të Jezercit, (2008)
16. "Libri në shtegtim" për krijimtarinë e krijuesit Isak Guta, (2008)
17. "Amaneti i kullës së lashtë", monolog, (2009)
18. "Gjaku i lirisë", kushtuar jetës dhe veprës heroike të Dëshmorit të kombit Fehmi Rama, (Prishtinë, 2009)
19. "Krisma e Këngë", për Dëshmorin Milaim Krasniqi (Rahovec, 2010)
20. "Fashiko", për sportin e karatesë në Kosovë, (Prishtinë, 2011)
- 21-33. Emission ekskluziv dokumentar në 12 vazhdimë "Luftë për jetën", i edituar dhe arkivuar në RTK gjatë sezonit (2010-2011)
34. "Mbijetesa", film dokumentar, (Prishtinë, 2012)
35. "Krimi", film dokumentar, (Prishtinë, 2012)
36. "Ai jeton në shpirtin e popullit", dokumentar, (Prishtinë, 2013)
37. "Shkencëtarja e gramatikës historike", dokumentar, (Prishtinë, 2017)
38. "Mbijetesa II", dokumentar, (Prishtinë, 2019)
39. "Zjarri që ndanë dy epoka" Shtëpitë Shkolla, Gjymnazi "Sami Frashëri" (Prishtinë, dhjetor 2019)

Pjesëmarrja në festivalet ndërkombëtare të filmit dhe teatrit:

- Festivali i Teatrove në ish Jugosllavi, drama "Hakmarrja", Vendi I parë, i organizuar në Makarska, 1979.
- Festivali i filmit ballkanik, film artistik i metrazhit të shkurtër "Qyteti i zi", i organizuar në Pogradec, 2014.
- Festivali "Javën e filmit", dokumentar "Mbijetesa", Nju Jork, 2015.
- Festivali i filmit "Hyjnesha në fron", filmi i metrazhit të shkurtër "Qyteti i zi", organizuar në Prishtinë, 2015.
- Festivali "Javën e filmit", filmi dokumentar "Krimi", Nju Jork, 2016...

DIBRAN TAHIRI



Aktori Dibran Tahiri, u lind më 6 maj 1949 në Prishtinë. Në fillim studio në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, në degën e aktrimit, më pastaj mbaroi studimet Universitare për aktor edhe në Fakultetin e Arteve Dramatike, në Universitetin e Beogradit. Ka arritur një karrierë shumë të suksesshme në Teatër nëpër mbarë ish Jugosllavinë, duke u vlerësuar një nga aktorët me të famshëm të asaj kohe. Interpretimet e tij në film ishin gjithashtu shumë të mirëpritura, duke arritur famë shumë të madhe në kinematografinë ish-jugosllave, kosovare dhe ndërkombëtare.

Është njëri ndër themeluesit e degës së Artit Dramatik, si dhe Akademisë së Arteve në Universitetin e Prishtinës në vitin 1989, ai kthehet nga Beogradi për të ligjëruar lëndën e aktrimit në këtë Universitet dhe formon kuadro të reja të aktorëve në Kosovë.

Dibrani është një person serioz, sot konsiderohet si një ndër aktorët më të famshëm në Kosovë.

Dibran Tahiri si aktor i madh prezantohet edhe në serialin e famshëm në Kosovën e pasluftës “Familja Moderne”, ku ai luan rolin e Dinit (Shemsidin Gashi). Roli i tij, në këtë komedi si baba, që merret me punët e Dritës, Korabit, Zanës, Almës, e sidomos me ato të familjes Gashi, ka qenë dhe mbetet shumë simpatik në mesin e përcjellësve të serialit. Dibrani në rolin e Dinit dallohet për gjeste, si përgjimi, të qeshura të paartikuluara dhe tentime për të folur në gjuhën letrare shqipe, të cilën shpeshherë e përziën me gjuhën turke, si shenjë e prejardhjes së saj.

Të gjitha këto publiku i konsideron mjaft argëtuese, andaj edhe roli i tij mbetet vazhdimisht i freskët, ndërkaq shikuesit janë gjithmonë të etur për paraqitjet e tij..

Filmografia:

- Mamutovitët e Rexhepovitët - mini serial
- Familja Moderne - serial televiziv
- Kukumi, në regji të Isa Qosja, 2005 - film 35mm
- Koha e Kometës, regjisor Fatmir Koci, 2008- film 35mm
- Shqipetari, Johannes Naber, 2009, 16mm
- Forgivnes of blood Joshua Marston, 2010, 35mm,
- Room 304, Birgitte Stearmose 2010, 35mm. Etj.

DIJANA TOSKA



Prof. Dijana Toska u lind në Shkup, më datë 4 qershor të vitit 1965. Shkollën fillore dhe të mesme i mbaron në Shkup. Ciklin e parë të studimeve i përfundon në Universitetin shtetëror të Tetovës, në Fakultetin për Gjuhë dhe letërsi angleze dhe merr titullin Profesor i Gjuhës dhe letërsisë angleze.

Në vitin 2012 e përfundoi ciklin e dytë të studimeve në UEJL në Tetovë, në Fakultetin e shkencave politike dhe administratës publike, dega Diplomaci, dhe me mbrojtjen e temës të magistraturës, me titull “Lobimi si mekanizëm i rëndësishëm i ndikimit diplomatik” merr titullin Magjistër i Diplomacisë.

Vite të tëra ka punuar si Profesor i Gjuhës angleze, ndërsa që nga viti 2012 mban postin më të lartë në administratën shtetërore, si Këshilltare shtetërore për promovimin e eksportit dhe marrëdhënieve ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Agjencinë për investime të huaja dhe promovimin e eksportit të RMV-së.

Ka ndjekur shumë trajnime dhe seminare të ndryshme nga fusha e administratës publike, si dhe ka qenë anëtare në grupe të ndryshme punuese njëkohësisht ka marrë pjesë në grupin e ekspertëve, si dhe ka qenë koautor në përpilimin e “Manualit për zgjidhjen e konflikteve mes qeverive dhe sindikatave”, në kuadër të ITC/ILO, në Torino të Italisë.

Veprat:

-“Gërsheta malli“, (poezi), 2014

-“Rruazat e jetës”, 2017

Tani është duke punuar intensivisht në tre libra, nga të cilat dy përmbledhje me poezi dhe një përmbledhje me tregime, të cilat do të botohen në vitin 2020.

Ajo është e njohur si autore e teksteve për këngë për fëmijë dhe ka qenë aktive me pjesëmarrje nëpër festivale mbi dhjetë vite me radhë në vend dhe rajon.

Poezitë e saj rregullisht botohen në portalet letrare elektronike, si dhe janë të përfshira në shumë antologji si: Antologjia e poezisë moderne shqipe, “Panorama e krijimeve”, të zgjedhura për nder të manifestimit “Ora e Astritit”, Antologjia e parë “Ars-Albanica”, përmbledhja e krijimeve letrare nga autorë të njohur shqiptarë “ILLZ”, etj.

DRITAN KORUMI



Dr. Dritan Korumi, u lind në Grevë, Peshkopi, më 1 Janar 1970. Shkollën 8-vjeçare e kreu në Grevë, të Mesmen Mjekësore në Korçë. Aty do të dallohet për cilësi të veçanta në procesin mësimor dhe jetën sociale. Studimet i vazhdoi në Olimpiadën e Fizikës si dhe Rekomandimin që të vazhdojë studimet e larta për mjekësi.

Në vitin 1988 do të fillonte studimet e larta në Tiranë, Universiteti Politeknik, Fakulteti i Mjekësisë së Përgjithshme. Pasi diplomohet në vitin 1993 do të kthehet në vendlindje.

Për 1 vit do të bënte Stazh pranë Spitalit të Peshkopisë dhe në vitin 1994 do të emërohej mjek familje në Qendrën Shëndetësore Melan, duke qenë në ndërkohë dhe drejtues i saj.

Në vitin 2004 fillon studimet pasuniversitare në Moskë, pranë Akademisë Sechenova. Pas një viti i ndërpret studimet dhe kthehet në Shqipëri, ku do të fillojë punën si mjek në drejtorinë e burgjeve, duke qenë edhe shef shërbimi në disa institucione.


Ai është ftuar në vizitë zyrtare nga Ministria Britanike e Drejtësisë, në vitin 2012-2013. Në vitin 2014 emërohet mjek familje dhe më pas drejtor në Qendrën Shëndetësore Zall-Bastar, Tiranë, ku dhe vazhdon të punojë. Në vitin 2016 do të formojë Sindikatën e Pavarur të Shëndetësisë.

Dritan Korumi ka krijuar lidhje të veçanta me Federatën e Pavarur të Shëndetësisë në Kosovë, duke shënuar hapa konkret.

Më 1 Tetor 2016 pranohet anëtar i irregullt i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Arteve dhe Shkencës, e cila kryesohet nga Prof. Skënder Kodra Ph.D. me qendër në New York. Në këtë institucion mbarshqipëtar do të rekomandohej nga Prof. Hysen Kosovrasti dhe kompozitori Përparim Tomcini. Në kuadër të kësaj akademie ka marrë pjesë në disa aktivitete të akademisë, ku veçohet vizita në New York, e cila pati si event të rëndësishëm një bisedë në studion e VOA në New York mbi problemet e shëndetësisë në Shqipëri si dhe projektin e Akademisë. Po ashtu ka patur disa prezantime në TV në Tiranë dhe në Kosovë.

Dr. Korumi, flet gjuhët anglisht, italisht dhe rusisht. Ai gëzon një reputacion të nderuar në Shqipëri dhe në Kosovë, kjo falë punës së palodhur dhe formimit të plotësuar profesional, kulturor, filozofik dhe historik...

DRITËRO AGOLLI (1931-2017)



Dritëro Agolli, u lind më 13 tetor 1931, në Menkulas të Rrethit të Devollit afër Korçës, dhe u nda nga jeta më 3 shkurt 2017 në Tiranë. Pasi mori mësimet e para në vendlindje, vazhdoi gjimnazin e Gjirokastrës. Ai vazhdoi studimet në Fakultetin e Arteve në Shën Petersburg.

Dritëro Agolli ka punuar shumë kohë gazetar në gazetën e përditshme "Zëri i popullit", dhe për shumë vjet ka qenë kryetar i Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë. Për tridhjetë vjet me radhë Dritëro Agolli u zgjodh deputet.

Krijimtaria e tij letrare është mjaft e pasur në gjini e lloje të ndryshme: poezi, poema, tregime, novela, romane, drama, skenarë filmash etj.

Është fitues i disa çmimeve dhe i nderimeve të tjera. Disa prej veprave më të rëndësishme të tij janë përkthyer në Perëndim e në Lindje.

Dritëro Agolli hyri që në fillim në letërsinë shqiptare (vitet '60) si një protagonist i saj, duke i ndryshuar përmasën e së ardhmes.

Agolli u bë poeti i tokës dhe i dashurisë, shkrimtari i filozofisë dhe i dhimbjes njerëzore. Vepra letrare e Dritëro Agollit krijoi traditën e re të letërsisë shqiptare.

Dritëro Agolli u shfaq në letërsi si një autor me kërkesa të larta për poezinë. Ai synoi një poezi më të përveçme, me më shumë individualitet. Ai krijoi një model të ri vjershërimi në problematikë dhe në mjeshtërinë letrare, gërshetoi natyrshëm vlerat tradicionale të poezisë me mënyra të reja të shprehjes poetike.

Frazeologjia e pasur popullore dhe filozofia jetësore e bëjnë përgjithësisht tërë veprën letrare të Agollit sot për sot ndër më të lexuarën.

Në moshën 85 vjeçare, më 3 shkurt 2017, ndahet nga jeta duke mbetur një nga figurat më të shquara të penës shqiptare.

Krijimtaria:

Për nga gjinitë, krijimtaria e Dritëro Agollit është e larmishme. Në vjershat dhe poemat e Dritëro Agollit gjejnë shprehje mendimet dhe ndjenjat e njeriut të ri, patriotizmi dhe besnikëria ndaj idealeve revolucionare, cilësitë e tij morale në jetë dhe në punë ("Devoll, Devoll", Poemë malore, "Hapat e mia në asfalt" etj.).

Vepra e tij poetike më e shquar është, "Nënë Shqipëri" (1975), ku krijohet figura e atdheut me traditat heroike, me vështirësitë e shumta që

ndeshi në rrugën e vet dhe me vendosmërinë për të përballuar çdo pengesë e armikut. Në poemën “Baballarët” theksohet rëndësia e veçantë e vijimësisë së traditave revolucionare në jetën e shoqërisë. Në një sërë vjershash dhe poemash Dritëro Agolli pasqyron frymën heroike të periudhës së Luftës ANÇ (Poema e udhës, Poemë për babanë dhe për vete), etj...

Në prozë bëri emër sidomos romani “Komisari Memo” (1969), në të cilin pasqyrohet roli i madh edukues dhe drejtues në vitet e Luftës ANÇ. Nga ngjarjet e kësaj periudhe e merr subjektin edhe romani “Njeriu me top” (1975), që flet për ndikimin e luftës çlirimtare në mentalitetin e njerëzve. Dritëro Agolli ka botuar edhe mjaft tregime e novela nga jeta e sotme.

Ndër krijimet satirike romani “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo” (1973) vë në lojë konformizmin, servilizmin dhe vanitetin si shfaqje të huaja për njeriun e ri.

Në vitin 2011 Dritëro Agolli, është nderuar me titullin “Doktor Honoris Causa” nga Universiteti Evropian i Tiranës. Në një ceremoni të veçantë, iu dha ky titull shkrimtarit të shquar *“Për kontributin e madh dhe të rëndësishëm në krijimtarinë e tij letrare për më shumë se 60 vjet, si poet, prozatore, dramaturg përkthyes e eseist”*.

Veprat:

- ”Në rrugë dolla”, 1958, “Hapat e mia në asfalt”, 1961,
- ”Zhurma e erërave të dikurshme”, 1964,
- ”Shtigje malesh dhe trotuare”, 1965,
- ”Mesditë”, 1969, “Komisari Memo”, roman, 1969,
- ”Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”, roman, 1973,
- ”Njeriu i mirë”, tregime, 1973, “Nënë Shqipëri”, 1974,
- ”Njeriu me top”, 1975, “Fjala gdhend gurin”, 1977,
- ”Trëndafili në gotë”, roman, 1980,
- ”Fytyra e dytë”, dramë, “Mosha e bardhë” (dramë),
- ”Udhëtoj i menduar”, 1985, “Pelegriini i vonuar”, 1993,
- ”Kalorësi lakuriq”, roman, 1996,
- ”Vjen njeriu i çuditshëm”, poezi, 1996,
- ”Arka e djallit”, roman, 1997,
- ”Teshtimat e lirisë”, - njeriu, politika dhe kultura, 1997,
- ”Fletorja e mesnatës”, 1998,
- ”I përndjekuri i dashurisë”, poezi, 2013, “Prit edhe pak”, poezi, 2016,
- ”E bukura, lozonjarja, tokësorja Grua”, poezi, 2017,
- ”Nulla dies sine linea”, aforizma, 2017. Etj.

ERZA VOCA MULAJ



Dr.spec.cand.Ph.D - Erza Voca Mulaj, u lind më 07 shtator 1976, në Prishtinë. Shkollën fillore e kreu në Istog (1990), ndërsa Shkollën e mjekësisë "Ali Sokoli ", e kreu në vitin 1994 në Prishtinë. Studimet e Stomatologjisë i regjistroi në vitin shkollor 1996/1997 ndërsa ato i kreu në vitin 2005. Specializojë Protetikën Stomatologjike në Qendrën Universitare Klinike në Prishtinë (2011). Gjatë luftës punoi në Tiranë, në rehabilitimin e refugjatëve të sëmurë në Qendrën "MED-Tirana-CRS". Punojë mjeke stomatologe në Komunën e Kastriotit në Kosovë, si dhe në Klinikën gjermane ZahnärztlichevTagesklinikv (2012). Për një kohë ka punuar si stomatologe në Kampin ushtarak Amerikan në Bonsteel si dhe në Akademinë Italiane të Nutricionit në Kolegjin "Fama" në Prishtinë (2016). Është e punësuar në QKSUK), Specialiste e protetikës klinike stomatologjike dhe e profesionalizuar në implantet e protetikës në Sistemin CaDCAM. Vazhdon studimet doktorale për Stomatologji në Universitetin Bullgar të Mjekësisë, në Sofie. Merret me publikime shkencore. Ka të botuara disa tekste nga protetika fikse, emergjenca mjekësore dentare (2019).

Botimet:

- 1.“Planifikimi i trajtimit paraprotetikor dhe protetik ne Implantologji” Konferenca e 22 kombëtare dentare, Tirane, 2016
2. Erza Mulaj: “Ushqehu fillimisht - Hani mirë që të ndjeheni mirë”, 2017.
3. Erza Mulaj: “Emergjenca dentare”, Libër, grup autoresh, 2018.
4. Erza Mulaj and Islam Borinca : " Element of Lifestyle has been selected to be part of the book: "Social Science:Global Perspectives” by Prof Dr.Antony White from University of Edinburgh,United Kingdoms, 2018.
- 3.N.Rugova, A.Ajeti, E.Mulaj:"Global Health Diplomacy Trends-Kosovo trends,The Knowledge Institute" - Internationa Journal volume 2, 2018.
- 4.Erza Voca Mulaj, Islam Borinca:" Nutritional Education as Indicative Element of Lifestyle",Published on Open Journal of Social Sciences, 2018.
- 5.Erza Mulaj, B. Lenjani “Sport Dental Trauma”, International Conference of Sport Emergency Medicine, Prishtine, 2018
6. Erza Mulaj, Basri Lenjani : “Traumat Dentare” 2nd Annual Congress of Trauma and Emergency Surgery,; Ohrid, Macedonia, 2018,
7. E. Mulaj, A. Murtezani, B. Reqica: “Single Implants in frontal maxilla - a functional and aesthetic problem”, etj.

EDMOND HAJRIZI



Prof. Dr. Edmond Hajrizi është themeluesi dhe rektori i institucionit privat të arsimit të lartë, UBT, me të cilin solli përvojën dhe eksperiencën e marrë nga studimet dhe puna nëpër shumë universitete dhe institucione ndërkombëtare. Ai u diplomua në profesionin e inxhinierit në Universitetin e Prishtinës, ndërsa dy vite më pas, mori titullin master në Teknologji të Përparuar të Automatizimit në këtë universitet. Në po të njëjtin vit, ai u bë pjesë e Universitetit të Vjenës, ku mori gradën doktor shkence në Menaxhim të Sistemeve dhe paralelisht përfundoi edhe studimet për Teknologji të Informacionit, teksa studimet e postdoktoratës i përfundoi në Angli, në City University London.

Edmond Hajrizi është menaxher i certifikuar për Menaxhim të Cilësisë nga TUEV Austria, është vlerësuesi i parë i akredituar për projektin e certifikimit në 4 nivele nga Shoqata Ndërkombëtare për Menaxhim të Projekteve. Hajrizi është ekzaminer dhe trajner i akredituar për Menaxhim të Cilësisë nën skemën e Organizatës Evropiane për Cilësi dhe Quality Austria, është vlerësues kryesor i akredituar për EFQM Model nga Fondacioni ILEP.

Rektori Hajrizi u kthye nga Vjena, për të jetësuar ëndrrën e tij për krijimin e institucionit, që sjell në Kosovë inovacionet dhe përparimet teknologjike në hapin e njëjtë me të gjitha vendet e tjera të zhvilluara, duke u shndërruar shpejt në adresën numër 1 për studime të larta në Kosovë dhe në rajon.

Në vitin 2001, Hajrizi themeloi institutin IEME, përmes të cilit solli një qasje ndryshe ndaj hulumtimit, studimeve universitare, trajnimeve profesionale dhe konferencave ndërkombëtare.

Përmes lobimit të profesorit Hajrizi, sot Kosova është anëtare dhe zë i fuqishëm nëpër shumë institucione ndërkombëtare, aty ku politika nuk mundi të depërtojë asnjëherë.

UBT, falë Profesor Edmond Hajrizit është bërë vatra e punësimit për më shumë se 500 persona që punojnë si staf akademik dhe administrativ, të cilët janë të kualifikuar dhe shkolluar në UBT ose në institucione të tjera prestigjioze ndërkombëtare. Profesionalizmi i profesor Hajrizit, ndikoi në rritjen e besimit tek ky institucion...

EJUP STATOVCI (1940-1997)



Prof. Dr. Ejup Statovci u lind më 16 prill të vitit 1940, në fshatin Prugovc të Prishtinës.

Shkollën fillore e ka kryer në fshatin Besi të Prishtinës, kurse Shkollën Normale e përfundoi në Prishtinë, në vitin shkollor 1959/1960. Pas përfundimit të Shkollës Normale, 14 muaj ka punuar si mësues në Shkollën Fillore në Besi. Në vitin shkollor 1961/1962 është regjistruar në Fakultetin Juridik të Zagrebit, ku është diplomuar më 30 mars të vitit 1966. Pas kësaj, ai ka lidhur marrëdhënie pune së pari në Shërbimin e Kontabilitetit Shoqëror në Prishtinë, dhe më pas ka kaluar në Sekretariatën Krahinor të Financave (Seksioni për marrëdhënie pronësore-juridike).

Në vitin 1968, Ejup Statovci si jurist i diplomuar, u zgjodh Asistent i Fakultetit Juridik-Ekonomik të Prishtinës, për Lëndë Civile. Në vitin Akademik 1970/1971, Ejup Statovci qe autorizuar të mbajë ligjërata nga lënda: “Pjesa e përgjithshme e të Drejtës Civile dhe e Drejta Sendore”, si dhe ligjërata nga “E Drejta Private Ndërkombëtare”.

Në vitin 1971, është zgjedhur Docent. Në vitin 1968/1969 ka regjistruar studimet pastdiplomike në Fakultetin Juridik të Zagrebit. Ka magjistruar më 26 qershor të vitit 1971.

Me vendim të Pleqësisë Shkencore-Pedagogjike të Fakultetit Juridik të Lubjanës, të datës 24 shkurt 1972, Ejup Statovcit i është pranuar Tema për disertacionin e Doktoraturës, të cilën e mbrojti me sukses më 19 qershor të vitit 1974 dhe me këtë fitoi shkallën shkencore doktor i shkencave juridike.

Në vitin 1975 është zgjedhur profesor inordinar për lëndën: “Pjesa e përgjithshme e së drejtës civile dhe e drejta sendore”. Në vitin 1980 është zgjedhur profesor ordinar në Fakultetin Juridik të Prishtinës. Prof. Dr. Ejup Statovci ka qenë kryetar i Pleqësisë së Fakultetit Juridik, drejtor i Studimeve Postdiplomike për gati katër vite. Pastaj, Dr. Ejup Statovci ushtroi edhe detyrën e Drejtorit të Institutit të studimeve juridike të Fakultetit Juridik.

Në vitin 1989, Prof. Ejup Statovci i organizoi dy simpoziume shkencore dhe botoi dy monografi për statusin kushtetues të Kosovës. Prof. Dr. Ejup Statovci ka qenë anëtar i Pleqësisë së Universitetit të Prishtinës. Ka qenë anëtar i Komitetit organizativ të Seminarit Ndërkombëtar

“Universiteti Sot”, në Dubrovnik, Kroaci. Ka qenë sekretar i Redaksisë së “Buletinit të Fakultetit Juridik të Prishtinës”, anëtar i Këshillit Botues të Revistës “Përparimi” dhe anëtar i Redaksisë së revistës “Universiteti Sot”. Ka qenë kryeredaktor i Revistës “E drejta (Pravo)” dhe kryeredaktor përgjegjës i “Përmbledhjes së punimeve” të Fakultetit Juridik.

Në Vitin 1976, Dr. Statovci ka qëndruar 6 muaj në Universitetin e Kembrixhit (Cambridge University), në Britaninë e Madhe.

Për qëndrim studimor ka qenë në Oksford, në Tiranë e Paris, ku ka qëndruar një kohë të caktuar. Si bursist i Fullbrajtit, Prof. Dr. Ejup Statovci, gjatë vitit 1979/1980 qëndroi në Universitetin e Harvardit (SHBA), në cilësinë “Visiting Scholar”.

Ndërkaq, në periudhën prej 1 prillit deri më 30 qershor të vitit 1985, Prof. Dr. Ejup Statovci qëndroi në Universitetin e Kembrixhit (Angli), ku qe i nderuar duke u zgjedhur anëtar i Fakultetit Juridik. Në vitin 1980 ka marrë shpërblimin e Dhjetorit.

Nga 26 nëntori 1991 e deri më 31 dhjetor 1997, Prof. Dr. Statovci ishte Rektor i Universitetit të Prishtinës. Ai me punën e tij kontribuoi shumë në vazhdimin e punës, në organizimin, në institucionalizimin juridik të Universitetit duke nxjerrë Dekretligjin mbi shkollimin e lartë dhe duke nxjerrë Statutin e Universitetit; duke e transformuar atë në një Universitet të kohës sipas përvojës evropiane dhe botërore, duke e afirmuar dhe pranuar atë brenda dhe jashtë si Institucion shtetëror.

Prof. Dr. Ejup Statovci pa kundërshtim është arkitekti kryesor i ndërtimit të Universitetit të Prishtinës. Universiteti e ndërtoi vetën dhe shtetin e Republikës së Kosovës.

Për punën e tij të madhe, si Rektor i Universitetit të Prishtinës Prof. Dr. Ejup Statovci, më 15 shkurt 1999 shpërblehet me Mirënjohje të Universitetit të Prishtinës, me detikimin:

“Mirënjohje postmortum - për kontributin e veçantë për rifillimin e punës së Universitetit të Prishtinës dhe për udhëheqjen e tij në kushte të jashtëzakonshme në periudhën 1991-1997”.

Atij iu nda çmimi edhe me rastin e 30-Vjetorit të themelimit të Universitetit të Prishtinës, më 16 maj 2000.

Punim shkencor:

-Parashkrimi-Trajtimi i tij në praktikën gjyqësore dhe administrative me rastin e zbatimit të Ligjit mbi Uzurpimet', "Përparimi" Nr. 5, Prishtinë, 1967-1957...

EKREM KRYEZIU



Regjisori Ekrem Kryeziu u lind në vitin 1943, në Pejë. Fillimisht studioi për drejtësi, në Zagreb, dhe më pas diplomoi për dramaturgji në Akademinë e filmit në Beograd, në vitin 1970.

Pas studimeve nis një karrierë të gjatë e të pasur, si prozator, autor dramash, skenarist e regjisor, një karrierë që i jep edhe shumë çmime. Përveç se shkrimtar e artist i angazhuar, është edhe publicist e analist politik. Si student ishte i angazhuar në TVB, në punët e spikerit e më vonë edhe të regjisorit në redaksinë, në gjuhën shqipe të

Televizionit të Beogradit. Momentalisht ligjëron në Prishtinë lëndën e dramaturgjisë. Është regjisor produktiv filmash dhe televizioni, autor filmash dhe producent filmash nga Kosova.

Në vitin 1967 mori pjesë në realizimin e filmit të parë në gjuhën shqipe "Uka i Bjeshkëve të Nëmura". Pas demonstratave të vitit 1981, burgoset dhe dënohet me tetë vjet heqje lirie.

Lirohet më 1985. Themelon kompaninë e prodhimit të filmit dhe muzikës "Labia" dhe i rikthehet punës si producent, skenarist e regjisor. Më 1996, themelon degën e Dramaturgjisë në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Gjatë luftës që zhvillohej në Kosovë, ai në prill 1999, dëbohet në Maqedoni, prej nga ku emigron për në SHBA.

Pas luftës, ai kthehet në vendlindje dhe vazhdon të punojë në Fakultetin e Arteve të UP, si profesor i dramaturgjisë.

Lista e titujve të veprave të Kryeziut, si autor dhe regjisor është shumë e gjatë. Ajo përmban njëmbëdhjetë filma dokumentarë.

Filmografia:

- "Një lindje", film, fitues i çmimit ORWO, më 1973;
- Dy seriale televizive ("Po e zëmë, po e zëmë", 1971, skenarist e regjisor dhe "Pranvera në Prishtinë", 2001, skenarist);
- Tri teledrama ("Të ngujuarit" 1972; "Epoka para gjyqit" 1978; «Xhani Ballkaneze», 1980);
- Tetë filma TV: "Buka" 1974, "Por" 1974 - regjia më e mirë në Festivalin e Filmit Televiziv në Portorozh të Sllovenisë, "E kafshoja terrin" 1977 - filmi më i mirë dhe regjia më e mirë po atë festival, më 1978 dhe çmimi i tretë në festivalin ndërkombëtar "Prix d'Italie", në Milano, "Kur pranvera vonohet", 1978 - version kinematografik dhe televiziv me katër pjesë,

"Gjurmë të Bardha", 1979 - version kinematografik dhe televiziv me katër pjesë, "Një jetë e tërë", 1980, "Gjurmë të Bardha", 1980, mori çmimin "Arena e Bronztë" për regji në Festivalin e Filmit të Jugosllavisë në Pula të Kroacisë, "Viktimat e Tivarit", 1993 dhe "Rruga pa kthim", 1994;
-Dy videokomedi: "Pa pardon" dhe "Sherif Patrioti", 1995;
-Dy filma artistikë: "Buka e hidhur" si dhe "Dashuria e Bjeshkëve të Nemuna", i prodhuar në vitin 1997.

Në fushën e teatrit, ai ka nënshkruar tekstet dhe regjinë e dramave "Të ngjuarit", 1971, Prishtinë; "Epoka para gjyqit", 1978 dhe 2003, Teatri Popullor, Gjakovë, Teatri Popullor, Tiranë; "Korridoret e Tmerit" 2002, Teatri Kombëtar, Prishtinë; "Lulëkuqet", 2004, Teatri Kombëtar Gjakovë; "Teuta ose qerrja e fitores", 2004.

Botime, skenarë dhe regji:

"Mbreti Zog - Geraldina dhe të tjerët", dramë, 2019;
"The American Dream"- "Ëndrra amerikane", dramë, 2018;
"Përtej vdekjes", skenar për film artistik, 2014;
"Binjak Siamez", dramë, 2014;
"Pushkatimi", dramë, Teatri "Istref Begolli", Pejë 2013;
"Përplasjet", dramë në TKK Prishtinë;
"Dashuria e Bjeshkëve të Nemuna II" film artistik, 2012;
"Kodi i jetës", Film artistik, 2008; dhe, seri televizive në 6 pjesë, 2009;
"I biri i Rozafës", dramë, 2007;
"Drama I,II", botim i UVE (Universiteti i Vizionit evropian) 2007;
"Përtej bunarëve" film televiziv, Prodhim i RTK-s Prishtinë, 2006;
"Komploti Ilir", dramë, Tetari kombëtarë Gjakovë 2005;
"Dashuria", dramë, Tetari kombëtarë Gjakovë, 2000;
"Epoka Para Gjyqit 1978-2003", dramë, Teatri Kombëtarë Gjakovë, 2002;
"Pranvera në Prishtinë", seri televizive, 1997; "Dashuria e Bjeshkëve të Nemuna", film artistik, 1996; "Buka e Hidhur", film artistik prodhuar nga "Labia" Prishtinë, 1995; "Pa pardon", Video komedi, 1994; "Rruga pa kthim", TV film, 1993; "Viktimat e Tivarit", TV film, 1980; "Një jetë e tërë", TV film, 1979; "Gjurmë të Bardha", film artistik, 1978; "Epoka Para Gjyqit", TV dramë etj.

Prodhimi "Kosova Film"

- 1977, *E Kafshoja terrin*, TV film, TV Prishtinës
- 1975, *Piktori Muslim Mulliqi*, film dokumentar
- 1974, *Mallkimi i kuajve*, Film dokumentar...

EMIN KABASHI



Emin Kabshi, u lind më 23.1.1949 në fshatin Drini (ish-Çifllak) të Rahovecit. Shkollën fillore, katër klasë i kryen në vendlindje, kurse katër klasë të tjera në fshatin Balldrin (ish-Ratkoc).

Gjinnazin e fillon në Prizren dhe e përfundon në Rahovec. Studimet i mbaron në Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe të Fakultetit Filozofik në Universitetin e Prishtinës.

Gjatë kohës së studimeve punoi mësues dhe arsimtar i gjuhës shqipe në disa shkolla të Kosovës, duke filluar nga vendlindja e deri në Prapashticë të Gollakut, komuna e Prishtinës. Një kohë ka punuar në gjinnazin e Rahovecit dhe një kohë në gjinnazin “Luigj Gurakuqi” të Klinës, si dhe në klasë të ndara të këtij gjinnazi në Pleqnar (ish-Kijevë) të Malishevës.

Ka kryer studimet pasuniversitare në Degën e Letërsisë dhe ka magjistruar me temën “*Poetika e Lasgush Poradeci*”, në vitin 1979.

Në vitin 1989 ka mbrojtur tezën e disertacionit të doktoratës me titull “*Poetika e poemave të Jeronim de Radës*” në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës.

Nga vitit 1974-1992 nuk i është mundësuar të punojë në arsim. Disa herë gjatë jetës është përballur me politikën antishqiptare që bënte Jugosllavia. Kësisoj, nuk i është mundësuar të punojë as në Institutin Albanologjik të Prishtinës, as më 1974, si asistent, as më 1981 kur ishte pranuar si hulumtues i pavarur shkencor. Në Institutin Albanologjik kthehet në shtator të vitit 1992, pasi kishte mbetur pa punë.

Nga kjo kohë punon në Institutin Albanologjik, në Degën e Letërsisë, këshilltar shkencor.

Me shkrime ka filluar të merret që nga vitet '70. Në fillim, kryesisht me kritikën letrare, pastaj edhe me shkrime artistike dhe publicistike.

Vepra të botuara:

- “Njerëz dhe rrugë”, roman, “Rilindja”, Prishtinë, 1990
- “Dimri i Drinisë”, roman, LSHK, Prishtinë, 1993
- “Gjaku i shprishur”, dy drama (Të fala nga Shkodra dhe Përtej harrimit), “Rilindja”, Prishtinë, 1993
- ”Dashuri në kohë robërie”, roman, “Plejada”, Prishtinë, 1994

- ”Poetika e poemave të Jeronim de Radës”, studim monografik, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1994
- ”Jeronim de Rada–poetika e poemave”, monografi, e ripunuar, ribotim, “Ombra GVG”, Tiranë, 2003
- ”Përtej grilave”, roman, “Rilindja”, Prishtinë, 1996
- ’Përtej grilave’, roman, “Eurorilindja”, Tiranë, 1997
- ”Lasgush Poradeci-jeta dhe vepra”, studim monografik, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1997
- ”Nusja dhe lufta”, roman, “Rilindja”, Prishtinë, 1997
- ”Kadare-mendësia shqiptare”, studime dhe ese, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinës, 1998
- ’Robëria, iluzionet, shqiptarët’, ese, kulturologji, Shoqata e Shkrimtarëve e Kosovës, Prishtinë, 1998
- ”Nusëria e Princeshës”, roman, “Rozafa”, Prishtinë, 2001
- ”A erdhi Nusja”, dramë, “Rozafa”, Prishtinë, 2002
- ”Liria”, dramë, “Era”, Prishtinë, 2003
- ”Batalioni Atlantiku i UÇK-së”, monografi, Prishtinë, 2004
- ”Përmasa kombëtare e Luftës së UÇK-së”, shkrime eseistike, 2005
- ”Iluzionet, kultura, Atdheu”, shkrime eseistike, IAP, Prishtinë, 2005
- ”Udha e madhe e jetës”, monografi, Prishtinë, 2005
- ”Shenjta e kujtesës historike” (Lufta e UÇK-së në anën e Malishevës), monografi, Prishtinë, 2006
- ”Jeta në udhëkryqet e historisë”, monografi, Prishtinë, 2007
- “Hisja e atdheut” (Dëshmorit të Kombit Ymer Krasniqi), monografi, Prishtinë, 2008
- ”Komandanti i lirisë” (Dëshmorit të Shemsi Ahmeti), monografi, 2010
- ”Gjëma e Atdheut”, roman, Prishtinë, 2013

Në gazetën e përditshme Rilindja, të shpërblyer, ose të marrë për botim, i janë botuar në vazhdimë edhe dy romane:

-”Kohë e zgjebosur”, 1992, dhe “Përtej vdekjes”, 1994, kurse romani Farë e mallkuar” kishte filluar të botohej më 1989, por u pamundësua botimi i tij.

Në shtypin e kohës, në revista, në botime të veçanta i janë botuar me dhjetëra njësi bibliografike, kritikë letrare, eseistike, studime, kumtesa për probleme të letërsisë së Rilindjes Kombëtare dhe të letërsisë së sotme shqipe. Deri në vitet '90 dy herë e kishte të ndaluar veprimtarinë botuese. Jeton dhe vepron në Prishtinë.

ENGJËLL BERISHA (1934-2015)



Akademik Engjëll Berisha, u lind në Prizren, në vitin 1934. Shkollën fillore, progjimnazin dhe Shkollën e Mesme të Muzikës (1953). Në vitet 1954-1958 mbaroi studimet e larta në Degën e Teorisë dhe të Pedagogjisë Muzikore, në Akademinë e Muzikës në Beograd. Pas diplomimit, në vitin 1958 kthehet në Prizren, ku deri në vitin 1968 punon në shkollën e Muzikës dhe Pedagogji të lëndëve muzikore, në Shkollën Normale dhe në Gjimnazin e Prizrenit. Më 1968 u zgjodh profesor i lëndës Histori e muzikës në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prishtinës. Aty punoi deri në vitin 1975. Më 1975, u zgjodh ligjërues i lëndës Histori e muzikës. Pastaj mori titullin profesor inordinar dhe më vonë profesor ordinar i Universitetit.

Gjatë viteve 1974-1978, studioi në Fakultetin Filozofik-Dega për muzikologji, në Lubjanë. Studimet pasuniversitare i ndoqi në Akademinë e Muzikës-Dega për Histori të Muzikës dhe Muzikologji në Sarajevë. Aty magjistroi në fund të vitit 1980. Ishte drejtor i Shkollës së Mesme të Muzikës dhe drejtor i Gjimnazit, prodekan, dekan. Ishte dirigjent i korit të SHKA "Agimi". Ligjëroi në Tiranë në vitin 1979, në Shkup, më 1993, Sarajevë, Novi-Sad, në vitin 1986, etj. Ishte sekretar i Seksionit të Arteve dhe sekretar i përgjithshëm i ASHAK-ut. Vdiq në Prishtinë më 2015

Librat e botuara:

“Kultura muzikore, për klasat I dhe II të gjimnazit”, EMM, Prishtinë, 1989

“Kultura muzikore botërore dhe shqiptare, për shkolla të mesme”, Libri Shkollor, Prishtinë, 1998

“Arti muzikor, për shkolla të mesme kl. 10,11,12”, botues Libri Shkollor, Prishtinë, 2004, 2005, 2006

“Historia e muzikës I (dispensë), për studentë të muzikës”, SHLP, Pri, 1975

“Zhvillimi i stileve në veprat e kompozitorëve shqiptarë të Kosovës”, Libri Shkollor, Prishtinë, 1997

“Studime dhe vështrime për muzikën”, ASHAK, botime të veçanta LII, Libri 6, Prishtinë, 2004

“Punime për Fjalorin Enciklopedik të ri”, botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008

“Album me vepra për piano”, zgjodhi dhe përgatiti për shtyp, botoi ASHAK, Prishtinë, 2009, si dhe botime tjera me shumë vlera.

ENGJËLL KOLIQUI



Engjëll Koliqi u lind më 10 nëntor 1956, në Stubëll të Vitisë, në Kosovë. Shkollën fillore e ka mbaruar në vendlindje, gjimnazin, drejtimin e shkencave natyrore-matematikore në Viti dhe në Ferizaj. Në Universitetin e Kosovës në Prishtinë ka mbaruar Fakultetin e Edukimit. Punoi në vendlindjen e tij mësimdhënës.

Ishte i ndjekur nga regjimi serb dhe më 1990 ishte arrestuar. Ai largohet dhe shkon në Itali. Që nga fillimi ka punuar gazetar dhe redaktor në Radio Vatikan, korrespondent i radiotelevizionit shqiptar-RTSH në Tiranë e pastaj i radiotelevizionit të Kosovës-RTK në Prishtinë. Ka punuar edhe për radiotelevizionin publik të Maqedonisë, si dhe për radiotelevizione të tjera private në gjuhën shqipe.

Mbi 20 vite shkruan në shtypin e përditshëm dhe atë periodik shqiptar; në Kosovë, në Shqipëri, në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në diasporë. Ka bashkëpunuar edhe me gazetatat italiane. Po ashtu ka bashkëpunuar edhe me dy qendrat kryesore radiotelevizive; RAI dhe MediaSET.

Në italisht ka botuar përmbledhjet me poezi “*Il mio secolo si chiama amore*”, (Shekulli im quhet dashuri), 2005, “*Sentimento di luce*” (Ndjenjë drite), Napoli, 2007, i njëjti libër, në gjuhën portugeze, “*Sentimento de luz*”, SHB ProTexto, në Curitiba. “*Madre Teresa –um amor sem limites*” (Nënë Tereza –një dashuri e pakufishme), SHB O Lutador në Belo Horizonteme, Brazil, 2008. Që të dy librat, në gjuhën portugeze i janë përkthyer nga Profesoresha e mirënjohur Dr. Vera Lúcia Alves Neves.

Veprat e botuara:

- “*Trokitje të heshtura*”, Tiranë, 2010
- “*Dr Ibrahim Rugova, arkitekt i Dardanisë së Re-Republikës së Kosovës*”, (monografi), Tiranë, 2011
- “*Për një jetë më të mirë*”, libri me ese, Tiranë, 2011
- “*Nën kurorën e lisit plak*”, (vëllim poetik), 2012, (fitoi konkursin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve Shqiptarë në Gjermani, duke u shpallur libri më i mirë poetik i autorëve të diasporës), botuar në vitin 2011 që iu dha çmimi i parë “Azem Shkreli”.
- “*Njëqind lule për Nënë*”, për Shqipërinë në 100 Vjetorin e Pavarësisë.
- “*Miku i madh i shqiptarëve*”, (publicistikë), kushtuar Papës Gjon Pali II.
- “*Rebeka, një dashuri e rigjeneruar*”, (roman), etj.

ENVER PETROVCI



Prof. Enver Petrovci u lind më 28 shkurt 1954 në Prishtinë. Është aktor dhe regjisor i njohur. Në fillim studoi në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë në degën e aktrimit, më pastaj mbaroi studimet Universitare për aktor në Fakultetin e Arteve Dramatike në Universitetin e Beogradit. Ka arritur karrierë shumë të sukseshme në teatër, sidomos në "Atelieja 212" dhe me rolet e tij të realizuara ,u bë i njohur në mbarë ish-Jugosllavinë duke u vlerësuar një nga aktorët më të famshëm të asaj kohe. Pas mbarimit të luftës e vazhdoi me sukses karrierën artistike në Prishtinë e në qendra të tjera shqiptare.

Interpretimet e tij në film ishin gjithashtu shumë të mirëpritura, duke arritur famë shumë të madhe në kinematografinë ish jugosllave, kosovare dhe ndërkombëtare.

Është njëri ndër themeluesit e degës së Artit Dramatik dhe Akademisë së Arteve në Universitetin e Prishtinës. Në vitin 1989, ai kthehet nga Beogradi për të ligjëruar lëndën e aktrimit në këtë Universitet dhe formon kuadro të reja të aktorëve në Kosovë.

Ka arritur karrierë shumë të suksesshme në Teatër nëpër mbarë ish Jugosllavinë ,duke u vlerësuar një nga aktorët më të famshëm të asaj kohe.

Teatër:

- ”Idioti” - regjinë dhe rolin kryesor;
- ”Dëshmitari kryesor” - regjisor;
- ”Kush më ka faj që jam shqiptar” - regjisor;
- ”Guxim për vrasje” - roli kryesor.

Filmografia:

- ”O sa mirë”, seri televizive, 2013;
- ”Topi ishte i nxehtë” - (Top je bio vreo), 2011
- ”The War Is Over”, 2010
- ”Gomarët e kufirit”, 2009
- ”Sekretet”, 2008
- ”Anatema”, 2006
- ”Lost Son”, film i shkurtër, 2005
- ”Black Flowers”, 2003
- ”Kurora malore“- (Gorski vijenac), 2000

- “The Hornet“, 1998
“Nekrologji“, 1994
“Një rast i lehtë i vdekjes“ - (Laksi slucuj smrti), 1993
“Bulevardi i Revolucionit“ - (Bulevar revolucije), 1992
“America e mallkuar“ - (Prokleta je Amerika), 1992
“Jetë më e mirë 2“ - (Bolji zivot 2), 1991, serial
“Rrethi“ - (Krug), film i shkurtër, 1991
“Djelidba“, 1991, film televiziv
“Pushimet në Sarajevë“ - (Praznik u Sarajevu), 1991
“Armiku i partisë“ - (Partijski neprijatelj), 1990
“Baruti i shurdhër“ - (Gluvi barut), 1990
“Ministër i popullit“ - (Narodni poslanik), 1990
“Stacioni normal i trenave“ - (Stanica obicnih vozova), 1990
“Migjeni“, film televiziv, 1990
“Redaksia e veçantë“ - (Specijalna redakcija), serial, (1989-1990)
“The Bizarre Country“, 1988
“Histori e zakonshme“ - (Obicna prica), 1989
“Forbidden Sun“, 1989
“Rojet e mjegulles“, 1988
“Gjithmonë gra të gatshme“ - (Uvek spremne zene), 1987
“Jeta në varreza“ - (Zivot u grobljanskoj), 1987
-Jugovizija - (Jugovizija_, 1986
“Vrella“ - (Vrenje), 1986
“Goditje e dyfishtë“ - (Dvostruki udar), film televiziv, 1985
“Një shteg i rrezikshëm“ - (Opasni trag), 1984
“Shkallët për në qiell“ - (Stepenice za nebo), 1983
“Shtatë sekretarët e SKOJ-it“ - (Sedam sekretara SKOJ-a), 1981
“Josip Kolumbo“, serial (katër episoda), 1981
“Kur pranvera vonohet“, serial televiziv, 1980
“Kur pranvera vonohet“, film i metrazhit të gjatë, 1979
“Disku i mëngjesit“ - (Jutarnji disk dzokej), film televiziv, 1979
“Slom“, serial televiziv, 1979
“Qëndrimi në lumin e madh“ - (Ti medjutim stojis na velikoj reci),
si dhe role tjera në filma të metrazhit të gjatë, të realizuar mjeshtërisht nga
aktori i madh Enver Petrovci, nga produktionet e ndryshme filmike dhe
nga regjisorë të Kosovës e më gjerë, si: të filmi i metrazhit të gjatë “Azem
Galica”, seriali televiziv “Vendlindja ime”, etj.

EQREM ÇABEJ (1908-1980)



Eqrem Çabej, u lind në Eskishehir më 6 gusht 1908, të Stambollit.

Mësimet e para i mori në Gjirokastrë, prej 1915 e deri më 1920, më pas për të vazhduar studimet u dërgua në Austri. Para se të hyej në ndonjë shkollë, iu desh të qëndronte një vit pranë familjes Reinmyler, në St. Pölten afër Vjenës, për të mësuar gjuhën gjermane.

Kreu gjimnazin në Klagenfurt (1923-1926), për shkollimin e lartë pati një fërkim me synimin që i ati i kishte vënë që të bëhej mjek. U regjistrua në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Romës. Por, pas këmbënguljes për gjuhësinë, regjistrohet në Grac për vitin akademik 1927-1928 dhe më pas kaloi në Vjenë (1930-1933), ku ndoqi mësimet e Paul Kretschmer, Karl Patsch, Nikolai Trubetzkoy dhe Norbert Jokl.

Nën drejtimin e Norbert Joklit, Çabeji filloi të kishte interes të madh në zhvillimin historik të gjuhës shqipe.

Në vitin 1933, Eqrem Çabej dorëzoi disertacionin e doktoraturës mbi Studime Italo-Shqiptare (Italoalbanische Studien).

Çabej u kthye në Shqipëri ku edhe punoi si mësues gjimnazi dhe nëndrejtor i konviktit "Malet Tona" në Shkodër, gjatë vitit shkollor 1933/1934, ku dha letërsi shqipe.

Në vitin shkollor 1935/1936, Eqrem Çabej u transferua në Shkollën Normale të Elbasanit, ku qëndroj një vit dhe që andej u transferua në Ministrinë e Arsimit për t'u marrë me drejtimin e arsimit të mesëm. Nga qëndrimi i tij, ai nuk e kishte mirëpritur një emërim të tillë.

Me një lutje të datës 17 dhjetor të vitit 1936, drejtuar Ministrisë së Arsimit, për arsye shëndetësore kërkoi të transferohej, duke u riemëruar profesor i letërsisë në liceun e Tiranës. Kërkesa nuk i plotësohet, duke e emëruar në Shkollën e Plotësimit Ushtarak.

Me "çështjen Çabej" u mor më në fund edhe Këshilli i Ministrave të asaj kohe, i cili vendosi që Çabej, pas mbarimit të Shkollës së Plotësimit Ushtarak, të transferohej si profesor në Gjirokastrë.

Më 1938-1939 vijon si arsimtar në Gjirokastrë, ku vazhdoi të jepte mësimin e letërsisë të bashkërenduar me elemente të gjuhës shqipe.

Në vitin shkollor 1939/1940 Eqrem Çabej u transferua në gjimnazin e Tiranës ku u ngarkua me drejtimin e shkollës.

Si anëtar i Institutit të Studimeve Shqiptare, më 1940 dërgohet në Romë nga ministri i Arsimit Ernest Koliqi, për të punuar mbi Atlasin Gjuhësor Shqiptar, i cili nuk u krye për arsye të ndryshimeve politike përgjatë Luftës së Dytë Botërore.

Në shtator të vitit 1943 u emëruar ministër i Arsimit në qeverinë Mitrovica, post të cilin nuk e pranoi. Më 25 janar 1944 i pushkatohet vëllai, Selaudini, nënprefekt i Malësisë së Gjakovës. Në Shqipëri u kthye vetëm pas korrikut të vitit 1944.

Në vitin 1947, ai u caktua anëtar i Institutit të Shkencave, instituti paraardhës i Universitetit të Tiranës. Nga 1952 deri më 1957, ai shërbeu si profesor i historisë së Shqipërisë dhe fonetikës historike. Më 1972, ai u bë anëtar themelues i Akademisë së Shkencave.

Veprimtaria shkencore:

Çabej u specializua në gjuhësinë krahasuese indo-evropiane. Veprimtarinë shkencore e shtjelloi në gjuhësi, por edhe jashtë saj, në folklor, etnografi dhe histori të letërsisë. Vend zënë studimet etimologjike dhe leksikologjike historike, dialektologjia e onomastikës, si edhe kodifikimi i gjuhës letrare. Çabej ka dhënë një ndihmë të çmuar me një varg sqarimesh etimologjike gjatë hartimit të Fjalorit të gjuhës shqipe, të botuar në Tiranë më 1980. Eqrem Çabej vdiq më 13 gusht 1980 në Romë të Italisë.

Tituj të veprave:

- “Fonetikë historike e gjuhës shqipe: hyrje në historinë e gjuhës shqipe II”
- “Diana dhe Zana”, 2011
- “Elemente të gjuhësisë dhe literaturës shqipe”, 2009
- “Hyrje në Indoeuropianistikë”, 2008
- “Sonete”, 2008; “Shqipja në Kapërcyell”, 2006
- “Studime gjuhësore I-IX”, Rilindja, Prishtinë, 1986
- “Studime etimologjike në fushë të shqipes”, Tiranë, 1976-2006 (I-1976); (II: A-B-1982); (III: C-D-1987); (IV: Dh-J-1996); (VI: N-Rr-2002); (VII: S-Zh-2006); (V: K-M. 2014)
- “Hyrja në historinë e gjuhës shqipe”. 'Fonetika historike e shqipes’, Rilindja, Prishtinë, 1970
- “Meshari i Gjon Buzukut (1555)”. Botim kritik. Pjesa e parë. Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë, 1968
- “Hyrja në historinë e gjuhës shqipe”. Pjesa e parë, Tiranë, 1958
- “Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes”
- “Fjalor i gjuhës shqipe” i vitit 1954, (Bashkautorësi)
- “Odiseu dhe Konstandini”. Etj.

ERMIRA YMERAJ



Prof. Dr. Ermira Ymeraj, u lind në qytetin e Shkodrës, më 18 dhjetor 1972. Njihet si studiuese në fushën e letërsisë, redaktore, korrektore autorësh të ndryshëm dhe poete. Studimet e larta i kreu në vitin 1995 për Gjuhë dhe Letërsi, në Universitetin, “Luigj Gurakuqi” në Shkodër. Studimet pasuniversitare në USHT, për letërsi, dhe në 2010 mbaroi studimet Master për “Etnokulturë dhe letërsi shqipe”, me temën “Ringjallja në epos”. Në vitin 2013 mbron titullin “Doktorë Shkence” në Fushën: Studime Letrare, Specialiteti: Letërsia dhe Baladat, me Tezë: “Balada si paratekst në letërsinë shqipe-vështrim krahasues ndërballkanik”, pranë QSA në Tiranë. Që nga viti 2010 e këtej, vazhdimisht shkruan, boton artikuj shkencor, merr pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, si zë serioz e argumentues në studimin e autorëve të ndryshëm dhe veprave të tyre letrare.

Libra të botuara:

1. “Shtegtimi i Miteve, nga religjioni e folklori, në letërsi”, monografi, studim, Shtëpia botuese “Naimi”, Tiranë, 2013
2. “Zemër diptike”, poezi, Shtëpia botuese “Naimi”, Tiranë, 2013
3. “Pirg dhimbjesh”, poezi, Shtëpia botuese “Naimi”, Tiranë, 2014
- 4 “Balada si paratekst në letërsinë shqipe, motivi i ringjalljes, flijimit e incestit”, studim krahasues ndërballkanik, Enti botues, 2015

Në fushën e arsimit, luan një rol të rëndësishëm. Në vitin 2003-2005, është certifikuar për: Mësuese e gjuhës dhe letërsi italiane, Projekti “Iliria”, MASH dhe Ambasada Italiane, Tiranë, 2004

Në vitin 2006, është certifikuar për: Edukimi për paqe e tolerancë, Fondacioni: Zgjidhja e konflikteve e mosmarrëveshjeve, Shkodër, 2006

Në vitin 2013, është certifikuar për: “Formimi i docentëve të shkollave të mesme në një perspektivë evropiane”, MASH. Roma Tre-Magis.

-2018-Bashkautore e Librit të Mësuesit, “Letërsi me zgjedhje 12”,

-2018-Bashkëpunëtoreshë në hartimit të “Udhëzues lëndor për lëndën: Gjuhë shqipe dhe letërsi”, AML, Klasa X-XI-XII dhe Letërsi me zgjedhje,

-2019-Bashkautorë në hartimin e librit shkollor: Letërsi 3, (libri i nxënësit, libri i mësuesit, fletorja e nxënësit) për Malin e Zi.

-Në vitin 2014, merr titullin “Qytetar nderi”, nga komuna Gruemirë e rrethit Malësi e Madhe.

-Ndërsa në vitin 2018 merr titullin “Ambasadore e Paqes”.

ERNEST KOLIQUI (1903-1975)



Ernest Koliqi, u lind më 20 maj 1903 në Shkodër, Pas mësimeve të para në Kolegjin Saverian të Jezuitëve, i ati e dërgoi për të studiuar në Itali në vitin 1918. Së pari në kolegjin jezuit "Cesare Arici" në Breshia dhe pastaj në Bergamo. Hapi gazetën "Noi giovani" ("Ne të rinjtë"), ku boton poezitë e para në italisht. Kthehet në Shqipëri pasi që gjendja futet në hulli pas Kongresit të Lushnjës, mëson shqipen dhe falë njohjes me Luigj Gurakuqin. Më 1921 mbahehet një konkurs për himnin kombëtar, ku Ernesti merr pjesë me një poezi, e cila fitoi çmimin e parë, të dhënë nga juria e përbërë prej Fishtës, Nolit, Frashërit e Gurakuqit.

Në mars-prill të po këtij viti merr pjesë si përfaqësues i shoqërisë kulturore "Rozafa", ku formoi grupimin "Ora e Maleve". Me ndihmen e Imzot Mjedës aderon në shoqërinë "Bashkimi" të themeluar prej të shuarit Avni Rrustemi, e drejtuar nga Zai Fundo.

Në atdhe nis punë si mësues në Shkollën Italiane Tregtare në Vlorë dhe mandej në Gjimnazin e Shkodrës (1930-'33), ku mes të tjerëve do t'iu jepte mësim Petro Markos dhe Lazër Radit.

Më 1933 jep dorëheqjen nga mësimdhënia për të nisur studimet universitare në Padova. Gjatë periudhës 1934-1936 ishte pjesëtar i grupit botues të të përkohshmes "Illyria" e Totos, ku do të botonte poemthin në prozë, "Quattor". Më 1937, doktoron në Padova. Më 1939, hapet në Universitetin Shtetëror të Romës Selia e Albanologjisë, ku Koliqi emërohet ordinar dhe qëndron i tillë derisa doli në pension.

Koliqi ishte mësues, poet, romancier, eseist, përkthyes, gazetar, dramaturg, ministër arsimit në qeverinë Vërlaci, botues dhe pedagog.

Sa i përket krijimtarisë letrare, bashkë me Mitrush Kutelin i lësohen si bashkëthemelues të tregimit modern shqiptar, ndërsa në punët politike e arsimore ka meritë të jashtëzakonshme për dërgimin e 200 arsimtarëve në trojet e Shqipërisë së Liriueme, konkretisht në Kosovë gjatë periudhës së Luftës së dytë Botërore.

Veprat:

Vepra e tij e parë qe poemthi dramatik, "Kushtrim i Skanderbegut", për të vazhduar pastaj me veprën tjetër poetike, "Symfonija e Shqipevet", "Kangjelet", kurse Koliqi vlera të larta në poezi tregon te "Gjurmata e Stinve", botuar më 1933.

Prozë:

Kulmin e vet letrar e arrin me librat e tregimeve “Hija e Maleve”, 1929 “Tregtar flamujsh”, 1935 dhe “Pasqyrat e Narçizit”, 1936. Me këta tituj u bë themeluesi i prozës moderne shqipe qoftë në nivel tematike, ashtu edhe stili. Më 1960 botoi romanin “Shija e bukës së mbrûme”.

Përkthime:

Më 1932 vëllimin e parë të antologjisë “Poetët e mëdhenj të Italisë”. Më 1935 boton vëllimin e dytë të antologjisë “Poetët e mëdhenj të Italisë”. Më 1961 nis të përkthejë “Lahutën e Malcís” në italisht, përkatësisht këngën XXVI, më tej më 1971 përktheu këngët XII-XIII-XIV dhe XV; dhe më 1973 vazhdon të përkthejë pjesë tjera të “Lahutës së Malcís”.

Publicistikë:

Qe themelues dhe drejtues revistash, ku botohej e trajtohej letërsia e kultura shqiptare si: “Ora e Maleve”, “Shkëndija”, “Shêjzat”, etj. Bashkëpunoi me revistat “Hylli i Dritës” e françeskanëve, “Leka” e jezuitëve, “Përpjekja shqiptare” e Branko Merxhanit, “Minerva”, “Besa” etj.

Studime:

- Nis të botojë nga viti 1954 deri më 1961, studimin krahasues “Dy shkollat letrare shkodrane: E Etënve jezuitë dhe e Etënve françeskanë”,
- Në Firenze boton vëllimin “Poesia populare albanese” “Poesia popullore shqiptare në vitin 1959,
- Vëllimin “Kangjelet e Rilindjes”, “I canti della Rinascita” edhe në italisht
- Studimin “Gabriele D’Annunzio e gli Albanesi”, (“Gabriel D’Anuncio dhe Shqiptarët”), në vitin 1963,
- Boton “Antologia della lirica albanese” (“Antologjia e lirikës shqiptare”),
- Në vitin 1965 del në dritë, “Albania”, një monografi italisht, botuar në “Enciclopedia dei popoli d’Europa”, në Milano.

Mirënjohje dhe Medalje:

Medalje ari e Shoqnis “Dante Aligheri”
Ylli i artë për Meritë të Shkollës
Akademik ordinar i Akademisë Tiberiane
Akademik Nderi i Akademisë Teatine të Kietit për Shkencat
Anëtar i Akademisë së Abrucit për Shkencat dhe Artet
Anëtar efektiv i Akademisë së Mesdheut
Anëtar Nderi i Qendrës Ndërkombëtare për Studimet shqiptare
Medalja e Artë e Lidhjes së Prizrenit në Kosovë, si dhe mirënjohje, shpërblime, dekorata, çmime e medalje tjera...

ESAD MEKULI (1916-1993)



Esad Mekuli, u lind në vitin 1916 në Plavë. Gjimnazin e kreu në Pejë në vitin 1936. Studioi veterinarinë në Beograd, ku u diplomua në fillim të vitit 1947. Specializoi parazitologjinë në Universitetin e Zagrebit më 1947 dhe 1948. U doktorua në Fakultetin e Veterinarisë në Beograd.

Ishte një nga redaktorët e fletores “Beogradski student”. Mori pjesë në aksionet studentore e demonstrata dhe u burgos, më 1940. Pas kësaj punoi veterinar ushtarak në Pejë. Më 1942, për shkak të punës në Lëvizjen Nacionalçlirimtare, u burgos. Më vonë iu bashkua aradheve partizane dhe një kohë punoi si mjek, e mandej anëtar i Agjitpropit dhe redaktor i gazetës ilegale “Lirija”.

Pas lufte u emërua kryeredaktor i fletores në gjuhën shqipe, Rilindja, kurse nga viti 1947 deri në vitin 1960 ishte shef i repartit parazitologjik të Institutit të Veterinarisë në Prishtinë.

Nga viti 1949 ishte kryeredaktor i revistës së parë letrare “Jeta e re”, të cilën e drejtoi për gati një çerek shekulli, e më vonë edhe kryeredaktor i revistës shkencore-profesionale bujqësore “Lajmëtari” (Glasnik).

Ishte kryeredaktor i revistës shkencore Biotehnika dhe kryeredaktor në Redaksinë e Enciklopedisë së Jugosllavisë në gjuhën shqipe.

Botoi njëmbëdhjetë punime shkencore-profesionale në revista jugosllave dhe të huaja, mandej dy libra dhe dy broshura nga shkenca e mjekësisë veterinare dhe rreth pesëdhjetë artikuj shkencorë-propagandistikë nëpër fletore e revista në gjuhën shqipe dhe serbokroate.

Me punën letrare filloi të merrej qysh në rininë e hershme, duke bashkëpunuar me revista të rinisë. Pas çlirimit botoi pesë përmbledhje poezish në gjuhën shqipe, gjashtë në gjuhën serbokroate dhe nga një në gjuhën maqedonase dhe turke, dhe përktheu më se tetëdhjetë libra.

Ka qenë kryetar i parë i Shoqatës së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Për veprimtarinë në fushën kulturore dhe letrare mori, më 1950, Shpërblimin e Qeverisë të RP të Serbisë, mandej atë të Bashkësisë Kulturoarsimore të KAKM dhe Shpërblimin e Nëntorit të Prishtinës.

Për punën në fushën e përkthimeve iu dha Shpërblimi i Dhjetorit të KSA të Kosovës dhe Shpërblimi i SGB “Rilindja”; po ashtu u shpërblye me Diplomën e Nderit të Lidhjes së Shoqatave të Përkthyesve të Jugosllavisë për meritat në afirmimin e bashkëpunimit ndërrepublikan.

Në vitin 1971 mori Çmimin AVNOJ për letërsi dhe Çmimin e 13 Korrikut të Malit të Zi, në vitin 1974.

Ishte anëtar i Këshillit të Kosovës dhe i Këshillit të Federatës.

Vdiq në Prishtinë në vitin 1993.

Libra të botuar:

- "Për ty", vjersha, Prishtinë, 1955;
- "Dita e re", vjersha, Prishtinë, 1966 dhe Shkup, 1977;
- "Avsha ada", vjersha, Prishtinë, 1971;
- "Vjersha", Prishtinë, 1973;
- "Brigjet", vjersha, Prishtinë, 1981;
- "Rini e kuqe", vjersha, Prishtinë, 1983;
- "Na putu, pesme", Bagdala, Krushevac, 1964;
- "Izmedju voleti i mrzeti", vjersha, Svjetlost, Sarajevë, 1970;
- "Glasovi vremena", vjersha, Beograd 1974 dhe Gornji Milanovac 1980;
- "Avsha ada", vjersha, Jedinstvo, Prishtinë, 1975;
- "Pjesme", izbor i prevod Lj. Rusi, Shkup, 1975;
- "Iki Kiyi (turqisht), vjersha, zgjedhja dhe përkthimi N. Zekerija, Prishtinë - Stamboll, 1983.

Përkthime në gjuhë shqipe:

- B. Qopiqi: Patroloxhija, poemë, botuar si libër, por nuk është ruajtur, Prizren, 1944;
- V. Majakovski: Lexo e gjezdis Kinë e Paris, poemë (me M. Krasniqin), Prishtinë, 1948;
- A. S. Pushkini: Përralla mbi gjelin e artë (me M. Krasniqin), Prishtinë, 1949;
- P. Voranci: Lulet e Shëngjergjit, tregime, Prishtinë, 1951;
- I. A. Krillovi: Përralla, Prishtinë, 1952.

Punime origjinale:

- "Shafrani-lajmëtar i pranverës", poezi në prozë, Rilindja, 1985;
- "Dashunia ime", Zëri i rinisë, 1985;
- "Lutje mëngjezore", Zëri i rinisë, 1985;
- "Prijs dhe mësues i popujve tanë", prozë poetike, ZR, 10-4, 1985;
- "Liria-dritë që nuk shuhet", vargje, Rilindja, më 25.V.1985.

Esad Mekuli, përveç veprave të tij origjinale u mor edhe me përkthime në gjuhën shqipe dhe atë serbokroate, si dhe me përkthime tjera si: romane, tregime, novela, poezi etj, të cilat i botoi në revista dhe në gazetat e kohës. Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës, në shenjë respekti për Mekulin, organizon: Takimi letrar "Esad Mekuli".

ESAT STAVILECI (1942-2015)



Prof. Dr. Esat Stavileci, u lind në Gjakovë më 1942. Aty kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Studimet e rregullta i ndoqi në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, të cilat i përfundoi më 1965 dhe u zgjodh asistent për lëndët juridike-administrative, ndërkohë regjistroi dhe vijoi studimet pasuniversitare në Fakultetin Juridik të Universitetit të Zagrebit dhe në Fakultetin Ndërkombëtar për Studime të Larta të së Drejtës Krahasimore në Strasburg të Francës, ku u laуреа magjistër i shkencave juridike-administrative, specialist për të drejtën krahasimore, pasi kreu katër semestra studimorë në Francë, Itali, Holandë dhe Venezuelë.

Doktor i shkencave juridike u promovua në Fakultetin Juridik të Universitetit të Sarajevës, më 1974. Prej vitit 1965 punoi në Fakultetin Juridik të Prishtinës, ku në vitin 1979 ishte zgjedhur profesor ordinar. Pas pensionimit më 2007, ishte i angazhuar në Programin Studimor Master në lëndën Të menduarit dhe të Shkruarit Juridik. Ishte anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (2000).

Ishte zëvendësdekan, shef i Katedrës së Shkencave Juridike-Administrative, drejtor i studimeve pasuniversitare në Fakultetin Juridik, drejtor i Entit për Kërkime Juridike, kryeredaktor i revistave shkencore: “Përparimi” dhe “E Drejta” (Pravo), kryetar i Shoqatës Krahinore për Teori dhe Praktikë Administrative, kryetar i Shoqatës së Pavarur të Juristëve të Kosovës dhe themelues i organit të saj “Vjetari”, etj. Përveç që mbajti leksione në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, u angazhua si profesor edhe në Degën e Historisë të Fakultetit Filozofik të Prishtinës dhe në Fakultetin Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës, në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, në Universitetin e Tiranës, Universitetin e Sofjes, të Jenës dhe në Universitetin Amerikan në Blagoevgrad.

Titujt e publikuar:

“Përgjegjësia politike e titullarëve të funksioneve publike dhe vetëqeverisëse”, 1978;

“E drejta administrative”, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 1981;


“Administrata në shoqërinë vetëqeverisëse”, Prishtinë, 1985;

“Elemente të së drejtës administrative”, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 1985;

“Hyrje në shkencat administrative”, Prishtinë, 1997;

“Fjalor shpjegues i termave administrative”, Prishtinë, 2010, etj.

ESAT LOSHAJ



Esat Loshaj, është i lindur në vitin 1954, në fshatin Carrabreg i Epërm të Deçanit.

Prej vitit 1975 jeton në Pejë. Studimet për Letërsi dhe gjuhë Shqipe i kreu në Universitetin e Prishtinës, është autor i katër veprave letrare si dhe shumë shkrimeve eseistike të botuara në revista letrare dhe gazeta ditore. Është marr edhe më aktrim.

Esat Loshaj, është kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve në Pejë, si dhe organizator i shkëlqyer i konkursit tradicional ndërkombëtar; “Shlezën Zhubi”, i “Pejës Poetike”. Plotë 40 vjetë u morr me gazetari, eseistikë, kritikë letrare, recensione librash, redakturë, aktrim, regji, takime letrare, si dhe më organizimin tradicional letrar “Flaka e janarit”.

Esat Loshaj, në vitin 1995 ka bërë regjinë e dramës “Takimi i ores 9 të mbrëmjes” të Ernest Koliqit. Kjo shfaqja ka marrë pjesë në festivalin e teatrove amatore në Prishtinë dhe është shpërblyer me mirënjohje, dhe më çmim për aktoren më të mire znj. Rudina Zhara për rolin kryesor e cila tashmë është aktore profesioniste.

Më iniciativen e zt. Esat Losha, në vitin 2000, është bërë lirimi i Teatrit të Qytetit të Pejës, i cili ishte i uzurpuar nga KFOR-i spanjoll. Teatri profesionist i qytetit “Istref Begolli” në vitin 2008 i ka dhënë mirënjohje për kontributin e tij në zhvillimin dhe afirmimin e teatrit të Pejës.

Esati si bome i poezisë shqipe në Kosovë tash e disa vjet i tubon poetët mbarëkombëtar aty ku frymohet e flasim Shqip.

Aty ku dëgjohet me kënaqësi fryma e njëri tjetrit, fryma poetike. Kjo frymë poetike vjen çdo vjet me një nivel të lartë, e të pjekur, nga një rrugë e gjatë, por e bukur.

Nuk mund të dallojmë njërën nga tjetra, të gjitha bartin me vete vlerat e tyre që kurorëzohen çdo vjet në aktivitetet e "Pejës Poetike". Dhe, poetet në krye me Esatin, ditën e kishin përpara e natën në mes, ndaj fjala e artë e tyre, çdo herë ka kumbuar pa droje,... ajo ishte magjepse, e sinqertë me plot dashuri e mirësi për jetën, familjen atdheun dhe kombin.

Veprat e botuara :

1. "Qendresë", Lidhja e Shkrimtarëve e Shqipërisë, Tiranë, 1993.
2. "Me diellin në duar", Medaur, Tiranë, 1999.
3. "Sytë e ditës", Rilindja, Prishtinë, 2000.
4. "Lisnaja e gurit", Shoqata e Shkrimtarëve e Pejës, Pejë, 2010.

ESHREF YMERI



Prof. Dr. Eshref Ymeri Ph.D, u lind me datën 25.12. 1938, në Smokthinë të Vlorës. Eshrefi është një personalitet dhe individualitet i veçantë i kulturës kombëtare, një erudit, që ka dhënë vlera të pakontestueshme në fushën e gjuhësisë, të përkthimeve dhe të publicistikës. Ai është autor dhe bashkëkohor, që ka vënë një gur të rëndë në kolonën e artë të kulturës kombëtare.

Prof.dr. Eshref Hasan Ymeri, është “Mjeshtër i Madh” për lexuesin e gjerë. Ai e ka quajtur veten gjithmonë nxënës. Gjithë jeta e tij është shkollë.

Eshrefi u rrit dhe u edukua me atdhedashuri, pasi në formimin e tij ndikuan, jo vetëm prindërit dhe familja, por edhe dëshira për njohje dhe dije.

Nga viti, 1947-1955, Eshrefi kreu arsimin 7-vjeçar në Smokthinë. Më, 1959 përfundoi gjimnazin në Vlorë. Nga viti 1959-1961 ishte student në Shën Petërburg. Kurse nga viti 1962-1966, përfundon studimet e larta për gjuhë dhe letërsi ruse në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë në Universitetin e Tiranës.

Deri në vitin 1977, ka qenë Pedagog i gjuhës ruse në Fakultetin e historisë dhe të filologjisë në Universitetin e Tiranës.

Prej 17 majit deri më 10 tetor të vitit 1975, e dërguan me shërbim në Pekin-Kinë, ku, ndoqi nga afër botimin në gjuhën ruse prej 1000 faqesh të vëllimit II të veprave të zgjedhura të Enver Hoxhës.

Prej shtator 1977 deri në mars 1979, qëndron pa punë, pasi që e kishin transferuan padrejtësisht në Kukës. Ndërkohë, punon si përkthyes i jashtëm i gjuhës ruse pranë SHB “8 Nëntori”.

Nga viti 1979-1981 kalon përkthyes efektiv në SHB. “8 Nëntori”. Prej gushtit 1981-tetor 1989 ishte shef i Redaksisë së botimeve në gjuhë të huaja në SHB. “8 Nëntori”, ku vazhdoi deri në vitin 1991.

Prej vitit 1992-2003 ishte Pedagog në Universitetin e Tiranës. Ndërsa më 1 shtator 2003 doli në pension. Dalja në pension për gjuhëtarin Ymeri, ishte nisma e një beteje studimore, të cilën e ka kryer me sukses.

Universiteti në Tiranë, në kuadrin e programit TEMPUS, më 2 dhjetor 2001, e përfshiu Eshref Ymerin në një grup pedagogësh të përkthimit nga gjuhë të ndryshme (anglishtja, frëngjishtja, gjermanishtja dhe italishtja), të cilët i dërgoi në Britaninë e Madhe, pranë Universitetit të Uestminsterit, ku qëndruan një javë për shkëmbim përvoja në fushën e përkthimit.

Aktiviteti pedagogjiko-shkencor konsiston në hartimin dhe botimin e shtatë (7) teksteve mësimore prej 1968-2002, të cilët u vijnë në ndihmë studentëve të katedrës së gjuhës ruse.

Ka dhënë lëndën e gjuhës ruse në të katër kurset e gjuhës ruse, gramatikën, analizën e tekstit, si dhe ka zhvilluar kurse leksionesh, si në stilistikë, gjuhësi, letërsi ruse dhe në përkthim.

Ka botuar artikuj metodiko-shkencorë dhe shkencorë në gazetën “Mësuesi”, në revistën “Studime filologjike” dhe “Gjuha jonë” gjatë viteve 1970-1980.

Gjatë viteve 1978-1990, ka përkthyer 3200 faqe letërsi politike nga gjuha shqipe në gjuhën ruse.

Prej vitit 1998 e në vazhdim, ka përkthyer e botuar vepra letrare-artistike të shkrimtarëve të ndryshëm: Aleksej Prijma, F.M. Dostojevski, (6 libra), Italo Kalvino, Nikollaj Kolada, Ludmilla Razumovskaj, Zheni Kostandinova, Zhorzh Amadu, Kobo Abe, Leonid Grossman.

Përkthime nga shqipja në rusisht:

“Porta Eva”. Skenar filmi, prodhim shqiptaro-rus.

“Ky është profeti Muhamed, i dërguari i Zotit për mbarë njerëzimin”, përgatiti për botim dhe botoi Instituti shqiptar i mendimit dhe i qytetërimit islam, Tiranë, 2008.

Bashkautorë i disa Fjalorëve:

“Fjalor i termave të mbrojtjes kundërajrore”, (me bashkautorë, 1990).

“Fjalor frazeologjik italisht-shqip”, (me bashkautorë, 1997).

“Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe”, (me bashkautorë, 2002).

“Fjalor i madh frazeologjik italisht-shqip”, (me bashkautorë, 2007).

“Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe”, (i pasuruar dhe i ripunuar, me bashkautorë), Tiranë, 2007.

“Fjalor frazeologjik rusisht-shqip”, me 25160 shprehje frazeologjike, botuar në vitin 2015.

Redaktor i dy fjalorëve, rusisht-shqip dhe shqip-rusisht.

Prej vitit 1991 dhe deri tani ka botuar 1237 artikuj publicistikë në mbrojtje të çështjes kombëtare, veçanërisht në mbrojtje të çështjes kombëtare të Kosovës, të Çamërisë, të popullit shqiptarë në Maqedoni, kundër qëndrimeve shoviniste të grekosllavizmit dhe sidomos kundër politikës shoviniste rusomadhe në raport me kombin shqiptar, kundër pushtimit të kishës sonë ortodokse nga kisha shoviniste greke, si dhe shumë artikuj tjerë të publikuar nga pena e Prof. Dr. Eshref Ymerit.

Vend të veçantë zënë edhe artikujt e tij kritikë, me vlerësime për vepra artistike të autorëve të ndryshëm.

Krahas intelektualëve të tjerë nacionalistë, ka ngritur zërin e tij të fuqishëm për ribashkimin e trojeve tona etnike.

Në publicistikën e tij kanë bien në sy të lexuesve edhe artikuj me tema shoqërore apo edhe artikuj polemikë.

Botimet:

“Shqipëria në dokumentet e arkivave ruse” (me bashkautor, 2006).

“Antologjia e kryqëzimit: Rusia dhe çështja shqiptare 1878-2012” (me bashkautor 2012).

“Përkthimi, një histori pasioni”, 2015.

“Arti i përkthimit gojor”, 2018.

“Fjalori Frazeologjik Anglisht-Shqip”, me 1254 faqe dhe me 25.440 shprehje frazeologjike, Tiranë, 2019, (një Monument në fondin e artë të kulturës kombëtare).

Gjuhën shqipe kam NËNË DHE BABË!” Eshref Ymeri

Kualifikimi shkencor:

Më, 16 dhjetor 1989 merr gradën shkencore “Kandidat i Shkencave”;
Grada “Kandidat i Shkencave”,

Më datë 30 qershor 1993, merr gradën shkencore, “Doktor”;

Më 13 dhjetor 1994 merr titullin “Asistent Profesor;

Më 11 maj 2001 merr titullin “Profesor”.

Vlerësimi -I-:

Shoqata kulturore atdhetare “Labëria”, me Kryetar Prof. dr. Ago Nezha dhe Sekretar Xhemil Çeli, me vendim të Forumit të saj, të datës 31 mars 2013, Prof. Dr. Eshref Ymeri e ka nderuar me Diplomën

“Personalitet i shquar i Labërisë”, me motivacionin:

“Profesor doktor, gjuhëtar i shquar, me kontribut të çmuar në zhvillimin e gjuhës shqipe dhe njohjen e saj në rrethe të larta intelektuale në Evropë dhe në SHBA. Një nga bijtë e Labërisë, që me veprën, jetën e sjelljen e tij nderon trevën e lindjes dhe mbarë kombin shqiptar”

Vlerësimi -II-:

Me propozim të Bordit dhe të Senatit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve Shqiptaro-Amerikane, Nju Jork, Prishtinë, Tiranë, Shkup, më datën 27 prill 2017 është pranuar anëtar i kësaj Akademie, me titullin e lartë shkencor Akademik në AAAS në New York.

Prof. Dr. Eshref Ymeri konsiderohet si ikona e artit të përkthimit.

FADIL MALOKU



Fadil Maloku, u lind më 6 prill 1958 në Besianë. Studimet bazike (katërvjeçare) i kreu në Universitetin e Prishtinës, në Departamentin Filozofi-Sociologji, 1984-1986. Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Zagrebit në Departamentin për Sociologji, të Fakultetit Filozofik. Studimet e doktoratës (PhD) i kreu me sukses në Universitetin e Prishtinës 2000-2003.

Prof. Dr. Maloku është Profesor i Sociologjisë së Integrimi dhe Globalizimit, Krimi dhe Devijimi Social, Hyrje në Komunikimin Politik (UP, Departamenti i Gazetarisë), Kultura dhe Politika (niveli mastër, në Universitetin Shtetëror të Tiranës), Në Universitetin “Hasan Prishtina”, të Prishtinës (Departamenti i Sociologjisë). Mësimdhënës në lëndët: Metodot Hulumtimit Empirik, (bachelor); Metodot Kuantitative (bachelor); Sociologji e Globalizimit (bachelor); Transformimeve Globale, (bachelor); Krimi dhe Devijimi Social, (bachelor); Kultura dhe Politika (master-Dep. i Shkencave Sociale ne Tirane); Hyrje në komunikimi Politik (doktoratë- Dep. Gazetari në Prishtinë); Metodologji Shkencore (doktoratë -Dep.Sociologji në Prishtinë); Transformimet Globale (doktoratë -Dep. Sociologji në Prishtinë).

Ligjërues në Kolegjin “Victory”, në Departamentin e Shkencave Politike, (niveli: Bachelor dhe Mostër, Lënda: Metodologjia e Kërkimit Shkencor, Kultura dhe Politika e Diplomacisë globale); Ligjërues në Universitetin Shtetërorë të Tiranës, 2013-2014; Në Fakultetin e Shkencave Sociale, Departamenti i Filozofisë, (niveli Mostër, Lënda: Kultura dhe Politika); Ligjërues i lëndës: Hyrje në Komunikimin Politik në Departamentin e Gazetarisë, për Doktorantët e vitit 2015-2016; Ligjërues i dy lëndëve: Metodologji Shkencore dhe Transformimet Globale, në Departamentin e Sociologjisë, për Doktorantët e vitit 2016-2017; Ligjërues i lëndës, Hyrje në Komunikimin Politik në Departamentin e Gazetarisë, për Doktorantët e vitit 2016-2017.

Botimet:

1. “Veç Zoti na shpëtoi”, (ditar eseistike-sociologjik), Shtëpia Botuese, “Gjurmët”, Prishtinë, 2009.
2. “Refleksioni sociologjike mbi Islamit”, “Zëri Ynë”, Prishtinë, 2011,
3. Tekst Universitar: “Refleksione Sociologjike mbi shtetësinë dhe raportet ndëretnike”, “Zëri Ynë”, Tiranë, 2011,

4. Tekst Universitar: “Refleksione Sociologjike mbi joviolencën dhe zgjedhjet”, Shtëpia Botuese, “Zëri Ynë” Tiranë, 2011,
5. Tekst Universitar: “Paradigmat Sociologjike të tranzicionit shqiptar”, Shtëpia Botuese, Logos, 2014,
6. Tekst Universitar: “Globalizmi, Integrimi dhe identiteti i Kosovës”, Shtëpia Botuese, Logos, 2017.

Publikimet në Revista vendore dhe ndërkombëtare:

- Cilat janë mundësitë e anëtarësimit të Kosovës në BE?, PAQJA, Reviste shkencore, nr.14, Janar 2007 (Analizë Sociologjike), Prishtinë.
- Revista OPTIME, (Botim i Institutit të Kërkimeve Shkencore dhe i Zhvillimit të Albanian University),
Simpozium: Këndvështrimi i Intelektualeve të Kosovës për Lëvizjen “Gylen”, Botim i Shtëpisë Botuese “Atmosfera”, Prizren.
- Simpozium: Domosdoshmëria e Dialogut ndërfaqetor e ndërkulturor për Paqen Botërore.
- “Globalizimi dhe dialogu ndërkulturor” (Analizë Sociologjike e aspekteve të religjioneve monoteiste në kushtet e globalizimit), 28 Maj 2008, Tiranë.
- Globalizimi, çështja e shtetit dhe Kosova, “ALTERNATIVA”, Revistë për Kulturë dhe Shkencë 2009.
- Globalizmi, globalizimi dhe globaliteti, Revista Kërkimore, MEDIA, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Dega e Gazetarisë, 2011,
- Dukuri të globalizimit në këndvështrime teorike, Botimi i Departamentit të Sociologjisë, Universiteti i Tiranës, Vëllimi II, Nr.1-2012,
- Revista (e përmuajshme mbarëkombëtare politike, ekonomike dhe kulturore, Viti III, nr. 26, Qershor 2013
- Revista mujore, fetare, shkencore e kulturore (Dituria Islame), Numër 305, viti 29 Shkurt 2016.
- Revista e përmuajshme mbarëkombëtare politike, ekonomike dhe kulturore, Viti IV, nr. 59, Mars 2016,
- Revista e përmuajshme mbarëkombëtare politike, ekonomike dhe kulturore, Viti IV, nr. 59, Mars 2016,
- Revista e përmuajshme mbarëkombëtare politike, ekonomike dhe kulturore, Viti IV, nr. 60, Prill 2016,
- Revista e përmuajshme mbarëkombëtare politike, ekonomike dhe kulturore, Viti IV, nr. 60, Korrik 2017, etj.

FADIL SULEJMANI (1940-2013)



Prof. Dr. Fadil Sulejmani, u lind në vitin 1940 në katundin Bozovcë të Malësisë së Sharrit të Tetovës. Arsimin fillor e kreu në vendlindje dhe në qytetin e Tetovës, kurse shkollën e mesme e kreu gjithashtu në Tetovë. Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prizren, ndërsa Fakultetin Filozofik, Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe e kreu në Prishtinë. Studimet pasuniversitare të magjistraturës i kreu në Beograd, kurse ato të doktoraturës me sukses i mbaroi në Universitetin e Prishtinës.

Ka punuar fillimisht arsimtar i gjuhës dhe letërsisë shqipe, në Obiliq të Prishtinës, dhe 2 vjet ka qenë profesor i gjuhës latine në Gjimnazin e Mitrovicës. Në vitin 1971 e filloi punën mësimdhënës i rregullt i lëndëve Morfologji dhe Fonetikë e gjuhës shqipe, në degën Gjuhë dhe Letërsi Shqipe të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku punoi deri në vitin 1993. Në vitin 1995, Fadil Sulejmani u zgjodh e profesor i rregullt i shkencave të filologjisë në këtë universitet.

Formimin e tij akademik e vijoi me 2 vjet specializim, si bursist i Fondacionit “Aleksandër Humboldt”, në Bon të Gjermanisë, si dhe 1 vit në Itali. Në vitin 1990, me fillimin e proceseve demokratike, u kthye nga Prishtina në Tetovë, ku angazhohet në aksionin e madh popullor për Pajtimin e gjaqeve.

Në vitin 1990, me themelimin e Bashkësisë Kulturore Shqiptare në Maqedoni, me seli në Tetovë, Këshilli nismëtar ia besoi detyrën e kryetarit të kësaj organizate, të cilën e ushtroi deri në muajin gusht të vitit 1991.

Gjatë 1991, bashkë me punonjës të tjerë shkencorë, intelektualë dhe përfaqësues të asociacioneve shqiptare në Maqedoni, u angazhua për organizimin e Simpoziumit shkencor, “Shqiptarët e Maqedonisë”.

Më 1994, bashkë me intelektualë të tjerë ka qenë njëri ndër nismëtarët e themelimit të Universitetit të Tetovës. Më 4 qershor, u emërua anëtar i Kryesisë së Universitetit, ndërsa më vonë, më 8 janar 1995 u zgjodh Rektori i parë i Universitetit të Tetovës, detyrë që e ushtroi gjatë dy mandateve, deri në vitin 2002.

Për këto aktivitete, pushteti i asaj kohe në Maqedoni e ndoqi, e keqtrajtoi shumë herë bashkë me familjen e tij dhe e dënoi me 2 vjet heqje lirie, ndërsa dënimin me burg e vuajti në kohëzgjatje prej afër një viti.

Profesor Fadil Sulejmani është nderuar me disa çmime nga Universiteti Shtetëror i Tetovës.

Përveç titullit “Rektor Nderi i Universitetit të Tetovës”, akorduar nga Senati i këtij Universiteti, më 25 nëntor 2002, ai u nderua edhe me çmimin “Nderi i Universitetit të Tetovës”, më 17 dhjetor 2002.

Në 18 vjetorin e themelimit, më 17 dhjetor 2012, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Rektorit të Parë, Prof. dr. Fadil Sulejmanit i ndau titullin: Doktor nderi i shkencave (Doctor honoris causa) i Universitetit Shtetëror të Tetovës.

Profesor Fadil Sulejmani është autor i mbi 10 veprave shkencore dhe më tepër se 200 artikujve të publikuar në periodikë të ndryshëm dhe revista shkencore.

Veprat:

„E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës”, një monografi për jetën dhe veprën e këtij autori arbëresh, Prishtinë 1979;

„Praktikumi i Gjuhës së Sotme Shqipe”, Prishtinë 1981, 1984,

„Lindja, martesja dhe vdekja në Malësitë e Tetovës”, monografi;

„Njohuri për Gjermaninë dhe popullin e saj”, 1995;

“Fonetika e gjuhës gjermane”, 1995; “Morfologjia e gjuhës gjermane”, e botuar në vitin 1995;

“Hapi historik i universitetit tonë”, 1994. etj.

Profesor Fadili ka lënë gati për shtyp disa libra:

“E folmja e Malësisë së Sharrit”, e cila ka qenë edhe temë e disertacionit të doktoratës së tij.

“Toponimia e tri malësive të Tetovës”, u botua pas vdekjes së tij, më 2016.

“Lojërat popullore në Malësitë e Tetovës”; “Sintaksa e gjuhës gjermane”,

Profesor Fadil Sulejmani ka dhënë kontribut të rëndësishëm në fushën e fonetikës dhe të drejtshkrimit, të gramatikës dhe të leksikologjisë, të dialektologjisë dhe të etnologjisë. Janë me qindra artikuj të publikuar ku i trajtoi këto çështje.

Në fushën e dialektologjisë dhe të leksikologjisë mund të përmendim artikujt si:

„Dukuritë fonetike në të folmen e Malësisë së Sharrit”,

„Terminologjia bimore dhe shtazore në të folmen e Malësisë së Sharrit të Tetovës”,

„Leksiku blegtoral nga e folmja e Malësisë së Sharrit të Tetovës”, etj.

Prof. dr. Fadil Sulejmani ndërroi jetë më 11 shkurt 2013.

FAIK BALLANCA (1945-1977)



Faik Ballanca ishte një gazetar dhe shkrimtar i njohur dibran. U lind në vitin 1945, në Tiranë, në një familje intelektuale të ardhur nga Dibra e Madhe. Pasi kreu gjimnazin dhe mbaroi Fakultetin Histori-Filologji dega e Gazetarisë, ai punoi si gazetar dhe redaktor në gazetën “Zëri i Rinisë” dhe në revistën letrare “Nëntori”.

Që nga viti 1962, nisi të botonte tregimet e para, përkthente dhe botonte prozë nga gjermanishtja, italishtja e frëngjishtja.

Edhe pse e ndërpreu krijimtarinë letrare në moshë të re, ai arriti të krijonte individualitetin e veçantë si shkrimtar i vërtetë, në saje të kulturës së gjerë, punës së tij profesionale, intuitës së hollë artistike dhe skrupulozitetit krijues.

Ndërroi jetë në vitin 1977, në moshë fare të re.

Botimet:

1. “Rrëmbimi”, tregime dhe reportazhe, Tiranë, 1970
2. “Mbasdite të lagura”, Tiranë, 1971
3. “Katër orë larg shtëpisë, i fundit Shtigjet me helm”, novela, 1972
4. “Letra anonime”, novelë e tregime, Tiranë, 1973
5. “Pritësit e rrufeve”, tregime, Tiranë, 1975
6. “Tregime të zgjedhura”, Tiranë, 1976.

Pas vdekjes së tij janë botuar këto vepra:

1. “Nomeja e largët”, roman, Tiranë, 1998, ribotuar më 2015
2. “Kënga e fundit e Marko Boçarit”, novelë, Tiranë, 2002
3. “Mbama pak pallton, çun”, tregime të zgjedhura, Tiranë, 2003.

Faik Ballanca e pati të shkurtër kohën e krijimtarisë, ashtu siç e patën Lermontovi, Migjeni, Veli Stafa apo Drago Siliqi.

Nga kjo anë, e fundit të dhimbshëm të jetës së shkurtër, megjithëse në rrethana të ndryshme shoqërore, ai u shëmbëllen në fatin tragjik këtyre shkrimtarëve, që nuk i dhanë dot të gjitha ato që mund të jepnin.

Shkrimtari Faik Ballanca, edhe pse ndërroi jetë në moshë të re, atij përveç 6 veprave të botuara nga viti 1970 deri në vitin 1976, iu kanë botuar e ribotuar edhe një roman, një novelë dhe një me tregime të zgjedhura.

Megjithatë, ky i dashuruar i marrë i librave, la një trashëgimi të vyer letrare, që përcjell te njerëzit një kënaqësi të vërtetë estetike edhe sot e kësaj dite. Lexuesi e njeh Faik Ballancën përmes veprave letrare...

FAIK KONICA (1876-1942)



Faik Konica, u lind më 15 mars të vitit 1876 në Konicë dhe vdiq më 14 dhjetor të vitit 1942, në Uashington. Ishte magjistër i artit dhe letërsisë, aktivist kombëtar dhe shkrimtar shqiptar.

Mësimet e para i mori në vendlindje, në gjuhën turke, arabe dhe greke. Mësoi në Shkodër, Kostatinopojë, Francë dhe SHBA.

Fliste frëngjishte të kulluar. Më vonë hyri në liceun perandorak francez të Stambollit për të kryer pastaj shkollën e mesme në Francë. Ndoqi studimet për filozofi në Dizhon dhe Paris.

Më 1912 u diplomua për letërsi, në universitetin e Harvardit të SHBA-së. U nderua me çmime për aftësitë e tij intelektuale jo të zakonata.

Faik Konica qysh i ri e lidhi jetën me veprën e tij dhe me lëvizjen kombëtare shqiptare. Pasi boton broshurën "Shqipëria dhe turqit" (1895) në Paris, ai vendoset në Bruksel (Belgjikë), ku nxjerr revistën "Albania", kjo revistë politiko-kulturore dhe letrare, u bë organi më i rëndësishëm e më me autoritet i Rilindjes sonë.

Më 1909 Konica, nga Londra shkon në SHBA, ku drejton gazetën "Dielli" edhe më pas gazetën "Trumpeta e Krujës". Me themelimin e Federatës "Vatra", më 1912 ai zgjidhet sekretar i përgjithshëm i saj.

Në kongresin shqiptar të Triestës (1913, Konica u zgjodh kryetar. Në 1921 u kthye në SHBA, ku u zgjodh kryetar i Federatës "Vatra".

Me dështimin e Revolucionit Demokratik, me ardhjen e Ahmet Zogut në fuqi, Konica u emërua ministër fuqiplotë i Shqipërisë në SHBA. Konica ishte një pianist, prozator dhe poet, publicist dhe eseist, kritik letrar dhe përkthyes.

Publicistikë:

Veprimtarinë e tij publicistike e letrare Faik Konica e zhvilloi kryesisht në shtyp, në revistën "Albania" ai botoi vjersha, proza poetike, skica, tregime, portrete, ese, artikuj të ndryshëm etj. Përgatiti dhe përmbledhjen letrare "Kandili i kuq", por nuk mundi ta botojë. Në të vërtetë nga Konica nuk kemi asnjë libër të botuar, me përjashtim të vëllimit me përralla, të përkthyer; "Nën hijen e hurmave" (1924). Krijimtaria e tij ka mbetur e shpërndarë në shtypin e kohës dhe një pjesë është e pa përfunduar. Prej tyre duhen veçuar si vepra të rëndësishme proza e gjatë satirike, "Doktor Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurasit", cikli i tregimeve

"Katër përralla nga Zullulandi", udhëpërshkrimi "Shqipëria si m`u duk". Ai la në dorëshkrim, anglisht, veprën "Shqipëria-kopshti shkëmbor i Evropës juglindore" dhe ese të tjera, e cila u botua pas vdekjes (1957).

Në trashëgiminë e Konicës vendin kryesor e zë publicistika. Ai paraqitet si një nga themeluesit dhe mjeshtrit e publicistikës shqiptare. Për afro gjysmë shekulli ai shkroi me qindra artikuj, pamflete, polemika, shënime, ese etj., të cilat i botoi në organet që drejtonte vetë. Tema qendrore e publicistikës së Konicës në revistën "Albania" do të jetë ajo atdhetare, problemet e lëvizjes kombëtare, fati i Shqipërisë dhe rrugët për çlirimin kombëtar. Nga ana tjetër, ai do t`i kushtojë vëmendje të posaçme ndriçimit të historisë së popullit shqiptar, zbulimit dhe propagandimit të vlerave të tij etno-kulturore, e veçanërisht krijimit të një gjuhe letrare shqipe.

Veprat:

- "Doktor Gjilpëra", (prozë satirike);
- "Katër përralla nga Zullulandi", (cikël tregimesh);
- "Shqipëria si m`u duk", (udhëpërshkrim);
- "Shqipëria-kopshti shkëmbor i Evropës juglindore", (dorëshkrim anglisht i veprës).

Prozë:

- Në faqet e revistës "Albania", botoi vjershat: "Gjuha jonë", "Flamuri", "Kushtrimi ose Marsejeza e shqiptarëve".
- "Një liqen", "Anës liqenit", "Bora", "Malli i mëmëdheut", etj.
- Prozës së shkurtër të F. Konicës i takojnë dhe disa skica letrare dhe rrëfenjëza që ai i quan përralla si "Urika", "Në dritë të hënës", "Ai që ishte gati të vdesë për Shqipërinë" etj.
- Me tematikë atdhetare ose përrallat "E bija e mbretit dhe trëndafilat", "I urti i malit", etj. shkrime këto plot fantazi nga bota e legjendave.
- Në trajtë esesh Konica ka shkruar veprën "Shqipëria-kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore".
- Ai shkroi një varg artikujsh teorikë letrarë si "Arti i të shkruarit", "Ca këshilla për artin e shkrimit", "Kohëtore letrare shqipe", etj.
- Pra, Faik Konica është i pari që lëvroi në prozën tonë esenë, një lloj letrare-publicistike.
- Të njohura janë dhe vjersha satirike, "Anadollaku" dhe lirika, "Helena e Trojës".

FARUK BEGOLLI (1944-2007)



Prof. Faruk Begolli, u lind në Pejë, më 14 shkurt 1944, i biri i kryebashkiakut Sefedin bej Begollit dhe Elmazes së Jashar Pashës.

Studioi në Akademinë e Filmit dhe Teatrit në Beograd dhe diplomoi në vitin 1966.

Faruk Begolli ishte gjithashtu një figurë e rëndësishme e Teatrit Kombëtar dhe Kinematografisë Kosovare. Ishte bashkëthemelues i degës së Aktrimit të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës, ku edhe punoi si pedagog i lëndës së aktrimit.

Në vitet e 90-ta ai së bashku me Enver Petrovcin, themeluan teatrin "Dodona" në Prishtinë. Në këtë teatër ai angazhonte studentët e tij dhe aktorë të tjerë, duke inskenuar shfaqje të ndryshme teatrale. Teatri "Dodona" u bë teatri më i njohur në Kosovë gjatë këtyre viteve duke vazhduar edhe deri në ditët e sotme.

Para se të bëhej aktor ka nisur studimet në Beograd për xehetari, por kjo nuk i shkoi dhe kështu e humbi vitin dhe u kthye në Pejë, në vendlindjen e tij. Pastaj ka regjistruar Fakultetin Ekonomik, por as ky nuk ishte për të, edhe pse me nota ishte mirë, po nuk e kishte pasion, derisa u takua me kushëririn e tij Istref Begolli dhe ai e bindi ta regjistrojë artin në Beograd, dhe menjëherë u bë aktori më i kërkuar në ish-Jugosllavi. Ka diplomuar në vitin 1966.

Faruk Begolli ishte i martuar me Zoja Gjokoviq, një balerinë profesionale, e cila edhe pas divorcit ka mbajtur mbiemrin Begolli

Artistët e vërtetë nuk vdesin kurrë. I tillë është aktori Faruk Begolli. Me talentin e tij ai shkriu role të mëdha, për të mbetur kështu një ndër figurat më të ndritura të kinematografisë shqiptare.

Figura e tij prej një djali tërheqës dhe plot sharm, ka bërë që ai ende të mbetet një ndër figurat më të dashura të artit shqiptar. Shumë nga fotografitë e tij, qoftë ato të ndara nga rolet e tij të shumta, apo fotografi të rastit, janë ende shumë të pëlqyera nga publiku që e deshi fort.

Rolet më të njohura të tij janë:

“Kur pranvera vonohet”;

“Era dhe Lisi”;

“Sulmi i kuq”;

“Dashuria e Bjeshkëve të Nemuna”, e shumë role tjera.

Faruk Begolli, përveç realizimit të shumë roleve kryesore në filma artistik të metrazhit të gjatë, ai ishte edhe pedagog i shkëlqyer, por edhe regjisor e dramaturg i suksesshëm i teatrit, këtu duhet veçuar shfaqjen më të njohur për artëdashësit “Profesor jam talent se jo mahi”, edhe shfaqjen e cila u shikua me mjaft interesim “Hajnat nuk vijnë gjithmonë për keq”, si dhe shumë shfaqje tjera, ku Faruk Begolli ishte regjisor dhe dramaturg.

Regjisor - dramaturg:

“Kur kishe mujt me m’pa, qysh më kishe pa”;

“Profesor jam talent se jo mahi”;

“Iluzionet e dashurisë”;

“Këngëtarja tullace”;

“Dashuritë e Xhorxh Uashingtonit”;

“Mbytma burrin”;

“Maturantët”;

“Martesa”;

“Stjuardesat”;

“Mbreti Ibish”;

“Hajnat nuk vijnë gjithmonë për të keq”;

“Ti, vetëm ti”;

“Të lumët na për këtë liri”;

“N’dorë e ka deputeti”.

Aktori i mirënjohur Prof. Faruk Begolli, njëri ndër aktorët më të adhuruar nga publiku shqiptar, gjatë karrierës së tij artistike ishte në vëmendjen e regjisorëve më të njohur të Kosovës dhe të ish Jugosllavisë së atëhershme. Ai me profesionizmin e tij realizoi shumë role, ndër të tjera edhe ato kryesore, në filma artistik të metrazhit të gjatë, të regjisorëve të njohur, shumë prej të cilëve ishin edhe pjesëmarrës në Festivale kombëtare e ndërkombëtare të filmit...

Filmografia:

“10 minuta”, film i metrazhit të shkurtër, (2004);

“Dashuria e Bjeshkëve të Nemuna”, (1997);

“Proka”, (1984);

“Kur pranvera vonohet”(1980);

“Era dhe lisi”, (1979);

“Sulmi i Kuq”, (1974);

“Të ngjuarit”(1972)

“Si të vdiset”(1972); Etj.

FATMIR HALIMI



Ma. Sci. Fatmir Halimi u lind më 26.03.1972 në fshatin Dumnicë të Podujevës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Podujevë, ndërsa studimet në degën letërsi dhe gjuhë shqipe në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Po aty i përfundoi edhe studimet pasuniversitare, ku mori titullin: Master i shkencave të Filologjisë. Është poet, shkrimtar, gazetar, kritik letrar dhe profesor i gjuhës shqipe. Poezitë e para i botoi në vitin 1989 në revistën; "Zëri i rinisë". Që atëherë, poezitë dhe punimet e tij letrare e shkencore i botoi gati në të gjitha gazetat dhe revistat si: Rilindja (Bujku), Bota e Re, Fryma, Bota sot, Kosova live, Iliria Post, Kosova sot, Epoka e re, Jeta arbëreshe në Itali, etj. Vepra e tij e parë, "Kornizat e burgut", e shkruar gjatë viteve të '90-ta, u botua në vitin 1996, e cila pas kërkesave të lexuesve u ribotua në vitin 2007.

Nga fusha e kritikës letrare, ka të botuar këta libra:

- "Postmoderniteti në prozës e Zejnullah Rrahmanit", botues: "Faik Konica", 2015,
- "Prej modernes kah postmodernia", botues: "ProkultPress", 2016,
- Kurse romani "Dy vdekjet e një jete", botues: "ProkultPress", 2017.

Në vitin 2018 romani "Dy vdekjet e një jete" u shpall romani më i mirë i vitit në Kosovë, nga Ministria e Kulturës, Rinisë e Sportit e Republikës së Kosovës.

Fatmir Halimi, nga viti 1997 e deri në vitin 2007, punoi gazetar në disa gazeta dhe radio lokale e kombëtare, si në gazetën "Bota Sot" (nga viti 1997-1999), bashkëpunëtor i jashtëm në (Bavari), Gjermani, më pastaj në portalin e lajmeve "Kosova Live", korrespondent nga Podujeva, (gjatë viteve 2001-2002), në radion "Vizioni", gazetar në studio dhe gazetar i terrenit, (2002-2004), në "Iliria Post" korrespondent nga Podujeva, gjatë viteve (2005-2007).

Nga viti 2004 e deri më sot, punon profesor i gjuhës dhe letërsisë shqipe në shkollat e komunës së Podujevës. Gjatë punës si mësimdhënës i gjuhës shqipe, është certifikuar dhe nderuar nga institucionet tona dhe nga organizatat e ndryshme në fushën e arsimit si:

- Zhvillimi i Mendimit Kritik gjatë leximit dhe Shkrimit (120 orë), në vitin 2008, nga MASHT- Republika e Kosovës,

- Të drejtat e fëmijëve-Aktiviteti dhe perspektiva, Durrës, në vitin 2009, nga Qendra për të drejtat e fëmijëve, Prishtinë,
- ”Licencë e Karrierës” për mësimdhënie, në vitin 2013, nga MASHT,
- Vlerësimi për nxënie- (20 orë), më 2012, nga MASHT-i dhe USAID,
- Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social (24 orë), më 2016, nga MASHT- Republika e Kosovës dhe SBASHK, etj.

Aktivitete të tjera:

Në vitin 2008 bashkë me të ndjerin Milazim Kadriun-gazetar dhe poet, e me disa të rinj, themeloi shoqatën kulturore “Prokult” në Podujevë, ku u zgjodh kryetar i saj.

Përmes kësaj shoqate Halimi, deri më sot, realizoi me dhjetëra projekte në fushën e arsimit, kulturës e të letërsisë, që vlen të ceket projekti “Festivali Kombëtar i Letërsisë dhe Ditët e Diasporës”, i cili për 10 dhjetë vite rresht bashkoi shkrimtarët e të gjitha trevave shqiptare, por edhe shkrimtarët tanë nga diaspora në komunën e Podujevës.

Në vitin 2014 krijoi shtëpinë botuese “ProkultPress”, ku deri më sot ka botuar më se 140 tituj të shkrimtarëve tanë, por edhe të shkrimtarëve nga Shqipëria dhe diaspora jonë, pra deri më tash, ka redaktuar dhe lekturuar më se 140 libra të fushave të ndryshme si letërsi, publicistikë, histori, art etj. Kurse së fundmi, bashkë me disa poetë, shkrimtarë dhe studiues themeloi revistën kulturore-letrare “Orfeu”, të cilën pretendon ta mbajë aktive dhe ta bëjë tradicionale.

Punime shkencore:

Që nga viti 2007, Halimi merret me kritikë letrare, ku fushë e kritikës së tij janë metodat postmoderne në letërsi.

Ai deri më sot ka botuar me dhjetëra punime shkencore si në librat studimor të nxjerr nga:

Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturë shqiptare, “Java e shkencës” të botuar nga MASHT i Kosovës, si dhe në gazetata e ndryshme, ku ndër to vlen të përmenden:

“Kosova dhe letërsia shqipe”, botuar në gjuhën italiane “Jeta arbëreshe”, Itali, 2008

“Vallja e yjeve dhe vargjet e lira”, “Zemra shqiptare”, Tiranë, 2009,

“Epi kombëtar i shqiptarëve”, Lahuta e malcisë”, Akllapi, Prishtinë, 2009,

“Aventura semiologjike, R. Barti”, revista letrare: ”Oaza”, Prishtinë, 2010.

Nga viti 2016 është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës.

FATMIR TERZIU



Prof. Dr. Fatmir Terziu, u lind në vitin 1964, në Elbasan. Pas mbarimit të shkollës së mesme të përgjithshme "Dhaskal Todhri", studioi për gjuhë dhe letërsi shqipe.

Ka punuar mësues dhe më vonë drejtor shkolle në disa shkolla të Shqipërisë.

Ka publikuar shkrime në gjithë shtypin shqiptar dhe ka qenë gazetar i gazetës "RD", kryeredaktor i gazetës së pavarur "Fjala e Lirë" dhe drejtor i Televizionit "Dardan", kryeredaktor i "Albanian Mail" dhe "Albanian News", gazetë e cila botohet në Mbretërinë e Bashkuar. Fatmir Terziu drejton dhe është botues edhe i faqes elektronike "Fjala e lirë".

Në vazhdim të edukimit të tij të mëtejshëm, ka studiuar në High Melton College, (South Thames College) për gjuhën angleze dhe për HNC, Certifikatë e Lartë Nacionale në Britaninë e Madhe për Media Production (media prodhimtari).

Ka marrë nivelin e lartë (Gradën-nivel A) për Communication Media (media komunikim) pranë Universitetit London South Bank University), 2004.

Më tej kreu studimet në London South Bank University, pranë Faculty of Arts and Human Sciences për Digital Film and Video Production, (2004-2007).

Fatmir Terziu ka fituar gradën e Masterit për Media, Kulturë dhe Politikë pranë Roehampton University në Britaninë e Madhe dhe Phd-së për Media, Kulturë, Politikë nga London South Bank University.

Veprat e autorit janë publikuar në UK nga BBC, ku autori ka fituar dhe një kompeticion me tregimin "Hija Diamant" (Ghost Diamond).

Krijimet e Fatmir Terziut janë përfshirë në Antologji Kombëtare, duke përmendur Antologjinë poetike Kombëtare:

"Pena e vjeshtës së artë", Antologjinë poetike

"Metaforë malli", Antologjia e letërsisë

"Lule për lulet", etj.

Pa ndërprerje ka shkruar dhe shkruan në revista e gazeta perëndimore dhe në gjuhën shqipe, në faqen elektronike "Agimi", etj.

Fatmir Terziu është aktiv në shtypin shqiptar dhe atë të huaj në Mbretërinë e Bashkuar etj.

Prej disa kohësh ai ka shkruar në blogun e tij "Media Information Production" dhe boton online revistën kulturore-informative "Fjala e Lirë" me licencën e rregullt, të njohur në fushën letrare në Angli dhe Wells.

Veprat e botuara:

"Mos hesht", 2000, Sejko,
"Djalli i Argadasit", 2003, Silver,
"The Devil of Argadas", 2004, Lulu,
"Ecje në qelq", 2005, Silver
"Krokamat", 2006, Lulu,
"Integrimi", 2007, Lulu,
"Misteriozja", 2008, Globus R,
"Kohëbota", 2010, Emal
"Eagles Voices", 2010, Emal
"Lumenjtë e ëndrrave", 2011, Lulu
"Lotët e Virgjër", 2011, Lulu
"Rrëfenjat e Xha Avramit", 2012, Filara
"Grykës", 2012, Lulu
"Bunari", 2012, Lulu
"Kojrillat", 2013, Lulu.
"Borxh ajrit", 2013, Lulu
"Xhungël mendimesh", (2010);
"Blirët e Pejës", (2014);
"Era nuk jepet me qera", (2015);
"Fijet e barit të thatë", (2016)
"Pas shiut", (2016)
"Zjarri është Blu", (2016).

Libra studimorë:

"Një vëzhgim në brendësi të prozës dhe poezisë shqiptare",
Pjesa e parë (2009), Arbëria;
"Kritika Ndryshe: Një vëzhgim në brendësi të prozës dhe poezisë
shqiptare", Pjesa e dytë, (2011);
"Një sy pas në Letërsinë për Fëmijë", Lulu,
"Poezia haraçi për kohërat", Lulu,
"Joni Poetik", Lulu,
"Disimetria, Universaliteti, Oksimoroni, (Anti) misigonia", (2016);
Writing the dictatorship: reuse of myth in Ismail Kadare's work (2016).

Si dhe shumë konferenca, simpoziume, dokumentarë dhe filma të metrazhit të shkurtër. Etj.

FATOS DACI



Fatos Daci , u lind në Zall-Kalis të lokalitetit të Sllovës, në një familje patriotike e arsimdashëse. Ka studiuar në Peshkopi, Lezhë dhe Tiranë, ku është diplomuar në shkencat ekonomike.

Në profesionin e ekonomistit, ka punuar nga nëntori i vitit 1975, deri në shkurt të vitit 1991, kur u emërua redaktor i gazetës Dibra”, organ i Komitetit Ekzekutiv Pluralist të Dibrës, ku punoi deri në vitin 1993. Më 10 maj 1998, themeloi gazetën “Dibra”, të cilën e drejton edhe sot, si botues dhe kryeredaktor. Ndërkohë, si kryeredaktor ka drejtuar edhe gazetat “Zëri i Lirë” dhe “Trojet shqiptare”.

Botimet enciklopediko-historike:

1.”Enciklopedia e Dibrës”, 2. ”Kukësi”-Enciklopedi, 3. ” Dibra”-Historia e plotë, 4. ”Personalitetet e Dibrës”, 5.”Vendlindja ime (Dibra e Bulqiza), 6.”Historia e arsimit shqip në Dibër”,7. ”Historia e mjekësisë dibrane”,8. ”Historia e kulturës dibrane”, 9. ”Antologjia e poezisë dibrane” vol.I, 10. ”Antologjia e poezisë dibrane” vol.II, 11. ”Dibra 07” –antologji, 12. “Një shekull poezi dibrane”, 13. ”Skënderbeu i vërtetë”, 14. ”Të vërtetat për Skënderbeun”, 15. ”Kastriotët e Çidhnës së Dibrës”, 16. ”Peshkopia”, 17. ”Çidhna dhe Kastriotët”,18. ”Sllova përgjatë një shekulli”, 19. ”Sllova”, 20.”Vendi i Artistëve”, 21. ”Gryka e Vogël”, 22. ”Radomira”, 23. ”Shqiponjat e kreshtave të Veriut”, 24. ”Burrat e kullës së Canit”, 25. ”Trajtime juridike”, 26. ”Nga lashtësia deri në vitin 1940”, 27. ”Met Kaca dhe pasardhësit”, 28. ”Hysen Bara, pari e Dibrës”, 29. ”Shqiponja fluturoi nga foleja”, 30. ”Pilket e Dibrës”, 31. ”Në Amerikë flakëron atdhetaria dibrane”, 32. ”Lirie Rasha-identiteti i vlerave”, 33. ”Estref Gjoshi...”, 34. ”Dodajt e mëdhenj të Dibrës”, 35. ”Pasardhës të Dodajve të mëdhenj”, 36. “Fitorja e Kosovës në duart e Dibrës”, 37. ”Çidhna e Kastriotëve”, 38. ”Shpërthime rinore”, 39. ”Histori e shkruar me pushkë e penë” , 40. ”Të pavdekshmit”, 41. ”Njeriu që di të bëjë gjera të mira”, 42. ”Miftar Fana, Nderi i Kombit”, 43. ”Burri i madh i Bulqizës”, 44. ”Mehmet Duriçi”, etj.

Dokumentarë televiziv:

1.“Sllova, mes heroizmit dhe ndryshimit”; 2.“Dodajt e mëdhenj të Reçit të Dibrës”; 3.“Kalisi”;4.“Mahmut Daci”; 5.“Origjina e vërtetë e Ataturkut”; 6.“Kalisi përkujton dëshmorët e tij”; 7.“Skënderbeu u kthye në shtëpi të vet”; 8. “Kalisi në festë”; 9. “70 vjet shkollë Pedagogjike”; 10. “Kuvendet e Dardhës së Dibrës”; 11. “Talenti i valleve popullore”, etj.

FEHMI AGANI (1932-1999)



Prof. Dr. Fehmi Agani, u lind në vitin 1932 në Gjakovë, ku mbaroi shkollimin fillor, ndërsa të mesmin e kreu në Prishtinë. Studimet për filozofi i mbaroi në Universitetin e Beogradit. Studimet pasuniversitare në shkencat politike i mbaroi po ashtu në Universitetin e Beogradit, duke marrë gradën shkencore Magjistër i shkencave politike me temën: “Pjesëmarrja e punëtorëve në procesin e vendimmarrjes në Gjermani, më 1965”. Gradën doktor i shkencave të sociologjisë, e mori në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, në vitin 1973, duke mbrojtur me sukses tezën: “Partitë dhe grupet politike në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore”.

Në vitin 1951, iu kundërvu politikës së turqizmit të shqiptarëve dhe për herë të parë u konfrontua me PKJ.

Edhe pse shumë i ri, u rreshtua në anën e LNÇ-së dhe të aleancës antifashiste. Ngjarjet e mëdha politike, veçanërisht ato të vitit 1981 e këndej, bënë që pikëpamjet dhe qëndrimet e tij politike gjithnjë e më tepër të marrin formën e social-demokracisë moderne perëndimore.

Në fund të viteve '50 dhe në fillim të viteve '60 punoi profesor i shkollave të mesme në Gjakovë dhe në Prishtinë, ndërsa më vonë gazetar dhe redaktor i politikës së jashtme në gazetën Rilindja.

Në vitet '60 nisi punën ligjërues i sociologjisë në Fakultetin Filozofik, ku luajti një rol të dorës së parë për zgjerimin e mësimdhënies në gjuhën shqipe dhe për zhvillimet e më vona të përgjithshme shoqërore.

Në vitin 1967 u zgjodh drejtor themelues i Institutit Albanologjik të Prishtinës. Më vonë u zgjodh prodekan dhe dekan i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës.

Ishte themelues i Degës së Sociologjisë dhe të Filozofisë në Fakultetin Filozofik dhe i Institutit të Sociologjisë të këtij fakulteti. Ishte kryeredaktor i revistave Studia Humanistica dhe Thema.

Në vitin 1978 mori Shpërblimin e Dhjetorit, çmim ky i cili iu dha për studimet e tij shkencore.

Pas vitit 1981, për shkak të mospajtimeve me vlerësimin dhe me qëndrimet e politikës ndaj demonstratave dhe ndaj çështjes shqiptare në Jugosllavinë e atëhershme, ishte në trysni të përhershme politike, ndërsa më 1984 iu mor e drejta të jepte mësim.

Ishte nënkryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe ndër kryesorët në hartimin e dokumenteve të rëndësishme për Kosovën.

Në vitin 1993 u zgjodh anëtar korrespondent, ndërsa më 1996 anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Akademik Fehmi Agani ishte bartës i shumë dekoratave, ndër të cilat edhe i Dekorates “Urdhri i Lartë Skënderbeg”, me të cilën e dekoroi presidenti i Shqipërisë dhe “Urdhri i Lidhjes së Prizrenit”, me të cilën e ka dekoruar kryetari i Republikës së Kosovës.

Për idetë dhe angazhimet e tij për çlirimin e Kosovës, u vra afër Lipjanit nga forcat ushtarake e policore serbe, më 6 maj 1999.

Librat e botuara:

1. “Në rrjedha të mendimit sociologjik”, (një histori e veçantë e mendimit sociologjik), Prishtinë, 1990.
2. “Demokracia, kombi, vetëvendosja”, Dukagjini, Pejë, 1994.
3. “Pavarësia-shpresa dhe gjasë”, Dukagjini, Pejë, 1999.
4. “Studime sociologjike dhe politikologjike”, ASHAK, Prishtinë, 2008.


Akademik Fehmi Agani ka lënë të botuara shumë studime sociologjike, politologjike, nëpër periodik në gjuhët shqipe, serbokroate dhe angleze. Ka lënë dorëshkrim monografinë “Partitë dhe grupet politike në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore” dhe shkrime të tjera.

Në vitin 2002, në 70-vjetorin e lindjes, Shtëpia botuese “Dukagjini” botoi veprat në 8 vëllime të Fehmi Aganit:

- Vepra 1, “Në rrjedha të mendimit sociologjik“,
- Vepra 2, “Për shoqërinë civile“,
- Vepra 3, “Demokracia, kombi, vetëvendosja“,
- Vepra 4, “Partitë dhe grupet politike në Shqipëri, (1939-1945)“,
- Vepra 5, “Sindikatat gjermane dhe shkrime të tjera“,
- Vepra 6, “Gjuha e dhunës dhe zëri i arsyes“,
- Vepra 7, “Pavarësia- gjasa dhe shpresë“,
- Vepra 8, “Intervista, reagime“.

Botoi edhe shumë studime, artikuj, trajtesa e polemika në organe të ndryshme shkencore, në revista dhe gazeta në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera. Pas vdekjes së tij është botuar një përmbledhje e punimeve të tij e titulluara "Pavarsia - Gjasa dhe Shpresa". Prodhimtaria shkencore-intelektuale e Fehmi Aganit është shkruar pjesën më të madhe në gjuhën shqipe. Për një pjesë ajo është hartuar serbisht, por ka dhe shkrime që janë ruajtur në përkthim anglisht...

FEJAZ DRANÇOLLI



Prof. Dr. Fejaz Drançolli, u lind më 1949 në Pejë. Shkollimin fillor dhe të mesëm e kreu në Pejë. Në Beograd kreu studimet e larta, ndërkaq studimet e magistraturës dhe të doktoratës i kreu në Universitetin e Prishtinës.

Një kohë punoi si mësimdhënës, më pas gazetar dhe kritik i artit figurativ në rubrikën e kulturës në gazetën 'Rilindja' në Prishtinë.

Për shumë vite punoi në Entin Krahinor për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, më vonë Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve në Prishtinë (IKMM) . Ishte sekretar i shoqatës së konservatorëve të ish-RSFJ-së dhe një kohë drejtor i IKMM-së. Udhëhoqi edhe sektorin e hulumtimit shkencor dhe të dokumentacionit në këtë Institut. Realizoi dhe udhëhoqi një numër projektesh për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore-materiale, si dhe disa projekte për trashëgiminë kulturore shqiptare të Kosovës të shkatërruar gjatë luftës së viteve 1998-1999.

Mori pjesë me kumtesa në shumë simpoziume dhe konferenca shkencore, duke realizuar një numër fotoekspozitash për shkatërrimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës gjatë viteve të luftës 1998-1999.

Punime shkencore dhe monografi:

1. Prof. Dr. Fejaz Drançolli, "Xhamia e Jashar Pashës", Prishtinë, 2003
2. Prof. Dr. Fejaz Drançolli, "Albanian tower (Kulla shqiptare)", Pr. 2001
3. Prof. Dr. Fejaz Drançolli, "Čiji su kosovski spomenici?", Prishtinë, 2004
4. Prof. Dr. Fejaz Drançolli, "Trashëgimia e mbetur e Prishtinës", Pr. 2008
5. Fejaz Drançolli, "Patriarchenkloster von Peć", E. von Der Buchhalter,
6. Prof. Dr. Fejaz Drançolli, "Arkitektura Islame e Kosovës e zhvilluar gjatë periudhes osmane ", Gjakovë, 2011
7. Prof. Dr. Fejaz Drançolli, "Monumentet e shkatërruara në Kosovë vitet 1998/'99", Prishtinë, 2015
8. Prof. Dr. Fejaz Drançolli, "Kulla e Riza Bej Gjakovës", Prishtinë 2015
9. Fejaz Drançolli, "Politika shtetërore serbe plaçkiti, dogji, granatoi dhe shkatërroi trashëgiminë kulturore në Kosovë", Prishtinë, 2016
10. Prof. Dr. Fejaz Drançolli, "Trashëgimia kulturore e Rajonit të Gjilanit",
11. Prof. Dr. Fejaz Drançolli, "Kisha politike 'Svetog Spasa' apo e "Shën shpëtimtarit", në Korpusin Universitar të Prishtinës", Prishtinë, 2016
12. Prof. Dr. Fejaz Drançolli, "Destroyed Heritage in Kosova 1998/99", Prishtinë, 2017, etj.

FERDINAND LAHOLLI



Ferdinand Laholli, u lind në Gradishtë të Lushnjës, më 16 qershor 1960, pak javë pasi që i ati, për t'i shpëtuar riburgosjes, u detyrua të arratisej për në Greqi, prej nga kalon në SHBA, ku edhe vdes pas 11 vjetësh.

Menjëherë pas lindjes së Ferdinandit, familjen e tij e transferojnë në një tjetër kamp internimi, Savër, ku autori jeton një kohë të gjatë.

Laholli një kohë të gjatë u mor me përkthime nga shqipja në gjermanisht.

Në vitin 2003 botoi librin "Antologji e poezisë moderne shqipe", ku përfshihen poezitë e më se 95 krijuesve shqiptarë me përkthim në gjuhën gjermane.

Ferdinandin në këtë antologji e ndihmuan edhe Mag. Dr. Carla Kraus autore dhe përkthyesë vjeneze, si dhe Dr. Thomas Krause prozator, lirik, kritik letrar, profesor letërsie në Universitetin Teknik në Chemnitz.

Poezitë që po publikojmë, janë marrë nga libri i Ferdinandit "Në ishullin e vetmisë", botuar në vitin 1993 në Tiranë.

Ky libër është botuar në dy gjuhë shqip - gjermanisht. Përkthimin në gjermanisht e ka bërë Robert Schwartz.

Ferdinand Laholli jeton dhe punon një kohë të gjatë në Gjermani.

Veprat e botuara:

“Mjaft ky paradoks i hidhur”, Tiranë 1992,

“Libri i dëshirave”, Tiranë 1994,

“Në ishullin e vetmisë”, shqip-gjermanisht, Tiranë 1993, (Përkthimi në gjermanisht nga Robert Schwarz),

“Kjo vajzë e përgjakur”-Në këtë vajzë të plagosur me gjak, dygjuhësh, Tiranë 1994, (Përkthimi në gjermanisht nga Robert Schwarz),

“Vetëvrasje e gjetheve”, shqip-italisht, Frosinone 1995, (Përkthimi në italisht nga Noé),

“Shtigrani i ëndrrës”, (Një magjistari në gjumin tim), Tiranë 1996,

“Urrejtja nuk është dashuria ime”, Prishtinë 1997,

“Bie shi në Bückeberg”, Tiranë, 2000,

“Antologji e poezisë moderne shqipe'-antologjia e lirisë moderne shqiptare, shqip dhe gjermanisht, Holzminden, 2003,

“Linda”, Prishtinë-Holzminden, 2005,

“Kur ikën ti” (sa herë që shkoni), Prishtinë-Hannover, 2006. Etj.

FERID MURATI



Prof. Dr. Ferid Murati, u lind më 14 shtator të vitit 1936, në Whiting, Indiana, SHBA, nga Xhabir Murad Ejupi (i ati shqiptar) dhe Henrieta Bowman (e ëma amerikane). Ai është diplomuar në Universitetin e Virxhinias, ku gjithashtu u emërua profesor në vitin 1970. Aty ka punuar deri në vitin 1981, para se të zhvendosej në Stanford. Një nga sukseset më të mëdha profesionale të Ferid Muratit është shpikja e “Viagras”, tashmë me famë në të gjithë botën. Ai ka punuar mbi këtë temë për vite të tëra (në shpikjen e Viagras), bashkë me Robert Furchgott dhe Louis Ignarro. Të tre bashkë fituan Çmimin Nobel në 1998. Gjatë atij viti ka pasur kritika prej tyre ndaj një fizikanti tjetër pretendent për çmimin, i quajtur Salvador Moncada, i cili në mënyrë të habitshme, i pavarur nga treshja e studiuesve fitues, kishte arritur paralelisht në përfundimet e Ignarros.

Ferid Murati aktualisht kryen kërkime shkencore në Universitetin e Teksasit.

Profesorit Ferid Murati i është dhënë titulli “Doktor Nderi” nga shumë universitete dhe institucione prestigjioze arsimore-shkencore ndërkombëtare. Gjithashtu, ka titullin “Doktor Honoris Causa” nga Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë.

Babai i Prof. Ferid Muratit është nga viset shqiptare të Maqedonisë së Veriut nga një fshat i Gostivarit, i cili kishte emigruar në Amerikë në fillim të viteve 1900.

Babai i tij, Ejupi emigroi nga Gostivari, në moshë të re, kur ishte 18 vjeç. Vështirësitë ekonomike dhe mungesa e punës e detyruan djalosin nga Gostivari të merrte rrugët e Evropës së turbulluar nga valët e Luftës së Parë Botërore, e cila sapo kishte filluar.

Xhabirit iu dha mundësia që në vitin 1914 të marrë një anije dhe, nëpërmjet Ellis Island-it të fillojë jetën e re në Amerikë. Pas peripecive të para në New York, ai kursen para për udhëtimin në Ohio, ku punon në një uzinë të shkrirjes së çelikut.

Shkëputet për një kohë në Detroit dhe më pas në Chicago, ku u vendos përfundimisht së bashku me gruan e tij, Henrietta Josephine Bowman. Jetonin me të ardhurat e fituara nga një restorant i tij në veri të Indiana-s dhe më pas në Chicago.

Kontaktet e Ferid Muratit me botën shqiptare gjithsesi kanë qenë të pakta. Kohët e fundit, ai ishte në një ligjëratë me studentët e Prishtinës, si dhe botoi një editorial në gazetën "Iliria" në SHBA dhe "Shekulli" në Tiranë, lidhur me pavarësinë e Kosovës.

Shumë njohës të Muratit e quajnë atë baba i "Viagres".

Murati nuk ka punuar në krijimin e Viagres as nuk e ka zbuluar atë.

Mirëpo, ka zbuluar rolin që Oksiti Nitric (NO) ka në sistemin kardiovaskular, duke ndikuar që enët e gjakut të relaksohen. Ky zbulim i tij që ka gjetur aplikim në trajtimin e një varg sëmurjesh, ka ndihmuar pastaj disa shkencëtarë të tjerë për të krijuar "Viagrën".

Ndoshta, në vend së ta quamë baba, do të mund ta quanim gjyshi i Viagrës. Shkenca si zbulues të Viagres njihet farmatologjistin Dr. Nicholas Terret, mirëpo puna e Feridit krijoi parakushte për zbulimin e këtij ilaçi.

Pak dihet se sot ekziston një çmim për mjekësi, që mban emrin e Ferid Muratit. Universiteti De Pauw i shtetit Indiana, ku Ferid Murati diplomoi në vitin 1958, ka themeluar çmimin vjetor me emrin e Ferid Murad për studentët më të mirë nga tërë Amerika.

Ky është një universitet me një traditë 175 vjeçare dhe në këtë mënyrë mirënjeh emrin dhe punën e nobelistit Murati. Zyrtarisht medalja mban emrin Murad Medal.

Ferid Murati ka punuar në disa nga spitalet e universitetet më të njohura të Amerikës. Në prill të vitit 1977, Ferid Murati u shpall kryetar i parë në Departamentin e ri të kombinuar për shkencat themelore, biologjinë integrative, farmakologji dhe fiziologji në Universitetin e Teksasit-Houston.

Edhe në kohën kur ushtronte profesionin e mjekut, gjatë një periudhe Ferid Murat në muajt e verës punonte si kamarier për ta mbështetur financiarisht familjen e tij të madhe. Siç ka deklaruar, restoranti i prindërve të tij, ka patur influencë shumë të madhe, në krijimin e personalitetit të tij dhe respektit për punën.

Ferid Murat e ka pranuar, që në vitin 1976, kur ka zbuluar rëndësinë e oksidit nitrik ka imagjinuar që ky zbulim mund t'ia sjell çmimin Nobel. Lajmin për çmimin ai e përshkruan ashtu siç është vet, me fjali modeste: *"Ishte thirrje zgjuare e jetës, kur me 12 tetor, 1998 në orën 4 të mëngjesit, cingëroi telefoni Në anën tjetër të linjës telefonike ishte përfaqësuesi i Komitetit zgjedhor për Çmimin Nobel. Isha tepër i gëzuar, është fantastike të njihesh prej dikujt për merita"...*

FITIM SELIMI



Dr. Fitim Selimi, u lind në fshatin Banullë të Lipjanit, më 30.11.1960. Shkollën fillore e kreu në vendlindje ndërsa Gjimnazin në Lypjan. Më 1978 fillon studimet ne Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Për shkak te angazhimeve kombëtare, disa herë arrestohet nga pushteti okupues serb. Arrin të iu rikthehet studimeve për t'i përfunduar ato më 1993. Selimi është themelues dhe udhëheqës i Degës së Kryqit të Kuq në Lipjan. Gjithashtu me Inicativën e Adem Demaqit, kishte themeluar edhe degën e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. Me fillimin e lëvizjeve të armatosura për çlirim, angazhohet në radhët e UÇK-së, fillimisht si të gjithë ushtarët, për tu profilizuar në drejtimin e institucioneve shëndetësore në kuadër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në këtë kohë kryen funksionin e Shefit te Sektorit të Shëndetësisë për Brigadën 121 "Kumanova", pastaj edhe funksionin e përgjegjës të Sektorit të Shëndetësisë, pranë Shtabit te Përgjithshëm të UÇK-së. Në mbarim të luftës çlirimtare, më 1999 angazhohet në Ministrinë e Shëndetësisë në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës në funksionin e drejtorit të drejtorisë së spitaleve. Është themelues i degës së PDK-së në Lipjan dhe udhëheqës shumëvjeçar i saj. Më 2000 në kuadër të Institucioneve të Përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës, emërohet në cilësinë e drejtorit regional për shëndetësi në regjionin e Prishtinës. Në këtë periudhë vazhdon punën në QKUK, në arritjen e përvojës profesionale specialistike në Kirurgjinë e Kraharrorit. Më 2003 mbaron specializimin nga kirurgjia torakale dhe krijon marrëdhënie të rregullt pune si specialist i kirurgjisë torakale në departamentin përkatës ne QKUK. Njëkohësisht vijon edhe studimet postdiplomike në lëmin e kirurgjisë. Gjatë kësaj kohe gjithashtu merr pjesë aktive në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit, ku për temë trajtimi ishin çështjet profesionale nga lëmi i kirurgjisë. Mbaron magistraturën me 2010 nga lëmi i shkencave mjekësore-kirurgjike. Gjithashtu prezantohet si autor dhe koautor me një numër punimesh të kësaj natyre. Prej 2008 deri 2013 kryen detyrën e kryeshefit të repartit klinik të Kirurgjisë Torakale në klinikën e kirurgjisë të QKUK-së. Ndërkohë ishte i angazhuar edhe asistent i lëndës së kirurgjisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Është doktorant në lëmin e shkencave mjekësore-kirurgjike. Gjithashtu, aktualisht është ligjërues në Universitetin për Biznes e Teknologji (UBT) në Prishtinë.

Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare dhe punimet:

Gjatë këtyre viteve ndoqi dhe u prezantua me punime në disa simpoziume dhe konferenca e seminare shkencore mjekësore, të çështjeve organizative, në Kosovë dhe jashtë saj:

- Tubimi i I-rë profesional i Onkologëve të Kosovës, 29-30 tetor 1999, Prishtinë;
- Simpoziumi i II-të i Onkologëve të Kosovës, tetor 2000, Prishtinë;
- Simpoziumi i III-të i Onkologëve të Kosovës tetor 2001, Prishtinë;
- Simpoziumin e I-rë Mediko Kirurgjik i Shoqatës së Kirurgëve të Kosovës, Prishtinë, 6-8.nëntor 2002;
- Konferenca per reformat në Mjekësi, Ministria e Shëndetësisë, 23 shtator 2003, Prishtinë;
- Simpoziumin e II-të Mediko Kirurgjik i Shoqatës së Kirurgëve të Kosovës, Prishtinë, 16-18 tetor 2003;
- Simpoziumi IV-te Onkologjik 21-22 Nëntor, 2003-Prishtinë;
- Konferenca pranverore e Kirurgjisë Torakale Europiane - Zurich 21-24 Mars 2004, Zvicër;
- Konferenca e I ndërkombëtare e Mjekimit Intensiv dhe Simpoziumi i II ndërkombëtar për traumën, Prishtinë;
- Konferenca e IX Onkologjike 2- 4 nentor 2006,Prishtine;
- Second International Conference on Trauma , Prishtina 8-9 maj, 2007;
- Simposium of Gen. Surg, Univers. Prishtina-University of Heidelberg-Germany ,Prishtina 4 - 5 oct. 2007;
- Kongresi i 2-të Ndërkombëtar Onkologjik 15-18 tetor 2008, Prishtinë;
- Konferenca e III-te Internacionale e Emergjences, maj 2009, Prishtine.

Deri më tani i ka të botuara këto punime:

- Fitim Selimi, Institucionalizimi i shëndetësisë në UÇK-ë,
- Konferenca për Emergjencat Civile, SHP i TMK-së , Prishtinë, 2001,
- F. Selimi. “Qasjet në trajtimin kirurgjik të pneumothoraxit spontan primar dhe sekondar” Punim magjistrature, Prishtinë, 2010,
- D. Selimi, Sh. Demaçi, S. Maliqi, A. Behluli, F. Çuperjani, S. Bajrami, E. Kastrati, N. Kolgeci, A. Poniku, B. Osmani, S. Misimi, G.Avdullahu, M. Ukshini. Prishtinë, “Trupi i huaj në traktin respirator dhe depërtimi transtorakal nëpërmjet empyemes necessitas në murin e kafazit të krahërorit” UBT, 2019.
- Arterial hypertension Simposium 24 October, Kumanovë, Macedonia, Medicus Oct. 2008 Suppl.3 p.261, Macedonia.

FLORA BROVINA



Dr. Sci. Flora Brovina, u lind më 30 shtator 1949, në Skenderaj. Shkollimin fillor, të mesëm dhe Fakultetin e Mjekësisë e kreu në Prishtinë, ndërsa studimet postdiplomike dhe specializimin për mjeke pediatër e kreu në Zagreb. Gjatë studimeve ka punuar gazetare në gazetën Rilindja në Prishtinë, pra ka studiuar pa ndërprerje nga puna.

Flora ka botuar disa vëllime me poezi:

“Vërma emrin tim”, (1973), “Bimë e zë”, (1979), “Luleborë”, (1988), “Thirrje e Kosovë”, (2000),

në kohën kur ishte e burgosur në kazamatet e Serbisë (1999-2000).

Ajo botoi edhe romanin “Stinë Jargavanësh”, (2015). Poezitë e saja janë përkthyer në shumë gjuhë të botës në revista letrare, ndërkaq ka të botuar librin me poezi, në gjuhën angleze “Call me by my Name”, (2001) New York, në gjuhën holandeze “Dageraad in de strad”, (2000), librin në gjuhën serbe “Nazivi me mojim imenom”, (2000) Beograd, Vocea inimii is Kosova (2014), në botim ka përmbledhjen në gjuhën gjermane.

Poezitë e saj janë prezantuar në shumë antologji të krijuesve nga Kosova, e Shqipëria. Ajo është anëtare e Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës që nga viti 1973, për pesë vite ishte edhe Kryetare, gjithashtu është anëtare e dhjetë PEN Qendrave në botë si PEN-it Amerikan (New York dhe San Francisko), Kanada, Suedi, Holandë, Danimarkë, Austri, Poloni, Serbi dhe në Kosovë.

Është laureate e disa çmimeve për veprimtari letrare dhe humanitare si:

- Çmimi i Mileniumit për Paqe, në Kombet e Bashkuara;
- Çmimi Mjekëve të botës në Washington;
- Çmimi i Akademise së Shkences dhe Artit në San Francisko;
- Çmimin Barbara Gold Smith nga PEN në New York;
- Çmimin Tuchlski nga PEN Suedez;
- Çmimin Henri Boll në Gjermani;
- Çmimin për kurajo qytetare nga PEN në Holandë;
- Çmimin për vepër jetësore nga Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës, Sofra e Drenicës; Mitingu i poezisë në Gjakovë, në Kumanovë etj.

Flora Brovina është Ambasadore e Paqes, është shpallur Qytetare nderi e qytetit të Peshkopisë si dhe Honoros Causa në Universitetin e Durrësit, ajo bart çmimin “Nënë Tereza” në Shqipëri dhe në Kosovë etj.

FLORI BRUQI



Prof. Dr. Flori Bruqi Ph.D, u lind më 29 qershor të vitit 1952 në Isniq të Deçanit.

Studimet i kreu në Universitetin e Beogradit, ndërsa ato postdiplomike (Magjistraturë) në Universitetin e Prishtinës - në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit (2004).

Bashkëpunoi më shtypin e përditshëm dhe periodik të vendit dhe të jashtëm, që nga viti 1974 e deri me tash (Bota e re - Prishtinë, "Rilindja" - Prishtinë, "Danas" - Zagreb, "Dello" - Lubjanë, "Dnevnik" -Lubjanë, "Vequer-Maribor", "Le Mond", "Corriera Della Sera", etj). Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, si dhe anëtar i Kryesisë në LSHK.

Është pronar i kompanisë "Flomed" nga Prishtina , si dhe menaxher gjeneral për Kosovë në distribuimin e preparateve farmaceutike të Schulke-Mayr-it të Gjermanisë, si dhe "BorerChemie AG" të Zvicrës.

Flori Bruqi, me sukses të shkëlqyeshëm e mbrojti punimin e magjistraturës në Universitetin "Hasan Prishtina", në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit, me titull "Dallimet në disa ndryshore fiziologjike ndërmjet studentëve sportistë dhe jo sportistë, para dhe pas vrapimit 400 metra", para Komisionit shkencor - të Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit në Prishtinë, në përbërje - Prof. Dr. sc . Hasim Rushiti, kryetar, Prof. Dr. Hysni Daka, mentor, Prof. Dr. sc. Mustafë Aliu, anëtarë.

Në punimin shkencor të magjistraturës nga lëmia e "Kineziologjisë fiziologjike",Flori Bruqi ka zbatuar një metodologji të avancuar shkencore, ku gjatë këtij hulumtimi të tij në 22 parametra morfologjikë-fiziologjikë ka përdorur kriteret më të avancuara shkencore e të "Programit biologjikë ndërkombëtar" të Weiner-it dhe Louri-së ; "Praktikumin e antropologjisë biologjike" të Buzin-ës më bashkëpunëtorë; "Praktikumin e fiziologjisë sportive", të Heimer-it më bashkëpunëtorë; "Udhëzuesit Kombëtarë të Asociacionit Shëndetësor Amerikan" etj.

Punimi i Bruqit, është vlerësuar lartë nga komisioni shkencor, pasi që ai ka shfrytëzuar burimet më të reja të literaturës bashkohore të Kineziologjisë fiziologjike në botë, duke cituar 49 referenca librash më të rinj nga kjo lëmi shkencore, si dhe ka përdorur 17 adresa portale relevante, që merren më këto hulumtime të "Fiziologjisë kineziologjike" botërore.

Flori Bruqi, ka botuar mbi 50 mijë punime në shtypin e kohës, internet dhe revista shkencore me impakt ndërkombëtar.

Me sukses të lartë e mbrojti disertacionit me titull "Delinkuenca e të miturve dhe ushtrimet fizike", (2016).

Në vitin 2016 u pranua anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe Arteve Shqiptaro-Amerikane, në New York, ku dhe mban titullin shkencor Prof.Dr. Flori Bruqi, Ph.D.

Bordi si dhe Senati i Akademisë në korrik të vitit 2017 e ka emëruar drejtor për Marrëdhënie me Publikun, pranë ASHASHA në New York (AAAS-it) për Kosovë, Shqipëri, Maqedoni dhe Amerikë.

Botimet:

1. "Zjarri i diellit", poezi, Prishtinë, 1995.
2. "Ndërgjegjja", roman, Prishtinë, 1995.
3. "Vrasësit e liridonëve", roman, Prishtinë, Tiranë, 1996.
4. "Ringjallja", roman, Tiranë, Prishtinë, 1996.
5. "Gjarpërinjtë e pallatit", roman, Tiranë, Prishtinë, 1996.
6. "Dorëzeza", roman, Tiranë, Prishtinë, 1997.
7. "Tokë e djegur", roman, Shkodër, Tiranë, Prishtinë, 1998.
8. "Burri dhe gruaja", libër shkencor, Tiranë, Prishtinë, 2000.
9. "Pallati i akereonit", roman, Tiranë, Prishtinë, New York, 2000.
10. "Vademecum DDD", libër shkencor, Prishtinë, 2002.
11. "Struktura faktoriale e dimensioneve antropometrike dhe fiziologjike", Prishtinë, 2004.
12. "Ndikimi i sportit në personalitetin e njeriut", libër shkencor, Prishtinë, 2004.
13. "Delinkuenca e të miturve dhe ushtrimet fizike", Prishtinë, 2004.
14. "Vademecum për preparate higjenike të "Schulke - Mayr"- it", libër shkencor, Prishtinë, 2004.
15. "Dallimet në disa ndryshore fiziologjike ndërmjet studentëve sportistë dhe jo sportistë para dhe pas vrapimit 400 metra" (Punim magjistrature, Prishtinë 2005).
16. "Antropometri-Jakov Milaj "Raca shqiptare", recension i zgjëruar i botuar në Floart, 2005.
17. "Si ta njohim internetin", Flomed, tetor-2005.
18. "Sëmundjet infektive seksuale", Floart, tetor-2005.
19. "Udhëzues i shkurtër i preparative dezinfektuese", Flomed, 2006.
20. "Merruni me sport dhe ushtrime fizike për t'u relaksuar", Floart, 2006.
21. "Kosova nuk është i berzë e zezë", Floart, dhjetor 2005.
22. "Fshehtësitë dhe të vërtetat për virusin avian", Flomed, 2005.

23. "The economic aspects of sports recreation and health", Sport ritmi-zemrës, janar 2006, etj.
24. "Determinantat socio-psikologjike të ushtrimit fizik" (Hulumtim sociopsiko-kineziologjikë më studentët e Universitetit të Prishtinës), 2006.
25. "Guxim shqiptar", Prishtinë, 2008.
26. "Olimpi shqiptar", Rugova-Art, Prishtinë, 2009.
27. "Triumfi shqiptar", Rugova-Art, Prishtinë, 2009.
28. "Polemika shqip", Rugova-Art, Prishtinë 2009.
29. "Antika greke"-Homeri, Eskili, Sofokliu, Aristofani dhe Aristoteli, Albemigrant, 2009.
30. "Nëse kam ditur të guxojë", Rugova-Art, Prishtinë, 2012
31. "Delikuenca e të miturve në Kosovë në periudhën 2003-2004", Prishtinë, 2012
32. Vademecum për dezinfektues të "Borer chemie AG", Prishtinë, 2013.
33. Vademecum për dezinfektues të "Schülke-Mayr", Prishtinë 2013.
34. "Diademë letrare", Rugova-Art, Prishtinë 2013.
35. "Diademë letrare II", Tiranë, 2014.
36. "Atdheu im s'më vret", poezi, Tiranë, 2015.
37. "Diademë letrare III", Tiranë, 2015.
38. "Vademecum për dezinfektues 1", Prishtinë, 2016.
39. "Vademecum për dezinfektues 2", Prishtinë, 2016
40. "Moderniteti në letrat shqipe", Tiranë, 2016.
41. "Praktikat e pastrimit dhe dezinfektimit të mjediseve spitalore dhe ambulatore në Kosovë", Prishtinë, 2017.
42. "Dëshmi të krimit të pandëshkuar", Tiranë-Prishtinë, 2017.
43. "Shtëpia e verdhë", Tiranë, Prishtinë 2019.
44. "Përparësia në parandalimin e infeksionit (Zgjedhje inovative për institucionet Shëndetësore, 2019-2020", Prishtinë, 2019.
45. Vademecum i preparateve dezinfektuese -higjenike të "Schülke-Mayer"-it, Prishtinë, 2019.
46. "Diademë letrare IV", Tiranë, Prishtinë, 2020.
47. "Leksikon Enciklopedik" (ASHASHA) New York, Tiranë, Prishtinë, Shkup, 2020.

Ka botuar 21 fejtone publicistiko-shkencore në gazetën "Rilindja" të Prishtinës, në periudhën 1974-1982, si dhe mbi 50 mijë punime në shumë faqe interneti (2003-2020). Nga viti 2005 është editor dhe kryeredaktor përgjegjës i web-faqës elektronike "FloriPress"...

FRASHËR DEMAJ



Prof. Dr. Frashër Demaj është lindur më 8.7.1973, në Radavc të Pejës. Shkollën fillore e ka kryer në vendlindje, ndërsa të mesmen në gjimnazin, “11 Maji”, tani “Bedri Pejani” në Pejë. Në vitin akademik 1991-1992 është regjistruar në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin Filozofik, dega e Historisë.

Në këtë fakultet ka diplomuar më 22 shkurt 1996. Në vitin akademik 1997-98 në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës filloi studimet pasdiplomike dhe kreu magjistraturën

Temën e doktoraturës e ka mbrojtur në vitin 2009, në Fakultetin Histori-Filologji në Universitetin e Tiranës.

Punoi në disa shkolla fillore dhe të mesme: “Iliria” në Prishtinë (1996); “Ismail Qemali”, në Prishtinë, në vitin shkollor 1997-1998; “Elena Gjika” nga viti 1998; në Gjimnazin Filologjik “Eqrem Çabej”, në Prishtinë, 1999-2000. Nga qershori i vitit 1999-2002 ka punuar si anëtar i redaksisë-gazetar i revistës “Kosovarja”, si dhe në redaksinë e revistës “Rrezja” në Prishtinë. Në vitin 1999 ka punuar në cilësinë e gazetarit në të përditshmen “Fakti” të Shkupit. Në vitin 2001 ka qenë drejtor i revistës për komunikacion “Tempulli” etj. Gjatë kohës së punës si gazetar, ka botuar një numër të konsiderueshëm të artikujve me përmbajtje historike, politike, kulturore, sociale etj.

Nga korriku i vitit 2003 punon në Institutin e Historisë në fillim si asistent dhe më pas si hulumtues i pavarur dhe si bashkëpunëtor shkencor deri në korrik 2015 si Bashkëpunëtor i Lartë Shkencor-Profesor.

Nga korriku 2015 është zgjedhur në gradën Këshilltar Shkencor-Profesor i rregullt (ordinar). Nga viti 2010-2013, Frashër Demaj ka punuar në kolegjin JURIDICA në Prishtinë.

Ka ligjëruar 2010-2018 në Kolegjin FAMA në cilësinë e profesorit në lëndën Histori e Shtetit dhe së Drejtës (2010-2013); Metodatat e hulumtimit në shkenca politike dhe administratë publike, Metodatat e Kërkimit Shkencor në studimet master (Juridik-Civil, Juridik-Penal, Shkencat e Sigurisë, Administratë Publike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare me Diplomaci), Shkathtësitë e Lidërshiptit, Teoria e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, në master, në drejtimin: Marrëdhënie Nderkombëtare me Diplomaci.

Frashër Demaj ka ligjruar (visiting profesor) në Universitetin e Barit Aldo Moro në Itali, në studimet master në programin Studimet e Paqes, Liritë dhe të drejtat e Njeriut.

Gjatë viteve 2014-2018 ishte rektor i kolegjit FAMA në Prishtinë. Frashër Demaj, në dhjetor të vitit 2016 është zgjedhur anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK)

Është Rektor i kolegjit FAMA nga viti 2014-2018, si dhe anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve në Kosovë.

Ka botuar një numër të konsiderueshëm të punimeve shkencore, profesionale në revista shkencore e publikime në Kosovë dhe jashtë, si dhe në gazeta e revista të ndryshme. Po ashtu ka botuar në bashkautorësi disa tekste shkollore nga historia për klasën 5-11.

Frashër Demaj ka botuar dhjetëra punime profesionale në revista shkencore, monografi si dhe botime të tjera të veçanta:

Botimet:

“Afrim Xhuraj, Jeta dhe vepra“, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë, 2009;

“Britania e Madhe dhe çështja shqiptare 1875-1913“, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë, 2011;

“Perandoria Osmane“, botues CDRSEE, Selanik, 2012, Greqi (autor i disa njësive);

“Kombet dhe shtetet në Evropën Juglindore“, botues CDRSEE, Selanik, 2012 (autor i disa njësive);

“Luftërat Ballkanike“, botues CDRSEE, Selanik, 2012, Greqi (autor i disa njësive);

“Lufta e Dytë Botërore“, botues CDRSEE, Selanik, 2012, Greqi (autor i disa njësive);

“Monumentet kulturore të periudhës osmane“, botues Instituti Goethe, Athinë, 2012. (autor i disa njësive);

“E Drejta e Bashkimit Evropian, historia, institucionet, legjislacioni dhe politikën“, Prishtinë 2015, (bashkautorësi);

“Il Diritto Europeo e le politiche di integrazione“, Edizioni Giuseppe Laterza, Bari 2015, (bashkautorësi);

“Mulla Zekë Berdynaj- Jeta dhe Vepra“, Prishtinë, 2016;

“Великобритания и албанския въпрос“, Sofije 2016 etj.

Si dhe shumë punime tjera shkencore, vepra, organizime, përrurime veprash historike e shkencore në kuadër të Akademisë...

FRITZ RADOVANI



Akademik Fritz Radovani, u lind në Shkodër, më 6 janar 1940. Nga bombardimet e Aleatëve nazist, më 13 tetor 1943 në Tiranë, iu vra i ati Kol Radovani, major i policisë shqiptare, ku Fritz u rrit vetëm me të ëmën. Në vitin 1956, në Shkodër ka përfunduar shkollën e mesme Pedagogjike. U emërua mësues nga Ministria e Arsimit në Burrel, në fshatin Macukull.

Për nevoja shëndetësore u kthye në Shkodër dhe u emërua disenjator në Kabinetin Pedagogjik, ku punoi 4 vjet. Pas katër vjetësh, kaloi mësues në lagjen “Liria”, po në Shkodër. Gjatë asaj kohe, pra në vitin 1965 ka përfunduar Liceun artistik me korrespondencë, në Tiranë. Nuk iu dha e drejta të vazhdojë shkollën e lartë për arsye biografie. Në vitin 1968 në periudhën e Revolucionit Kultural, mbas arrestimit të dytë të vëllait të madh, u transferua në fshatin Kosmaç, mësues në klasat fillore.

Në vitin 1969, u largua nga arsimit dhe u emërua piktor në fabrikën e Tekstilit, Shkodër. Aty nuk vazhdoi vetëm dy vjet me titull Piktor dhe kaloi në organikën e asaj fabrike, si punëtor reparti, stampimi deri me daljen në pension të parakohshëm, në vitin 1992.

Që nga viti 1967 nuk ka pasur të drejtë as të marrë pjesë në ekspozita piktore. Që nga viti 1945 dhe deri në vitin 1998 (duke përjashtuar vitet 1961-1964) ka pasur vazhdimisht një njeri të familjes në burgjet e kampet e shfarosjes, prandaj edhe ka qenë gjithmonë i përfshirë në “luftën e klasave” të pushtetit komunist.

Në viti 1945 e këndeje i janë arrestuar dy dajat Paulin e Mikel Prennushi. Paulini ka mbajtur 5 vjet burg, e 5 vjet internim. Mikeli ka mbajtur 10 vjet burg. Në vitin 1946 i është arrestuar xhaxhai i nënës At Mati Prennushi, Provincial i Françeskanëve të Shqipërisë, i cili është pushkatuar më 11 mars 1948.

Në vitin 1948 është arrestuar daja tjetër prift Don Kolec Prennushi, i cili mbas hetuesisë ka vdekur në vitin 1950.

Në vitin 1950 është arrestuar vëllai Alfonsi, dhe është dënuar 8 vjet burg me grupin e studentëve të Gjimnazit Shkodër.

Është arrestuar prapë në vitin 1967 dhe është dënuar me grupin e klerikëve të Tiranës, me 10 vjet burg për pikëpamje fetare, duke u përfshi në nenin e “Agjitacionit e Propagandës kundër pushtetit”.

Radovani në vitin 1991, në muajin janar u zgjedh kryetar i Sindikatës së Fabrikës të Pëlhurave të Shkodrës, në periudhën e lëvizjes antikomuniste në Shqipëri. Po në këtë kohë u zgjedh edhe anëtar i kryesisë BSPSH (Bashkimi i Sindikatave të Pavaruna Shqiptare) në Shkodër, për sektorin e propagandës dhe marrëdhënieve mes besimeve.

Ka kontribuar në përmbysjen e qeverisë komuniste të Ramiz Alisë, duke organizuar mbledhje, mitingje, greva dhe në radio “Shkodra” e gazeta, me artikuj kundër komunizmit.

Nuk u pajtua asnjëherë me demagogët dhe komunistët e konvertuar në “demokrat” e “socialist”, për këtë arsye edhe nuk ka marrë pjesë asnjëherë në asnjë parti politike të djathtë as të majtë.

Kjo e ka shtyrë, që në vitin 1997 të largohet nga Shqipëria ilegalisht, mbasi u kërcënua me vrasje.

Në vitin 1998 u kthye në Tiranë, kurse në vitin 2000 ka emigruar përsëri, kësaj radhe në Australi.

Edhe këtu nuk kanë munguar veprimet kundër tij nga metastazat e Sigurimit famëkeq të komunistëve të Tiranës.

Falë shtetit australian, që i ka siguruar jetën, ka përfunduar librin “*Një monument nën dhe*”, në vitin 2002 dhe ka vazhduar punën për një botim të dytë të librit “*At Pjetër Meshkalla S. J.*”, i botuar për të parën herë në Shqipëri, në vitin 1993.

Në vitin 1992-1993 është bashkautor i librit “*Martirizimi i Kishës Katolike Shqiptare 1944-1990*”, i cili libër i është dhuruar Papës Gjon Pali II, me rastin e vizitës në Shqipëri më 25 prill 1993.

Ka përfunduar edhe librin “*Gurt' e Parë*” dhe është futë në “labirintet e demokracisë përparimtare”, që t' i jap rinisë një punë tjetër modeste nga ana e tij. Dy të fundit janë dorëshkrime.

Përveç “publicistikës” Fritz Radovani po punon mbi një libër të vogël (xhepi) për mësimin e bazave të para të gjuhës shqipe (Gegërishtja e sotme), për nxënësit e rritur në Australi, që kanë përfunduar shkollat e ulëta e nuk njohin Gegërishten.

Fritz Radovani është anëtar i rregullt i AAAS, nga Melburni i Australisë.

Botimet:

1. “Një monument nën dhe”, 2002
2. “At Pjetër Meshkalla S. J.”, 1993
3. “Martirizimi i Kishës Katolike Shqiptare 1944-1990”, 1992
4. “Gurt' e Parë”...

GANI MEHMETAJ



Prof. Gani Mehmetaj, (1955), u lind në fshatin Dubovë, komuna e Pejës. Shkollën fillore e Gjinnazin i kreu në Pejë, Fakultetin e Shkencave Politike, degën e Gazetarisë e kreu në Universitetin e Prishtinës, ndërsa studimet pasuniversitare në Universitetin Ndërkombëtar.

Gani Mehmetaj është shkrimtar, dramaturg e gazetar nga Peja. Është profesor në Fakultetin e Arteve Mediale. Mehmetaj ligjëron lëndët: Adaptim filmi, Histori filmi dhe Estetikë si profesor në Fakultetin e Arteve e njëherësh mban pozitën e drejtorit të “Kosovafilm-it” qysh prej vitit 2003 Shkroi kritika filmi, ese e studime. Ishte ndër nismëtarët dhe themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës me kryetar Ibrahim Rugovën.

Gjatë viteve 1997-1999, Gani Mehmetaj, ishte redaktor, pastaj kryeredaktor i gazetës "Rilindja" - botimi për Perëndim, me seli në Cyrih (Zvicër).

Pasi u kthye në Kosovë, në fund të vitit 1999, themeloi gazetën e përditshme “Dardania press”, drejtoi revistën Titanic.

Punoi në Qendrën Informativë të Kosovës, pastaj ishte redaktor përgjegjës dhe drejtor i gazetës “Bota sot”, drejtor i revistës “Anza”.

Është ndër krijuesit dhe intelektualët më të angazhuar në trajtimin e problemeve e fenomeneve devijonte, që e karakterizojnë kohën e tranzicionit, përkatësisht periudhën traumatike të pasluftës.

Gani Mehmetaj është producent filmash dhe njëherit ishte edhe drejtor i “Kosovafilmit”.

Gjatë kohës sa ishte drejtor në Qendrën Kinematografike të Kosovës “Kosovafilm” u realizuan disa filma artistik të metrazhit të gjatë.

Filmat e realizuar në “Kosovafilm”, shumëherë ishin pjesëmarrës në festivale në ish-Jugosllavi dhe në festivale ndërkombëtare.

Krijimtaria e Gani Mehmetajt është e larmishme, ai ka shkruar edhe skenar filmi, publicistikë, romane etj.

Ese filmi e publicistikë:

“Magjia e ekranit” - Kritikë filmi, (2005), “Kosovafilmi”, Prishtinë;

“Për shtetin e Dardanisë”, - intervista me personalitetet politike, (2006),

“Faik Konica”, Prishtinë;

“Dardani a Shqipëri etnike“, - analiza, ese (2007), “AIKD”, Prishtinë;

“Udhëkryqet pas Rugovës”, - komente, ese (2007), “Dardania press”;
“Shqiptarët në vllimet ballkanike-1990-1999” - (2008), shqyrtime, botoi
“Titanic”, Prishtinë;
“Sfidat e pavarësisë” - (2009), analiza;
“Sharmi i filmit”, - (2010) historia e kinematografisë në Kosovë dhe
Shqipëri, “Kosovafilmi”;
“Kosova: Sfidat e pavarësisë”, - (2010), studim, Universiteti Ndërkombëtar
i Strugës, në vitin 2010;
“Ëndrra e madhe”, - kujtime (2015);
“A di zoti shqip”, 2016;
“A di zoti shqip”, - ribotim i plotësuar 2016;
“Adaptim filmi, si të shkruash skenar origjinal ose të frymëzuar nga
romani, drama e kronika sociale e gazetës”, - dedikuar studentëve të
Akademisë së Filmit, botues Akademia Evolucion, Prishtinë, 2014;
“Kolosët e filmit”, - pjesë nga historia e filmit, libër për studentë dhe për
filmofilet, botues Fakulteti i Arteve Mediale, Akademia Evolucion.

Veprat letrare:

1. “Kujtime të trishta”, tregime, (2010), “Dardania press”, Prishtinë
2. “Qyteti në anklh”, roman (2011) “Dardania press”. Prishtinë
3. “Aventurat e Lulisë” (Kalorësja e arratisur e bashkimit kombëtar), roman
I botuar në vitin 2012
4. “Nata e fantazmave”, triptik me një monodramë (2014).
5. “Ilirianët”, tregime, 2015, “Dardania press”, Prishtinë, 2015
6. “Ëndrra e madhe”, kujtime, Dardania press, 2015, Prishtinë,
7. “Zhvarrimi”, roman 2016, Dardania press, Prishtinë,
8. “Boritë e Apokalipsit”, roman 2017. Dardania press, Prishtinë,
9. “Kalorësit e Dardanisë” është libri më i ri i shkrimtarit Gani Mehmetaj,
Shkroi tre skenarë për filma artistik të metrazhit të gjatë dhe katër skenarë
për filma të shkurtër.

Editoriale:

Gjirokastra e princeshës Argjiro a Gjinokastra e Gjin Bua Shpatës?
Ura e Sidneit, Opera, Kopshti Botanik
Parlamenti i 4000 dhomave!
Kriza identitare turke e greke
Shpërfytyrimi i lirisë. Etj.

...të pabotuara

Si na zuri shpërthimi i Çernobilit në kufi me Ukrainën?, 26 prill 1986. etj.

GANI HALILAJ



Dr. sc. Gani Halilaj, neuropsikiatër, u lind më 7.06.1958 në Tërdec te Drenasit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse të mesmen në Drenas. Studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës i përfundoi në vitin 1984. Specializimin në fushën e Neuropsikiatrisë i përfundoi në Tiranë në vitin 1993, kurse studimet e doktoratës i kreu në Tiranë në vitin 2014, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, me temën: "PTSD tek popullata e Drenicës 13 vite pas luftës dhe korrelacionet me depresionin dhe nivelin e cilësisë së jetës".

Ka punuar mjek i përgjithshëm në Shtëpinë e Shëndetit, në Drenas, deri në vitin 1993.

Pasi përfundoi specializimin punoi si specialist neuropsikiatër në Shtëpinë e Shëndetit në Drenas deri në vitin 1997.

Në vitin 1998 i bashkohet radhëve të UÇK-së si mjek, në Sektorin e Shëndetësisë, në cilësinë e mjekut dhe udhëheqësit të sektorit të shëndetësisë për regjionin e Drenicës deri në përfundim të luftës.

Gjatë shërbimit në UÇK, dr. Ganiu tregoi vlera të larta humane e profesionale në shërbim të ushtarëve të UÇK-së dhe popullatës civile, duke u dalë në ndihmë jo vetëm në spitale ushtarake, por edhe në terren ku paraqitej nevoja.

Pas gjendjes post traumatike në popullatën e asaj treve, dr. Ganiu nuk kurseu mundin prej profesionisti e humanisti, duke filluar me trajtimin e veteranëve të UÇK-së, popullatën civile dhe personave të dhunuar gjatë luftës duke u ofruar trajtim mjekësor falas.

Pas përfundimit të luftës ishte drejtor i QKMF në Drenas, nga viti 2000 deri në vitin 2004, kurse nga viti 2004 deri në vitin 2007, ka ushtruar pozitën e nënkryetarit të Komunës së Drenasit.

Pasi mbaron mandatin në atë pozitë dr. Gani Halilaj, nga viti 2007 e deri në vitin 2012 punoi përsëri drejtor i QKMF-së në Drenas.

Gjatë periudhës 2012-2014 punoi në pozitën e udhëheqësit të Zyrës për Shëndet Mendor në Ministrinë e Shëndetësisë, ku kontribuoi në zhvillimin e infrastrukturës ligjore dhe në Strategjinë Afatgjatë për Shëndetin Mendor në Kosovë.

Nga viti 2014 emërohet drejtor i Institutit të Psikiatrisë Forenzike,

ku puna e tij shquhet në ngritjen e kapaciteteve profesionale e rregullative prej themelimit të Institutit e deri me sot, duke u vlerësuar pozitivisht nga shumë organizma monitorues vendor e ndërkombëtar.

Është autor i Monografisë me të njëjtën temë dhe titull sikur, i temës së Doktoratës: "Ptd tek popullata e Drenicës 13 vite pas luftës dhe korrelacionet me depresionin dhe nivelin e cilësisë së jetës".


Në vitin 2016 shpallet drejtori më i suksesshëm, dhe Instituti i Psikiatrisë Forenzike institucioni më i suksesshëm nga QKUK.

Bibliografia

Ka një numër të konsiderueshëm punimes shkencore, publikime dhe pjesëmarrje aktive në konferenca vendore e ndërkombëtare:

- “Anger, hyperactivity, conduct, self-esteem, hopelessness and suicidality at one clinical adolescent sample”. Eur Child Adolesc Psychiatry 22 (Suppl2);
- Healthcare: Kosovo case. WPA XVII Word Congress of Psychiatry, 2017, Berlin.
- “Djemtë kundërvajtës dhe me problem të sjelljes. Konferenca e dytë e adiktologjisë, Tiranë.
- Youths With conduct problems. European Psychiatry, Volume 41, Supplement 2017;
- “Adolescent offenders profile in one Kosovo correctional centre“, 5th EFCAP Congress, Association for Child and Adolescent Psychiatry, 10-13.05.2016, Porto Portugal;
- Establishment, issues and problems; 5th European Conference on Mental Health, September, 14-16, 2016; Prague, Czech Republic, 2014/12/ECMH;
- “Benefits of the compulsory treatment for mentally ill persons who commit offences in IPFK”, WPA co-sponsored International Conference on Forensic Psychiatry, October 13-15, 2016, Ohrid, Macedonia 2016/10/ SCIENTIFIC–PROGRAMME;
- “Profesionet; Komplementariteti dhe Konkurrenca; 5th Albania Psychiatric Association“;
- “Mole offenders and youth with condents problems“, WPA XVII, World Congress of Psychiatry, 8-12;11. 2017, Berlin Germany;
- “PTSD in Kosovo, thirteen years after the war” European Congress of Psychiatry, Munich Germany, 2017.

GANI XHAFOLLI (1945-2015)



Gani Xhafolli u lind në fshatin Drenovc, afër Prishtinës, në vitin 1945.

Ndryshe, ai punoi në arsim: në Drenovc, Barilevë, në Lipjan dhe në Magure, si mësues.

Në Radiotelevizionin e Prishtinës, prej vitit 1979, ishte redaktor në programin për fëmijë. Në vitin 1990, pushtetarë të shtetit Jugosllav e largojnë me dhunë nga puna, së bashku me 1340 punëtorë të RTP-së.

Xhafolli ka të kryer Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Ka fituar shumë çmime letrare.

Gani Xhafolli punoi redaktor i programit për fëmijë në Televizionin e Prishtinës dhe drejtoi revistën "Zanore". Ka botuar disa përmbledhje me poezi dhe romane për fëmijë, si:

"Te porta e edhave", "Zog shiu", "Vjershën s'e zë gjumi", Shtëpia me kulm teposhtë", "Po", "Të dua", "Në gojë të gjarprit", "Princesha që fluturon", "Zgjedhje" "Dosjet në kutinë e zezë", "Gishtat me flutura".

Ishte stilist i përsosur i përmasave të paimagjinueshme e poetikës letrare. Xhafolli me letërsinë e tij mbetet i veçantë si shkrimtar në sferën e imagjinatës krijuese, në këndvështrimin e tij origjinal e në konceptimin modern tekstor e mjaft interesant të larushisë së temave, do të hyjnë imagjinata e semantizimit të shenjave të ndryshme grafike, të grafemave dhe të shkronjave.

Gjeneratat e mëhershme e mbajnë në mend gjithnjë si një shkrimtar që ka thyer kodet e regjimeve të hekurta me liberalizimin e tij jetësor e letrar, si dhe emisionet që përgatiste për radiotelevizionin e Prishtinës. Fëmijët do e mbajnë në mend si shkrimtar të dashur, për paraqitjet e tij spektakulare të një komunikimi të papërsëritshëm deklamues të vargjeve, me emocionet që zgjonte dhe me porosinë tejet të lirshme e me frymë moderne, që e përcillte te ta.

Gani Xhafolli ishte i veçantë si në krijime ashtu dhe kur i përformonte ato, ai asnjëherë nuk i recitonte thjeshtë ose veç t'i lexonte, por bënte një lloj shfaqje me to. Ai do të mbahet mend si artist i letërsisë. Vargjet i bënte si shfaqje, herë besa edhe i këndonte. Ai ishte i afërt, i veçantë, karakteristik në vargjet e tij.

Ganiu ndërroi jetë në vitin 2015, ai sot i mungon kulturës dhe letërsisë...

GAQO ÇAKO (1935-2018)



Gaqo Çako është këngëtar shumë i njohur. Tenori legjendar, Gaqo Çako, artist i popullit, i rreshtuar në emrat e mëdhenj të Panteonit të muzikës shqiptare.

Gaqo Çako, u lind në Korçë, më 1935 dhe në moshën trembëdhjetë vjeçare së bashku me të ëmën u shpërngul për në Kuçovë, ku pas mbarimit të shkollës shtatëvjeçare nisi të punojë si tornitor. Në moshën shtatëmbëdhjetë vjeçare ai nisi të studiojë për kanto në Liceun Artistik të Tiranës, nën udhëzimet e Mihal Cikos, dhe pak më vonë e më gjatë të Jorgjie Trujës. Midis viteve 1957 dhe 1961 ai studioi në konservatorin “Çajkovski” të Moskës, nën drejtimin e pedagoges Anna Soloviova. Pas kthimit në Shqipëri, më 1961, ai u emërua tenor i përherëshëm i Teatrit të Operës dhe Baletit të Tiranës.

Është mjaft i njohur edhe në skenat italiane, ku ai ka mbaruar konservatorin e Santa Cecillias.

Ai dëgjohet e shfaqet, në opera, në televizion, në radio, në salla të mëdha a të vogla koncertesh.

Ishte i vetmi këngëtar lirik i Operës së Tiranës, të merrte pjesë dhe të këndonte në Festalet e Radios.

Ndër operat e huaja, ku Gaqoja këndoi, kryesisht rolet e para, përfshihen:

“Traviata”,
“Rigoletto”,
“Aleko”,
“La Bohème”,
“Peshkatarët e perlave”,
“Cavalleria Rusticana”,
“Pagliacci”,
“Madama Butterfly”,
“Berberi i Seviljes” e tjera.

Ndërsa ndër operat shqiptare Gaqoja u dallua në këto: “Mrika” e Prenk Jakovës, “Lulja e kujtimit” e Kristo Konos, “Pranvera” e Tish Daisë, “Heroina” e Vangjo Novës, “Skënderbeu” i Prenk Jakovës e, “Skënderbeu” i Abdulla Grimcit, “Komisari” i Nikolla Zoraqit, “Zgjimi” i Tonin Harapit, “Toka e jonë” e Pjetër Gacit, “Goca e Kaçanikut” e Rauf Dhomit e disa të tjera, ku Gaqoja këndoi rolet e para.

Të qenit pedagog i kantos, për vite me radhë, në shkollën e lartë të arteve në Tiranë, Gaqoja bëri turne edhe në disa vende të huaja si në Bashkimin Sovjetik, Itali, SHBA, Kubë, Austri, Greqi, Rumani, Turqi, Gjermani e Jugosllavi.

Në Dhjetor 1962, Gaqo Çako dhe Luiza Papa marrin pjesë në Festivalin e I-rë në RTSH me këngën "Lum Kush Dashuron". Në Dhjetor 1962, Gaqo Çako merr pjesë në Festivalin I në RTSH me këngën "Kam Një Mall". Në Dhjetor 1967, Gaqo Çako merr pjesë në Festivalin e 6-të në RTSH me këngën "Këngë Për Shkurte Vaten". Në Dhjetor 1968, Gaqo Çako merr pjesë në Festivalin e 7-të në RTSH me këngën "Komisari i Kuq". Në Dhjetor 1969, Gaqo Çako merr pjesë në Festivalin e 8-të në RTSH me këngën "Më Lart Frymën Revolucionare". Në Dhjetor 1970, Gaqo Çako merr pjesë në Festivalin e 9-të në RTSH me këngën "Shtëpia Ku Lindi Partia". Në Dhjetor 1970, Gaqo Çako merr pjesë në Festivalin e 9-të në RTSH me këngën "Borizani". Në Dhjetor 1973, Gaqo Çako merr pjesë në Festivalin e 12-të në RTSH me këngën "Marrshon Shqipëria". Në Dhjetor 1973, Gaqo Çako merr pjesë në Festivalin e 12-të në RTSH me këngën "Poeti Partizan".

Në Dhjetor 1974, Gaqo Çako merr pjesë në Festivalin e 13-të në RTSH me këngën "Qemal Stafa, Yll i Lirisë". Në Dhjetor 1976, Gaqo Çako merr pjesë në Festivalin e 15-të në RTSH me këngën "Këngë Për Tiranën". Në Dhjetor 1977, Gaqo Çako merr pjesë në Festivalin e 16-të në RTSH me këngën "Ti Që Ke Në Sy Lirinë". Në Dhjetor 1978, Gaqo Çako merr pjesë në Festivalin e 17-të në RTSH me këngën "Këputa Një Gjethe Dafine".

Në Dhjetor 1979, Gaqo Çako merr pjesë në Festivalin e 18-të në RTSH me këngën "Parti E Vendit Tim". Në Dhjetor 1980, Gaqo Çako merr pjesë në Festivalin e 19-të në RTSH me këngën "Rrjedh në këngë e ligjërime". Në Dhjetor 1980, Gaqo Çako merr pjesë në Festivalin e 19-të në RTSH me këngën "Nën Yje E Prisnim Vitin E Ri". Në Dhjetor 1981, Gaqo Çako merr pjesë në Festivalin e 20-të në RTSH me këngën "Udhët E Atdheut Më Thërrasin". Në Dhjetor 1982, Gaqo Çako merr pjesë në Festivalin e 21-të në RTSH me këngën "Bijtë E Tu Të Mirë". Në Dhjetor 1982, Liliana Kondakçi dhe Gaqo Çako marrin pjesë në Festivalin e 21-të në RTSH me këngën "Gjuha Jonë E Bukur". Në Dhjetor 1984, Gaqo Çako merr pjesë në Festivalin e 23-të në RTSH me këngën "Të Përshëndes Atdheu Im". Në Nëntor 1999, Pirro Çako dhe Gaqo Çako marrin pjesë në Kënga Magjike 1999 me këngën "Romancë"...

GAZMEND SHAQIRI (1936-2019)



Prof. Dr. Gazmend I. Shaqiri, dr. sc.med, u lind në Shkodër, në vitin 1936. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Prishtinë, fakultetin e mjekësisë në Beograd, specializimin e kirurgjisë së përgjithshme në Akademinë Ushtarake të Mjekësisë në Beograd (1969), ndërsa specializimin e kirurgjisë kardio-vaskulare në UKECH të Pragës (1970-1972) dhe Texas Heart Institute, Houston SHBA (1986-1987). Është themelues i kirurgjisë vaskulare në Kosovë. Me hapjen e Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë zgjidhet

ligjërues (1969), prodekan (1973-1975) dhe dekan i këtij fakulteti (1976-1979).

Pas mbrojtjes së doktoratës nga lëmi i kirurgjisë së enëve të gjakut (1974), merr thirrjen docent, më vonë profesor inordinar (1977) dhe profesor ordinar (1983) për lëndën e kirurgjisë së përgjithshme. Ai udhëheq Klinikën e Kirurgjisë dhe të Ortopedisë, prej vitit 1987 deri në shtator të vitit 1990, kur, si pasojë e represionit serb, dëbohet nga puna.

Dëbimi i tij nga puna e ka ndërprerë realizimin e projektit për themelimin e kirurgjisë kardiace në Prishtinë. Pas kësaj vazhdon të punojë në kirurgjinë kardiorakale në Klagenfurt, Austri. Shaqiri ka pasur nderin të shkollojë, të edukojë dhe të avancojë një plejadë të tërë mjekësh dhe kirurgësh kosovarë. Ka botuar mbi 210 punime shkencore.

Ka marrë pjesë në tubime të shumta shkencore në vend dhe jashtë tij.

Vdiq më 15 korrik të vitit 2019.

Botimet:

- “Sëmundjet e arterieve”(1989); “Kirurgjia e zemrës dhe aortës”(1994);
- “Doracakët medicinal në praktikën ditore”(1996);
- “Kirurgjia urgjente, Lëndimet“(1999);
- “Kirurgjia urgjente, Pjesa e përgjithshme”(2001);
- “Kirurgjia, Sëmundjet akute, Pjesa speciale”(2001);
- “Ndërhyrjet kirurgjike“(2005); Ditari i kirurgut”(2006);
- “Patokirurgjia“, (2010). “Pagjakësia e anësive trupore-Sëmundjet e arterieve periferike“(2016),
- “Kirurgjia e enëve viscerale të gjakut”(2019),
(koautorë: Prof. Dr. Gazmend Shaqiri dhe Dr. sc. Luan Jaha).

Ka botuar mbi 210 punime shkencore...

GAZMEND ZAJMI (1936-1995)



Akademik Gazmend Zajmi, u lind në Krumë, më 1936. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Prizren. Fakultetin Juridik dhe Studimet post-diplomike (drejtimi juridik-politik), i mbaroi në Beograd. Doktoroi më 1972.

Tre vjet ushtroi detyrën e gjykatësit e të kryetarit të Gjyqit të Rrethit të Prizrenit. Me themelimin e Fakultetit Juridik të Prishtinës u zgjodh asistent. Pas viteve 1963-67, ushtroi detyrën e profesorit të Fakultetit Juridik për lëndët Sistemi politik dhe E drejta kushtetuese. Qe shef i Katedrës së Shkencave Politike, prorektor dhe rektor i Universitetit të Prishtinës, kryetar i Shoqatës së Pedagogëve Universitarë të Kosovës, anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Shoqatës të së Drejtës Komparative të Jugosllavisë, kryetar i Bashkësisë së Universiteteve të Jugosllavisë, anëtar i Komitetit të Përhershëm të Konferencës së Rektorëve të Evropës, etj.

Ish nënkryetar dhe kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Në vitin 1992 u zgjodh anëtar i Akademisë Evropiane të Shkencave me seli në Strasburg.

Ishte një ndër figurat më të ndritshme intelektuale të vitit të madh 1968. Artikuloi kërkesat për Republikën e Kosovës, për vetëvendosjen e shqiptarëve, për Kushtetutën e Kosovës, për Universitetin e Prishtinës, për shkëputjen nga Serbia dhe barazinë e plotë të shqiptarëve me popujt e tjerë të ish-Jugosllavisë.

Prandaj, regjimi e largoi nga posti i rektorit, e përjashtoi edhe nga Universiteti.

Ishte iniciator dhe autor i Apelit 215, të intelektualëve shqiptarë, në mars të vitit 1989. Në vitin 1990 ishte kryehartuesi i Deklaratës së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, për pozitën e re Kushtetuese të Kosovës, dhe përpilues i tekstit të Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut 1990, dhe dokumenteve të tjera për avancimin e pozitës konstitucionale-juridike të Kosovës.

Publikoi mbi 30 punime shkencore dhe katër studime monografike. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës i botoi veprat e tij në katër vëllime.

Është gjithashtu autor i tre vëllimeve me kompozime këngësh dhe i dy vëllimeve me vargje të këngëve të kompozuar. Vdiq më 1995.

Botimet:

“Ustavno-pravna zaštita i tretman jezika nacionalnih manjina u Evropi izmedju dva svetska rata”, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 1982;

-Vepra I, ASHAK, 1997.

-Vepra II, ASHAK, 2001.

-Vepra III, ASHAK, 2003,

-Vepra IV, ASHAK, 2004.

Artikujt dhe studimet:

-Quelques aspects theoriques de la corelation entre le traitement de minorites nationales dans le droit international et le droit constitutional, Conference internationale sur les minorites, Triestes, 27-31, maggio 1974;

-Same observations on the (language) possition of national minorities in Europe after the first eorld ear, in connection eith contempirery problems of national minorities, United Nations S.O. 216/3 (26), United Nations Seminar on the promotion and protection of human rights of national, ehnie and other minorities, Ohrid, Jugoslavija, 1974, “Ohrid Seminar”, 1975, Nova Makedonija;

-“L'essenza politica delle miknoranze nazionali” Atti del simposio sui problemi socioeconomici e ambientali degli Sloveni in Italia, volume I, Trieste 1978;

Language equality among the nations and nationalites of Yugoslavia, Nations and nationalities of Yugoslavia, Medjunarodna politika, Beograd, 1974;

-Od flotantnosti iseljenika do njihove etničke (nacionalne) aglomeracije, Iseljenišтво naroda i narodnosti Jugoslavije i njegove uzajamne veze s domovinom, Zavod za migracije i narodnosti, Zagreb, 1978 (separat);

-Marksizmi dhe vetëqeverisja, Përparimi, nr. 2/75;

-L'autogestion. Dokuments. Centre International de coordination des Rexherches sur l'autogestion (CICRA) Paris, septembre, 1977;

-Functions and aspects of the balanced and effective development of the universities of developing countries and/or regions, International Association of Universities. Seventh general conference, Manila 1980, documents.

-Nelogičnost u mehaničkoj paraleli izmedju teorije o odumiranju države i teorije o odumiranju nacije, Socijalizam u svetu, Medjunarodni časopis marksističke i socijalističke misli, Beograd, 1980.

GËZIM AJGERAJ



Gëzim Ajgeraj, u lindimë 1967, në Malësinë e Vërrinit. Jeton dhe krijon në Zvicër.

Ka bashkëpunuar dhe bashkëpunon me të gjitha gazetat dhe revistat në gjuhën shqipe. Nga janari i vitit 2004, çdo tre muaj nxjerr revistën “Metafora”. Së fundi, është duke e botuar edhe revistën “Vërrini” (dy herë në vit).

Botimet:

“Klithmë malli”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë, 1997, “Ëndrra për parajsë”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë, 1998, “Qiellit po digjem”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë, 1998, “Flakë në plagë”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë, 1998, “Kënga e babait”, poezi për fëmijë, “Apolonia”, Prishtinë, 1998, “Urti popullore të Vërrinit 1” (bashkautor), “Apolonia”, Prishtinë, 1998, “Mallëngjimi”, poezi, “Rilindja”, 2000, “Balada e Vërrinit” (poemë), KL “F. S. Noli”, Prizren, 2001, “Rruga e lirisë”, dramë, “Meshari”, Prishtinë, 2001, “Rruga e lirisë” (intervistë me Zafir Berishën), Asociacioni i Veteranëve të UÇK-së, Prizren, 2002, “Pëllumbat e lirisë”, novelë për fëmijë, “Fidani”, Prizren, 2004, “Ditët e bardha”, novelë për fëmijë, “Fidani”, Prizren, 2004, “Lulëkuqet e Vërrinit”, poezi, “Metafora”, Zvicër, 2005, “Zana në mërgim” (poezi për fëmijë), “Metafora”, Prizren, 2007, “Huqet e Benit” (poezi për fëmijë), “Metafora”, Zvicër, 2007 “Bosi lepurushi”, fabula, “Metafora”, Zvicër, 2006, Gjëegjëza: “Metafora”, Zvicër, 2006, “Dita me Tonin” (poemë), “Metafora”, Zvicër, 2006, “Muajt e vitit me Ardin” (poemë), “Metafora”, Zvicër, 2006, “Dallëndyshja në Vërrin” (poezi për fëmijë), “Metafora”, Prizren, 2007, “Kroi i qytetit tim” (poezi për fëmijë), “Metafora”, Prizren, 2007 “Masakra e Tuzsuzit”, monografi, (bashkautor), “Metafora”, Prizren, 2007 “Degë e thyer”, poezi, “Metafora”, Prizren, 2007, “Misioni i kriminelit”, roman, Prizren, 2009, “Serboarmatosja”, roman, Prizren, 2012, “Etje në fjalë”, poezi, Prizren, 2013, “Kthimit furtunat m’i bëjnë prita”, poezi, Prizren, 2013, “Nxitoj të kthehem me dritë”, poezi, Prizren, 2013, “Xhevat Berisha - Legjenda e Vërrinit”, monografi, Prizren, 2013, “Bashkimi bën fuqinë”, (poezi për fëmijë), Edicioni i revistës “Fidani”, Prizren, 2013, “Studentët”, roman, “Metafora”, Prizren, 2014, “Arti poetik i Ibrahim Skenderit nën optikën e rivlerësimit”, kritikë letrare, “Metafora”, Prizren, 2014, “Shtigjet e bardha”, Novelë letrare, (Ribotim), Prizren, 2014,

“Të jesh shkrimtar 1”, Ese letrare, “Metafora”, Prizren, 2014,
“Ah, ky art i shkrimit 2”, ese letrare, “Metafora”, Prizren, 2014,
“Arti e “Metafora” 3”, ese letrare, “Metafora”, Prizren, 2014,
”Një kafe me miqtë e metaforës”, antologji, “Metafora”, Prizren, 2014.
“Në rrjedhën e Drinit”, antologji, “Metafora”, Prizren, 2014,
“Çaste alpikë”, poezi, “Metafora”, Prizren, 2014,
“Piktura në mur”, poezi për fëmijë e të rinj, “Metafora”, Prizren, 2014,
“Duhemi sikur”, lirika dashurie, “Metafora”, Prizren, 2014
“Art “Metafora”, poezi, “Metafora”, Prizren, 2014,
“Helmimi”, Roman, “Metafora”, Prizren, 2014,
“Metafora e lirisë”, vështrim rreth krijimtarisë së Bedri Halimit, shoqata kulturore “Ymer Prizreni”, 2014, “Periodiku i kohës për luftën në Vërrin e Prizrenit–1”, publicistikë, “Metafora”, Prizren, 2014,
“Larg pikon malli”, poezi, “Metafora”, Prizren, 2015,
“Mbi rima bie shi”, botoi, “Metafora”, Prizren, 2015,
“Larg pikon malli”, poezi, “Metafora”, Prizren, 2015,
“Pranvera poetike në Vërrin”, antologji, “Metafora”, Prizren, 2015,
“Metafora” e fjalës”, studime letrare, “Metafora”, Prizren, 2015,
“Kukulla Elonë”, poezi për fëmijë, “Metafora”, Prizren, 2015,
“Teatri Lona”, poezi për fëmijë, “Metafora”, Prizren, 2016,
“Gjemba në fjalë”, poezi për fëmijë e të rinj, “Metafora”, Prizren, 2016
“Rob”, roman, “Metafora”, Prizren, 2016,
“Gjashtë picimulët në olimpiadë”, përralla për fëmijë, “Metafora”, Prizren, 2016, “Libri është porta e botës”, poezi për fëmijë e të rinj, “Metafora”, Prizren, 2016, “Trëndafilat e pranverave të kuqe”, “Metafora”, Prizren, 2016
“Notesi i poetit mërgimtar”, “Metafora”, Prizren, 2016,
“Copëzat e idealizmit”, “Metafora”, Prizren, 2016,
“Kësulëkuqja Koni kërkon një shtëpizë” (përralla për fëmijë), “Metafora”, Prizren, 2016,
“Ditari i ushtarit të lirisë”, SHKYP, Prizren, 2016 etj.

Është përfaqësuar në shumë antologji dhe leksione me punimet e tij.

Deri më tani, ka botuar 113 libra, nga të gjitha zhanret letrare. Është nderuar me çmimin “Shkrimtari më mirë i vitit 2014” nga Drejtoria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sportit, komuna e Prizrenit, 2014.

Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, i Lidhjes së Shkrimtarëve të Zvicrës (SSV) dhe anëtar i Shoqatës së Krijuesve Shqiptarë në Zvicër.

GËZIM ALPION



Gëzim Alpion u lind në Peshkopi, në vitin 1962. Ai ndoqi studimet universitare dhe pasuniversitare në Universitetin e Kajros nga 1985-1993. Në vitin 1997, Alpion mbrojti Doktoratën në Universitetin e Durhamit në Angli. Ai ishte lektor në Universitetet Huddersfield, Sheffield Hallam, dhe Newman në Angli.

Alpion ka shërbyer si ekzaminues doktrorash në universitete të mirënjohura në Indi, i Programit të Sociologjisë në Universitetin York St John në Angli, dhe i Shkencave Shoqërore për Komisionin e Arsimit të Lartë të Maltës.

Anëtar bordi i disa revistave akademike, si: “Celebrity Studies” (Routledge), Alpion ka recensuar artikuj për revista shkencore.

Fillimisht, Alpion tërhoqi vëmendjen e mediave britanike kur dramat e tij: “Vouchers: A Tragedy” dhe “If Only dhe Dead Could Listen” u shfaqën me sukses me sponsorizimin e Këshillit të Arteve të Anglisë në disa qytete angleze në 2002, 2006 dhe 2008.

Libri i tij i mirënjohur “Mother Teresa: Saint or Celebrity?” u botua nga Routledge në Oksford dhe Nju Jork në 2007. Edicioni indian i kësaj vepre u botua nga Routledge në Nju Delhi në 2008. Po atë vit, Salerno Editrice botoi në Romë edicionin italian. Libri i Alpion Encounters with Civilizations: From Alexander the Great to Mother Teresa u botua fillimisht në Indi nga Meteor Books në vitin 2008.

Disa studime të Alpion rreth sociologjisë së fesë, nacionalizmit, dhe mediave janë përfshirë si kapituj në libra botuar nga SAGE Publications, University Press of America, dhe Brewin.

Monografia e re e Alpion Mother Teresa: “The Saint and Her Nation” do të botohet nga Bloomsbury Academic në Londër, Nju Jork, Nju Delhi dhe Sydney në 2020.

Punimet e botuara në revistat shkencore:

Continuum: “Journal of Media & Cultural Studies”,

“Journal of Southern” “Europe and the Balkans”,

“Celebrity Studies”,

“The Review of Communication”,

“Islam and Christian-Muslim Relations” (Routledge),

“Studies in Religion/Sciences Religieuses” (SAGE Publications), etj.

Vitet e fundit, Alpioni ka zhvilluar më se 50 ligjërata në universitete të mirënjohura në 15 vende.

Ai gjithashtu ka zhvilluar turne leksionesh në Indi (2005), Amerikën e Veriut (2008), dhe Finlandë (2012).

-Gëzim Alpioni, *Encounters with Civilizations: From Alexander the Great to Mother Teresa*, London and New York: Routledge, 2017.

-Alpion, G., *Madre Teresa: Santa o Celebrità?* Trans. Massimo Laria. Rome: Salerno Editrice, 2008.

-Alpion, G., *Mother Teresa: Saint or Celebrity?* London, New York, 2007; New Delhi: Routledge India 2008.

-Alpion, G., "The Specter of Communalism and the Eugenic Solution to Britain`s Immigration Problem", in J. Tripathy and S. Padmanabhan (eds.), *Becoming Minority: How Discourses and Policies Produce Minorities in Europe and India*, London and New Delhi: SAGE Publications, 2014;

-Alpion, G., "European Media and Outsiders within", in A. Schumann (ed.), *Logic in Central and Eastern Europe: History, Science and Discourse*, Lanham, MD: University Press of America, 2012;

-Alpion, G., "Why are modern spiritual icons absent in celebrity studies?" *Celebrity Studies Journal* (Routledge). Published online in February 2019;

-Alpion, G., 'The Emergence of Mother Teresa as a Religious Visionary and the Initial Resistance to Her Charism/a: A Sociological and Public;Theology Perspective', *International Journal of Public Theology*, Vol. 8, No. 1, February 2014;

-Alpion, G., 'Media and celebrity culture: subjectivist, structuralist and post-structuralist approaches to Mother Teresa's celebrity status', *Continuum: Journal of Media & Cultural Studies*, Vol. 20, No. 4, 2006;

-Alpion, G., *Media, ethnicity and patriotism: The Balkans "unholy war" for the appropriation of Mother Teresa*, *Journal of Southern Europe and the Balkans*, Vol. 6, No. 3, 2004 etj.

Specializimet e Gëzimit përfshijnë sociologjinë e fesë, nacionalizmin, famën, racën, median, filmin dhe autorësinë. Në botimet e tij të fundit ka eksploruar konceptin e karizmit nga një perspektivë teologjike sociologjike dhe publike, retorika populiste e Enoch Powell në kontekstin e ligjërimit eugjenik, dhe arsyet e mungesës së ikonave moderne shpirtërore në studimet e famshëm. Gëzimi aktualisht është duke zhvilluar idenë e "kapitalit të famës" si një ndryshore në një kontekst ndërkombëtar...

GËZIM MEKULI



Gëzim Mekuli, u lind në Pejë (1966). Studioi në Universitetin e Prishtinës gjuhën dhe letërsinë angleze. Në Mainz të Gjermanisë studioi shkencat politike. Në Norvegji (Oslo) studioi shkencat e Filmit, Mediave dhe Komunikimit. Magjistroi në shkencat e Mediave (në drejtimin e Retorikës) në Universitetin e Bergenit, (Norvegji).

Mekuli është kritik i parë i mediave në përgjithësi në Kosovë. Gëzim Mekuli është i gjallë në debatet publike; në rrethin intelektual respektohet si kritik i paanshëm dhe si intelektual që solli frymë të re në fushën e kritikës së shkencave të medias.

Kritika:

Mediat dhe Politika;

- Etika në gazetarinë shqiptare, Mediabërësit dardan dhe etika e tyre,
- Etika dhe përgjegjësia kapitale e publikut dardan,
- Gazetarët shqiptarë një bandë amatorësh,
Mediat dhe feudali;
- Amputimi i trurit logjik,
- Shteti ligjor (Pravna drzava),
- Kolonializimi i mendjes shqiptare,
- Retorika vizuele dhe politika,
- Nuk është “karikaturë”, nuk është “zhele”. Është ikona e simboli ynë!,
- Ju jeni të pavdekshëm,
- Dhurata tragjike.

Mediat, Fëmiu dhe Etika;

- Etika në media dhe përgjegjësia e publikut,
- Fëmijët dhe lajmet televizive,
- Mediat dhe politika, Monopoli i agjencive të lajmeve,
- Mediat dhe politika; “Vrasësi i demokracisë;”,
- Propaganda e fotografive,
- Retorika dhe politika-Gazeta “Pravda” dhe “Kamishi”,
- Mediat, Retorika dhe “Armiku”,
- Mediat dhe politika; Partia, gazetaria dhe z. Dell,
- Mediat dhe politika; Gazetaria dhe fjala e lirë (19 vite më parë)
- Mediat dhe politika; Këta po na fryejnë, etj.

Shumë artikuj të Gëzim Mekulit mund ti gjeni Albania Opinion, etj.

GJIN KOL MUSA



Gjin Kol Musa ka lindur më 15.06.1952, në fshatin Nanmavriq të Bajrakut të Shalës, Dukagjin, Republika e Shqipërisë.

Është larguar nga vendlindja, pa i mbushur mirë tre vjeç. Prindërit e tij vendosen në qytetin e Shkodrës. Aty përballë kishës së Shënkollit. Me kalimin e viteve, vendosen në fshatin Kukël të Lokalitetit Bushat.

Arsimimi dhe dija ishin pasioni i jetës. Me shumë dëshirë dhe pasion shërbeu në radhët e ushtrisë, si në aviacion dhe për një periudhë kohe komandant i Repartit 2203/b pranë detashmentit të Ministrisë së Mbrojtjes në Tiranë.

Mbështetja maksimale ishte nga e Komandanti i Detashmentit, Gjeneral Milto Kosova ia arritën dëshirën dhe pasionin për uniformën ushtarake ushtarakut të ndritur Gjin Kol Musa.

Gjin Kol Musa filloi të shkruajë në shtypin e kohës dhe në Radio Shkodra, Radio Tirana e tjera.

Me ardhjen e demokracisë, në mbështetje të votave të fituara, ai emërohet nga Kryeministri shqiptar, Aleksandër Meksi, Sekretar i Këshillit të Komunës Bushat, ndër më të mëdhatë në shkallë republike.

Në nëntor të vitit 1994, piloti, gazetari dhe publicist Gjin Kol Musa me lot në sy emigroi në Itali.

Ai pas emigrimit në Itali e filloi bashkëpunimin me radio dhe gazeta shqiptare, si dhe më gazetarët: Pëllumb Troci dhe Jaho Margjeka. Për disa vite ishte korrespondent i rregullt Radio Sofisë në Bullgari, në gjuhën shqipe.


Bashkëpunim dinjitozë në vitet e fundit e ka me gazetën “Fjala e lirë”, me botues, Arben Çokaj ,si dhe me disa gazeta të tjera si “Idea”, “Sot”, ”Floripress” e tjera.

Gjini, sot ka në pronësi portalin "Nji Dritare e Re" dhe "Radio Zëri i Mërgimtarit", këto portale mbajnë pronësinë e Gjin Kol Musa.

Gjini për 16 muaj ka botuar dhe publikuar mbi 10.000 shkrime autoriale, si dhe krijimtari të poetëve dhe autorëve të ndryshëm nga e gjithë hapësira shqiptare dhe bota.

Nga viti 2018 është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve Shqiptaro-Amerikane në New York, Tiranë, Prishtinë dhe Shkup.

GJON BORIÇI



Prof. Dr. Gjon Boriçi u lind në Tiranë, më 12 qershor 1977. Ka përfunduar studimet universitare në Fakultetin Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës. Mban titullin doktor i shkencave historike në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare të Shqipërisë, ka diplomuar në Institutin e Historisë të Qendrës, sot Akademia e Studimeve Albanologjike.

Është i specializuar në marrëdhëniet shqiptaro-kineze dhe studimet e marrëdhënieve ndërkombëtare në periudhën e Luftës së Ftohtë.

Dr. Gjon Boriçi ka një eksperiencë 14 vjeçare në mësimdhënie në arsimin e lartë brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

Në shtator 2017, Dr. Boriçi është zgjedhur për të marrë pjesë në programin studimor shkencor ndërkombëtar "China Studies", organizuar nga Akademia e Shkencave Shoqërore dhe Ministria e Kulturës e Republikës Popullore të Kinës.

Dr. Gjon Boriçi është punonjës shkencor në Departamentin e Historisë Bashkëkohore në Institutin e Historisë të Akademisë së Studimeve Albanologjike, në Tiranë.

Monografi dhe artikuj shkencor:

1. "Studime, Artikuj, Ese-Studime, Articles, Essays" (Shqip-Englisht) (GEER, 2006);
2. "Marrëdhëniet ndërkombëtare në vorbullën e diplomacisë" (GEER, 2006), Botimi II, UFO University Press, 2009;
3. "Pushteti dhe Lidërshipi" (GEER, 2007) - Botimi II, UFO University Press, 2009);
4. "L'ex Yougoslavie entre la violence et la paix" (GEER, 2007);
5. "Lufta për paqen në ish Jugosllavi 1987-1999" (GEER, 2008), Botimi II, UFO University Press, 2009;
6. "Politika, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe diplomacia në shekujt e historisë", (1600-1899) Vol. I (GEER, 2008), Botimi II, UFO University Press, 2010. Etj.

Përkthimet nga shqipja në anglisht:

1. "Albanian diplomacy between the past and the future", 2004;
2. "National and European Identity of Albanians", Tiranë, 2004;
3. "Serb terrorist and extremist organizations in Kosova", Prishtinë, 2015.

GJON FRANÇESK ALBANI (1649 -1721)



Amaneti i Papa Klementi XI-Albanit: “*Më varrosni në mënyrë shumë të thjeshtë, por të shkruhet në pllakën time që Papa Albani është Papë në Romë, por rrjedh nga gjaku shqiptar*”.

Papa me origjinë shqiptare, Klementi XI (Gjon Françesk Albani) lindi më 23 korrik 1649 në Urbino dhe vdiq më 19 mars 1721 në Romë).

Ishte papa i 243 i kishës katolike. Shërbeu si papë që nga zgjedhja e tij më 23 nëntor 1700 dhe deri më 19 mars 1721. Në vitin 1660, pas kryerjes së shkollës fillore, shkoi në Romë për të ndjekur kolegjin romak. Studjoi gjuhë të vjetra dhe drejtësi.

Në vitin 1668 diplomohet në drejtësi. Në vitin 1670 fillon karrierën kishtarë. Nga papa Inoçenti XI u emërua sekretar i Brevave (dekreteve papnore). Më 13 shkurt 1690 emërohet kardinal. Më 9 tetor 1700 zgjidhet Papë i kishës katolike.

Krenaria e origjinës shqiptare e Papës Klementi XI- Albani u shfaq në çastin kur u zgjodh Papë. Mbas emrit të tij Papnor, ai kërkoi që t'i vendosej mbiemrit të vet Albani, për t'i treguar botës se është shqiptar.

Papa Albani në latinisht shkruhet: “*Clementes Undecimo Albani Urbinas*“ që shqip do të thotë “*Shqiptari Klementi XI nga Urbino*“.

Madje, sipas biografit të tij personal francezit M. Reboule, në emrin e tij të Papës, ai shikonte edhe emrin toponimik të fisit të shquar shqiptar të Kelmenit. Sipas biografit, Papa Françesku u emocionua shumë nga krenaria, kur mori vesh se si Papë, atij ju vu emri Klementi, jo për faktin se emri i tij “Klementi“ kishte kuptimin (i miri), por për faktin se ky emër papnor përkonte me emrin e fisit të tij luftarak të Shqipërisë së Veriut, Kelmenit, nga kishte zbritur stërgjyshi i tij Mikeli.

Konti i Kelmenit me luftëtarët e tij kelmenas i qe bashkuar ushtrisë së Skënderbeut në vitin 1447, kur ai rrethoi Danjën në luftime kundër Venedikut. Më vonë, dy djemtë e Mikelit, Gjergji e Filipi, gardistë të Skënderbeut, kelmenas, zbritën me ushtrinë e tij në vitin 1461, kur ai pati ndihmuar Ferdinandin e Napolit në luftë kundër Anzhuinëve.

Për të gjallëruar marrëdhëniet me Mbretërinë e Napolit, si dhe për të siguruar më pas ndihmën për qëndresën e shqiptarëve ndaj turqve prej mbretit Ferdinand e aleatëve të tij, Papa Piu II dhe dukës së Milanos, Françesk Sforcës, të cilët formonin bllokun politik më të fuqishëm në Itali,

Skënderbeu gjykoi t'i jepte ndihmë ushtarake mbretit Ferdinand në luftën që kishte shpërthyer midis tij dhe kundërshtarëve të vet politik, që ishin baronët e Italisë së Jugut. Këta ishin bashkuar me princin francez Rene të Anzhuinëve, të cilët pretendonin fronin e mbretërisë së Napolit.

Skënderbeu pasi i shpartalloi forcat armike e siguroi pushtetin e Mbretit, Ferdinandi në shenjë mirënjohje për këtë ndihmë i dhuroi Skënderbeut, feudet e Monte Sant Anxhelos e të San Xhovani Rotondos si dhe një pension vjetor prej 1200 dukatësh.”(“H.P.Shqip." V.I f443).

Skënderbeu e pati lënë në Urbano kontin kelmenas, bashkë me 30 gardistë për të mbrojtur kështjellat dhe tokat që i dhuroi Mbreti, ku pasardhësit e kësaj dege formojnë vazhdimësinë e dinastisë së Albanëve.

Gjergji pati dy djem Antobelin dhe Hanibaldon. Po kështu Antobeli pati dy djem Oracin dhe Karlin. Karli është babai i Gjon Françeskos (Frانيت). E ëma quhej Elena (Lena me origjinë shqiptare).

Kjo familje ka dhënë një dinasti të shquar prelatësh, një papë dhe disa kardinalë, si dhe një radhë politikanësh. Për rolin e saj në histori, emrin e kësaj familje dhe pinjollëve të saj të veçantë, janë shkruar në enciklopeditë e shumta botërore.

Për vendin nga e ka prejardhjen dinastia e Albanëve në vendin tonë, janë dhënë mendime të ndryshme. Për këtë fakt At Zef Valentini është më i sakti. Ai do të shprehët: *“Nji familje shqiptare- fis të Dukagjinëvet ose dalë prej feudëve të tyne e pikrisht prej Laçit, por s'dihet prej cilit Laç - ishte bartë në Itali... dija e virtyti e çuan në ma të naltën kambë të botës, në fronin papnuer; aty me emnin Klement XI shëndriti në botë si një ndër më të mirit papë të këtyne shekujve të fundit; andej u dërgonte urdhna ipeshkëvet shqiptarë e i drejtonte n'atë Koncilin e Arbërit që nisi të përtrimit moral të Shqipnisë veriore; andej rrokej që t'u vinte në ndihmë kelmenasvet, që kishin çue krye kundër turkut.”* (At Valentini "Vepra III" f. 75).

At Valentini nuk gabon, kur thotë : *“Familja Albani i përket fisit të Dukagjinit ose e dalun prej feudalëve të tyne”*.

Në shekullin e XV kontea e Kelmenit ishte pjesë e zotërive Dukagjinas. Madje deri vonë malësorët e Malësisë së Madhe të ulur në Breg të Matit e sidomos kelmenasit e kësaj Malësie janë quajtur *“Lekët”*, për nderë të Lek Dukagjinit me të cilin ata patën luftuar kundër osmanëve.

Emrin Laç që përdor studjuesi, ai e vë në dyshim, se cilit Laç i përket kjo familje. Përrjashtohet emri Laç i Kurbinin, sepse n'atë kohë ishte domen i Kastriotëve dhe jo i feudalëve Dukagjinas.

Po të merret llogapi i Albanëve, Laç, në të vërtetë në dokumentat latine shkruhet “Laze“, shqip Lace. Emër toponimi që edhe sot, që nga koha e Mesjetës, ndodhet në Rozhajë, djepi i Kelmenit, (Lace e Rozhajës). Por më i saktë është llogapi Laze (Lac) i Albanëve, Mikel Lace-emër njeriu e jo toponim, i përdorur shumë deri më sot tek kelmanasit. Ka kuptimin e djalit, lindi me lac, që do të thotë lindi djalë . Sot gjenden mjaft emra e mbiemra tek kelmenasit Mbishkodër e Nënshkodër, që quhen “Lac“.

At Gusepe Valentini, po këtu në veprën e tij të tretë, në pjesën “Venecia dhe Shqipëria“ (f.25), na vë në dukje interesimin e madh të Papës Klementi XI, që të shpëtonte kelmenasit kryengritës nga raprezaljet e osmanëve, duke i propozuar Venedikut edhe shpërnguljen e tyre në një provincë veneciane, për të cilën publicisti italian na dëfton se: *“Papa i Romës (Klementi XI) i lutej Zonjës (Venedikut) t'i vinte në ndihmë fiseve të Kelmenit, duke marrë prej saj edhe premtimin për një mërgim të sigurtë, nëse nevoitet, të popullsisë në Kataro.”*. Shpresa e vazhdueshme e papës me origjinë shqiptare Klementi XI për të bashkuar krishterimin, dha rezultat të mirë në Shqipëri, ku kisha katolike romake dhe ajo ortodokse bashkëjetuan për një periudhë. Me 14 janar 1703 u mbajt “Kuvendi i Arbërit“ në Mërq të Lezhës, në Kishën e Shën Gjonit, me nxitjen dhe përkrahjen e drejtpërdrejtë të Papa Klementi XI-Albani. Ky kuvend ishte më i rëndësishmi që zhvillohej në Shqipëri pas Kuvendit të Besëlidhjes së Skënderbeut në Lezhë. Kuvendi i Arbërit është absolutisht, mund të thuhet nga më të rëndësishmit në historinë kombëtare shqiptare. Problemet që ky kuvend trajtoi janë në tri rrafshë: Në rrafshin kanonik kishtar, doktrinor, në rrafshin organizativ-ekonomik dhe pragmatist si dhe në rrafshin arsimor dhe politik të kombit shqiptar dhe në këtë kuadër kishte tre objektiva kryesore: -Bashkimin e shqiptarëve dhe ndaljen e islamizmit, që kishte marrë dhenë. -Zbatimin e kanunoreve morale e kishtarë nga ana e klerit katolik. -Mbrojtjen dhe përdorimin, mësimin e gjuhës shqipe pranë kishave, si dhe kleri katolik të flasë e të predikojë shqip. Aty iu tha troç e shqip priftërinjve: “A e dini gjuhën e shqiptarëve?” Tetë vjet më vonë, më 19 shkurt 1711, me “Bulla Communis nobis”, Papa Klementi XI urdhëroi të gjendej sa më parë një vend ku të mësohej gjuha shqipe. Gjithashtu caktoi një vend të përvitshëm në kolegjin e Propogandës Fide për djemtë e krahinave të Epirit. Merita më e madhe e tij ishte ngritja e kolegjit të Shën Mitër Koronës, ku u hap katedra e gjuhës shqiptare. Një degë e parë kjo universitare e gjuhës shqipe në Evropë dhe në botë ...

GJYLE MULLIQI-OSMANI



Prof. Dr. Gjyle Mulliqi-Osmeni, u lind më 02 prill 1954 në Pejë. Shkollën fillore dhe të mesme e kreu në Pejë. Fakultetin e Mjekësisë e kreu në Universitetin e Prishtinës, më 2 nëntor 1978. Në Zagreb e kreu specializimin për Mikrobiologji në Shkollën e Shëndetit Publik "Andrija Stampar". Studimet pasuniversitare i kreu në Shëndetësinë Publike me Epidemiologji në Universitetin e Prishtinës. Magjistroi në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, më 25 qershor 1994, ndërsa doktoroi në Shkencat mjekësore pranë Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë, më datën 13.12.2001.

Është specialiste e Mikrobiologjisë. Punoi në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik në Prishtinë si dhe Profesoreshë e rregullt në shumë lëndë mjekësore: "Mikrobiologji"; "Mjekësisë sociale me statistikë mjekësore dhe informatikë"; "Mjekësisë familjare dhe Mjekësisë të punës" në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë.

Publikimet Shkencore:

- 1.Gj.Mulliqi-Osmeni: "Korrelacioni në mes te veçorive Fizike, Kimike dhe Bakteriologjike të Ujit të Pijshëm dhe Sëmundjeve Ngjitëse të Tubit tretës", 1997.
2. Reintjes R, Dedushaj I, Gjini A, Jorgensen TR, Cotter B, Lieftucht A, D'Ancona F, Dennis DT, Kosoy MA, Mulliqi-Osmeni G, Grunow R, Kalaveshi A, Gashi L, Humolli, I.: "Tularemia outbreak investigation in Kosovo: case control and environmental", 2002.
3. Kalaveshi A, Mulliqi Gj: "Epidemiological Characteristics of CCHF in Kosova 1995-2002", 2002.
4. L. Raka, Gj. Mulliqi-Osmeni, L. Berisha, L. Begolli, Sh.Omeragiq, L.Parsons, M.Salfinger, A. Jaka, A. Kurti, Xh. Jakupi: "Etiology and susceptibility of urinary tract isolates in Kosova", 2004.
- 5.Gj.Mulliqi Osmani dhe L.Raka: "Mostrimi në mikrobiologjinë klinike", botuar në vitin 2005.
6. Ilir Begolli, Mirije Begolli, Drita Salihu, Valbona Zhjeqi, Gjyle Mulliqi - Osmani. Linda Laçi, Bujar Fejzullahu, Fatos Sada, Visare Mujko, Mirushe Emini: "Building sustainable Health education capacities for reproductive health dedicated for Youth", 2006.
7. L. Raka, D. Zoutman, Gj. Mulliqi, S. Krasniqi, I. Dedushaj, A. Vishaj,

N. Raka S. Ahmeti, M. Shala, Y. Elezi.: "Prevalence of nosocomial infections in the high risk units at the University Clinical Center of Kosova", 2006.

8. L. Raka, A. Krasniqi, F. Hoxha, Rr. Musa, Gj. Mulliqi, S. Krasniqi, A. Kurti, A. Dervishaj, B. Nuhiu, B. Kelmendi, I. Tolaj: "Surgical site infections in abdominal surgical ward at Kosova teaching hospital", 2007.

9. Raka L, Krasniqi A, Hoxha F, Musa R, Mulliqi G, Krasniqi S, Kurti A, Dervishaj A, Nuhiu B, Kelmendi B, Limani D, Tolaj I.: "Surgical site infections in an abdominal surgical ward at Kosovo Teaching Hospital", 2008.

10. G. Spahija, Gj. Mulliqi, L. Raka, N. Spahija, Z. Bukoshi, F. Hoxha, A. Krasniqi: "Prevalence of nosocomial infections in adult intensive care units at Kosova teaching hospital", 2008.

11. Gj Mulliqi Osmani, L. Raka, D. Zoutman, J. P. Horcajada: "Mikrobiologjia e sepsës", 2008.

12. L. Raka, Gj. Mulliqi, "The challenges of implementing infection control procedures in hospitals with limited resources", 2009.

13. G. Lila, Gj. Mulliqi, Rr. Bajrami, A. Kurti, L. Raka, E. Azizi: "Bacteriological examination of ice cream samples in the 2003-2006 period in Kosovo", 2009.

14. L. Raka, S. Kalenić, Z. Bošnjak, A. Budimir, D. Šijak, Gj. Mulliqi, D. Zoutman, I. Dedushaj, A. Krasniqi, A. Jaka. Molecular epidemiology of *Acinetobacter baumannii* in Brazilian Journal of Infectious Disease", 2009.

15. Xhevat Jakupi, Gjyle Mulliqi Osmani, Naser Ramadani, Selvete Krasniqi, Arlinda Jakupi "Prevalenca dhe Ndjesheria ne antimikrobik e *pseudomonas aeruginosa* në mostrat nga Qendra Klinike Universitare e Kosoves", 2010.

16. Gjyle Mulliqi, Lul Raka, Shqipe Svarqa, Lumturije Pajaziti, Arsim Kurti, Greta Lila.: "Flora e izoluar nga mostrat e kavitetit oral dhe arsyeshmëria e ekzaminimeve të tilla", 2011.

17. Ramiz Hotia, Aferdita NuraLamaa, Gjyle Mulliqi Osmanib, Naser Tronia, Fatbardh Gashia, Hamit Ismailia, Veprim Thaçi: "Synthesis of 4-Triazolylaminoand 4-Benzothiazolylamino-3-nitro-2H-[1]-Benzopyran-2-ones and their Antimicrobial Activity", 2014.

18. Gunar Gunther, Gabriela, B. Gomez, Christoph Lange1, Stephan Rupert3, Frank van Leth, Gjyle Mulliqi, Agreta Gecaj-Gashi, Antigona Hasani, Burbuqe Bruqi: "Availability, price and affordability of anti-tuberculosis drugs in Europe: A TBNET survey", 2014. Etj.

GONXHE BOJAXHIU (1910-1997)



Gonxhe Bojaxhiu e njohur si Nënë Tereza, tani Shen Nënë Tereza, u lind në Shkup, më datë 26 gusht 1910. Një ditë pas lindjes u pagëzua në kishën e Zembrës së Krishtit nga famullitari i atëhershëm Dom Zef Ramaj, ditë të cilën ajo e llogariste si datëlindjen e saj.

Shen Nënë Tereza ishte fëmija i tretë i Kolë Bojaxhiut me origjinë nga (Rrethi i Shkodrës) dhe e Drane Bojaxhiut (mbiemri i vajzërisë Barnaj) nga Novo Sella e Gjakovës.

Gonxhja kishte një vëlla dhe një motër. Babai i saj merrej me tregti dhe mbliidhte në shtëpinë e tij artistë dhe patriotë shqiptarë.

Shkupi i merret Shqipërisë prej Maqedonisë me 1 janar 1918 në bazë të traktatit të Versajës. I ati, që ishte i përfshirë në lëvizjet politike të asaj kohe, vdes në vitin 1919 kur ajo ishte vetëm 8 vjeçe.

Gonxhe Bojaxhiu mësimet e para i mori në një shkollë shqipe në Shkup, ku po ashtu e kreu dhe gjimnazin, në gjuhën serbo-kroate. Pasionet e rinisë ishin tre: të bëhej mësuese, të shkruante dhe recitonte poezi dhe të kompozonte e të luante muzikë. Emrin “Tereza” e mori kur ishte 18 vjeçe dhe u dorëzua murgeshë.

Nënë Tereza u largua më 26 shtator 1928 nga Shkupi në drejtim të Dublinit, Irlandë. Prej kësaj dite, nënë, bijë e motër nuk do të shiheshin më.

Më 12 shtator 1928, Nënë Tereza kishte shkruar këtë letër drejtuar tezes së saj: *“Shkup 12. 09. ‘28. E dashura Teze Lis! Më 26 të këtij muaji po nisem prej Shkupit. S’po mund mos me ju shkrue dy tri rreshta për juve. Lamtumirë, e dëshiroj që Zoti t’ju nap gjithshka që ju dëshron zemra. Dua t’ju fal gjanat ma të përzemërta, Gonxhja”*.

Ky ishte momenti kur ajo u nda përfundimisht me familjen dhe vetëm pas 30 vitesh, do të takohej me të vëllain, Lazrin. Kurse nëna dhe motra, shkuan në atdhe, në Shqipëri, qysh para Luftës së Dytë Botërore.

Nënë Tereza u vendos në Kalkuta të Indisë ku fillimisht u bë mësuese dhe shumë shpejt drejtore e shkollës së vajzave.

“Nënë Tereza e Kalkutës” u quajt kur themeloi urdhrin “Misionaret e Dashurisë” (1951) për t’u shërbyer më të varfërve dhe më të pashpresëve të Kalkutës, Indisë dhe gjithë botës.

Në vitin 1979, kur mori Çmimin Nobel për Paqe, e gjithë bota mësoi se Nënë Tereza ishte shqiptare. Haste vështirësi për të folur rrjedhshëm

shqip pas një largimi prej 70 vjetësh dhe qëndrimi në ambiente joshqiptare, por ajo kurrë nuk e ka mohuar origjinën e saj shqiptare.

Shkrimet e saj në shqip janë letrat e rinisë dhe më pas me familjen në shqip, përshëndetje në shqip popullit shqiptar pas fitimit të çmimit Nobel me 1979 dhe lutja në shqip transmetuar nga "Zëri i Amerikës", 1978.

Në çastin e marrjes së Çmimit Nobel më 1979, një nga klerikët që mernte pjesë në sallë e pyeti Nënë Terezën se nga ishte. Ajo deklaroi: *"Kam lindur në Shkup, jam shkolluar në Londër, jetoj në Kalkutë dhe punoj për të gjithë njerëzit e varfër në Botë. Atdheu im është një vend i vogël me emrin Shqipëri"*. Por Shqipëria heshte!

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë nuk i kishte dhënë vizë nobeliste së ardhshme as sa për të parë nënën e saj që jetonte në Tiranë, as për të marrë pjesë në varrimin e saj më 1974, as për të parë varrin.

Nënë Tereza ishte nënë kujdestare e 7.500 fëmijëve në 60 shkolla, ishte nënë që mjekonte 960.000 të sëmurë në 213 dispanseri, ishte e vetmja në botë që trajtonte 47.000 viktima të lebrozës në 54 klinika, kujdesej për 3.400 pleq të braktisur e të lënë rrugëve, në 20 shtëpi pleqsh, kishte birësuar 160 fëmijë ilegjitimë e bonjakë. Ish Presidenti i Shteteve të Bashkuara Ronald Reagan e kishte shpërblyer Nënë Terezën me çmimin merititor "Medal of Freedom" në vitin 1985.

Nënë Tereza nuk qe ndonjë perëndeshë dhe me të mund të fliste çdonjëri. Shtëpinë e Nënë Terezës e kanë vizituar personalitete si mbretëresha e Britanisë, ish presidentët e Shteteve të Bashkuara George Bush e Jimmy Carter, Yasser Arafati, princesha Diana e shumë të tjerë.

Nënë Tereza ka qenë mjaft bujare, humane e zemërgjerë dhe këto janë karakteristikat që do ta bëjnë të jetojë përgjithmonë në zemrat e gjithë njerëzve, sidomos në zemrat e shqiptarëve.

Kur ishte e re jo vetëm ka folur, por ka shkruar edhe poezi në gjuhën shqipe. Për shembull poezinë e parë e ka shkruar kur ishte 22 vjeçe gjatë rrugës për në Indi. Sot kemi një dëshmi të Nënë Terezës që flet shqip më 1988, në një intervistë dhënë Zërit të Amerikës në gjuhën shqipe.

Nënë Terezës, për të ardhur në Shqipëri iu desh të dërgonte tri letra. Ajo i kishte dërguar më parë letër Komitetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë, por nuk mori kurrë përgjigje. Ja si e shpjegohet letra e Nënë Terezës dërguar Presidentit të Republikës në vitin 1989, të cilit i theksonte se: *"...për 60 vjet kam vizituar shumë e shumë vende jashtë atdheut tim"*, që është edhe një fakt se ajo e konsideronte Shqipërinë atdheun e saj.

Më në fund, e para pasaportë (për këtë rast ishte diplomatike) e dhëne për nënshtetas të huaj me origjinë shqiptare iu dha pikërisht Nënë Terezës, e cila vizitoi Shqipërinë në vitin 1989. Nënë Tereza gjithashtu kishte pasaportë nga India, Vatikani, Britania e Madhe dhe Italia.

Kur i thanë për pasaportën Shqiptare ajo u përgjigj: *“E pranoj me kënaqësi, sepse është pasaporta e vendit tim; atje kam Nënë dhe motrën, atje kam miq e të njohur, atje shumë shpejt do të hapim misionin tonë e unë do të jem vetë aty”*.

Nënë Tereza e tha shumë herë: *“Me gjak, unë jam Shqiptare. Me shtetësi, jam Indiane. Me besim, unë jam një murgeshë Katolike. Sipas profesionit tim, unë i përkas botës. Për nga zemra ime, unë i përkas plotësisht Zembrës së Jezusit”*.

Në vitin 1982, në kulmin e rrethimit të Beirutit, Nënë Tereza shpëtoi 37 fëmijë të bllokuar në një spital ushtarak duke ndërmjetësuar një armëpushim të përkohshëm ndërmjet Ushtrisë Izraelite dhe grupeve të guerilëve palestinez. E shoqëruar nga punëtorët e Kryqit të Kuq, ajo udhëtoi përmes zonës së luftës deri tek spitali i shkatërruar për t'i shpëtuar ata.

Nënë Tereza udhëtoi për të ndihmuar dhe shërbyer të uriturve në Etiopi, viktimave të rrezatimit në Çernobil, dhe viktimave të tërmetit në Armeni. Në vitin 1991, Nënë Tereza kthehet për here të parë në vendlindjen e saj dhe hapi shtëpinë e Vëllezërve Misionarë të Bamirësisë në Tirane.

Gjatë viteve, Bamirësia e Misionareve të Nënë Terezës u zgjerua nga dymbëdhjetë në mijëra persona që u shërbejnë “me të varfërve nga të varfëritë” në 450 qendra në mbarë botën.

Shtëpia e parë e Misionarëve të Bamirësisë në Shtetet e Bashkuara ishte themeluar në Bronksin e Jugut, Nju Jork, deri në vitin 1984 asambleja punonte në 19 institucione gjatë gjithë vendit.

Përkushtimi i saj i përjetshëm për tu kujdesur për të varfëritë, të sëmurët dhe të pafatë ishte një ndër shembujt më të lartë të shërbimit për humanizmin njerëzor”. Nënë Tereza fliste rrjedhshëm 5 gjuhë: Bengalisht, Shqip, Serbisht, Anglisht dhe Hindisht.

Ndër titujt që i janë dhënë Nënë Terezës janë: Pamada Shir; Gjoni XXIII për Paqe, të cilën ia dorëzoi personalisht Papa Pali VI; Samaritani i Mirë, në Boston; Shpërblimi Ndërkombëtar John Kennedy, në Uashington; Nëna e të Gjitha Nënave, Balzan; Çmimi Nobel për Paqen; Medalja e Lirisë, shpërblimi më i lartë amerikan; Medalja e Paqes, shpërblimi më i lartë i Rusisë; etj.

HADI SHEHU (1949-2017)



Aktori Hadi Shehu, u lind në Gjakovë, më 15 shkurt 1949 dhe u nga nga jeta më 12 mars 2017, në qytetin e tij të lindjes, në Gjakovë.

Në teatrin e Gjakovës, fillimisht si amator, aktroi në moshën e re, si nxënës. Ishte themelues i Teatrit Profesionist të Gjakovës dhe njëherit edhe drejtor i këtij teatri, ku punoi deri në fund të jetës së tij, në vitin 2007.

Diplomoi në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, në vitin 1974, në degën e artit dramatik, klasa e Faruk Begollit.

Në skenën e Teatrit të Gjakovës, Hadiu ka realizuar me qindra role, që kanë mbetur të paharruara dhe të mahnitshme në drama të ndryshme.

Rolet:

- “Fisheku në pajë”,
- “Njeriu me top”,
- “Epoka para gjyqit”.
- “Monserati”,
- “Kur shpirti ndërron jetë”, etj.

Filmografia:

Ka luajtur në role kryesore në dhjetëra filma artistik, më të njohurit janë:

- “Djurmë të bardha”, (1980),
- “Kur pranvera vonohet”, (1979),
- “Era dhe lisi”, (1979)

Në dramën televizive “Epoka para gjyqit”, të regjisorit të njohur Ekrem Kryeziu, shkëlqeu dhe vërtetoi edhe një herë epitetin Aleksandër Moisiu i Kosovës.

Hadi Shehu ka lënë pas një karrierë të pasur të aktorit profesionist, shumë filma të metrazhit të gjatë, drama e skena teatrale, ndërsa vdekja e tij ka lënë një boshllëk në botën e artit kosovar.

Hadi Shehu dhe puna e tij e palodhshme, janë trashëgimi e vlefshme për artin dhe kulturën shqiptare, andaj edhe kujtimi për aktorin e vlerave do të jetë i përhershëm.

Hadi Shehu do të përkujtohet gjithnjë për pasurinë e madhe artistike që i ka lënë Kosovës, gjatë punës së tij prej disa dekadash.

Hadi Shehu e kishte përmbyllur karrierën artistike në teatër, në vitin 2015, kur kishte luajtur për herë të fundit në dramën “Pjata prej drurit”...

HAJDAR SALIHU (1950-1995)



Hajdar Salihu u lind në Batushë, në vitin 1950, fshat malor në komunë të Gjakovës. Është shkrimtar shqiptar nga Kosova. Shkollën fillore e kreu në fshatin e afërm të Mulliqit, kurse normalen dhe SHLP në Gjakovë. Më tej vazhdoi studimet universitare dhe pasuniversitare në UP, dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe. Magjistroi në Kosovë, me temën “Poezia shqipe” me alfabet arab. Hajdar Salihu punoi disa vjet si arsimtar në fshatrat Krelan dhe Mulliq.

Mandej punon si profesor në gjimnazin e Deçanit, por përjashtohet nga puna në vitin 1981 dhe rifillon aktivitetin profesional, në vitin 1987 pranë Teatrit Popullor në Gjakovë.

Veprat:

- “Udha e ditës së nesërme”, (roman, 1990)
- “Jerina dhe helmi”, (roman, 1994)
- “Raport për jetën paralele”, (roman, 1994)
- “Pas vdekjes iu botuan dorëshkrimet”
- “Stina e mjegullës”, (1999)
- “Baladë për kthimin e nizamëve”, (2005).
- Ese për stinën e mjegullës, tani të titulluar;
“Stina e mjegullës” (1999) nga i cili u zgjodh një fragment nga kapitulli i parë.

Ishte viti 1982, Hajdari sa kishte filluar për të hulumtuar, dhe mbledhë materialin për këtë temë të rëndësishme për kulturën fetare-kombëtare. Libri me titullin: “Poezia e Bejtexhinjve”, edhe pse ishte e përgatitur për shtyp, ajo u vonua edhe dy-tri vjet deri sa u botua.

Libri, jo vetëm që u vonua, por edhe kur u botua më 1987, nga “Rilindja” në Prishtinë, emri i Hajdar Salihut nuk u shënuar në kopertinë, sepse ai ishte një atdhetar i çështjes kombëtare.

Hajdar Salihu ishte ndër profesorët e parë, ku së bashku me disa kolegë të tjerë iu nënshtruan procesit të diferencim ideo-politik, që aplikohet masa më e çoroditur nga policia e atij pushteti kolaboracionist.

Botoi disa vepra me të cilat u dallua në mesin anëtarëve të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Punoi si dramaturg dhe aktor pranë Teatrit popullor në Gjakovë.

Hajdar Salihu vdiq në vitin 1995.

HAJDIN MORINA



Prof. Hajdin Morina, u lind më 15.12.1961, në fshatin Rixhevë të komunës së Klinës.

Shkollimin fillor dhe të mesëm e mbaroi në Kijevë. Fakultetin Filozofik- Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare e mbaroi në Prishtinë, ku vijoi edhe studimet pasuniversitare në Degën e Letërsisë. Sa ishte student, pas vitit 1981 u burgos për bindje politike. Prej vitit 1985 deri më 1987 ka punuar mësues i gjuhës shqipe në Kijevë, në paralelen e gjimnazit “Luigj Gurakuqi” të Klinës. Prej vitit 1992 deri më 1996 punën e mësimeve në shkollën e shqipes e vijoi në paralelet e gjimnazit në Gllarevës. Prej vitit 1996 deri më 1998 ka punuar këshilltar i gjuhës shqipe në Këshillin Komunal të Arsimit në Klinë. Prej vitit 1999 punon në Drejtorinë arsimore të Komunës së Klinës, kurse në shkurt 2014 u emërua drejtor i kësaj drejtorie dhe këtë detyrë e kreu deri në dhjetor 2017.

Me shkrime letrare, kryesisht poezi, ka shkruar dhe botuar në faqet e gazetës së studentëve “Bota e re”, pastaj në revista të tjera si “Zëri i rinisë”, “Fjala” etj. Pas lufte, po ashtu, ka bashkëpunuar dhe bashkëpunon me gazeta dhe revista të ndryshme. Morina kultivon poezinë, publicistikën, esenë dhe studimin letrar.

Gjatë përvojës shumëvjeçare në arsim, pjesë e veprimtarisë së tij profesionale janë edhe shkrimet dhe hulumtimet e natyrës dhe të problematikës pedagogjike, të cilat i boton në revistën pedagogjike “Mësuesi” të Tiranës. Shkrime të tilla më parë ka botuar në revistën “Shkëndija” të Prishtinës. Më 2012, për veprën letrare, juria kompetente i dha çmimin “Ora e Tahir Deskut” në kuadër të manifestimit kulturor tradicional që mbahet në Klinë.

Në vitin 2000 është pranuar anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës.

Veprat:

1. “Brenda dritareve të vogla”, poezi, Klinë”, 1995
2. “Prushi i fjalës”, poezi, Klinë, 2011
3. “Reflektime letrare” (vëzhgime letrare, ese), Klinë, 2012
4. “Vesel Zeka” (monografi), bashkautor me Mikel Gojanin, SHB “Faik Konica”, Prishtinë 2014
5. “Dhe unë rri me diellin”, poezi, SHB “Rozafa”, Prishtinë, 2014
6. “Përtej stinëve”, poezi, SHB “Rozafa”, Prishtinë, 2015.

HAJRO ULQINAKU



Hajro Ulqinaku (i lindur Hajrudin Pufja) u lind më 3 maj 1938, në Ulqin. Shkollën fillore e ka mbaruar në vendlindje. Shkollën e mesme të mësuesisë (normalen) e ka kryer në Prishtinë.

Është diplomuar në Beograd për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe. Në vitet 1967/68 fillon të punojë si gazetar, fillimisht në Radio Prishtinë. Nga maji i vitit 1974, deri në përjashtim nga puna prej forcave policore serbe, më 5 korrik 1990, ishte redaktor i Redaksisë së Programit për Fëmijë në RTP Televizionin e Prishtinës. Aktualisht është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, i Lidhjes së Gazetarëve të Kosovës, si dhe anëtar i Bashkimit të Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi. Shkruan prozë dhe poezi për fëmijë. Hajro Ulqinaku është autor i disa veprave teatrale, më e njohura ndër ta është drama “Tërë bota Kosovë”.

Libra për fëmijë:

“Fëmijët e detit”.

“Margaritarët e zez”.

“Çelësi i artë”.

“Kolovajza e florinjtë e Hënës”.

“Mbrëmje pulëbardhash”.

“Fëmijëria në bregdet”.

“Gjiri i Shpresës”.

“Ligji i detit”.

“Ani, Ben, ani”.

“Bukuria e detit”.

“Panorama e detit”.

“Thesari i piratëve”.

“Pëllumbat në antenë”.

“Mos qaj Kestrina”.

“Barka me vela” (ose Barka me visare).

“Limani i Qetësisë”.

“Lulëkuqet mbi banka”.

“Ishulli i Gjelbër”.

“Libri për detin”,

“Tërë bota Kosovë”, dramë. etj.

Hajro Ulqinaku është shkrimtari i ekzotikes bregdetare të Ulqinit..

HAKIF BAJRAMI



Prof. Dr. Hakif Bajrami u lind më 7 mars 1943, në katundin Balsh të komunës së Besianës, Malësi e Llapit. Shkollimin tetëvjeçar, si dhe shkollën e mesme Gjinnazin e kreu në Besianë me sukses shembullor.

Në Prishtinë i mbaroi studimet universitare, në Degën e Historisë së Fakultetit Filozofik. Nga viti 1969 u punësua si arsimtar i gjuhës latine dhe i sociologjisë në Gjinnazin e Besianës, kurse nga viti 1973 punoi profesor i historisë në Gjinnazin e Prishtinës. Ai njëkohësisht i vazhdoi studimet pas-universitare, në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, për të magjistruar në vitin 1975. Profesor Bajrami me gradën shkencor “Magjistër i Shkencave të Historisë” u punësua “Bashkëpunëtor shkencor” në Entin e Historisë së Kosovës, ku i ngjeshi përpjekjet për ngritjen profesionale shkencore dhe më 15 janar 1979 e mori gradën shkencore “Doktor i Shkencave historike”.

Pikërisht nga shkurti i vitit 1981 deri në mars të vitit 1990, të mbante postin e drejtorit të Arkivit Shtetëror të Kosovës, porse një kohë i “pa dëshiruar”, meqë ishte nënshkruar i të ashtuquajturit “Apeli 215” të vitit 1989 për Republikën e Kosovës, në Kuadër të Jugosllavisë!” Si pasojë, më 1990, do të pushohet nga detyra e drejtorit.

Hakif Bajrami i bashkohet, “Lëvizjes Gjithpopullore Shqiptare për Faljen e Hasmërive”, në shkurt të vitit 1991.

Historiani ynë, Dr. Hakif Bajrami, në shekullin e tij të veprimtarisë shkencore i arriti të gjitha gradat shkencore, në afatet ligjore, deri në “Këshilltar shkencor”, ekuivalent me gradën “Profesorit ordinar”.

Në vitet 1995-1999 ishte anëtar i “Partisë Parlamentare”, dhe shquhej si prouçkëistë, e në vitet 1998/99 i përkiste “Timit” të Këshilltarëve politiko-diplomatikë në Zyrën e Përfaqësuesit Politik të UÇK-së, Liderit kombëtar, Zotëri Adem Demaçi,

Hakif Bajrami merr ndihmesë financiare të familjarëve, hulumtoi nëpër Institute dhe Arkiva të shumta Shtetërore.

Ai i ka publikuar rreth 630 tituj të studimeve, punimeve fejttonistike historiografike dhe të përqasjeve politike të botuara në gazeta ditore dhe në revista shkencore shqip e serbokroatisht.

Profesor Hakif Bajrami gjithsesi është i vetmi historian yni që ka argumente, guxim dhe dije teorike për të ndriçuar problematikën

historiografike politike, bashkëkohore, për të shërbyer si far për në të ardhmen e dinjitetshme të kombit shqiptar të sunduar nga shumë lider me specie të hidrës.

Nga viti 2019, Historiani Hakif Bajrami merr gradën shkencore Akademik Prof. Dr. PhD pranë Akademisë së Shkencave dhe Arteve Shqiptaro-Amerikane në New York, Tiranë, Prishtinë dhe Shkup.

Veprat:

“*Konventa Jugosllave-Turke 1938*”, për dëbimin e shqiptarëve në Turqi, botuar më 1980.

“*Prememorjen e Gj. Bisakut, Sh. Kurtit dhe L. Gashit, e vitit 1930*”, për gjenocidin ndaj shqiptarëve në Jugosllavi, botuar më 1989.

“*Marrëveshjen Xhentëlmene Tito-Kyprii të vitit 1953*”, për dëbimin e shqiptarëve në Anadoll, botuar më 2002.

“*Gjenocidi serb në Kosovë 1844-1999*”, botuar më 2002.

Akademik Hakif Bajrami, është historiani shqiptar më produktiv, me një origjinalitet historiografik filozofik e dokumentar që tejkalon edhe kornizat e asaj që është ngulitur të thuhet:

- “Shkollë historiografike e Ali Hadrit”.


Libra dhe punime shkencore:

1. Rrethanat shoqërore politike në Kosovë 1918-1941, Prishtinë 1981;
2. Aradhja Partizane e Shalës, Beograd 1981, fq. 106;
3. Partia Komuniste e Jugosllavisë në Kosovë 1919-1941, Prishtinë 1983, fq. 238;
4. Aradhja Partizane “Bajram Curri”, Prishtinë, 1985, fq. 244;
5. Bataloni Partizan “Meto Bajraktari”, Prishtinë 1988, fq. 232;
6. Libri i bardhë (në katër gjuhë: shqip Anglisht, frëngjisht, gjermanisht, serbokroatisht), Prishtinë-Tiranë, 1992, (gjithsej 512 f.);
7. Tragjedia e Tivarit, Prishtinë 1993, fq. 226;
8. Bedri Pejani 1885-1946, Prishtinë, 1994, fq. 205;
9. Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb i Kosovës 1844-1995, Prishtinë 1995, fq. 208;
10. Dëbimi dhe shpërngulja e shqiptarëve në Turqi (dokumente), Prishtinë 1996, fq. 506;
11. Mustafë Hoxhë Nishefci 1915-1995, Prishtinë 1997, fq. 338;
12. Kosova prej Bujanit në Kaçanik, Prishtinë 1997. F. 424 (i ndaluar më 1990 në shtypshkronjë);
13. Programet që shënuan historinë kombëtare shqiptare 1878-1997,

13. Programet që shënuan historinë kombëtare shqiptare 1878-1997, Prishtinë 1997, f. 162;
14. Dokumente të institucioneve gjermane për historinë shqiptare 1941-1944, Prishtinë 1998, fq. 302;
15. Ismail Hasan Ajeti-Bushi, Prishtinë 1999, fq. 166;
16. Ibrahim Gjakova shtyllë e Komitetit Kosovës, Prishtinë 2000;
17. Met Podjeva-Babloku, 1888-1976, Prishtinë 2000, fq. 202;
18. Kosova njëzetë shekuj të identitetit saj, Prishtinë 2001, fq. 156;
19. Politika serbe për rikolonizimin e Kosovës me sllavë 1945-1948 (vëllimi i parë), Prishtinë 2002, fq. 634;
20. Programi Kombëtar politik i shqiptarëve, Prishtinë, 2002, fq. 110;
21. Si e okupoi Serbia Kosovën më 1912 (1), Prishtinë 2003 fq. 230;
22. Dosja Demaçi, Prishtinë 2003 dhe botimi i dytë 2004,479;
23. Naçertania program politik serb për shfarosjen e shqiptarëve 1844-1999, Prishtinë 2004, fq. 339;
24. Riokupimi i Kosovës nga Serbia më 1918 (2), Prishtinë 2004;
25. Politika dhe lufta e drejtë shqiptare përballë neofashizmit serb 1989-1999, Prishtinë, 2006, fq. 530;
26. Antimemorandum (në gjuhët: shqip, anglisht, serbisht), Prishtinë 2007, fq. 207;
27. Zaverë i zloçini UDB-e Jugosllavije prema albancima na Kosovu do 1966, Pristina, 2008, fq. 207;
28. Komiteti “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës” dhe Qeveritë e Tiranës për krimet serbe ndaj shqiptarëve 1918-1941, Prishtinë, 2008, fq. 462;
29. Shqiptarët në mes Lindjes (Stalinit) dhe Perëndimit (Çerqillit), (botuar si fejtton ekskluziv në “Kosova Sot”), 2008 (në procedurë për botim në libër);
30. “Si e tradhtoi PKJ udhëheqësin shqiptarë rreth çështjes së Kosovës (dokumente sekrete” - Libër në procedure të botimit;
31. Epoka e Adem Demaçit, Prishtinë, 2009, fq. 68.
32. Peticioni që i shpëtoi shqiptarët në Shqipërinë kontinentale nga fashizmi serb, Prishtinë 2005, fq.73;
33. Shqiptarët në mes dy totalitarizmave 1918-1999, Prishtinë 2010, fq. 357; Etj.

Prof. Dr. Hakif Bajrami është aktiv në krijimtarinë e tij studimore, ai tani më është bërë hulumtues e vizitor i arkivat të pahapura...

HALIL KAJTAZI (1935-2018)



Halil Kajtazi, u lind më 21 qershor 1935, në fshatin Vitak të Drenicës.

Shkollën Filllore dhe Gjinnazin e ulët e kreu në vendlindje, kurse Shkollën Normale dhe Fakultetin Filozofik-Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, në Prishtinë.

Me shkrime letrare u paraqit për herë të parë më 1952. Një kohë ishte arsimtar i gjuhës shqipe në Runikë të Komunës së Skenderajt, në Rakosh të Komunës së Istogut (Burimit), pastaj gazetar i Radio-Prishtinës si dhe i gazetës “Kosova” të Obiliqit. U mor me krijimtari letrare, kryesisht në prozë dhe me mbledhjen e studimin e folklorit shqiptar.

Vdiq më 1 qershor 2018 në Prishtinë. Halil Kajtazi, deri më tash i ka botuar këto vepra:

Veprat folklorike:

“Xingli-mingli”, Prishtinë, 1967.

“Nina-nëna”, (grup autorësh),

Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, Prishtinë, 1978.

“Proza popullore e Drenicës”

(financues autori), Prishtinë, 1970.

“Proza popullore e Drenicës II,

Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, Prishtinë, 1972.

“Nga lirika popullore e Drenicës”, “Rilindja”, Prishtinë, 1972.

“Proza popullore e Drenicës, I, II, III, Prishtinë,

Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, Prishtinë, 1986.

“Proza popullore e Drenicës. IV”,

Shtëpia Botuese “Rozafa”, Prishtinë 2007.

“Proza popullore e Drenicës V”,

Prishtinë, 2010 (financues, PTK).

“Fjalë të urta nga Drenica, Prishtinë”, 2015 Shtëpia botuese ULPI.

Veprat letrare:

“I treti”, roman, Prishtinë, 1979.

“Në Shtëpinë e bardhë”, roman, Prishtinë, 1996.

- “Një kohë tjetër”, tregime, Prishtinë, 1997.
“Pehlivan Guri”, roman, Prishtinë, 2002.
“Loti në tri kohë”, roman, Prishtinë, 2002.
“Shkrime letrare”, ese, Prishtinë, 2002.
“Norka”, roman, Prishtinë, 2003.
“Orët e mëngjesit”, roman, Prishtinë, 2005.
“Udha e eshtrave”, roman, Prishtinë, 2011.
“Në Shtëpinë e bardhë”, roman, Prishtinë,
ribotim Shtëpia Botuese “Faik Konica”, 2012.
“Shtalbakët e Vitakut”, roman, Prishtinë.
“Koha e gjarpinjve”, roman, Prishtinë.
“Guri i mullirit”, poezi, Shtëpia botuese ULPI, Prishtinë, 2013.
“Hija e jetës”, roman, Prishtinë, 2014 Shtëpia botuese ULPI.
“Erërat e Kosovës I”, Prishtinë, 2014 Shtëpia botuese ULPI.
“Dasmë e ftohtë”, tregime, 2014 Shtëpia botuese ULPI.
“Besa-Besë”, roman, Shtëpia botuese ULPI, 2014.
“Shtalbakët e Vitakut”, roman, Shtëpia botuese ULPI, 2014.
“Erërat e Kosovës II”, Prishtinë, 2015 Shtëpia botuese ULPI.
“Pena e re”, Prishtinë, 2015 Shtëpia botuese ULPI.
“Koha dhe Zemra”, tregime, 2015 Shtëpia botuese ULPI.
“Erërat e Kosovës III”, Prishtinë, 2016 Shtëpia botuese ULPI.
“Kosovë lirika jonë”, Prishtinë, 2018 Shtëpia botuese ULPI.
“Legjenda e Drinisë”, Prishtinë, 2018 Shtëpia botuese ULPI.
“Për ty nënë”, Prishtinë, 2018 Shtëpia botuese ULPI.
“Luani dhe miza”, Prishtinë, 2018 Shtëpia botuese ULPI.
“Tokë e panjohur”, Prishtinë, 2019 Shtëpia botuese ULPI.
“Degë e këputur”, 2019 Shtëpia botuese ULPI.

Krahas marrjes me letërsi ka bërë shumë gjurmime dhe hulumtime në folkloristikë, si dhe në mjekësinë popullore për mjekim praktik.

Ka botuar doracakët:

- “Shërimi i majasëllit (hemoroideve)”
- “Shërimi i bronkitit kronik dhe i astmës”
- “Shërimi me pemë dhe barishte natyrore”...

Halil Kajtazit pas vdekjes iu botuan pesë libra. Shumë materiale dhe shkrime i kanë mbetur në dorëshkrim, të cilat presin kujdesin e familjarëve dhe të krijuesve e botuesve shqiptarë, që kanë vullnetin krijues për t’i rishikuar e botuar ato...

HALIL XANI



Halil Xani u lind më 1952, në fshatin Polac të Skenderajt. Shkollën fillore e mbaroi në Polac e Skenderaj, ku e kreu edhe gjimnazin.

Mbaroi studimet në degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe, në Fakultetin e Filologjisë, në Universitetin e Prishtinës.

Nga viti 1974 e deri në vitin 1976, punoi arsimtar i gjuhës shqipe, në shkollën fillore të Qirezit, kurse në shkollën fillore të Polacit, nga viti 1976 e deri në vitin 1983.

Nga viti 1983 e deri në vitin 1990, punoi gazetar në Radio Mitrovicë, deri atëherë kur policia serbe i dëboi me dhunë punëtorët shqiptarë nga puna dhe mbylli programin shqip.

Pas luftës së fundit, një vit punoi gazetar në të përditshmet “Dita” dhe “24 orë”, në Prishtinë, si dhe dy vite rrjesht drejtoi programin e Radio Drenicës, në Skënderaj. Pos vjershave për fëmijë, të cilat i botoi që nga viti 1971 e këndej, në gazeta e revista të ndryshme, që dilnin në Prishtinë e Shkup, shkruan edhe humor. Jeton dhe vepron në Polac të Skenderajt.

Veprat:

“Ndal Drenushë”, -vjersha për fëmijë, Mitrovicë, 1996

“Unë e babi mjeshtër”, -vjersha për fëmijë, Prishtinë, 2005

“101 Qyfyret e Nastradinit” - vjersha sipas anekdotave, Prishtinë, 2009

“Pak për mahi më shumë përnjëmend” - mahi, Prishtinë, 2009

“Ec e mos u bëj nervoz” - vargje satirike, Prishtinë, 2010

“Borxhin e hëngri qeni” - mahi, Prishtinë, 2010

“Gjuha e zemrës” - vjersha për fëmijë, Prishtinë, 2012

“Prekja e pikëllimit”, (bashkautor me Xh. Mjekun), 2013

“M’i akuzojnë sytë” - vargje satirike, Prishtinë, 2015

“Halla nga Prevala” - vjersha për fëmijë, Prishtinë, 2018

“Epigrame” - Prishtinë, 2018

“Jeni të gjallë në mes nesh” - vargje përkushtuese, Prishtinë, 2018

“Gjuha e zemrës” - vjersha për fëmijë, ribotim i plotësuar- Prishtinë, 2019.

Halil Xani me humorin e tij të hollë, nxjerrë nga përditshmëria dhe aktualiteti në vendin tonë, bëri që shumë herë të jetë në qendër të vëmendjes në manifestime të ndryshme letrare, që organizohen në Kosovë e Shqipëri.

Ai me sensin e të shkruarit, përveç poezive për të vegjlit, skalitë edhe satirën, e që më plotë kuptimin e fjalës, quhet edhe poeti satirik.

HAQIF MULLIQI



Prof. Haqif Mulliqi, u lind më 6 maj 1960 në Pejë, shkollën fillore dhe të mesme i ka mbaruar në Prishtinë, ndërsa Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës. Përfundoi magjistraturën në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës. Ka doktoruar në fushën e antropologjisë të dramës dhe të teatrit, në Akademinë e Studimeve Albanologjike.

Haqif Mulliqi prej vjetësh është profesor për lëndën e Dramaturgjisë në DAD të Fakultetit të Arteve, në Universitetin e Prishtinës, Tetovës, si dhe në Akademinë e Arteve të bukura në Universitetin e Tiranës.

Gjithashtu, ligjëron edhe lëndët: Teknikat e hulumtimit gazetaresk, si dhe Gazetari investiguese në Departamentin e Gazetarisë të Fakultetit Filologjik të Universitetit të Prishtinës, si dhe lëndën "Gjuha e mediave" në studimet master të Fakultetit Filologjik, gazetari etj.

Gjate viteve 1992-1996, ka qenë selektor i festivaleve në Shqipëri, Maqedoni dhe Kosovë.

Në vitin 1996 në Mostar (Bosnjë) është lauruar për tekstin dhe regjinë më të mirë, për komedinë "Ali Hoxha, Hoxhë Alia". Ka marrë pjesë edhe në festivalet botërore të teatrove: Edinburg (Skoci), Londër (Angli), Avinjon (Francë), Varshavë (Poloni), si dhe në shumë vende të tjera.

Ka botuar qindra kritika, ese dhe vështrime studimore lidhur me dramën, skenën dhe teatrin. Ka ligjëruar mbi problemet e dramës dhe teatrit edhe në Tiranë, Londër, Grac (Austri), Lubjanë (Slloveni), Mostar (Bosnjë Hercegovinë), Kajro (Egjipt), Ohër (Maqedoni), Selanik (Greqi), etj.

Ishte prodekan në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, ndërsa, aktualisht është shef i Katedrës së Studimeve Master në Drejtimin e Dramaturgjisë në Fakultetin e Arteve të UP-së.

Për disa vjet me radhë ishte kryetar i Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës. Ishte kryeredaktori i parë i të përditshmes kosovare "Kosova sot", kryeredaktor i të përditshmes "Gazeta e re", kryeredaktor i parë i "Gazeta shqiptare" (Prishtinë). Ka qenë kryetar i degës së Kosovës së SEEMO-s (Organizatës së Medieve të Evropës Lindore dhe Juglindore) me seli në Vjenë. Është anëtar i IFG-së (Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve) me seli në Bruksel, si dhe i IPI (Institutit Ndërkombëtar të Shtypit) me seli në Vjenë. Është anëtar i bordit të PEN-it të Kosovës etj.

Veprat:

- “Kosova në ruletin ndërkombëtar”, 1993, libër publicistik, (botoi revista “Zëri”, Prishtinë);
- “Katër epoletat”, 1993, dramë, (botues Tok Theatre, Prizren);
- “Si e mposhta Mussolinin”, 1994, dramë, (botues Dodona);
- “Parfumeria”, në vitin 1998, dramë, (botues Theatri);
- “Trenat”, 2002, dramë, (botues “Kombi”);
- “Një plagjiat i përkryer”, 2002, dramë, (botues “Kombi”);
- “Parfumeria”, 2002, dramë, (botues “Kombi”) dhe
- “Përralla klaustrofobike”, 2002, dramë, (botues “Kombi”);
- “Kaos atdhedashurie në Paris”, 2005, dramë, (botues “Kombi”);
- “Gjakova një luftë ndryshe”, 2005, dramë, (botues “Kombi”);
- “Asgjë veç Gjyzepes”, 2005, dramë, (botues “Kombi”) dhe
- “Një varr për majorin e Mbretit” 2005, dramë, (botues “Kombi”);
- “Sistola” në vitin 2006, dramë, (botues “Kombi”), etj.


Punime shkencore:

- “Prezantimi i konfliktit në Mqedoni në mediat e Kosovës”, Shkup, 2001;
- “Marrëdhëniet me media si pjesë e marrëdhënieve me publikun”, Revista “Media” 2007;
- “Origjina e dramës, poetika dhe rëndësia e saj”, Studime për artin, 2013.
- “Komedia apo mënyra më e çuditshme e përballjes me ligjet e kozmosit” “Jeta e re” Nr. 2 Prishtinë, 2013;
- “Aspekte zhanror të komedisë së Milazim Krasniqit”, 2014;
- “Pesë drama”, libër i botuar në vitin 2012, SHB “Rozafa”, Prishtinë;
- “Vitet kur Kosova e njohu veten“, publicistik LOGOS-A Shkup, 2012;
- Në vitin 2013 Botoi librin “Pesë drama”, “Sistola”, “Si e mposhta Mussolinin”, “Trenat”, “Gjakova një luftë ndryshe”, “Një përkujtim në kafeteatër”, Shtëpia Botuese “Olymp”, Prishtinë;
- Në vitin 2014, Këshilli i librit i MKRS-së, i ka përzgjedhur për botim përmbledhjen e komedive: “Çdo gjë është e mundshme”, “Komedia”, “Asgjë të re nga Jugu”, “Show time”, Shtëpia Botuese “Olymp”, Prishtinë;
- Skripta e autorizuar “Format e kërkimit gazetaresk” Libër për studentët e gazetarisë të UP-së 2006;

Haqif Mulliqi, si regjisor i ka inskenuar rreth 20 drama:

- “The Kosowars”, “TAK-Theatre”, Prishtinë (2015)
- “Asgjë të re në jug”, Teatri Profesionist “Istref Begolli”, Pejë (2013)
- “Trenat”, Teatri Profesionist “Bekim Fehmiu”, Prizren (2013), etj.

HASAN PRISHTINA (1873-1933)



Hasan Prishtina u lind në vitin 1873, në Vushtrri. Mësimet e para dhe disa klasë të shkollës së mesme i mbaroi në Vushtrri. Hasan Prishtina vazhdoi shkollimin në gjimnazin grek të Selanikut, ku mësoi edhe gjuhën frënge.

Në Stamboll, u diplomua në Drejtësi, në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike.

Ishte ithtar i ideve të Revolucionit Francez (1789-1794). Ai njihte shumë gjuhë: anglishten, arabishten, gjuhën çerkeze, frëngjishten, greqishten, gjermanishten, italishten, serbishten, si dhe gjuhën turke. Në vitet 1908-1912, u zgjodh tri herë deputet në Parlamentin osman, si përfaqësues i Vilajetit të Kosovës, në Prishtinë.

Hasan Prishtina mori pjesë në Kuvendin e Ferizajit, ku paria shqiptare u mbloodhën për të përkrahur rikthimin e kushtetutës dhe ishte pikënisja e Revolucionit Xhonturk.

Në dhjetorin e vitit 1908 u zgjodh deputet i Sanxhakut të Prishtinës në Mexhlisin Osman, arsye për të cilën mbiemri i tij ndryshoi, burimet turke e quanin Prishtineli dhe Volçitirnli Hasan.

Në fillim të janarit të viti 1912, ai dënoi terrorin që ishte ushtruar mbi popullin shqiptar gjatë kryengritjes së Kosovës.

Në vitet 1908-1912, së bashku me Esat Toptanin, Isa Boletinin, Bajram Currin, ishte ndër nismëtarët për organizimin e Kryengritjes së Përgjithshme të Armatosur në Shqipëri.

Qysh nga janari i vitit 1912, ai do të mbajë mbledhje të fshehta së bashku me Ismail Qemalin, Syrja bej Vlorën, Nexhip Dragën, Myfid bej Libohovën, etj. në lagjen “Taksim” të Stambollit dhe do të vendosin për organizimin e Kryengritjes së Përgjithshme të Armatosur në Shqipëri.

Pas një lufte, triumfale midis 5 majit-18 gushtit 1912, kryengritësit shqiptarë në krye me Hasan Prishtinën e liruan Vilajetin e Kosovës.

Në vitin 1913 u kthye në Shqipëri dhe u ngarkua nga Ismail Qemali me detyrën e Ministrit të Bujqësisë në Qeverinë Kombëtare të Vlorës.

Gjatë Luftës së Parë Botërore u kthye në Kosovë dhe u bë përsëri promotori i arsimit të shqiptarëve, duke hapur shumë shkolla shqipe për arsimimin e të rinjve, anëmbanë Kosovës.

Më 1917, u burgos nga policia bullgare. Hasan Prishtina, falë shkathtësive të tij, u arratis nga burgu.

Me themelimin e komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, në Shkodër më 1918, të udhëhequr nga Hoxhë Kadriu (1878-1925), u zgjodh anëtar i tij, ndërsa në dhjetor të vitit 1919, komiteti e ngarkoi si kryetar të delegacionit të tij në Konferencën e Paqes në Paris.

Mori pjesë aktive në përgatitjen dhe organizimin e Kongresit të Lushnjës 1920, dhe në prill të vitit 1921 u zgjodh deputet i Dibrës në parlamentin shqiptar.

Hasan Prishtina mori pjesë aktive në përgatitjen e kryengritjes të qershorit të vitit 1924.

Pas dështimit të revolucionit të 1924-ës, u largua jashtë atdheut. Në shtator të vitit 1924, në krye të një delegacioni, në emër të komitetit "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës", shkoi, së bashku me Fan Nolin, Luigj Gurakuqin, Bajram Currin e Bedri Pejanin në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë, ku protestoi kundër barbarizmave mbi popullsinë shqiptare të qarqeve shoviniste serbe në Kosovë.

Gjatë tërë kohës në mërgim (1925-1933), qëndroi në krahun më të përparuar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Nën drejtimin e tij, u themelua “Komiteti i Çlirimit të Kosovës”

Dy herë e burgosën pushtuesit serbë dhe bullgarë. Gjashtë herë e dënuan me vdekje xhonturqit, feudali Esat Toptani, qarqet shoviniste serbomadhe dhe tri herë qeveria e Ahmet Zogut.

Bashkëpunoi me rryma dhe shtete të ndryshme kundër Zogut, madje organizoi mjaft atentate kundër tij. Për një atentat të tillë u dënua me vdekje në mungesë, më 6 qershor 1933, së bashku me 7 të tjerë të arratisur politikë. Më 10 janar ishte në Vjenë, më 16 mars në Bukuresht, më 1 prill në Sofje, më 11 prill në Selanik, më 1 maj në Stamboll, më 1 qershor në Vjenë, më 6 qershor në Budapest, më 23 qershor në Vjenë, më 30 qershor në Stamboll, dhe më 1 korrik 1933 në Selanik.

Më 13 gusht të vitit 1933 ndodhej në Selanik, i shoqëruar nga Ibrahim Çela. Çela në orën 2 pasdite, më datë 13 gusht 1933, kishte goditur me 4 plumba trupin e Hasan Prishtinës.

Në vitin 1977, eshtrat e atdhetarit Hasan Prishtina, me një vendim të Republikës Socialiste të Shqipërisë, u sollën nga Selaniku dhe u varrosen në Kukës, sipas protokollit shtetëror.

Më datë 4 maj 2014, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani, vlerësoi pas vdekjes Hasan Prishtinën me: “Dekoratën e Flamurit Kombëtar”...

HASAN HASANI



Hasan Hasani u lind më 16 janar 1947 në fshatin Shqiponjë (ish-Jabllanicë) të Dushkajës, rrethinë e Gjakovës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, Zhebël, Gërgoc dhe Baran. Shkollën Normale e kreu në Gjakovë. Studimet e larta, Dega Gjuhë e Letërsi Shqipe, në Universitetin e Prishtinës. Me krijimtari letrare dhe publicistike merret që nga viti 1965, kur e botoi poezinë e parë në revistën letrare “Jeta e re”.

Krijimet letrare dhe publicistike i botoi në të gjitha gazetat dhe revistat që u botuan në gjuhën shqipe në Kosovë, Maqedoni, dhe më vonë edhe në Mal të Zi.

Si student i vitit të parë, në vitin 1969 nisi punën si bashkëpunëtor i rregullt në gazetën e studentëve “Bota e re”, ku punoi deri në qershor të vitit 1971, kur kaloi gazetar i rregullt në gazetën arsimore shoqërore dhe pedagogjike “Shkëndija”. Në vitin 1976 kalon në revistën për art, kulturë e letërsi “Fjala”, në fillim gazetar, e më vonë redaktor.

Në vitin 1987 emërohet redaktor, e më vonë edhe kryeredaktor në revistën letrare për fëmijë “Pionieri”, ku punoi deri në vitin 1996, kur kalon në revistën letrare “Jeta e re”.

Nga viti 2003 përsëri e gjejmë redaktor në revistën letrare për fëmijë “Pionieri”, dhe nga janari i vitit 2004 përsëri e gjejmë kryeredaktor po në revistën “Pionieri”.

Përveç me shkrime publicistike, është marrë me krijimtari letrare, për fëmijë dhe për të rritur. Nga viti 1967, kur ka botuar librin e parë me vjersha e deri me 2013, botoi gjithsej 60 vepra të ndryshme letrare.

Hasan Hasani për 55-vjet me radhë, (në vitin 1967 botoi librin e parë), ka përgatitur për shtyp veprën e plotë letrare të Ernest Koliqit në gjashtë vëllime, të Ethem Haxhiademit në dy vëllime, të Nermin Vlorës në dy vëllime, të Mehdi Frashërit në një vëllim, të Rrahman Dedajt në katër vëllime, të cilat janë botuar në Prishtinë.

Ka përgatitur numra tematikë (të veçantë) të revistës letrare “Jeta e re” për Ernest Koliqin, Gjergj Fishtën, Nermin Vlorën, Musine Kokalarin, Mehdi e Mithat Frashërin, Vinçenc Prenushin, Azem Shkrelin, B. Musliun, si dhe shumë numra tjerë tematik për personalitete të njohura të letërsisë shqipe, përfshirë këtu poetë e shkrimtarë nga e gjithë hapësira shqiptare që nga Rilindja e deri në ditët e sotme.

Poezi për të rritur:

1. "Krojet e bardha", 1967; 2. "Dallgët e vërrinit", 1969; 3. "Dy legjenda", 1969; 4. "Më bekoi pa gjuhë", 1971; 5. "Suferinë", 1967; 6. "Emoniana", 1980; 7. "Shenasa", 1980; 8. "Gurëkala", 1981; 9. "Unazëforta", 1984; 10. "Përkolajt", 1988; 11. "Emira", 1992; 12. "Gurdurimi", 1992; 13. "Gjëmim baladash", 1994; 14. "Harfë e Antikës", 1997; 15. "Plak urtak mençurak", 1997; 16. "Muza shqiptare", 1997; 17. "Idhuj adhurimi", 1998; 18. "Qerpikë me lot", 1999; 19. "Haxhiu i fshatit Pykë", 2005; 20. "Tek uji i zi", 2009; 21. "Shivegimi", 2012; 22. "Shpirtvlarë", 2012; 23. "Helmshtare", 2013; 24. "Buka e mëkatit", 2013; 25. "Shiba", 2013.

Tregime për të rritur:

26. "Njeriu që grindet me qiellin", 1979; 27. "Zhurmë në pyll", 1985; 28. "Lojë me shamia", 1990; 29. "Gruaja që grindet me pluhurin", 1996; 30. "Muzgu i hyjneshës", 1996

Romane për të rritur:

31. "Ulërima", 1989; 32. "Qafëtuli i Shavarinës", 1999; 33. "Kohë të egra",

Poezi për fëmijë:

34. "Ajkuna e Rugovës", 1978; 35. "Mici e topi", 1980; 36. "Tali i Budalinës", 1986; 37. "Vallja e shkrimtarëve", 1993; 38. "Ylberi i shkronjave", 1995; 39. "Ezopi e breshka", 1995; 40. "Shqipet e Shqiponjës", 2000; 41. "Abetarja e UÇK-së", 2006; 42. "Princesha e Shalës", 2010; 43. "Palaço në Prishtinë", 2012

Kritikë letrare:

44. "Të anatemuar", 2005; 45. "Faqe libri", 2007; 46. "Gavril Dara i Riu", 2007; 47. "Shënjëzime", 2011; 48. "Letërsia si art dhe komunikim poetik" (me Sh. Vishajn), 2011; 49. "Metafora e dhembjes", 2012; 50. "Arti i fjalës dhe i rrëfimit", 2013

Monografi:

51. "Bajrush Doda", 2011

Vepra publicistike:

52. "Nermin Vlora Falaski", 1992; 53. "Miftar Spahija korife i Lumës", 1995/2002; 54. "Nijazi Sulça mall Kosove që djeg", 2005; 55. "Nëntë biseda për Kosovën", 2005; 56. "Jehon një gjëmë mes mureve", 2005

Vepra leksikografike:

57. "Leksikoni i shkrimtarëve shqiptarë" 1501-1991, 1994/1995;
58. "Leksikoni i shkrimtarëve shqiptarë" 1501-2001, 2003;
59. "Të pavdekshmit e Dukagjinit", 2003; etj.

HASIM RUSHITI



Prof. Dr. sc. Hasim Rushiti, u lind në fshatin Rashincë të Shtimës, në vitin 1962. Fakultetin e Shkencave Sportive në Prishtinë e kreu më 1986.

Studimet pasuniversitare i regjistroi në Fakultetin e Kulturës Fizike në Universitetin e Zagrebit, ndërsa i përfundoi në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit në Universitetin e Prishtinës në vitin 1999.

Dy vite më vonë, më 2001 arrinë gradën e doktorit të shkencave sportive, me temën e doktoratës "Struktura dhe relacionet ndërmjet faktorit gjeneral të forcës dhe mekanizmit të rregullimit strukturor të lëvizjeve". Që nga viti 1987 ka punuar profesor në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit të Universitetit të Prishtinës, duke i arritur të gjithë titujt universitarë: asistent (1995-2001), profesor asistent (2001-2009), profesor i asocuar (2009-2012) dhe profesor Doktor ordinar (2013). Është autor dhe bashkautor i shumë punimeve profesionale dhe shkencore nga fusha kineziologjisë.

Punimet:

- 1.Hasim Rushiti, "Determining the time limit of the attack in handball". (Coauthor). "Acta kineziologica" No1, University of Prishtina, F.Ph.C., 1994, Prishtina.
- 2.Hasim Rushiti, "Morphological structure of the Faculty of Physical Culture students". (Coauthor). "Acta kineziologica" No1, University of Prishtina, F.Ph.C., 1997, Prishtina.
- 3.Hasim Rushiti, "Struktura morfologjike e studentëve të FKF-së në Prishtinë," Acta kineziologjika", Prishtinë, 1997.
- 4.Hasim Rushiti, "Development of some motor skills in young people in different working conditions". "Acta kineziologica" No1, U.P., F.Ph.C., 1997, Prishtina.
- 5.Hasim Rushiti, "Karakteristika metrike dhe struktura faktoriale e ca testeve të fleksibilitetit", "Acta kineziologjika", Prishtinë, 1998.
6. Hasim Rushiti, "Metric characteristics of flexibility tests and their factorial structure". "Acta kineziologica" No1, U.P., F.Ph.C., 1998.
- 7.Hasim Rushiti, "Struktura faktoriale e dimensioneve antropometrike dhe relacioni i tyre me disa aftësi motorike tek të rinjtë e moshës 13-14 vjeç", FKF i UP, Prishtinë, 1999.

8. Coauthor of the project "Development of Physical Culture at the University" supported and financed by WUS - Austria office in Kosova, 1999.

9. Hasim Rushiti, "The impact of kinesiology activities in development of some psychosomatic characteristics in young people". "Acta kineziologica" No1, U.P. F.Ph.C., 1999, Prishtina.

10. Hasim Rushiti, "Factorial structure of anthropometric dimensions and their relationship with some motor skills in young people aged 13-14 years". (Master of science thesis) University of Prishtina, F.Ph.C., 1999.

11. Hasim Rushiti, "The test of physical preparation for candidates applying at the Defense Academy, for Kosova Protection Corps", 2000.

12. Hasim Rushiti, "Struktura dhe relacionet ndërmjet faktorit gjeneral të forcës dhe mekanizmit të rregullimit strukturor të lëvizjeve", FKF, Prishtinë, 2001.

13. Hasim Rushiti, "Relations between the general strength factor and the mechanism for structural regulation of movements". (Doctor of science dissertation) University of Prishtina, Faculty of Physical Culture, 2001.

14. Hasim Rushiti, "Isometric force of bilateral and unilateral contraction of the forearm symmetric muscles". (Coauthor). "Acta kineziologica" No1, U.P., F.Ph.C., 2001, Prishtina.

15. Hasim Rushiti, "Impact of kinesiology activities in the development of isometric force in student population". "Acta kineziologica" No1, U.P. F.Ph.C., 2001, Prishtina.

16. Hasim Rushiti, "Brief analysis on contemporary basketball" (coauthor). "Sports studies" No4, 2004, Tirana, Albania.

17. Hasim Rushiti, "Connection between the basic locomotive and situational skills and their impact for more advanced results in basketball" (coauthor). "Sports studies" No5, 2004, Tirana, Albania.

18. Hasim Rushiti, "The level of development of locomotor skills of explosive type at the young people aged 11-14 years (author)". Second international symposium of education and university sport". 2006, Skopje, Macedonia, 2006.

19. Hasim Rushiti, "The mathematical principles of measurement of high jump in tensionmetrical platform" (coauthor). Second international symposium for teaching physical education, sport and sports activities for students". 2006, Skopje, Macedonia. Si dhe dhjetë (10) punime tjera profesionale shkencore nga fusha kineziologjisë.

HAVA SHALA-QYQALLA (1960-2015)



Prof. Dr. Hava Shala u lind në Trudë të Prishtinës, më 23.V.1960. Shkollimin e mbaroi në vendlindje, Gjinnazin në Prishtinë, Fakultetin Filozofik (Filologjisë), degën Gjuhë Shqipe e Letërsi, e mbaroi në Universitetin e Prishtinës.

Më 1985 ia filloi punës në Shkollën e Mesme Profesionale në Prishtinë. Më 1987 zgjidhet Asistente (në mbështetje të suksesit të lartë në studime që ka treguar) në Fakultetin e Filologjisë (ish Filozofiku) në degën e Gjuhës shqipe, për lëndën Gramatika Historike e Shqipes, të cilën lëndë e ligjëroi deri në fund të jetës së saj.

Më 1995 mbrojti me sukses punimin e magjistraturës te mentori Akad. Besim Bokshi, me temën: *Format e pashtjelluara të foljes në sistemin historik dhe mori titullin Magjistër e shkencave të Gjuhësisë.*

Në vitin 2009 mbrojti me sukses Disertacionin e Doktoratës në Universitetin e Prishtinës dhe mori titullin: Doktore e Shkencave të Gjuhës Shqipe. Më 2016 u botua vepra e saj shkencore - gjuhësore: *“Sistemi foljor i shqipes në veprën e Pjetër Bogdanit”*, dhe në vitin 2010 gradohet me titullin Profesor ass.

Merr pjesë me kumtesa, ligjërata, punime shkencore në të gjitha Seminaret e Gjuhës, Letërsisë e Kulturës Shqiptare, që mbaheshin në Prishtinë e Tiranë, që nga viti 1987.

Disa nga punimet e saja shkencore:

“Një vështrim i zhvillimit historik të paskajores dhe përdorimit të saj në shqipen standard”, në vitin 2002;

“Tingujt antihiatizues në strukturën e fjalës”, më 2003;

“Probleme të kulturës së gjuhës në institucionet arsimore”, më 2004 në Seminarin Ndërkombëtar të Albanologjisë në Tetovë;

“Format foljore perifrastike të shqipes në veprën e “Pjetër Bogdanit”, botuar në Studime Filologjike Shqiptare, mbajtur në Konferencën Shkencore të ASHAK dhe ASHSH;

“Studimet e Holger Pedersenit për morfologjinë historike të shqipes”, SNGJLKSH, më 2004

“Studimet historike të strukturës së shqipes në 100 vjetorin e tyre”, Studime Albanologjike, Tiranë 1/2012;


Më 2010 në Universitetin e Lubjanë në katedrën e Gjuhëve të huaja mban

ligjëratë dhe kumtesë: *Shkëmbim i përvojave mes universitetit tonë dhe atij në Lubjanë*, përkatësisht trajnim i metodologjisë së mbajtjes mësimore për seminaristët e huaj, që mësojnë e studiojnë gjuhën.

Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë, Kulturën Shqiptare 21, 2002, Prishtinë, mbajti kumtesën shkencore “*Një vështrim i zhvillimit historik të paskajores dhe përdorimit të saj në shqipen standarde*” ku në studimin e bërë për paskajoren paraqet një vështrimin sa historik aq edhe faktik për mënyrën e përdorimit dhe përherë të parë me argumente shkencore e studimore, Prof.dr. Hava Shala-Qyqalla paraqet kërkesën që edhe paskajorja dhe pjesorja të futen në normën e standardit të gjuhës shqipe. Pas kësaj paraqitjeje sa shkencore aq edhe faktike u hap një debat i gjerë mes gjuhëtarëve të cilët u ndanë në dy taborë: pro dhe kontra futjes në standard; Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë, Kulturën Shqiptare 22, 2003, Prishtinë, në të cilin botoi kumtesën studimore: “*Tiparet antihiatizues në strukturën e fjalës*”; Seminari Ndërkombëtar i Albanologjisë në Tetovë, 2007, paraqet kumtesën shteruese “*Probleme të kulturës së gjuhës në institucionet arsimore*”; Studime Filologjike Shqiptare, Konferenca Shkencore e ASHAK dhe ASHSH paraqet referimin: “*Format foljore perifrastike të shqipes në veprën e “Pjetër Bogdanit”*”; Konferenca Shkencore 50 vjet Studime Albanologjike, paraqet kumtesën : “*Kontributi i Besim Bokshit në ndriçimin e shumë çështjeve të morfologjisë historike*”; Në SNGJLKSH, 26, 2007 , Prishtinë, i botohet punimi studimor e shkencor : “*Vështrim historik i përemrave pronorë*”; Post Mortum: Në revistën letrare e shkencore “Orfeu” Prishtinë, 2017 iu botua studimi shkencor: “*Sistemi foljor sintetik në aspektin morfologjik*”.

Këto janë vetëm disa nga punimet e shumta që i zgjedha. Ka folur e shkruar në 4 gjuhë (shqip, anglisht, gjermanisht e serbokroatisht). Deri në ndërrim jete, ka punuar Profesoreshë e lëndës së Gramatikës Historike të Shqipes, por edhe lëndë tjera si Formimin letrar, Tekste të Vjetra, Shkrim Akademik dhe përpos në Universitetin e Prishtinës, ka mbajtur mësim edhe në Gjakovë, Prizren, Gjilan. Edhe përkundër sëmundjes që lëngonte dhe ishte në ditët e fundit të jetës, ajo për asnjë çast nuk iu nda punës me studentë. Dhe, vetëm 15 ditë para vdekjes ajo, ishte mentore e masterit të studentit Mevludin Mazrreku dhe ashtu mezi rrinte ulur, mori pjesë në mbrojtjen e masterit dhe më nuk u duk në fakultet, aty ku i dha shkencës së gjuhësisë shqiptare dijen, zotësinë e studimin e saj të zellshëm, të thellë e shkencor.

HILMI DAUTI



Prof. Dr. Hilmi Dauti, u lind në vitin 1951 në fshatin Carrabreg të Deçanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse gjimnazin e kreu në Pejë. Diplomoi në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, në vitin 1975.

Më 1977 u zgjodh asistent i lëndës së "Anatomisë së njeriut" në Fakultetin e mjekësisë në Prishtinë. Studimet pasuniversitare i përfundoi në vitin 1980 në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb. Tezën e doktoratës e mbrojti në vitin 1981 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë.

Emërohet docent, profesor inordinar, profesor ordinar i lëndës "Anatomia e njeriut" në vitin 1994 në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Në periudhën 1998-1999 qëndroi në Hjuston të SHBA-ve për perfeksionimin profesional pasdoktoral. Ishte drejtor i Institutit të Anatomisë, drejtor i Instituteve Mjekësore të QKUK-së, si dhe në funksione të tjera në kuadër të Fakultetit të Mjekësisë dhe të Universitetit të Prishtinës.

Në vitin 2004 u zgjodh drejtor për çështje akademike në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës. Është autor dhe bashkautor i një sërë punimesh shkencore dhe profesionale dhe i tekstit universitar nga fusha e "Anatomisë së njeriut". Që nga viti 1994 ishte profesor i rregullt i "Anatomisë" në Fakultetin e Mjekësisë, i "Anatomisë kineziologjike" në Fakultetin e Kulturës Sportive në Universitetin e Prishtinës, si dhe profesor i "Anatomisë së njeriut" në Universitetin e Tetovës.

Punimet shkencore:

1. Hilmi Dauti, Bajram Nuraj: "Anatomia e Njeriut - Kombliku" (Libër Universitar).


2. Hilmi Dauti, etj., "Postnatal - physiological research of the bronchial receptor system development on the isolated preparation of the human trachea in vitro", 2006.

3. Hilmi Dauti, etj. "In vitro examination of ontogenesis of developing neuronal cells in vagal nuclei in medulla oblongata in newborns, 2008.

4. Hilmi Dauti, etj. "In vitro examination of degenerative evolution of adrenergic nerve endings in pulmonary inflammatory (corrected) processes in newborns., 2008.

5. Hilmi Dauti, etj. "In Vitro Examination of Degenerative Evolution of Adrenergic Nerve Endings in Pulmonary Inflammatory Processes" 2008, etj.

HIVZI MUHARREMI



Prof. Hivzi Muharremi, u lind më 1948 në Pejë. Gjimnazin e kreu në Pejë në vitin 1963.

Më 1973, ka kryer Fakultetin e Historisë së Artit në Beograd. Më 1986 ka kryer Magjistraturën dhe më 1995, kreu Doktoratën.

Nga viti 1974, është profesor i historisë së artit në Shkollën e Mesme të Arteve Aplikative në Pejë. Më 1981, Profesor i Historisë së Artit në Akademinë e Arteve në Prishtinë.

Më 1995, Profesor i rregullt. Prej vitit 1986-1990 drejtor i Teatrit Popullor në Pejë.

Prej vitit 1997- 1999, Prodekan i Akademisë së Arteve. Prej viteve 1999-2001, 2001- 2003 dhe 2005-2007 si Dekan i Fakultetit të Arteve Prishtinë. Prej vitit 2003-2005. Ka qenë anëtar i Bordit të Universitetit të Prishtinës. Prej vitit 2007-2009, ka qenë anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit. Drejtori Teatrit Popullor në Pejë. (vitet 2001-2007). Profesor në Universitetin e Tetovës, Akademia e Arteve në vitet 1995-2010.

Prej viteve 2004-2011, ka qenë Profesor në Fakultetin Filologjik Departamenti, Gjuhë Angleze dhe Letërsi. Profesor në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara të Biznesit-Pejë, nga viti 1990 deri 2010. Prej vitit 2009 Profesor në UBT, (Ligjërues i lëndës Histori e artit dhe Histori e arkitekturës). Prej vitit 2011 e në vazhdim, Profesor në Albanian University, Tiranë dhe Berat. Më 2015 Dekan në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara Albanian University. Në periudhën e deritanishme është zgjedhur në këto vende:

1979-1983, Themelues dhe kryetar në dy mandate të Shoqatës së Artistëve Figurativë të Pejës. 1983-85, anëtar i Komitetit Nacional të Historianëve të artit të ish-Jugosllavisë.

1983-85, anëtar i kryesisë së Pedagogëve të Kosovës. 1984, anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativ të Kosovës. 1985, anëtar i Shoqatës së Artistëve Aplikativë të Kosovës. 1992, anëtar i kryesisë së Lidhjes së Historianëve të Artit në ish-Jugosllavi.

1993-97, kryetar i Shoqatës Gjithëkombëtare për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturo-Historike të Pejës dhe rrethinës. 1997- 99, anëtar i kryesisë së Shoqatës për tërë Diasporën shqiptare për Trashëgimi Kulturo-historike. 2000 kryetar për ngritjen e Kompleksit Memorial “Ademi Jashari”, në Prekaz, etj.

Botimet:

- 1986, "Pasqyrë e shkurtër e Historisë së Artit", botues: UP.
1986; "Metamorfozat e gjuhës figurative", Rilindja.
1986; "Monografia V", Radoviq.
1989; "Kultura Figurative për klasën e II të shkollave të Mesme".
2000; Monografia "Muslim Mulliqi", Botues ASHAK.
2005; "Historia e artit I", Universiteti i Prishtinës
2005; "Historia e Artit II", Tekst Universitar.
2006; "Arti Bashkëkohor i Kosovës", monografi, 2007.
"Kultura Figurative", Tekst shkollor për klasën e X.
2005; "Arti Figurativ për klasën e XII".
2010; "Maestro Mulliqi" (Monografi), botues, MK, Maqedoni.
2014; "Komunikimi dhe Bashkëpunimi Miqësor Kosovë- Kroaci".
2014; "Anëtar i Redaksisë dhe autorë i zërave për Enciklopedinë e Kosovës", Botues: ASHAK.
2015; "Qasja Vizuale", Botues, Kuvendi Komunal i Prishtinës.

Kontributet:

- 2006, "Tendencat zhvillimore të Arteve vizuale Shqiptare", Kairo,
2007, "Arti mesjetar shqiptar", ligjëratë, Edinburg, 2008,
"Interferencat ndërmjet Arteve vizuale dhe poetike", Ohër.

Që nga viti 1973 merret me kritikë figurative, ku ka botuar mbi 800 vështrime, kritika, ese dhe parathënie të katalogëve për ekspozita personale dhe kolektive si të krijuesve vendorë po ashtu edhe të jashtëm.

Punimet nga vështrimet kritiko-estetike:

- 1984, "Impresionizmi—etapë e re në Historinë e Artit modern»
1987, "Të respektohet roli i Historisë së Arteve"
1977, "Barometër Frymëzimesh e ngjarjesh Autoktone"
1977, "Pasqyrim real i arritjeve të një viti"
1980, "Ritëm dinamik i kompozicioneve"
1980, "Sintetizimi dhe integrimi i realitetit me abstraksionin"
1980, "Suprematizmi si shprehje e Konstruktivizmit e neoplasticizmit"
1981, "Konceptualizmi si sinonim i komunikimit"
1982, "Motive me kolorit të pasur"
1981, "Trajtim i gjerë i elementeve dhe i formave Figurative"
1982, "Trajtim i gjerë i formave dhe i figurave në hapësirë"
1982, "Invencionin lartë kreativ-figurativ"
2011, "Antalia, Pjesëmarrja në Koloninë Botërore", Antalia, etj.

HYDAJET HYSENI



Hydajet Hyseni, u lind më 10 mars 1954, në Përlepticë të Gjilanit. Ka studiuar gazetari-diplomaci dhe ka punuar gazetar i “Rilindjes” në Prishtinë.

Më 1973 Hydajet Hyseni u takon radhëve të organizuara të "Grupit revolucionar".

Nga ajo kohë Hydajet Hyseni vazhdoi jetën në ilegalitet të thellë deri me burgosjen e tij më 1981, i cili konsiderohet si njëri nga organizatorët kryesor të pranverës së '81-ishes. Ishte njëri prej veprimtarëve të dalluar të Lëvizjes Ilegale, një nga ideatorët e pranverës së '81-it, dikur, dhe njëri prej udhëheqësve të skenës politike kosovare, në vitet e '90-ta.

Ishte i burgosur dhe pas lirimit u mor me veprimtari politike, njëkohësisht edhe anëtar dhe nënkryetar i KMDLNJ-së, gazetar, redaktor dhe kryeredaktor i gazetës, "Bujku" ("Rilindja").

Hyseni ishte edhe njëri ndër pjesëtarët në Konferencën e Rambujesë, anëtar i Qeverisë së përkohshme dhe bashkëdrejtues në strukturat e përbashkëta administrative.

Deputet shumëvjeçar, anëtar i kryesisë, përfaqësues disavjeçar i Kuvendit të Kosovës, në KGJK si dhe në Asamblenë Parlamentare të KE-s.

Nga viti 1995 - kryetar i Shoqatës së ish të Burgosurve Politikë; nismëtar i Këshillit të Paqes në Kosovë, bashkëkoordinues i Këshillit Shqiptar për Paqe dhe anëtar i Këshillit Global të FPU-së.

Është kryetar i Shoqatës së ish të Burgosurve Politikë të Kosovës. Flet gjuhën frënge, angleze, serbe dhe në mënyrë pasive edhe italisht e gjermanisht. Jeton dhe vepron në Prishtinë.

Veprat:

“Këngët e lirisë“

“Pushka amanet“

“Përrallat flasin gjuhën time“

“Paraverë në katër pamje“

“Ngjarjet në Kosovë nuk janë kundërrevolucion“, etj.

Hydajet Hyseni, pavarësisht angazhimeve zyrtare nëpër shoqata dhe institucione shtetërore, ai asnjëherë nuk ndalon krijimtarinë e tij letrare. Përpos pesë veprave të botuara, ai ka edhe vepra tjera që presin dritën e botimit. Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës.

HYSNI DAKA



Prof. Dr. Hysni Daka, u lind më 20 janar 1952, në fshatin Kabash të Prizrenit. Diplomoi në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, më 11 janar 1978. Nga viti 1979 punoi në Institutin e Fiziologjisë të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Studimet pasuniversitare për "Imunologji klinike" me "Alergologji" i mbaroi në Fakultetin e Mjekësisë në Zagreb, ku mbrojti edhe magjistraturën më 11 janar të vitit 1985.

Disertacionin e doktoratës, e mbrojti nga po kjo fushë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, më 23.09.1987. Emërohet asistent më 1979 dhe në vitet vijuese merr të gjithë titujt përkatës universitarë.

Më 2001 u zgjodh profesor ordinar i lëndës "Fiziologjia e njeriut" dhe "Imunologjisë", në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë.

Kreu detyra të ndryshme në institucionet e shkollimit të lartë universitarë, kryetar i Shoqatës së Alergologëve dhe Imunologëve në Kosovë, anëtar i Akademisë Evropine të Alergologëve dhe Imunologëve, profesor i "Fiziologjisë kineziologjike" në Fakultetin e Shkencave Sportive në Prishtinë, profesor i "Fiziologjisë së njeriut" dhe "Imunologjisë në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Tetovës, Kolegji "Rezonanca", Kolegji "AAB" etj.

Është autor dhe bashkautor i tekstit universitar "Bazat e imunologjisë" (2013). Përktheu dhe adaptoi tekste universitare nga fusha e "Fiziologjisë së njeriut" dhe "Imunologjisë etj.


Tekstin e përkthyer të autorëve: Ian Todd, Gavin Spickett "Imunologjia" (Botuar nga: ALB-MED në 2012) përkthyer nga: Hysni Daka, Adnan Emini dhe Isa Bajçinca.

Teksti bazë i "Imunologjisë " për studentë dhe mjekë ofron në mënyrë të përshtatshme temat themelore të imunitetit dhe imunopatologjisë dhe për të dhënë një pamje të plotë të lëndës, parimet kryesore shtjellohen në mënyrë progresive.

Ky libër i përkthyer nga profesor Daka më bashkëpunëtorë, është ideal edhe për ata që e mësojnë imunotogjinë për herë të parë ose kanë njohuri të mëparshme nga kjo lëndë e mjekësisë humane.

Botimi i gjashtë i këtij libri, cilësohet me përmbajtjen e tij të përditësuar mbi rolin dhe rregullimin e qelizave dhe të molekulave të sistemit imunitar...

IBRAHIM KODRA (1918-2006)



Ibrahim Shaban Likmetaj Kodra, u lind në Ishëm, më 22 prill të vitit 1918. Vdiq më 7 shkurt 2006 në Milano.

Në moshën 20 vjeç (1938) largohet përgjithmonë nga Shqipëria me një bursë studimi nga oborri mbretëror për në Akademinë e Arteve të Bukura në Romë.

Ai e lëshon Romën dhe përfundon në Milano, në Akademinë e Arteve të Bukura të Brerës. Ai ekspozon në Romë, Milano, Venecia, Paris, Beograd, Nju Jork, krijon krahasimet dhe raporte me piktorë të mëdhenj si Pikaso, Marc Chagall, Henry Matisse, Lucio Fontana, Renato Guttuso, me poetë, shkrimtarë, Kritikë e regjisorë nga Eugenio Montale dhe Vittorio Sereni, nga Bertoni tek Bruno Munari, dhe Giuseppe Marotta.

Në vitin 1948, Ibrahim Kodra u bë mik me Pablo Picasso, pikërisht në këtë temë në "Konferencën Ndërkombëtare për Paqen e Romës", në të cilën të dy së bashku ata kryen një hulumtim të thellë artistik.

Ibrahim Kodra ka lënë pas rreth 6 mijë vepra, të shpërndara nga muze privat, koleksionistë, dhe vetëm 2 mijë prej tyre janë të regjistruara dhe të dokumentuara: Vatikan Muzetë, Vatikan.

Dhoma e Deputetëve (Itali), parlamenti italian, Itali, Muzeu Kodra, Lugano të Zvicres.

Galeria Kombëtare e Arteve, Prishtinë, Shqipëri, Muzeu Kodra, Milano, Itali.

Art Gallery nga bazilike Santuario di Santa Maria de Finibus terrae, Santa Maria di Leuca, Itali, Art Gallery mbledhja e Metropolitan qytetin e Milanos (Provincia di Milano), Itali,

Ekspozita arti:

Ekspozitë kolektive në "Paradise" me Pablo Picasso, Dali, Matta, Ernst, Levi, Panseca, Braque, etj.

Ekspozitë kolektive në "Stone Gallery", në Newcastle me Corneille, Gear, Gleghorn, Michaux, Millares, etj.

Ekspozita në Milano, The Stone Gallery në Newcastle, "Senator" në Stuttgart, po ashtu edhe në "New Art Center" në Zurich.

Ekspozitë personale në Galerinë e Artit Modern, në Prishtinë.

Ekspozitë personale në Princess Hall në New York, "2D Gallery", në Sassari, etj.

IBRAHIM RUGOVA (1944-2006)



Dr. Ibrahim Rugova, u lind më 2 dhjetor 1944 në fshatin Cerrcë, komuna e Istogut. Më 10 janar 1945 komunistët jugosllavë ia pushkatuan të atin, Ukën dhe gjyshin Rustë Rugova, gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ibrahim Rugova shkollën fillore e kreu në Istog, të mesmen e kreu në Pejë, më 1967.

Fakultetin Filozofik Dega Gjuhë e Letërsi Shqipe e kreu në Prishtinë. Gjatë vitit akademik 1976-77 qëndroi në Paris, në École Pratique des Hautes Études, nën mbikëqyrjen e Prof. Roland Barthes-it. Doktoroi në fushën e letërsisë në Universitetin e Prishtinës, më 1984.

Në vitin 1996 Ibrahim Rugova u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Kosovës. Në fillim ishte redaktor në gazetën e studentëve “Bota e re” dhe në revistën shkencore “Dituria” (1971-72), që botoheshin në Prishtinë. Një kohë punoi edhe në revistën “Fjala”. Pastaj, për afro dy dekada, Ibrahim Rugova veprimtarinë e vet shkencore e zhvilloi në Institutin Albanologjik si hulumtues i letërsisë. Një kohë ka qenë kryeredaktor i revistës “Gjurmime albanologjike” të këtij Instituti. Me krijimtari letrare u mor që nga fillimi i viteve gjashtëdhjetë.

Ibrahim Rugova më 1988 u zgjodh kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, që u bë bërthamë e fuqishme e lëvizjes shqiptare, e cila kundërshtoi sundimin komunist serb dhe jugosllav në Kosovë. Si intelektual që i jepte zë kësaj lëvizjeje intelektuale e politike, Ibrahim Rugova u zgjodh, më 23 dhjetor 1989, nga themelimi kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, partisë së parë politike në Kosovë që sfidoi drejtpërdrejt regjimin komunist në fuqi. LDK, nën udhëheqjen e Ibrahim Rugovës, u bë shpejt forca politike prijëse në Kosovë, duke mbledhur shumicën e popullit rreth vetes. Në bashkëpunim me forcat e tjera politike shqiptare në Kosovë si dhe me Kuvendin e atëhershëm të Kosovës, Ibrahim Rugova dhe LDK-ja përmyllën kornizën ligjore për institucionalizimin e pavarësisë së Kosovës.

Deklarata e pavarësisë (2 korrik 1990), shpallja e Kosovës Republikë dhe miratimi i kushtetutës së saj (7 shtator 1990), Referendumi popullor për pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës, mbajtur në fund të shtatorit 1991, qenë prelud për zgjedhjet e para shumëpartiake për Kuvendin e Kosovës, mbajtur më 24 maj 1992. Ibrahim Rugova u zgjodh President i Republikës së Kosovës. Ibrahim Rugova u rizgjodh President i

Republikës së Kosovës në zgjedhjet e mbajtura në mars të vitit 1998. Në mbështetje të rezultateve të zgjedhjeve parlamentare të 17 nëntorit 2001, u zgjodh Kryetar i Kosovës.

Çmimet dhe titujt ndërkombëtarë:

- Më 1995, iu dha Çmimi për paqe i Fondacionit Paul Litzer në Danimarkë;
- Më 1996, u shpall Doktor Nderi (Honoris Causa) i Universitetit të Parisit VIII Sorbonë, Francë;
- Më 1998, iu nda Çmimi Saharov i Parlamentit Evropian;
- Në vitin 1999, mori Çmimin për paqe të qytetit Mynster (Münster), Gjermani;
- Në vitin 1999 u shpall qytetar nderi i qyteteve italiane: Venedik, Milano dhe Breshia (Brescia);
- Në vitin 2000, mori Çmimin për paqe të Unionit Demokratik të Katalonisë "Manuel Carrasco i Formiguera", në Barcelonë, Spanjë;
- Në vitin 2004 Ibrahim Rugova u nderua me Çmimin e Evropës, Senator
- Nderi nga Fondacioni panevropian Coudenhove-Kalergi;
- U nderua gjithashtu nga Komonuelthi i Pensilvanisë (SHBA), "Mik i Shteteve të Bashkuara të Amerikës";
- Më 2004, Ibrahim Rugova u shpall Doktor Nderi (Honoris Causa) i Universitetit të Tiranës;
- Në vitin 2006 Presidenti i Shqipërisë, Alfred Moisiu dekoroi Presidentin Ibrahim Rugova (post mortum) me çmimin "Urdhrin e Flamurit Kombëtar". Vdiq në Prishtinë në vitin 2006.

Veprat:

- “Prekje lirike”, Prishtinë, 1971;
- “Bibliografia e kritikës letrare shqipe”, Prishtina, 1974;
- “Kah teoria”, Prishtinë, 1978;
- “Kritika letrare”/ koautor Sabri Hamiti/, Prishtinë, 1979;
- “Strategjia e kuptimit”, Prishtinë, 1980;
- “Vepra e Pjetër Bogdanit 1675-1685”, Prishtinë, 1982;
- “Kahe dhe premisa të kritikës shqiptare 1504-1983”, Prishtinë, 1985;
- “Refuzimi estetik”, Prishtinë, 1987;
- “Pavarësia dhe demokracia”, Prishtinë, 1991;
- “The Glow of Passion”, një antologji e letërsisë bashkëkohore në ish-Jugosllavi, në gjuhën angleze, Prishtinë, 1991.
- “Marie-Françoise Allain, Xavier Galmiche: I. Rugova, La question du Kosovo”, Paris, 1992; etj.

IDRIZ AJETI (1917-2019)



Prof. Idriz Ajeti, u lind në katundin Tupallë të Jabllanicës së Epërme, më 26. VI. 1917. Shkollën fillore e mbaroi në Banjën e Sijarinës më 1930, të mesmen në Shkup më 1938. Po atë vit u regjistrua në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Zagrebit në Degën e romanistikës.

Studimet i mbaroi pas luftës, në vitin 1949 në Fakultetin e Filozofisë të Beogradit. Punoi në Gjimnazin e Prishtinës. Nga viti 1953 deri në vitin 1960, me cilësi lektori, jepte mësim në Degën e Albanologjisë të Fakultetit të Filozofisë të Beogradit. Në vitin 1958 mbrojti disertacionin e doktoratës. Që nga viti 1960, njëherë docent, pastaj profesor inordinar dhe nga viti 1968 profesor ordinar, dha mësim në Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe të Fakultetit të Filozofisë të Prishtinës.

Me nismën e tij, pas hapjes së Fakultetit të Prishtinës (1960), u nxor revista shkencore “Gjurmime albanologjike” (1962), kurse më 1974 u organizua Seminari i Kulturës Shqiptare për albanologë të huaj. Gjatë vitit 1969-1971 ishte drejtor i Institutit Albanologjik, prej vitit 1971 deri më 1973 ishte dekan i Fakultetit Filozofik, ndërsa gjatë viteve 1973-75 rektor i Universitetit të Prishtinës. Në vitet 1979-1981 dhe 1996-1999 ishte kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Vdiq në Prishtinë, më 13 shkurt 2019.

Librat e botuar:

“Pamje historike e ligjërimit shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX”, Rilindja, Prishtinë 1960.

“Istorijski razvitak gegijskog govora Arbanasa kod Zadra, Balkanološki institut Naucnog društva B i H”, Sarajevo 1961,

“Hymje në historinë e gjuhës shqipe”, Fakulteti Filozofik i Prishtinës, Katedra albanologjike, Prishtinë 1963, .

“Ortografia e gjuhës shqipe (me Sulejman Drinin, Hasan Vokshin, Mehdi Bardhin e Latif Mulakun)”, Beograd 1964.

“Hymje në historinë e gjuhës shqipe” (botim II), Fakulteti Filozofik i Prishtinës, Katedra Albanologjike, Prishtinë 1965.

“Historia e gjuhës shqipe (Morfologjia historike)”, Prishtinë 1969.

“Probleme të historisë së gjuhës shqipe”, Rilindja, Prishtinë 1971.

“Studije iz istorije albanskog jezika”, ASHAK, Prishtinë 1982.

Vepra 1, “*Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës*”, 1997.

Vepra 2 1998, Vepra 3 1998, Vepra 4 2001, Vepra 5 2002.

”*Për të vërtetën shkencore*”, ASHAK, Prishtinë, 2006.

“*Pararendësi*”, Botimet Koha, Prishtinë, 2011.

Tekste shkollore dhe përkthime:

Letërsia jugosllave (dispensë), Prishtinë 1947.

Libër leximi për klasën IV të shkollave fillore (me Stathi Kostarin e Jani Gjjonin), Prishtinë, 1948.

Nga letërsia shqipe (me Hasan Vokshin), botim i shtëpisë botuese Mustafa Bakija, Prishtinë, 1951.

Arkadije Gajdar, Timuri dhe çeta e tij (përkthim nga serbokroatishtja), botim i shtëpisë botuese Mustafa Bakija, Prishtinë, 1951.

Libër leximi për klasën V të shkollës tetëvjeçare (me Anton Çettën), botim i shtëpisë botuese Mustafa Bakija, Prishtinë, 1954.

Libër për klasën V të shkollës tetëvjeçare (botim II), (me Anton Çettën), botim i shtëpisë botuese Mustafa Bakija, Prishtinë, 1955, etj.

Studime dhe artikuj të ndryshme:

Monumenti m'a i vjetër i gjuhës shqipe (Meshari i Gjon Buzukut 1555), Jeta e re, Prishtinë, 1950, nr. 5-6,

Vjeti i madh 1941, (përktheu Mark Krasniqi), Jeta e re, Prishtinë, 1950,

Prežihov Voranc, Nadja e mirë, (përkthim nga serbokroatishtja),

Pjetër Bogdani (1630-1689), Jeta e re, Prishtinë, 1951,

Shtjefën Gjeçovi (1874-1929), Jeta e re, Prishtinë, 1951, nr. 2-3,

Glisha Elezoviq dhe ndryshimet e kryedialekteve të shqipes, 1951, nr. 5,

Një vështrim rreth përdorimit të konjuktivit, Jeta e re, Prishtinë, 1951, nr. 6,

Vështrim mbi Fjalorin serbokroatisht-shqip të Henrik Bariçit, Zagreb, 1950, Jeta e re, Prishtinë, 1951,

Toskërishtja dhe baza dialektore e shqipes letrare, *Gjuha jonë*, 1-4/1997,

Rreth gjuhës letrare shqipe, *Rilindja*, 17.II. 2001,

Shqipja normative – pengesë apo përparësi e kulturës kombëtare, 2001,

Pas gjysmë shekulli veprimtarie shkencore, *Bota e re*, 10.VII 1997,

Mendimi shkencor shqiptar- mbështetje e sigurt për mendimin politik, *Bujku*, 26 korrik 1997,

Puna e Akademisë më 1998- Recensione- Dy fjalë mbi përmbledhjen: Probleme të historisë së gjuhës shqipe, A ka shqipja farë lidhjeje me etruskishten, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë e Kulturën Shqiptare, (2001), etj.

IDRIZ BERISHA



Akademik Idriz Berisha është piktor e poet, është lindur më 1953, në Dobërdol të Klinës. Ka kryer shkollën e mesme të artit në Pejë, kurse akademinë e arteve në Universitetin e Prishtinës. Nga vitet '80 të shek. të kaluar është angazhuar në rrjedhat e artit figurativ të Kosovës si anëtar i SHAFAK-së, dhe rregullisht merr pjesë në ekspozitat që organizon ky asociacion brenda e jashtë vendit. Rreth tri dekada ka punuar si mësimdhënës i artit në disa shkolla të Malishevës e të Klinës. Në vitet 1997-1998 punoi në Këshillin

Komunal të Arsimit të Klinës, këshilltar i kulturës, kurse gjatë luftës u angazhua në radhët e UÇK-së me punë profesionale.

Ka dhënë ndihmesën e tij në fushën e kulturës me angazhime të ndryshme në trojet shqiptare dhe jashtë, me veprimtari figurative e letrare. Ka bërë ilustrime të shumta librash, dhjetëra skenografi dramash, festivalesh e koncertesh dhe ka marrë pjesë në disa koloni artistësh në hapësirën kombëtare. Ka marrë disa çmime për pikturë: në Sallonin e Nëntorit të SHAFAK-së, Prishtinë, 2012. Pikturë vitit 2012 (Pegasi-Albania), Pikturë-artist i shquar 2015 (Pegasi-Albania). Çmimi special, Global Art 2, Kosova Art. Çmimi “Agim Ramadani” – ekspozita e përbashkët QK, Cyrih, Zvicër. Çmimi i parë në konkursin gjithëkombëtar për “Vitin e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut” (Prizren, qershor 2018), si dhe një varg mirënjohjesh e çmimesh të tjera.

Veprat:

- “Bindi i dheut”, poezi, KSH “Vorea Ujko”, Klinë, 2012.
- “Udhëtim mes dy Drinash”, poezi, KSH “Vorea Ujko”, 2014, 2018.
- “Në ç’kohë të gjeta”, poezi, “Rozafa”, Prishtinë, 2015.
- “Arti i daltuar”, bashkautor, “Rozafa”, Prishtinë, 2017).
- “Në cep nate” (poezi, 2019),
- “Monografi kushtuar artistit Arsim Berisha, piktor, valltar, koreograf e veprimtar i kulturës në Zvicër (2017), bashkautor me Ismet Krasniqin.

Është anëtar i SHAFAK (Shoqata e Artistëve aplikativ e figurativ të Kosovës, SHSHK, Pegasi-Albania.

Është i përfshirë në disa Enciklopedi e libra me poezi të poetëve të njohur dhe në atë të Akademisë së Shkencave e Arteve të Kosovës si krijues i suksesshëm...

ILIR MUHARREMI



Ilir Muharremi u lind më 1983 në Pejë. Është shkrimtar dhe veprimtarinë e tij krijuese e zhvillon në Prishtinë, Itali dhe Ballkan. Është fitues i çmimit “Shkrimtari i vitit 2018” me romanin “Psycho” nga Shoqata e shkrimtarëve të Pejës. Është autor i disa dramave për teatër dhe i disa librave poetik.

Iliri në dramën e tij flet dhe shtjellon ngjarjen në mënyrë të shkëlqyer. “Van Goghu kosovar”, është dramë që ka në qendër të vëmendjes një piktor 22-vjeçar, i cili përjeton momente të vështira gjatë periudhës së rinisë, gjë që i kushton shumë shtrenjtë në fazat e mëvonshme të jetës. Kjo dramë u inskenua në teatrin Dodona në Prishtinë, vazhdoi rrugëtimin në festivalin e Dibrës. U dha edhe në Teatrin e Shkupit. Në luftë ushtria serbe ia vret nënën, babanë dhe motrën. I tmerruar nga masakrimi i familjes, ai kalon në skizofreni. Tërë ngjarja pasqyron jetën e tij prej skizofreni, nga e cila në fund nuk mund të shërohet, andaj si 'strehë' e gjen çmendinë. Fqinji që banonte përballë shtëpisë së tij është i pari që zbulon skizofreninë e tij. Ndërsa drama “Unë me veten, Kafeneja”, janë dy drama e para flet për sfidën e njeriut me vetveten, i cili tenton të dal nga vetja, por nuk mundet. Ndërsa, komedia “Kafeneja” rrëfen për një realitet kosovar dhe ballkanik. Të mbyllur në një kafene “tallava”, personazhet rrëfejnë barsoleta, ndërsa kafeneja menaxhohet nga një vajzë nga Ukraina. Aty kemi dehje, prostitucion, para të pista, borxhe, fajde. “Moskuptimet”, është libër shkencor, i cili trajton vdekjen e Zotit dhe drejtësinë si diçka përmbi Zotin. Autori këtu tejkalon çdo filozofi atesite dhe i vihet përballë drejtësisë. Trajtohet edhe problemi i absurdit nga Albert Camus, Samuel Becket. Në libër vërtetohet se absurdi nuk ka kuptim pa njeriun. Trajtohet edhe problemi i teatrit dhe kinemasë absurde. Kemi edhe shqyrtimin e postmodernizmit.

Veprat:

- “Djali në qytetin tim” (1996),
- “Dera e fundit e çmendurisë”, poezi, (2003),
- “Van Goghu kosovar”, dramë, (2010),
- “Unë me veten, Kafeneja”, dramë, (2013),
- “Moskuptimet”, libër shkencor, (2016),
- “Psycho”, roman, (2017).

ILIR SHAQIRI



Ilir Shaqiri u lind më 6. 12.1960, në Burojë të Drenicës. Shkollën fillore e kreu në Turiqec, atë të mesme në Prizren. Studimet e larta për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe në Prizren dhe Prishtinë.

Magjistroi në degën e Letërsisë me temën “*Estetika dhe semiotika*”.

Arritjet artistike: Artist i Merituar

Krijimtaria muzikore:

Ka krijuar mbi 600 këngë në muzikën tonë të lehtë, popullore dhe për fëmijë. Krijues i muzikës në 17 filma dokumentarë. Krijues i muzikës për shfaqjet “*Zeka i Zi*” dhe “*Fizikanët*”, në Teatrin Kombëtar.

Autor i muzikës në filmin e gjatë artistik “*Mala*”, 2019. Ka botuar 34 albume muzikore dhe 4 video-albume me këngë.

Në vitin 2012, në 100-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë boton albumin muzikor me 100 këngë të përzgjedhura.

Krijimtaria letrare:

- “*Estetika dhe semiotika në krijimtarinë artistike të nënës*”, 2014,
- “*Tan Temali*”, roman , Tiranë 2014,
- “*Lemza e dheut*”, roman , Prishtinë, 2016,
- “*Adem Jashari*”, poemë, Prishtinë, 2018.
- Shaqiri është autor i skenarit për film të gjatë artistik “*Kangjelet*”, Kinematografia e Kosovës 2016 -2017.
- Autor i libretit për kantatën “*I miri i motrës*”, kompozuar nga dr. Korab Shaqiri, 2018.
- “*ITH*”, poezi dhe prozë, Tiranë, 2019.

Krijimtaria dokumentare:

- Është autor i filmit dokumentar “*Hapi i çeliktë*”, RTK 2014.
- Autor i filmit dokumentar “*Zëri i këngëve lapidare*”, RTK 2017.

Interpretimet artistike:

Ka interpretuar (aktruar) në filmin artistik A.D “*Vite të rëndësishme*”, regjisor Isa Qosja, 1997.

Ka interpretuar mijëra këngë shqipe, nëpër mijëra koncerte (shumica prej tyre humanitare), nëpër shumë vende të botës ku jetojnë shqiptarët: në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Mali i zi, Greqi, Turqi, Bosnje, Kroaci, Slloveni, Itali, Austri, Zvicër, Gjermani, Çekosllovakia, Belgjikë, e vende tjera.

Në vitin 1998, ka mbajtur 109 koncerte nëpër Evropë, në përkrahje të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në vitin 1999, gjatë luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është anëtar i Trupës Artistike Ushtarake “Hamëz Jashari”, themeluar nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së.

Vlerësimet:

Është vlerësuar brenda dhe jashtë vendit me çmimet e jurisë, çmimet e publikut si dhe çmime e shpërblime tjera:

- “Fest-Arb”, “Çmimi i publikut”, Shkup, 1992.
- “Kënga Shqiptare”, “Çmimi i parë” i jurisë dhe publikut, 1995.
- “Special avard folk moot USA”, Festivali ndërkombëtar, Karolina e Veriut - SHBA, 1994.
- “Këngëtari emblamatik i Ballkanit”, Bruksel, 2000.

Mirënjohjet-Dekoratat:

- “Mirënjohje” nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, 1999.
- “Mirënjohje” nga Shoqatat e dala nga lufta e Kosovës, 2000.
- “Nderi i Odës Dibrane”, Peshkopi, 2004.
- “Naim Frashëri i Artë” nga Presidenca e Republikës së Shqipërisë, 2011.
- “Mirënjohje” nga Batalioni i Forcave Speciale të Shqipërisë, 2014.
- “Medalje” nga Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë, 2014.
- “Mirënjohje” nga Kryepeshkopi kontinental i arbëreshëve, 2017.
- “Kalorësi i Skënderbeut” nga arbëreshët në Kalabri, 2017.
- “Qytetar nderi i Matit” nga Bashkia e Burrelit, 2018.
- “Certifikatë Mirënjohje” nga The Albanien American Academy of Sciences, New York, 2019.
- “Mirënjohje e thellë” nga Assoalbania asti-Itali, 2019.
- “Princi i Këngëve Shqiptare” nga Qendra e Artit dhe Kulturës, Tiranë, 2019.
- “Ambassador for Peace” nga Universal Peace Federation, 2019.
- “Nderi i Republikës së Kosovës” dekoruar nga Presidenca e Republikës së Kosovës, 2019.

Veprimtaria e tij kreative është përmbledhur në monografinë “*Heroizëm dhe Dashuri*”, me autor prof. dr. Kudusi Lama, botuar nga LSHK, 2012. Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës.

Vokacioni i tij është muzika, proza dhe poezia moderne.

Aktualisht është Mbikëqyrës artistik për programe të veçanta në Radiotelevizionin e Kosovës.

ILIRIANA HOXHA-ANA OXA



Anna Oxa e lindur (me emrin Iliriana Hoxha) më 28 prill 1961 në Bari të Italisë, është këngëtare italiane me origjinë shqiptare, nga Kruja, e bërë e njohur, me shfaqjet e saja në festivalin Sanremo, prej vitit 1987.

Këngët e saj janë "*Ti lascerò*", "*Storie*" dhe "*Senza pietà*", kjo e fundit ka fituar në vitin 1999.

Me ndihmën e Ivano Fossatit mori pjesë për herë të parë në festivalin e San Remos në vitin 1978, ku u paraqit me një pamje interesant, "punk look" me këngën "*Un'emozione da poco*". Kënga mori vendin e dyte, dhe fitoi ne seksionin "*Giovani*" (çmim për të rinj).

Ajo fitoi dy herë në festivalin e San Remos: në vitin 1999 me këngën "*Senza pietà*" dhe në vitin 1989 me "*Ti lascerò*" (duet me Fausto Leali).

Me Fausto Leali-n në vitin 1989 mori pjesë në Evropizion, ku ata përfaqësuan Italinë me këngën "*Avrei voluto*" dhe morën vendin e nëntë.

Ajo ishte prezantuese e festivalit të San Remos së bashku me Pippo Baudo në vitin 1994. Ishte po ashtu edhe moderatore e shfaqjes së njohur italiane "*Fantastico*" në vitet 1988 dhe 1989.

Në vitin 1979 mori pjesë në filmin "*Maschio, femmina, fiore, frutto*" nën regjinë e Ruggero Miti-t. Në San Remo mori pjesë deri tash me dhjetëra herë.

Këngët e saj pjesëmarrëse në San Remo:

1978, *Un'emozione da poco*-vendi i parë në seksionin "giovani",
vendi e dytë në seksionin "big"

1982, *Io no*

1984, *Non scendo*

1985, *A lei*

1986, *È tutto un attimo*;

1988, *Quando nasce un amore*

1989, *Ti lascerò*-vendi i parë (duet me Fausto Leali)

1990, *Donna con te*

1997, *Storie*-vendi i dytë

1999, *Senza pietà*-vendi i parë

2001, *L'eterno movimento*

2003, *Cambierò*

2006, *Processo a me stessa*

Këngë tjera të suksesshme:

1978 *Fatelo con me*
1979 *Pagliaccio azzurro*
1980 *Controllo totale*
1982 *Fammi ridere un po*
1983 *Senza di me*
1984 *Eclissi totale*
1985 *Parlami*
1988 *Tu non ridi più*
1989 *Avrei voluto*-duet me Fausto Leali
1989 *Tutti i brividi del mondo*
1992 *Mezzo angolo di cielo*
1996 *Spot*
1999 *Come dirsi ciao*
1999 *Camminando camminando*-duet me Chayanne
2001 *Io sarò con te*; Diskografia; Oxa 1982
Oxanna (1978)
Anna Oxa (1979)
Q-Disc (1980)
Per sognare, per cantare, per ballare (1983)
La mia corsa (1984)
Oxa (1985)
È tutto un attimo (1986)
Pensami per te (1988)
Fantastica (1988)
Tutti i brividi del mondo (1989)
Oxa live con i New Trolls (1990)
Di questa vita (1992)
Cantautori (1993)
Do di petto (1993)
Oxa cantautori (1994)
Anna non si lascia (1996)
Storie, i miei grandi successi (1997)
Senza pietà (1999)
L'eterno movimento (2001)
Collezione (2001)
Ho un sogno (2003).

ILIRIANA SULKUQI



Iliriana Kadri Sulkuqi (Fejzullai), u lind në qytetin e Elbasanit, në vitin 1951. Mbaroi mbaroi gjimnazin “Dhaskal Todri”, në qytetin e lindjes në vitin 1969, vazhdoi studimet në Akademinë Ushtarake të Forcave Tokësore në Tiranë.

Është diplomuar në vitin 1971. Gjatë viteve 1971-1995, Iliriana punoi ofcere, në Akademinë Ushtarake, gazetare në shtypin ushtarak dhe në Shtëpinë Botuese të ushtrisë.

Gjatë kësaj periudhe ka mbaruar studimet për gjuhë-letërsi dhe filozofi. Së fundi ka punuar si gazetare në gazetën “Drita”, organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Nga viti 2004 deri sot jeton në New York-SHBA.

Botimet e para i botoi rreth viteve '60-ta. Është vlerësuar disa herë me çmime të para Kombëtare dhe Ndërkombëtare.

Poezitë e saj janë përkthyer në disa gjuhë si: italisht, greqisht, maqedonisht, bullgarisht, arumanisht, anglisht. Renditet në disa antologji, si brenda dhe jashtë vendit, si dhe në Enciklopedinë Shqiptare të Gazetarëve, në “Lexikoni i shkrimtarëve Shqiptarë 1501-2001, me autor Hasan Hasani (Shtëpia Botuese “Faik Konica”, Prishtinë, 2003).

Është anëtare Nderi e Organizatës Shqiptare Amerikane: ”Motrat Qiriazit”, (2006). Është anëtare e Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencave dhe Arteve. (2006). Anëtare Nderi e Shoqatës së Ushtarakëve në rezervë-Dega Athinë (2008). Anëtare e Klubit të Shkrimtarëve “Drita” dhe Kryeredaktore e Revistës Letrare Artistike, “Pelegrin”.

Libra të botuar:

- “Më kërkojnë sytë e nënës”, 1974,
- “Ç'u fala stinëve që ikën?” 1988,
- “Të jesh grua” 1990, “Do të jetoj”, Rozafa, 1996,
- “Trokit dhe zgjo”, “Egnatia”, 2000,
- “Kush ma vrau OFELINË”- (italisht-shqip), Toena, 2000,
- “Për një mollë që hëngri Eva”, Prishtinë-gusht 2002,
- “(F) Shihemi në sy” (janar-shkurt), 2002,
- “Pulëbardhë në det' të zi”-“Ilar”, maj 2002,
- “Lirika” Medaur, 2003, “Hajku”- bashkautorë, “Egnatia”-2004,
- “Më kërkon falje”, Arbëria, 2004,
- “Poezi”, (dy libra në një) (botimet “Snaj”-2007).

ILIAZ BOBAJ



Iliaz Bobaj, u lind në vitin 1952 në fshatin Lazarat të Rrethit të Gjirokastrës, në një familje me tradita atdhetare dhe kulturore.

Shkollën fillore e filloi në vendlindje, por e vijoi dhe e përfundoi në qytetin e Delvinës, ku u shpërngulën familjarisht. Në qytetin e Delvinës përfundoi edhe shkollën e mesme. Ka kryer studimet e larta për matematikë dhe fizikë në Institutin e Lartë Pedagogjik të Shkodrës, kurse në Universitetin "Eqrem Çabej", në Gjirokastrë, po në këtë degë, kreu Fakultetin Matematikor.

Ka punuar mësues në rrethet e Sarandës, Delvinës, drejtues shkollë në qytetin e Delvinës, drejtues i Shtëpisë së Pionierit Delvinë dhe gjatë viteve 1992-1997 ka kryer detyrën e Sekretarit të Këshillit të Rrethit të Delvinës.

Prej vitit 1997 ka emigruar së bashku me familjen e tij në qytetin e Patrës, (Greqi), ku jeton edhe sot. Me krijimtari letrare është marrë që në bankat e shkollës, duke botuar në organet e shtypit të kohës fabula, poezi, (për të rritur dhe për fëmijë), epigrame, tregime, (për të rritur dhe për fëmijë), përkthime dhe publicistikë.

Është poet, shkrimtar, fabulist, humorist, eseist, publicist dhe përkthyes.

Veprat:

1. "Dora dhe faqja", (fabula)
2. "Dhelpra dhe gjyqtari", (fabula)
3. "Jetën e pres si të vijë", (poezi)
4. "501 fjalë të urta", (fjalë të urta)
5. "Molla e sherrit" (fabula)
6. "Legjenda e Syrit të Kaltër", (legjendë për fëmijë)
7. "Tregu i fjalës", (epigrame)
8. "Dino Buzzati ndalohet në doganë", (tregime satirike)
9. "777 fjalë të urta", (fjalë të urta)
10. "Testamenti i bukurisë", (poezi)
11. "Rrëfimet e një nate kthimi", (ese)
12. "Kali i pushtetit", (fabula, poezi satirike, epigrame)
13. "Poezitë e fqinjëve të jugut", (antologji poetike)
14. "Zogjtë e ballkonit tim", (poezi për fëmijë)
15. "Ditën e artë e shkoj me ty", (poezi)

16. “Legjenda e Butrintit” (legjendë për fëmijë)
17. “Bota është e madhe shumë” (poezi për fëmijë)
18. “Është pikërisht kështu” (tregime satirike)
19. “Legjenda e zogut Gjon” (legjendë për fëmijë)
20. “Shkolla e diplomacisë” (100 fabula)
21. “Antologji e tregimit satirik botëror” (antologji)
22. “Ylli i fshehur” (antologji poetike)
23. “Bota është sa nëna ime” (rrëfenjë për fëmijë)
24. “Legjenda e Qenit të Sharrit” (legjendë për fëmijë)
25. “Libri për Kosovën” (poezi të zgjedhura) etj.

Ka përkthyer në shqip pjesë nga veprat e autorëve të mëdhenj botërorë, (midis tyre edhe nobelist), si: Azis Nesin, Mark Tuein, Gi Dë Mopasan, Anton Çehov, Krillov, Sabiel, Xhovani Soresi, Jarosllav Hashek, Klod Arno, Jorgos Seferis, Odiseas Elitis, Konstandinos Kavafis, Sapfo, Qiqi Dhimulla, etj.

Ka përkthyer në gjuhën greke pjesë nga krijimtaria e poetëve të njohur shqiptarë: Ali Podrimja, Agim Gjakova, Agim Vinca, Mujo Buçpapaj, Kalosh Çeliku, Jeton Kelmendi, Muharrem Kurti, Rushit Ramabaja, Ibrahim Kadriu, Astrit Bishqemi, Pandeli Koci, Nikolla Spathari, Luan Rama, Tahir Bezhani, Sejdi Berisha, Mentor Hoxha, etj.

Krijimtaria e tij letrare është përfshirë në disa antologji poetike brenda dhe sidomos jashtë atdheut.


Disa nga librat e tij janë rekomanduar për programin mësimor në degët e gjuhës shqipe në Universitete brenda vendit dhe në degët e Albanologjisë jashtë vendit.

Vëllimet poetike të tij janë vlerësuar me çmime të ndryshme, kurse në gjininë e humorit me tregimin “Mjekra e kryeministrit” fitoi në konkursin e vitit 2004 - çmimin e parë. Midis të tjerash vlen të përmendet libri “Jetën e pres si të më vijë”, ku shfaqet fuqishëm talenti poetik i tij, gërshetuar me ndjenjat e atdhedashurisë (karakteristikë familjare e tij).

Pjesëmarrja e tij aktive në jetën gazetareske, sidomos në shtypin shqiptar në Greqi, si dhe është redaktor i gazetës “Lazërat”. Megjithëse jashtë atdheut, me shkrimet dhe debatet e tij, tregon se jeton brenda tij, me detajet, me gëzimet, krenarinë dhe brengat e tij. Është përkthyes i mirë nga gjuhët: greke, ruse, italiane.

Gjithashtu është fitues i mjaft çmimeve letrare, (brenda dhe jashtë vendit), për krijimtarinë e tij letrare dhe për përkthime...

ILJAZ PROKSHI (1949-2007)



Iljaz Prokshi, u lind në Fortesë (ish Vërbovc) të Drenicës, më 15 nëntor 1949, kurse vdiq më 28 prill 2007. Shkollën fillore e përfundoi me rezultat të shkëlqyeshëm. Edhe në shkollën e mesëm ishte nxënës i dalluar, duke u shquar për zgjuarsinë, vizionin dhe vokacionin prej krijuesi.

Studimet i mbaroi në Fakultetin e Filologjisë, dega për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe (Albanologji), në Universitetin e Prishtinës me nota të larta. Si gjatë shkollës së mesme dhe gjatë studimeve universitare, bashkëpunoi me të gjitha gazetatat dhe revistat e kohës si gazetar dhe krijues.

Më vonë punësohet në gazetën “Kosova” të Korporatës Energjetike të Kosovës, në Prishtinë, në fillim si gazetar, e më vonë si redaktor përgjegjës i kësaj gazete.

Poezitë e para, Iljaz Prokshi filloi t’i botojë në gazetatat dhe revistat letrare të Kosovës më 1966.

Ishte në moshë të re kur u paraqit në letërsi dhe vinte me një përvojë që e kishte arritur gjatë leximit të shkrimtarëve më moderne shqiptarë dhe të huaj.

Botoi në gazetën “Rilindja”, në revistën letrare “Jeta e re”, “Fjala”, “Bota e re”, “Zëri”, “Plejada”, “Koha ditore” dhe në disa gazeta më pak të njohura, që botohen në Kosovë, si dhe në periodikun shqiptar në Shkup të Maqedonisë, si “Flaka” dhe “Jehona”, “Top kultura”, “Spektri” në Zvicër, “Trojet tona” në New York - SHBA, e tjera.

Iljaz Prokshi i takon plejadës së krijuese avangardë të Kosovës. Në konceptet estetike të tij shquhet me idenë e një fillimi të ri në letërsinë shqipe, duke krijuar një letërsi që është simbol i artit modern.

Pak kohe më vonë ai botoi edhe tregimet e para, gjithnjë në kërkim te rrugëve dhe mjeteve të reja letrare.

Si student ishte shume aktiv në jetën kulturore. Botoi poezi, tregime, reportazhe, recensione dhe ese për letërsinë. Fitoi pothuajse çdo vit çmime letrare, për poezi ose tregime, në konkurset letrare, që shpallnin gazetatat dhe revistat e kohës. Iljaz Prokshi, në konkurse të tilla është nderuar prej çmimit të parë gjer në çmimin e tretë. Për veprën e tij si në poezi dhe në prozë kanë shkruar kritikë të njohur të vendit, ndërsa rezonancë e të gjithë këtyre, është se veprën e Prokshit e përshkon fryma e modernitetit.

Tek ky krijues, të shkruarit është gjithmonë në shërbim të kërkimit dhe të ideve filozofike, kurse në qendër të shqetësimeve të tij është njeriu, i rrahur mes erërave të absurdit dhe revoltës, kundruall një realiteti të hidhur, me kuptim, që qenia njerëzore t'i ikën karakterit negativ, të prezantoje ato vlera që shquhen për vizionin e një bote të freskët dhe të dëlirë, shënjuese për kohën dhe hapësirën.

Lexuesit e admirojnë letërsinë e tij, ndërsa kritika me gjithë këta të paret i detyrohet vlerave dhe mesazhit poetik të kësaj vepre.

Librat me poezi:

- “Pikë e bardhë ëndrrë”, ”Rilindja”, Prishtinë, 1983
- “Satanai në ferr”, poezi, “Fjala”, Prishtinë, 1992
- “Fytyrë në pergamenë”, “Rilindja”, Prishtinë, 1995
- “Psalm arbëror”, “Rilindja”, Prishtinë, 1998
- “Sonatë e dhembshurisë”, LSHK, Prishtinë, 2003.

Librat me tregime:

- “Libri i kujtimeve”, “Rilindja”, Prishtinë, 1987
- “Daullet e natës”, “Rilindja”, Prishtinë, 1990
- “Vdekja në ëndërr”, “Rilindja”, Prishtinë, 1996
- “Magjia e mjegullës”, LSHK, Prishtinë, 1997
- “Vajza e trëndafilave”, “Rozafa”, Prishtinë, 2002
- “Pallati i Helenës”, Prishtinë, 2003

Kishte edhe dy libra të gatshme për shtyp me tregime.

Romane:

- “Fundit i zemërimit”, “Rilindja”, Prishtinë, 1997
(Për këtë roman, autorit iu dha çmimi letrar si romani më i mirë i vitit i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës më 1997):
- “Dashuri në labirint”, 2001 etj.

RILEXIMI

Kur ikën lakuriqët e natës së heshtur
Kam parë shkronja trungut duke hipur,
Palla s'më hëngri për gjarprin e mbytur
Ja, tek rrëzoi diq dhe flet tani shqip.

Dhe sapo u ndezën fjalë që nuk thuhet
Mes universit tim gjeta eshtra dhe gurë,
Po sall dhimje t'ishin prapë do më duhen
Sepse mbi këtë lumë, bëmë dhe një urë.

Mbi epokat e zeza engjëlli seç më zgjoi,
As lamtumirë kujt s'i kam thënë, o Nënë,
Dhe ç'u ngrit kjo erë, s'di dot a kaloi
Vendenisi a hyri qetë apo jo në Ulpianë.

Kështu mbeti çdo vetëtimë duke e ditur
Se rileximi po fillonte fletë me fletë,
Dhe kurrë s'do të humbë asgjë e ndritur,
Ç'trazojnë krrokatjet, Uni do të rrijë i qetë.

Këto pak vargje i shkëputëm nga poezia “Rileximi” të nxjerra nga libri i Iljaz Prokshit “Satanai në ferr”, e botuar në vitin 1992.

INVA MULA



Inva Mula, lindi në Tiranë, në vitin 1963, nga babai Avni Mula dhe nëna me origjinë ruse Nina Mula. Në moshën 16 vjeçare ajo merr mësim nga e ëma e saj. Më vonë diplomohet si soprano në Akademinë e Arteve në Tiranë, ku interpreton Violetën e Traviatës, performancë kjo që do të përsëritet disa herë në rolet e mëpasshme. Ky rol i hap dyert e Teatrit të Operës në Tiranë, ku ajo këndon për 5 vjet me radhë si soliste. Aty ajo interpreton suksesshëm rolet e Rozinës tek “Berberi i Seviljes”, Mimi tek “Boheme”, Xhilda tek “Rigoletto”, si edhe këndon në opera të kompozitorëve shqiptarë.

Që nga viti 1990, ajo zhvendoset në Francë. Triumfoi në 1993 në konkursin “Placido Domingo” dhe që aty filloi një bashkëpunim të ngushtë me maestron e madh. Pikërisht këtu fillon karriera e saj ndërkombëtare, fillimisht në operën e Avignon, pastaj Los Angeles, Bonn, Washington, Chicago e New York. Bashkëpunime të mëtejshme me emra të mëdhenjë në fushën operistike si me baritonin Leo Nucci apo maestron Ricardo Muti në teatrin e la Scales në Milano, i hapin rrugën suksesit të saj të mëtejshëm në Itali. Ajo ftohet të këndojë Violetën për hapjen e teatrit Arcimoldo në Milano, sukses ky që i sjell angazhime të tjera në Itali.

Por, Inva megjithëse jeton jashtë shtetit, është më e pranishme se kurrë pranë shqiptarëve të kudondodhur në botë. Deri më sot Inva ka marrë shumë çmime, si edhe dashurinë e mbarë publikut, si shqiptar ashtu edhe ndërkombëtar, dhe këngët e saj janë bërë moto e mbarë gjeneratave.

Karriera

- 1987 Fitoi konkursin e “Këngës Shqiptare” në Tiranë;
- 1988 Fitoi konkursin “George Enesku” në Bukuresht;
- 1992 Fitoi konkursin “Butterfly” në Barcelonë;
- 1993 Merr çmim në Operalia-n e parë të Placido Domingos në Paris;
- Ka bashkëpunuar me tenorë të famshëm në operën e Bastille-s në Paris, në Bruksel, në Mynih dhe në Oslo;
- 1996 Ka marrë pjesë në operën “Medee” të Luigi Cherubini-t në Francë;
- 1998 Rikthehet në operën e George Bizet “La Jolie fill de Perth”;
- 1997 Në filmin “Elementi i pestë” i jep zërin këngëtares në rol Lucia di Lammermoor në skenën “The Diva Dance”;
- Më vonë ajo luajti në “Ivan IV” të Bizetit në Paris.

- Gjatë vitit 2001 ishte e angazhuar në Itali ku luajti në teatrin “La Scala” pjesën e Verdit “Falstaff” dhe Riggoletto-n në Arenën e Veronës;
- Ka marrë pjesë rregullisht në “La Scara” ku luajti Lucia di Lammermoor, La bohème, Manon (2006);
- Luajti gjithashtu disa herë dhe La traviata-n në qytete të rëndësishme si Tokio, Bilbao, Orange, Trieste dhe Toronto;
- 2007 Luajti Norinë-n e parë në “L'elisir d'amore” në Toulouse të Francës.
- 28 Nëntor 2012, Ka realizuar koncertin “Rrugëtimi i Kombit” në Pallatin e Kongreseve.
- 2016 Me TOB interpreton dhe vë në skenë operën “Pagliacci” të kompozitorit italian Leoncavallo.

Për herë të parë si regjisore e spektaklit, por jo për të filluar një karrierë të re, atë si regjisore, por për të realizuar dhe konceptuar një produksion, i cili është frut i eksperiencës dhe vizionit të Invës, të spektaklit nga fillimi në fund. Një sfidë e re në karrierën e saj.

Çmime dhe Nderime

- 1987 Fiton konkursin “Tefta Tashko Koço” dhe shpallet si këngëtarja më e mirë e operës për vitin 1987. Që këtu, fillon të shfaqet nëpër koncerte ndërkombëtare.
- 1990 Fiton çmimin “Zhorzh Enesko”, më pas Madamme Butterfly në Barcelonë.
- Sopranos Inva Mula i është akorduar titulli i lartë “Nder i kombit” nga [residenti i republikës, Bujar Nishani

Album

- Në vitin 2009, Inva Mula publikon albumin "Il Bel Sogno".
- Në vitin 2012, Inva Mula publikon albumin "Për Ty Atdhe".

Albumi me këngë në shqip, nuk është një rastësi që e ka quajtur pikërisht “Për ty atdhe”. Ky album që përmban 12 këngë, ka lindur si iniciativë e këngëtares pikërisht për 100 vjetorin e Pavarësisë dhe është përçaruar në të gjitha trevat shqiptare.

Janë këngët më të njohura të kënduara në vite, këngë të cilat duhet të përcillen në të gjithë brezat e ardhshëm si pasuri e çmuar e kombit tonë. Tituj si “Rrjedh në këngë e ligjërimi“, “Për mëmëdhenë”, “Himni i flamurit”, “Agimet shqiptare” apo “Dua më shumë Shqipërinë”, janë balsam për veshin e çdo bashkatdhetari, janë një rikthim në nostalgjinë e kohëve të hershme...

IRMA HASAN KURTI



Irma Hasan Kurti, u lind më 20 mars 1966, në Tiranë. Përfundoi studimet në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë, dega anglisht në 1988. Irma Kurti ka nisur të shkruajë e të botojë poezi që në moshë të vogël.

Në vitin 1980 u nderua me çmimin e parë në konkursin kombëtar me rastin e 35-vjetorit të revistës “Pionieri”. Më 1989 fitoi çmimin e dytë në konkursin e organizuar nga Radio Tirana, me rastin e 45-vjetorit të çlirimit të Atdheut.

Ka punuar si mësuese e gjuhës angleze dhe më pas gazetare në disa organe shtypi.

Ka shkruar 100 tekste këngësh të muzikës së lehtë në anketa, festivale kombëtare në RTSH e në koncerte pranvere, një pjesë e konsiderueshme e të cilave janë të njohura për publikun dhe të vlerësuara me çmime. Ka botuar disa libra në gjuhën shqipe dhe në gjuhën italiane.

Librat e saj janë përkthyer në disa gjuhë të botës: në anglisht, frëngjisht, spanjisht dhe gjermanisht.

Për poezinë dhe prozën i janë akorduar dhjetëra çmime në konkurse të ndryshme letrare në Itali, në Zvicër e në SHBA.

Në vitin 2013 fitoi çmimin ndërkombëtar “Universum Donna” për Letërsinë dhe emërtimin “Ambasadore e Paqes”, nga Universum Academy dhe Universiteti i Paqes në Lugano, Zvicër.

Veprat e botuara:

- “Këtë natë me ty”, poezi 1999
- “Shihemi në një tjetër botë”, poezi 2002
- “Qirinjtë janë fikur”, poezi 2003
- “Bëj sikur fle”, poezi 2005
- “Puthja e fundit”, poezi 2007
- “Midis dy brigjeve”, roman autobiografik, 2010
- “Një vjeshtë pa kthim”, tregime, 2013
- “Nën bluzën time”, poezi, 2013
- “Copëza shënimesh nëpër rrugët e shkreta”, publicistikë, 2013
- “Njeriu që fliste me pemët”, roman, 2015
- “Nuk është ky deti”, poezi, 2016
- “Lajmet vijnë edhe këtu”, tregime, 2016
- “Krahët rreh një flutur”, poezi për fëmijë, 2016

”Në pragun e një dhimbjeje”, poezi, 2016

“Pa atdhe”, poezi, 2017

“Në borxh me dashurinë”, poezi, 2018

“Mesazhe nga lart”, poezi, 2018.

Irma Kurti njihet nga publiku i gjerë si krijuese e talentuar e teksteve të këngëve të lehta. Është pjesëmarrëse në anketa muzikore, festivale kombëtare e koncerte pranvere përpara dhe pas viteve ‘90-të. Shumë prej këngëve me tekstet e saj janë nderuar me çmime dhe poezitë e tyre kanë mbetur ende tek dashamirësit e muzikës së lehtë. Plot lirika të suksesshme poetja i shkroi që në bankat e Universitetit. Përmendim: “Urimi yt”, “Mbrëmja që mban dashurinë time”, “Pranë të kaltrit det”, “Letër malli”, “Një çast në kujtesën tënde”, “Shikomë në sy”, për të vazhduar në vitet e mëvonshme me: “E njëjta ëndërr”, “Larg nga vetvetja”, “Dhe prapë jam kthyer”, “Trokite tek dera”, “Të jem për ty Number 1”, “Imazh i largët”, ”Nën dritën e qirinjve”, "Befas zgjohem", "Ndjehem ndryshe" etj.

Libra në gjuhën italiane

“Tra le due rive” (Midis dy brigjeve), botim i Shtëpisë Botuese Kimerik, 2011

“Risvegliare un amore spento” (Të rizgjosh një dashuri të shuar), poezi, botim i Shtëpisë Botuese Aletti Editore, 2011.

“Un autunno senza ritorno” (Një vjeshtë pa kthim), përmbledhje me tregime, Kimerik, 2012.

“Sotto la mia maglia” (Nën bluzën time), poezi, Kimerik, 2013.

“Le notizie arrivano anche qui” (Lajmet mbërrijnë edhe këtu), përmbledhje me tregime, Kimerik, 2014.

“Non è questo il mare” (Nuk është ky deti), poezi, Kimerik, 2014.

“Sulla soglia di un kolore” (Në pragun e një dhimbjeje), poezi, Kimerik, 2016.

“Senza patria” (Pa atdhe), poezi, Kimerik, 2016

“In assenza di parole” (Në mungesë të fjalëve), roman, Kimerik, 2017.

“Le pantofole della solitudine” (Pantoflat e vetmisë), poezi, Besa Editrice, 2018.

“Il sole ha emigrato” (Dielli ka emigruar) poezi, Edizioni Convalle, 2019.

Libra në anglisht

“I knew the gray sky” (Njoha qiellin gri), poezi, 2014.

“Under my blouse” (Nën bluzën time), poezi, 2015.

“A cottage in the forest” (Një shtëpizë në pyll), poezi për fëmijë, 2016.

ISAK SHEMA



Prof. Dr. Isak Shema, u lind më 10.02.1940, në Beguncë, komuna e Vitisë.

Është doktor i shkencave filologjike dhe profesor ordinar i Fakultetit të Filologjisë, (Dega e Letërsisë Shqipe) të Universitetit të Prishtinës.

Për qëllime studimi në disa intervale kohore, ka qëndruar në Shqipëri, Francë, Austri, Zvicër, Itali, Gjermani, Belgjikë, Angli etj. Me ftesën e universiteteve: Universiteti i Tiranës, Universiteti Parisit, Universiteti i Bordosë, Universiteti i Oldenburgut, Universiteti “Université Libre” i Brukselit, Universiteti i Kalabrisë në Rende, Universiteti i Sankt Petersburgut, etj, ka qëndruar në këto institucione universitare për qëllime studimi dhe është interesuar të njohë sa më mirë planet dhe programet mësimore dhe funksionimin e tyre. Përveç punës arsimore dhe shkencore dhe angazhimit të vazhdueshëm në punë profesionale me studentët, ka pasur edhe angazhime në funksione të tjera në Universitetin e Prishtinës, në kolegjin “Universum” të Prishtinës, në kolegjin “ILIRIA” etj.

Veprat e botuara:

- “Aspekte të letërsisë”, Rilindja, Prishtinë, 1985
- “Vrojtime letrare dhe artistike”, Rilindja, Prishtinë, 1995
- “Vlerësime të letërsisë shqiptare”, Rilindja, Prishtinë, 1996
- “Procedime letrare”, Rilindja, Prishtinë, 1999
- “Çështje të arsimit kombëtar shqiptar”, Libri shkollor, Prishtinë, 2000
- “Metodologji dhe teknikë e punës shkencore”, Prishtinë, 2004
- “Letërsia shqiptare e shekullit” XX, “Rozafa”, Prishtinë, 2005
- “Ismail Kadare fitues i çmimit “The Man Booker International Prize”
- “Onufri”, Tiranë, 2006
- “Studime letrare”, Universiteti AAB, Prishtinë, 2008
- “Identitet letrare I”, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2015
- “Kultura letrare bashkëkohore”, LSHK, Prishtinë, 2015
- “Studije albanske književnosti”, Dituria 2015, Prishtinë, 2015
- “Identitete letrare II”, Prishtinë, 2016
- “Josip V. Relja-Jeta dhe krijimtaria letrare”, Prishtinë, 2016
- “Josip V. Relja-Jeta dhe krijimtaria letrare”, Zarë, Prishtinë, 2016
- “Josip V. Relja-Život i književno stvaralaštvo”, Prishtinë, 2015
- “Shkrimi akademik”, Kolegji Iliria, Prishtinë, 2013 (Dispensë)

- “Letërsia shqiptare I”, për klasën e parë dhe të dytë gjimnaz dhe për shkollat e mesme, Modeli C, Prishtinë, 2016
- “Mësimi i shqipes në Arbënesh të Zarës:”, Prishtinë, 2017
- “Faik Konica-Bruxelles 1896-1902”, Prishtinë, 2019
- “Sterjo Spasse-Jeta dhe krijimtaria letrare”, (Studim monografik), Prishtinë, 2019.

Bibliografi:

- Bibliografi e kritikës letrare shqiptare 1844-1974, (Bashkautor Ibrahim Rugova), Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1976. Ribotoi Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i Kosovës, Prishtinë, 1997;
- Bibliografite e letërsisë dhe të kritikës letrare shqiptare, në “Procedime letrare, Prishtinë 1999;
- Libri Faik Konica-Bruxelles 1896-1902, Prishtinë, 2019.

Tekste shkollore:

- Lexim letrar I, (bashkautor Latif Berisha), ETMM, Prishtinë, 1997,
- Lexim letrar II, (bashkautor Latif Berisha), ETMM, Prishtinë, 1979.

Përgatitja e botimeve

- Hasan Mekuli: Romani shqiptar, “Libri shkollor”, Prishtinë, 2000 (Librin e kanë përgatitur: Vehap Shita, Isak Shema),
- Latif Berisha: Vepra, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2002 (Librin e kanë përgatitur: Isak Shema, Nuhi Rexhepi dhe Sali Bashota,
- Josip V. Rela, Nita, Faik Konica”, Prishtinë, 2014,
- Josip Vladović Relja: Nita, Društvo zadarskih Arbanasa, Zarë, 2014,
- Shime Deshpali: Vepra letrare, LSHK, Prishtinë, 2015,
- Grup autorësh: Universiteti dhe shoqëria bashkëkohore, Prishtinë, 2003,
- Universiteti i Prishtinës, Fakte dhe shifra (2001-2002), Prishtinë, 2002,
- Akademik Aleksandër Stipçeviq, Kolegji Iliria, Prishtinë, 2017,
- Iliria dhe Ilirët, Kolegji Iliria, Prishtinë, 2018,
- Shqipja standarde dhe gjendja standarde aktuale e përdorimit të saj, kolegji Iliria, Prishtinë, 2018,
- Besëlidhja e Lezhës dhe 540 vjetori i vdekjes së Skënderbeut, kolegji Iliria, Prishtinë, 2018,

Ka marrë pjesë me punime shkencore të paraqitura në kongrese, konferenca dhe seminare shkencore ndërkombëtare.

Në kuadër të manifestimi tradicional mbarëkombëtar kulturor e “Flakadani i Karadakut 2019”, që kishte karakter garues, vendin e parë e ka zënë prof. dr. Isak Shema me poezinë “Relikt”.

ISLAM LAUKA



Prof. Dr. Islam Lauka u lind më 18 qershor 1954, në fshatin Bytyç të Tropojës.

Eshtë diplomat i njohur karriere, studiues dhe autor i disa veprave shkencore. Në vitin 1976, ka përfunduar Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Tiranë. Në vitin 1982, përfundoi kursin e lartë të filozofisë, ndërsa në vitin 1986, mbaroi kursin e diplomacisë.

Pas disa viteve punë 1976-1981, si mësimdhënës, në Lekbibaj dhe Bytyç, të rrethit të Tropojës, si dhe drejtues i Komitetit të Rinisë në po këtë rreth (1982-1985), në shtator të vitit 1985, transferohet në Tiranë, në sistemin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, në fillim, si i atashuar, referent, shef sektori, ndërsa në vitin 1991, emërohet sekretar i parë dhe, më vonë, i ngarkuar me punë i Ambasadës së Shqipërisë në Moskë.

Në vitin 1994, mbrotji doktoraturën në politologji, në Akademinë Diplomatike të Moskës, në Rusi.

Pas kthimit në atdhe, në vitin 1996, jep dorëheqjen nga Ministria e Jashtme dhe deri në vitin 2005 merret me aktivitet privat.

Në vitin 2005, rikthehet në MPJ, duke kryer detyra të rëndësishme si, Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë Rajonale, Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Organizatave Ndërkombëtare dhe Drejtor i Bordit të Institutit të Diasporës.

Në vitin 2009, emërohet Ambasador i Shqipërisë në Kosovë. Në periudhën shtator 2013 - mars 2014 ka kryer detyrën e Dekanit të Trupit Diplomatik, të akredituar në Prishtinë.

Pas përfundimit të mandatit të tij si ambasador, në mars 2014, transferohet në Tiranë, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, me gradën diplomatike Ministër Këshilltar, ku qëndroi deri në mars 2015.

Aktualisht, është ligjërues në UBT dhe kolegjin “Fama”, në fushën e diplomacisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Nga viti 2003, është Presidenti i Qendrës Shqiptare të Studimeve Amerikano – Britanike dhe nga viti 2005 Drejtori Institutit Shqiptar të Studimeve Politike.

Ka marrë pjesë në dhjetëra konferenca ndërkombëtare dhe ka botuar artikuj të shumtë shkencorë, kryesisht, për çështjen e Kosovës, në shtypin vendor dhe atë të huaj.

Veprat:

Vepra kryesore e tij është “Kosova, rast universal apo sui generis”, e botuar në vitin 2007, në disa gjuhë të huaja.

Në këtë libër, Prof. Dr. Islam Lauka polemizon, kryesisht, me autorë rusë, rreth “precedentit” të Kosovës, duke i hedhur poshtë pretendimet e tyre për analogji të rastit të Kosovës me “konfliktet e ngrira” në hapësirën e ish Bashkimit Sovjetik, dhe duke argumentuar shkencërisht që Kosova është një rast i veçantë, i cili kërkon zgjidhje të veçantë, dhe se nuk ka alternativë tjetër, veç pavarësisht të saj.

Libra të tjerë:

- “Evoluconi i problemit të Kosovës dhe gjendja e tij aktuale (1994)
- “Shkëputja e Kosovës nga Rusia” (2007)
- “Kosova e pavarur ose dështimi i kryqëzatës ruso-serbe” (2011)
- “Kosova e kërcënuar nga gjarpri i shtëpisë” është libri më i ri i autorit.

Bashkautor i librave:

- “Shqipëria në arkivat ruse” (2006)
- “Antologjia e kryqëzimit: qëndrimi rus ndaj çështjes shqiptare, 1878-2012” (2012)

Botues:

- “Toni Bler për shqiptarët ” (Ramiz Lushaj, 2001)
- “Marrëdhëniet shqiptaro-hebraike” (Haxhi Bajraktari, 2009)
- “Medlin Ollbrajt- misionarja e Kosovës (Fatbardha Lauka, 2011)

Është shpallur dy herë qytetar nderi, fillimisht në komunën e Bytyçit (2010) dhe në Bashkinë e qytetit të Bajram Currit (2015), në të dyja rastet me motivacion të njëjtë - për argumentimin shkencor dhe mbrojtjen diplomatike të çështjes së Kosovës, si dhe lobimin për njohjen e saj si shtet i pavarur dhe sovran.

Kuvendi i komunës së Deçanit më 29.07.2016 bje këtë vendim: “Shpallë Qytetar nderi i komunës së Deçanit ish Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë Dr. Islam Lauka. Me motivacion për kontribut të shquar në shkencë, politikë dhe diplomaci. Edhe vet Dr. Islam Lauka, pasi pranoi titullin (më 31 tetor 2016), “Nderi i Qytetit të Deçanit” tha se; Deçani është shtyllë e shqiptarisë, unë nuk mund ta dalloj Deçanin nga Lezha nga Kruja e qytete tjera, Deçani në të gjitha kohërat ka ruajtur vlerën, traditën burrërinë dhe trimërinë. Unë jam shumë më fat që nga sot bartë edhe një përgjithësi, e kjo është nder për mua, që gjithë jetën do të jem edhe banor i qytetit të Deçanit...

ISLAM QERIMI



Prof. Dr. Islam Qerimi, u lind në Dumnicë të Poshtme, komuna e Vushtrisë më 12 prill 1967. Ka mbaruar studimet bazike në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës (10 korrik 2002).

Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin Juridik të Universitetit Ruhr të Bochum-it (23 shtator 2004) dhe arrijti gradën shkencore akademike magjister i Drejtësisë. Tezën e doktoraturës më titull "Diversioni në Austri dhe Kosovë. Krahasim juridik me theks të veçantë tek veprat penale kundër jetës dhe trupit" në Universitetin e Vijenës më 19 janar 2016 morri gradën akademike Doktor i shkencave juridike (Doktor der Rechte).

Punoi si pedagog në Kolegjin Mbretëror "Iliria", në Prishtinë prej vitit 2007-2010; Kolegjin "Victory", në Prishtinë 2010-2011.

Nga data 24 nëntor 2016 e tutje, Prof. Ass. Dr. Islam Qerimi, është Prodekan për mësim në Fakultetin Juridik të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", si dhe profesor për lëndet penale.

Ka shumë publikime në disa revista shkencore në shumë vende të botës Munihi, Hamburg, Graz, Rijekë, Osijekë, Prishtinë etj.

Që nga marsi i vitit 2020 Prof. Ass. Dr. Islam Qerimi, është anëtar i rregullt i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Arteve, Nju Jork, Prishtinë, Tiranë, Shkup.

Publikime në revista shkencore:

1. Islam Qerimi - Ardrit Gashi "Wirtschafts- und Organisierte Kriminalität in den Ländern Südosteuropas", 2010.
2. Islam Qerimi "Die Institutionen der Rache und der Blutrache bei den Albanern", 2009.
3. Islam Qerimi & Latif Hyseni "E Drejta e autorit dhe plagjiati me theks të veçantë në Kosovë", 2010.
4. Bedri Bahtiri & Islam Qerimi "Mediation as a Way of Alternative Resolution of Disputes in Kosovo", 2014.
5. Islam Qerimi & Vebi Mujku "The Situation of repatriates in Kosovo and Their impact on Poverty", 2016.
6. Islam Qerimi & Bedri Bahtiri „Alternative Sanktionen im kosovarischen Strafrechtssystem Alternative Strafen, Diversion, Mediation und Erziehungsmaßnahmen“, 2017.

7. Bedri Bahtiri & Islam Qerimi "Family and Marriage in the Family Law of Kosovo", 2017.
8. Islam Qerimi & Bedri Bahtiri "Die Entwicklung des Strafrechts- und Strafprozessrechts im Kosovo", 2017.
9. Islam Qerimi & Vebi Mujku "Abandonment of children, housing and adoption system in Kosovo", 2017.
10. Bedri Bahtiri & Islam Qerimi "The Regulation and Protection of Children's rights in Kosovo from a legal aspect", 2019.
11. Islam Qerimi "Legal comparison of the Kosovo and Austrian Criminal Law System with a special emphasis on diversity measures", 2019.
12. Bedri Bahtiri & Islam Qerimi "Vermittlung und Versöhnung bei den Albanern", 2020. Etj.

Librat e publikuar në shtëpitë botuese gjermane:

1. Islam Qerimi & Mejreme Berisha: "Criminal Offences, Sentences and Its Enforcement Under the Albanian Customary Law (German Edition)", München, 2011.
2. Islam Qerimi: "Eine Kurze Geschichtliche Zusammenfassung Der Beziehungen Zwischen Albanern Und Österreichern (German Edition)", München, 2011.
3. Islam Qerimi: "Ausländer in den österreichischen Kriminalstatistiken (1990 - 2009) (German Edition)", 2013.
4. Islam Qerimi: "Urheberrecht und Plagiat (German Edition)", 2013.
5. Islam Qerimi & Vjollca Salihu: "Social Organization and Self-Government of Albanians According to the Customary Law (German Edition)", München, 2013.
6. Islam Qerimi: "Einige Fakten und Ansichten des Terrorismus in Ex-Jugoslawien" (German Edition), München, 2013.
7. Islam Qerimi: "Rolle und Herkunft des Kanun bei den Albanern (German Edition)", München, 2013 (Plotësimi i librit - gusht 2018 - Zweite Auflage)
8. Islam Qerimi & Mejreme Qerimi (Berisha): "Praktisches Beispiel aus der Familienmediation" (German Edition), München, 2013.
9. Islam Qerimi: „Gewohnheitsrecht in Albanien" (German Edition), Hamburg, 2014 (Plotësimi i librit të parë - gusht 2018 - Zweite Auflage)
10. Islam Qerimi: "Dissertation: Diversion in Österreich und im Kosovo: Rechtsvergleichung insbesondere bei strafbaren Handlungen gegen Leib und Leben (German Edition), Vijenë, 2015.
11. "Eu-Mediationskonzepte zur Konfliktlösung", 2016. Etj.

ISLMAIL DRESHAJ



Prof. Dr. Ismail Dreshaj, u lind në Nabërgjan të Pejës në vitin 1951. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin e kreu në Pejë. Fakultetin e Mjekësisë e kreu në Prishtinë, më 1975. Pas diplomimit angazhohet në procesin mësimor në Institutin e "Fiziologjisë Patologjike" të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë.

Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd, në vitin 1981. Në Fakultetin e Universitetit të Harvardit në Boston, punoi në Laboratorin e Fiziologjisë pulmonologjike (1983-1985). Tezën e doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë (1988). U zgjodh docent i lëndës "Fiziologjia Patologjike" dhe në periudhën 1976-1983, njëkohësisht punoi në njësinë nukleare të fizikës në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Pas kthimit nga SHBA-të (1985-1991) punoi në "Fiziologjinë patologjike"-në njësinë respiratorë (Fiziologjinë patologjike pulmonare) të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Në vitin 1991 përjashtohet nga puna nga masat e dhunshme serbe dhe po atë vit shkoi në Fakultetin e Universitetit të Klivlendit (Ohio, SHBA), ku bashkë me Akademik Prof. Dr. Musa Haxhiun bënë kërkime të frytshme në kontrollin e frymëmarrjes. Më pas kreu specializimin për "Mjekësi interne" dhe më 2004 u zgjodh asistent profesor në Spitalin Universitar të Klivlendit (Ohio, SHBA). Në këtë qendër është zgjedhur disa herë mësimdhënës i vitit dhe "Master clinician".

Punimet shkencore në bashkautorësi:

1. M A Haxhiu, M Jakupi, I A Dreshaj, Halil Ahmetaj: "[The effect of Ca²⁺ blockers on the response of respiratory tract smooth muscle to bronchoconstrictor and bronchodilator agents]" 1988
2. M Jakupi, I A Dreshaj, I Mandura, M A Haxhiu: "Effect of ethanol on tone of isolated smooth muscle of the pulmonary artery", 1991
3. M.A. Haxhiu, I.A. Dreshaj, Bernadette Erokwu, Paul Ernsberger: "Vasodepression elicited in hypertensive rats by the selective I₁-imidazoline agonist moxonidine administered into the rostral ventrolateral medulla," 1992
4. M.A. Haxhiu, I.A. Dreshaj, S G Schäfer, Paul Ernsberger: "Selective Antihypertensive Action of Moxonidine Is Mediated Mainly by I₁-Imidazoline Receptors in the Rostral Ventrolateral Medulla", 1994

- 5.I Litmanovitz, I Dreshaj, M J Miller, R J Martin: "Central chemosensitivity affects respiratory muscle responses to laryngeal stimulation in the piglet" 199
- 6.Ricardo J. Rodriguez, Ismail A. Dreshaj, Ganesh K Kumar, Richard J. Martin: "Maturation of the cholinergic response of tracheal smooth muscle in the piglet", 1994
- 7.I A Dreshaj, M J Miller, Paul Ernsberger, M A Haxhiu: "Central effects of endothelin on respiratory output during development", 1995
- 8.R J Martin, I A Dreshaj, M J Miller, M A Haxhiu: "Neurochemical control of tissue resistance in piglets", 1995
- 9.Ismail A. Dreshaj, Musa A. Haxhiu, Charles F. Potter, Richard J. Martin: "Maturation changes in responses of tissue and airway resistance to histamine", 1996
- 10.Mesut Sahin, Musa A. Haxhiu, Durand M Durand, Ismail A. Dreshaj: "Spiral nerve cuff electrode for recording of respiratory output", 1997
- 11.Maroun J Mhanna, Ismail A. Dreshaj, Musa A. Haxhiu, Richard J. Martin: "Mechanism for substance P-induced relaxation of precontracted airway smooth muscle during development", 1999
- 12.IA Dreshaj, FH Agani, JE Krause, MA Haxhiu: "NK-1 receptors (R) are not required for changes in respiratory output induced by hypoxia or cyanide administration in mice," 1999
- 13.Jalal M Abu-Shaweesh, Ismail A Dreshaj, Martha J Miller, Richard J Martin: "GABAergic Mechanisms Are Involved in Respiratory Depression Induced by Laryngeal Nerve Stimulation:", 1999
- 14.Maroun J Mhanna, Ismail A Dreshaj, Musa A Haxhiu, Richard J Martin: "Maturation Influences Electrical Field Stimulation [EFS] Induced Relaxation of Airway Smooth Muscle in Mice", 1999
- 15.Sabine C Iben, Ismail A Dreshaj, Musa A Haxhiu, Richard J Martin: "Hyperoxia Affects NO-Induced Modulation of Bronchopulmonary Responses to Vagal Stimulation during Development", 1999
- 16.M A Haxhiu, I A Dreshaj, C B McFadden[...], Paul Ernsberger: "Moxonidine acting centrally inhibits airway reflex responses", 1999
- 17.Jalal M. Abu-Shaweesh, Ismail A. Dreshaj, Agnes J. Thomas, Richard J. Martin: "Changes in respiratory timing induced by hypercapnia in maturing rats", 1999
- 18.R Belegu, S Hadziefendić, IA Dreshaj[...], R J Martin: "CO2-induced c-fos expression in medullary neurons during early development", 1999

19. Mulakkan D, Yohannan, Richard J. Martin, Ismail Dreshaj, Paul Ernsberger: "Ontogeny of neurokinin-1 receptors in the porcine respiratory system", 1999
20. D G Ferguson, M.A Haxhiu, A.J To, I.A Dreshaj: "The $\alpha 3$ subtype of the nicotinic acetylcholine receptor is expressed in airway-related neurons of the nucleus tractus solitarius, but is not essential for reflex bronchoconstriction in ferrets", 2000
21. Sabine C Iben, Ismail A. Dreshaj, Carol F Farver, Richard J. Martin: "Role of endogenous nitric oxide in hyperoxia-induced airway hyperreactivity in maturing rats", 2000
22. F P Tolentino-Silva, MA Haxhiu, Paul Ernsberger, IA Dreshaj: "Differential cardiorespiratory control elicited by activation of ventral medullary sites in mice", 2000
23. M.A. Haxhiu, J.C. Chavez, P Pichiule, I.A. Dreshaj: "The excitatory amino acid glutamate mediates reflexly increased tracheal blood flow and airway submucosal gland secretion", 2000
24. Musa A Haxhiu, Bryan Yamamoto, Ismail A Dreshaj[...], Donald G Ferguson: "Involvement of glutamate in transmission of afferent constrictive inputs from the airways to the nucleus tractus solitarius in ferrets", 2000
25. F.H. Agani, I.A. Dreshaj, M.A. Haxhiu, R.J. Martin: "cDNA expression array reveals hyperoxia-induced changes in patterns of gene expression in mouse lung", 2000
26. Jalal M. Abu-Shaweesh, Ismail A. Dreshaj, Musa A. Haxhiu, Richard J. Martin: "Central GABAergic mechanisms are involved in apnea induced by SLN stimulation in piglets", 2001
27. I.A. Dreshaj, M.A. Haxhiu, M.J. Miller, R.J. Martin: "Differential effects of hypercapnia on expiratory phases of respiration in the piglet", 2001
28. Pakaphan Kiatchoosakun, Ismail A Dreshaj, Jalal M Abu-Shaweesh, Richard J Martin: "Effects of Hypoxia on Respiratory Neural Output and Lower Esophageal Sphincter Pressure in Piglets", 2002
29. Mohammad Khassawneh, Ismail A Dreshaj, Shijian Liu, Richard J Martin: "Endogenous nitric oxide modulates responses of tissue and airway resistance to vagal stimulation in piglets", 2002
30. Musa A Haxhiu, Bryan Yamamoto, Ismail A Dreshaj, Donald G Ferguson: "Activation of the midbrain periaqueductal gray induces airway smooth muscle relaxation", 2002. Etj.

ISMAIL KADARE



Ismail Kadare u lind më 28 janar 1936 në Gjirokastrë. Shkollën fillore dhe të mesme e mbaroi në Gjirokastrë.

Studimet universitare i kreu më 1958, në Universitetin e Tiranës, në degën e Gjuhës e të Letërsisë dhe u diplomua për Mësuesi. Gjatë viteve 1958-1960 studioi në Moskë, në Institutin e Letërsisë Botërore "Maksim Gorki".

I zhgënjyer nga realizmi socialist, mendoi ta lë letërsinë krejtësisht. Detyrohet t'i braktisë studimet para kohe, për shkak të prishjes së marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik. U kthye në atdhe dhe nisi punë si gazetar dhe e filloi karrierën letrare.

Përgjatë viteve '50 dhe në fillimet e viteve '60, Kadare ishte i njohur për poezi, kurse duke filluar nga vitet '60 edhe për prozë.

Në moshën 13 vjeçare zbuloi Makbethin, një ndër veprat e Shekspirit dhe kështu i lindi dashuria për letërsinë. Në këtë moshë shkroi tregimet e para, të cilat i botoi te revista "Pionieri" në Tiranë. Më 1954 botoi një përmbledhje poetike e quajtur "Frymëzime djaloshare".

Kadare shkroi romanin e tij të parë "Mjegullat e Tiranës", të cilin e përfundoi në prag të vijimit të studimeve. Në vitin 1961 botoi edhe një vëllim poetik me titull "Shekulli im". Gjatë qëndrimit në Moskë kishte shkruar romanin "Qyteti pa reklama".

Nga ky roman shkëputi një fragment, i cili u botua si novelë me titullin "Ditë kafenesh", më 1962 te "Zëri i Rinisë". Sapo doli u ndalua.

Në vitin 1962 e botoi tregimin "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", të cilin më pas e zgjeroi, e bëri roman, dhe e botoi të plotë në vitin 1963.

Romani pasues, "Përbindëshi", i cili ishte antidogmatik, u botua në revistën "Nëntori", mirëpo menjëherë u etiketua si dekadent dhe u ndalua.

Kadare është shkrimtari i vetëm shqiptar me njohje ndërkombëtare dhe është i përkthyer në 45 gjuhë.

Ismail Kadare është laureat i shumë çmimeve letrare kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në vitin 1992 u vlerësua me Prix Mondial Cino Duca. Në vitin 2005 fitoi çmimin "Man Booker International Prize", ku kishte qenë i nominuar bashkë me shkrimtarë të tjerë të mëdhenj botëror. Në vitin 2009 u nderua me çmimin spanjoll "Princi Asturias" për Artet-çmimi më i rëndësishëm

letrar në vendet spanjolle, dhe një nga çmimet letrare më prestigjioze në botë. Në vitin 2010 Ismail Kadare nderohet në Itali me çmimin “Lerici Pea”. Në vitin 1996 Kadare u bë anëtar për jetë i Akademisë së Shkencave Morale dhe Politike në Francë.

Ismail Kadare është dekoruar nga institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë me Urdhrin “Nderi i Kombit” dhe nga shteti francez me urdhrat “Kryqi i Legjionit të Nderit” dhe “Oficer i Legjionit të Nderit”.

Me studimin e veprës së Kadaresë janë marrë autorë të shteteve të ndryshme, të cilët kanë botuar vepra dhe studime për të në gjuhët e tyre amtare: Eric Faye dhe Jean-Paul Champseix (frëngjisht), Piet de Moor (hollandisht), Peter Morgan (anglisht), Jose Carlos Rodrigo Breto (spanjisht). Ky i fundit e ka vlerësuar si një nga shkrimtarët më të rëndësishëm të gjysmës së dytë të shekullit XX, dhe shkrimtarin më të rëndësishëm të shekullit XXI.

Veprat:

“Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Kështjella”, “Kronikë në gur”, “Shekulli im”, “Ura me tri harqe”, “Kush e solli Doruntinën”, “Prilli i thyer”, “Dosja H”, “Palalti i ëndrrave”, “Piramida”, “Pasardhësi”, “Ëndërrimet”, “Frymëzime djaloshare”, “Përse mendohen këto male”, “Motive me diell”, “Koha” etj.

Përkthime

Një ndër fushat më pak të lakuara të veprimtarisë së Kadaresë janë përkthimet, hulli të cilën e nisi më 1955, kur shqipëroi poemat *Lisi*, *Fëminija*, *Në pyllin afër fronit*, *Katjusha*, *Pranvera*, etj. të shkrimtarit rus M. Isakovski. Autorë të tjerë të shqipëruar prej tij janë: Eskili, Heminguej, Pushkin, Majakovski, Eminescu, Gogol, Esenin, Mihallkov, Shçipaçov, Mickieviç, Buske, Sendrar, Bodler, Andrade, Vijon, Kejler, Seferis, Kavafis, Elitis, Li Bo, Du Fu, Jan Czjun, etj.

Mirënjohjet

“Medalja e Artë e Lidhjes së Prizrenit”, Kosovë;
“Prix Mondial Cino Del Duca”, Francë, 1992;
Çmimi “Bokaçio”, Itali, 1997;
“Commandeur de la Légion d’Honneur” (C.LH), Francë, 2016;
Çmimi “letërsia shqipe”, Kosovë, 2017;
Çmimi “Nonino”, 2018;
Çmimi i karrierës akademike, nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

ISTREF BEGOLLI (1933-2003)



Aktori Istref Begolli, u lind më 7 maj të vitit 1933 në Pejë dhe vdiq më 31 janar të vitit 2003 në Krapinske Toplice, në Kroaci.

Rrjedh nga një familje artistësh kosovarë të mirënjohur, së cilës i takon edhe artisti i madh, aktori dhe profesori i aktrimit Faruk Begolli.

Istref Begolli, shumë i ri do të largohet nga Peja, si 15 vjeçar për ta marrë rrugën drejt theme-limit të Teatrit Krahinor në Prishtinë, ku edhe do të lulëzonte karriera e tij, si aktor i dërrasave të teatrit dhe roleve tragjike, i cili shkriu e stërshkriu role të mëdha edhe në skenat e teatrove prestigjioze të ish-Jugosllavisë.

Prej viteve '90-ta Istref Begolli nuk ka qenë i angazhuar në Teatrin Krahinor (aso kohe), ngase pushtuesit serb i morën të gjitha institucionet e kulturës, e morën edhe teatrin.

Istrefi në ndërkohë i ka realizuar disa drama televizive, natyrisht në rrethana të vështira.

Istref Begolli, në pjesën e dytë të vitit 1974 njoftohet me Hadije Malokun nga Prizreni, me të cilën martohet me 28 dhjetor 1974. Në shtator të vitit 1975 vjen në jetë Alba. Çifti, në kohën kur u njoftuan ishin në ndërtim të karrierës së tyre. Hadije Maloku-Begolli ka qenë gjykatësja e parë femër në Kosovë, Kryetare e Grave të Kosovës, e deri në pensionimin e saj në cilësi të Avokates Krahinore të Kosovës, në janar të vitit 1990. Që të dy ishin personalitete me botëkuptime përparimtare dhe vizionare, ishin dy intelektualë të shquar.

Pas luftës, në pjesën e dytë të vitit 1999 dhe në fillim të vitit 2000 ka dhënë rolin e Atit në filmin “Vjeshta e Trëndafilave” shkruar nga V. Karahoda - në regji të Agim Sopit, e që ishte roli i tij i fundit.

Istref Begolli e vazhdon jetën e tij të mbushur me role kolosale në teatro dhe filma për 50 vite të plota karriere. Ai ka qenë dhe vazhdon të jetë tragjedianti më i madh i Teatrit Shqiptar.

Rolet e realizuara:

“Makbethi”, Jagua tek “Othello” të Sheksipirit,
Prifti në “Gjeneralin e Ushtrisë së Vdekur” të Ismail Kadarese,
Në “Bregun e Pikëllimit” të Teki Dervishit,
Në “Dervishi dhe Vdekja” të Mesha Selimoviçit,
Të Atit në “Vjeshtën e Trëndafilave”,

Në “Përroin Vërshues”, film në regji të Besim Sahatçiut, pastaj në dramën televizive: “Oda e Junikut” në regji të Adem Mikullovcit, “Kulla” e Anton Pashkut, “Vallja e Çmendur” e Rexhep Qosjes, etj,

Role këto të realizuara mjeshtërisht që i kanë dhënë Istref Begollit vendin e tij të merituar në hartën dhe pasaportën e kulturës të artit shqiptar.

Në librin e lëndës të historisë në shkollat fillore, në një pjesë ku mësohet për artin dhe kulturën është përfshirë vepra e aktorit Istref Begolli. Teatri Profesionist i qytetit të tij të lindjes, në Pejë, mban emrin e aktorit të madh “Istref Begolli”.

Istref Begolli ishte një nga aktorët më të spikatur shqiptarë të gjitha kohërave, një figurë me plot prezencë dhe karizmë në çdo hapësirë ku depërtonte dhe realizonte role.

Istrefi ka qenë tragjediani më i madh i Teatrit Shqiptar. Mbi të gjitha njihej edhe për tremën e tij famoze para secilës premierë që kishte. Ka qenë perfeksionist i madh në punë dhe në jetë, në përgjithësi.

Filmografia

- “Vjeshta e Trëndafilave“, (1999/2000)
- “Migjeni“, (1990) (TV)
- “Opasni trag“, (1984)
- “Përroi vërshues“, (1981)
- “E tërë jeta për një ditë“, (1980) (TV)
- “Kur pranvera vonohet“, (1980) (mini) TV Seri
- “Era e Lisi“, (1979) (mini) TV Seri
- “Epoka para gjyqit“, (1978) (TV)
- “Pasqyra“, (1977) (TV)
- “Crveni udar“, (1974)
- “Bombasi“, (1973)
- “Hleb“, (1973) (TV)
- “Si të vdiset“, (1972)
- “Të ngjuarit“, (1971) (TV)
- “Lelejska gora“, (1968)
- “Brat doktora Homera“, (1968)
- “Do pobjede i dalje“, (1966)
- “Nevesinjska puska“, (1963)
- “Solunski atentatori“, (1961)
- “Kapetan Leshi“, (1960) etj.

ISUF BAJRAMI



Isuf Bajrami është i lindur në fshatin Velekincë në Komunën e Gjilanit, më 8.06.1963.

Shkollën fillore, tri vite, i kreu në vendlindje dhe atë tetëvjeçare dhe të mesmen në Gjilan, kurse studimet në Universitetin e Prishtinës.

Nga viti 1994 deri më 1996 ishte anëtar i "Union of Independent Journalists of Kosova". Në Qendrën Rajonale për Studime Politike dhe Diplomatike pranë Akademisë Diplomatike të Shqipërisë, më 2006, e mbaroi dhe e mbrojti temën "Epiri dhe përkatësia etnike e epirotëve".

Veprat letrare:

1. "Fushë e Trimërive", përmbledhje poezish, 1995
2. "Eklipsi", përmbledhje poezish, 1997
3. "Një ditë më shumë në jetë, një ditë më afër vdekjes", prozë, 1997.

Me veprat e deritashme, Isuf Bajrami, ka krijuar një individualitet në krijimtari me stilin e tij origjinal që e përdor.

Është përfshirë në panoramën e krijuesve letrarë të Kosovës Juglindore "Psherëtimë për tokën" të Hysen Kqikut. Në "Leksikonin e shkrimtarëve shqiptarë 1501-2004" të Hasan Hasanit, etj.

Aktualisht është gazetar i pavarur dhe anëtar i Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK), si dhe anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve Shqiptaro-Amerikane në New York, Tiranë, Prishtinë dhe Shkup.

Akademik Isuf B. Bajrami, përveç gazetar është edhe politikolog.

Studime dhe shkrime të publikuara:

“Ku janë trojet shqiptare“

“Epiri dhe përkatësia etnike e epirotëve“

“Shpërngulja e popullit shqiptar nga Çamëria si myslimanë të Turqisë“

“Greqia te çështja çame, shkel Konventat!“

“Çështja çame duhet zgjidhur drejt“ !

“Terrorizmi qendrën e ka në Moskvë-Athinë-Beograd“

“Serbia e madhe, faktor destabilizues në Ballkan“

“Kosova sot nën lupën intelektuale“

“Aktakuzë kundër serbosllavisë“

“E vërteta për Kosovën“

“Ku shtrihen trojet shqiptare“

“Marrëveshja e Konçullit“, etj.

ISUF DEDUSHAJ



Akademik Isuf Dedushaj, u lind në fshatin Vuthaj, më 10 tetor të vitit 1951. Shkollën fillore e mbaroi në Vuthaj dhe Guci. Gjimnazin e kreu në Pejë, kurse Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, në mars të vitit 1976.

Fillimisht punoi në Shtëpinë e Shëndetit në Drenas, ish Glllogovci.

Në vitin 1976 punësohet në Entin Krahinor për Mbrojtje Shëndetësore, ku zgjidhet bashkëpunëtor për lëndën Mjekësi Sociale. Përfundon specializimin nga epidemiologjia më 20 maj 1980 dhe njëherit është epidemiologu i parë shqiptar i Kosovës.

Studimet pasuniversitare i mbaroi në Fakultetin e Mjekësisë në Sarajevë, ku edhe u magjistruar në nëntor të vitit 1983.

Prof. Dr. Isuf Dedushaj, më 27 nëntor, të vitit 1986, në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë, mbrojti tezën e doktoratës.

Zgjidhet ligjërues në vitin 1983. Gjatë vitit 1986/1987 përfundon subspecializimin nga imunologjia pranë Universitetit të Zagrebit-Kroaci. Punoi në Entin për Mbrojtjen Shëndetësore të Kosovës, prej vitit 1976-1990. Në vitin 1990 për shkaqe politike largohet nga puna.

Si mësimdhënës në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë prej vitit 1976 ka arritur gradën prof. ordinar i epidemiologjisë, pra Prof. Dr. Ph. D. i shkencave të mjekësisë - epidemiolog.

Në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë ka qenë edhe prodekan në dy mandate, prej vitit 1992-1996. Gjithashtu prej tetorit të vitit 1992 e deri në vitin 2001 ka qenë kryetar i Kryqit të Kuq të Kosovës.

Prof. Dr. Isuf (Isuf) Dedushaj ka qenë anëtar i Kryesisë së Forumit të Intelektualëve të Kosovës-përgjegjës për sektorin e Shëndetësisë.

Ka qenë dhe është anëtar i Redaksisë së Revistës Shkencore “Praxis Medica” të Kosovës.

Prof. Dedushaj ka qenë mentor, por edhe anëtar në Komision për mbrojtjen e temave të doktoratës të më se 45 kandidatëve, prej të cilave disa jashtë Kosove, pastaj 55 magjistraturave shkencore dhe mbi 150 mjekë i ka udhëhequr në specializime të lëndëve preventive (epidemiologji, higjienë, mjekësi sociale, mjekësi e punës dhe mjekësi e përgjithshme). Ka publikuar 120 punimeve shkencore në Kosovë dhe jashtë. Ka qenë redaktor përgjegjës i revistës “Shëndeti”, për dhjetë vjet me radhë.

Ka qenë drejtor i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, kryetar i Asociacionit të Shëndetësisë Publike të Kosovës, si dhe Dekan i fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Ka publikuar disa tekste universitare (Epidemiologjia Speciale e sëmundjeve ngjitëse, Epidemiologjia, Imunoprofilaksa, etj).

Më 17 tetor 2019 doli nga shtypi libri enciklopedik i autorit Prof. Dr. Isuf Dedushaj “Enciklopedi e doktorëve të shkencës të mjekësisë shqiptare gjithandej globit”.

Profesori Dedushaj ka publikuar një numër të madh të punimeve shkencore si autor dhe koautor.

Punime shkencore:

- Ularemia outbreak investigation in Kosovo: case control and environmental studies,
- R. Reintjes, I. Dedushaj, A. Gjini, TR Jorgensen, B. Cotter, A. Lieftucht, *Emerging infectious diseases* 8 (1), 69, 2002,
- Interacting roles of immune mechanisms and viral load in the pathogenesis of Crimean-Congo hemorrhagic fever A Saksida, D. Duh, B. Wraber, I. Dedushaj, S. Ahmeti, T. Avšič-Županc *Clin. Vaccine Immunol.* 17 (7), 1086-1093, 2010,
- Prevalence of nosocomial infections in high-risk units in the university clinical center of Kosova L. Raka, D. Zoutman, G. Mulliqi, S. Krasniqi, I. Dedushaj, N. Raka, S. Ahmeti,
- Infection Control & Hospital Epidemiology* 27 (4), 421-423, 2006.
- Epidemiological, serological and herd immunity of Crimean-Congo haemorrhagic fever in Kosovo I. Humolli, I. Dedushaj, TA Županac, S. Muçaj *Med Arh* 64 (2), 91-3, 2010,
- Prevalence of Crimean-Congo hemorrhagic fever virus in healthy population, livestock and ticks in Kosovo L. Fajs, I. Humolli, A. Saksida, N. Knap, M. Jelovšek, M. Korva, I. Dedushaj, *PLoS One* 9 (11), e 110982, 2014,
- Current situation of Crimean-Congo hemorrhagic fever in Southeastern Europe and neighboring countries: a public health risk for the European Union?
- S. Dreshaj, S. Ahmeti, N. Ramadani, G. Dreshaj, I. Humolli, I. Dedushaj *Travel medicine and infectious disease* 14 (2), 81-91, 2016. Etj.

IBUSH REÇICA



Ibush Reçica u lind më 10.1.1953 në fshatin Llugaxhi të Lipjanit. Shkollën fillore e filloi në vendlindje, e vazhdoi në Banullë dhe kreu në Kastriot, SHMT degën e Elektroteknikës, si dhe Fakultetin Teknik degën e Elektroteknikës-Energjetikës e kreu në Prishtinë më 1977. Si student i dalluar merr bursën e Universitetit. Studimet pas-universitare i kreu më 1982 në Zagreb, ku edhe magjistroi.

Fillimisht punoi në QSHT në Kastriot, ku ligjëroi lëndën Matjet elektrike, në vitin shkollor 1975/76. Gjatë viteve 1976/77, 1977/78 punoi në SHMT “28 Nëntori” në Prishtinë, ku ligjëroi lëndët: Teknologji e Materialeve Elektrike, Ndriçime Elektrike, Pajisjet Elektrike të Automjeteve, Instalimet Elektrike, Rrjetat Elektrike, Largpërçuesit Elektrikë, Mirëmbajtja e Instalimeve.

Ka qenë i angazhuar në grupin e ekspertëve për hartimin e planeve dhe programeve mësimore për shkollat e mesme profesionale. Pastaj ka punuar në KEK “Ferronikël” si organ mbikëqyrës, në Bashkësinë e Sigurimeve “Kosova”, si udhëheqës i Sektorit për Vlerësimin e Dëmeve në Ekonomi. Nga viti 1981 gjer më 1989 punoi në IMN “Kosova” në Prishtinë, si drejtor teknik. Nga viti 1989 gjer në largimin e punëtorëve nga regjimi serb punoi në NSH “Konsulting”, si projektant e organ mbikëqyrës.

Gjatë kohës së okupimit ai ndihmoi për zhvillimin e arsimit shqip që zhvillohej në Prishtinë. Ishte gjithnjë i gatshëm për t’u ndihmuar në mënyrë financiare. Më 1991 themelon Ndërmarrjen Private NSHTP “ELTRISI” në Prishtinë, e cila edhe sot punon e vepron në Kosovë.

U mor me projekte, ku i punoi 300 sish në fushën e instalimeve e ndriçimeve elektrike, elektroenergjetikës dhe automatikës për objekte të ndryshme. Ka zbatuar punë dhe udhëheq në mbi 80 objekte të ndryshme.

Librat e botuara:

- “1012 fjalë të urta të përzgjedhura”, 2008,
- “Personaliteti ynë” (2015),
- “Mendime mbi veçoritë dhe botën njerëzore”, 2018.
- “1012 fjalë të urta të përzgjedhura” është ribotuar në vitin 2012,
- ”Mendime mbi veçoritë dhe botën njerëzore” i është përkthyer në gjuhën angleze nga Prof. Avni Spahiu.

Ibush Reçica ka të përgatitura edhe libra tjera të gatshme për botim...

IZET SADIKU



Dr. Izet Sadiku u lind më 10. 08. 1968 në Hajvali, Prishtinë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen dhe Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Ka kryer studimet pasdiplomike të magistraturës në fushën e sëmundjeve ngjitëse në Universitetin e Prishtinës, në vitin 2009, ndërsa studimet e doktoraturës i ka kryer në Universitetin Mjekësisë në Tiranë me temë: "Karakteristikat epidemiologjike, klinike, diagnostike dhe trajtimi i Tularemisë në Kosovë 2006-2011", nga fusha e sëmundjeve ngjitëse në vitin 2013. Izet Sadiku është specialist i infektologjisë dhe punon në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, ku nga viti 2015 e udhëheq repartin e fëmijëve për sëmundjet e Sistemit Nervor Qendror dhe Sistemit Respirator. Është Profesor i rregullt në Kolegjin AAB, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore dhe asistent në Fakultetin e Mjekësisë, Katedrën e Sëmundjeve Infektive, që nga viti 2009-2019.

Deri me tani ka kryer këto detyra të rëndësishme politike, shoqërore dhe akademike: Sekretar i Shoqatës së Infektologëve të Kosovës, 2007. Anëtarë i bordit të KUSA. Shef i ekipit për parandalim të infeksioneve brenda spitalore, Koordinator i Zyrës për HIV/AIDS, Zëvendësministër i Shëndetësisë 2015-2017.

Izet Sadiku ishte pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Zonën Operative të Llapit 1998-1999 dhe veteran i UÇK-së. I burgosur; Maj-Nëntor 1999.

Ka të publikuara mjaft punime shkencore në konferenca dhe revista të ndryshme shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare:

1. Izet Sadiku, Muharrem Bajrami, Arian Harxhi, Albina Ponosheci, Ajete Aliu: "Characteristics of Tularemia in Kosovo during the period 2006-2011", 2013,

2. Sadiku I., Bajrami M., Ponosheci A. "Characteristics of Tularemia in Kosovo 2010 "Iliria International Review", f. 251 publications.uiliria, 2011/12, Prishtina, 2011,

3. Sadiku I., Harxhi A., Bajrami M., Ponosheci A., Ejupi-Doda T., Emini M., "Karakteristikat epidemiologjike, klinike, dignostik edhe trajtimi i Tularemis Familajre në Kosovë 2010-2011". "MEDICUS", Dhjetor, 2011,

4. Sadiku I., "Clinical characteristics and ethiological of viral meningitis in

ISUF KRASNIQI



Prof. Dr. Isuf Krasniqi, u lind më 1948 në Prapaçan të Deçanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, shkollën e mesme, gjimnazin, në Pejë, ndërsa Fakultetin Teknik, dega e Elektroteknikës, në Universitetin e Prishtinës më 1972.

Studimet pasuniversitare, i kreu në Fakultetin e Elektroteknikës në Universitetin e Zagrebit, më 1978. Disertacionin e doktoratës e mbrojti më 1987, në Universitetin e Prishtinës.

Më 1974 zgjidhet asistent në Fakultetin Teknik dega e Elektroteknikës. Ligjërues u zgjodh më 1978 për lëndët: Teknika e tensioneve të larta dhe Teknologjia e materialeve elektroteknike. Docent u zgjodh më 1987, profesor inordinar më 1993, ndërsa profesor ordinar më 1998. Ishte dekan i Fakultetit të Elektroteknikës në periudhën 1988-1994, ndërsa më 1997/99 ishte kryetar i Këshillit Qendror të Arsimit në Kosovë. Në vitin 1976 qëndron për specializim në Qendrën kërkimore-shkencore IRC, në Sarajevë. Më 1978 ka qëndruar për një specializim në Universitetin Shtetëror të Tiranës.

Më 1985, modelon, konstrukton dhe patenton motorin elektrostatik. Në ekspozitën: “13 Jugoslovenska izložba izuma, tehničkih unapredjenja i noviteta” të mbajtur në Rijekë të Kroacisë, më 1985, merr Pllaketën e artë për inovacionin e motorit kurorë.

Ka publikuar shumë punime shkencore nga elektrostatika dhe elektroenergjetika në revista të njohura shkencore në vend dhe në botën e jashtme si në SHBA, Shqipëri, Poloni, Spanjë, Slloveni, Kroaci, Serbi, Qipro, Malejzi, Rumani, etj.

Ka botuar dy libra universitarë, si dhe libra për shkolla të mesme teknike nga lëmi i teknologjisë së materialeve.

Universiteti i Prishtinës i ndau Mirënjohje në vitin 2000, ndërsa komuna e Deçanit ia dha Çmimin “Jusuf Gërvalla”, në vitin 2009.

Është autor dhe koautor i shumë projekteve zhvillimore strategjike dhe shkencore. Ka qenë shef i Departamentit të SEE në FIEK, 2005-2012; anëtar i Komisionit për studime të Doktoratës, 2009 dhe anëtar i Këshillit Kombëtar të Shkencës, 2009-2011.


Në vitin 2008 është zgjedhur anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ndërsa në dhjetor të vitit 2012, anëtar i rregullt. Që nga viti 2012 është Sekretar i përgjithshëm i ASHAK-ut.

Punime shkencore:

- I. F. Krasniqi, Prenos najvišim naponom, Elektrotehnički Fakultet, Zagreb, 1976;
- I. F. Krasniqi, Uticaj korona na prenos radio i TV signala, Elektrotehnički Fakultet Zagreb, 1976;
- I. F. Krasniqi, One?is?enje izolatora na elektroenergetskim postrojenjima, Magistarski rad, Elektrotehnički Fakultet, Zagreb, 1978;
- I. Krasniqi, Klasčini i radioaktivni gromobran, Opatija, Kroaci, 1979;
- I. F. Krasniqi, Efekti i ndotjes industriale në SEE të TC Kosova B, simpoziumi JUREM 1980;
- I. F. Krasniqi, A. Abazi, S. Limari, Efekti i ndotjes industriale në punën e stabilimenteve të TC Kosova A, Revista KXMK Kosova, 1985;
- I. F. Krasniqi, G. Latifi, Lëshuesit e mbitensioneve ZnO, Buletini i Fakultetit të Elektroteknikës, 1985, Prishtinë;
- I. F. Krasniqi, Electrostatic Corona motor, Third International Conference on electrostatics, Cracou, Poland, 1985;
- I. F. Krasniqi, Motori elektrostatik-Kurorë, punim i doktoratës, Prishtinë, 1987;
- I. F. Krasniqi, A. Abazi, Ndikimi i këndit të elektrodave në vlerat e parametrave hyrëse të motorit Kurorë, Simpozium ndërkombëtar për geoelektricitet dhe rrufepritës, Nish, 1988;
- I. F. Krasniqi, A. Abazi, The influence bent Electrode Angle on the input and output of PVC electrostatics Corona Motor, Fourth Internati. Conference on Electrostatics, Wroclaw-Szklarska Poreba, Poland, 1990;
- I. F. Krasniqi, Një vështrim i posaçëm për kurorën si fenomen i tensioneve të larta, Revista Dardania Sacra, nr. 4, Prishtinë, 2002;
- I. F. Krasniqi, G. Kabashi, Mbrojtja e linjave të tensionit të lartë me shkarkues të mbitensionit ZnO, Revista Kërkime, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë, 2007;
- I. F. Krasniqi, V. Rexhepi, Mbrojtja transformatorëve 400kV me shkarkues të mbitensionit ZnO, Revista Kërkime, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë, 2008;
- I. F. Krasniqi, A. Alidemaj, Efficiency of electrostatic precipitators at Kosova "B" BP, Second International Conference, Balkan Power, Shibenik, September, 2008;

Prof. Isuf Krasniqi ka botuar edhe 18 vepra të tjera, njëherit ka botuar edhe tekste shkollore, si dhe projekte shkencore.

IZET DURAKU



Izet Duraku, u lind më 16 maj 1956, në fshatin Morinë të Kukësit. Shkollën tetëvjeçare e kreu në vendlindje, të mesmen pedagogjike në qytetin e Kukësit, studimet e larta në Fakultetin Histori-Filologji të Universitetit të Tiranë, dega gjuhë-letërsi shqipe. Pas vitit 1990 është trajnuar për gazetari në GTZ, BBC, etj. Fillimet e gazetarisë së Izet Durakut i gjejmë në gazetën “Studenti”, ku punoi një kohë redaktor. Edhe gjatë viteve të punës në arsim në Kukës vazhdoi të shkruajë reportazhe, skica, portrete dhe përshkrime për gazetat “Zëri i rinisë dhe “Puna”. Në vitin 1985 emërohet korrespondent i së përditshmes “Bashkimi” për zonë Kukës-Tropojë, ku punoi deri në vitin 1992. Më pas, deri më 1997 ishte drejtor i Radio-Kukësit. Prej asaj kohe transferohet gazetar-redaktor në Radio-Tirana ku vazhdon të punojë prej më shumë se 8 vjetësh. Tash është drejtor përgjegjës i Revistës letrare e Tiranës “Ilz”. Lëvron të gjitha zhanret e gazetarisë e të publicistikës, është autor i disa librave dhe shumë punimeve publicistike:

Veprat:

1. “Drini i Bardhë”
2. “Pragu”
3. “Vezullim heshtash”
4. “Agim Spahiu, metafora e lirisë së munguar”
5. “Libri i udhëtarit”
6. “Libri i udhtarit”
7. “Ana tjetër e malit”
8. “Veprat e artit në kërkim”.

Punime publicistike:

1. “Rreth kufijve dhe semantikës së baladës”. (Baladat e Lumës, Hasit, Malziut dhe Fanit, një kontribut i shtuar për kulturën kombëtare)
2. “Lufta midis komunistëve e nacionalistëve kurseu shumë gjak ushtari gjerman në Shqipëri”
3. “Ta kujtojmë me shpirt të pastër Havzi Nelën”
4. “Lahutarët e Sanxhakut të Pazarit të Ri”
5. “Muzetë dhe galeritë publike nuk kanë rivlerësuar veprat, rrezikohet trafikimi dhe humbja e tyre”
6. “Puthje mbi Bosfor”, një hyrje në detin e poezisë turke, etj.

JAHJA DRANÇOLLI



Prof. Dr. Jahja Drançolli, u lind në Pejë, më 10 tetor 1946. Studimet për Histori i mbaroi në Prishtinë më 1971. Ka magjistruar në Zarë dhe doktoruar në Prishtinë më 1981, respektivisht më 1984. Gjatë viteve 1984-1990 ka bërë kërkime shkencore medievalistike dhe të paleografisë e epigrafisë, në arkiva, biblioteka dhe muzeume, të Ankonës, Dubrovnikut, Kotorrit, Padovës, Romës, Venedikut, Zagrebit, Zarës, etj.

Gjatë vitit 2003 u emërua drejtor i Institutit Arkeologjik në Prishtinë, institut këtë të cilin e udhëhoqi deri në vitin 2009.

Jahja Drançolli, në cilësinë e udhëheqësit dhe drejtorit të Institutit Arkeologjik të Kosovës, ka zbuluar mbetjet e kështjellës së Harilaqi, e cila daton nga shekujt IV-VI pas/Kr.

Gjatë vitit akademik 2003/2004, ka qenë bartës i projektit “History of Religions”, të financuar nga CEU-Budapest. Ndërkaq, gjatë viteve akademike, 2000 deri në 2005, ka qenë bartës i një sërë projekteve nga lëmi i historisë dhe trashëgimisë kulturore.

Është autor i shumë monografive shkencore, dhe më së 100 studimeve shkencore të botuara në Kosovë, Shqipëri, Kroaci, Itali, Gjermani, Turqi, etj. Prof. Dr. Jahja Drançolli njëkohësisht është kontribuesi i vetëm shqiptar në Encyclopedia of Global Archaeology (Claire Smith, ed, Springer, 2014) me studimin "Kosova: Archeological Heritage".

Botime - monografi:

1. “Gjin Gazulli-astronom dhe diplomat i shek. XV”, Prishtinë, Rilindja, 1984
2. “Raguzanët në Kosovë prej fundit të shek. XIII deri në vitin 1455”, Prishtinë, 1986
3. “Albanci v srednjem veku, in Albanci” (J. Drançolli et al.), v Ljubljani
4. “Kosovo und sein kultureller Reichtum, in: Albanien, Zwischen Kreuz und Halbmon”, (Jahja Drançolli et al.), München, 1998
5. “Shteti Mesjetar i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”, Pejë, 2001
6. “Histori e Religjioneve Komparative”, WUS Austria-Prishtinë, 2005 (tekst universitar, co-autor Denis Janz, Ph.D., Loyola University New Orleans, Provost Distinguished Professor of Religious Studies)
7. “Histori e Shkencës”, WUS Austria-Prishtinë, 2003 (tekst universitar).

8. “Monumentet e kultit katolik gjatë mesjetës në Kosovë”, 2005;
Simpoziumin Ndërkombëtar Krishterimi ndër shqiptarë, mbajtur në
Tiranë, 1999, Shkodër, 2000
9. Kosova Archaeologica, Kosova Arkeologjike 1, Editor, Prishtinë, 2007
10. “Historiografia dhe teoritë historike të shekujve XIX-XX”, WUS
Austria-Prishtinë 2008
11. “Arbërit ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes gjatë Mesjetës”,
Zagreb, 2008.

Punime shkencore:

1. “Marrëdhëniet e Durrësit me Raguzën prej shek. XI deri më 1501”, in:
Gjurmime Albanologjike (ser. e shk. Historike), Prishtinë, 1982/12;
Studime për Epokën e Skënderbeut, Tiranë 1989/3
2. “Vështrim për Kosovën gjatë feudalizmit të zhvilluar”, in: Prishtinë
1983/12
3. “Raguzanët në Prishtinë gjatë shekujve XIV-XV”, in: Vjetar i Arkivit,
Prishtinë, 1984
4. “Tregtarët e njohur të Kosovës prej fundit të shek. XIII deri në vitin
1455”, in: Buletin i Muzeut të Kosovës, Prishtinë, 1984/XIII-XIV
5. “Lidhjet e bujarëve raguzanë me Durrësin gjatë shekujve XIII-XV”,
Prishtinë, 1984/VIII
6. “Presence des Albanais e Raguse entre le XIIIe et le XVe siecle”, in:
Recherches Albanologiques, 1987/4
7. “Les rapports des nobles de Raguse avec Durrës au course des XIII-
XIV”, Tiranë, 1987/3
8. “Rrugët e Kosovës gjatë Mesjetës: Vjetar i Arkivit të Kosovës”,
Prishtinë, 1987/XXIII;
9. “Diaspora shqiptare në Greqi gjatë shek. XIV”, in: Tiranë, 1987/3
10. “Disa aspekte të mjekësisë ilire”, in: Gjurmime Albanologjike (ser.
folklor e etnologji), Prishtinë, 1988/18.

Përveç monografive dhe punimeve shkencore, që u përmendën më sipër,
Prof. dr. J. Drançollin e ndeshim edhe në referencat e studimeve historike
ndërkombëtare.

Ai botoi gjithashtu edhe shumë kritika e recensione, si dhe më tepër
se 100 punime profesionale-shkencore në gazeta e revista të vendit dhe
botës, si në revista e gazeta: Zëri, Fjala Jeta e Re, Gjurmime Albanologjike,
Vjetarin Arkivor, Ekskluzive, Drita, Rilindja, Koha ditore, Illyria, Rilindja
demokratike, Shkëndija, Bujku, FloriPress, Pavarësia, Lajm, Express, etj.

JAHJA LLUKA



Akademik Prof. Mr. sc. Jahja Mustafë Lluka, u lind në Pejë, më 17.03.1952, ku e kreu shkollën fillore dhe të mesme, ndërsa studimet e larta të Elektroteknikës i vijoi në Zagreb.

Pas kthimit nga Zagrebi, studioi në Shkollën e Lartë Komerciale në Pejë. Është magjistër i marrëdhënieve ndërkombëtare.

Në vitin 1989 filloi aktivisht të merret me angazhimet kundër ndryshimeve kushtetuese të Kosovës. Më 1990, pas protestave të shumta në qytetin e Pejës, themeloi së bashku më shumë shokë "Shoqatën për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur nga Trojet e Veta", ndërsa në Kuvendin e Parë të Shoqatës u zgjodh kryetar.

Me largimin me dhunë të punëtorëve shqiptar nga puna, nga ana e ish regjimit të dhunshëm serbo-sllav, u paraqit nevoja për krijimin e një subjekti, i cili do të ndihmonte shumë familje në nevojë, që vuanin për kafshatën e gojës.

Jahja Lluka, bashkë më shumë veprimtarë të tjerë pejanë, themeloi "Këshillin e Solidaritetit", këshill ky që i ndihmoi minatorët e "Trepçës", të "Goleshit", të "Kishnicës", të "Fabrikës së Municionit" në Skenderaj, si dhe grumbulluan dhe dhanë pagat e para për arsimtarët shqiptar të komunës së Pejës.

Në vitin 1995 u burgos nga regjimi serb, pas organizimit me shumë shokë të përpjekjeve për armatosjen e shqiptarëve të Kosovës për t'u vetëmbrojtur nga hordhitë fashiste serbe. Burgun e vuajti në Dubravë, Lipjan, Pejë, Pozharevc, etj.

Është shkrimtar si dhe publicist letrar. Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës.

Veprat e botuara:

1. "Edhe ti Atdhe"
2. "Vargje vetmie"
3. "Mos eja në ëndërr"
4. "Në kalanë e zemrës sime"
5. "Shpërngulja e shqiptarëve nga Peja dhe rrethina", 1912/1994
6. "Për shtetin tim, Kosovën"
7. "Kosovo from "Naçertanie" to independence" 1844-2008
8. "Përmbledhje shkrimesh". etj.

JAKOV XOXA (1923-1979)



Jakov Xoxa u lind në Fierit, më 15 prill 1923. Vitet e para të shkollimit i ndoqi në qytetin e lindjes, për t'i vazhduar më pas në Vlorë, Kavajë, Korçë; qytete ku shkonte për të punuar i ati i tij, Thanasi. Shkollimin e mesëm e vazhdoi në qytetin e Elbasanit, por e ndërpreu gjatë pushtimit italo-gjerman dhe e përfundoi në Tiranë, pas çlirimit të vendit.

Që i ri mori pjesë në Luftën e Dytë Botërore, fillimisht si gueril në qytetin e lindjes dhe më pas në mal, si partizan.

Pas Çlirimit të vendit vazhdoi studimet e larta për filologji dhe njëkohësisht bëri hapat e para në poezi dhe në prozë. Më 1949 botoi veprën e parë në prozë “*Novela*”. Krijimtarinë letrare në këtë zhanër e vazhdoi dhe gjatë viteve '50, kështu në vitin 1958 botoi veprën e dytë, po me atë titull “*Novela*”. Ndërkohë botoi dhe dy drama “*Buçet Osumi*” dhe “*Zemra*”.

Që nga viti 1957 punoi profesor në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë në Universitetin e Tiranës, ku për shumë vite ligjëroi lëndën *Teoria e letërsisë*. Për nevojat e studentëve, në formën e dispensës, hartoi vepra teorike të domosdoshme për kohën si *Hyrje në letërsi*, *Teoria e letërsisë* dhe *Metrika*. Ndërkohë punoi edhe për një vepër të plotë teoriko-letrare, *Bazat e teorisë së letërsisë*, që ishte nga veprat më serioze të kohës (si degë e shkencës mbi letërsinë). Kjo vepër u botua po ashtu në formë dispense më 1972. Ndonëse në të autori ofronte dije dhe përvojë teorike letrare të gjerë, që dilte jashtë kornizave të teorive zyrtare të kohës, kjo vepër e rëndësishme për shkencën letrare shqiptare pati kritika të skajshme dhe autori, pa bujë dhe zhurmë, ashtu siç ishte gjatë tërë jetës, i qetë dhe i mbyllur në vete, u tërhoq në vetmi.

Gjithsesi, vepra në fjalë pati edhe përkrahës të shumtë, sidomos në radhët e studiuesve, pedagogëve dhe studentëve të letërsisë, dhe, po brenda atij viti, një pjesë e konsiderueshme e saj u ribotua, e ripunuar dhe e zgjeruar, bashkë me dy autorë të tjerë (N. Lezha, P. Kraja), në katër vëllime, me të njëjtin titull: “*Bazat e teorisë së letërsisë*”

Pjesën më të madhe të jetës krijuese Jakov Xoxa e kaloi në Pojan, një fshat myzeqar afër Fierit, ku, krijoi romanet “*Lumi i vdekur*” 1965 dhe “*Juga e bardhë*” 1971, ndërsa romanin “*Lulja e kripës*” 1978 e shkroi gjatë viteve të qëndrimit në Ballsh, ku po ndiqte nga afër ndërtimin e Uzinës së

Pasurimit të Naftës, e cila do të ishte në epiqendër të romanit të ardhshëm “*Ari i Zi*”. Tre romanet e përfunduara dhe të botuara, bëjnë pjesë në rrethin e romaneve artistikisht më cilësorë të letërsisë shqiptare.

Në Shqipëri, pas lufte, qe gazetar dhe shkrimtar. Vepra e tij më e famshme është romani “Lumi i vdekur”, botuar më 1964 në Tiranë, për të cilin mori çmimin e Republikës së Shkallës së Parë, dhe vepra u brohorit nga kritika shqiptare, si një kryevepër e narratives socialiste.

Asnjë roman para tij nuk e pasqyron në mënyrë aq komplekse botën shqiptare në prag të Luftës së Dytë Botërore, si “*Lumi i vdekur*”, periudhën gjatë luftës, si romani “*Lulja e kripës*”, apo edhe periudhën e kolektivizimit të bujqësisë (vitet ‘60) si “*Juga e Bardhë*”.

Në këto vepra gjejmë një shtrirje të pakufishme të rrëfimit që mbulon plotësisht hapësirën e jetës dhe të ekzistencës së mjedisit shqiptar.

Jakov Xoxa është nga romancierët më në zë të gjysmës së shekullit 20. Në krijimtarinë e tij letrare ai individualizohet me parimin krijues-realist: fati individual do të jetë ai që do të hedhë dritë mbi kontestin tërësor të mjedisit dhe të kohës së fokusuar në rrëfime.

Shëmbëllyeshëm me romanet e shquara realiste, Jakov Xoxa do ta vendosë dramën jetësore të personazheve dhe të familjeve në sfond të një kolektiviteti, të një gjendjeje, apo të një rrjedhe historike.

Asnjë shkrimtar shqiptar, para dhe pas Xoxës, nuk ka arritur të futet aq thellë në shpirtin e njeriut, në psikologjinë, karakterin e mentalitetin e tij, botën njerëzore gjatë shekujve të robërisë.

Parashenja më karakteristike e prozës së Jakov Xoxës është stili. Gjuha e tij vërehet dhe veçohet si e një individualiteti të fuqishëm dhe të papërsëritshëm në letërsinë shqiptare: nga njëra anë është e pranishme fryma e urtisë popullore me tërë thellësinë e shpirtit kolektiv; nga ana tjetër, kemi një rrëfim të rrjedhës së qetë, të shtrirë në gjerësi, por edhe në thellësi. Jakov Xoxa është i dekoruar me Urdhrin “Nderi I Kombit”.

Veprat e Jakov Xoxës:

"Novela", përmbledhje shkrimesh, 1949

"Buçet Osumi", dramë, 1956

"Zemra", dramë, 1958

"Novela", përmbledhje shkrimesh, 1958

"Lumi i vdekur", roman, 1964

"Juga e bardhë", roman, 1971

"Lulja e kripës", roman, 1980/1981.

JAKUP KRASNIQI



Prof. Dr. Jakup Krasniqi, u lind më 01 janar 1951 në Fatos (ish Negrovc) të Drenasit. Shkollën fillore dhe të mesme e kreu në vendlindje.

Studimet i mbaroi në Prishtinë, në Fakultetin Filozofik dega Histori. Më pas i kushtohet punës si pedagog dhe krahas saj fillon veprimtarinë politike në ilegalitet. Në vitet 1981 deri më 1991 burgoset për arsye politike nga pushtuesi serb.

Angazhohet aktivisht në ndërtimin e strukturave dhe zëdhënës i UÇK-së në kohën e luftës. Ishte anëtar i delegacionit shqiptar në Rambuje të Francës, ministër në qeverinë e parë të Kosovës. Pas zgjedhjeve të para në Kosovën e çliruar, ministër për shërbimet publike. Në zgjedhjet e lira, pas pushtimit, më 1992-1998, deputet në parlamentin e Kosovës. Më 9 janar 2008, Jakup Krasniqi zgjidhet kryetar i Parlamentit të Kosovës.

Veprat:

- 1."Kthesa e madhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës", Shtëpia Botuese "Buzuku", Prishtinë 2006;
- 2."Kosova i a historical context"; Shtëpia Botuese "Eeuropyntny", 2007;
- 3."Një luftë ndryshe për Kosovën"; botuar nga Shtëpia Botuese "Buzuku", Prishtinë, 2007;
- 4."Pavarësia si kompromis"; Shtëpia Botuese "Buzuku", Prishtinë, 2010;
- 5."Kosova në kontekst historik"; Botim i dytë i plotësuar, Shtëpia Botuese "Buzuku", Prishtinë 2010;
- 6."Lëvizja për Republikën e Kosovës 1981-1991 sipas shtypit shqiptar"; Shtëpia Botuese "Buzuku", Prishtinë 2011;
- 7."Guxo ta duash lirinë", Shtëpia Botuese: "Buzuku". Prishtinë, 2011;
- 8."Pranvera e lirisë '81", Shtëpia Botuese: "Buzuku". Prishtinë, 2011;
- 9."Flijimi për lirinë", Shtëpia Botuese: "Buzuku". Prishtinë, 2011.
- 10."Pavarësi dhe personalitete" (Në 100-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë), Shtëpia Botuese "Buzuku", Prishtinë, 2012.
- 11."Një histori e kontestuar" (Kritikë librit të Oliver Jens Schmitt: "Kosova - histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike"), Shtëpia Botuese "Buzuku", Prishtinë, 2013.
- 12."Zhurmuesit e demokracisë"; Shtëpia Botuese "Buzuku", 2016;
- 13."Reflektime demokratike"; Shtëpia Botuese "Buzuku", 2017;
- 14."Arti i bisedimeve"; Shtëpia Botuese "Buzuku", Prishtinë, 2018.

JASHAR REXHEPAGIQ (1920-2010)



Prof. Dr. Jashar Rexhepagiq, u lind në Plavë më 1929. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Beran dhe në Pejë. Grupin e lëndëve pedagogjike e studioi në Fakultetin Filozofik të Zagrebit, ku diplomoi më 1953. Gradën doktor shkence, e mori më 1965 në Fakultetin Filozofik të Zagrebit, ku mbrojti me sukses tezën “Zhvillimi i shkollave dhe i arsimit të shqiptarëve në territorin e Jugosllavisë deri në vitin 1918”.

Ushtri detyra të ndryshme në shkolla dhe në arsim: profesor i Shkollës Normale dhe Gjimnazit në Prizren, profesor e drejtor i Shkollës Normale të Prishtinës, këshilltar pedagogjik për shkolla të mesme i Pleqësisë së Arsimit të KAKM, ligjërues dhe profesor i Shkollës së Lartë Pedagogjike të Prishtinës, kurse nga viti 1962 ishte profesor i rregullt në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, ku veproi deri më 1990, kur u pensionua. Dy herë qe sekretar i Përgjithshëm i Akademisë dhe në dy mandate nënkryetar i ASHAK-ut.

Ka marrë pjesë në kongrese, simpoziume, tryeza të rrumbullakëta dhe në tubime të tjera shkencore e profesionale të pedagogëve në vend dhe jashtë. Në konferenca ndërkombëtare shkencore ka mbajtur referate ose kumtesa: në Pragë, Moskë, Jenë, Ankara, Mahaçkalla, Tiranë, Teheran (dy herë), Prishtinë, Sarajevë, Novi-Sad. Bashkëpunoi në afro njëzet revista e fletore pedagogjike e të tjera. Ka qenë redaktor i Buletinit të Fakultetit Filozofik të Prishtinës, redaktor i revistës shkencor Studime të Seksionit të Shkencave Shoqërore të ASHAK dhe redaktor i Vjetarit të ASHAK, anëtar i Këshillit redaktues të bibliotekës “Pedagogë bashkëkohor”, anëtar i Këshillit redaktues të Enciklopedisë pedagogjike I, II, kryetar i Këshillit botues të revistës shkencore Përparimi. Anëtar i redaksisë së rev. Studime të ASHAK-ut, revistës Edukata Islame, kryetar i Këshillit redaktues të Buletinit të Tutinit dhe anëtar i Këshillit botues të revistës “Univerzitetiska misao” të Universitetit të Novi-Pazarit.

Është marrë edhe me poezi (5 libra) dhe me kritikë shkencore e letrare. Është autor i mbi njëzet librave dhe i më se 360 punimeve shkencore e profesionale. Gjatë hulumtimit botoi disa vepra monografike, një numër të konsiderueshëm të studimeve, disa tekste shkollore.

Është laureat, pos të tjerash, i Shpërblimit të Dhjetorit të KSA të Kosovës për punë shkencore dhe për rezultate në pedagogji (1972).

Është bartës i Urdhrit të Punës me Kurorë të Artë (1980) dhe i Urdhrit të Republikës me Kurorë të Argjendtë (1988). Vdiq në vitin 2010.

Libra të botuar:

- ”Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë deri në vitin 1918”, Prishtinë;
- “Tema të zgjedhura pedagogjike, Shkup”, Nova Makedonija, 1972;
- “Hyrje në metodologjinë e punës hulumtuese-shkencore”, dispencë, Prishtinë, 1972;
- “Školstvo i prosveta na Kosovu do kraja XVIII stoleča do 1918 godine”, Priština, 1974;
- “Hyrje në metodologjinë e punës shkencore-hulumtuese Prishtinës”, 1975
- “Dituri shoqërie”, për klasën V të shkollës fillore, (koautor V. Nedoviq), Prishtinë, 1976;
- “Pedagoška misao Svetozara Markovič”, Beograd, 1979;
- “Mendimi pedagogjik i Svetozar Markoviçit”, Prishtinë, 1985;
- “Ruka na ruci”, (poezija), Pljevlja, 1985;
- “Od gradjanske do marksističko-lenjinističke pedagogije, Posebna izdanja ANUK, Odeljenje društvenih nauka”, knj. 5, Priština, 1986, str. 1-219;
- “Etika nastavnika danas”—Etika e arsimtarit sot, Prishtinë, 1989;
- “Sami Frashëri dhe pedagogjia e Rilindjes Kombëtare”, Prishtinë, ASHAK, 1995;
- “Islamsko-persijska kultura i uticaj persijskog jezika u nas”, Beograd, 1996, etj.

Studime dhe artikuj:

- Mbi disa çështje më të rëndësishme të edukatës shoqërore dhe morale, Përparimi, Prishtinë, 1955.
- Psikologjia dhe zhdukja e pasioneve negative, Përparimi, Prishtinë, 1956.
- Metodat dhe organizimi i edukimit për punë, Përparimi, 1957.
- Roli i vetive të subjektit në zgjedhjen e profesionit, Përparimi, 1957.
- Detyrat, përmbajtja dhe format e punës së inspektimit shkollorë, Përparimi, 1958.
- Povijest školstva i pedagogije u Hrvatskoj, Prosvetni pregled, 31.III 1959.
- Učiteljsku školu u Prištini pohadja 800 učenika, Prosvetni pregled.
- Metodika e studimit psikik të nxënësve, Prishtinë, 1960.
- Studime antologjike dhe pedagogjike për nder të prof. Dr. Aleksandër Xhuvanit, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë, 1986, etj.

JULIANA MEHMETI



Juljana Mehmeti u lind më 29 tetor 1973, në Durrës. Ka studiuar gjuhën frënge në Universitetin e Tiranës. Ka një sërë publikimesh në fushën e poezisë dhe përkthimeve. Është autore e prezantuar në gjuhën shqipe, gjuhën italiane dhe gjuhën angleze. Aktualisht krijon në gjuhën shqipe dhe gjuhën italiane.

Qysh në moshë të hershme u apasionua pas artit të shkruar, kryesisht poezisë, gjini që në vitet më pas do e shndërronte në lajtmotiv jete dhe mendësi për të shprehur idetë, vizionin dhe metafizikën, si këndvështrim përtej koherencës, por edhe si përsosje e tejkallim të vetë sugjestionit, që e rrethon botën njerëzore.

Juliana Mehmeti, tashmë është një zë mjaft i njohur në zhanrin e poezisë moderne shqiptare.

Krijimtaria e saj poetike është mjaft origjinale, e ngrohët dhe dominante, që zgjon mendime dhe krijon realitete unike në ndërgjegjen e lexuesit.

Juliana Mehmeti është poete mërgimtare, që ndriçon në gjerdanin e poezisë shqipe. Çdo vepër letrare që shkruan Juliana është një sfidë, emocion njerëzor.

Librit i parë “Soft Poesie“ është publikuar në italisht dhe tërhoqi vëmendjen e kritikës letrare italiane e botuesve, jo vetëm për stilistikën e veçantë, por dhe për gjetjet, gjuhën e përdorur, mesazhin filozofik dhe për më tepër të rrymave përshkuese nga ai hermetik deri në surrealizëm.

Libri i dytë vjen nga fusha e përkthimit me titull “Vramendje” (Rimugino) i autorit italian Alessandro Ferruccio Marcucci Pinoli, i cili do përbënte eksperiencën e parë në këtë drejtim, por do përforconte dhe idenë e saj të kahershme për njohjen dhe sjelljen në shqip të autorëve të njohur të letërsisë italiane.

Vepra letrare:

1. “Soft Poesie”, (poezi në gjuhën italiane), Itali, 2015
2. “Vramendje”, përkthime në shqip) Itali, 2015
3. “Tejkallim”, Tiranë, 2017
4. “In his light”-Dream Press-Hollandë, 2019
(Përkthyer në anglisht nga Arben Hoti)
5. “Namastè”...

JUSUF BAJRAKTARI



Prof. Jusuf Bajraktari u lind në Qafë Morinë të Gjakovës, më 27 mars 1948. Shkollën fillore e kreu në Ponoshec, gjimnazin në Gjakovë, Fakultetin Filozofik, Dega e Historisë, në Prishtinë, në vitin 1973.

Në vitin 1980, kreu magistraturën në Fakultetin Filozofik, në Prishtinë. Tezën e doktoratës e mbrojti më 1985 në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës.

Gjatë vitit shkollor 1966-1967 punoi mësues në shkollën fillore të Ponoshecit, në vitin 1969-1970 arsimtar në shkollën fillore “V. Nazor” në Prishtinë.

Gjatë viteve 1971-1973 ishte profesor i historisë në shkollën e mesme ekonomike, shkollën e mesme teknike dhe në gjimnazin “Xh. Doda” në Prishtinë. Nga viti 1999 ka ligjëruar në cilësinë e profesorit në disa Universitete publike e private në Kosovë e Shqipëri. Në vitet 1973-1978 kryen punën e bashkëpunëtorit profesional në Sekretariatit për Arsim, Shkencë dhe Kulturë të Kosovës. Nga 1 shkurti 1978, deri më 1 prill 2013 punoi në Institutin e Historisë në Prishtinë. Nga janari i vitit 2000 ishte drejtor i këtij Instituti dhe kryeredaktor i Revistës “Kosova” dhe i botimeve të tjera shkencore. Më 5 dhjetor 2012 u zgjodh anëtar korrespondent në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Ka publikuar studime monografike, studime shkencore, tekste shkollore, trajtesa, recensione, vështrime e shkrime të tjera në revista shkencore dhe në shtypin e kohës në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, SHBA etj. Ka udhëhequr disa projekte shkencore e hulumtuese nga fusha e historisë, ka marrë pjesë në sesione, simpoziume e konferenca shkencore të organizuara në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Rusi, SHBA etj. Ka qëndruar për qëllime hulumtuese shkencore në Tiranë, Podgoricë, Beograd, Cetinjë, Sofje etj. Nga 11 prill 2011 është anëtar nderi i kryesisë së Federatës Panshqiptare “Vatra” në Nju Jork.

Punime të botuara në revista shkencore:

“Gjakova me rrethinë në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX (1878-1912)”, Prishtinë, 1998.

“Monografia KOSOVA”, ASHAK, Prishtinë, 2009, (autor i disa njësive).

“Fjalori Enciklopedik Shqiptar”, Tiranë, 2010, (autor i disa njësive).


“Perandoria Osmane”, Selanik, 2012 (autor i disa njësive).

- “Kombet dhe shtetet në Evropën Juglindore”, Selanik, 2012.
“Luftërat Ballkanike”, Selanik, 2012 (autor i disa njëjësive).
“Lufta e Dytë Botërore”, Selanik, 2012 (autor i disa njëjësive).
“Gjilani me rrethinë” (monografi), autor i një kapitulli, (në botim).

Publikime shkencore:

- BRKJ dhe zhvillimi i Lëvizjes së Rinisë në Kosovë në periudhën mes dy luftërave botërore, Prishtinë, 1979.
Lidhja e Komunistëve e Kosovës më 1966-1974, Prishtinë, 1982.
Gjakova dhe rrethina në vitet 70-ta të shekullit XIX, Prishtinë, 1986.
Rrënjët historike të autonomisë së Kosovës, Rrjedhat, 1/1990, Ponošec.
Albanske žrtve na Kosovu nakon Drugog Svjetskog Rata sve do Brionskog Plenuma, Viktimologija, Zagreb, 1991.
Format e gjenocidit të pushtetit serb ndaj shqiptarëve nëpërmjet aksionit të mbledhjes së armëve (1913-1993), në Gjenocidi dhe aktet gjenocidale të pushtetit serb ndaj shqiptarëve nga Kriza Lindore e këndeje, ASHAK, Prishtinë, 1995.
Shpërnguljet me dhunë të shqiptarëve në fund të shekullit XIX, Studime, ASHAK, Prishtinë, 1995.
Aneksimi i Kosovës nga Serbia më 1945, në Çështja e Kosovës një problem historik dhe aktual, Tiranë, 1996.
Serbias Annexation of Kosova in 1945, The Kosova issue a historic and current problem, Tirana, 1996.
Sendërtimi i planeve serbe dhe spastrimi etnik në Vilajetin e Kosovës, në publikimin “Dëbimi i shqiptarëve dhe kolonizimi i Kosovës (1877-1995)”, Prishtinë, 1997.
Largpamësia e vendimeve të Konferencës së Bujanit, në Konferenca e Bujanit, Prishtinë, 1998.
Relacionet e Isa Boletinit me Bajram Currin, në Isa Boletini dhe koha e tij, Prishtinë, 1998.
Gjakova me rrethinë në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Kosova, nr. 20/21, Prishtinë, 1998/99.
Kontributi i Kosovës në Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, Studime Historike, Tiranë 2003.
Haxhi Zeka figurë emblematike e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, Kosova, 22/23, Prishtinë, 2003.
Fadil Hoxha personifikon historinë 50-vjeçare të Kosovës, Kosova, 22/23, Prishtinë, 2003.

JUSUF GËRVALLA (1943-1982)



Jusuf Gërvalla, u lind në fshatin Dubovik, më 1 tetor 1943. Jusufi ka qenë veprimtar, shkrimtar dhe muzikant shqiptar. Ka qenë themelues i grupit "Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës".

Jusuf Gërvalla, ishte themelues i Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës, që më pas u nda në dy fraksione Lëvizja Popullore e Kosovës dhe Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës.

Në letërsi, ai nuk i takonte qarkut të "lapidaristëve" të poezisë. Ishte fjalëpakë që e shoshiste të tashmen me shkrimin simbol plot alegori në petkun e arkaikes mbikohore e në frymën e visarit të traditave të lashta gojore.

Jusufi Gërvalla bashkë me të vëllain, Bardhoshin, dhe Kadri Zekën, u vranë më 18 janar 1982, nga Shërbimi sekret Jugosllavë në lokalitetin Untergruppenbach, pranë Shtutgartit në Gjermani.

Zëri i tij poetik ishte zë më vete, mjaft origjinal, personal dhe individual.

Poezia e tij na flet drejtpërsëdrejti, ngrohtë, thellësisht njerëzor e me një sensibilitet të stërholluar.

Në dy përmbledhjet e tij të para: "*Fluturojnë e bien*" (1975) dhe "*Kanjushë e verdhë*" (1978)- poezia e tij merrej kryesisht me vatrën e poetit tek janë mjaft kuptimplotë titujt e cikleve "*Shtëpia në kornizë*" dhe "*Skena nga jeta e fshatit*". Poezia e tij e përmallshme e këndon dashurinë, e kujton dhimbshëm (dhe pa idilë ruraliste) vendlindjen dhe na e rrëfen porosinë e saj qendrore, kërkimin e poetit për "pak frymë njeriu e pak dritë qiriri". Me kohë, duke u bërë gjithnjë e më shumë refleksiv poeti kaloi gjithnjë e më shumë te një qark më i gjerë tematik dhe te të folurit poetik me bukuri e begati të rrallë metaforike e figurative. Kështu, poezia e tij e përmallshme e vendlindjes gjithnjë e më shumë bëhet edhe universale.

Në vëllimin e tretë poetik të Jusufit, "*Shenjat e shenjta*" (1979), kemi të bëjmë dhe me fjalë e elemente si "hije", "pluhur", "frikë", "terr", "ftohtë", "varr" e tjera.

Shkallëzohen vetmia dhe shqetësimet e poetit që flet shpesh edhe për fundin dhe vdekjen. Me një thellësi që nuk hetohet në lexim të cekët, na qet tablo tejet të qëlluara të groteskës që e quajmë "jeta".

Thelbi kryekëput human i vargjeve, ligjërimi lirik dhe substancial i poetit të mallit, të dashurisë, të dhembjes, të vetmisë e të vdekjes e bëjnë Jusuf Gërvallën një zë të patjetërsueshëm të poezisë së re shqipe.

Jusuf Gërvalla para së gjithash ishte dhe mbetet një poet nga më të rrallët në letrat shqipe, një prozator me shpirt filigrani, një dramaturg që veçoi momentin e flijueshëm letrar për ta bërë më të kapshme e të dobishme idenë atdhetare, një këngëtar e kompozitor me talent vullkanik, një shqipëruar me ndjenjë të hollë për kuptimet, gjuhën e tingëllimet, një publicist me gamë të gjerë interesimesh, por edhe një piktor që la dëshmi jo të pakta të prirjes prej artisti.

Gërvalla në asnjë fushë të krijimtarisë së vet nuk brodhi së koti duke kërkuar identitetin e vet krijues, të cilin kishte zënë ta përfntonte që në hapat e parë krijues. Pra, Gërvalla qe, siç thuhet, krijues i herës së parë. Tek ai çdo gjë ishte e dorës së parë. Ai nuk u mor kurrë me gjëra të dorës së dytë e të tretë. Ndërkaq një forcë tjetër e tij, kriteri i rreptë i artistit, ishte ajo që vinte “penda” kriteresh të rrepta dhe vinte harmoninë mbi ato shpërthime. Gërvalla artin e vet kishte zënë ta krijonte shumë herët, në moshën e vet mitare, për ta pritur atë të vinte i pjekur në kohë. Kështu brenda një periudhe kohe prej katër vjetësh ai botoi tre libra me poezi.

Librat të botuar:

“Fluturojnë e bien”, 1975

“Kanjushë e verdhë”, 1978

“Shenjat e shenjta”, 1979, (këto vepra ishin fryt i një pune që zgjati sa gjithë jeta e tij).

I po kësaj periudhe kohore është edhe romani i tij “Rrotull”, i cili u botua pas vdekjes së autorit, më 1983, kurse pak më e vonshme ndoshta është drama “Procesi”, që u botua në vitin 1984, si dhe “Vepra Letrare”, e botuar në Prishtinë, 1992.

Në këtë drejtim është bërë një punë me vlerë me botimin e plotë të veprës letrare të Jusuf Gërvallës në Prishtinë dhe të një monografie për udhën jetësore të këtij shkrimtari e atdhetari me një titull kuptimplotë “Fati i luleve” nga Kadri Rexhaj, njëri nga miqtë më të mirë dhe njohësit më të thellë të Jusuf Gërvallës.

Kjo punë duhet të vazhdohet më tej me botimin e plotë të veprave të Jusuf Gërvallës në fushë të muzikës e të artit figurativ, e sidomos me krijimtarinë e tij në lëmë të gazetarisë e të publicistikës, të cilën ai e ka krijuar në një periudhë të gjatë kohe.

Botimi i plotë dhe me kompetencë i veprave të një autori është nderimi themelor që duhet t’i bëhet çdo krijuesi, e kur kjo gjë ka të bëjë me krijues si Jusuf Gërvalla...

JUSUF OSMANI



Prof. Jusuf Osmani u lind në Albanë të Madhe (Sllatinë të Madhe) të Fushë Kosovës në vitin 1948. Pasi kreu shkollën fillore, të mesmen, fakultetin dhe studimet pasuniversitare në Zagreb (1878), në vitin 1986 doktoroi në fushën e arkivistikës pranë Fakultetit Filozofik (Dega e Arkivistikës).

Është doktori i parë i arkivistikës në Kosovë si dhe është kandidati i parë në Universitetin e Lubjanës që e mbrojti temën nga kjo lëmi.

Ka punuar si arsimtar, profesor, kurse prej vitit 1973 në Arkivin e Kosovës në Prishtinë, prej vitit 1987-2001 në Arkivin e Qytetit të Prishtinës, ndërsa prej marsit të vitit 2001 prapë kthehet në Arkivin e Kosovës në vendin e punës drejtor.

Jusufi tani është në pension dhe jeton e vepron në Prishtinë.

Veprat e botuara:

Deri më tani ka botuar vepra, punime e artikuj të shumtë nga lëmia e arkivistikës dhe historisë, nga të cilat po i veçojmë disa prej tyre:

“Lënda arkivore për kolonizimin dhe reformën agrare në Kosovë 1918-1941“, Prishtinë, 1996,

“Lexikon i termave dhe i shprehjeve të arkivistikës“, Prishtinë, 1996,

“Vrasjet në Pragë: e Cena Beut-1927 dhe e Alqiviadh Bebit-1928“ (sipas burimeve arkivore), Prishtinë, 1997,

“Kolonizimi serb i Kosovës“ (recenzent prof. dr. Noel Malcolm nga Londra), Prishtinë, 2000,

“Vendbanimet e Kosovës“, nr 1-18, për komunat: Prishtina, Kastrioti dhe Fushë Kosova 1, (2003); Rahoveci 2, (2003); Klina 3, (2003); Theranda 4, (2003); Lypjani 5, (2003); Gjilani 6, (2004),

“Vendbanimet e Kosovës“, nr 1-18, për komunat: Vitia 7, (2004); Mitrovica, Zveçani dhe Zubin Potoku 8, (2004);

Ferizaj, Shtimja dhe Shterrpca 9, (2004); Kaçaniku 10, (2004); Peja dhe Deçani 11, (2004); Burimi (Istogu), 12, (2004).

“Vendbanimet e Kosovës“, nr 1-18, për komunat: Dardana (Kamenica) 13, 2005, Gjakova 14, (2005); Drenica 15, (2005),

Vushtrria 16, (2005), Besiana (Podujeva) 17, 2005,

Pizreni 18, 2005 dhe

“Arkivistika-teoria dhe praktika“, Prishtinë, 2005, etj.

KADRUSH RADOGOSHI



Kadrush Radogoshi u lind në Gjakovë më 15 shtator 1948. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Gjakovë, Fakultetin Filosofik (Dega e gjuhës dhe letërsisë shqipe) si dhe studimet pasuniversitare në degën e letërsisë i kreu në Prishtinë.

Magjistroi me punimin “Poetika e romanit bashkëkohor shqiptar me tematikë të shekullit XV”. Në “Nor Quest College” (Edmonton, Kanada) kreu “Intercultural Studies and English as a Second Language” (8 semestra). Prej vitit 1969 e deri në vitin 1981 punoi në arsim, kur e burgosën dhe e dënuan për propagandë antijugosllave. Ishte i vetmi gjakovar në mesin e 237 intelektualëve të arrestuar më 28 mars 1989, e të dërguar fillimisht në burgun e Leskovcit, e pastaj në burgun e Prokuples. Vite të tëra ka qenë i papunë dhe i persekutuar, herë-herë gjer në linç publik.

Njerëzve që sakrifikuan shumëçka nga jeta, iu është ofruar shumëçka, por ata kanë refuzuar dhe kanë zgjedhur një rrugë tjetër. Ata nuk u brengosen në situata të caktuara, nuk u brengosen për fatin personal të tyre. Ekziston bindja se nganjëherë këta njerëz u kalitën dhe arritën të mbijetonin, sepse qëllimi ishte më i lartë se sa vuajtja individuale.

Ai mendon se rreziku më i madh është nëse intelektualit pranon të mësohet me të keqen. Në raste të tilla e keqja e jashtëzakonshme shndërron në të zakonshme. Është detyrë e intelektualëve, që të mos e lejojnë këtë fenomen të rrezikshëm ekzistencial për një popull. Kështu ka vepruar Sokrati, kështu vepron edhe krye personazhi i romanit “Laokooni” të këtij shkrimtari.

“Laokooni”, nuk është roman tradicional, por është roman i kodit simbolik. Narracioni në të nuk është linear kronologjik, por i dramatizuar sepse bëhet nga më shumë se një narrator dhe nga shumë këndvështrime, pra thyerjet janë të mëdha në aspektin struktural. Nuk është e rastit që autori i këtij romani ka fituar në Kanada “EAC Project Grant for Individual Artists” shuma e të cilit është 25.000 \$.

Kadrushi me jetën e tij personale dhe me romanet e tij përfaqëson fatin e intelektualit shqiptar të Kosovës siç janë: Adem Demaçi (i dënuar për 28 vjet në kazamatet serbe), apo Ukshin Hoti i zhdukur nga policia serbe në atë ditë kur përfundonte afati i dënimit në burgun e Dubravës. Në vitin 2005 Adem Demaçi u zgjodh kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të

Kosovës, ndërsa Kadrush Radogoshi nënkryetar. Ademi nuk arriti ta kryejë mandatin për shkaqe shëndetësore, prandaj punën e tij e kreu nënkryetari Kadrush Radogoshi, i cili në mandatin tjetër (2007-2009) u zgjodh kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës.

Raporti i Kadrush Radogoshit me Adem Demaçin ishte shumë miqësor. Adem Demaçi ishte simbol i Lëvizjes Kombëtare shqiptare, i lëvizjes ilegale. Ata shkrimtarë, që nuk u instrumentalizuan politikisht, janë persekutuar në forma të ndryshme e ka edhe të tillë që janë mbytur në burg. Në Burgun Prishtinës në vitin 1964, kur është arrestuar për herë të dytë Adem Demaçi si kryetar i Lëvizjes për Bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, Fazli Greiçevci, një prej poetëve të njohur e bashkëveprimtar i Adem Demaçit është mbytur nga torturat në burgun e Prishtinës. Ka pasur edhe shkrimtarë, që kanë ikur nga Kosova (Ramadan Rexhepi, Kosovë Rexhëbala etj.) por edhe të atillë, që kanë qenë në burgun famëkeq të Goli Otokut (“Ishulli i thatë” në detin Adriatik) si Teki Dervishi.

Kadrush Radogoshi ka qenë në burgosje hetuese, që e kanë marrë sa herë kanë dashur udhëbës . Nuk ka pasur dënime të gjata, por kanë qenë burgosje nën hetim.

Kadrushi nuk i arsyeton disa poetë. Nuk dëshiron të rëndojë ndërgjegjen e tij, por po e morët, librin e historianit Akademik Prof. dr. Haki Bajramit, “Dosja Demaçi”, që është një libër afro 500 faqe, cili ka arritur të depërtojë në Arkivin e Gjykatës së Prishtinës e të marrë tërë dokumentacionin e tri gjykimeve të Adem Demaçit- më 1959, më 1964 dhe më 1975. Në të tria gjykimet e Ademit deklaratat akuzuese janë të shokëve të tij shkrimtarë, të cilët sot janë emra të njohur dhe për disa prej tyre shqiptarët kanë krijuar mitet ishin akuzuesit e Adem Demaçit.

Kadrush Radogoshi me shkrime filloi të merret që nga viti 1970 e deri me tash. Shkruan kryesisht poezi, prozë, dramë, ese, kritikë letrare dhe artikuj studimorë për letërsinë. Është fitues i shumë çmimeve për poezi e tregim në konkurset letrare.

Për librin “Nëpër universin letrar” (kritikë, ese, studime) në vitin 2003 fitoi Çmimin ”Pjetër Bogdani” për veprën më të mire në të gjitha zhanret letrare, ndërsa në vitin 2009 për librin “Çabrat antologjia, Seancë e përshtirshme” fitoi Çmimin për librin më të mire poetic të vitit.

I pakënaqur me gjendjen e rëndë në Kosovën e pasluftës për shkak të politikës dështake në të gjitha aspektet emigroi në Kanada në vitin 2010. Pas kryerjes së studimeve në Kanada dhe mësimit të anglishtes së nivelit

akademik, Kadrush Radogoshi u zgjodh në programin njëvjeçar për shkrimtarë, të quajtur “Borderlines Writers Circle”, të organizuar nga katër institucione kanadeze: University of Alberta, Writers Guide of Alberta, Edmonton Public Library dhe Edmonton Arts Council.

Gjatë prezantimit të parë publik si pjesëtar i këtij programi shkrimtarësh mori medaljen e artë me stemën e University of Alberta (universitet shtetëror) në Edmonton. Ky program ia mundësoi, që të inkuadrohej natyrshëm në jetën letrare kanadeze si anëtar i tri asociacioneve letrare kanadeze: The Stroll of Poets, Writer Guild of Alberta dhe Canadian Authors' Association. Profilin e tij letrar e kanë prezantuar gazeta të njohura kanadeze si “Edmonton Journal” e Edmontonit, “The Gazette” e Montrealit etj. Për të kanë shkruar emra të njohur kanadezë si Michael Hingston, Richard Davies, Rita Espescht etj.

Pos dy librave të fundit të botuar në gjuhën angleze, poezitë e Kadrush Radogoshit gjerë tani janë zgjedhur dhe prezantuar në tetë antologji poetike kanadeze dhe në antologjinë botërore “Intercontinental Anthology of Poetry on Universal Peace” (2016). Gjithashtu poezitë e tij janë zgjedhur në disa libra tematikë të botuar në Kanada.

Veprat-Poezi:

1. “Në mes të heshtjës dhe këngës” (1981); 2. “Në udhëkryq” (1984);
3. “Nekrologji për Sodomën” (1991); 4. “Heraldika e pikëllimit” (1997);
5. “Pikon çati e shpirtit” (2004); 6. “Orfeu nga Vendenisi” (2005);
7. “Pikëllim i buzëqeshur” (2006); 8. “Çabrat antologjia- seancë e përshpirtshme” (2008); 9. “A Devout Session 2 - Seancë e përshpirtshme 2” (libër bilingual, 2014);
10. “Orpheus' Palimpsest” (2018); 11. “Palimpsest orfeik 2” (2018);

Kritikë, ese, studime:

1. “Poetika e romanit bashkëkohor shqiptar me tematikë të shek. XV” (1985); 2. “Interpretime” (1993); 3. “Nëpër universin letrar” (2003); 4. “Semantika e bregut tjetër” (2008);

Romane:

1. “Jeta artistike e Ilir Shkretës” (1993); 2. “Homo Dardanicus” (2001);
3. “Laokooni” (2017);

Dramë

“Adem Jashari dhe vdekja” (2001)

Libër dokumentar

“Nëpër rrathët e ferrit serb” (2005).

KASTRIOT TUSHA



Kastriot Tusha, i lindur më 14 prill 1964, në Elbasan. Është tenor shqiptar. Mësimet fillestare për kanto i mori në Shkollën e Mesme të Muzikës "Onufri", (Elbasan), nga viti 1978 deri në vitin 1982. Në vitet 1983-1984 kryen kursin 9-mujor të krijimtarisë popullore për kanto në Tiranë.

Në vitin 1984 fillon studimet e larta në Institutin e Lartë të Arteve, Tiranë, dega kanto, nën drejtimin e tenorit të mirënjohur Gaqo Çako. Përveç detyrimeve shkollore, në këtë periudhë ka zhvilluar aktivitet koncertor me pianist dhe orkestra. Mbrojtjen e diplomës e bëri me rolin e Pinkertonit nga Opera "Madam Butterfly" e Puçinit, me Orkestrën e Akademisë së Arteve.

Pas mbarimit të studimeve u emërua solist pranë Teatrit të Operës dhe Baletit, kohë në të cilën ka realizuar disa role kryesore. Nga viti 1999 e në vazhdim është pedagog i kantos në Akademinë e Arteve.

Kastriot Tusha ka treguar aftësitë e tij të këndimit brenda vendit dhe jashtë tij në shumë zhanre dhe turne, si në fushën e muzikës klasike, muzikës së lehtë dhe asaj të zgjedhur popullore, si dhe ritmeve latino-amerikane e tjera.

U paraqit në koncerte në Kosovë, Maqedoni, Gjermani, Itali, Zvicër, Turqi, Angli, Irlandë, Danimarkë, Norvegji, Suedi, SHBA, Kanada,

Këndoi ndër të tjera edhe nën shoqërimin e Orkestrës së Re të Filarmonisë. Koncertet e tij shumë të njohura janë: "Kastriot Tusha me Miqtë", "Latino American Classic", "Vikena Kamenica dhe Kastriot Tusha", "Tre Tenorët", etj.

Me rastin e premierës së operës të parë kosovare *Dasma arbëreshe* Kastriot Tusha interpretoi rolin e Arbrit.

Për dëgjuesin shqiptar u bë i njohur më shumë me zhanrin e këngës qytetare, që ai i këndon me tingullin e tenorit lirik.

Kastriot Tusha këndoi himnin kombëtar të Gjermanisë me rastin e një ndeshjeje të boksit, për titullin e kampionit të Evropës, për të cilin titull ndeshje shqiptari Luan Krasniqi. Kjo ndodhi pas kërkesës së vet boksierit.

Rolet operistike:

1989. TOB-Opera "Pagliacio" (në rolin e Beppes),

1989. TOB-Opera komike "Paja" (në rolin e Kolës),

1990. TOB-Opera "Peshkatarët e Perlave", (në rolin e Nadirit),

1990. Katedrale Tiranë-Mozart "Requiem" për solist, kor dhe orkester (tenori). Trupa e TOB-së.
1991. TOB-Opera "Traviata" (në rolin e Alfredos),
1992. TOB-Opera "Mrika" (në rolin e Dodës),
1992. TOB-Opera "Trovatore" (në rolin e Ruiz),
1993. TOB-Skena nga Opera "Rigoletto" (në rolin e Dukës),
2003. Teatri Kombëtar Prishtinë-Opera "Dasma Arbëreshe" (në rolin e Arbrit).

Veprat muzikore:

- “Jeto jetën“
“Serenata“
“Dua më shumë Shqipërinë“
“Disa nga këngët e tij“
“Vitet ikën tutje“
“Shqipëri faleminderit“
“Ti Shqipëri më jep nder“
“O Korça ime“
“Mos harrojmë Adem Jasharin“
“Lërmë të të puth“
“Drenusha ime“
“Emocione nga Turqia“
“Veç një ditë të jetoja pranë teje“
-Je si yll e je si hënë
“Jo se nena dhe tata nuk e donë“
“Çapkënia“
“Për datëlindje“
“Falni Dashuri“
-Intimitet - orkestrale për kitarë
“Ditë të bardha“
“Jepma mollën“
“Rinia nuk vjen më“
“Turkesha gazmore“
“Vajze xheloze“
“Zëri i jetës“. etj.

Kastriot Tusha, sikurse edhe shumë këngëtar të Estrades shqiptare në përgjithësi, ka marrë pjesë në shumë programe humanitare, që janë organizuar në trojet shqiptare dhe në diasporë...

KATARINA JOSIPI (1923-1969)



Katë Dulaj, apo siç njihet me emrin artistik Katarina Josipi-Kati, u lind në fshatin Zym të Hasit, komuna e Prizrenit, pikërisht më 9 nëntor të vitit 1923. Katarina Josipi shkollimin fillor e nisi në Zym në gjuhën serbe, pas vrasjes së Atë Shtjefën Gjeçovit, kurse e kreu në Nish, ku ishte me babanë e vet bukëpjekës. Atje e kishte kryer edhe shkollën e natës për rrobaqepëse.

Pas bombardimit të Nishit, në prill të vitit 1941, babai i Katit, sikurse shumë bukëpjekës të tjerë nga Zymi, kishin ikur nga Nishi, kurse babai i Katit, Gjin Joza, ishte vendosur në Ferizaj.

Katarina Josipi si aktore amatore kishte hapëruar në dërrasat e Teatrit Amator në Ferizaj, së bashku me Shaban Gashin e Matej Serreqin, që të dy nga Ferizaji.

Ishte mbarimi i vitit 1947, kur për herë të parë në Prishtinë po hapej teatri profesional. Ndërkaq, në pranverë të vitit 1948 në këtë teatër u angazhuan Katarina Josipi, Hyrije Hana e Meribane Shala, që njëherësh ishin tri femrat e para shqiptare të këtij teatri.

Shfaqja e parë, në gjuhën shqipe në këtë teatër u realizua më 1 maj 1949, me pjesën "Personi i dyshimtë", të autorit Branislav Nushiq.

Katarina Josipin-Katin e kemi parë në skenën e teatrit profesional, e kemi dëgjuar në radio me radiodrama, por e kemi parë edhe në televizion e në film. Megjithatë, ajo jetoi në skenën teatrore, aty ku e fillonte jetën magjepse që e sheh, e ndien, ku i zbulonte karakteret e njerëzve, rolet e të cilëve i interpretonte. Ishte prijëse e dramës shqipe. Jeta e Katit ka filluar kur janë ndezur dritat e skenës. Aty derdhi djersën e vet. Në skenë ajo jeton edhe sot prej kalimit të saj në amshim. Jeton në kujtimet e artistëve, por edhe të shikuesve e të dashamirëve të teatrit.

Shfaqjet që luajti Katarina dhe roli i saj:

“Personi i dyshimtë”, (Marica), 1949, “Zjarri dhe hiri” (Tanja) 1950

“E shoqja e Hasan Agës”, (E shoqja e hasan Ages) 1952

“Sikur të isha djalë”, (Remzija) 1952, “Tri botëna”, (Ajshja plakë) 1953

“Nuk martohen me parë”, (plaka) 1954

“Shërbëtori i dy zotnive” (Beatriqja) 1955

“Nita” (Ithja), 1955

“Zotni Fedor”, (Marina), 1955, etj.

KOPI KYÇYKU



Prof. Kopi Kyçyku, doktor i shkencave, inxhinier, akademik, gazetar, eseist, profesor i gjuhës italiane dhe i historisë së Ballkanit, u lind në Pogradec më 1943, ka mbaruar fakultetet Gjeologji-Miniera dhe Histori-Filologji (degët gjuhë-letërsi dhe histori-gjeografi), Profesor në universitetet e Tiranës e të Bukureshtit, anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë (qysh më 1967). Kyçyku po ashtu ka marrë pjesë, me referate dhe kumtesa, në shumë veprimtari shkencore ndërkombëtare. Është nderuar me diploma dhe çmime ndërkombëtare për mësimdhënien e stilistikës së gjuhës italiane, të historisë së Ballkanit, si dhe në fushën e përkthimeve.

Është autor i shumë vëllimeve me poezi, tregime, drama, pamflete, artikuj kritikë për letërsinë e artet, si dhe studimesh shkencore; përkthyes i veprave të shumta letrare, historike dhe gjeologjike nga disa gjuhë, në shqip, rumanisht dhe italisht. Laureat i Medaljes “Mihai Eminescu”, akorduar me Dekretin e Presidentit të Republikës së Moldavisë (2012).

Është anëtar themelues i Fondacionit Evropian “Nikolae Titulesku”, anëtar themelues dhe është doktor i shkencave dhe akademik, anëtar themelues dhe anëtar i Komitetit Drejtues Ndërkombëtar i Qendrës Evropiane të Studimeve Ndëretnike dhe të Komunikimit pranë Akademisë Rumune, (1991, anëtar themelues i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Evropës Qendrore, anëtar titular i Akademisë Evropiane të Arteve (Belgjikë), anëtar i Këshillit të Nderit të *European Academy of Performing Arts*, Kavalier i Shën Silvestrit Papë,

Në lëmin e historisë ka shkruar dhe ka botuar në shqip, rumanisht dhe italisht një numër të madh monografish, ndër të cilat:

„Mustafa Qemal Ataturku”, „Turqia e Pasluftës (1945-1985)”

„Kryengritja e armatosur e Ilindenit”, Maqedoni (1903)

„Marrëdhëniet shqiptaro-rumune gjatë shekujve”

“Arumunët e Shqipërisë në kontekst ballkanik”

“Arumunët në optikën shqiptaro-rumune”

“Historia e Shqipërisë”, ”Pater-Emil Conduraqi”

„Historia e Maqedonisë”, „Histori e shkurtër e Azerbaixhanit”

„Ataturkizmi dhe Turqia e Mijëvjetshit të Tretë”

„Algjeria-e kaluara dhe e sotmja”, “Mes strehësh e trandjesh”, etj.

KOSOVARE UKSHINI



Kosovare (Mustaf) Ukshini, u lind në Gjakovë (1986). Studimet e larta, i kreu në vitin 2008, në Fakultetin Ekonomik, pranë kolegjit AAB, në Prishtinë, me notë mesatare 9,89. Sapo i kreu me sukses studimet bazike, në vitin 2008 ajo u angazhua si staf i rregullt akademik në Fakultetin Ekonomik të Kolegjit AAB.

Në vitin 2009, Kosovarja filloi studimet pas-universitare dyvjeçare në Menaxhment dhe Informatikë në kolegjin AAB, të cilat i përfundoi në vitin 2012, duke mbrojtur me sukses të dalluar temën me titull *“Motivimi dhe faktorët e motivimit tek punëtorët e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme-Rast studimi komuna e Gjakovës”* me notë mesatare 9,69. Më datën 3 prill 2014, Kosovarja u zgjodh ligjëruese për lëndën Menaxhment, në Fakultetin Ekonomik, Kolegji AAB.

Gjatë vitit 2014, ajo është zgjedhur si koordinatore për projekte në kuadër të Fakultetit Ekonomik, kolegji AAB. Nga viti 2018 ajo mbanë pozitën e Prodekanit për mësim, po në këtë institucion.

Në vitin 2019 mbrojti temën e doktoraturës me titull *“Kontributi i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në rritjen e punësimit në Kosovë-politikat mbështetëse dhe efektet”*.

Punimet shkencore:

- "Ndikimi i politikave në rritjen e punësimit përmes mbështetjes së NVM-Rasti i Republikës së Kosovës ",
- Kosovare Ukshini, Izet Zeqiri; The effect of supportive policies on sme development-Kosovo case. In proceeding Danubius International Conferences, 13th International Conference on European Integration-Realities and Perspectives, Rumania,
- K. Ukshini, I. Zeqiri; Ndikimi i rritjes së aftësive sipëmarrëse në rritjen e nvm-ve në vendet në tranzicion, International Journal Scientific Papers,
- Izet Zeqiri, Kosovare Ukshini; Roli i inovacioneve në zhvillimin e bizneseve të reja,
- Biennial International Scientific Congress, Economic Analysis of Global Trends In Tourism, Finance, Education,
- Kosovare Ukshini, Besime Ziberi, Donat Rexha; Kultura organizative në institucionet akademike pesë dimensionet e hofstedes 2,
- "Ndikimi i qeverisë së Kosovës në zhvillimin ekonomik", etj.

KOZETA ZAVALANI



Kozeta Zavalani, u lind në qytetin e Korçës, më 8 mars 1958. U diplomua në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Tiranës më 1982, kurse në vitin 1985 është specializuar për gazetari. Qysh nga viti 1992 puna e saj është përqendruar në gazetari.

Kozeta punoi në Televizionin Shqiptar dhe botoi revistën “Stina për ndryshim”.

Ajo ka marrë pjesë në aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare, kushtuar gruas në vende të tilla si; në Holandë, Itali, Amerikë, Norvegji, Poloni, Marok, e vende tjera në Evropë e më gjerë.

Ka kryer një sërë kualifikimesh pasuniversitare dhe ka kontribuar si lektore në konferencat: “*Mbi menaxhimin e kohës*” nga Vrije University, në Amsterdam të Holandës, dhe në Palermo të Italisë, ku është laureuar me titullin: “Doktor”.

Tani është kryeredaktore e revistës “Stina për ndryshim”. Bashkëpunon me shoqatën “FIDAPA” në Itali, “Women and Peace”, UNESCO në Greqi, “Dirigenteas” në Paris, WIN - Zvicër, “Women Abroad” Angli, GlobeWomen, CIPE, TIAW dhe BRAZZERS në Uashington D. C. etj.

Në moshën 10-vjeçare, poema e saj fitoi çmimin e parë dhe u botua në revistën kombëtare të fëmijëve “Pioneri”.

Në vitin 1976 ajo ishte bashkautor në librin me tregime epike “*Heronj të heshtur*” dhe në vitin 1978, në librin “*Yje të pashuar*”.

Libri i saj i parë i poezive “*Këngët e para*”, nuk u botua në vitin 1979, sepse konsiderohej “tepër lirik”, dhe nuk “ndiqte parimet e ideologjisë komuniste”.

Sa ishte në shkollë të mesme 1975-1976, Kozeta ka punuar në “Radio Korçë” si spikere.

Ajo punoi si moderatore televizive për programin e fëmijëve në të vetmin Transmetues Kombëtar, Radiotelevizionin Shqiptar (1977-1981).

Pas diplomimit, në vitin 1982 u emërua Përgjegjëse e Departamentit të Tregtisë në Maliq, Korçë, ku punoi deri në vitin 1992.

Më 1993 ajo filloi të punonte si gazetare e spikere e lajmeve për Radio Televizionin Shqiptar (1994-2001). Ndërmjet viteve 1997-2002, ajo botoi gazetën periodike “The Manager”, në Tiranë.

Në vitin 1999 mbrojti masterin për temën në Palermo, Itali dhe Vrije në Holandë.

Në dhjetor 2002, ajo themeloi shoqatën “Familja dhe Media”. Në vitin 2006 ajo u nderua me titullin "Ambasador për Paqe" nga Federata për Familje e Paqen Botërore.

Në vitin 2009 ajo u nderua me çmimin e dytë në Takimin e Poeteshave Shqiptarë në Vushtrri, Fitues i "Çmimit Special" në kategorinë e Poezisë Ballkanike në "Netët e Poezisë së Korçës" më 2 korrik 2010.


Në qershor 2011, në Kongresin Botëror të 22-të të Poetëve në Larisa të Greqisë, Kozeta Zavalanit iu dha çmimi Olympus Poetry "Demeter", etj.

Librat e botuar:

1. “Gra që më kanë frymëzuar”, vëllimi 1, "Gra që më kanë frymëzuar" - intervista-shtëpia botuese- Dita, Tiranë, viti 2000.
2. “Gra që më kanë frymëzuar”, vëllimi 2, "Gra që më kanë frymëzuar" - intervista-shtëpia botuese - Dita, Tiranë, viti, 2001.
3. “Women who have inspired me”, përshtypje dhe intervista në anglisht - Shtëpia botuese Afërdita, Tiranë, viti, 2001.
4. “Halfworld”, biografi, përshtypje dhe intervista në gjuhën angleze - shtëpia botuese Logoreci, Tiranë, viti, 2005.
5. “Gjysmëbota” - biografi, përshtypje dhe intervista në shqip - Shtëpia botuese Medaur, Tiranë, Viti, 2007.
6. “Porta e Shpirtit” - libër poetik në shqip dhe anglisht, Shtëpia Botuese Vllamasi, Tiranë, Shqipëri, viti, 2012.
7. “Migratory” - "Shtegtare" - libër poetik në 8 gjuhë të ndryshme, Shtëpia botuese Ada, Tiranë, Shqipëri, viti, 2010.
8. “Women” (libri i poezisë në anglisht), Platforma e pavarur e botimit, Bolonja, Italia, 2014.
9. “Frymëmarrje femërore” - ese në shqip-Shtëpia botuese Vllamasi, Tiranë, viti, 2014.
10. “Ankthi” - roman në shqip - Shtëpia botuese Toena, Tiranë, viti, 2014.
11. “Rizgjimi” - libër poetik në shqip, Platforma e pavarur e botimit, Bologna, Itali, 2015.
12. “90+” roman - Shtëpia Botuese GLA, Tiranë, mars, 2018 etj.

Kozeta Zavalani është krijuese me plot energji. Ajo nuk mungon thuajse në asnjë manifestim kulturor e letrar që organizohen në trojet shqiptare dhe në diasporë. Ajo duke e respektuar poezinë shqipe dhe poetet shqiptarë, është e respektuar dhe e mirëpritur nga të gjithë.

KRISTAQ TURTULLI



Kristaq Petraq Turtulli, shkrimtar, poet, gazetar, piktor, romancier i njohur me banim në Toronto, Kanada. Z. Turtulli, u lind në Korçë, më 18 nëntor 1954. Mbaroi shkollën artistike të pikturës në qytetin e lindjes, Korçë, dhe më pas ndoqi shkollën e lartë në Universitetin e Tiranës, në degën Gjuhë Letërsi.

Kristaqi u aktivizua në ekspozita të ndryshme me piktura dhe punoi për shumë vite si profesor letërsie, si dhe gazetar dhe editor në revistën “Meridian”, si dhe në gazetatat dhe revistat më të suksesshme të vendit. Ka qenë për vite me radhë z/ president i klubit të shkrimtarëve ballkanikë: “Bota e re”, frymëzuesi dhe organizuesi i “Netëve poetike korçare”. Si dhe z/ president i shoqatës “Korça, Tradita, Progresi”.

Kristaq Turtulli rrjedh nga një familje e shquar, bamirëse, tregtare, patriotike. Ai mori pjesë me disa punime të tij me piktura, në ekspozitën e pikturës që u organizuan nga një grup piktoresh në Toronto, në vitin 2012 dhe në vitin 2018. Gjashtë punimet e tij në pikturë, në vaj, u vlerësuan për tematikën dhe koloritin.

Kristaq Turtulli është fitues i disa çmimeve kombëtare në prozë. Është i përkthyer me sukses në gjuhën angleze. Anëtar i Unionit të Shkrimtarëve të Kanadasë. Veprat e tij si romanet, librat me novela, poezitë, poemat kanë një auditor të gjerë si brenda vendit, në mërgim, po ashtu dhe lexues anglishtfolës.

Turtullit, për veprimtari të shquar në fushën letrare dhe artistike, qeveria shqiptare i akordoi titullin e madh: AMBASADOR I KOMBIT.

Veprat:

- “Ana”, me çmim kombëtar 1981, novelë
- “Nëna”, me çmim kombëtar 1989, novelë
- “Aventurat e Arushit Topik”, novelë-përrallë për fëmijë
- “Zogjtë”, novelë e tregime për fëmijë, 1989
- “Hija e ariut”, roman, botuar në vitin 1996
- “Hani me dy porta”, roman, me çmim e madh Fan Noli 1998
- “Ç'është jeta e një njeriu”, 2006, roman
- “Vetmia e Zërave”, 2007, roman
- “Dëgjo floriri im”, roman, si dhe ka të botuara edhe shumë libra në gjuhë angleze dhe saga në dy pjesë nga SHB ProkultPress...

KRISTO FRASHËRI (1920-2016)



Kristo Frashëri, u lind më 4 dhjetor të vitit 1920, në Stamboll dhe vdiq më 31 janar 2016, në Tiranë. Frashëri ka një prodhimtari shkencore që mbulon një periudhë 70-vjeçare.

Që nga viti 1938, kur ka botuar shkrimin e tij modest mbi Jeronim de Radën, ka botuar me dhjetëra artikuj studimorë, referate historike, vëllime dokumentare dhe monografi shkencore, që trajtojnë pa përjashtim ngjarje, personalitete dhe procese të historisë së Shqipërisë.

Më 1940 ka qenë pjesë në Grupin Komunist të të Rinjve, gjë për të cilën figuronte edhe në një "studim të grupeve antiparti" të Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit më 1964. Më 19 prill 1943 figuron si ilegal në listën e të akuzuarve të gjyqtarit hetues major Sartorio Gresertenti.

Ka trajtuar temat nga historia politike, zhvillimi ekonomik, probleme shoqërore, mendimi filozofik dhe lëvizja kulturore shqiptare. Ndër to janë sprovat për të ndriçuar mjegullnajën shqiptare gjatë Mesjetës së hershme, rendin feudal mesjetar në viset shqiptare, formacionet shtetërore mesjetare, shqiptarët në Betejën e Kosovës (1389), figurën e errët të Musa Arvanitasit, tiparet e regjimit feudal turk në Shqipëri, jetën kulturore shqiptare gjatë shekujve të sundimit osman, Rilindjen Kombëtare Shqiptare, luftën çlirimtare të Vlorës, zhvillimin e ekonomisë së tregut gjatë shekujve XIX-XX, jetën dhe veprimtarinë e Pjetër Bogdanit, Sami Frashërit.

Punimet shkencore të botuara pas vitit 1990:

“Lidhja e Prizrenit 1878-1881” (Tiranë, 1997),

“Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Jeta dhe vepra”, Tiranë, 2002.

Janë të pa botuar edhe 9 vëllime për historiografinë e heroit kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeut,

“Historia e Tiranës” (Tiranë, 2004),

“Historia e lëvizjes së majtë në Shqipëri” (Tiranë, 2006),

“Skënderbeu në burimet dokumentare shqiptare në shek. XV”, 2005,

“Identiteti kombëtar i shqiptarëve” (Tiranë, 2006),

“Historiografia shqiptare në tranzicion” (Tiranë, 2006),

“Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë, 28 nëntor 1912” (Tiranë, 2008);

“Historia e qytetërimit shqiptar” (Tiranë, 2008),

“Lidhja e Prizrendit”: (1878-1881)-(1956),

“Rilindja kombëtare shqiptare”: me rastin e 50-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë Kombëtare-(1962),
“Tre vëllezër pishtarë”: Abdyl Frashëri, Naim Frashëri, Sami Frashëri: botuar me rastin e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, (1978),
“Lidhja shqiptare e Prizrenit”, 1878-1881, botohet me rastin e 100-vjetorit të lidhjes shqiptare të Prizrenit-(1979),
“Abdyl Frashëri”, 1839-1892-(1984),
“Skënderbeu-jeta dhe vepra”,(2002),
“Historia e Tiranës”, (2004),
“Himara dhe përkatësia etnike e himarjotëve”, (2005),
“Skënderbeu dhe lufta shqiptare-turke në shek. XV”, (2005),
“Hasan Reçi”,1904-1948-2005,
“Identiteti kombëtar shqiptar dhe çështje të tjera”, (2006),
“Historia e lëvizjes së majtë në Shqipëri dhe e themelimit të PKSH-së” (1878-1941) (2006),
“Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë”, (28 nëntor 1912)-(2008),
“Historia e qytetërimit shqiptar”, (Nga kohët e lashta deri në fund të Luftës së Dytë Botërore)-(2008),
“Bajroni në Shqipëri dhe takimet me Ali Pashë Tepelenën”, (Vjeshtë 1809)-(2009),
“Skënderbeu i shpërfytyruar”, (2009),
“Historia e Kosovës”, Dardania, (Kosova Antike),(2009),
“E vërteta mbi Shqiptarët e Maqedonisë dhe shtrembërimet e Enciklopedisë së Shkupit”, (2010),
“Frashëri”: shkëlqimi dhe rrënimi i tij”, (vështrim i shkurtër), (2010),
“Monedha, krediti dhe banka në Shqipëri gjatë shekujve”, (vështrim i shkurtër), (2011),
“Lidhja Shqiptare e Prizrenit”, 1878-1881-(2012),
“Historia e Dibrës”, (2012),
“Etnogjeneza e shqiptarëve”, Vështrim historik, (2013),
“Abdyl Frashëri: jeta, veprimtaria dhe shkrimet” (1839-1892)-(2013),
“Ahmet Zogu”: (vështrim historik), (2014),
“Jeta e një historiani”, (2014),
“Principata e Arbërisë”, 1190-1215-(2014),
“Historia e Çamërisë”, (vështrim historik) - (2015).

Kristo Frashëri u rrit si historian kombëtar dhe u fik si një fëmijë shëmbëllor me detyrën e kryer ndaj Atdheut!

KUJTIM MATELI



Kujtim Mateli, u lind në Mazhan të rrethit të Përmet të Shqipërisë, më 15.06.1951. Fakultetin Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, e kreu në Elbasan 1985-1990. Më fillim ka punuar mësues në rrethin e Përmetit dhe në Tiranë, ku jeton aktualisht.

Krijimtarinë letrare e ka filluar në vitet e '70-ta dhe në fillim të 1980-të, ka botuar ciklin e parë me poezi në gazetën "Drita" dhe në vijim ka botuar vazhdimisht në opuset qendrore të shtypit dhe atë lokal, ese, komente dhe kritikë letrare.

Ka botuar vëllimin poetik "Kur mendon për të tjerët" në vitin 2009. Një publicitet të veçantë krijimtarisë së tij e ka dhënë revista "Metafora" organ i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, ku ka qenë i pranishëm pothuaj në çdo numër të saj. Është i pranishëm në veprimtaritë letrare që zhvillohen në Shqipëri, por dhe në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Klubi i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve "Naim Frashëri" në Përmet, e ka vlerësuar me Çmim të Parë në vitin 2017, për vëllimin poetik "Qetësojmë shpirtin e trazuar".

Fusha e dytë e studimeve të tij ka të bëjë me historinë e antikitetit dhe konkretisht me identitetin e Dodonës dhe vendodhjen e saj. Në vitin 2001 i është përkushtuar Dodonës pellazge, materialet e së cilës do t'i përmbledhë në tri libra, me mbi 20 vjet studim.

"Dodona ndodhet në Dëshnicë të Përmetit, I" 2011

"Dodona ndodhet në Dëshnicë të Përmetit, II", 2016

"Qetësojmë shpirtin e trazuar" (poezi), 2017.

Librat e tij kanë qenë objekte edhe i studiuesve të huaj, siç është kërkuesi shkencor Gilles De Rapper, anëtar i French National Centre for Scientific Research.

Për ta sensibilizuar opinionin publik ka dhënë disa intervista në shtypin e shkruar dhe disa emisione televizive. Televizioni "Planet" në vitin 2013 realizoi një dokumentar 40 minutash, në lidhje me studimin e tij për Dodonën.

Fusha e tretë e punës së tij ka qenë dhe publicistika. Është një numër i konsiderueshëm artikujsh që paraqesin realitetin shqiptar në këto vitet e fundit ku mund të përmendet shkrimi: "Albanologut Milan Shuflaj, emrin dhe gjakun ia ruan Shqipëria", botuar në disa gazeta, ku pasqyrohet dhe kontributi i Akademisë së Shkencave Shqiptaro-Amerikane.

KUJTIM SHALA



Prof. Kujtim Shala është poet lirik, studiues letrar, profesor i letërsisë. U lind më 28 shkurt të vitit 1974, në Loxhë të Pejës. Shkollën fillore e ka kryer në vendlindje në vitin 1988, ndërsa gjimnazin në Pejë në vitin 1992.

Studimet për Letërsi Shqipe i ka përfunduar në Universitetin e Prishtinës, studimet themelore 1996, studimet postdiplomike e magistraturën (2001), doktoratën (2002).

Ka bërë studime postdoktorale në Universitetin e Bolonjës, në fushën e teorive letrare (2004-2005).

Është i specializuar në letërsi moderne, teori e forma letrare dhe në estetikë. Karrierën në Universitetin e Prishtinës e ka nisur si asistent (2002), ka vijuar si profesor asistent (2006) e pastaj si profesor i asocuar (2011), për t'u zgjedhur profesor i rregullt, më 2016.

Gjatë këtyre viteve, ka ligjëruar në shkallën e studimeve Bachelor, Master dhe në Shkollën doktrate lëndë të letërsisë shqipe e të fushës teorike. Po ashtu, ka ligjëruar Letërsi shqipe në Universitetin e Tiranës, në vitin akademik 2010/2011.

Ka redaktuar revistën e kulturës “Fjala” (2004-2005) dhe revistën letrare “Verbi” (2008-2009). Ka fituar Çmimin Kombëtar për Letërsi “Azem Shkreli”, si dhe çmime të tjera letrare në Kosovë e jashtë saj.

Në vitet 2000-2002 ka qenë drejtues i Sektorit të Bibliotekave dhe të Publikimeve të Departamentit të Kulturës të Kosovës. Ndërsa, nga viti 2003 ka qenë pjesë e Grupit të Ekspertëve për reformimin e Planprogrameve të letërsisë. Ka qenë zëvendëskryeministër dhe ministër i Kulturës i Kosovës. Anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës është zgjedhur në dhjetor të vitit 2016.

Veprat e botuara:

“Epistemologjia e dytë”, “Buzuku”, Prishtinë, 2016

“Revelaia”, “Librarium Haemus”, Bukuresht, 2016

“Kujtesa e Rugovës”, “Fondacioni Ibrahim Rugova”, Prishtinë, 2016

“Ernest Koliqi: authentica et urbana”, “Buzuku”, Prishtinë, 2015

“Zbulesa”, “Buzuku”, Prishtinë, 2015

“Onufri”, Tiranë, 2016

“Prishtina letrare: petit Paris”, “Buzuku”, Prishtinë, 2014

“Analepsa”, “Fondacioni Ibrahim Rugova”, Prishtinë, 2013, etj.

LASGUSH PORADECI (1899-1987)



Lasgush Poradeci (Lazar Gusho), u lind në Pogradec, më 27 dhjetor të vitit 1899. Ka vdekur në Tiranë, më 12 nëntor 1987. Në letërsinë shqipe është i njohur si poet, shkrimtar e përkthyes shqiptar, nën pseudonimin Lasgush Poradeci. Pseudonimi letrar, me të cilin njihet, vjen nga rrudhja e emrit të tij përfshi atësinë, Lazar Sotir Gusho (La-S-Gush) dhe si mbiemër ka përdorur endonimin e vendlindjes, Poradeci. Lasgushi është autor i dy vëllimeve me poezi “*Vallja e yjeve*” botuar në vitin 1933 dhe “*Ylli i zemrës*” në vitin 1937. Këto dy përmbledhje poetike i ka botuar në Bukuresht të Rumanisë. Vëllimin e parë e ka botuar me ndihmën e mërgatës shqiptare në Konstancë, ndërsa vëllimin e dytë, i botuar me ndihmën e Mitrush Kutelit. Përmbledhja e dytë poetike përmban edhe vargje të përpunuara nga vëllimi i parë me poezitë me vargëzimin e melodinë më të hollë në gjuhën shqipe. Përpos dy vëllimeve, Poradeci botoi tregime në prozë ndër të përkohshmet e viteve '30-'40. Veçanërisht tek “Përpjekja shqiptare” e redaktorit Branko Merxhani. Shkrime prej tij janë shfaqur edhe në të përkohshmet “Drita” dhe “Nëntori”, të cilat të bluara siç qenë nga censorët e kohës ishin hapësira më të volitshme për serën e shqipëruesve.

Lasgushi është autor i më se shumë se 100 poezive, një pjesë prej të cilave edhe poezi dashurie. Ishte adhurues i fjalëve arkaike, shprehjeve filozofike popullore po aq sa i fjalëve të reja dhe eksperimenteve leksikore për një amë të re. Kuteli që i redaktoi “*Yllin e zemrës*” e quajti “Poeti i vetëm shqiptar që mendoi, foli dhe shkroi vetëm në gjuhën shqipe. Veç të tjerash, janë të njohura poemat: “Ekskursioni teologjik i Sokratit”, “Mbita”, “Kamadeva”, baladat për Muharrem e Reshit Çollakun. Gjithashtu, përktheu disa nga kryeveprat e letërsisë botërore si: “*Eugjen Onjegin*” të Pushkinit, lirikat e Lermontovit, të Bllokut, Poemat e Hajnes, të Majakovskit e Miçkieviçit, lirikat e Gëtes dhe Hajnes, poezi të Lanaut, Brehtit; Hygoit, Mysësë, Bajronit, Shellit, Bërnsit, të Emineskut, e poetëve të tjerë të njohur botëror.

Me rastin e 100-vjetorit të lindjes në 27 dhjetor 1999, kryetari i Republikës Rexhep Mejdani i jep titullin “Nderi i Kombit” dhe Pogradeci, qyteti i tij i lindjes titullin “Qytetar nderi”. Pallati i Kulturës në Pogradec mban emrin Lasgush Poradeci...

LATIF BERISHA (1931-1999)



Prof. Latif Berisha, u lind më 18 qershor 1931, në Smrekonicë të Vushtrrisë. Mësimet fillore i kreu në vendlindje, ndërsa ato të mesme në Vushtri e Prishtinë. Fillimisht më 1949, punoi mësues në shkollën fillore në Pantinë. Këtu filloi të shkruajë poezi e disa prej tyre edhe i botoi në revistën letrare "Jeta e Re". Më 1951 punoi inspektor në Sekretariatit për Arsim Kulturë dhe Shëndetësi. Në ato vite qe edhe anëtar i kryesisë së Shoqatës së Arsimtarëve.

Më 1954, Latif Berisha punoi mësimdhënës i Gjuhës dhe letërsisë shqipe në Gjimnazin e ulët të Vushtrrisë, ndërsa më 1955 regjistrohet student i rregullt i Albanologjisë në Fakultetin Filozofik në Beograd.

Gjatë kohës së studimeve, më 1957 boti përmbledhjen e poezive "TUFA". Aktiviteti i tij u dallua edhe në formimin e Shoqërisë letrare "Përpyekja" të studentëve shqiptarë, që studionin në Universitetin e Beogradit.

Në qershor të vitit 1959, diplomoi në degën e Albanologjisë dhe pastaj punoi mësimdhënës në Gjimnazin e Mitrovicës.

Më 1963, Latif Berisha i vazhdoi studimet pasuniversitare, drejtimi i Letërsisë, në Fakultetin Filologjik të Beogradit dhe punoi temën e magjistraturës "Skënderbeu në letërsinë e shkruar shqipe".

Më 1965 u zgjodh asistent në degën e Albanologjisë në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, ndërsa më 1968 u zgjodh ligjërues i Historisë së letërsisë shqipe (Romantizmi).

Që nga viti 1984, Latifi punoi në projektin "Skënderbeu në letërsinë shqipe" të cilin për shkak të rrethanave të asaj kohe, nuk arriti ta mbaroi.

Në vitin 1991, si dhe shumë mësimdhënës të tjerë shqiptarë, edhe Latif Berishën, regjimi okupues serb e largoi nga puna. Regjimi i egër serb përveç shtypjes se vazhdueshme ndaj popullatës shqiptare në Kosovë, në shenjestër të vazhdueshme kishte intelektualët dhe shkollën shqipe.

Gjatë viteve të '90-ta, Latif Berisha u angazhua në lëvizjen e intelektualëve dhe të popullit shqiptar për mbrojtjen e çështjes kombëtare.

Kontributi i Latif Berishës në fushën e arsimit, shkencës, kulturës etj, qe shumë i madh. Vepra e tij poetike e shkencore zë vend të rëndësishëm në letërsinë dhe shkencën shqiptare të filologjisë.

Latif Berisha, me gjithë veshtirësitë e asaj kohe, ka botuar vëllimin e parë me poezi "*Tufa*", në vitin 1957, por megjithë atë, ai nuk ndaloi veprimtarinë e tij letrare, duke punuar edhe një numër të madh vështrimesh e studimesh tjera nga fusha e letërsisë.

Studimet dhe vështrimet letrare:

- “Ali Asllani dhe krijimtaria e tij poetike”, (1963),
- “Skënderbeu në poemën Kënga e sprasme e Balës”, (1968),
- “Skënderbeu në disa krijime të letërsisë shqipe në Jugosllavi”, (1968),
- Vepra “Lulet e Verës” dhe disa nga dimensionet e saj kuptimore, (1972),
- Poema “Bagëti e Bujqësi”, (vlera ideoartistike), (1972),
- “Hil Mosi dhe krijimtaria e tij poetike”, (1972),
- “Andria Kaçiq Miošiq dhe shqiptarët”, (1974),
- “Një tufëz vjershash autografe të Zef Serembes”, (1974),
- “Mistifikimi letrar dhe letërsia shqiptare e Rilindjes”, (1976),
- “Jehona e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në katër poezitë e atyre viteve”, botuar në vitin 1978,
- “Zef de Rada”, poet pak i njohur arbëresh”, (1978),
- “Pikëpamjet e Luigj Gurakuqit mbi poezinë”, (1978),
- “Në gjurmë krijuese të Jeronim de Radës”, (1978),
- “Pikëpjekje të Letërsisë së Rilindjes me jetën dhe letërsinë e sllavëve të jugut”, (1982),
- “Poezia e De Radës në suaza botërore”, (1984),
- “Gjendje aktuale e kulturës shqiptare në Kosovë dhe kahet e zhvillimit të saj”, (1995),
- Vepra letrare “Dora d'Istrias, Shqiptarët”, (1995) etj.

Latif Berisha është hartues i dy teksteve shkollore. Kurse, numri tematik "Jeta e re", e marsit të vitit 2000, i kushtohet Latif Berishës.

Latif Berisha ishte në shënjestër të organeve pushtuese serbe që nga vitet e paraluftës, prandaj kur lufta për çlirimin e Kosovës mori hov të madh, më 24 mars 1999, në natën e parë të bombardimeve të forcave të NATO-s mbi caqet serbe, në Mitrovicë, kriminelët serbë e vranë prof. Latif Berishën, në pragun e shtëpisë së tij.

Për kontributin e dhënë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, në vitin 2004, është dekoruar me Medaljen e Artë të Pavarësisë. Ishte anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Pas luftës, biblioteka e qytetit në Mitrovicë e mori emrin e tij, si dhe Shoqata e Shkrimtarëve në Vushtrri mbanë emrin “Latif Berisha”...

LEONORA BRUÇAJ



Prof. Leonora Ibish Bruçaj është e lindur në Istog, më 19. 08. 1973. Studimet Master i mbaroi në Fakultetin e Filologjisë, dega Letërsi Shqipe, drejtimi Shkencor në Universitetin publik “Hasan Prishtina” në Prishtinë.

Diplomoi në kolegjin FAMA, në drejtimin Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, Master.

Është Phd cand.- doktorante e shkencës së Letërsisë Shqipe, në Universitetin e Prishtinës, “Hasan Prishtina” në Prishtinë.

Prof. Leonora Ibish Bruçaj, si poete botoi edhe nëpër revistat letrare të kohës siç ishin: “Pionieri”, “Gep”, “Shëndeti”, “Dielli”, “Kosovarja”, “Zëri i Rinisë”, “Rilindja”, “Bota e Re”, si dhe në revistën “Bashkimi” në Republikën e Shqipërisë.

Në revistën letrare “Jeta e Re” nr. 3, 2013, Prishtinë, ka botuar disa poezi. Leonora Ibish Bruçaj, po ashtu merret edhe me prozë, dhe ka një libër në dorëshkrim. Leonora Ibish Bruçaj poezitë e saja i ka përkthyer edhe në gjuhë të tjera të botës.

Leonora, nga viti 1994-1999 në shtypshkronjën “Grafika Reznici”, asistente administrative. Prej vitit 1999 deri në vitin 2011, ka punuar në UNMIK (Misioni i Kombeve të Bashkuar) në Prishtinë.

Nga viti 2010, dhe deri me tani, punon si profesoreshë në shkollën e gjuhëve të huaja “Cambridge School” dhe njëkohësisht është ligjëruese në Ambasadën Amerikane, UNMIK, KFOR, MPJ, MPB, Gjykatën Kushtetuese dhe institucione të ndryshme.

Është ligjëruese e lëndës “Letërsi e antike” në Universitetin shtetror “Ukshin Hoti” në Prizren.

Veprat:

“Vdekja e Balozit”, Shtëpia Botuese “Rilindja”, Prishtinë, 1993.

“Dhembje e harresës”, Shtëpia Botuese, “Rilindja”, Prishtinë, 1998.

“Brerimë politikash”, prozë, (është në dorëshkrim).

Çmime në letërsi:

Në korrik 2017, certifikohet nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Departamenti për Shkencë dhe Teknologji në Konferencën shkencore “Java e Shkencës” në Prishtinë.

Po ashtu, më 2017 në Konferencën e Dytë Shkencore “Studime

Filologjike”, organizuar shkolla doktorate e Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, merr certifikatë.

“Çmimi i Lidhjes” në manifestimin letrar “Ibrahim Rugova”, në manifestimin letrar “Ibrahim Rugova”.

Në qershor 2019, në manifestimin letrar të poezisë “Pranvera poetike”, të organizuar nga klubi letrar “Martin Camaj në Mynhen, manifestim ky që kishte edhe karakter garues, poetja Bruçaj zë vendin e parë me poezinë “Flas me detin”.

Pastaj, edhe çmimin “Shpërblimi i Jurisë” në Festivalin e VI Tradicional “Promenadë mërgimtare 2019”, i cili u mbajt në Prishtinë.

Në manifestimin “Festa e Plisit të bardhë”, që u mbajt në Tiranë, u nderua me “Çmimin e dytë “për poezinë poemë.

Çmimin “Zëri i Fishtës” për punimin shkencor kushtuar “Homerit Shqiptar”, At Gjergj Fishta.

Në vitin 2019, u shpërblye me “Çmimin Special” Ibrahim Rugova, në konkursin mbarëletrar me çmimin “Ibrahim Rugova”, edicioni i 5-të jubilar me motivacion; Kontribut të vazhdueshëm për realizimin e projekteve dhe tematikave rreth punës dhe veprës letrare të Ibrahim Rugovës.

Në manifestimin letrar “Takimet e Dom Mikelit 2019”, mori Çmimin “Agim Ramadani”, duke zënë vendin e parë me poezinë më të mirë në këtë manifestim, i cili u mbajt në Stubëll.

Certifikatë për pjesëmarrjen në Seminarin XII Ndërkombëtar të Albanologjisë në Prishtinë.

Në gusht 2019 kryen me sukses të plotë “Akademinë Verore për Komunikim Diplomatik, Protokoll dhe Etikë” në Prishtinë.

Certifica of internacional konference on linguistics, literature and kulture-icllc, 2017.

The United Nations Institute For Training and Research Programme of Correspondence Instruction in Peacekeeping Operations-Certificate of Completion-Logistical Support to United Nations Peacekeeping Operations, si dhe çmime e shpërblime tjera.

Leonora me poezitë e saja të thurura mjeshtërisht, kudo që merr pjesë, shpërblehet nga juritë profesionale.

Leonora Bruçaj është anëtare e rregullt e Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, anëtare e Unionit Global të Poetëve Shqiptarë, si dhe nga data 28 tetor 2019 është anëtare e Akademisë së Shkencave Shqiptare Amerikane në New York, Tiranë, Prishtinë dhe Shkup.

LIMAN RUSHITI



Prof. Dr. Liman Rushiti është lindur më 25 qershor të vitit 1942, në fshatin Sazli, komuna e Ferizajt, Kosovë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje dhe shkollën e mesme ekonomike në Ferizaj, viti 1963. Në vitin 1963 shkoi në Prishtinë për të studiuar historinë në Universitetin e Prishtinës, ku edhe diplomoi në vitin 1968.

Në vitin 1975, kreu magistraturën me temën “Rregullimi territorial dhe administrativ i Kosovës 1918-1941”, në Universitetin e Prishtinës. Në po të njëjtin Universitet, ai edhe mbrojti temën e doktoraturës “Lëvizja Kaçake në Kosovë” 1918-1928”, më 25 janar 1980.

Profesor doktor Liman Rushiti, deri më tani ka botuar edhe 4 libra, si dhe është bashkautor i disa librave të tjerë historik e enciklopedik dhe i disa teksteve shkollore.

Autor i librave:

“Lëvizja Kaçake në Kosovë”, botim i Institutit të Historisë, 1981.

“Rrethanat Politiko Shoqërore 1912-1918”, botim i Institutit të Historisë, Prishtinë, 1986.

“Kujtimet për Lëvizjen Kaçake”, Prishtinë, 2003.

“Rregullimi administrativ dhe ndarja territoriale e Kosovës”, 1878-1941, I botuar në Prishtinë, 2004.

Bashkautor i librave:

“Historia e popullit shqiptar”, Tiranë, 2008.

“Enciklopedia e popullit shqiptar” Tiranë, 2005.

“Fjalori enciklopedik i Kosovës”, Prishtinë, 2014.

Profesor doktor Liman Rushiti është edhe pjesëmarrës në shumë kongrese dhe simpoziume në Prishtinë, Tiranë, si dhe në shumë vende të ish-Jugosllavisë, si në Beograd, Zagreb, Sarajevë, etj.

Është autor i mbi 200 punimeve shkencore të botuara në revista të ndryshme shkencore si në Prishtinë, Tiranë, Shkup dhe në disa nga qytet kryesore të ish-Jugosllavisë si në Beograd, Zagreb, Sarajevë, etj.

Profesor doktor Liman Rushtiti është edhe bashkautor i disa teksteve shkollore në Kosovë, deri në vitin 1989.

Profesor doktor Liman Rushiti, në vitin 1981, është avancuar në titullin e lartë shkencor, “Profesor Inordinar”, dhe në vitin 1987, është avancuar në titullin “Profesor Ordinar”.

LISEN BASHKURTI




Prof.Dr. Lisen Bashkurti u lind në qytetin e Shkodrës, në vitin 1957. Në vitin 1980 mbaroi studimet në Akademinë e Arteve Tiranë. Në vitet 1984-1985 përfundoi studimet universitare për marrjen e Gradës Kandidat i Shkencave. Nga viti 1987 deri në vitin 1992, u përfshi tërësisht në jetën politike të vendit. Në fillim të viti 1992 është specializuar me grupin e parë të ambasadorëve, ku jepnin mësim një grup profesorësh nga Ministria e Jashtme gjermane.

Lisen Bashkurti është Doktor Shkencash nga viti 1992 dhe ka titullin akademik Profesor i Asocuar nga viti 2008. Ai gjithashtu mban gradën diplomatike "Ministër Këshilltar" nga viti 2002.

Veprat shkencore:

“Shqiptarët në Rrjedhat e Diplomacisë”, Tiranë, Shqipëri,
“Diplomacia Shqiptare në Fillimet e Luftës së Ftohtë”, Tirane, Shqipëri,
”Diplomacia e Vetëizolimit”, Tiranë, Shqipëri
”Albanian Diplomacy Between the Past and the Future”, Tiranë, Albania,
”Identiteti, Imazhi, Diplomacia”, Tiranë, Shqipëri,
”Political Dynamic Within the Balkan Countries”, Chicago, USA 7,
”Identity, Image, Diplomacy”, Skopje, Macedonia,
”National and European Identity of Albanians”, Tiranë, Albania,
“Diplomacia Shqiptare”, Volumi I, Tiranë, Shqipëri,
”Diplomacia Shqiptare”, Volumi II, Tiranë,
”Diplomacia Shqiptare”, Volumi III, Tiranë, Shqipëri,
”Evropa, Ballkani dhe Sfida e Kosovës”, Tiranë, Shqipëri,
“E Drejta Ndërkombëtare dhe Organizatat Ndërkombëtare”, Tiranë,
“Negociatat – Historia, Teoria, Praktika”,
”Krizat Ndërkombëtare”, Tiranë, Shqipëri,
“International Organizations”, Albania,
”Multilateral Diplomacy and International Organizations”, Macedonia,
”Çamëria - Rruga drejt zgjidhjes”, Shqipëri, 2012,
“Koncerti dhe Funerali-Shqiptaret, Ballkani dhe Fuqitë e mëdha”, 2013,
“Ksenofobie-Muret e Urrejtjes”, Tiranë, 2014,
“Diplomacia-Bazat Teorike” Tiranë, 2015,
“Crumbled Bridges of the Balkans”, Published in USA, October, 2016. Etj
Lisen Bashkurti ka shkruar gjithashtu mbi 650 artikuj, studime dhe ese...

LUIGJ GURAKUQI (1879-1925)



Luigj Gurakuqi u lind më 20 shkurt 1879. Shkollën fillore e të mesme i ndoqi në kolegjin Saverian, më 1897.

E plotësoi arsimin e mesëm në kolegjin arbëresh e Shën-Mitër Koronës, ku pati mësues De Radën. Diplomën e pjekurisë e merr me meritë në Kozencë.

Vijoi studimet universitare në Napoli në Fakultetin e Mjekësisë në vitet 1901-1906.

Në korrik të vitit 1908 kthehet në Shkodër. Në nëntor të po atij viti, merr pjesë në Kongresin e Manastirit, ku u zgjodh nënkryetar dhe anëtar i komisionit, për njësimin e alfabetit. Bashkë me Fishtën ishte përfaqësues i "Bashkimi-t". Me Logorecin kishin mandat të përfaqësonin inteligjencën shkodrane.

Shkroi alfabetet e miratuar nga Kongresi i Manastirit dhe i zbuloi para delegatëve. Në tetor të vitit 1909 u emërua drejtor i Normales që u hap në Elbasan.

Në prill të vitit 1911 merr pjesë në kryengritjen e mbi Shkodrës, kurse së bashku me Ismail Qemalin hartoi Memorandumin e Gretës. Ishte bashkudhëtar i Ismail Qemalit, dhe në vitin 1912 bashkë me të në Vlorë, mbërritën më 27 nëntor.

Në Qeverinë e Përkohshme të Vlorës u zgjodh ministër i Arsimit dhe vendosi arsimimin e detyruar fillor për djem e vajza. Merr pjesë në Konferencën e Londrës më 1913, me Ismail Qemalin e Isa Boletinin.

Në Luftën e dytë Botërore Shkodra pushtohet nga ushtria malazeze. Luigj Gurakuqi internohet në Podgoricë, nga 17 korriku i vitit 1915 deri në janar të vitit 1916.

Gjatë viteve 1921/1924 u zgjodh deputet i Shkodrës në Këshillin Kombëtar. Më 5 mars 1924 u sëmur rëndë nga një grip.

Mbrëmjen e 2 marsit 1925, në restorantin e hotelit "Cavour", Luigj Gurakuqi u qëllua me tre plumba. Më 1957 eshtrat e tij u rivarrosën në Shqipëri.

Veprat:

I përpirë nga fryma e Lidhjes së Prizrenit dhe idetë nacionaliste vjershën e parë e ka shkruar 13 vjeç. Nis shkrimet me pseudonimet *Marosh Ujka*, *Jakin Shkodra*, *Lek Gruda*, *Pjetri dhe Pali*, *Hamidi*.

Me veprën "*Vargënimi n'gjuhë shqype me një fjalorth shqyp-frengjisht*"

n'marim" botuar në Napoli më 1906, bëri të parën përpjekje të suksesshme për kodifikimin e metrikës së poezisë shqiptare.

Po atë vit botoi në Bukuresht librin "*Abetar i vogël shqyp mas abevet t'Bashkimit e t'Stambollit me tregime n'dy dhialektet*" e në Napoli "*Fjalorth Shqyp-Frengjisht e Frengjisht-Shqyp i fjalëve të reja*", etj.

Sa i përket vokacionit të tij të gjuhës shqipe, Atë Justin Rrota thotë: "*gjuhën shqype e njofti mâ mirë e mâ këthelltë se çdo shqyptâr*".

I dha shkollës shqipe, si autor e bashkautor, 8 tekste mësimore, me një vëllim prej 738 faqesh. Ka merita të shquara në zhvillimin e gjuhës letrare shqipe, në përpunimin e gjuhës letrare dhe në njësimin e shqipes së shkruar, në stabilizimin e drejtshkrimit, në pasurimin e fjalorit, në çështjet e leksikologjisë, terminologjisë e të gramatologjisë.

Gurakuqi ishte tekstologu më i shquar shqiptar i fillimit të shekullit tonë. Parashtrroi në parlamentin shqiptar ide dhe mendime për politikën arsimore dhe rrugën që duhet të ndiqte shkolla shqiptare.

Luigj Gurakuqi ishte njohës i thellë i trashëgimisë kulturore të popullit të vet dhe i kulturës klasike romake e latine. Historia e vendit dhe ajo botërore ishin objekt i përhershëm i studimeve të tija. Njihte arkeologjinë, shkencat ekonomike e financiare, trashëgiminë arsimore pedagogjike kombëtare dhe evropiane. Gurakuqi ishte poliglot.

Përveç shqipes zotëronte latinishten, italishten, turqishten dhe frëngjishten, njihte greqishten e gjermanishten ka të ngjarë edhe anglishten dhe kishte një kujtesë të çuditshme.

Është ndër hartuesit kryesorë të programit arsimor e kulturor të lëvizjes kombëtare për autonomi, liri e pavarësi. Në këtë kuadër ai ishte njohësi dhe propaganduesi më i mirë i traditave të popullit tonë, i traditave kulturore e patriotike, i traditës gojore e shkrimore dhe i psikologjisë së popullit shqiptar.

Si krijues Luigj Gurakuqi pati marrëdhënie të shkëlqyera me elitën intelektuale të vendit.

Disa nga veprat e krijimit e veta, Luigj Gurakuqi ia kushtoi Gjergj Fishtës, Prenk Doçit, Hil Mosit e Mati Logorecit. Por edhe Gurakuqit i drejtohen mjaft dedikime e përkushtime nga Filip Shiroka dhe Hil Mosi, i cili edhe e quajti bylbyl në tingëllimin që i kushton, "*S'kndôn bylbyli*".

Kurse poeti i madh Gjergj Fishta, ndër veprat e tij të njohura dhe të shumëlexuara i dedikon Luigj Gurakuqit veprën "*Pika e voeset*".

Gurakuqi deri në fund të jetës s'ndaloi veprimtarinë e tij atdhetare...

LULE ALIDEMA



Lule (Alisahit) Alidema u lind në Shkup, në vitin 1972. Ajo si fëmijë u transferua me prindër në vendlindjen e babait të saj në Kosovë, ku edhe e kreu shkollën fillore dhe të mesmen.

Studimet i kreu në Prishtinë në Departamentin e Psikologjisë, nivelin Bachelor dhe Master.

Është e licencuar “Psikologe klinike”, nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës. Ajo e ushtron profesionin e saj psikologe klinike në poliklinikën "Shëndeti im", në Prishtinë.

Gjatë luftës në Kosovë, ajo emigroi në Paris të Francës, duke zhvilluar profesionin e saj në testimin e fëmijëve kosovar, si dhe për ndihmën e shumë familjeve dhe fëmijëve në nevojë, që ishin të traumatizuar nga lufta. Pavarësisht ofertave që asaj ia bënë francezët, ajo u kthye në Kosovë për t'i dalë në ndihmë popullit të saj. Tash e dy decenie i shëron me fjalë personat me stresa postraumatike të fituara nga lufta.

Gjithashtu, ajo ka ndihmuar dhe iu ndihmon qifteve bashkëshortorë që kanë probleme familjare, probleme psiko-sociale, fëmijëve të moshave të ndryshme që kanë probleme të ndryshme (asociale dhe psikologjike etj).


Një kohë ajo punoi si mësimdhënëse e psikologjisë në gjimnazin “Xhevdet Doda”, në Prishtinë, ndërsa tash punon si psikologe klinike në poliklinikën “Shëndeti im“, në Prishtinë. Ajo i udhëzon dhe iu ndihmon të sëmurit, i vlerëson ata për aftësi psiko-fizike, mbanë seanca psikologjike me adoleshentë dhe më të rritur etj.

Qëllimi i saj në karrierë është t'i edukojë të rinjtë me shkrime, si dhe më udhëzime psikologjike rreth preokupimeve të tyre në kushte aktuale, duke shtjelluar tema të ndryshme nga psikologjia .

Publikime nga psikologjia klinike, psikologjia sociale:

1. “Disa teknika rreth menaxhimit të stresit”
2. “Kemi apo nuk kemi vetëbesim”
3. “Të priremi nga mendimi pozitiv”
4. “Që të mos zhgënjeheni, uleni pritshmërinë”
5. “A ja vlen të zemërohemi e të mbajmë inat”
6. “Të nisesh nga vetja nuk do gabosh kurrë”
7. “Roli dhe rëndësia e të qënurit gjysh”
8. “Adoleshenca dhe çrregullimet e saj”
9. “Sjelljet agresive të nxënësve adoleshentë në shkollë”, etj.

LUSH GJERGJI



Dr. dom Lush Gjergji, prift katolik shqiptar, i Ipushkvisë Shkup-Prizren, u lind më 21 mars të vitit 1949 në Stubëll të Epërme të Karadakut, komuna e Vitisë.

Lushi i vogël, zuri të dallohej në mes shokëve bashkëmohatarë për urtësi, bujari, zgjuarësi e devotshmëri. Katër vitet e para të shkollës fillore i mori në vendlindje.

Mësonte mirë e me rregull, ndonëse në shtëpi nuk kishte kushte të përshtatshme. Studionte mbi një sofër druri karakteristike, që i shërbente si një tryezë për të përgatitur mësimet dhe më pas pjesëtarët e familjes shtronin sofrën për miqtë e shumtë.

Stubulla e Epërme, ka ngjarje që ruhen thellë në kujtesën e historisë nacionale e fetare të këtyre trevave, ku, kulmojnë ndër të tjera edhe martirët që e falën jetën e tyre, në shërbim të krishtërimit (mbi të cilët sot ekzistojnë edhe libra studimorë, të realizuar nga autorë shqiptarë, në formë monografie me fakte e të dhëna të pasura me ndodhitë e historisë). Këtu ruhen me dashuri, ende si jehonë të shekujve, që kanë kaluar afresket e kishës plot kolorit të gjallë, që shfaqen hijshëm nëpër faqet e murale të objektit të kultit, të cilat, me stoicizëm i kanë rezistuar erërave të furishme të historisë që ka përjetuar kisha. Këtu meshtari i ardhshëm lutej dhe vetëm lutej, për vete dhe të tjerët. Ai, do të kujtojë me mall ceremoninë e bukur të krezmimit të tij. Përsëri vitin e pestë, vocrraku që hidhte shtat, do të vijojë çdo ditë shkollën e Vitisë. Ndërsa, tre vjetët e fundit, nga klasa e pestë deri në të tetën i ndjek në shkollën e fshatit Zhegër. Lushi vijon studimet në gjimnazin klasik në Dubrovnik, ku vitin e parë gjendet si student në degën e filozofisë pranë qytetit të Splitit, kurse vitet e tjera të filozofisë, nisat për t'i ndjekur në Romë, ku më pas mbron magjistraturën me temë: "Pavdekshmëria e shpirtit në Plotinon", në vitin 1970. I etur për të zgjeruar dhe thelluar dijet, me të cilat nuk kënaqej asnjëherë, përsëri në Itali, vijon studimet e arrin të marrë diplomën e teologjisë, pranë Universitetit Papnor të Urbanias ose siç njihet "Propaganda Fide" në Romë. Paralelisht me studimet e larta universitare të filozofisë e teologjisë, ka bërë pronë të tij asimilimin e plotë të studimeve universitare dhe pasuniversitare në Institutin e Psikologjisë në Universitetin Shtetëror "La Sapienza" të Romës, ku ka doktoruar në vitin 1975, duke mbrojtur temën e disertacionit: "Gruaja shqiptare".

Sipas vlerësuesve profesorë laikë dhe klerikë të famshëm në Itali, që kanë asistuar në këtë eveniment shkencor, theksohet, se punimi i autorit shqiptar shquhet për një trajtim korrekt dhe serioz, e pasur me argumente logjike dhe burime të larmishme shkencore shqiptare e botërore në fushën e psikologjisë shoqërore.

Dr. Gjergji, ka preferuar të rrokë temën e ndjeshme të një forcë të shoqërisë shqiptare: "Roli i femrës shqiptare në familje dhe shoqëri", të cilin e botoi dhe ribotoi si vepër të veçantë. Shtypi i kohës, i ka kushtuar një kujdes të veçantë në shumë rrafshë. Në veçanti shquhet një artikull vlerësues, konceptuar me kulturë nga studiuesi i letërsisë shqipe prof. Isak Ahmeti, ku midis të tjerave e ka cilësuar këtë vepër, si "... hap i guximshëm prometik në lëmin përkatës" ("Drita", 3 maj 1978).

Në vitin 1975, pasi përfundon me sukses doktoratën, kthehet në Kosovë, duke mbartur me vete një kulturë të shëndoshë, i pajisur me cilësi të lartë morale, fetare, shoqërore e patriotike. Ai bëhet një përkushtues deri në ditët tona i interesave të larta të devocionit të fesë dhe të nacionit shqiptar. Ai, është i njohur, jo vetëm si prift i thjeshtë por mbi të gjitha si një njeri me botë të madhe njerëzore, duke vënë të gjithë talentin e tij intelektual dhe njerëzor, vetëm për të mirën e popullit e vendit të tij.

Me erudicion, më përpara dhe tashti, diti me mjeshtëri, të ndërthurë e kanalizojë interesat nacionale, shoqërore të popullit tonë, me nevojat e brendshme shpirtërore të tij. Edhe në ditët tona shpesh porositë, se: "*Në mënyrë graduale duhet të vijë ripërtëritja e qëndrueshme ose rindërtimi i shpirtit të njeriut veçanërisht për Shqipërinë, duke e shëruar nga plagët e thella, të shkaktuar nga konflikti me sistemin dogmatik ateist, i cili për pasojë solli edhe rënien e kulturës...*".

Pra, ai shquhet, për një aktivitet të ngjeshur të jetës në Kosovë, ku angazhimi shoqëror dhe atdhetar zinin peshë të dukshme. I palodhur u gjend në të gjitha tubimet, ku printe flamuri nacional, duke i paraprirë misionit fisnik për pajtimin e gjaqeve, përkrah profesorit të nderuar Anton Çettës. Aksioma udhëheqëse e këtij akti sublim popullor, për rëndësinë që po merrte për dr. dom Lush Gjergjin ishte e shkruar në ndërgjegjen e zemrës së tij: "*Ne më parë duhet të shërojmë plagët tona, pastaj t'i kthemi vetvetes*". Në ato çaste, kur gjakmarrja përmes normave kanunore të maleve ishte kthyer në një plagë, u gjend me Kryqin në dorë dhe Biblën si fitimtare tash 2000 vjet, meshtari i matur e i urtë, në realizimin me sukses të misioneve pajtimtare, dom Lush Gjergji.

Viti 1990, shënoi një ngjarje të rëndësishme për popullin shqiptar në Kosovë, ku, merr jetë themelimi i Shoqatës Humanitare me emërimin e një shenjtojeje, me emrin "Nënë Tereza", në krye të së cilës u zgjodh si kryetar dr. dom Lush Gjergji. Ai, pa kursim, por me vullnet të madh mori pjesë në hartimin e programit dhe të statutit të kësaj Shoqate. Mirëpo, ajo që e dallon këtë meshtar, është thjeshtësia si virtyt cilësor i dr. Gjergjit. Ai shprehet: "E kam parasysh një thënie të vjetër të Pjetër Bogdanit: *"Fati i popullit tim është edhe i imi, prandaj në çdo formë organizimi, që ka për bazë mirësinë ndaj popullit tim, kam ofruar mundësitë e mia organizative dhe krijuese"*.

Si intelektual, është kërkues drejt horizonteve të reja të kulturës shqiptare e botërore, duke i dhuruar njerëzimit 7 vepra të Nënë Terezës, me shifra astronomike me tirazh 4 milion kopje, sikurse është "Madre della carita" (Nëna e mëshirës). Ky biograf e studiues i afërt i jetës së Gonxhe Bojaxhiut, u bë motoja e jetës së tij, krahas detyrës baritore të përditshme, me arsyen e parë për t'i treguar mbarë botës, se kush janë shqiptarët që Shkrimi i Shenjtë i Biblës i përmend me krenari tash 2000 vjet, për t'i përcjellë botës, se kjo Nënë e vogël, shpirtërisht kishte një zemër të madhe, sa mbarë bota. Meshtari e publicisti, mbrojti me stoicizëm identitetin shqiptar të Nënë Terezës, ndonëse në kohën që kishte botuar librin biografik "Nëna jonë Terezë", shtypi i atëhershëm jugosllav, kishte mbushur faqet e gazetave me pretendimin, se ajo është jugosllave. Ishte pikërisht serioziteti dhe ofrimi i fakteve autentike që studiuesi i palodhur Dr. dom Lush Gjergji i ka bërë kësaj figure madhore të njerëzimit. Më pas media e shtypi i huaj, ka marrë si pikë referimi shkrime nga jeta e Nënë Terezës, duke u mbështetur në veçanti nga burimet origjinale të hulumtuesit Dr. Lush Gjergji. Kështu, vetëm libri "Nëna jonë Terezë" në fillim u botua në gjuhën amtare, më pas u botua me sukses edhe në 9 gjuhë të botës, si: anglisht, italisht, gjermanisht, portugalisht, spanjisht, frëngjisht, sllovenisht, hungarisht dhe kroatisht.

"Lule për Nënë", është libri ekskluziv, që u botua në shqip dhe italisht, e kohët e fundit edhe në gjuhët e tjera. Këtu përmbledhen kontribute arti, që në këtë rast i kushtohen Nënë Terezës. Ndërsa në 80 vjetorin e lindjes së saj, autori nxjerrë botimin e librit me titull domethënës: "Madre Tereza" (1990), mbasi u botua në shqip, u përkthye në: italisht, frëngjisht, anglisht, spanjisht, gjermanisht e polonisht.

Libri i ri, është një publikim i rrallë, i veçantë, duke rrezatuar e vendosur një urë afrimi mes botës shqiptare me atë humanitare amtare, të

mishëruar në pedestal, përmes Nënë Terezës, si shembull përsosshmërie në tërë botën. Ajo, si vepër, ka arritur në një shifër rekord në 4 milion kopje.

Intelektuali dr. Gjergji, njihet për libra të tjerë: "Kosova, strategji pa dhunë", botuar në italisht më 1993, dhe ribotuar disa herë në vit.

Është rast i vetëm, që një autor shqiptar me librin në fjalë shërben si literaturë plotësuese e informuese për shkollat e mesme në Itali.

Libri tjetër që ka zgjuar shumë interesimin e botës evropiane është "Bosnje, s'mund të na detyroni t'ju urrejmë".

Dr. dom Lush Gjergji ka shkruar një libër tjetër: "Të falem për të jetuar", dhe në vitin 1997 është botuar në italisht. Ngjarjet, i ka marrë nga jeta e përditshme e bashkëatdhetarëve në Kosovë, që zë fill në pjesën më të madhe të vitit 1981. Ai për shumë vite me radhë ka qenë redaktor dhe kryeredaktor i revistës fetare-kulturore "Drita", si dhe i Shtëpisë Botuese me të njëjtin emër në Ferizaj.

Në botë emri dhe vepra e tij, veç shkrimeve origjinale (në gjuhë të huaj), ka pasur nderin të jetë edhe bashkëpunëtorë i shumë revistave kombëtare dhe ndërkombëtare, veçmas me punime dhe studime rreth edukimit të fëmijëve dhe rinisë, studiues e analist i kujdesshëm bashkëkohorë i çështjeve familjare-shoqërore.

Është bashkëpunëtor i revistës së njohur kulturore-rinore "Shpresa" në Prishtinë.

Dr. dom Lush Gjergji, është një "fabrikë", që prodhon përherë me cilësi për fenë e nacionin, dhe së shpejti do të prezantohet me vepra të reja, që prej vitesh i ka në dorëshkrim, për të cilat janë të interesuar shumë shtëpi botuese prestigjioze në Evropë, SHBA dhe madje edhe një shtëpi botuese serbe në Beograd.

Dom Lush Gjergji është një autor shqiptar dhe dijetar i njohur gjerësisht nga e gjithë bota si biograf i librave të të Shejtës Terezë.

Librat e tij janë përkthyer në 35 gjuhë të huaja. Ai thotë se bekimi i Zotit është një burim gëzimi për shqiptarët e të gjitha besimeve.

Don Lush Gjergji njoftohet se mori titullin "Monsinjon", nga Papa Françesku. Këtë titull ia kumtoi në Katedralen në Prishtinë, delegati i Papës për Kosovën, duke thënë se: "Monsinjori Lush Gjergji tani i përket të ashtuquajturës familjes Papnore. Ju Monsinjon jeni formuar në shkollën e Shën Terezës". Me këtë rast, Delegati Apostolik Sh. T. Imzot Juliusz Januzs do të shpallë zyrtarisht edhe emërimin e Don Lush Gjergjit, Kapelan i Shenjtërisë së Tij Papa Françeskut, që nënkupton titullin Monsinjon...

MAHMUD HYSA (1834-2016)



Prof. Mahmud Hysa, u lind në Dibër, më 1934. U shkollua në Dibër, Tiranë dhe Tetovë. Studimet i kreu në Fakultetin Filologjik në Beograd. Pas një pune disavjeçare në gjimnazin e Dibrës, ku kishte lindur, një kohë punoi në arsimin e Maqedonisë, në Akademinë Pedagogjike në Shkup, pastaj u zgjodh profesor në Universitetin e Prishtinës, në degën Letërsi e gjuhë shqipe. Në Fakultetin Filologjik, dega e letërsisë shqiptare në Tetovë, ai ishte një ndër profesorët e parë gjatë themelimit të Universitetit Shtetëror të Tetovës, ku ka ligjëruar historinë e letërsisë. Ai është autor i shumë librave dhe botimeve shkencore nga kjo fushë.

Është autor i një numri të madh veprash me rëndësi për historinë e letërsisë dhe të kulturës shqiptare. Ndër të tjera ka shkruar: “*Alamiada shqiptare; Kongresi i Dibrës 1909-2004*”.

Është autor i teksteve nga letërsia e vjetër shqiptare; I veprës *Andon Zako Çajupi (Jeta dhe veprat)*; *I Gjurmëve të letërsisë arbëreshe*; *Letërsia* (me shembuj) i tekstit për kl. I të shkollave të mesme, bashkautor me Xhevat Gega, dhe e një varg veprash të tjera.

Në kohë të fundit, posaçërisht u mor me krijimtarinë letrare të Ibrahim Kadriut.

Profesori Hysa ishte aktiv me shkrimet e tij në shtypin ditor në Prishtinë dhe Shkup, deri në ditët e fundit të jetës së tij. Ishte fitues i çmimit për vitin 2015, i Ministrisë së Kulturës të Maqedonisë.

Prof. Dr. Mahmud Hysa vdiq më 19 mars 2016, në Prishtinë, dhe u varros në vendlindjen e tij në Dibër.

Vepra shkencore:

“Letrari dhe vepra”, Shkup, 1972

“Gjurmëve të letërsisë arbëreshe”, Shkup, 1978

“Anton Zako Çajupi”, monografi, Prishtinë, 1983

“Krestomaci e letërsisë së vjetër shqiptare”, Prishtinë, 1987

“Autorë dhe tekste nga letërsia e vjetër shqiptare”, I, Shkup, 1995

“Said Ajdeni - Hoxhë Voka”, Michigan, USA, 1992

“Autorë dhe tekste nga letërsia e vjetër shqiptare”, II, Shkup, 1995

“Shtjellime letrare”, Tetovë, 1996

“Almaida shqiptare”, I, Shkup, 1997, si dhe shumë vepra tjera.

MAJLINDA KELMENDI



Majlinda Kelmendi u lind më 9 maj 1991, është një xhudiste shqiptare nga Peja, Kosovë. Kelmendi filloi të praktikonte artin e xhudos në vitin 1999, në qytetin e saj. Trajneri i saj aktual është Driton Kuka. Në vitin 2009, Kelmendi fitoi medaljen e artë në Kampionatin Botëror për të rinj në Paris, Francë.

Në vitin 2010, ajo arriti vendin e 5-të në Kampionatin Botëror për të rinj në Maroko dhe përfundoi e 9-a në kategorinë 52 kg në World Judo 2010 Championships në Tokio, Japoni.

Në Kampionatin Botëror të Xhudos 2013, Kelmendi i dha Kosovës titullin e parë botëror në xhudo, kur ajo mundi kandidaten e Brazilit Erika Miranda në ndeshjen e -52 kg për medaljen e artë në Rio de Janeiro.

Fitorja e 22 vjeçarës, e cila ishte kosovarja e parë lojtare e xhudos, që fiton një medalje në një kampionat që prej Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, në 2008-ën, nuk ishte një fitore e papritur, pasi Kelmendi erdhi në Rio de Janeiro e renditur si "numri një" në kategorinë e saj, pasi kishte fituar ndeshjen prestigjioze të Masterave.

Në vitin 2009, Kelmendi fitoi medaljen e artë në Kampionatin Botëror për të rinj në Paris, Francë.

Kelmendi ruajti titullin botëror, në 2014-ën. Ajo humbi vetëm dy herë, në 2013-ën dhe kishte arritur t'i mundte të gjithë në përballjet e tjera.

Ajo nuk arriti ta mbronte titullin e saj vitin pasardhës për shkak të një lëndimi.

Në vitin 2014, Majlinda u shpall xhudistja më e mirë në botë në të gjitha kategoritë nga presidenti i FNXH, Marius Vizer .

Më 24 dhjetor 2014, ajo u dekorua nga Presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga me titullin "Medalja Presidenciale e Meritave".

Në shkurt të 2016-ës, ajo fitoi medaljen e artë në Grand Slam Paris, duke e bërë këtë titullin e tretë radhazi, pasi kishte fituar të gjitha garat në vitin 2014 dhe në vitin 2015.

Dy muaj më vonë, ajo fitoi një medalje të artë në Kampionatin Evropian të Judos në Kazan, Rusi.

Në Lojërat Olimpikë 2016, ajo u bë atletja e parë kosovare, që fitoi një medalje të artë, ose edhe thjeshtë një medalje, për Kosovën në Lojërat Olimpikë.

Kontradiktat u ngritën kur raportet shfaqën se, Majlinda nuk kishte pranuar të bënte një test kontrolli të dopingut në qershor, në Francë, trajneri i saj insistoi se ajo ishte e pastër dhe refuzimi kishte ardhur si pasojë e faktit, që testuesi nuk kishte pasur një formë autorizimi nga WADA.

Sukseset në Lojërat Olimpike:

Medalja e Artë, Lojërat Olimpike Rio de Janeiro, Brazil, 2016,

Kampionati botëror:

World Championships Rio de Janeiro, 2013,

World Championships Chelyabinsk, 2014.

Lojërat Evropiane:

European Games Minsk, 2019.

Kampionati Evropian:

European Championships Budapest, 2013, (Vendin e tretë),

European Championships Montpellier, 2014,

European Championships, Kazan, 2016,

European Championships, Warsaw, 2017,

Grand Prix:

Grand Prix Abu Dhabi, 2012,

Grand Prix Samsun, 2013,

Grand Prix Dusseldorf, 2013,

Grand Prix Samsun, 2014,

Grand Prix Budapest, 2014,

Grand Prix Budapest, 2016,

Grand Prix Tashkent, 2018,

Grand Prix Dusseldorf, 2019,

Grand Prix Tel Aviv, 2019.

Grand Slam:

Grand Slam Abu Dhabi, 2014,

Grand Slam Paris, 2014,

Grand Slam Paris, 2015,

Grand Slam Paris, 2016,

Grand Slam Paris, 2017.

World Cup:

World Cup Istanbul, 2012,

World Cup Rome, 2012,

Masters:

Masters Tyumen, 2013. etj.

MARGARITA XHEPA



Margarita Xhepa, u lind më 2 prill të vitit 1932, në Lushnjë. Në maj 2004 u rikthye në skenën e Teatrit Kombëtar, për të shkëlqyer në dramën "Streha e të harruarve", një tjetër sukses në karrierën e saj 50-vjeçare.

Në mbarim të shkollës shtatëvjeçare Margarita Prifti do të dërgohej në Liceun Artistik "Jordan Misja" në Tiranë, në degën e dramës.

Në vitin 1950, kur ishte vetëm tetëmbëdhjetë vjeçe, nxënësja lushnjare e Liceut Artistik "Jordan Misja" do të ftohet të ishte pjesë e trupës

së Teatrit Popullor, sot e Teatrit Kombëtar.

Në vitin 1951 pat dalë për herë të parë në skenën e Teatrit Popullor. I qe besuar të luante rolin e shërbyeses, në një dramë ruse me titullin "Makar Dubrov".

Më vonë, është shfaqur në rolin e Majlindës te drama "Majlinda" e Xhemal Brojës.

Artiditja e Popullit, Margarita Xhepa-Nderi i Kombit, ka krijuar mbi 150 role në teatër, midis të cilëve do t'i përmendim: Majlinden tek "Majlinda" (Xh. Broja), Dafina tek "Lumi i vdekur" (dramatizuar nga K. Veçla i romanit me të njëjtin titull të Jakov Xoxës, Filja tek "Cuca e Maleve (Loni Papa), Zonja Mëmë tek "Kush e solli Doruntinën" (dramatizim nga Edmond Budina e Pirro Mani i romanit me të njëjtin titull të Ismail Kadaresë, Nëna tek "Përballë vetes" (Ruzhdi Pulaha) e role tjera.

Ka qenë njësoj e suksesshme në rolet e dramaturgjisë botërore, si Ofelia tek "Hamleti", Vajza e dytë tek "Mbreti Lir", Dado tek "Romeo e Xhulieta", Mbretëresha Margaret tek "Rikardi i III", të Shekspir.

Në rolet e tjera nga dramaturgjia botërore spikasin këto suksese Klea tek "Dhelpra dhe rrushtë" (Figereido), Lena tek "Xhaxha Vanja" (Çehov), Ledi Milford tek "Luiza Miler" (Shiler), Zonja Berling tek "Vizita e inspektorit" (Pristli), Zonja Lomen tek "Vdekja e një komisioneri" (A. Miller), Ana Andrejevna tek "Revizori" (Gogol), Marsela tek "Qeni i kopshtarit" (De Vega), Mashenka tek "Mashenka" (Afigenov), Shejla tek "Morali i zonjes Dulska" (Zapolska), apo Dado tek "Elektra" e Sofokliut, nën drejtimin e regjisorit grek Dhimitri Mavriqis, në Teatrin Kombëtar të Greqisë, në Athinë. Margarita Xhepa ka interpretuar edhe shumë role tjera në teatrot më të njohur të Shqipërisë.

Veç roleve në teatër, ka realizuar edhe 32 role në kinematografi, duke punuar me shumicën e regjisorëve shqiptarë. Me K. Dhamon xhiron “Vitet e para” dhe “Gjurmët” me I. Muçajn e K. Mitron “Dimri i fundit”, “Tokë e përgjakur”, “Një djalë edhe një vajzë” dhe “Apasionata”, me Viktor Gjiken, “Gjeneral gramafoni”, me E. Musliun, “Rrethi i kujtesës” dhe “Vitet e pritjes”, me Kujtim Çashkun, “Dora e ngrohtë”, me Dhimitër Anagnostin, “Gurët e shtëpisë sime”, me P. Milkanin, “Pranvera s’erdhi vetëm”, me Saimir Kumbaron, “Koncert në vitin 1936”, me Gj. Xhuvanin, “E diela e fundit” dhe “I dashur armik”.

Në vitin 1997 interpretoi ne filmin grek "Mirupafshim" (regjisor J. Koras, K. Vupuras). Filmi u laureua me Çmimin e Madh në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit Mesdhetar në Selanik, ndërsa Margarita Xhepa, u nderua me Çmimin e Nderit.

Filmografia:

- Kronikë provinciale, (2009)
- Ne dhe Lenini, (2008)
- I dashuri armik, (2004)
- Mirupafshim, (1997)
- E diela e fundit, (1993)
- Një djalë edhe një vajzë, (1990)
- Vitet e pritjes, (1990)
- Kush e solli Doruntinën, (1989)
- Pesha e kohës, (1988)
- Pranvera s’erdhi vetëm, (1988)
- Misioni përtej detit, (1988)
- Rrethi i kujtesës”, (1987)
- Fillim i vështir, (1986_
- Gabimi, (1986)
- Gurët e shtëpisë sime, (1985)
- Militanti, (1984)
- Apasionanti, (1983)
- Dora e ngrohtë, (1983)
- Shokët, (1982), etj.

Artistja e popullit Margarita Xhepa është e dekoruar Nderi i kombit, si dhe është shpërblyer edhe shumë çmime e shpërblime tjera kombëtare e ndërkombëtare për realizimin e suksesshëm të roleve, që i janë besuar, nga regjisorë të njohur të teatrit dhe të kinematografisë...

MARIN MEMA



Marin Mema u lind më 22 mars 1981, në Tiranë, është gazetar shqiptar. Marini punon për televizionin “Top Channel” dhe gazetën shqip.

Mema rrjedh nga një familje me prejardhje nga Kolonja. Më 1999, pasi kreu shkollën e mesme të gjuhëve të huaja "Asim Vokshi" në Tiranë, u regjistrua për degën e gazetarisë në Universitetin e Tiranës. Mema u diplomua për gazetari në korrik të vitit 2003, pranë departamentit të gazetarisë të UT-së. Është gjithashtu titullar i një masteri për shkencë politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare, që e mori më 2008, pas studimeve në Shkollën Shqiptare të Studimeve Politike, që sot njihet si Akademia e Studimeve Politike. Mema, gjatë viteve 2009-2016, ishte realizues i ciklit të reportazheve "Shqipëria Tjetër", që transmetoheshin në Top Channel dhe “Top News”. Marin Mema realizoi gjithashtu një sërë dokumentarësh, si "Shqiptonjat kufitare" (për shqiptarët në Sanxhakun e Serbisë), "Gjurmët e historisë" (për zonat dhe fshatrat e shqiptarëve në Bellkamen, Negovan, Follorinë dhe Kostur, "Çamëria, përse kanë frikë grekët" (jeta e sotme në këto zona dhe gjurmët që nuk janë shuar), "Manastiri në Maqedoni" dhe më tej kanë qenë në fokus të dokumentarëve dhe reportazheve.

Në gusht 2012 është shpallur "non grata" nga Republika e Greqisë me akuzën për kërcënim të sigurisë kombëtare dhe rendit publik. Kjo erdhi pas disa emisioneve të realizuara në zona të ndryshme të Çamërisë. Në vitin 2015, Mema filloi me realizimin e një cikli dokumentarësh, që mban emrin "Gjurmë Shqiptare", po ashtu në “Top Channel” dhe “Top News”. Në prill 2016 gjatë realizimit të një dokumentari ndalohet nga forcat speciale maqedonase në Shkup dhe mbahet në komisariatit qendror të qytetit për mbi gjashtë orë. Ka botuar disa vepra letrare: "Qetësi shurdhuese", roman dhe "Çmenduria e Fundit", përmbledhje me poezi, 2004.

Çmime dhe nderime:

Çmimi i parë për reportazhin "Avokatët e Djallit", i shpallur si reportazhi më i mirë investigativ mbi vetëvrasjen e fëmijëve në Shqipëri, 2005, Reporteri më i mirë 2011-2012 (nga Akademia e Pavarur e Audiencës), Një nga 10 personalitetet e vitit 2012 (zgjedhur nga revista "Klan"), 2012, Ambasador i "Vullnetit të mirë" për diversitetin kulturor, PNUD, 2013, Gazetari më i mirë i vitit 2014, nga Unioni i Gazetarëve Shqiptare, etj.

MARJAN DEMA



Prof. Marjan Dema, u lind më 27 maj 1957, në Klinë, Kosovë. Ka përfunduar Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës.

Prof. Marjan Dema është magjistër i shkencave matematike nga viti 1984, me temën "Disa veçori të interpolimit të funksioneve analitike në hapësira të Hilbertit" dhe doktor i shkencave matematike në vitin 1987, me tezë "Interpolimi i shumëfishtë në hapësirat Hp pa konditën e Karlesonit", nga Universiteti i Prishtinës.

Marjan Dema ka filluar karrierën në Departamentin e Matematikës të FSHMN-së në vitin 1980.

Në vitet e nëntëdhjeta është transferuar në Fakultetin Ekonomik, ku ka ushtruar edhe detyrën e prodekanit, ndërsa me të shpërthyer lufta në Kosovë, është larguar me familje në SHBA, ku ka qëndruar deri pas përfundimit të luftës në vitin 2005.

Atëherë është kthyer për një kohë në Departamentin e Matematikës, ndërsa në vitin 2007 ka vazhduar karrierën në FIEK. Po atë vit është zgjedhur prorektor i Universitetit të Prishtinës, në kohën kur rektor ka qenë Prof. Dr. Enver Hasani.

Në periudhën 2009-2012 shërbeu si anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës.

Në mars 2016 ai u emërua rektor i Universitetit të Prishtinës.

Publikimet shkencore:

1. Marjan Dema. "Certain Inequalities for (-Convex functions", International Journal of Mathematical Archive-2(12), 2011.
2. Muje Gjonbalaj, Marjan Dema, Iliriana Miftari, "The Role of Statistics in Kosovo. Enterprises, Journal of Applied Quantitative Methods, Vol. 4, No. 3 Fall 2008.
3. Xhevat Z. Krasniqi, Huseyin Bor, Naim L. Braha edhe Marjan Dema, "On Absolute Matrix Summability of Orthogonal Series", Int. Journal of Math. Analysis, Vol. 6, 2012.
4. Dr Marjan Dema. "On a Problem of Multiple Interpolation in Hp Spaces."—Liet. Matem. Rink., Vilnius, Lithuania, 1985.
5. Dr Marjan Dema. "Një problem mbi interpolimin në Hapësirat Hp"—Buletini I FSHMN, Prishtinë, 1995.

6. Dr Marjan Dema, “Interpolimi i shumëfishtë mbi hapësirat Hp”, Buletini I FSHMN, Prishtinë 1995.
7. Dr Marjan Dema. “Mbi interpolimin e shumëfishtë më peshë në klasat Hp(p1)” Kërkime, Prishtinë, 1997.
8. Marjan Dema. “Disa veçori të interpolimit të funksioneve analitike në hapësirat të Hilbertit”, punimi i magistraturës, Prishtinë, 1984.
9. Marjan Dema. “Intrapolimi i shumëfishtë në hapësirat Hp pa konditën e Karlesonit, punim i disertacionit të doktoratës, Prishtinë, 1987.

Tekstet universitare:

- 1990 Dr Marjan Dema, Probleme të zgjidhura nga Gjeometria Deskriptive, Prishtinë, (dispense),
1995 Dr Marjan Dema, Dr Fuat Rizvanolli. Matematika për ekonomistët, Prishtinë, 1995,
1997 Dr Marjan Dema, Dr Nexhat Muhaxheri, Testet për provimin klasifikues, Prishtinë, 1997.

Karriera profesionale dhe thirrjet akademike

- 1978-1981, Profesor në gjimnazin “Sami Frashri” ne Prishtinë, në
1981 Asistent ne FSHM, Departamenti i Matematikes. Universiteti i Prishtinës,
1984 Ligjërues për lëndën Gjeometri Deskriptive, në Universitetin e Prishtinës, FSHMN,
1988 është zgjedhur në thirrjen e docent për lëndën e Gjeometrisë Deskriptive, FSHMN, Universiteti i Prishtinës,
1994-2001 Është zgjedhur në thirrjen e profesorit inordinar,
1981-1985 Sekretar i Katedrës së Matematikës në FSHMN,
1996-1998 Ka qenë prodekan në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës prej vitit 1996 deri në vitin 1998,
2006/09 Zgjidhet Prorektor për burime dhe infrastrukturë dhe zëvendës Rektor në Universitetin e Prishtinës,
2009 Zgjidhet Rektor, u.d. i Universitetit të Prishtinës,
2009-2012, Anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës.

Në vitin 2019, Rektori Marjan Dema ishte mbrojtësi i një seminari ndërkombëtar të organizuar nga Rotary International me studentë nga Gjermania, Greqia, Turqia dhe Kosova me temën e kontrollit të malaries, si dhe pjesëmarrës në shumë seminare tjera.

Është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve Shqiptaro-Amerikane në New York, Tiranë, Prishtinë dhe Shkup nga viti 2019.

MARTIN CAMAJ (1924-1992)



Martin Camaj, u lind në Telum të Fukagjinit, më 13 korrik 1925.

Në vendlindje kaloi dhjetë vitet e para të jetës së tij. Në vitin 1935 vendoset përfundimisht në Shkodër dhe fillon të marrë arsim të rregullt pranë kolegjit jezuit "Xaverianum". Rektor i kolegjit atëbotë qe P. Giuseppe Valentini SJ, prej të cilit mësojmë se arsimin fillor 5 vjeçar e kishte përfunduar në 4 vjet. Pesë vitet në vijim ai ndoqi rregullisht gjimnazin, gjë që i dha të drejtën për të vijuar studimet në liceun klasik të kolegjit. I ati

vdes pak vite pasi Martini i vogël u fut në kolegji

Studimet detyrohet t'i ndërpresë në vitin e tretë, më 1946, mbas mbylljes së instituteve fetare të Shkodrës.

Themeloi në Prekal shkollën, ku veproi si mësues i vetëm deri më 1948. Camaj merrte pjesë në rezistencën kundër partizanëve komunistë me çetën e kapedan Gjon Destanishtës dhe në gusht qe i detyruar të jetoj në ilegalitet deri sa ia arriti të ikë në Jugosllavi bashkë me Át Daniel Gjeçajn OFM dhe grupin e përbërë prej 36 vetash. Kryen për tre muaj një kurs intensiv për mësuesinë në Pejë (1 korrik-30 shtator 1949), mandej punon një vit (1949-'50) mësues në Tuz, në shkollën "Mahmut Lekiq".

Viti 1950 e gjen Martinin në Beograd, ku u regjistrua në universitetin e kryeqytetit jugosllav. Diplomohet pas pesë vitesh, më 20 korrik 1955, duke dhënë provim diplome në degën e filologjisë romane me fusha kryesore gjuhë dhe letërsi italiane. Pas mbylljes së studimeve në Beograd, Camaj përgatitet për formimin pasuniversitar në albanologji pranë fakultetit filozofik të Universitetit të Sarajevës, i udhëhequr nga albanologu prof. Henrik Bariç.

Veprat:

"Një fyell ndër male", Prishtinë, 1953,

"Kânga e vërrinit", Prishtinë 1954,

"Djella", Romë, 1958,

"Legjenda", Romë, 1964,

"Lirika mes dy moteve", Munich, 1967,

"Kânga e vërrinit", që u ribotuan në Munich 1981,

"Selected Poetry", përmbledhje poeiazh e përkthyer në New York, 1990

"Palimpsest", përmbledhje poezish, Munich dhe New York 1991. etj.

MASAR STAVILECI (1935-2016)



Prof. Masar Stavileci, u lind më 12 dhjetor 1935, ka qenë profesor në Kolegjin AAB dhe Rektor i parë i tij.

Ka mbaruar Normalen në Prishtinë dhe studimet universitare i kreu në Universitetin e Beogradit (dega e frëngjishtes). Një kohë punoi gazetar në gazetën “Rilindja”, prej nga pas mbarimit të studimeve pasdiplomatike u zgjodh ligjërues në Fakultetin e atëhershëm Filozofik, në degën gjuhë e letërsi frënge.

Gjatë viteve sa punoi në “Rilindje” si gazetar, shkroi e botoi vështrime e ese letrare për vepra e autorë frëng, por edhe shqiptarë, ndërsa është edhe përkthyes i disa veprave nga gjuha frënge në shqip. Kujtohet për kulturën gjuhësore dhe kujdesin deri në fanatizëm të zbatimit të standardit të gjuhës bashkëkohore shqipe.

Ka specializuar në Universitetin e Zagrebit dhe të Sorbonës, në Paris. Ka mbrojtur magistraturën në Zagreb. Ka bërë kërkime të gjata shkencore të doktoratës kryesisht në Paris e në Tiranë. Ka mbrojtur doktoratën në Fakultetin e Filologjisë së Universitetit të Prishtinës, ku edhe ka punuar si profesor i këtij universiteti deri në vitin 2003.

Masar Stavileci ka botuar një numër të konsiderueshëm vështrimesh, kritikash e studimesh letrare në gazeta e revista të specializuara në Kosovë, në Shqipëri, në Francë, në Angli, si dhe në disa nga republikat e ish- Jugosllavisë. Ka marrë pjesë në kongrese, simpoziume, sesione dhe projekte shkencore me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar. Është marrë dhe me përkthime letrare nga gjuhët e huaja në shqip. Ka bërë përkthimin e romanit “*Neveria*” të filozofit dhe të shkrimtarit të madh francez Sartre.

Punimet e tij janë botuar nëpër revista të njohura shkencore e letrare të Kosovës dhe në qendrat e republikave të ish-Jugosllavisë, në Shqipëri, Francë. Ishte pjesëmarrës në shumë kongrese, simpoziume dhe bashkautorë në projekte nga fusha e artit të letërsisë në Kosovës dhe jashtë.

Ka botuar dhe disa vepra:

- ”Iluminizmi në Letërsinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare”, 1990.
- “Tema letrare franceze”, Prishtinë, 1996; Apologji e Çështjes Shqiptare”, Prishtinë, 1998.
- “Iluminizmi shqiptar”, II, Tiranë, 2000, Elemente të stilistikës let., 2005.
- ”Apologji e Çështjes Shqiptare”, III, në 100-vjetorin e Pavarësisë, 2012.

MAXHUN BRUQI (1928-2016)



Maxhun (Rexhep) Bruqi, u lind në fshatin Isniq të Deçanit, më 25 dhjetor 1928. Shkollën fillore e kreu në Strelle të Epërm të Deçanit, progjimnazin në Pejë, ndërsa Normalen e Gjakovës më 1948. Fakultetin e Shkencave të Natyrës - Degën e gjeografisë e kreu në Universitetin e Prishtinës, kurse studimet pasuniversitare për gjeografi i ndoqi në Universitetin e Zagrebit.

Karrierën në arsim e filloi në vjeshtën e vitit 1949. Ishte mësues në fshatrat e komunës së Deçanit: Carrabreg të Epërm, Deçan, Junik, Strelle të Epërm etj. Më vonë pas kryerjes së fakultetit të gjeografisë në vitet e '70-ta, kaloi si profesor i gjeografisë në gjimnazin “Vëllezërit Frashëri”, në Deçan. Profesor Maxhun Bruqi, është ndër pishtarët e parë të arsimit shqip në Kosovë. Dy gjeneratat e para të Normalës së Gjakovës dolën me detyrë anëmbanë Kosovës, por edhe jashtë kufijve të saj. Ata e kishin për detyrë që ta përhapin kulturën, arsimin dhe dijen në gjuhën tonë të ëmbël shqipe, mu në atë kohë kur afër 85 % e popullatës ishte analfabete, dhe kur në shumicën dërmuese të fshatrave tona nuk kishte shkolla.

Këta maturantë, asnjëherë nuk kanë pasur ndonjë kërkesë apo vërejtje për kushtet e punës së tyre, sepse udhëhiqeshin nga ideali i lartë patriotik. Ata e dinin se dija është dritë, është fuqi që na çon përpara, na bën zot të vetvetes. Maxhun Bruqi bashkë edhe me disa emra tjerë të fushës së arsimit më Dërvish Rozhajën, Pajazit Nushin, Rexhep Hoxhën, Fehmi Aganin, Arsim Fehmiun e të tjerë e kanë krijuar masën gjenetike të zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe kombëtar të shqiptarëve, të cilën studiuesit me plot të drejtë e quajnë vatër e pashuar e zhvillimit të vetëdijes kombëtare shqiptare. Ishte pjesëmarrës i Luftës së Dytë Botërore.

Ai është pjesë e panteonit të arsimit shqip në Kosovë, si njeri, i cili tërë jetën ia kushtoi arsimit, ku dhe kreu detyra më përgjegjësi në institucionet arsimore-pedagogjike të Kosovës. Ishte prind i mirë, pedagog i vyer i shumë mësuesve, mjekëve, gazetarëve, inxhinierëve, juristëve, ekonomistëve, punëtorëve shëndetësorë në Dukagjin.

Maxhun Bruqi do të mbetet gjatë në kujtesën tonë dhe të secilit nxënës të tij, që e pati fatin të mësoi për kulturën, pedanterinë dhe etikën profesionale prej një pedagogu më namë në rrafshin kombëtar dhe edukativë. Vdiq në Prishtinë, më datën 02 prill 2016.

MEHMET GJEVORI (1910-2007)




Mehmet Gjevori u lind më 1910 në Elbasan, aty mbaroi shkollën 6-klasëshe, kurse vazhdoi shkollën normale, në Tiranë, më 1933. E filloi punën në Prizren si mësues, shërbeu edhe si sekretar i Inspektoratit të Arsimit dhe në të njëjtën kohë edhe drejtor i shkollës fillore “Abdyl Frashëri”. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Mehmet Gjevori caktohet anëtar i Këshillit Nacionalçlirimtar për Arsim e Kulturë në qarkun e Sharrit. Nga 1945, ai emërohet inspektor i arsimit për shkollat në gjuhën shqipe në Kosovë, pranë Drejtorisë së Arsimit të Këshillit Popullor me seli në Prizren. Mehmet Gjevori ishte i përfshirë në organizmin e kurseve të para pedagogjike në gjuhën shqipe në Prizren, Pejë dhe Prishtinë. Më vonë merret me veprimtari botuese, si dhe angazhohet në gazetën “Rilindja” në detyrat e redaktorit dhe kryeredaktorit deri në pension. Ai është autor dhe bashkautor i abetareve të para shqipe për shkollat fillore në Kosovë. Mehmet Gjevori është autori i Abetares së parë shqipe në Kosovë.

Botoi “Frazologjizmat e Gjuhës Shqipe dhe spjegime”, autor i librit “Prindërit dhe fëmijët”, “Kujtime e shënime”, Shoku im (libër leximi për klasën e parë të shkollës fillore). Gjithashtu, ka botuar një numër të konsiderueshëm studimesh në revista të ndryshme pedagogjike nga fusha e metodikës dhe e didaktikës, nga edukata e fëmijëve, nga gjuha praktike etj. Si autor i abetares së parë shqipe në Kosovë, Mehmet Gjevori me përkushtim të rrallë shpërndau shkronjën shqipe gjithandej nëpër Kosovë. E gjithë krijimtaria edukativo-arsimore dhe botuese e Mehmet Gjevorit ishte një mision njerëzor dhe patriotik, ku si qëllim kishte përhapjen e dijes dhe të kulturës shqiptare. Mehmet Gjevori vdiq në Prishtinë në vitin 2007.

Presidenti i Kosovës, e dekoron Gjevorin me Medaljen e Artë të “Lidhjes së Prizrenit”, për kontributin e dhënë në fushën e arsimit të Kosovës, gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj, në mbarëvajtjen e shkollës në Kosovë, në fushën e hartimit të teksteve shkollore, si dhe të mirëkuptimit e të përkrahjes së Lëvizjes Demokratike të Kosovës për liri e pavarësi në vitet '90-ta, në qershor të vitit 2003. Mehmet Gjevori u, dekorua medaljen e artë “Naim Frashëri të klasit I” nga Presidenti i Shqipërisë, dhënë në Tiranë, më 11 prill 1994. Mehmet Gjevori punoi e krijoi 62 vjet në fushën e arsimit dhe të edukimit të brezave të rinj të Kosovës.

MEHMET KAJTAZI (1944-2003)




Mehmet Kajtazi u lind në vitin 1944, në Kllodernicë të Drenicës (komuna e Skenderajt). Një kohë punoi arsimtar i gjuhës dhe letërsisë shqipe në vendlindje, në Turqefc, në Runik, në Klinë të Epërme dhe në shkollën e mesme “Isa Boletini” në Skenderaj, ndërsa, prej vitit 1973 ishte gazetar dhe redaktor i fejtistikës në të përditshmen “Rilindja” dhe së fundi deri në vdekje, punoi si redaktor profesional për prozë në Ndërmarrjen Botuese “Rilindja”, Prishtinë. Ka botuar tregime, reportazhe dhe shkrime të ndryshme në revista dhe gazeta, që botoheshin në gjuhën shqipe në Prishtinë, Tiranë, Shkup, Podgoricë dhe Zvicër. Me krijimtari letrare merrej që nga shkolla e mesme. Ka shkruar kryesisht prozë për të rritur, romane, tregime, novela. Mehmet Kajtazi, vdiq më datë 25 shtator 2003 në Lozanë të Zvicrës, dhe u varros në Prishtinë, më 27 shtator 2003.

Veprat e botuara:

- “Nata në gur”, (roman, 1984), botoi “Rilindja”, Prishtinë.
- “Plaku dhe urat”, (roman, 1986), botoi “Flaka”, Shkup.
- “Zemër e Thyer”, (tregime, 1987), botoi “Rilindja”, Prishtinë.
- “Fundit i legjendave”, (roman, 1990), botoi “Rilindja”, Prishtinë.
- “Shqiptarët në Goli Otok”, (roman, 1991), botoi “Dielli”, Zagreb.
- “Kodra e pajtimit”, (tregime, 1993), botoi “Ylberi”, Prishtinë.
- “Ushtimë e Alboderit”, (roman, 1993), botoi “Shkëndija”, Prishtinë.
- “Shote Galica”, (roman, 1995), botoi LSHK, Prishtinë.
- “Minatorët”, (roman, 1995), botoi “Onufri”, Elbasan.
- “Thikë në portokall” (roman, 1995), botoi Shoqata e Shkrimtarëve të Kosovës, Prishtinë.
- “Gjeli i katedrales”, (roman, 1996), botoi NB “Rilindja”, Prishtinë.
- “Santa Ana”, (roman, 1998), botoi NB “Rilindja”, Prishtinë.
- “Guri i dallëndyshes”, (roman, 1998), botoi NB “Rilindja”, Prishtinë.
- “Lindja në qiell”, (roman, 2000), botoi “Rilindja”, Prishtinë.
- “Udha I”, (roman, 2000), botoi “Rilindja”, Prishtinë.
- “Ndezja e shiut”, (roman, 2001), botoi NB “Rilindja”, Prishtinë,
- “Një diell tjetër”, (roman, 2003), botoi NB “Rilindja”, Prishtinë.
- “Ndezja e shiut”, roman u nderua me çmimin “Hivzi Sylejmani” të Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, për veprën më të mirë në prozë në vitin 2001.

MEHMET KRAJA



Akademik Mehmet Kraja është lindur më 27 qershor 1952, në Kështenjë të Krajës, fshat afër Liqenit të Shkodrës, në Mal të Zi. Shkollimin e mesëm e kreu në Ulqin, ndërsa të lartin në Universitetin e Prishtinës, Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe.

Gjatë viteve 1974-76 ishte kryeredaktor i gazetës së studentëve të Universitetit të Prishtinës, 'Bota e re', më pas punoi si gazetar dhe redaktor i kulturës në gazetën "Rilindja", ku botoi tekste të shumta publicistike për çështje të ndryshme nga problematika kulturore dhe recensa e shkrime diskurzive për letërsinë.

Gjatë viteve 1992-99 jetoi dhe punoi në Tiranë. Në atë kohë e pushoi angazhimin politik dhe iu përkushtua letërsisë dhe publicistikës. Pas luftës së Kosovës ishte redaktor i kulturës në të përditshmen "Zëri", më pas redaktor i shtojcës për kulturë në gazetën "Koha ditore". Që nga viti 2002 është ligjërues në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, ku jep lëndën e skenarit të filmit. Është anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, dhe tash kryetar i kësaj Akademie.

Me shkrime letrare filloi të merrej që kur ishte nxënës i gjimnazit në Ulqin. Tregimet e para i botoi në revistën letrare "Jeta e re", nën përkujdesjen e Esad Mekulit. Deri më tani ka botuar dymbëdhjetë romane, katër vëllime me tregime, dhjetë drama dhe pesë libra nga fusha e publicistikës.

Romane:

- "Gjurmë në trotuar", Rilindja, Prishtinë 1978.
- "Portali i perëndive të fyera", Rilindja, Prishtinë, 1980.
- "Moti i Madh", Rilindja, Prishtinë, 1981.
- "Udhëzime për kapërcimin e detit", Rilindja, Prishtinë, 1984.
- Naim Frashëri, Tiranë, 1987,
- "Sëmundja e ëndrrave", "Rilindja", Prishtinë, 1987.
- "Net bizantine", "Rilindja", Prishtinë, 1990.
- "Muri i mjegullës", Toena, Tiranë, 1998.
- "Edhe të çmendurit fluturojnë", Onufri, Tiranë, 2004.
- "Im atë donte Adolfin", Onufri, Tiranë, 2005.
- "Selvitë e Tivarit", Onufri, Tiranë, 2007.
- "Hotel Arbëria", Onufri, Tiranë, 2010.
- "E zeza dhe e kuqja", Onufri, Tiranë, 2015.

Tregime:

“Dritat e mesnatës”, Rilindja, Prishtinë, 1974,
“Vdekja pa emër”, “Eurorilindja, Tiranë 1995, “Dukagjini”, Pejë 1996,
“Portat e qiellit, Toena, Tiranë, 1996, “Buzuku”, Prishtinë 1997,
“Njëzet tregime për kohën e shkuar”, Dukagjini, Pejë 2001,
“Hija e qershisë nën dritën e hënës”, Toena, Tiranë, 2006.

Drama:

Tri drama (“Princi i hijeve”, “Onufri i Neokastrës”, “Hëna prej letre”),
Rilindja, Prishtinë 1987, “Im atë donte Adolfin”, dramatisim, Prishtinë,
2007, “Hëna prej letre”, version i ri, Prishtinë, 2007.

Kritikë dhe publicistikë:

“Shoqërime”, Rilindja, Prishtinë, 1997, “Vite të humbura”, Eurorilindja
Tiranë 1995, Rozafa, Prishtinë 2003. “Mirupafshim në një luftë tjetër”,
Rozafa, Prishtinë 2003. “E shtuna ime”, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë,
2009. “Identiteti kosovar”, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë 2011.

Shfaqje të realizuara:

“Princi i hijeve”, realizuar në Prishtinë në vitin 1984, me regji të Agim
Sopit dhe në teatrin e Gjilanit në vitin 1985.

“Hëna prej letre”, realizuar nga teatri i Gjakovës në vitin 1988, në regji të
Fadil Hysajt.

“Onufri i Neokastrës”, nga tetari amator “Emin Duraku” i Gjakovës, në
vitin 1987, në regji të Nimon Muçajt.

“Ëndërr qeni”, realizuar në Teatrin Kombëtar të Prishtinës, në vitin 2001,
në regji të Isë Qosjes.

“Grafitet”, realizuar në teatrin “Oda” të Prishtinës, në vitin 2005, në regji të
Isë Qosjes.

“Onufri i Neokastrës” (version i ri), realizuar nga një grup artistësh të lirë të
Gjakovës, në vitin 2006, në regji të Nimon Muçajt.

“Im atë donte Adolfin”, realizuar si shfaqja e parë profesioniste e teatrit të
Prizrenit, në vitin 2007, në regji të Agim Sopit.

“Rekuem”, realizuar nga Teatri i Qytetit të Gjilanit, 2010.

Çmime:

Çmimi vjetor i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës për veprën më të mirë
(për romanin Moti i Madh, 1981,

Çmimi “Hivzi Sulejmani”, 1995,

Çmimi i shtëpisë botuese “Toena”, 1998,

Çmimi “Pjetër Bogdani”, 1999, etj.

MELIHATE AJETI (1935-2005)



Melihate Ajeti, u lind më 9 tetor 1935, në Prishtinë; vdiq më 26 mars 2005, në Prishtinë. Semimaturën e kreu në Prishtinë. Vijoi shkollën e aktrimit në Prishtinë dhe bëri një specializim në Paris (Comedie Française).

Melihate (Shabani) Ajeti, ka nisur karrierën e aktrimit në Pejë, ku ka luajtur në vitin 1949 në dramën “Gomari i Nasradinit”, në regji të Kristë Berishës dhe po ashtu në vitin 1950 ka luajtur në dramën "E mbesa e Krahinarit" në regji të Kristë Berishës

Aktorja numër një e teatrit Prishtinas, nisi aktrimit si 16 vjeçare në vitin 1951, në Teatrin Krahinor të Kosovës dhe shkriu në skenë 180 role kryesore, me të cilat dëshmoi talentin, bukurinë e kapacitetin e madh prej aktoreje dhe shpirti artistik.

Teatër:

“Zullumqari”, “Vajza pa pajë”, “Zonja me kamelie”, “Besa”, “Sikur të isha djalë”, “Halili e Hajrija”, “Erveheja”, “Hanka”, “Hamleti”, “Shtettrrethimi”, “Othello”, “Ana Karenina”, “Vdekja e një mbretëreshe”, “Svinga e Gjallë”, “Magbethi”, “Antigona”, etj.

La gjurmë të pashlyera në teatër, si dhe në kinematografinë kosovare dhe atë jugosllave.

Filmografia:

“Uka i Bjeshkëve të nemuna“, “Buka“, “Zonja me kamelie“, “Trimi“, “Lepuri me 5 këmbë“, “Era e Lisi“, “Erveheja“, “Kur Pranvera vonohet“, “Të ngjuarit“, “E shtëna në ajër“, “Othello“, “Përroi vërshues“, “Migjeni“, “Gjurmët e bardha“, “Magbethi“, “Dorotej“, etj.

Shpërblimet e lëvdatat:

Për Zonjën me Kamelie-Shpërblimi i dhjetorit (1963), Joakim Vujic (1972) dhe (1975), Hajrijën dhe Svingën, Shpërblimi i Shoqatës së Artistëve të Jugosllavisë për Ervehenë (1971), Çmimi më i lartë i punës (1971).

Në vitin 1985, mori shpërblimin e parë për rol femre në “Shtettrrethimin” në festivalin Joakim Vujic.

Këto janë vetëm disa mirënjohje që dëshmojnë se Melihate Ajeti, është nga femrat tona të para e më të merituar-Doajenë e Teatrit Kombëtar të Kosovës-Primadona e skenës shqiptare.

MIGENA ARLLATI



Prof. Migena Arllati, është e lindur në Elbasan 6.09.1974. Migena Arllati jeton në Gjakovë prej 24 vjetësh. Studimet e larta i ndoqi në Fakultetin Filologjik, dega gjuhë-letërsi në Universitetin publik “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan. Diplomoi për diplomaci në Akademinë Diplomatike Shqiptare në Tiranë. Ka përfunduar studimet pasuniversitare Master për Gjuhësi, në Qendrën Shtetërore të Studimeve Albanologjike në Tiranë. Është Phd cand-doktorante e shkencës së gjuhësisë, specialiteti leksikologji, në Universitetin e Evropës Juglindore. Karriera e saj paraprihet nga dhjetë vjet angazhimi në gazetarinë radiofonike në agjencinë e lajmeve “KosovaLive”.

Në vitin 2002, organizata amerikane IREX, e nderoi me çmimin e dytë, për projektin e saj radiofonik, kushtuar sfidave të gruas së pasluftës në Kosovë. Në vitin 2006, Qendra mediale “Dukagjini” i ndau çmimin e parë për shkrimet lidhur me promovimin e punës dhe sfidat e femrës shqiptare.

Ka punuar për katër vjet si ligjëruese e jashtme në Universitetin Publik “Fehmi Agani” në Gjakovë. Migena mori pjesë në konferenca të ndryshme shkencore, të organizuara nga Universiteti i Tiranës, Prishtinës, Shkupit, Tetovës, Shkodrës, Elbasanit, Durrësit, Vlorës, si dhe me prezantime të nivelit ndërkombëtar në Slloveni, Itali, Zvicër, Gjermani e Angli. Deri tani, është redaktore dhe recensente e rreth 70 vëllimeve me poezi e prozë të autorëve shqiptarë e tre të huaj. Ka botuar shkrime nga fusha e kritikës letrare dhe publicistikës pothuajse në të gjitha gazetatat dhe revistat që botohen në Kosovë, Shqipëri e rajon.

Libra të botuar:

1. “Mendime në kornizë”, Vëllim me poezi, Prishtinë, 2012.
2. “Lindur për t’u bërë mjek”, Monografi, Gjakovë, 2013.
3. “Vështrim rreth shprehjeve frazeologjike në të folmen e Gjakovës”, Studimi gjuhësor, Gjakovë, 2014.
4. “Patronimet, mbiemrat familjarë në Gjakovë”, Botimi studimor, në bashkautorësi me prof. M. Rogova, Gjakovë, 2015.
5. “Kritikë letrare e recensa”, Gjakovë, 2016.
6. “Autorë të letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj, Leksikoni enciklopedik, 1886-2017”, në bashkautorësi me prof. dr. A. Bishqemi, Gjakovë, 2017.
7. “Nuk dashurojnë perënditë”, Vëllimi me poezi, Elbasan, 2018. etj.

MILAZIM KADRIU (1958-2019)



Milazim F. Kadriu, u lind më 1958 në fshatin Revuq, komuna e Besianës (ish-Podujevë). Shkollën fillore e mbaroi në Llapias (Kërpimeh), gjimnazin në Besianë (Podujevë), kurse në Fakultetin Filologjik në Prishtinë, studioi Letërsi dhe Gjuhë Shqipe. Punën në arsim e nisi fillimisht në shkollën e mesme në Besianë (Podujevë) e më pas në shkollën në Llapias (ku edhe kishte punuar). Milazim Kadriu bashkë me tre vëllezërit e tij ishte ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e tash veteran i UÇK-së.

Me shkrime ka filluar të merret qysh si nxënës i shkollës fillore dhe ka botuar në revistat për fëmijë. Edhe me gazetari ka filluar të merret herët, ku ka bashkëpunuar kohë të gjatë me gazetën “Rilindja”, pastaj me “Zëri i Rinisë”, ”Shkëndija”, ”Bujku”, etj. Po ashtu gjatë kohës së okupimit në vitet e 90-ta ka qenë bashkëpunëtor i rregullt i gazetës kroate, që botohej në Zarë “Fokus”. Milazimi ishte edhe ushtarë i UÇK-s, në kuadër të së cilës kontribuoi për lirinë e atdheut të vet, ndërsa pas mbarimit të luftës, një kohë punoi në radion lokale “Radio-Llapi”. si gazetar, redaktor e kryeredaktor.

Ai ishte edhe bashkëpunëtor i redaksisë “Dëshmorët e UÇK-s”, si dhe bashkautor i monografisë “Feniksët e lirisë”. Anëtar i redaksisë së revistës “Albi” dhe korrespondent nga Besiana, i gazetave “Epoka e re”, “Gazeta e re”, “24 orë”, ”Kosova sot” etj.

Milazim Kadriu është i përfaqësuar në rreth 30 antologji me poezi, që janë botuar në Kosovë, Shqipëri, Preshevë e Maqedoni. Me krijimtari letrare kryesisht është marrë me poezi për fëmijë dhe për të rritur, tregime për fëmijë, kritikë letrare dhe si hobi e kishte enigmatikën.

Libra të botuar:

- “Lindi dielli”, (poezi për fëmijë) - 2000,
- “Besnik Muharrem Restelica”, (Biografi) -2011.
- “Flakadani i lirisë”, (50 autorë-100 poezi) -2012.
- “Tri shkronja”, (poezi për fëmijë) -2014.
- “Uragani i lirisë”, (20 autorë-55 poezi) -2017.
- “Refleksione letrare”, (kritikë) -2017.
- “Vështrime letrare”, (kritikë) -2017,
- “Përsiatje letrare”, (kritikë) -2018,
- “Ata që për liri u flijuan”, - 2018, etj.

MILAZIM KRASNIQI



Prof. Dr. Milazim Krasniqi, u lind në fshatin Breznicë të Prishtinës, më 25 tetor 1955. Studimet e filologjisë i kreu në Prishtinë. Magjistroi në temën "Struktura e vargut të Ndre Mjedjes", si dhe doktoroi në temën "Soneti në poezinë shqipe" në Fakultetin Filologjik të Prishtinës.

Nga viti 1987-1995 ishte redaktor, gazetar dhe kryeredaktor. Punoi në revistën, "Fjala". Nga viti 1987 deri në vitin 1990 ishte redaktor, gazetar në revistë "Fjala", ndërsa më vonë (1990 deri më 1995) ishte kryeredaktor i revistës për kulturë "Fjala". Ishte sekretar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës (1988-1999). Ishte redaktor përgjegjës nga viti 1995 e deri në qershor 1999 në gazetën "Bota sot", e cila botohej në Cyrih.

Nga viti 1995 deri në vitin 1998, anëtar i kryesisë së Lidhjes së Gazetarëve të Kosovës. Ishte kolumnist në "Kosova Sot" dhe "Gazeta e Re". Nga viti 2001 deri në vitin 2002 ishte kryeredaktor i revistës "Interesi Nacional". Nga viti 2001 deri në vitin 2009 ishte anëtar i bordit të Drejtorëve të Radiotelevizionit të Kosovës.

Nga viti 2002 deri në vitin 2006 ishte analist te radio "Evropa e Lirë", 2004-2006. Nga viti 2004 deri në vitin 2006 anëtar i bordit të Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës. Nga viti 2002 bashkëpunëtor i jashtëm në Fakultetin e Filologjisë, në Departamentin e Letërsisë Shqipe, ndërsa pas themelimit të Departamentit të Gazetarisë, mësimdhënës me gradën akademik, prof. ass. Në vitet 2009-2011 anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës. Në gradën prof. Dr. u zgjedh më 9 mars 2011. Është anëtar i bordi shkencor në revistën "CENTRUM"(2013-en), si dhe në bordin shkencor në revistën "VIZIONE, SHKUP (2008-ende). Anëtar i Këshillit të seminarit ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare (2010-2012), anëtar i redaksisë së revistës kërkimore "MEDIA"(2009- ende). Mentorime të katër temave të Master-it në periudhën 2011-2018. Mentorime të tezave të disertacionit, 2018. Anëtar i këshillit të studimeve doktorale në Fakultetin e Filologjisë (dy mandate), Anëtar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, 2008-2011. Anëtar i komisionit të studimeve doktorale në Universitetin Internacional të Strugës, PEN Qendra e Kosovës; Shoqata e Gazetarëve të Kosovës, Unioni i Gazetarëve të Kosovës.

Vepra studimore dhe letrare:

- ”Nacionalizmi shqiptar” (studim),
- “Rigjetja e vetes” (poezi),
- “Vepra komplete” (vëllimet 1-7),
- “Imazhi gri” (poezi),
- “Pirg vegimi” (poezi),
- “Qeshje sardonike” (poezi),
- “Formula e Katonit” (poezi),
- “Kurs për pantomime” (poezi),
- “Dalja e atdheut edhe nga ëndrrat” (poezi),
- “Dritë në kujtime” (poezi),
- “Fijet e shpirtit” (roman),
- “Fotografitë e kujtimeve” (roman),
- “Zbulimi” (komedi),
- “Mos më merrni në qafë” (komedi),
- “Punë Sizifi” (komedi),
- “Kush i bie fyellit” (komedi),
- “Bryma e vdekjes” (dramë),
- “Kosovë në ndërgjegje” (dramë),
- “Monedha e Gentit” (dramë),
- “Rulet rus për Ali Pashën” (dramaturgj),
- “Një Antigone e re” (tragjedi),
- “Kësulkuqja e shekujve” (tragjedi),
- “Horrat në krye të detyrës” (publicistikë),
- “Kosova pas 22 janarit 1998” (publicistikë),
- “Në çfarë Kosove do të jetojmë” (publicistikë),
- “Ankthi i vjetër në shekullin e ri” (Presionet e Serbisë ndaj Kosovës pas vitit 1999) (publicistikë),
- “Soneti në poezinë shqipe” (studim monografik),
- “Dhuna dhe qytetërimi perëndimor: Islami si fillim i historisë” (studim),
- “Islami i keqkuptuar dhe fatkeqësia botërore” (studim),
- “Hyrje në Gazetari” (libër universitar), etj.

Milazim Krasniqi, në kuadër të veprimtarisë së tij, studion edhe fenomene të ndryshme, me të cilat shoqëria kosovare përballet, ndër to, edhe gjendjen e mediave në Kosovë, dhe mendimet e tij i shpreh pos nëpër libra, edhe në blogje personale...

MIRA MEKSI



Mira Meksi është përkthyesë dhe prozatore e njohur, fituese e disa çmimeve kombëtare dhe ndërkombëtare për krijimtari dhe përkthime. Mira Meksi kreu studimet e larta për filologji shqipe dhe frënge në Universitetin e Tiranës.

Është një nga zërat më të rëndësishëm, më të fuqishëm dhe më përfaqësues të letrave shqipe të periudhës pas rënies së regjimit totalitar në Shqipëri.

Falë mjeshtërisë së përkthimit të saj, kanë ardhur në gjuhën shqipe kryeveprat e letërsisë botërore të autorëve: Gabriel Garcia Márquez, Vargas Llosa, Charles Baudelaire, Alphonse de Lamartine, Jorge Luis Borges, Ernesto Sabato, Marguerite Duras, Pablo Neruda etj.

Është nderuar me mjaft çmime të rëndësishme shqiptare dhe të huaja, ku vlen të përmendim: çmimi Përkthimi më i mirë i vitit 2006, për romanin: “Kujtim kurvash të trishta” nga Gabriel Garcia Marques, dhënë nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;

Titulli i Nderit me motivacionin: “Personalitet frankofon i multi-linguizmit 2009” dhënë nga Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë dhe akorduar nga Ministria e Punëve të Jashtme;

Urdhri “Comendadora” i Meritës Civile dhënë nga mbreti i Spanjës Huan Carlos I, 2011; çmimi i eseistikës “Gjergj Fishta” 2011, akorduar nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për librin me ese “Leximet e ndaluara dhe shkrimet e fshehura” etj.

Është levruese e pothuaj të gjitha gjinive letrare, duke filluar që nga romani:

Veprat:

“Frosina e Janinës”;

“Porfida-ballo në Versailles”;

“E kuqja e demave”;

“Mallkimi i priftëreshave të Ilirisë”;

"Planeti i ngrirë";

"Fantazma me sy njeriu"(roman për adoleshentë),

Novelat:

"Ballo në Versailles";

"Pa zemer ne kraharor";

"Vrasje ne Venecia";

Përmbledhje me tregime:

- “Mali i shpirtrave”;
- “Buzë të panjohura gruaje”;
- “Zonja plakë e Parisit”;
- “Antologjia e Poezisë së sotme Aragonase”;
- “Flutura mes gjinjve”;

Përmbledhje me përralla dhe një novelë e ilustruar:

- “Magjistrica e 12 pasqyrave”;

Libra eseistike:

- “Guri filozofal”;
- “Leximet e ndaluara dhe
- “Shkrimet e fshehura” etj.

Çmime:

- 1995: Çmimi i Tregimit të Pabotuar të RFI, Paris
- 1996: Çmimi i Festivalit të Sain Quentin, Francë;
- 2008: Çmimi i Përkthimit Letrar i Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë;
- 2009: Titulli i Nderit: “Personalitet Frankofon i Multilinguizmit 2009”
- 2011: Çmimi Letrar "Gjergj Fishta"
- 2011: Urdhri ”COMENDADORA” i Meritës Civile, Spanjë
- 2011: Çmimi i Eseistikës "Gjergj Fishta 2011"
- 2015: Çmimi i Përkthimit 2015 Panairii Librit
- 2015: Çmimi i Romanit 2015 "Rexhai Surroi”

Mira Meksi është mjaft aktive me shkrimet publicistike, si në shtypin shqiptar ashtu dhe të huaj (francez dhe spanjoll).

Romani “E kuqja e demave” është përkthyer në disa gjuhë të huaja, si dhe rishkruar nga vetë autorja në frëngjisht, botuar nga Shtëpia Botuese “Persee”. Veprat e saj janë të njohura edhe për lexuesin e huaj, tashmë të përkthyer në bullgarisht, serbo-kroatisht, greqisht, frëngjisht, anglisht, italisht etj. Në veprën më të fundit “Hakmarrja e Kazanovës”, ku përfshihet novela me titullin në fjalë dhe 16 tregime, vepër kjo që u prezantua në panairin e librit të vitit 2019. Mira Meksi i zbulon lexuesit vetë vetësinë (individualitetin) e Xhakomo Kazanovës. Autorja, për herë parë në letërsinë shqipe, shpalos para lexuesit një figurë komplekse të shek. XVIII, si Xhakomo Kazanova (Giacomo Girolamo Casanova - 1725-1798),

Në vitin 2014, romani i Mira Meksit "Mallkimi i priftëreshave të Ilirisë" ka përfaqësuar Shqipërinë në kompeticionin për çmimin letrar "Ballkanika".

MIRADIJE RAMIQI



Miradije Ramiqi u lind më 11.9.1953, në Pozharan të Vitisë, ku kreu filloren, kurse Shkollën e mesme Normale në Ferizaj e Gjilan, gjatë viteve 1974-1978.

Akademine e Arteve (pikturë 1974-1978). Gjatë studimeve ishte anëtare e Pleqësisë së Fakultetit, njëherësh edhe anëtare e Senatit të Universitetit të Prishtinës. Më 1979, mori pjesë në "Takimet e Universiteteve të Jugosllavisë në Malinska-Kërka, e cila përfaqësoi studentët e Universitetit të Prishtinës.

Ka bërë specializimin (3) mujor në Paris-Francë, në artet figurative, 1995-1997. Kreu studimet pasuniversitare, në Prishtinë.

Punoi Profesor i rregullt në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës 2016-2017.

Nga Fakulteti i arteve të bukura "Hasan Prishtina" Prishtinë, është propozuar për anëtare pranë Akademisë së Shkencës dhe Arteve të Kosovës në Prishtinë.

Miradija jeton dhe vepron në Prishtinë. Vazhdon të jetë aktive në dy veprimtaritë, atë të pikëturës dhe atë të letërsisë.

Ekspozita Personale (26), në vend dhe jashtë vendit si në: Shqipëri (Sarandë, Berat dy, Korçë, Tiranë), Mal të Zi, Francë, Zvicër tri, etj.

Simpoziume - koloni dhe ekspozita ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit, prej vitit 2003 deri në vitin 2019.

Kosovë: Therandë, Prizren, Pejë, Prishtinë. Shqipëri: Pogradec, Korçë, Bajram Curr, Durrës, Fier. Mali i Zi; Ulqin. Maqedoni; Kërçovë. Turqi: Izmir, Odesha-Birgi, Egjipt; Sharm Elsheik.

Ekspozita Kolektive: mbi 200, kombëtare dhe ndërkombëtare, si në; Kosovë, Preshevë, Shqipëri, Maqedoni, Mali i Zi, Bullgari, Sofia, Francë, Paris, Belgjikë, Zvicerr; Spanjë, Amerikë, Japoni, Korea e Jugut.

Miradije Ramiqi ka marrë pjesë edhe në shumë Simpoziume arti, Festivale e Takime të letërsisë kombëtare e ndërkombëtare, e cila është edhe anëtare e disa Lidhjeve, Shoqatave, Akademisë, Klubeve etj.

Është edhe fituese, e shumë çmimeve kombëtare e ndërkombëtare si në pikturë, gjithashtu edhe në letërsi.

Miradije Ramiqi, pëpos në profesionin e saj të piktores, është aktive edhe në fushën e letërsisë.

Miradije Ramiqi gjatë karrierës së saj, për punën profesionale është shpërbyer me shumë çmime, mirënjohje e dekorata.

Çmime për pikturë:

2009, Shpërblimi i "Sallonit të Nëntorit", Pejë, Kosovë,
2006, Mirënjohje dhe Medalje të Argjendë në konkursin internacional në "Sallonin e 36-të të Akademisë Evropiane të Arteve", Bruksel, Belgjikë,
2006, Çmimi blerës i Galerisë së Arteve "Flaka e Janarit", Gjilan,
2005, Medalje të Argjendë kombëtare në konkursin internacional në "Sallonin e 35-të të Akademisë Evropiane të Arteve" Bruksel, Belgjikë,
Klubi "DRITA" Lidhja e shkrimtareve Shqiptarë", Athinë, Greqi.

Ekspozita kolektive:

2008 Galeria e Arteve "Flaka e Janarit", Gjilan,
2007 Galeria Qendra e kulturës, nentor, Mitrovicë,
2007 Galeria Nacion. "Çifte Hamam", nentor, Shkup-Gostivar,
2007 Muzeu i Kosovës- "Rrugët e lirise" SHAFK, mars Prishtinë,
2006 Muzeu i Kosovës, "Dita e Prishtinës", qershorë Prishtinë,
2006 Galeria e Arteve të Kosovës, Ekspozita, Prishtinë,
2006 Galeria "Çifte Amam", nentor Shkup, etj.

Vepra letrare:

2014, Antologji shqip-italisht, "*Dashuria flet me zemren e diellit*", Prishtinë, 2014,
2011, Botim i dytë, anglisht-shqip "*Heshtje e k(th)yer*", SHBA,
2010, Vëllimi i katërt poetik, "*Hirësi përrallore*", Prishtinë,
2000, Vëllimin i tretë poetik "*Pëshpërim mbretërie*", Prishtinë,
1990, Vëllimin e dytë poetik "*Shi në pasqyrë*", Prishtinë,
1981, Vëllimin e parë poetik "*Drithërimë ngjyrash*", Prishtinë.

Çmime për poezi:

2015, Prix de Paris-Concourse International de poesie, 6 pril, Paris,
2011, Çmimi Mirënjohje dhe Vlerësim par Ekselencë në Poezi,
2010, Çmimi i parë në "*Flakadan i Karadakut*", Viti,
2007, Çmimi i tretë në "*Flakadan i Karadakut*", Viti,
2006, Çmimi i tretë në "*Sofra Poetike*" Ymer Elshani, Drenicë,
2004, Çmimi i dytë në "*Flakadan i Karadakut*", Viti,
2001, Çmimi i tretë në "*Ditët e Nënës Terezë*", Prishtinë,
2000, Çmimi i parë në "*Takimet e poeteshave*", Vushtrri,
2000, Çmimi i parë i "*Flaka Janarit*"-"Flaka e Lirisë", Gjilan,
1986, Çmimi i parë në "*Takimet e poeteshave*", Vushtrri...

MIRLIND BRUQI



Prof. Dr. Mirlind (Maxhun) Bruqi, Ph.D, u lind në fshatin Isniq të Deçanit, më 21 janar 1968. Shkollën fillore e kreu në vendlindje , ndërsa gjimnazin në Deçan. Studimet i kreu në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit “Hasan Prishtina”, në Prishtinë më 1992, studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë më 1997.

Në vitin 2005 e mbrojti tezën e doktoratës më titull :“Optimizimi i proceseve prodhuese në linjat fleksibile assembluese të reparteve të elektromotorëve në fabrikën ATB-Wiena”.

Bruqi është i punësuar në Në Fakultetin Teknik të Prishtinës, (Dega e mekanikës), ku ligjëron këto lëndë:

Mësimdhënës në lëndët e nivelit Bachelor:

1. Teknologjia e përpunimit
2. Përpunim me deformim
3. Përpunim me deformim I

Mësimdhënës në lëndët e nivelit Master:

1. CIM,
2. Përpunim me deformim II,
3. Makinat për përpunim me deformim,
4. Modelimi i sistemeve prodhuese, etj.

Në Tiranë nga viti 2016 ligjëron edhe në Universitetin Politeknik lëndën: “Teknologjia Mekanike” për pjesën e përpunimit plastik.

Profesori Bruqi, më tepër merret me hulumtime shkencore në fushën e projekteve të proceseve teknologjike si dhe veglave të përpunimit me deformim dhe me simulimin e proceseve prodhuese - CIM. Është autor dhe bashkautor i disa teksteve universitare si dhe mori pjesë në disa kongrese, simpoziume dhe konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.


Dr. Mirlind Bruqi është autor i softuerit për enkriptimin dhe dekriptimin e të dhënave, GOV-DYN Code (2008) si dhe X-Code (2009), që përdoren sot në Stafin diplomatik të Republikës së Kosovës.

Ushtri disa funksione në arsimim, ekonomi, dhe shkencë, si anëtar bordesh, konsulent i shumë projekteve qeveritare dhe universitare etj.

Botimet:

1. Hulumtimi i mundësisë për automatizimin e disa elementeve të procesit projektues dhe konstruktues të teknologjisë së farkëtimit, 1997.
2. Sistemi programues për llogaritjen automatike të disa parametrave optimal të procesit të farkëtimit, 1998.
3. Llogaritja automatike e formës dhe dimensioneve optimal të pjesës farkëtuese të bashkësisë sipas kriterëve të Bashkësisë Evropiane, “EUROFORGE”, 2001.
4. Optimalizimi i proceseve prodhuese në linjat fleksibile asambleuse të reparteve të elektromotorëve në fabrikën ATB-Wiena, (Doktoratura,2005).
5. Quality Management, Prishtina, 2007.
6. Data Security, Prishtina, 2007.
7. Computer Networks, Prishtina, 2008.
8. GOV-DYN-Code - Office of the Prime Minister of Republic of Kosovo.
9. X-CODE - Ministry of Foreign Affairs, 2009.
10. Metal forming I, Prishtina, 2011.
11. Metal forming II, Prishtina, 2011.
12. Forming machines, Prishtina, 2011.
13. Harmonizimi i kërkesave të tregut të punës me sistemin Arsimor, zhvillimi i standardit të profesionit dhe kualifikimit në nivelin 6 dhe 7 të KKK në fushën e Mekatronikës, ALLED, 2016.
14. With scientists and invited companies “biomass co- generation” (MIRECK, Hamburg University of Technology, TUHH -Germany, 2017).
15. Projekti i Klasterit Industrial për Energjinë e Ripërtrishtshme dhe Industrinë e përpunimit të metaleve (KIMERK); FIM nga UP, MTI, Bizneset Kosovare, Klasteri i Hamburgut dhe GIZ- (MIRECK, Hamburg University of Technology, TUHH -Germany,2017).
16. Përdorimi i aluminit dhe lidhjeve të tij në industrinë automobilistike, Tiranë, 2017.
17. Trendët bashkëkohore nga të cilat sot është i zhvilluar përpunimi plastik i metaleve, Tiranë, 2017.
18. Përdorimi i TI në teknologjinë e përpunimit plastik të metaleve, Tiranë, 2017.
19. Krijimi e softuerit për automatizimin e procesit teknologjik të përpunimit me deformim plastik, Tiranë 2018.
20. Certifikimi i produkteve sipas normës evropiane CE, Tiranë, 2018. Etj.

MIRUSH KABASHI



Mirush Kabashi, u lind më 17 prill 1948, në Shkodër. Origjina e tij është nga Gjakova. Më 1970 u diplomua për aktrim në Institutin e Lartë të Arteve në Tiranë dhe filloi punën në teatrin “Aleksander Moisiu” të Durrësit. Aty vazhdoi deri në vitin 1994, duke pasur edhe rolin e drejtorit, 1991-1993.

Më pas punoi në Televizionin Shqiptar, në departamentin e Programeve Artistike si ideator dhe prezantues, kurse nga 2002 e në vijim në Teatrin Kombëtar. Nga viti 1985, me periudha te ndërprera, është aktivizuar si pedagog i “Mjeshtërisë së Aktorit” pranë Akademisë së Arteve. Ai është aktor i rreth 100 roleve, në teatër dhe filma.

Kabashi është cilësuar si një nga interpretuesit më të mëdhenj të poezisë në Shqipëri. Ai ka dhënë një kontribut të madh në filmografinë shqiptare.

Spikat në rolet satirike dhe komike. U dallua fillimisht me krijimin e figurës qesharake të Telit në komedinë “Kartela e verdhë” e Haxhi Ramës.

Ky rol u pasua me tutje me karaktere të tilla komike, si: Diafarusi në komedinë “I sëmuri imagjinar e Molierit” (1982), me të cilin luajti mjaft bukur me elegancën plastike të tij, me përpunimin e gjestit, çka i dhanë Kabashit hirin, sharmin, ngjyrimin dhe stilin klasikist. “Në teatër, pastaj ka marrë pjesë nëpër filma, shfaqje. Të vetmen gjë që mund t’jua them me bindje: nuk i jam trembur e shmangur kurrë punës në çfarëdolloj kushtesh. Kur është fjala për të provuar, për të pasur mundësinë e kontaktit me spektatorin, ai nuk ka refuzuar, por përkundrazi ka provuar me guxim. Njëra prej këtyre fushave është edhe ajo e recitimit. Një pjesë të jetës së tij ia ka kushtuar edhe teatrit me rolet e tij të larmishme, ku ndër to më i veçanti ka mbetur ai i Sokratit, tek “Apollogjia e fundit e Sokratit. Roli i Sokratit është ndoshta kulmi i tij artistik, ku fuqia interpretuese mbërrin në caqe vërtet të lavdërueshme dhe realisht konkurruese në rrafsh ndërkombëtar.

Mirush Kabashi pëson një transformim të plotë psikofizik, plastika e tij paraqitet tejet e përpunuar, e folura gjithashtu, edhe me temperamentin dhe energjinë, që ka ndërkallur në fjalën pasionale e ironike të Sokratit, realizon një akuzë të fortë ndaj tiranisë, padrejtësisë, korrupsionit, në suazën e një sarkazme të pamëshirshme, duke i dhënë krejt lojës një qasje të dukshme bashkëkohore.

Çmimet:

Në festivalin Kombëtar të teatrove profesioniste 1989, u shpall “Aktori më i mirë”, me rolin e Sadush Nezirit te komedia “Hija e tjetrit” e Ruzhdi Pulahe.

Po me këtë rol, në Festivalin Teatror Ballkanik, të zhvilluar në Korinth të Greqisë, u vlerësua si ndër aktoret më të mirë.

Në vitin 2002 fitoi çmimin e “Aktorit më të mirë” si protagonist në Festivalin e Aktrimit “Apollon 2002” me rolin e Nokes në komedinë “Sa mirë bëri që vdiq” e Ilir Bezhanit

Më 1997 në edicionin e nëntë të Festivalit Eksperimental të teatrit të organizuar në Kajro të Egjiptit.

Mirush Kabashi është vlerësuar me “Sfinksin e artë” si interpretuesi më i suksesshëm mes njëmijë aktorëve pjesëmarrës nga dyzetegjashtë vende të botës.

Mirush Kabashi, në fund të vitit 2014, u nderua me titullin e lartë “Nderi i Kombit”, më parë kishte titujt “Artist i Merituar” dhe “Mjeshtër i Madh i Punës”.

Filmografia:

“Kronikë provinciale“, (2009),

“Ne dhe Lenini“, (2008),

“Nata“, (1998),

“Edhe ashtu edhe kështu“, (1989), Babai i Almës,

“Binarët“, (film), 1987,

“Telefoni i një mëngjesi“, (1987), Kujtimi,

“Zëvendësi i grave“, (1987), Lisimak Boci,

“Nxënësit e klasës sime“, (1984), Mësues Nardi,

“Kohë e largët“, (1983), Asketi Lithan,

“Dora e ngrohtë“, (1983), Brahusi,

“Shoqja nga fshati“, (1980), Nasi (dajua i Tirkes),

“Një ndodhi nëport“, (1980), Calamani,

“Gëzhoja e Vjetër“, (1980), Bake,

“Radiostacioni“, (1979), Një nga tekniket e Radios,

“Koncert në vitin 1938“, (1978), Toger Shazivari,

“Zani partizani“, (1976) (TV), Partizan-vëlla i zanit,

“Emblema e dikurshme“, (1976), Veniamin Papa, etj.

Mirush Kabashi ka interpretuar edhe shumë role tjera e monologje të ndryshme, kushtuar figurave emblematike kombëtare...

MITRUSH KUTELI (1907-1967)



Dhimitër Pasko, i njohur si Mitrush Koteli, është i lindur, më 13 shtator 1907, në Pogradec.

Shkollën fillore e kreu në Pogradec më 1919, pas dy viteve shkoi në Selanik me anë të një burse për shkollën tregtare rumune. Organizoi shoqërinë e nxënësve shqiptarë të Selanikut të quajtur "Kostandin Kristoforidhi".

Më 1928 shkoi në Bukuresht, ku vijoi studimet në Akademinë e Shkencave të Larta Ekonomike, duke punuar njëherësh edhe si llogaritar.

Ndiqte kurse letërsie, kritike, folklori në fakultetet e tjera dhe dinte shkrim e këndim në greqisht e latinisht, frëngjisht, rumanisht dhe italisht.

Qe sekretar dhe më 1931-'34 kryetar i shoqërisë së studentëve shqiptarë të Rumanisë, ndërkohë më 1928-'33 drejtoi gazetën "*Shqipëria e Re*", që botohej në Konstancë. Më 1931 u diplomua dhe në shkurt të 1934, mori doktoratën në shkencat bankare e monetare me vlerësimin "Diplomam Magnam cum Laudë".

Qe ndër anëtarët themelues të Lidhjes së Shkrimtarëve, anëtar i këshillit të parë të saj dhe i komitetit drejtues të revistës "*Bota e Re*".

Emërohet anëtar i këshillit të parë dhe drejtor i drejtorisë qendrore. Ideoi e zbatoi disa nga operacionet më të rëndësishme financiare të pasluftës, si vulosja e monedhës, emetimi i çeqeve monedhë për plotësimin e nevojave të para financiare etj. Pasko dha dorëheqjen në gusht të vitit 1946, pasi nuk pranoi kursin e këmbimit të caktuar nga shteti shqiptar mes lekut dhe dinarit jugosllav.

Më 16 maj 1947 e arrestuan dhe e dënuan si "Armik i Popullit", për "agjitacion e propagandë" me 5 vite heqje lirie. Pasi kaloi dënimin në kampin e Vloçishtit në Maliq, u lirua nga burgu në maj 1949 me falje.

Punoi përkthyes te "Zëri i Popullit", i cili punoi deri më 1953, pastaj u transferua në shtëpinë botuese "Naim Frashëri" deri më 1967, ku nga fundi i jetës me shkëputje dhe iu rikthye për njëfarë kohe e drejta e botimit nga vera e vitit 1966. Ai ndërroi jetë më 4 maj 1967 në Tiranë.

Ka qenë ekonomist dhe ekspert ekonomie, përkthyes, i njohur për kritikën letrare dhe prozën e shkurtër. Së bashku me Ernest Koliqin, themelues i prozës moderne shqipe, ku njihet më shumë me emrin e pendës Mitrush Kuteli.

Mitrush Kuteli është autori i parë shqiptar që botoi libra kritike. Nga tekstet autobiografike që ka lënë, lë të kuptojmë që tekstet më themelore në prozë, poezi e kritikë, i ka bërë para se të binte në burg, duke nisur nga vitet 1927-'28 dhe duke u përmbyllur më 1947. Veprimtaria letrare e pas burgut mund të përmbledhet në lëmin e përkthimit letrar.

Me rastin e 100 vjetorit të lindjes së tij, viti 2007 u shpall "Viti i Mitrush Kutelit" nga ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,


Veprat:

- “Lasgush Poradeci”, kritikë letrare, 1937,
- “Netë shqiptare”, rrëfenja, 1938,
- “Ago Jakupi”, e të tjera rrëfime, 1943,
- “Sulm e lotë”, poema, 1943,
- “Këngë e britma nga qyteti I djegur”, këngë popullore të mbledhura, 1944,
- “Shënime letrare”, kritikë letrare, 1944,
- “Havadan më havadan”, pamflet, 1944,
- “Kapllan Aga i Shaban Shpatës”, tregime, 1944,
- “Dashuria e Barbarit Artan”, 1946,
- “Pylli i gështenjave”, poezi, 1958,
- “Xinxifilua”, përralla, 1962,
- “Tregime të moçme shqiptare”, përshtatje në prozë, 1965,
- “Vjeshta e Xheladin Beut dhe rrëfime të tjera”, novelë, 1972,
- “Baltë nga kjo tokë”, poema dhe vjersha, 1973,
- “Në një cep të Ilirisë së poshtme”, tregime, 1983,
- “E madhe është gjëma e mëkatit”, novelë, 1993,
- “Netë moldave”, tregime dhe shënime, 2015.

Përkthime

- Aleksander Fadeev, “*Shpartallimi*”, 1956,
- Ivan Turgenjev, “*Kujtimet e një gjahtari*”, 1963,
- Maksim Gorki, “*Tregime*” (1956) dhe
“*Përralla të Italisë*”, (1960),
- Mihail Saltikov-Sedrin, “*Zotërinjtë Gollovliovë*”, (1964) dhe “*Përralla*”,
Nikolai Gogol, “*Tregimet e Petërburgut*”,
“*Shpirtra*” ndryshuar më pas “*Frymë të vdekura*”,
- Pablo Neruda, “*Zgjohu, druvar*” (1958) dhe
poezi nga “*Bleta e bardhë*”, (1974),
- Vahtang Baratasvili, “*Miq të gëzuar*”, 1960,
- Viktor Eftimiu, “*Doktor Fausti magjistar*”, pjesë teatrale, 1963.

MUHAMED KËRVESHI



Prof. Dr. Muhamed Kërveshi u lind në Mitrovicë më 1935. Shkollën fillore e kreu në Pejë, ndërsa gjimnazin në vendlindje. U largua nga Kosova për të studiuar filozofi në Universitetin e Beogradit dhe më pas kreu studimet pas-universitare në Zagreb. U rikthye në Kosovë, në Prishtinë, ku mbrojti më pas edhe doktoratën. Ka dhënë mësim në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Muhamed Kërveshi, poet i afirmuar, është prezantuar në shumë panorama dhe antologji të poezisë shqipe, të botuara në Kosovë (në frëngjisht, në italisht, në gjermanisht, në anglisht, në turqisht, në serbisht), në Shqipëri, në Republikat e ish-Jugosllavisë dhe Vojvodinë edhe në vende të ndryshme të botës.

Poezitë e këtij autori janë botuar në “Antologjinë e lirikës shqipe” (gjithëshqiptare) në italisht, që e përpiloi dhe e botoi shkrimtari ynë Ernest Koliqi, në Milano, më 1963. Poezitë e Muhamedit botohen në spanjisht, në revistën letrare “Comoran y delfin” Buenos Aires (Argjentinë), 1971. Muhamed Kërveshi është përfaqësuar në “Antologjinë e Evropës...” në gjuhën gjermane, që e përpiloi, e përktheu dhe e botoi Dr. Egon H. Raketa, në Bon, më 1976. Vargjet e Kërveshit i zgjodhi dhe i përktheu në gjermanisht Rudolf Grulich, në antologjinë “Regen in einer Legende”, Heiligenhof, 1977.

Poezitë e Muhamed Kërveshit janë të botuara në arabisht, në antologjinë “Palestina shqiptare” që e përpiloi Muhamed Mufaku dhe e botoi Qendra Kulturore Arabe, në Siri, më 1980. Poezitë e Muhamed Kërveshit janë botuar në antologjinë “Një grusht kaltri” në turqisht, që e përpiloi, e përktheu Hasan Merxhan dhe u botua në Stamboll, më 1985. Poezitë e këtij poeti të njohur janë botuar në “Sikur një shqiponjë Antologji e lirikës shqipe që nga shekulli XVI deri në ditët tona”, që e përpiloi dhe e botoi në gjermanisht Robert Elsie, Shtutgard, 1988. Poezitë e Muhamed Kërveshit janë botuar në “Antologjinë e poezisë së poetëve të ish-Jugosllavisë”, Regnborgens Sanger, në gjuhën suedeze, të përpiluar dhe të botuar nga rumuni Jon Milosh, në Stokholm, 1991.

Gjithashtu poezitë e këtij shkrimtari janë botuar në antologjinë “Kosova në errësirë”, në frëngjisht, e përpiluar dhe e botuar nga Anne-Marie, Christiane Matecot, Alexandre Zotos dhe Yves Potel, e botuar në

Paris, më 1999. Poezitë e Muhamedit janë botuar në “Antologjinë e poezisë moderne shqipe” (shqip-gjermanisht), që e përpiloi, e përktheu dhe e botoi Ferdinand Laholli, në SHB. Doruntina në Gjermani, në vitin 2003.

Veprat për të rritur:

1. Ngjyrat e dashunisë (poezi), Rilindja, 1964; 2. Portretet në miniaturë (poezi), Rilindja, 1966; 3. Hijet (poezi), Rilindja, 1968; 4. Valët e reja (poezi), Rilindja, 1971; 5. Rrathët (poezi), Rilindja, 1973; 6. Piramidat (poezi), Rilindja, 1976; 7. Ngjyrat (poezi-serbokroatisht), Jedinstvo, 1977; 8. Ura (poezi), Rilindja, 1978; 9. Kundruall (poezi), Rilindja, 1980; 10. Vazhdimësi (poezi), Rilindja, 1982; 11. Zemra ime (Antologji e poezisë), SH.B. “Naim Frashëri”, Tiranë, 1982; 12. Etje (poezi-turqisht), TAN, 1982; 13. Sheshi i ditës (poezi), Rilindja, 1985; 14. Lojë në vazhdimë (Antologji e poezisë), Rilindja, 1985; 15. Trokitje (poezi), Rilindja, 1990; 16. Syri i Kosovës (poezi), Rilindja, 1994; 17. Shirat flasin (poezi), N.B. Rilindja, 1997; 18. Kontakte letrare (ese, kritika etj.), Rilindja, 1999; 19. Loti i Kosovës (poezi), Rilindja, 2000; 20. Zëri i ditëve (tregime poetike), “Dukagjini”, 2000; 21. Flaka e përqaftuar (poezi), SH.B. “Vëllezërit Frashëri”, 2001; 22. Dashuria peng (pesë drama), SH.B. “Vëllezërit Frashëri”, 2002; 23. Kopshtari i dashurisë (tregime poetike), SH.B. “Faik Konica”, 2003; 24. Jetë guri (poezi), Rilindja, 2003; 25. Zilja e kujtimeve (tregime), SH.B. “Vëllezërit Frashëri”, 2004; 26. Zjarri i përqaftuar (poezi), “Dukagjini”, 2004; 27. Çelësi (gjashtë monodrama), SH.B. “Vëllezërit Frashëri”, 2005; 28. Në pasqyrë (tregime), SH.B. “Vëllezërit Frashëri”, 2006; 29. Jetë druri (poezi), SH.B. “Vëllezërit Frashëri”, 2006; 30. Ora e madhe (poezi-dialog), SH.B. “Vëllezërit Frashëri”, 2006; 31. Hyrje në metaforë (poezi), SH.B. “Faik Konica”, 2008; 32. Antologji e poetëve të Pejës, SH.B. “Faik Konica”, 2009; 33. Ëndrra e diktatorit (roman), SH.B. “Faik Konica”, 2009; etj.

Veprat për fëmijë:

Telegramet e dallëndysheve (poezi), N.B. Rilindja, 1972; 46. Ylli rojtar (poezi), N.B. Rilindja, 1981; 47. Fjalë e nënës zog (poezi), N.B. Rilindja, 1986; 48. Shtëpia e re (tregime), N.B. Rilindja, 1989; 49. Ura (tregime), N.B.G.L. Dukagjini, 1997; 50. Xhufi (tregime), N.B.G.L. Dukagjini, 2001; 51. Në valle të rrezeve (poezi), Pionieri, 2002; 52. Gjuha e zogjve (roman për fëmijë) SH.B. Vëllezërit Frashëri, 2007; 53. Përrallzat me gjumë, SH.B. Vëllezërit Frashëri, 2007; 54. Në mes dy dashurive (tregime) SH.B. Faik Konica, 2017, etj, si dhe shumë vepra të shqipëruara nga frëngjishtja.

MIXHAIT REÇI



Akademik Prof.dr. Mixhait Reçi, Ph.D, u lindë në Strugë, Republika e Maqedonisë Veriore më 15.03.1957. Shkollën fillore dhe të mesme e kreu në vendlindje .Fakultetin ekonomik e kreu në Prishtinë .Magjistraturën e kreu në Universitetin e Zagrebit ,ndërsa doktoroi në ekonomi në Universitetin e Prishtinës. Për 28 vite ka punuar fillimisht si asistent pastaj si profesor në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, në lëndët e “Kontabilitet”, “Kontabiliteti Financiar”,

“Kontabiliteti i Menaxhmentit”, si dhe “Sistemi Informativ Financiar”. Akademik Prof.Dr. Mixhait Reçi është themelues dhe President i Kolegjit mbretëror “Iliria” në Prishtinë.


Ishte kryetar dhe anëtar i "Këshillit nismëtar për themelimin e Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tetovës".

Profesor Reçi ishte Dekani i Parë i Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Tetovës, mbajti një nga ligjëratat e para në këtë universitet, si dhe dorëzoi Indeksën e parë të regjistrimit të studentit në Universitetin e Tetovës. Ai ka botuar shumë punime shkencore dhe analiza si autor apo bashkautor. Z. Reçi është organizator dhe pjesëmarrës i shumë aktiviteteve shkencore.

Punime shkencore dhe publicistike:

- 1."Bisedimet për çështje teknike dhe statusi final i Kosovës";
- 2."Kosova dhe faktori ndërkombëtar";
- 3."Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe çështja shqiptare";
- 4."Besëlidhja e Lezhës dhe roli i Gjergj Kastrioti - Skënderbeut";
- 5."Kosova një vit shtet i pavarur";
6. “Kosova në rrugën e Integritimeve Euro - Atlantike, dhjetë vjet nga ndërhyrja e NATO-s”;
- 7.“Iliria dhe Ilirët”;
- 8.“Shën Pali ungjillëzuesi i Ilirëve”
- 9.”Gjuha standarde shqipe dhe gjendja aktuale e përdorimit të saj”;
- 10.”Të pavërtetat dhe dëmet e shkaktuara nga Raporti i Dick Marty;
11. “Kërkimi shkencor dhe Inovacioni në Arsimin e lartë universitar”;
- 12.“Media dhe politika “;
- 13.”Fjalori enciklopedik i Kosovës”, I dhe II,
ASHAK, Prishtinë, 2018.

MUHAMET MJEKU



Muhamet Mjeku u lind më 12 prill 1943, në Shpitullë të Prishtinës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin dhe Fakultetin Filozofik, në Prishtinë.

Fillimisht ka punuar si profesor në Shkollën Ekonomike, në Prishtinë, në Shkollën e Mesme të Mjekësisë, ku jepte dy lëndë, shqip e latinisht, pastaj në gjimnazin “Ivo Lolla Ribar”, tash “Sami Frashëri”. Aty Muhameti takoi edhe disa profesorë të kohës kur ishte nxënës, dhe nuk mund t'i besonte vetes se tash do të bëhej kolegë me ta. Ndërkohë atij iu shfaq dëshira që të bëhej gazetar, sepse qysh si gjimnazist, dhe më pas student, në gazetën “Rilindja”, kishte botuar disa shkrime dhe poezi në faqen e kulturës dhe në “Zanin e Rinisë”, ndërsa më herët në revistën, “Pioneri”.

Muhamet kishte besim në vete se mund ta kryente si duhet profesionin e gazetarit, që në atë kohë lakmohej nga shumëkush.

I bindur në këtë, në qershor të vitit 1971, pas një testi provues, filloi punë në të përditshmen “Rilindja”. Këtu punoi deri në maj të vitit 1974 prej nga kaloi në Televizionin e Prishtinës. Ndoshta për opinionin e sotëm është interesant se në rubrikën e kulturës të gazetës "Rilindja" në atë kohë punonte një elitë intelektualësh, si: Vehap Shita, Anton Pashku, Musa Ramadani, Gani Bobi, Mensur Raifi, Ali Podrimja, Dedë Mirdita, Nexhat Halimi, Sylë Osamani, Mensur Pozhegu, Muhamet Mjeku etj.

Në Televizionin e Prishtinës ka punuar si gazetar, redaktor i lajmeve dhe udhëheqës i rubrikës së brendshme. Afro një vit e gjysmë, derisa u adaptua ndërtesa e Televizionit të Prishtinës, ka përgatitur tri herë në javë ditarin (lajmet) nga studio e Televizionit në Beograd, prej nga emitoheshin lajmet në gjuhën shqipe.

Ka sajuar një numër të emisioneve dokumentare në Kosovë dhe jashtë saj. Ka realizuar disa dokumentarë nga një udhëtim atraktiv shumëditësh (45) në Afrikë, bashkë me xhiruesin e TVP-Urim Ukimerin. Po ashtu, ka realizuar edhe një dokumentar në Berlin në vitin 1975 me rastin e 30 vjetorit të ngadhënjimit mbi fashizmin.

Për shkak të “lëshimeve ideo-politike”, përballë konceptit të politikës së atëhershme serbe, është suspenduar disa herë. Gjatë grevës së minatorëve të “Trepçës” është larguar nga procesi i punës për një vit bashkë

me disa kolegë, dhe më pas është marrë gjashtë herë në biseda informative nga organet e sigurimit shtetëror të federatës, Serbisë dhe Kosovës.

Kur Slllobodan Millosheviq erdhi në Fushë-Kosovë në vitin 1989, për shkak të përgatitjes së një emisioni special kontestues, që u emitua për tërë rrjetin jugosllav, u suspendua dhe iu ndalua hyrja për një kohë të caktuar në lokalet e televizionit, bashkë me kolegun Nuhi Bytyqi.

Shtypi serb dhe politika serbe këtë emision e anatemoi si diversion kundër sistemit jugosllav.

Në Televizionin e Prishtinës ka punuar deri më 5 korrik 1990, kur ky institucion u okupua nga policia serbe dhe u nxorën dhunshëm të gjithë punëtorët shqiptarë, me përjashtim të ndonjë shqiptari të “ndershëm”, siç e shpiku këtë term asaj kohe politika në Beograd.

Muhameti ka qenë redaktori i parë i ditarit të Televizionit të pavarur në Prishtinë, 1975 dhe redaktori i fundit i ditarit të orës 7:30 (lajmeve), 5 korrik 1990 kur policia serbe mbylli këtë institucion iformtivo-kulturor.

Pas mbylljes së televizionit botoi librin “Shaban Polluzha dhe Lufta e Drenicës”, që ishte libri i parë për një temë tabu. Ky libër u botua në 10.000 ekzemplarë. Më parë po në këtë temë kisha botuar një fejtton në 13 vazhdime në revistën “ Zëri i Rinisë”. Libri është botuar dhe është shpërndarë fshehtas në Kosovë, Zvicër, Gjermani etj.

Pas botimit të këtij libri dhe mbylljes së Televizionit të Prishtinës, iu përgjigj thirrjes së veprimtarit dhe biznesmenit të njohur, Harry Bajraktari për nxjerrjen e gazetës “Illyria” në New York, ku punoi si editor i parë i saj.

Përpos librave, ka botuar një seri artikujsh publicistik dhe disa fejtone me karakter politiko-historik.

Njëherit, ka qenë pjesëmarrës në projektin “Kombi-rrugët e bashkimit kombëtar”, New York 1997. Ka në dorëshkrim librin "Ditari i Luftës", i cili së shpejti do të jetë në duartë e lexuesve.

Librat e botuara:

- "Lufta e Drenicës-Shaban Polluzha", Prishtinë, 1991,
- "Vdekja në Bunker", Prishtinë, 1996,
- "Pse sulmohet Drenica?" New York, 1998
- "Kosova në dimrin e vitit 1945", Prishtinë, 2003,
- "Shqiptarët 120 vjet pas Lidhjes së Prizerenit", New York, 1997,
- "Një jetë mes Kosovës dhe Amerikës", New York, 2008,
- "Binak Alia dhe Brezat pas tij", New York, 2016.
- "Familja Mjeku-rrugëtimi i saj historik", 2019, etj.

MUHARREM BERISHA (1942-2010)



Prof. Muharrem Berisha, u lind më 1942 në fshatin Vilanc, komuna e Vushtrrisë. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, ndërsa në vitin 1961 kreu Shkollën Normale në Prishtinë.

Gjatë vitit shkollor 1961/62 ka punuar mësues në shkollën fillore të Samodrexhës dhe të Novosellës, të komunës së Vushtrrisë. Në vitin shkollor 1962/63 u regjistrua në studimet e matematikës në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. U diplomua më 1966. Gjatë vitit shkollor 1966/67 punoi profesor i lëndës së matematikës në

Shkollën e Mesme Teknike të Prishtinës.

Në tetor të vitit 1967 ka mbajtur ushtrimet nga Analiza matematike I në katedrën e matematikës të Fakultetit Filozofik të Prishtinës. Në mars të vitit 1968 zgjidhet asistent në katedrën e matematikës.

Më 1969 u regjistrua në studimet pasuniversitare në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Beogradit.

Në vitin shkollor 1970/71 autorizohet të mbajë ligjërata në katedrën e matematikës të FSHMN-së. Në vitin 1974 magjistroi në Fakultetin e Shkencave Matemaikë-Natyrore të Beogradit.

Gjatë periudhës shkurt 1978-shkurt 1979 ka qëndruar në specializim në Universitetin “Lomonosov” të Moskës. Në maj të vitit 1979 ka mbrojtur tezën e doktoratës

Po në këtë vit zgjidhet docent në seksionin e matematikës në FSHMN të Prishtinës. Në maj të vitit 1982 u zgjodh profesor inordinar në lëndën, Analiza matematike I, ndërsa në mars të vitit 1987 profesor ordinar në FSHMN të Prishtinës.

Më 24 dhjetor 1996 u zgjodh anëtar korrespondent, ndërsa më 20 dhjetor 2000 anëtar i rregullt i ASHAK-ut. Gjatë kësaj periudhe, që nga viti 1967, si asistent, docent, profesor inordinar dhe ordinar në seksionin e matematikës ka ligjëruar, ka udhëhequr seminar

Ka qenë kryesues i Kryesisë së Shoqatës së Matematikanëve, Fizikanëve dhe Astronomëve të Kosovës, ka qenë shef i seksionit të matematikës. Nga tetori i vitit 1985, deri në tetor të vitit 1987, ka kryer detyrën e prodekanit të FSHMN-së.

Në vitin 1987 zgjidhet dekan i FSHMN-së, është laureat i Shpërblimit të Dhjetorit të vitit 1983.

Është korrespondent i Mathematicial Reviews dhe anëtar i American Mathematical Society.

Gjatë periudhës 1985-1991, sa e ka parë dritën revista “Punime matematike”, ka qenë redaktor i saj si dhe i revistës “Kërkime” dhe sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës të ASHAK-ut. Vdiq më 2010.

Punimet shkencore:

M. Berisha, Transformacija i zbirlijvnost Fourier-ovog reda neprekidne funkcije. 1974. Beograd (Punimi i magjistraturës).

M. Berisha, Vlerësimi i koeficjentëve Fourier të një funksioni nga klasa, Bul. FSHMN. Nr. 5 1977.

M. Berisha, Procena Fourier-ovih koaficijenata nekih klasa funkcija, 1979, Prishtinë, (Tezë e doktoratës).

M. Berisha, O koeficijentah Furie nekatorih klasov funkcij. Glasnik matematički, Zagreb, 1981.

M. Berisha, Mbi koeficientët Fourier monotonë të funksionit çift nga klasa e funksioneve, Kërkime, ASHAK, Nr. 2 (1983).

M. Berisha, On coefficients of double lacunary trigonometric series. Rostock, Math.kolloq, 43, 27-38, (1990).

Muharrem Berisha, Fevzi Berisha, An application of a Peetre type k -functional in approximation theory. Kërkime, ASHAK. 6, (1998).

M. Berisha, Shumimi i serisë Fourier të një funksioni të vazhdueshëm. Kërkime, ASHAK, 7, (1999).

.M. Berisha, M. Q. Berisha, Jackson and its converse theorems for a generalized modules of smoothness. Kërkime, ASHAK 8, (2000).

F. M. Berisha, M. Q. Berisha, Jackson theorem for a generalized r -th modules of smoothness. Kërkime, ASHAK 9, (2001).

M. Q. Berisha, F. M. Berisha, A note on the inverse theorem for a generalised modulus of smoothness. Mat. Bilten. Skopje, 25(51)(2001) etj.

Punimet profesionale:

Krahasimi lokal i funksioneve; “Dituria”, revistë shkencore e studentëve të Kosovës, 1975; Mosbarazitë dhe mosbarazimet; Matematika-Fizika, revistë profesionale–metodikë, 1980; Mosbarazimet sumultante të shkallës së dytë; Matematika-Fizika, revistë profesionale-metodike, 1984, etj.

Tekste shkollore dhe universitare:

N. Maksimoviq, G. Nenkoviq, Matematika për kl. II dhe III të shkollave të mesme dhe profesionale, Prishtinë, 1975; M. Živkoviq, Aritmetika për kl. V të shkollës fillore, Prishtinë, 1976, Përkthyes: M. Berisha, etj.

MUHARREM BLAKAJ



Muharrem Blakaj u lind në fshatin Vrellë, komuna e Burimit. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, të mesmen, ekonomiken, tre vitet e para në Pejë, ndërsa vitin e katërt, maturën, në Burim, ish Istog. Pas regjistrimit në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, krahas studimeve, vazhdon aktivitetet patriotike e kombëtare, të filluara qysh në vitet e para të shkollës së mesme, në bashkëpunim me grupin ilegal, që udhëhiqej nga Jusuf Gërvalla. Më 14 dhjetor të vitit 1979 e arrestojnë milicia jugosllave, duke e ndaluar në burgun hetues të Qarkut, në Pejë. Me ndihmën e avokatit Bajram Kelmendit, lirohet nga burgu dhe në tetor të vitit 1987 detyrohet ta lëshojë Kosovën, dhe të kërkojë strehim politik në Zvicër. Ai deri më tani, i ka botuar kudo në shtypin shqiptarë, qoftë në diasporë apo në Kosovë, si tregime dhe fragmente nga romanet e tij.


Gjatë bastisjeve në shtëpinë e tij, si provë materiale, policia ia konfiskon dorëshkrimet: „Monolog i një komiti“ (tregime), dhe dy novela; „Balta me gjak“ dhe „Besa“, të cilat nuk ia kthejnë asnjëherë.

Vepra të botuara:

1. „Misioni sekret“, roman, Shtëpia Botuese „Rozafa“, Prishtinë, 2004,
2. „Thesaret e humbura“, roman, SHB, SHKSH „Mëmëdheu“, 2005,
3. „Atentat brenda germës L“, roman, SHB, „Kombi“ (IKDFK), 2007,
4. „Paraardhësit“, roman, SHB, SHKSH, „Mëmëdheu“, CH-St. Gallen, 2009,
5. „Rugëtim Fatal“, monografi, Shtëpia Botuese, „Dukagjini“, Pejë, 2012,
6. „Nana Kadë“, film dokumentar, Pejë, 2018,
7. „Paraardhësit“ roman, botim i dytë, Shtëpia Botuese, „Rozafa“, Prishtinë, 2018,
8. „Mëndesha“ tregime, Shtëpia Botuese, „LENA“, Prishtinë, 2018,

Krijimtaria e tij letrare u vlerësua me disa mirënjohje dhe çmime letrare nga: „Shoqate e Krijuesve Shqiptarë në Zvicër“, „Lidhja e Krijueseve Shqiptarë në Mërgatë“, Klubi Letrar „Martin Camaj“ në Mynih, Shtëpia e Kulturës, „Koço Racin“ në Shkup dhe „Unioni i Shkrimtarëve dhe Kritikëve Shqiptarë“, që ia ndau çmimin: „Ramiz Kelmendi“, në tregim, për vitin 2018.

MUHARREM QENA (1930-2006)



Muharrem Qena, u lind në qershor të vitit 1930 dhe vdiq më 24 shtator të vitit 2006, ishte shkrimtar, këngëtar, aktor dhe regjisor shqiptar.

Muharrem Qena është njëri prej themeluesve të skenës teatrore dhe të këngës argëtuese shqiptare. Ai punoi si regjisor, producent, këngëtar, dhe skenarist. Gjimnazin e kreu në Prishtinë, kurse shkollën e filmit në Beograd. Ai shkriu talentin e tij prej regjisor, aktori, shkrimtari dhe këngëtar. Ishte regjisor i më se 200 shfaqjeve teatrale.

Shpërblimet e shumta lokale e ndërkombëtare, e radhisin ndër krijuesit më të mirënjohur kosovar. Me "Ervehenë" e autorit Ahmet Qirezi (1932), mori 5 shpërblime kryesore në Festivalin e Steries-Novi Sad (1967). Muharremi ishte nismëtar i punës së teatrove në Prizren, Gjakovë dhe Gjilan. Ai krijoi dhe këndoi një sërë këngësh argëtuese në frymën bashkëkohore, të cilat frymëzuan dhe u falën kënaqësi shumë brezave.

Muharrem Qena vdiq më 24 shtator 2006 në Prishtinë, duke lënë pas tij një veprimtari të gjerë prej shkrimtari, regjisor i këngëtar dhe më se 200 shfaqje teatrale.

Regjisor:

"Bashkëshortët",
"Zonja me Kamelie",
"Erveheja",
"Njerëzit me shpresa te thyera",
"Anmiku i popullit",
"Ambrozio shfaros kohën" etj.

Aktor:

"Kapedan Lleshi",
"Proka" (1984),
"Lepuri me pesë këmbë" (1982),
"Kukumi",
"Kur pranvera vonohet" (1980),


Skenarist drame:

"Bashkëshortët",

Autor kënge:

"Kaçurrelja", "Shokut", "Lamtumirë", "Mine", "Tetori", etj.

MURTEZA NURA (1935-2017)



Murteza Xajë Nura, u lind në Pejë, më 27 nëntor 1935. Është rritur në Pejë, ndërsa pjesën më të madhe të jetës e kaloi në Gjakovë.

Ishte aktivist i çështjes kombëtare, për të cilën u dënua me burg për dyzet e katër vite, por i mbajti vetëm dymbëdhjetë. Ai ishte piktor me disa ekspozita personale, poet e shkrimtar i shumë veprave letrare. Vdiq më 12 korrik 2017.

Xaja i takon grupit të shkrimtarëve të lirë, po që në kohën e "patlixhonave të kuq", ishte i ndaluar dhe i burgosur. Gjatë jetës së tij ka botuar numër të madh të librash, por si pasojë e rrethanave, në të cilat ka vepruar, me tirazh të vogël e më shpesh dorëshkrime të lëna për botim.

Ndër tjera nga shënimet gazetareske lë të kuptohet se, Xaja, ka 15 vëllime poetike, 5 romane dhe disa piktura, si pjesë e "pakërcimeve" letrare. Me këto piktura, Xaja, është paraqitur pas luftës së fundit, para dashami-rëve të artit figurativ në gjashtë ekspozita.

Nga përcjellësit e veprimtarisë së tij, ai paraqitet si një figurë e lindur rebel dhe oponentë e krijimtarisë artistike. Xaja ka botuar gjithsej 22 vepra, disa prej të cilave janë të listuara më poshtë. Xaja po ashtu ka dhe mbi 30 vepra të pabotuara akoma, në formë dorëshkrimesh.

Veprat letrare:

“Maratona e Prerë”, poezi, botuar më, 1993, “Pragoxhaku Diellor”, poezi, botuar më 1993, “Shtesë Shqipe”, poezi, botuar më 1993, “Profil Brenge”, poezi, botuar më 1993, “Mundimtorja”, roman, botuar më 1993, “Aktrimi i Frymës”, poezi, botuar më 1993, “Heshtja e Biblave:”, poezi, botuar më 1994, “Oorbulla e Mynxyrës”:”, roman, botuar më 1994, “Rrëzë Kalvari”, roman, botuar më 1994, “Dergja:”, poezi, botuar më 1994, “Traktat Poetik”, “Ungjillizim i Jetës”, poezi, botuar më 1994, “Dita e Vrasjes”, roman, botuar më 2004, “Sizifi dhe Kentaurët”, botuar më 2004, “Klithja e Metaforës”, botuar më 2004, “Muzgu në Morgë”, botuar më 2004, “Një Jetë Ndryshe”, botuar më 2004, “Vitrazh i Thyer”, botuar më 2009, “Jam Udha e Virtytit”, botuar më 2009, “E Vërteta Vjen Virgjër”, botuar më 2010, “Dëshmorin nuk e do Harrimi”, botuar më 2012.

MURTEZA OSDAUTAJ



Prof. Dr. Murteza Osdautaj, u lind në fshatin Isniq të Deçanit, më 15 prill 1964. Është drejtor i përgjithshëm i Departamentit për planifikim dhe mbikëqyrje e zhvillimit të sistemit të shkencës dhe teknologjisë pranë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Republikën e Kosovës.

Në dhjetor të viti 1989 diplomoi dhe mori titullin Profesor i Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe.

Fusha kryesore e profesionit; Letërsia shqipe e realizmit, letërsia shqipe neoklasiciste, Kritika letrare, shkollat e studimit të letërsisë (Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filologjik, Prishtinë, Kosovë). Më 1997 magjistroi në shkencat filologjike (Letërsi).

Dhjetor 2002: Ciscocertifiednetworkassociation (CCNA)

Fusha kryesore e profesionit *Hardueri dhe softueri për rrjetat kompjuterike, konfigurimi dhe planifikimi i rrjetave të mëdha WAN dhe të vogla LAN (CiscoNetworkAcademy - USA).*

Në qershor 2008, doktoroi në Shkencat Filologjike në Letërsi.

Në prill të 2009 përfundoi masterin e shkencave të edukimit (edukimi special) Niveli sipas klasifikimit ndërkombëtar dhe evropian ISCED 5A-Shkalla e dytë.

Në Tetor 2008-janar 2009, punoi ligjëruesi lëndës Arsimit Inkluziv në projektin PARK.

Në Tetor 2010-shkurt 2010: ligjërues i lëndës Letërsia e Romantizmit në Fakultetin e Edukimit-UP (Gjakovë). Në Nëntor 2010-Mars 2011: ligjërues i lëndës Kulturë gjuhe dhe shkrim akademik, në programin për aftësim dhe kualifikim të mësim-dhënësve (AKM).

Në Tetor 2011- janar 2012, ligjërues i lëndës Shkathtësi të mësimimit akademik, në vitin e parë të drejtimit parashkollor-Fakulteti i Edukimit në Gjakovë.

Në Shkurt 2012-qershor 2012, ligjërues i lëndës Kulturë gjuhe dhe shkrim akademik në programin për aftësim dhe kualifikim të mësimdhënësve (AKM).

Shkurt 2012-qershor 2012, ligjërues i lëndës Kulturë gjuhe dhe shkrim akademik në programin për aftësim dhe kualifikim të mësimdhënësve (AKM).

Shkurt 2012- tetor 2012; shkurt 2013–tetor 2013, Shkrim Akademik dhe kulturë gjuhe, në vitin e dytë të drejtimit Arkitekturë-UBT, Prishtinë.

Mars 2013-tetor 2013, Edukim special-Inkluziv në programin për aftësim dhe kualifikim të mësimdhënësve (AKM).

Mars 2013-tetor 2013, Teori e mësimimit dhe punë praktike, kolegji AAB dega Gjakovë.

Tetor 2013- tetor 2015, Shkrim Akademik dhe kulturë gjuhe, në vitin e dytë të drejtimit Arkitekturë - UBT, Prishtinë.

Tetor 2015-tetor 2016, ligjërues i lëndës Kulturë gjuhe dhe shkrim akademik në programin për aftësim dhe kualifikim të mësimdhënësve (AKM), Universiteti i Prishtinës dhe MASHT, Prishtinë.

Librat e botuara:

1. “Haleluja në gjumë” (poezi) “Dielli”, Prishtinë, 1995
2. “Vdekja e Sizifit” (poezi), KL “Jusuf Gërvalla”, Deçan, 1996
3. “Lumenj të shterruar” (poezi)-Eurorilindja, Tiranë, 1999
4. “Psalme dhe sakrilegj” (poezi), Pejë, 2000
5. “Fjalë dhe gurë” (poezi), SHKP-Pejë (bashkautor), 2003
6. “Leximi poetic”, (studim kritik) ese për poezinë bashkëkohore, Shoqata e Artistëve, Pejë, 2008
7. “Hermesi i ndalur”, monografi (Bashkautor), Prishtinë, 2007
8. “Poetika e Dritëro Agollit”, SHB 'Faik Konica', Prishtinë, 2011
9. “Kompozicioni i Veprës Epike”, 'Faik Konica', Prishtinë, 2012
10. “Puhizë mbi Koshare”. Përmbledhje poezish (bashkautor), "Faik Konica", Prishtinë, 2014
11. “Poetika Kontekstuale e tekstit”, ShSh të Kroacisë, Zagreb, 2014
12. “Psalme dhe nudo” (poezi), ShB “Faik Konica”, Prishtinë, 2016
13. “Psalme dhe djaj” (poezi), ShB “Armagedoni”, Prishtinë, 2018
14. “53” (poezi), ShB, “Armagedoni", Prishtinë, 2019.

Dispensa të botuara për studentë:

1. Fillet e shkrimit Akademik, dhe
2. Arsimi special dhe qasja e barabartë e FNV në shkollë.

Profesor Murteza Osdautaj, prej tetorit të vitit 2015 - tetor 2016, ishte ligjërues i lëndës: Kulturë gjuhë dhe shkrim akademik në programin për aftësim dhe kualifikim të mësimdhënësve (AKM), në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe pranë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Prishtinë.

MUSA HAXHIU (1939-2007)



Prof. Dr. Musa Haxhiu, u lind më 15 mars 1939 në Pejë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje. Diplomoi në Fakultetin e Mjekësisë në Beograd më 1963. Gjatë viteve 1964/67 punoi në spitalin për mjekim të tuberkulozit “Ali Kelmendi” në Pejë.

Specializoi në Beograd në lëmin: Sëmundjet të mushkërive, në vitin 1968. Studimet pasdiplomike në lëmin e Kardiologjisë i përfundoi në Beograd më 1971. Në vitin 1973, në Universitetin e Zagrebit, e mbrojti tezën e doktoratës dhe promovohet Doktor i Shkencave të Mjekësisë. Po këtë vit Dr. Musa A. Haxhiu vazhdoi edhe 6 muaj specializimin dhe studimet plotësuese në Postgraduate Medical School në Londër, Britani e Madhe.

Gjatë viteve 1973/75 emërohet Dekan i Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë dhe kjo periudhë ishte periudha më e ndritur e këtij Fakulteti.

Prof. dr M. Haxhiu bëhet emër i njohur i shkencave mjekësore, prandaj gjatë viteve 1975/76 qëndroi në Pennsylvania University, Philadelphia, SHBA.

Në vitin 1978 ftohet në një Qendër tjetër të fuqishme shkencore në Silikose-Forschungsinstitut der Bergau-Berufs-genossenschaft, Bochum, RF. e Gjermanisë.

Në vitin 1977 emërohet Profesor inordinar i Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë për lëndën Fiziologjia Patologjike.

Periudhën 1978/79 emërohet kryetar i Lidhjes së Shoqatave të Fiziologëve të ish-Jugosllavisë, anëtar i disa asociacioneve profesionale dhe shkencore në vend dhe jashtë vendit. Në vitin 1979, bazuar në të arriturat profesionale dhe shkencore, zgjidhet anëtar me korrespondencë i Akademisë të Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Në vitin 1980, Akademik M. Haxhiu, sërish qëndroi në Institutin Silikose Forschungsinstitut der Bergau-Berufs-genossenschaft, Bochum Gjermani. Në vitin 1982 ftohet në Case Western Reserve University, Cleveland, Ohio, USA. Në vitin 1983 emërohet Profesor ordinar në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë.

Në vitin 1990 zgjidhet kryetar i ASHA të Kosovës.

Gjatë këtyre viteve, Prof.dr. Musa Haxhiu formoi Institutin e Fiziologjisë Patologjike.

Në këtë Institut për herë të parë filluan punën eksperimentale kirurgët, gastroenterologët dhe specialistët e degëve tjera të Mjekësisë Interne. Pas demonstratave antikomuniste të vitit 1981 në Kosovë, në diferencimin ideopolitik në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve, Akademik Musa Haxhiu me guximin e intelektualit të kalibrit më të lartë, kundërshtoi njëmendësinë moniste.

Prej vitit 1990 Prof. Haxhiu jetoi dhe veproi në Ohajo të SHBA-ve, por, pa u ndarë asnjëherë nga Kosova dhe përkrahja e shkencëtarëve të rinj, të cilëve u mundësoi përfundimin e tezave të Doktoraturave në Amerikë.

Akademik Prof. Dr. Musa A. Haxhiu, pa dyshim është eksperti më i cituar në literaturën shkencore botërore, jo vetëm ndër mjekët shqiptar por edhe atyre evropian.

Ka botuar disa tekste universitare dhe mbi 400 punime, kumtesa dhe ligjërime shkencore në të gjitha revistat me renome botërore. Kontributi shkencor dhe profesional i Akademik Musa Haxhiut i bënë nder kombit tonë dhe humanizmit në tërësi.

Më 17 09 2007 në Ohio të Amerikës, pushoi së rrahuri zemra e të ndriturit, shkencëtarit, fisnikut dhe atdhetarit të devotshëm Akademik Prof. dr. Musa A. Haxhiu.

Në Case Western University mbajti pozitën e profesorit në katër institute. Për aftësitë shkencore dhe organizative ai qe angazhuar nga Howard University në Washington DC, ku i vuri themelet dhe ngriti në këmbë një laborator te neurofiziologjise moderne.

Ka qenë anëtar Këshillit recensues i tri revistave më me zë të Shoqatës Amerikane të Fiziologjisë the te Neurofiziologjise, ndërsa ishte anëtar i shumë shoqatave, siç janë: American Association for the Advancement of Science, American Physiological Society, International Brain research Organisation, Society for neuroscience, New York Academy of Sciences, pa i përmendur anëtarësinë dhe pozitën në Akademinë tonë.

Vështirësitë e bënin më këmbëngulës dhe më të determinuar për të arritur qëllimin. Përballë të gjitha angazhimeve ai ishte pedant në zyrë, në laborator dhe në publik, duke i kushtuar kujdes të veçantë veshjes dhe dukjes fizike.

Gjatë qëndrimit tij në spital, pothuaj çdo ditë i diskutonin projektet aktive dhe bënin plane për projekte të tjera. Në asnjë moment ai nuk tregoi pesimizëm, frikë ose dorëzim përballë sëmundjes.

MUSA RAMADANI



Musa Ramadani, u lind më 21 maj 1941, në Gjilan. Qysh si foshnje, bashkë me familjen, nga pushteti i atëhershëm, u depërtua në Prizren, ku e kreu një pjesë të shkollimit fillor, për ta vazhduar atë (me të kthyer sërish) në Gjilan e në Viti. Në Gjilan e kreu edhe shkollimin e mesëm (Shkolla e Nxënësve në Ekonomi), ndërsa në Prizren në Shkollën e Lartë Pedagogjike, Dega e Letërsisë dhe Gjuhës. Që nga bankat e shkollimit të mesëm zu të merret me gazetari e letërsi, në mënyrë, që, nga viti 1965 e deri në mbyllje të saj, pas vitit 2000, të punojë gazetar, redaktor në të përditshmen “Rilindja”.

Musa Ramadani është prezantuar në disa nga vëllimet, panoramat letrare e antologjitë, të përkthyer edhe në gjuhë tjera. Është laureat i një sërë çmimesh. Talentin e tij e ka sprovuar edhe në krijimtarinë e fushave të tjera artistike.

Është autor i një sërë tekstesh për këngë të lehta e të muzikës së tendencave moderne. Është autor edhe i disa këngëve në frymën e zhanrit të muzikës së lehtë.

Ndonëse pa ndonjë përgatitje paraprake muzikore, ka kompozuar këngë, të cilat, madje në manifestimin më të madh muzikor të kohës, “Akodret e Kosovës”, janë vlerësuar edhe me Çmimin e Parë të Jurisë.

Herë pas herë, është marrë e merret edhe me pikturë. Madje një “kaptinë” e tërë e romanit të tij të fundit “*Inamor:55*”, është e “ilustruar” nga vetë punimet e autorit. Ramadani ka shkruar edhe humoreska, skeçe humoristike e shkrime satirike, me pseudonimin “*Babloku*”.

Merret edhe me shkrime eseistike e kritikë teatrore, sikundër edhe me Udhëshkrime (nga Vjena e Parisi).

Drama “Moisiu në unazën e Inlandit”, në sezonin 2003, u inskenua nga Teatri Kombëtar i Prishtinës, ndërkaq, drama “Ligatina” e Nebi Islamit, shkruar sipas motiveve të romanit homonim të Musa Ramadani, në sezonin 2006, u inskenua në Teatrin Kombëtar të Gjilanit.

Musa Ramadani punon me një përkushtim të madh, gjithnjë duke i qëndruar besnik frazës e vargut të latuar deri në përpikëri, të një sintakse të kulluar shqipe, të një leksiku të begatshëm shprehjesh është cilësuar nga kritika letrare, siç është vepra “*Ligatina*”, sikundër edhe “*Zezona*”, e një sërë përmbledhje tregimesh prej tij.

Vepra letrare:

- “Mëkatet e Adamit” (poezi), “Rilindja, 1969;
“Thirravaje” (poezi), “Rilindja”, 1971;
“Neurosis” (poezi), botim autorial, 1973;
“Romani pa kornizë”, “Bota e Re”, 1975;
“Muzat nuk flejnë” (poezi), “Rilindja, 1976;
“Fluroma” (tregime), “Rilindja”, 1978;
“Zezona” (roman), “Rilindja”, 1978, “Faik Konica”(ribotim), 2003;
“Fjala në skenë” (recensione për shfaqje teatrore), “Rilindja”, 1980;
“Alfabeti i neurozave” (poezi), “Flaka e Vëllaznimit”, 1983;
“Ligatina” (roman), “Rilindja”, 1983;
“Moisiu në unazën e Inlandit” (dramë), “Rilindja”, 1984;
“Eugjenika e tri deteve” (poezi), “Rilindja”, 1986;
“Satana ma vodhi gurin e urtisë” (tregime), “Rilindja”, 1987;
“Nostalgji antike” (përzgjedhje e poezive), “Rilindja, 1995;
“Vrapuesja e Prizrenit” (roman), “Dukagjini”, 1997;
“Antiprocioni” (roman), “Buzuku”, 1997;
“Inamor: 55” (roman), “Buzuku”, 2000.
“Mëkatet e Ha(E)vës”, poezi, Pen/club, 2007, Prishtinë
“Premiera shqiptare” (Recensione për dramën, shfaqjet), “Spektri”,
Shkup 1996;
“Profeti nga Praga” (roman), Tiranë, 2017.


Përkthimet:

- “Mariamna” - Pär Lagerkvist,
“Fillokteti” - Heiner Müller,
“Askushi” - Jezi Andzejevski,
“Shkretëtira e tatarëve” - Dino Buzzati,
“Legjenda per Araratin” - Yasar Kemal,
“Bufi i verbër” - Sadec Hedayat,
“Dhe nuk gjej vëlla më të mirë” - Maksud Ibrahimbekov,
“Humbella” - Mirko Kovaç,
“Ditë pranvere” - ċiril Kosmać,
“Aromat, ari e temjani” - Slobodan Novak,
“Piramida e Emës” - Dubravka Ugrešić,
“Ogursëzi” - Nedžad Ibrisimović etj.

Çmimet:

- Çmimi letrar “Beqir Musliu”, 2006, Çmimi Kadare, 2017...

MUSLIM MULLIQI (1934-1998)



Muslim Mulliqi, u lind më 1 qershor 1934, në Gjakovë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, Shkollën e Mesme të Artit e regjistroi në Pejë, dhe pa e mbaruar atë, në vitin e tretë, konkurroi në Akademinë e Arteve Figurative në Beograd, ku u pranua më 1954. U diplomua në klasën e profesoreshës Zora Petroviq. Te kjo profesoreshë kreu dhe studimet pasuniversitare, në vitin 1961. Po këtë vit kthehet në Kosovë.

Një kohë punon në Sekretariatën për Arsim e Kulturë dhe shumë shpejt merr bursën njëmujore për Paris. Në vitin 1963 fillon punë në Shkollën e Lartë Pedagogjike, Dega e Pikturës. Konsiderohet nismëtar i Akademisë së Arteve të Universitetit të Prishtinës (1973), ishte kryetar i komisionit amë dhe që nga viti 1974 dekan i saj. Atë vit merr dhe titullin profesor inordinar.

Veprat e tij gjenden në shumë koleksione të njohura. Me emrin e tij sot Galeria e Arteve e Kosovës organizon njërin nga manifestimet më prestigjioze të arteve pamore në vend.

Anëtar i Shoqatës së Artistëve Figurativë të Kosovës, ishte që nga themelimi i saj. Anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, u zgjodh në vitin 1979, ndërsa në vitin 1985, anëtar i rregullt i ASHAK-ut.

Një mandat (1984-1986) ka qenë sekretar seksioni, ndërsa për dy mandate nënkryetar i ASHAK-ut, (1986-1988 dhe 1988-1990). Vdiq në Prishtinë 1998.

Ekspozitat e pavarura:

1952-Pallati i Kulturës, Gjakovë, 1956, 1960, 1965-Foajeu i Teatrit Popullor, Prishtinë; 1967-Pallati i Kulturës, Smederevë; Galeria e Shtëpisë së APJ-së, Tuzëll, Rjekë, Pulë, 1969-Foajeu i Teatrit Popullor, Prishtinë, 1970-Salloni i Vogël Figurativ, Novi-Sad, 1973-Galeria e APJ-së, Beograd, 1974-galeria “Gjuro Sallaj”, Beograd, 1975-galeria “Heleoart”, Romë (Itali), 1989-1990–Galeria e KO, Grozhnjan, 1993-La Galerie, Pejë, Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë, 1996-galeria “Evropa”, Pejë, Galeria “Roma”, Prishtinë, etj.

MUSTAFË MUSA



Mustafë Musa, është i lindur më 05.03.1953, në fshatin Pozheran, Komuna e Vitisë, ku ka kryer edhe shkollën fillore. Shkollën e mesme e ka kryer në Viti, është diplomuar në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës, ku ka mbaruar edhe studimet pasuniversitare, ka marr titullin shkencor Master i shkencave juridike, drejtimi civilo-juridik.

Studimet Ph.D i ka përfunduar në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës, Republika e Maqedonisë, ku dhe ka marr titullin doktor i shkencave juridike, drejtimi Civilo - juridik.

Nga viti 1976 ka punuar në organet e jurispodencës, gjyqtar i Gjykatës Komunale ne Viti, deri në vitin 1984, ku kishte treguar suksese ne aspektin profesional, për çka në fillim të vitit 1985 ishte avancuar dhe është emëruar gjyqtar i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, ku ka punuar deri në shtator të vitit 1990, kur dhe është larguar nga puna, nga pushteti i atëhershëm serb.

Gjatë gjithë kohës sa kishte punuar e organet gjyqësore, kishte punuar në materien civile.

Nga viti 1990 është licencuar pranë Odës së Avokatëve te Kosovës, ku nga atëherë e edhe tani, ushtron veprimtarin e avokatisë së pavarur.

Nga viti 2011 është i angazhuar për ligjërues i lëndëve civile pranë Kolegjit FAMA, në Prishtine, në të dy programet si në Bachelor ashtu edhe në Master.

Është autor i shumë punimeve shkencore me impakt kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e së drejtës civile:

Kontrata e depozitit,
Marrëveshjet e arbitrazhit,
Servitutet.

Autor i këtyre botimeve:

“E drejta dhe Noteria”,
“E drejta e arbitrazhit”,
“Posedimi dhe Mbrojtja e tij” (në praktikën gjyqësore),
“Klinika juridike e se drejtes civile”,
“E drejta e procedures civile I”, bashkautor dhe
“E drejta e procedures civile II”, bashkautor.

Mustafë Musa jeton dhe vepron në Gjilan.

MUSTAFË HAZIRI



Prof. Dr. Mustafë Haziri, u lind në fshatin Leçinë të Skenderajt, më 03.01.1966. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse të mesmen në Skenderaj, në vitin 1983. Fakultetin filozofik në Universitetin e Prishtinës, e kreu më 1987. Në vitin 1989 filloi punën si mësimdhënës në shkollën fillore në Shipol. Punoi si profesor në gjimnazin "Frang Bardhi", rreth 20 vjet , ndërsa në vitin 2008, u emërua drejtor i shkollës fillore "Shaban Idrizi" në Zhabar të Mitrovicë. Në vitin 2010, e përfundoi masterin në Universitetin e Prishtinës, dhe doktoroi në lëminë e Historisë.

Është bashkëpunëtor i jashtëm i Institutit të Historisë dhe Institutit Albanogjik dhe bashkautor në projektin për historinë e Kosovës, si dhe bashkëpunëtor në projektin e enciklopedisë së hartuar nga Akademia e shkencave dhe arteve të Kosovës. Është autor i 2 monografive dhe i mbi 38 punimeve shkencore të botuara brenda dhe jashtë vendit, në revistat kredibile ndërkombëtare me impakt faktor, Ai është organizator i shumë konferencave shkencore brenda dhe jashtë vendit, fitues i bursit ndërkombëtar CIPUS . Është anëtar i bordit të Universitetit "Isa Boletini" ne Mitrovicë, sekretar i Lidhjes së Historianëve të Kosovës, si dhe koordinator i Qendrës për studim dhe hulumtim në Mitrovicë.

Botimet:

1. “Dasma gjatë viteve të tetëdhjeta të shekullit XX në rrethinën e Preshevës”, Preshevë, 2012.
2. “Shtypi i kohës për Grevën e Minatorëve të Trepçës”, 2012.
3. “Greva e minatorëve të Trepçës ne Stan-Terg” 1989, 2011.
4. “Monografi për Shaban Idrizin”, 2012.
5. “Shtypi vendor dhe i huaj për Grevën e Minatorëve të Trepçës në Stan-Tërg”, 2010,
6. “Trepça ndër shekuj”, Mitrovicë, 2012,
7. “Marrëdhëniet Shqiptaro–Jugosllave”, gjatë vitit 1945-1950, 2014,
8. “Zhvillimi i arsimit shqip në Mitrovicë me rrethinë gjatë sundimit Austro-Hungarez”, Mitrovicë, 2015,
9. “Ushtria Çlirimtare e Kosovës-Zona Operative e Drenicës”, 2016.
10. “Veshjet kombëtare dhe diversiteti i saj”, Medvexhë, 2018,
11. “Skënderbeu dhe Lidhja e Lezhës”, 2019, e tjera.

MERITA EMINI



Dr. Merita Emini Sadiku është e lindur më 23.10.1975 në Preshevë, shkollën fillore dhe të mesmen e mbaroi në vendlindje, ndërsa Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Tiranës në Shqipëri në vitin 2000.

Magjistraturën shkecore në fushën e diabetologjisë, e kreu në vitin 2007, në Universitetin e Prishtinës, dhe në vitin 2012 kreu doktoraturën shkencore, gjithashtu në fushën e diabetologjisë në Universitetin e Zagrebit në Kroaci.

Nga viti 2009 është specialist e sëmundjeve të brendshme dhe nga viti 2013 subspecialiste në fushën e endokrinologjisë dhe diabetologjisë. Nga viti 2013 punon si specialiste në Klinikën e Endokrinologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe nga viti 2011 është asistente e rregullt në Katedrën e Mjekësisë Interne të Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës. Nga ky vit 2020 është Profesor në Universitetin AAB-së.

Nga viti 2000-2005 ka punuar në Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës. Është anëtare e Shoqatës Evropiane për Studime të Diabetit (European Association for the Study of Diabetes), anëtare e Shoqatës Evropiane për Endokrinologji (European Society of Endocrinology), anëtare e Kryesisë së Shoqatës së Endokrinologëve dhe Diabetologëve të Kosovës dhe anëtare e Shoqatës së Endokrinologëve dhe Diabetologëve Klinik në Kroaci. Prej një kohe të gjatë merret edhe me punime shkencore, kryesisht të fushës së diabetologjisë dhe endokrinologjisë, të cilat janë të botuara në revista të njohura nga të cilat 10 prej tyre në platformat prestigjioze PubMed dhe Scopus. Ka të botuar monografinë “Non-insulin antidiabetic agents and cardiovascular outcomes” në Lambert Academic Publishing.

Publikimet si autore e parë në revista ndërkombëtare Emini-Sadiku, M., Car N., Metelko Z., Bajraktari G., Morina N., Devolli D.: “Prevention or delay of type 2 diabetes by pharmacological or lifestyle interventions”, *Diabetologia Croatica*, 2008, etj.

Publikimet në revista akademike ose shkencore ndërkombëtare si koautore: sopjani M, Millaju I. Nebija D, Emini M, Rifati-Nixha a, “The glycogen synthase kinase-3 in the regulation of ion channels and cellular carriers” *Curr Med Chem*, Oct 9. 2018, etj.

MYRVETE DRESHAJ-BALIU



Prof. Myrvete Dreshaj-Baliu, u lind më 1966, në Vrellë të Istogut, Republika e Kosovës. Shkollën fillore dhe të mesme i ka kryer në Pejë. Në vitin 1984, deri sa ishte maturante e gjimnazit të Pejës, për veprimtarinë e saj atdhetare dhe pjesëmarrjen në themelimin e grupit ilegal “Ideali”, u dënua me pesë vjet burg politik.

Ndërsa, në vitin 1989, për aktivitetin e saj në demonstratën e Qendrës së Studentëve në Prishtinë, burgoset prapë dhe dënohet me dy muaj burg, nga organet e sigurimit serb.

Në vitin 1990 ishte njëra prej themelueseve të Lëvizjes për Pajtimin e Gjaqeve (1990-1992).

Myrvetja Fakultetin e Filologjisë, degën e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe, e kreu në Universitetin e Prishtinës (1989-1993).

Po këtu ka përfunduar edhe studimet e magjistraturës dhe të doktoratës (1994-2002).


Para më shumë se dy dekada, ka filluar punën si asistente në Universitetin e Prishtinës (1997-2003: asistente për grupin e lëndëve gjuhë dhe letërsia shqipe në Fakultetin e Mësuesisë të Universitetit të Prishtinës; 2002, ligjëruese e lëndës Histori e letërsisë shqipe në Fakultetin e Edukimit, ndërsa tani është profesoreshë e asocuar në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Është autore e disa studimeve dhe veprave shkencore, si dhe pjesëmarrëse në disa konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Veprat e botuara:

1. “Pajtimi i gjaqeve 1990-1992”, (bashkautore), Instituti Albanologjik i Prishtinës,
 2. “Jusuf Gërvalla-jeta dhe vepra” (tezë e magjistraturës),
 3. “Konteksti i shkrimit” (studime dhe ese), Prishtinë, 2004,
 4. “Pesha e komunikimit”, (ese) Prishtinë, 2009,
 5. “Jeta dhe vepra e Jusuf Gërvallës” (monografi), Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2010,
 6. “Enciklopedisti i kërkimeve albanologjike” (Studimet historiko-letrare të Jup Kastratit) (monografi), Prishtinë, 2014,
 7. “Letërsia për fëmijë”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2019, etj.
- Myrvete Dreshaj-Baliu punon dhe jeton në Prishtinë.

NAIM FRASHËRI (1846-1900)



Naim Frashëri, u lind më 25 maj 1846, në Frashër dhe ndërroi jetë më 20 tetor 1900 në Stamboll.

Naimi ka qenë poet dhe shkrimtar shqiptar, një nga përfaqësuesit më të shquar të Rilindjes Kombëtare dhe figura qendrore e letërsisë së Rilindjes. Për së gjalli u pagëzua "apostull i shqiptarizms" dhe "bilbil i gjuhës shqipe".

Vepra poetike e Naimit vuri bazat e letërsisë kombëtare dhe luajti rol të rëndësishëm në zgjimin e vetëdijes atdhetare. Naimi i këndoi mallit e dashurisë për atdhe, krenarisë kombëtare dhe të kaluarës së lavdishme të shqiptarëve.

Në vendlindje bëri mësimet fillore dhe nisi të mësonte turqishten osmane, arabishten dhe persishten në Teqenë e Frashërit, si myhib bektashi. Ai mbaroi gjimnazin grek "Zosimea" në vitin 1869.

Më 1871 shkoi në Stamboll, ku qëndroi vetëm tetë muaj, pastaj u kthye në Janinë. Në vitet 1874-1876 punoi si drejtor dogane në Sarandë.

Nga sëmurja rermatizmes, e shtrënguan të largohej nga Saranda dhe shkoi për kurim gjashtë muaj në banjat e Badenit në Perandorinë Austro-Hungareze. Më 1878 punoi tetë muaj si drejtor të dhjetash (*ashari mydiri*) në Berat. Më 1882 u vendos përfundimisht në Stamboll, ku punoi në fillim në detyrën e anëtarit e pastaj të kryetarit të Komisionit të Inspektimit dhe Kontrollit, dhe më vonë, të kryetarit të Këshillit të Lartë të Arsimit dhe të zëvendësministrit të arsimit.

Më 14 gusht të vitit 1882, nënshkroi lejen për botimin e *Gramatikës* së Kristoforidhit.

Në vitin 1884 u shfaq revista shqiptare "Drita" Naim Frashëri ishte redaktor i fshehtë pasi që në atë kohë shqiptarët myslimanë nuk lejoheshin të shkruanin. Frashëri përdorte inicialet N.H.F.

Krijimtaria letrare:

Naimi është autor i gjithsej njëzet e dy veprave: katër në osmanishtë, dy në persishtë, dy në greqishtë dhe pesëmbëdhjetë në shqipë.

Në vitin 1880 shkroi veprën e parë shqipe me përmbajtje atdhetare, poemthin "*Shqipëria*",

Në vitin 1886 botoi në Bukuresht 6 vepra: "Bagëti e Bujqësi", "Vjersha për mësonjëtoret e para", "E këndimit të çunave këndonjëtoreja" me dy vëllime, "Istori e përgjithshme" dhe "Dituritë".

Në vitin 1898 do të botonte poemën epike “Istori e Skënderbeut”

Veprat:

- “Kavâid-i fârisiyye dar tarz-i nevîn”. (Mühendisynn Matbaasi, Kostandinopel 1871,
- “Ihtiraat ve ke, sfiyat”. (Kostandinopel 1881,
- “Fusûli erbe'a. Francizcadan me'huzdur. Cep Kütüphanesi aded 16”, (Mihran, Kostandinopel 1883,
- “Tahayyulat”. (Mihran, Kostandinopel 1884,
- “Bagëti e bujqësi” prej N.H.F. (Dritë, Bukuresht 1886),
- “E këndimit çunavet këndonjëtoreja” copë e parë prej N.H.F. (Dritë, Bukuresht 1886),
- “E këndimit çunavet këndonjëtoreja” copë e dytë prej N.H.F. (Dritë, Bukuresht 1886),
- “Ho alêthês pothos tôn skypetarôn hypo D”. (Bukuresht 1886),
- “Ilyada”. (Kostandinopel 1886),
- “Istori e përgjithëshme për mësonjëtoret të para” prej N.H.F. (Dritë, Bukuresht 1886)
- “Vjersha për mësonjëtoret të para” prej N.H.F. (Dritë, Bukuresht 1886),
- “Dituritë për mësonjëtoret të para” pej (sic) N.H.F. (Dituri, Bukuresht 1888),
- “Luletë e verësë”. N.H.F. (Dituri, Bukuresht, 1890),
- “Mësime prej N. F.” (Bukuresht, 1894),
- “Parajsa dhe fjala fluturake”. “Vjersha të N. F.” (Bukuresht 1894, rebotim Dhori Koti, "Korçë Ho Erôs. Poiêmata prôtotypa eis asmata oktô met' eikonôn, (Gerardos, Kostandinopel 1895),
- “Fletore e Bektashinjet”. (Shtypëshkronjë të Shqipëtarëvet, Bukuresht, 1896),
- “Iliadë e Omirit”. Këngë e parë kthyerë prej N.H.F. (Dituri, Bukuresht, 1896),
- “Istori e Skënderbeut” (Tipografi e Shqipëtarëvet, Bukuresht, 1898),
- “Qerbelaja” prej N.H.F. (Dituri, Bukuresht, 1898),
- “Dëshira e vërtetë e Shqipëtarëvet”. “Vjershë kombiare” prej N.H.F. Shqipëruar nga greqishtja. (Mbrothësia, Sofje, 1904).

Botime integrale:

- “Vepra të zgjedhura 1-2”. (Akademia e Shkencave, Tiranë, 1980-1985),
- “Vepra 1-7”. (Rilindja, Prishtinë, 1986),
- “Vepra letrare 1-5”. (Naim Frashëri, Tiranë, 1995-1996), etj.

NAIM KELMENDI



Prof. Dr. Naim S. Kelmendi, PhD, u lind më 10 shtator 1959 në Ruhot të Pejës. Studioi në Fakultetin Filozofik të Prishtinës në Degën e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe. Shkruan poezi e prozë, por edhe me gazetari e me publicistikë, duke u dëshmuar edhe në këto fusha të shkrimit, sidomos me publikimet e tij, si te gazeta “Bota sot”, “Pavarësia”, “Pavarësia News” etj. Nga veprimtaria e tij poetike janë përkthyer poezi edhe në gjuhët evropiane, duke u prezantuar edhe në antologji të ndryshme, si dhe në shtypin e kohës.

Naim Kelmendi ishte themelues dhe kryetar i klubit letrar “Faik Konica” në Zvicër, i cili për vite me radhë ka lënë gjurmë në jetën letrare të mërgatës sonë atje. Ishte drejtues dhe kryeredaktor i revistës “Top Kultura”, e cila botohej në Zvicër. Naim Kelmendi ishte themelues dhe kryeredaktor i gazetës “Pavarësia”, pastaj ish editor i gazetës “Pavarësia News”.

Nga kritika letrare e kohës, Naim Kelmendi konsiderohet si një ndër poetët tanë më të dalluar në poezinë tonë modern. Edhe në fushën e publicistikës Naim Kelmendi dallohet dhe çmohet si një ndër publicistët tanë më në zë, sidomos për angazhimin dhe guximin e tij intelektual në mision të fjalës së shkruar. Naim Kelmendi ishte edhe reporter lufte i gazetës “Bota Sot” në luftën e Koshares me 1999. Ai është “zogu” që ka hyrë edhe vet në balada lufte, sepse edhe ky ishte njeri i baladave, Ai u ngrit me vargun e tij për t’i dënuar ata mizorët, që u sulën pabesisht pas shpine me Elaborate, histori të tmerrshme, për t’i zhbërë me rrënjë nga faja e dheut - Njerëzit Legjenda: Adem Jashari, Drenicën, Deçanin, Rugovën, Logjën e Llapin, Isa Boletinin, Agim Ramadanin, “që pikturën dhe poezinë dardane e la ta shkruajë në kohë paqeje...”, që kurrë për s’ë gjalli s’arriti... Lexuesi i mirëfilltë kur t’i lexojë 47 baladat e librit “Shqiptari vdes duke kënduar”, do të bindet se Naim Kelmendi është poet modern.

Naim Kelmendi do ta ndjejë veten si një shfaqje filmike, ku personazhet si Adem Jashari, Hamëz Jashari, Shaban Jashari, Isa Boletini, Oso Kuka, Agim Ramadani, Kosharja legjendare, lëvizin si në ekranin e filmit, duke ua dhënë një art skenik në heshtje, apo një vallëzim të zjarrtë, që herë herë është i akullt, me përplot akrobacione të kryera skenike të një kalibri protonismian. Sekretet dhe talenti i homerianit tonë shqiptar i përket një fuqie tjetër: asaj të njohurive të shkëlqyera të kodeve të shkruara dhe të

pashkruara të gjinisë së poemave të gjata, asaj të përvetësimit të plotë të gjitha elementeve të poezisë (e veçanta është se askund nuk përdoren shenjat e pikësimit), asaj zotësisë së tij profesionale për t'i kthyer këto njohuri në instrumente diplomatike, që ndihmojnë drejtpërsëdrejti në kryerjen sa më të përsosur të plotësimit “të shkyer” të hartës Arbërore nga Europa plakë (Flori Bruqi)...

Naim Kelmendi ishte reporter i luftës së Kosovës-1999. Nga vija e parë e frontit, në epopenë e madhërisme të Koshares, ai ishte krah për krah me luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës deri në ditën e shumë pritur të lirisë. Edhe reportazhet e para të pasluftës nga Kosova e lirë i përkasin penës së tij. Është anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe Arteve Shqiptaro-Amerikane në New York, Tiranë, Prishtinë dhe Shkup, si dhe editor i Shtëpisë Botuese “Rugova Art” në Prishtinë.

Veprat letrare:

1. "Shtreza në fjalë", 1985
2. "Nyja e Gordit", 1992
3. "Albanoi", 1992
4. "Pse ashtu Pandorë", 1993
5. "Çka të bëj me dhembjen", 1993
6. "Satanai me fytyrë tjetër", 1994
7. "Eklipsi i diellit", 1997
8. "Përballje me vdekjen", 1999
9. "Shqiptari vdes duke kënduar", 2000
10. "Kohë për të folur gurët", 2001
11. "Sipërfaqja e padukshme", 2003
12. "Vrasja e deputetit", monografi, 2003
13. "Beteja e Koshares...", publicistikë, 2008
14. "Pikëpamje dhe reagime", publicistikë, 2003
15. "Në një jetë pas Krishtit", 2010
16. "Esenca", 2010
17. "shqiptari vdes duke kënduar" (botim i dytë), 2010
18. "Antologjia e dhembjes poetike", 2012
19. "Është vetëm kujtesë", 2012
20. "Po i flisja vetes", 2013
21. "Një gjurmë intelektuale përgjatë një jete", monografi, 2014
22. "Kronika e një vrasjeje të paralajmëruar", 2014
23. "Fjala e dhembjes", (Antologji poetike për Azem Shkrelin), 2015 etj.

NAMIK SHEHU



Akademik Dr. Namik Muhedin Shehu, është i lindur në Berat, më 1934. Ka kryer Fakultetin e Mjekësisë në Tiranë, në vitin 1957. Namik Shehu jeton në Astoria, New York, bashkë me familjen, që prej vitit 1997.

Nga viti 1999, ai është sekretar shkencor i Akademisë së Shkencave Shqiptaro-Amerikane në New York. Është nënshtetas amerikan, por edhe një veprimtar i shquar i komunitetit shqiptaro amerikan në Nju Jork e më gjerë. Ka marrë pjesë aktivisht, në veprimtari organizative dhe shkencore të Akademisë dhe ka zhvilluar një aktivitet të dendur organizativ, të shoqëruar me mbajtje referatesh. Mban gradë e titull shkencor, Doktor i Shkencave Mjekësore dhe Bashkëpunëtor i Vjetër Shkencor.

Shehu është drejtues i revistës shkencore “Dituria”, në kuadër të Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe të Arteve, në New York. Ka botuar një seri librash mjekësore dhe publicistike letrare-shkencore, monografi, përshtatje dhe përkthime librash mjekësore dhe ka shkruar e publikuar qindra artikuj shkencor dhe mjaft shkrime shkencore popullore. Ka mbajtur referate në 20 sesione shkencore, 7 simpoziume dhe 3 konferenca shkencore, si dhe referate në kongrese ndërkombëtare si në Itali, Belgjikë dhe në ShBA. Ka një publicistikë të gjerë në shtypin periodik, në revista në radio dhe televizionin shqiptar. Në vazhdim kohë më parë Prof. Dr. Namik Muhedin Shehu, është paraqitur para publikut shqiptar me punimin e tij: “Aforizma dhe shprehje të mençura”. Ka publikuar mbi 20 libra mjekësore shkencore, ka botuar mbi 100 punime dhe studime mjekësore, si dhe ka shkruar dhe shpërndarë broshura me tematikë shkencore popullore.

Namik Muhedin Shehu, ishte shumë aktiv edhe në jetën shoqërore dhe shkencore ishte këshilltar shkencor i Ministrisë së Shëndetësisë në vitin 1971, kryetar i shoqatave të mjekëve në Berat në periudhën 1971-1994, kryetar i shoqatës Shqipëri-Turqi për Beratin dhe nënkryetar i saj për Shqipërinë në vitet 1991-1997.

Ka qene anëtar i Shoqatës Evropiane të Kardiologëve dhe të Dhimbjes së Kokës që nga viti 1992. Për punën e tij të palodhshme dhe sukseset e mëdha në këto fusha, u dekorua disa herë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me “Urdhrin në Shërbim të Mirë të Popullit”, kurse

Instituti Amerikan i Biografive e nderoi me çmimin “American Medal of Honor” (Medalja Amerikane e Nderit).

Si bashkautor, botoi më 1983 monografinë “Reumatizmi artikular akut dhe pasojat e tij”, si dhe botoi artikuj të shumtë në revistat: “Shëndetësia Popullore”, “Buletini i UT-së”, Seria e Shkencave Mjekësore, punime neuro-psikiatrike, punime neurologjike etj. Ka marrë pjesë në rreth 50 sesione dhe konferenca shkencore.

Për këtë arsye, profesor Namiku radhitet me të drejtë në radhën e mjekëve, që lanë emër në mjekësinë shqiptare, si: Maksut Dërrasa, Pandeli Çina, Lluka Muço, Ymer Dishnica e shumë të tjerë.

Kryetari i Akademisë së Shkencave Shqiptaro-Amerikane në New York, Akademik Prof. Dr. Skënder Rexhep Kodra, Ph.D, ka thënë për profesor Namik Muhedin Shehun: “Dr. Namik Muhedin Shehu është një personalitet shkencor dhe një person i devotshëm dhe i aftë në kryerjen e detyrës”.

Në 70-vjetorin e lindjes së tij, ai i dhuroi qytetit të lindjes, ku dhe kremtoi këtë jubile, edhe librin, “Berati, mjekësia nëpër shekuj”, kurse bashkia e Beratit e nderoi me titullin “Intelektual i shquar i qytetit të Beratit”.

Veprat e botuara:

1. “Hipertensioni Arterial Esencial në rrethin e Beratit”, Disertacion, Tiranë, 1980,
2. “Dukuritë anësore të antibiotikëve”, Broshurë, Tiranë, 1985.
3. “Presioni Arterial patologjitet dhe mjekimi”, Monografi, Tiranë, 1997,
4. “Berati mjekësia nëpër shekuj”, Monografi, Tiranë, 2004,
5. “Namik Shehu, 70 vje jetë dhe punë”, Broshurë, Tiranë, 2004,
6. “Proverba dhe fjalë të urta”, Nju Jork, 2006,
7. “Tungjatjeta Diasporë”, Monografi, Nju Jork, 2008,
8. “Duhani helmues i heshtur e vrasës i zgjedhur i njeriut”, Broshurë, Nju Jork, 2008,
9. “Kolesteroli: rëndësia, ndikimet në organizëm dhe trajtimi”, Nju Jork, 2008,
10. “Pedagogtë dhe studentët që krijuan mjekësinë shqiptare”, Monografi, Nju Jork, 2010,
11. “Përsiatje rreth dinjitetit njerëzor”, Nju Jork, 2010,
12. “Kolesteroli: rëndësia, ndikimet në organizëm dhe trajtimi”, Nju Jork, 2008, etj.

NAXHIJE DOÇI



Prof. Naxhije Doçi është e lindur në Therandë (Suharekë). Naxhije Doçi shkollën fillore e kreu në vendlindje, në Therandë, kurse të mesmen, Normalen në Prizren, Fakulteti Filologjik-Gjuhë e Letërsi Shqipe, në Prishtinë. Mbi 30 vjet ka punuar profesreshë në shkollat e mesme të Prishtinës. Nga viti 2000 ishte shefe në Drejtorinë e Arsimit-Prishtinë dhe zëv. Drejtor.

Nga viti 1989, Naxhije Doçi është marrë intenzivisht me organizimin e aktiviteteve arsimore e politike në të mirë të Kosovës. Ka punuar për shkollimin dhe emancipimin e femrës shqiptare në Kosovë, si edhe për të drejtat e femrës shqiptare.

Pas luftës zgjidhet sekretare gjenerale e FGLDK dhe kryetare e Degës së II të FG, në Prishtinë. Nga viti 2010 dhe aktualisht është nënkryetare e Forumit të Gruas të LDK.

Më 2004-2008 zgjidhet deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Më 2005 shpallet Ambasadore e Paqës Universale në Botë.

Në Kongresin Mbarkombëtarë të Gruas Shqiptare, mbajtur në Prishtinë dhe Vlorë, në vitin 2012, shpallet: Gruaja Shqiptare e Vitit për Kosovë, çmim ky meritohet për aktivisten Naxhije Doçi.

Naxhije Doçi është anëtare e disa shoqatave dhe qendrave kulturore e letrare në Kosovë e në Shqipëri si: anëtare e Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës (LSHK), anëtare USHKSH-Prishtinë, anëtare, LNPSHA-Pegasi-Albania, anëtare e QKPSHA-Gjakova dhe anëtare e SHSH “Elena Gjika” në Therandë, por edhe e shumë organizatave tjera humanitare.

Veprat:

Naxhije Doçi është shkrimtare dhe i ka të shkruara këto libra:

1. “Shpirti i dërmuar-Dhuna serbe ndaj femrës shqiptare në Kosovë, 1997-1999”, Prishtinë, 2001,
2. “Destan Bajraktari folklorist, letrar dhe atdhetar”, Prishtinë, 2009,
3. “Krimi dhe përdhunimi serb kundër femrës shqiptare në Kosovë, 1997-1999”, Prishtinë, 2010.
4. “The Serbian crime and rape against the Albanian Womanin Kosova 1997-1999”, Prishtinë–2013,
5. “Kohë flakadanësh të lirisë” - (Poezi), Prishtinë, 2012,
6. “Times of flambeaus of freedom”, Prishtinë, 2012, (205),
7. “Udha e Kombit-Ëndërr e dehur e rrënjës”-(Poezi), Prishtinë, 2015,

8. Libri (poezi) "Vargëzim mbi gjurmë", 2017,
9. Libri me poezi "Jeh Motersh", Prishtinë, 2019,
10. Në përfunfim libri: "Rrëfimet e disa të mbijetuarëve të gjallë të Masakrës së Tivarit", Prishtinë, 2019,

Naxhije Doçi ka marrë pjesë në shumë tubime letrare e shkencore në Kosovë, Maqedoni e Shqipëri, ku edhe ka marrë shumë mirënjohje dhe çmime, duke u vlerësuar poezia e saj nga juria profesionale me vendin e parë, dytë e tretë, si dhe ka marrë edhe shumë mirënjohje.

Çmimet:

- Vendi parë për poezi-Konkurs Letrar: SHSH "Fahri Fazliu", në Kastriot, 2. 11. 2016,
- Vendi parë për poezi-Konkurs Letrar "Ditët e Lidhjes" - Prizren, 10. 06. 2019,
- Vendi dytë - poezi-Konk Let - QKPSHA "Gjakova", 2014,
- Vendi i dytë për poezi - Podujevë, 18. 08. 2018,
- Vendi i tretë për poezi-Therandë, 2014 dhe 2015,

Një numër të madh poezish, përkushtuese dhe të tjera (diku mbi 40 sish), si edhe shkrime publicistike e etnografike i ka të botuara nëpër Antologji të ndryshme dhe në Revista Letrare e gazeta, botuar në Kosovë dhe nëpër trojet shqiptare. Disa prej tyre i ka edhe të përkthyer.

Shumë poezi, por edhe prozë publicistike dhe tregime i ka të botuara edhe nëpër gazeta elektronike të ndryshme të pasluftës në Kosovë dhe më gjerë.

Mirënjohjet:

- Mirënjohje për merita të veçanta letrare, ndarë nga shqiptarët e Rumanisë, 2018,
- Titulli "KRENARIALNPSHA-PEGASIALbania", Tiranë, 2009,
- Publiciste vitit 2013 për Kosovë", PEGASI", Albania,
- Aktiviste e viti 2014 për Kosovë-Akademia Pegasiane,
- Mirënjohje "Ulpiana Krenaria jonë", Komuna - Prishtinë (Drejtoria për Kulturë), 2013,
- Mirënjohje "Engjëlli i Ulpianës", 2014, si edhe shumë Mirënjohje të tjera, diku mbi 40 sish.

Naxhije Doçi është edhe autore e shumë fejtoneve publicistike për tmerret e luftës serbe në Kosovë gjatë viteve 1998/1999, e vlerësimeve letrare e shkencore dhe e punimeve etnografike e gjuhësore.

Naxhije Doçi është recensuese veprash letrare dhe autore e disa teksteve shkollore:

1. "Fletore pune e gjuhës shqipe", për kl. e IV.
2. "Fletore pune e gjuhës shqipe", për kl. e V-të.
3. Libër leximi për kl. e III-"Mësojmë shqip".

Naxhije Doçi jeton dhe vepron në Prishtinë.

NAZMI MAKSUTAJ



Prof. Dr. Nazmi Maksutaj, u lind në Deçan, më 27 gusht 1976. Shkollën fillore dhe të mesme e kreu në Deçan (1994). Pas kryerjes së gjimnazit "Vëllezërit Frashëri", Nazmi Maksutaj u detyrua të largohet nga Kosova për në Shqipëri. Në Shqipëri jetoi deri para fillimit të luftës. Ai u kthye në vendlindje, duke kontribuar si shumica e të rinjve. Studimet Bachelor i vazhdoi në vitin 2007 në fushën Ekonomike. Në vitin 2010 i vazhdoi studimet Master në ekonomi, ndërsa studimet e doktoratës në ekonomi, i ka filluar në vitin 2014, ndërsa ato i përfundoi në vitin 2018, dhe mori titullin Doktor i shkencave Ekonomike në Marketing dhe Menagjim. Në vitin 2016 filloi punën si asistent në kolegjin "Fama" në Prishtinë, ku punoi deri në vitin 2018. Më vonë filloi po në këtë vit (2018) punën në kolegjin "Univerzum " në Prishtinë. Në vitin shkollor akademik 2019, është profesor i rregullt në kolegjin "UBT" në Prishtinë. Aktualisht është i angazhuar në Këshillin Drejtues në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë. Gjithashtu është kryetar i nënkëshillit shkencor në fushën e Ekonomisë në Ministrinë e Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore, si dhe ka dhjeta publikime shkencore:

1.Nazmi Maksutaj," The Costumares Orientation of Enterprises in Kosovo", from, 2017, 2.Nazmi Maksutaj "The general features of the procedures for dealing with an insured damave InternatioInal scientific conference X-th",

3. Nazmi Maksutaj, "Orientation of the Enterprise to the Market", 2015,number 14, pages-327 Political-economic developments in the Western Balkan states during the transition, theHertige" Management and Cooperation of Banks Associations in Kosovo",

4. Internatioinal scientific conference X-th "The general features of the procedures for dealing with an insured damave International scientific conference X-th Innovation, education, research and science in function of global development,

5. Nazmi Maksutaj,"The general features of the procedures for dealing with an insured damave InternatioInal scientific conference X-th

6. Nazmi Maksutaj "Management and Cooperation of Banks Associations in Kosovo", International scientific conference X-th, Etj.

NAZMI RRAHMANI



Nazmi Rrahmani u lind në fshatin Ballofc të Besianës, ish Podujevës.

Nazmiu u shkollua në Besianë dhe në Prishtinë. Studimet për gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në Prishtinë.

Pas studimeve punoi si gazetar në Radio-Prishtina e më pas te gazeta "Rilindja", për të vazhduar në redaksinë "Jeta e Re" dhe më pas në redaksinë e botimeve "Rilindja".

Nazmi Rrahmani është shkrimtari që ka patur dhe vazhdon të ketë një numër të madh lexuesish, në Kosovë dhe në mbarë trojet shqiptare.

Tek shkollarët e mesëm është pa dyshim më i njohur, por është i lexueshëm për të gjitha shtresat shoqërore dhe për të gjitha moshat.

Rrahmani është ndër autorët e paktë të letërsisë së sotme shqiptare, që shkruan vetëm llojin e prozës së gjatë, romanin.

Për nga formacioni stilistik, është i shkollës realiste klasike, por i një realizmi të përafërt me atë të narracionit Dokumentar.

Ka botuar romanet:

“Malësorja”, 1965,

“Pas vdekjes” (Kthimi i njeriut të vdekur), 1975,

“Tymi i votrës së fikur”, 1969,

“Toka e përgjakur”, I, II, 1973,

“Rruga e shtëpisë sime”, 1978.

Nazmi Rrahmani ka bërë redaktimin e një numri të madh të librave, kryesisht të romaneve dhe formave tjera të shprehjes së letërsisë të dalluara nga "Rilindja".

Nazmi Rrahmani e udhëheqë Shtëpinë Botuese “Faik Konica“ në Prishtinë, shtëpi botuese e njohur për botimin e shumë titujve të librave nga autorë të njohur shqiptarë.

Romanet e tij edhe sot lexohen tek lexuesit me një përkushtim të madh, duke arritur lexueshmëri të madhe, Nazmi Rrahmani radhitet në rangun e autorëve më të lexuar të romanit .

Këto romane të Nazmi Rrahmanit asnjëherë nuk do të zhvlerësohen te lexuesit sepse të gjitha e kanë një tematikë interesante, që bëhet fjalë për jetën e fshatrave e sidomos lokalitetit të autorit.

Nazmi Rrahmani jeton dhe vepron në Prishtinë.

NEBIH BUNJAKU



Nebih Bunjaku, u lind më 15 maj 1947, në fshatin Poliçkë të Dardanës, ku kreu ciklin e ulët të fillores, kurse pas shpërnguljes nga vendlindja dhe vendosjes në Malishevë të Gjilanit, pas tri vitesh pauze, kreu tetëvjeçaren. Në Gjilan kreu shkollën e mesme ekonomike, ndërsa studimet për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe i mbaroi në Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Më 1960 familja u vendos në Prishtinë. Si student filloi karrierën arsimore shkollën fillore në Banjën e Siarinës, në gjimnazin e Dardanës, në Shkollën Teknike të Gjilanit, në Shkollën fillore të Banullë-Gllogofcit, në gjimnazin e Lypjanit, në Shkollën Teknike të Kastriotit. Nga fundi i shtatorit 1991, si kryetar i një Komisioni votues për mbajtjen e Referendumit për Pavarësinë e Dardanisë, u burgos dhe u dënua me 60 ditë burg të cilin e mbajti në Prishtinë. Më 1993 lidhi marrëdhënie pune me Gjimnazin e Filologjisë “Eqrem Çabej” në Prishtinë, ku ligjëroi letërsi shqipe dhe botërore. Pas tri vitesh u zgjodh drejtor i këtij gjimnazi dhe punoi gjerë në çlirimin e vendit.

Gjatë punës shumëvjeçare në arsim mbi 20 herë mori mirënjohje për punën profesionale, por edhe për aktivitete të ndryshme kulturore. Në këtë gjimnaz nxori revistën “Filologu i Ri”, ku botoheshin poezi në shqip, anglisht dhe gjermanisht. Më 1998 Nebih Bunjaku, jo vetëm që ishte njëri nga organizatorët e Protestës së Maturantëve të Prishtinës, por doli në ballë të saj në zemër të Prishtinës. Më 28 Nëntor 1998, të ftuar nga sektori i Kulturës së UÇK-së, Grupi i Recituesve “Lasgush Poradeci”, për nder të Ditës së Flamurit, Ditëlindjes së Komandantit Legjendar-Adem Jasharit dhe Betimit të ushtarëve të rinj, jehonin malet nga deklamimi i vargjeve të “Poemë Kosovari” të Mitrush Kutelit. Bunjaku u mor edhe me krijimtari letrare dhe bashkëpunoi me shumë gazeta dhe revista shqiptare.

Cikle poezish i janë botuar turqisht, anglisht dhe polonisht. Përpos poezisë, ai botoi edhe shumë shkrime publicistike.

Veprat e botuara:

1. “Dalje nga balada” (1994), 2. “Gramatikë zemre” (2004), 3. “Terapia e dashurisë” (2005), 4. “Një samit për një simit” (2007), 5. “Prushimë buzësh” (2008), 6. “Zemra nuk ka dimër” (2009), 7. “Testamenti i lotit” (2012), 8. “Kopshti i shpirtit”, (2013, (ribotuar më 2015), 9. “Elegjia e qyqes” (2018), 10. “Nektar shpirti” (2019).

NEHAT JAHIU



Nehat Jahiu, u lind më 10 tetor të vitit 1951, në fshatin Orizare të komunës së Likovës.

Shkollën fillore e tetëvjeçare e kreu në vendlindje, të mesmen në Preshevë dhe Shkollën e Lartë Pedagogjike (Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe), në Gjakovë. Punoj në shkollën nëntëvjeçare “Faik Konica” të fshatit Sllupçan.

Me shkrime ka filluar të merret qysh në bankat e shkollës fillore. Nga fillimi i krijimtarisë së tij e deri në ditët e sotme, ka shkruar kryesisht poezi për fëmijë, por edhe për të rritur. Merret edhe me

shkrime gazetareske, opinione, publicistikë, ese, skica letrare, prozë, recensionë, tregime etj. Bashkëpunon me shumë revista, gazeta të shumta në mbarë trojet tona dhe në diasporën shqiptare. Është një ndër themeluesit e Klubit të Shkrimtarëve “Jehona e Karadakut” në Kumanovë dhe anëtar i Kryesisë. Është themelues dhe anëtar i redaksisë së Revistës letrare “Doruntina”, themelues dhe nënkryetar i “Klubit të Shkrimtarëve” të Komunës së Likovës, bashkëthemelues dhe Anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptar të Maqedonisë. Është prezantuar në shumë antologji në trojet tona dhe në diasporën shqiptare. Nehat Jahiu është edhe Anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve Shqiptaro-Amerikane, në New York. Nehat Jahiu është shpërblyer me shumë çmime si mirënjohje, diploma etj. Nehat Jahiu jeton dhe vepron në vendin e tij të lindjes në Orizare. Antologjitë ku janë prezantuar veprat e Nehat Jahiut:

Hasan Hasani: “Leksikoni i shkrimtarëve shqiptarë 1501-1990”, 1994,

Dr. Arif Selmani “Bibliografia e letërsisë shqiptare në Maqedoni, 1953-1997” (Tetovë, 1998),

Dr. Arif Selmani “Bibliografia e letërsisë shqiptare për të rritur, në Maqedoni 1951-1999” (Tetovë, 2001),

Lidhja e Shkrimtarëve Shqiptarë-Netët poetike të verës “Takime nën Rrap” (Antologji e krijuesve pjesëmarrës, Shkup, 2009),

Milazim F. Kadriu: “Flakadani i lirisë”, Besianë, 2012,

Ejup Ajdini: “Letërsia shqipe për fëmijë në Maqedoni I-II”, Tetovë, 2013,

Rrahman Hyseni: Antologji poetike “Nëna” 2017.

Rudi Berisha: “Shqipëri, nëna ime”, Grup autorësh, Podujevë, 2017,

“Prof. ass. Dr. Astrit Bishqemi- Prof. Mr. Sc. Migena Arllati “Autor të letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj, 1886-2017”,

Fjalor enciklopedik- Shaban Pllana “Rrugët e thyra” për Milazim F. Kadriun, 2019,

“Lulëkuqet e lirisë” “Çdo shesh nga një përmendore”- antologji poetike- Dibran Fylli-2015, etj

Nehat Jahiu është prezantuar edhe në disa leksikone të shkrimtarëve, fjalorë enciklopedikë të shkrimtarëve shqiptarë etj. Për krijimtarinë e tij letrare është shpërblyer me çmime të shumta.

Deri më sot ka botuar 44 libra në gjuhën shqipe e në gjuhë të huaja.

Veprat:

“Në sytë e tu”-1982,

“Ura prej zemrave”-1985.

“Fluturimi i pëllumbave”-1990

”Të pret malli që na treti”-1993,

“Hidhe vallën, Laro!”-1994.

“Kukuvajka”-1995,

“Hape derën, shkolla ime!”-1995,

“Epitaf lirie”-2000,

“Rrënjët i ke në këtë tokën ilire” -2005.

“Huti mbi çati”-2005,

“Brez pas brezi në luftë për shkolla shqipe”-2008,

“Lulëkuqe mbi varre”- 2010,

“Orizarja ndër shekuj”-2010,

“Rrugës së drejtë”- 2011.

“Zana dhe Guri”-2011,

“Poemë për mikun Sadulla Zendeli, Daja”-2012,

“Te ura e gjyshes”-2012,

“Rreze në dritare” -2013,

“Krahët e fluturës”-2013,

“Hëna u bë nuse”-2013,

“Kënga e zogjve”-2013,

“Gjaku im të qoftë falë”-2014,

“A vjen liria”-2016,

“Mbresa njerëzore për një njeri të veçantë”-2016,

“Biri i shqiptarisë”-2016,

“Zorite libertatii-Agimet e lirisë”-2016 (përkthyer në gjuhën rumune nga Adriana Tabacu),

“Të qeshën e të bënë nuse”-2016, etj.

NERITAN CEKA



Prof. Dr. Neritan Hasan Ceka u lind më 11 shkurt 1941, në Tiranë. Ai është i biri i arkeologut të parë shqiptar, Hasan Ceka, u interesua për arkeologjinë që fëmijë, kur shoqëronte të atin në ekspeditat arkeologjike të Apollonisë. Ka kryer studimet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Histori-Filologji, në vitin 1962, por iu kushtua plotësisht kërkimeve arkeologjike. Tani mban titullin Profesor Doktor. Në vitet 1963-1964 gërmoi në kështjellën ilire të Rosujës në Tropojë; në vitin 1969 zbuloi varrin e pasur të Selcës së Poshtme dhe po atë vit filloi gërmimet disavjeçare në Belsh. Tërheqjen më të fortë e pati drejt qytetit të madh të Bylisit.

Ai drejtoi ekspeditat në vitet 1978-1991, duke zbuluar teatrin, stadiumin, shëtitoret, gjimnazin dhe disa nga hyrjet dhe kullat e fortifikimeve të qytetit ilir. Në vitet 1992-1994 drejtoi ekspeditën e përbashkët shqiptaro-franceze në Apolloni, si dhe gërmimet në Butrint.

Që nga viti 1985 jep leksionet e Arkeologjisë Klasike në Fakultetin Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës.

Ka dhënë leksione dhe konferenca shkencore në Gjermani, Angli, Itali, Francë, Austri, SHBA dhe në vende të tjera.

Ka shkruar librin shkencor “Qyteti ilir pranë Selcës së Poshtme” (1985), si dhe një numër të madh artikujsh shkencorë mbi kërkimet e tij arkeologjike. Neritani është anëtarë i disa instituteve të larta shkencore si: Këshillit Shkencor në Institutin e Arkeologjisë në Tiranë, Institutit të Arkeologjisë në Berlin, dhe Institutit të Koldeway Gesellschaft.

1985-1990: Shef i Departamentit të Arkitekturës në Institutin Arkeologjik;

1990-1993: Drejtor i Institutit Arkeologjik.; 1992;

1997-1998: Ministër i Brendshëm;

1998-2005: Kryetar i Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare;

2008-: Nënkryetar i Kuvendit të Shqipërisë.

Veprat:

1.”Qyteti ilir pranë Selcës së Poshtme” (1985);

2.”Arkeologjia: Greqia, Roma, Iliria” (1994);

3.”Ilirët” (2001);

4.”Apollonia e Ilirisë” (1982);

5.”Butrinti” (2001);

6."Bglise" (2004);

7."Bylisi" (me bashkautor);

8."Udhëtim në kështjellat ilire" (2006).

Arkeologu dhe studiuesi i njohur shqiptar, Neritan Ceka, ka botuar në gjuhën angleze librin e tij "Ilirët". Studimi është fryt i një pune voluminoze 10 vjeçare, është një nga librat më të kërkuar aktualisht nëpër libraritë e Tiranës, sidomos nga studentët dhe turistët. Po ashtu mjaft të kërkuar janë edhe librat e tij të tjerë në shqip, anglisht dhe gjermanisht Apolonia, Butrinti dhe Bylisi.


Por vendin më të rëndësishëm mes tyre e zë natyrshëm libri për ilirët, i cili ka hedhë dritë mbi njërin prej periudhave më interesante dhe të panjohura të lashtësisë së popullit shqiptar.

"Kushdo që do ta lexojë librin, do ta kuptojë që historia jonë është një histori lineare, pa ndërprerje, pa katastrofa. Ndoshta ka pak mjegull në historinë e shqiptarëve që nga shekulli VI deri në shekullin XI kur shfaqen krejtësisht të qartë me emrin e tyre të trashëguar nga antikiteti nga albanoi tek arbërit, por kjo është një histori e cila nuk mund të kontestohet me asnjë argument tjetër; kaq i fortë është argumenti historik i vazhdimësisë që përkon dhe me argumentin arkeologjik".

Bazuar mbi zbulimet arkeologjike dhe studimin e burimeve të shkruara, libri i Prof.Cekës trajton me detaje prejardhjen e shqiptarëve të sotëm nga ilirët, një nga popullsitë më të vjetra të rajonit. Pikërisht kjo periudhë e lidhjeve mes ilirëve dhe shqiptarëve e kishte tërhequr Prof. Cekën gjithmonë në punën e tij shkencore, ndonëse ka qenë e mbuluar prej shumë vitesh me errësirë dhe enigma, si edhe botime fare të pakta, kryesisht të autorëve të huaj.

Prof. Dr. Neritan Ceka në studimin e tij hedh dritë edhe mbi lindjen dhe origjinën e gjuhës shqipe si dhe trajton gjerësisht pjesëmarrjen aktive të ilirëve në qytetarinë romake. Sipas tij, një faktor i rëndësishëm që ka ndikuar fuqishëm në mbijetesën dhe kompaktësimin e popullsisë shqiptare ka qenë edhe konflikti i madh me sllavët në atë periudhë kur këta të fundit u vendosën në rajon. Prof. Neritan Ceka i shkroi kapitujt e parë të këtij studimi në vitin 1987. Ai trajton një nga çështjet më të rëndësishme të kulturës shqiptare, pasion që e ka të trashëguar nga i ati, gjithashtu një arkeolog i njohur shqiptar. Libri "Ilirët" në shqip u publikua për të herë të parë në takime me studentë të Universiteteve të Tiranës dhe të Elbasanit, si dhe në Institutin Albanologjik të Prishtinës, duke ngjallur menjëherë interesimin e qarqeve shkencore universitare. Etj.

NEXHAT DACI



Akademik Nexhat Daci, u lind më 1944 në Tërnoc, ku mbaroi shkollimin fillor. Shkollimin e mesëm e kreu në Leskoc (1956-1960). Studimet universitare i mbaroi në Fakultetin e Shkencave Matematike - Natyrore (Dega e kimisë) në Beograd (1962-1966), ku u diplomua në qershor të vitit 1966. Studimet pasuniversitare i mbaroi në fakultetin dhe drejtimin e njëjtë në Beograd (1966-1968). Një kurs pasuniversitar e ka mbaruar Lièges (Belgjikë), në vitin 1970.

U doktorua në vitin 1973 në Universitetin e Zagrebit. Studimet e pasdoktoraturës i vazhdoi në Angli (Universiteti i Bradfordit) në vitin 1974.

Në vitin 1968 u punësua asistent në Fakultetin Filozofik në Katedrën e Kimisë. Më 1971 ishte ligjërues; më 1974 profesor inordinar; më 1984 profesor ordinar.

Ai dhjetëra herë ka pasur udhëtime studimi në Çeki (Brno), Shqipëri, Angli (Bradford, Oksford, Londër), Skotlandë (Aberdin).

Ka marrë pjesë në tubime shkencore (simpoziume, konferenca dhe kongrese) në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare. Është anëtar i Shoqatës Kimike Amerikane në vitin 1985, i Akademisë Evropiane për Çështje Mjedisi me seli në Tübingen të Gjermanisë dhe Londër në vitin 1987 dhe kombëtare, në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në vitin 1993. Është anëtar i Akademisë Evropiane të Shkencave dhe të Arteve nga viti 2014.

Gjatë periudhës akademike-universitare ka ushtruar edhe këto detyra: shef i Degës së Kimisë 1971-1973; sekretar i përgjithshëm i ASHAK-ut, 1994-1999; kryetar i ASHAK-ut, 1999-2002.

Ka qenë deputet (2001-20011) kryetar i Parlamentit të Kosovës në periudhën 2000-2004 dhe 2004-2006.

Bibliografia e Prof. Dr. Nexhat Dacit është e pamundur të përfshihen të gjitha punimet shkencore, jo vetëm si autor personal, por edhe si bashkautor me kolegët e tij.

Punimet kualifikuese:

N. M. Daci, Kiseonice funkcionalne grupe u kerogenu Aleksinackog bituminoznog skriljca-Izbor metoda i kvantitativno odredjivanje, Magistarski rad, Beograd, 1968.

N. M. Daci, Prilog odredjivanju hemijske strukture organske supstance Kosovskog ugljena, Doktorska disertacija, Sveuciliste u Zagrebu, 1973.

Punimet shkencore:

- N. M. Daci, Ispitivanje hemijske konstitucije kerogena Aleksinackog bituminoznog skriljca, Buletini i punimeve shkencore i FSHMN-e, Prishtinë, 103, VII, 1970.
- N. M. Daci, A.Nura, Prilog odredjivanju hemijske strukture organske supstance Kosovskog ugljena–Odredjivanje karbonilne grupe, Hemija u industriji, Zagreb, 1972.
- N. M. Daci, Hemijska struktura i osobine Kosovskog ugljena, Hemija u industriji, Zagreb, 1973, 3, 1974.
- N. M. Daci, Përcaktimi i strukturës së substancës organike të qymyrit të Kosovës, Buletin i FSHMN-e, Prishtinë, 31, 1, 1973 etj.

Projekte shkencore:

- Furnizimi i Kosovës me ujë të pijes dhe hulumtimi i ujërave të ndotura, Udhëheqës i projektit të financuar nga WHO, (1973/1975).
- Zhvillimi i fazave të larta të prodhimit në ekonominë e Kosovës, Udhëheqës projekti 1975/1976.
- Hulumtimi i substancës së qymyrit dhe mundësia e përfitimit të karburanteve të pastër si dhe plehrave kimikë organikë, Udhëheqës projekti, (1979/1982). Etj.
- Identifikimi i ndotësve të efluentëve të ujërave urbane dhe të industrisë dhe trajtimi i tyre, ASHAK, (2013/2014).

Tekste dhe monografi:

- N. M. Daci, Struktura organske substance Kosovskog ugljena, Prishtina, 1978.
 - N. M. Daci, Kimia Organike, (tekst universitar), Prishtinë, 1981.
 - N. M. Daci, Kimia organike për studentët e mjekësisë dhe biologjisë, Prishtinë, 1982/1983.
 - N. M. Daci, Kimia Organike Eksperimentale, ASHAK-Libri Shkollor, Prishtinë, 1998.
 - N. M. Daci, Kimia e mjedisit, Ndotja industriale-Parandalimi, ASHAK-Libri Shkollor, Prishtinë, 1998.
 - N. M. Daci, Kimia Organike, botimi i tretë i plotësuar, Prishtinë, 2003.
 - N. M. Daci, M. Daci-Ajvazi, Shkenca e Mjedisit-Zhvillim i Qëndrueshëm, ASHAK, dhjetor 2014.
- Akademik Nexhat Daci jeton dhe vepron në Prishtinë.

NEXHAT REXHA



Prof. Nexhat Z. Rexha, u lind më 1 shkurt 1956, në Topanicë, komuna e Dardanës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse të mesmen në Dardanë.

Nexhat Rexha kah fundi i viteve të '70-ta studioi për gjuhë shqipe, dhe i përfundoi studimet në Fakultetin Filologjik-Gjuhë dhe Letërsi shqipe në vitin 1980.

Merret me krijimtari letrare në zhanrin e poezisë, prozës dhe kritikës letrare. Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës.

Kryeredaktor i revistës letrare "Nositi", Dardanë. Anëtar i redaksisë së revistës letrare "Agmia"- Gjilan. Redaktor dhe recensent i shumë librave letrar dhe shkencor.

Fitues në disa konkurse letrare. Poezitë e tij janë publikuar në shumë gazeta, revista dhe albume poetike. Po ashtu, ato janë përkthyer edhe në disa gjuhë.

Punor profesor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Gjimnazin "Ismail Qemali", në Dardanë dhe jeton në vendlindje.

Libra të botuar:

- "Ndrydhja e pikës K"- poezi, 2003
- "Unazë qiellore"- poezi, 2005,
- "Ligjërime përjetimesh"- kritikë, 2006,
- "Dhembja kujtesë"- poezi, 2008,
- "Binecuvantarea Seceolor", "Bekimi i shekujve", poezi,
e botuar në Bukuresht- 2009
- "Pikojnë heshtjet"- poezi, 2010,
- "Fjala ruan kujtimin", 2010,
- "Etje e Pashuar" Poezi nga autorë të Dardanës, 2010 (Bashkautorë),
- "Emra dhe vlera", kritikë, 2012,
- "Samtal Med Skuggorna "Bisede me Hijet", 2012, poezi,
e botuar në gjuhen suedeze,
- "Fluturojnë zogjtë në kafaz", poezi, 2014,
- "Shtjellimi i tekstit", kritikë, 2015,
- "Vlerësime letrare", kritikë, 2016,
- "Shfletime dhe kundrimet letrare", kritikë, 2018.

Nexhat Rexha, jeton dhe vepron në Topanicë, komuna e Dardanës.

NEXHMIJE PAGARUSHA (1933-2020)



Nexhmije Pagarusha, u lind më 7 maj 1933, në fshatin Pagarushë të Malishevës, në Kosovë. Kur flitet për të, përdoren në një frymë shumë epitete si: “Bilbili i Kosovës”, “Mbretëresha e Këngës Shqipe”, “Primadona e Melosit Popullor”, “Ema Sumak Shqiptare”, “Madam Butterfly”, “Fyti i Kristalte”, etj. Mori shumë çmime, ndër të tjera "Këngëtare e Shekullit".

Veprimtaria e saj muzikore 40-vjeçare është aq e gjerë, sa që është vështirë të thuhet se cilit zhanër i takon. Është e njohur për interpretimet e saj të shkëlqyera në muzikën popullore dhe opera. Nexhmije Pagarusha ishte edhe aktore e suksesshme, si në film ashtu edhe në teatër.

Në Beograd vijoi shkollën e muzikës për solo kanto, të cilën ajo e la në vitin e tretë dhe nuk e vazhdoi më. Po ashtu në Beograd kishte paraqitjen e parë muzikore në skenë. Në vitin 1948 është pranuar soliste në Radio Prishtinë.

Bashkëpunoi edhe me këngëtarët nga Shqipëria dhe u paraqit edhe në Shqipëri me Ansamblin “Shota” me rastin e një turneu.

”Baresha” është një ndër kryeveprat e interpretimit të saj. Kjo këngë u kompozua nga bashkëshorti i saj Rexho Mulliqi, me tekstin e poetit Rifat Kukaj.

Nexhmije Pagarusha interpretoi në një koncert të muzikës klasike veprat e përkthyer shqip të Bethovenit, Puçinit, Verdit, etj. Ky koncert ka qenë i pari i këtij lloji. Fatkeqësisht, asnjërit nga organizatorët teknikë nuk iu kishte kujtuar që të regjistronte këtë koncert! Mendohet se ajo ka interpretuar mbi 150 këngë.

Veprat muzikore:

“Baresha”, “Ani mori nuse”, “Mora testin”, “Kur më shkon si zog n'hava”, “Kur më del në derë”, “Ke selvitë”, “Ç'u ngrit lulja në mëngjes”, “Çil njat zemër plot kujtime”, “Dallëndyshe”, “Një lule”, “Zambaku i Prizrenit”.

Interpretoi në filmat dhe shfaqjet teatrore:

“Dasma e përgjakur”, (1967), “Jugovizioni” (1973), “Gëzuar viti i ri”, (1976), “E kafshoja terrin” (1977), “I ikuri”. (1980), “Tre vetë kapërcejnë malin” (1981), “Lepuri me pesë këmbë”, “Fluturimi i Micakut”, “Daullet e të çmendurve”, “Rexha i nënës në grazhd të kalit”, “Vrasësit bëjnë dasmë natën” (1997). Etj.

NIJAZI HALILI



Prof. Dr. Nijazi Halili, u lind në Tërstenik të Vitisë, më 1964. Shkollimin fillor e kreu në Tërstenik, të mesmen në Viti, ndërsa studimet Themelore në Degën e Edukimit në Universitetin e Prishtinës. Ka studiuar në Fakultetin Filologjik, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane në Universitetin e Prishtinës, nga viti 1992-93.

Vijoi studimet pas Universitare në Akademinë Diplomatike Shqiptare në Tiranë, prill-qershor 2009. Studimet e magjistraturës i vazhdoi në Universitetin Ndërkombëtar në Strugë, dhe i mbaroi gjatë periudhës kohore 2008/2010. Studimet e doktoratës i filloi me 26.03.2012 në Shkenca Politike në “Emuni University,” në Slloveni. Gjatë periudhës kohore 2012/2015 vazhdoi më tej me studime në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe u gradua Doktor në Administrim Biznesi.

Është pjesëmarrës i shumë konferencave shkencore, sesioneve shkencore, simpoziumeve si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Po ashtu është autor i shumë publikimeve nëpër revista të ndryshme shkencore ndërkombëtare. Është aktiv në fushën e publicistikës.

Nijaziu është anëtar i rregullt i Aluminit të Asocionit të Universiteteve të Kalifornisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, anëtar i Aluminit të Universitetit Evropian të Tiranës në Shqipëri, anëtar i bordit në Institutin për Studime Ligjore Demokratike në Gjilan, Zv. Kryetar i Shoqatës së Intelektualëve të Kosovës me seli në Prishtinë, anëtar i Asociacionit të Atlantikut të Rinisë së Kosovës KYATA me seli në Prishtinë, anëtar i Organizatës Unitetit Global-Alban, me seli në Prishtinë, anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Vitisë.

Nijazi Halili është Anëtar i Akademisë Shqiptare-Amerikane të Shkencave dhe Arteve me seli në New York, USA, 2019 etj. Tani i emëruar anëtar i Këshillit Shkencore “Shkencat ekonomike dhe sociale” në MASHT, Departamentin e Arsimit të Lartë, Prishtinë, 2019.

Ekspierienca

Më 1989 punoi në shkollën fillore të Stubllës së Epërme dhe Viti, kurse në vitin 1995/1997 në shkollën fillore “Liria” në Sllatinë të Epërme dhe paralelen e ndarë në Tërstenik. Nga vitin 2015/16 ishte i angazhuar dhe punon në Kolegjin “Iliria” në Prishtinë, Është autor i shumë librave universitare si dhe qindra punimeve shkencore me impakte ndërkombëtare

“Dështimi i diplomacisë në Ballkan“, (Libër), Ferizaj, 2018.

“Reflektime Diplomatike në shtetndërtimin e Kosovës“, (Libër), Prishtinë, 2019.

“Balkans, Peninsula Of Crisis Failure Of Diplomatic Management“, në gjuhën angleze. Prishtinë, 2019.

Punimet shkencore:

- Punimi shkencor: Kontributi i Klementit XI në Diplomacinë Evropiane, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Java e Shkencës 2012,
- Punimi shkencor: Gjeopolitika e Shqipërisë në periudhën e marrëdhënieve me Kinën (1961-78). ADSH Tiranë, 2012,
- Punimi shkencor: Sfidat e Institucioneve Kosovare integrimi i veriut të Mitrovicës, Tiranë, 2012,
- Punimi shkencor: Negociatat Kosovë-Serbi, Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, në vitin 2014,
- Punim shkencore: Menaxhimi i Krizave dhe Konfliktëve Ndërkombëtare, Gjilan, 2014,
- Punimi shkencor: Gjenologjia e Negociatave, 2015,
- Punimi shkencor: Integrimi në BE-Sfidë e Kosovës, Gjilan, 2018,
- Punimi shkencor: Luftërat Ballkanike 1911-1913, Shoqata e Shkrimtarëve të Vitisë, Malli i Shtampës, Revistë Historike, 2018, Etj.

Konferencat shkencore:

Nijazi Halili, për punën e tij akademike shkencore është dekoruar me mirënjohje dhe certifikata nga shumë institucione në fushën e dijës e shkencës.

- Konferenca shkencore, “Java e shkencës në Kosovë-2015”;
- Çmimin PASHKO për liri ekonomike Universiteti Evropian i Tiranës-Shqipëri,
- Mirënjohje nga: Asociacioni i Paktit Antlantik i Rinisë së Kosovës (KYATA), Prishtinë, Dhjetor 2017,
- Participimi: The Challenges of Changing Politics and shifting Alliances, held from May 11-13/2017 in Budva, Montenegro,
- Mirënjohje nga: Shtëpia Botuese LenaGraphic, Prishtinë, 2019,
- Mirënjohje nga: Academy for-Diplomacy and Protokol, Prishtinë, 2019,
- Mirënjohje nga: Akademia Shqiptare Amerikane e Shkencave dhe Arteve në New York, Prishtinë, Tiranë, Shkup, 2019. Etj.

Akademik Nijazi Halili, ka të publikuara me qindra shkrime në shumë web faqe elektronike dhe të shkruara...

NIKOLLA SPATHARI



Nikolla Spathari, është i lindur në Malësi të Madhe, më 5. 12. 1940, ku mbaroi edhe mësimet e para. Në Shkodër bëri shkollën e mesme pedagogjike. Studimet e larta i kreu në Tiranë për matematikë.

Ka filluar të botojë në vitet gjashtëdhjetë të shekullit njëzet. Në vitet shtatëdhjetë boton dy librat e parë dhe bëhet një emër i njohur në publicistikën shqiptare. Me botimin e dy librave pranohet anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Por shpejt u ngrit çështja e biografisë dhe gjatë regjimit komunist i është hequr dy herë e drejta e botimit për motive politike, në 1970 dhe në 1975. Është interesant se herën e dytë, kur iu dha e drejta e botimit, iu vu kushti që të mos botojë shkrime kritike, por vetëm reportazhe.

Për 35 vjet punoi mësues në fshatrat e largëta të Malësisë së Madhe: Selcë, Zagorë, Reç, Bratosh, Kamicë, Koplík i Sipërm dhe në fund në Grudë të Re. Por çdo e keqe ka edhe të mirën e vet, sepse për më shumë se tri dekada e studioi me rrënjë jetën shekullore të malësorëve, gjë që u kurorëzua me veprat e tij studimore: *“Malësia e Madhe, siç e njoha unë”*, *“Në këngë është edhe historia”*, *“At Benedikt Dema”*, *“Malësia e Madhe-tokë e një etnokulture të lashtë”*.

Aq sa lejonte regjimi nuk e ka kursyer edhe kritikën në revistën “Hosteni” me fejtone të herëpashershme. Ndërsa në verën e vitit 1990, kur u hap pak drita jeshile, botoi artikullin “Paaftësia nën vellon e sektarizmit”, i cili në Plenumin e Komitetit Qendror u quajt “artikull, që në gazetën e Partisë i kundërvihet Partisë”.

Pas shembjes së regjimit totalitar ka qenë themelues dhe kryeredaktor i gazetës “Besa” në Shkodër (1991-1993) dhe i gazetës letrare “Pena” në Durrës (2004-2005).

Ka qenë gjithashtu reporter për Shqipërinë, i gazetës “Albania Herald” (1991-1996), Nga viti 2009 e në vazhdim është drejtor i revistës “Vegime letrare”. Nga viti 2007 është kryetar i Klubit të Shkrimtarëve dhe Artistëve Durrës.

Me 7 dhjetor 2013 është pranuar anëtar i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave në New York. Ka kumtuar në dhjetëra sesione shkencore në Shqipëri, Kosovë dhe Amerikë.

Ka botuar deri tani 26 libra me studime, poezi, prozë, letërsi për fëmijë, publicistikë, etj. Ka në botim veprën e plotë në 16 volume. Tre volumet e para kanë dalë nga shtypi.

Tituj dhe dekorata

Titullin “Mjeshtër i Madh i Albanologjisë” Titullin “Profesor Doktor”. Medaljen “Naim Frashëri” Titullin “Mirënjohja e Qytetit të Durrësit”, Titullin “Qytetar Nderi i Malësisë së Madhe”.

Çmime

Çmimin “Migjen” Çmimin “Mark Tuen” Çmimin “Dritero Agolli”. Çmimin “Xha Deradha”. Tre “Çmime të Para” në poezi. Tre “Çmime të Dyta” në poezi. Disa diploma dhe certifikata mirënjohje.

Vepra Studimore:

“Malësia e Madhe, siç e njoha unë”, -SHB. Idromeno, 2001.
“Në këngë është edhe historia”, -ars Print, Prishtinë 2011.
“At Benedikt Dema”. -SHB Jozef, 2015.
“Malësia e Madhe-tokë e një etnokulture të lashtë”, - SHB Jozef, 2018.

Poezi

“Përtej shiut”, -ShB Shtjefni, 2003. “Përkohësisht e Bukur” - ShB Globus R, 2005. “Të shtyhet mëngjesi”, -ShB Globus R, 2007.
“S'iki dot nga kjo vjeshtë”, -ShB Milenjum, 2014.
“Bir i Diellit”. -ShB Jozef, 2019.
“Do të mbetet për gjithnjë Homeri” (Greqisht)-Greqi, 2017.
“Përshtatje e Poemave Satirike të Fishtës” -në proces,
“Kur isha Ministër” -Botimet (Tregime) Toena, 1998.
“Aventurë në Xhennet” - (Tregime) ShB Jozef, 2017.
“Djemtë e dikurshëm”, (Roman) Botimet Toena, 2004.

Letërsi për fëmijë

“Një shtyllë elektrik”, -SHB Naim Frashëri, 1971.
“Iku nëna u bë kështjellë”, -Botimet Ada, 2010.
“Një javë në përrallë” -Botimet Ada, 2010.
“T'lumtë i them kush e ka gjetur”, -Botimet Ada, 2009.
“Kështjellë edhe nënë”, -SHB Fidani, 2017.
“Një ditë e largët dimri”, - SHB Naim Frashëri. 1974.
“Tom Sojri” (Dramë, sipas motiveve të romanit të M. Tuen). 2013

Publicistikë

-Letër me Adresë (Në proces botimi). Drejt Evropës me gomar të Nastradinit.-SHB Idromeno, 2000. Etj.

NIMON MUÇAJ



Nimon Muçaj, u lind më 1952, në Llukë të Epërme të Deçanit. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në Deçan.

Studioi gjuhë dhe letërsi angleze. Kreu shkollën e lartë për aktor në Prishtinë më 1973. Tri vjet punoi si arsimtar i gjuhës angleze në Drenoc dhe Isniq, komuna e Deçanit.

Që nga viti 1977-2006 punoi në Teatrin Popullor të Gjakovës. Ishte drejtor në teatrin “Istref Begolli”, në Pejë gjatë viteve 2011-2017.

Deri tani ka interpretuar mbi 100 role në teatër, në TV drama, filma artistik dhe video profesionale filmike.

Nimon Muçaj, përveç shumë roleve, ka bërë shumë regji teatrore, filmike dhe dokumentare.

Nimon Muçaj ka qenë asistent regjisor në filmin e metrazhit të gjatë “Kur shpirti ndërron jetë”, të regjisorit të njohur Smajl Ymeri. Filmi është xhiruar e realizuar pas luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe flet pikërisht për masakrat dhe gjenocidin e policisë dhe të ushtrisë serbe mbi popullatën e pafajshme shqiptare gjatë viteve 1998/1999.

Ka realizuar një film televiziv dhe disa videofilma në teknikën BETACAM: “Kosovë, kurrë s'tu nda gazepti”, 1996,

“Anija e përgjakur”, 1997,

Me filmin televiziv “Nr. 56296” 1997 mori pjesë në Festivalin e Filmit “Eurofilm” Çeki 1999.

Dokumentaret: “Nënë Aisha”, 1997,

“Elton Zherka” 1999,

“Disa javë me refugjatët”, 1999, i ka realizuar në TV shqiptar, Shijak TV dhe TV Klan.

“Salih Çekaj-Gurthemel i Pavarësisë” dokumentar, i realizuar në vitin 2002 dhe i transmetuar edhe në RTK në shkurt të vitit 2003.

Vepra të botuara:

1. “Prova e tridhjetetretë” roman-Rilindja, Prishtinë, 1989,
2. “Ditët që thyen shpatën e perandorisë” dramë–Jeta e re-Prishtinë, 1991
3. “Vdekja e kalit” roman-“Rilindja”, Prishtinë, 1993,
4. “Baladë për borën e kuqe” roman, Tiranë 1999,
5. “Verrat e Llukës dhe Neutrali i Junikut”, botim i autorit, Prishtinë, 2002,
6. “Salih Çekaj-Gurthemeli i Pavarësisë së Kosovës” - Gjakovë, 2003,

7. “Rekuuem për Atë Shtjefën K. Gjeçovin dhe për Patër Luigj Palajn”-
Botim i Kuvendit Françeskan, Gjakovë, 2003, ku përfshihen tri forma
letrare: roman, dramë dhe skenar filmi.
8. Ditët e buburrecit, roman -Rozafa -MKRS, 2004,
“Guximi s'ka gojë” roman Faik Konica-Ministria e Kulturës së 2014,
Nimon Muçaj jeton në Llukë të Epërme dhe tani është aktor,
regjisor dhe shkrimtar i lirë. Ai u pensionua në maj të vitit 2017.
Jeton në Llukë të Epërme dhe Gjakovë.

Disa nga rolet:

Vuçi Pasha “Nora” Andrera Skanjeti 1971,
Shpendi “Bajram Curri” 1975
Tuç Maku “Toka e Jonë” 1976,

Regjisor e aktor:

Plaku te “Stina e Kuqe” Fatmir Gjata 1976,
“Besa e Madhe”, Mirash Markaj, 1979,

Ne Teatrin e Ferizajt

Profesori, “Ngjarja ne Vishi” Artur Miler, 1975,

Disa nga rolet ne Teatri Popullor Gjakove

Orhani “Fisheku në pajë” e F. Krajës, 1977,
Valteri “Intrigë e dashuri” F. Shiler 1979,
Fahredini “Njëriu me top” e D. Agollit, 1981,
Kukudhi te “Unë Halil Garria” e B. Musliut, 1983,
Haruni dhe Iblisi te “Beselam pse me flijojnë” e R. Qosjes-1985,
Kryetari i pushtetit lokal “Babai im kulak socialist”-T. Partliq, 1985,
Pol Koulmen “Korali Lensdaun thotë jo” e A. Buzës, 1985,
Bejtash Aga, te “Halili e Hajria” e K. Jakovës, 1987,
Kryetari te “Hëna prej Letre”-M. Kraja, 1990,
“Qytetari Fisnik” Molieri, 1993,
Reinhardi “Aleksander Moisiu” M. Ramadani, 1995,
Roja “Antigona” e Sofokliut, 1996,
Prifti “Të fala nga Shkodra” Emin Kabashi,
Branko te “Dasma e trojeve tona” F. Kraja, 2000,
Qamil Beu “Epoka para gjyqit e E. Kryeziut, 2003,
Oficeri te “Antigona e re”- M. Krasniqi, 2003,
Ujkani te “Kaos atdhedashurie në paris” e Haqif Mulliqit, 2004,
Hamleti, regjia Agim Selimi etj.
Njeriu prej dheu- regjia Agim Sopi. Etj.

NURI DRAGOJ



Prof. Nuri Dragoj, u lind më 22 prill të vitit 1951, në fshatin Zhepovë të rrethit të Përmetit. Shkollën e mesme të përgjithshme “Musa Fratarit” e kreu në Këlcyrë. Studioi në Fakultetin e Veterinarisë dhe është diplomuar në vitin 1976.

Gjatë jetës studentore ka qenë redaktor në gazetën “Studenti i Bujqësisë”. Ka punuar si mjek veterinar në ekonomitë bujqësore të rrethit të Përmetit, në vitet 1977-1986,

Më pas është emëruar kryeveteriner i NB Otlak, në Berat. Ka kryer një sërë specializimesh në fushën e shkencës të veterinarisë.

Nga viti 2003 deri në vitin 2009, ka qenë kryeredaktor i gazetës “Republika”. Pas kësaj ka kryer detyrën, drejtor i Bibliotekave dhe Arkivit të Qendrës Albanologjike Shqiptare.

Prej 16 vitesh është kryeredaktor i gazetës mujore “Dëshnica”, drejtor i Qendrës për Kulturë Demokratike “Fan Noli”, nënkryetar i Shoqatës Atdhetare Kulturore “Dëshnica”, nënkryetar i Shoqatës së Gazetarëve të Bujqësisë etj.

Ka mbrojtur doktoraturën në Fakultetin e Filologjisë, pranë Universitetit Shtetëror të Tiranës, në fushën e Historisë.

Veprat:

1. “Lumo Pavari”, monografi”, Tiranë, 2004,
2. “Hajrulla Muhametaj midis tri epokave”, monografi, Tiranë, 2005,
3. “Dëshnica dhe Dëshnicarët”-libër studimor në tri vëllime,
4. “Vështrim gjeografik dhe jeta ekonomike”, Vëllimi I, Tiranë, 2005,
5. “Njerëz që u këndon zemra”, Vëllimi II, Tiranë, 2005,
6. “Penë dhe pushkë për mëmëdhenë”, Vëllimi i tretë, Tiranë, 2006,
7. “Eshtra që akuzojnë (Zhvarrimet në Përmet, turp i politikës)”, 2006,
8. “Trebeshina një jetë para gjyqit”, studim monografik, Tiranë, 2007,
9. “Shqiptarët dhe grekët-realitete historike”, Monografi, Tiranë, 2009,
10. “Familja Qerimaj në sfidat e pentagramit”, monografi, Tiranë, 2009,
11. “Rreziku i Shkombëtarizimit”, Tiranë, 2011,
13. “Prapaskenat e Konferencës së Londrës”, Tiranë, 2013,
14. “Arsimi në Përmet (1912-1944)”, Tiranë, 2015,
15. “Përmeti dhe lufta për pavarësi”, Tiranë, 2015,
16. “Në përballje me krimin”, monografi, Tiranë, 2016, etj.

NIKË GJELOSHI



Dr. Sc. Nikë Gjeloshi, u lind në Rakoc, në vitin 1950. Shkollën fillore e kreu në Irzniq të Deçanit, normalen në Pejë, Fakultetin e Politikologjisë e kreu në Universitetin e Zagrebit, si dhe studimet pasuniversitare i kreu në Zagreb. Ka doktoruar në shkencat politike. Punoi gazetar në Radiotelevizionin e Prishtinës.

Nikë Gjeloshi ka qenë themelues dhe nënkryetar i Partisë Shqiptare Demokristiane, prej vitit 1990 dhe ka mbajtur poste të larta në Qeverinë e Kosovës në ekzil, si dhe ministër i mbrojtjes i Republikës së Kosovës (1991-1995).

Publikimet:

1. "Shqipëria jashtë Konferencës së shteteve Islamike, 2006.
2. "Për shtetin sovran dhe të pavarur të Kosovës", Prishtinë 1991.
3. "Aspekte të pandriquara të ndryshimeve kushtetuese", Prishtinë, 1990.
4. "Çasje e gabuar ndaj problemit shqiptar në RFJ" Prishtinë, 1990.
5. "Si u bënë ndryshimet kushtetuese në Kosovë" Prishtinë 1990.
6. "Nuk do të ketë front jugor", Prishtinë, 1991.
7. "Në jemi në radhë", 1992.
8. "Në Kosovë bie zilja e alarmit", 1992.
9. "Kosova dhe e ardhmja e saj" Tiranë, 1995.
10. "Në mungesë të ndërhyrjes ndërkombëtare, shqiptarëve u mbetet shembulli i Kongresit të Lushnjës", 1998.
11. "Tepër gjatë kemi thirrë natën nëpër terr" 1998.
12. "Kosovës i duhet një qeveri, një ushtri, një konto" 1999.
13. "Si identifikohet politika ndër ne" "Spektrum", 2000.
14. "Si ta heqim lakun e quajtur: Respektim i sovranitetit dhe integritetit territorial të RFJ-së", 2000.
15. "Kosova 1999 - as republikë e proklamuar as autonomi e imponuar", Tiranë, 2002 dhe 2004.
16. "Demonstratat e vitit 1981 bënë kthesë në identitetin tonë kombëtar", botuar në vitin 2006.
17. "Shqipëria jashtë Konferencës së shteteve Islamike", 2006.
18. "Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës 1991-1995", "Rugova-Art", Prishtinë 2015. Etj.

NUSRET PLLANA



Dr. sc. Nusret Pllana është i lindur më, 21 maj 1959, në Arbnesh të Prishtinës, është publicist kosovar. Shkollën filloren e kreu në vendlindje, kurse gjimnazin dhe Fakultetin Ekonomik në Prishtinë. Në vitin 1984 themeloi Ansamblin Artistik, "Hasan Prishtina", të Prishtinës, të cilin e udhëhoqi deri më 1996.

Derisa ndiqte studimet pasuniversitare të ekonomisë në Zagreb, me të kthyer në Kosovë, më 1986, dënohet me 6 vjet burg, i mban vetëm 5 vjet. Pas daljes nga burgu themelon Ndërmarrjen private për prodhimin e qilimave "Teuta" në Prishtinë. Ndërkaq, më 1994 burgoset për të dytën herë, por kësaj radhe si anëtar i Këshillit Drejtues të Odës Ekonomike të Kosovës. Ishte pjesëmarrës i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe folësi i parë i Radios "Kosova e lirë". Pas kthimit nga lufta, ishte redaktor përgjegjës i Radios "Kosova e lirë". Ishte zëvendës ministër dhe ministër i kulturës i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës 1999-2000.

Ka udhëhequr sektorin e Arkivit të UÇK-së nga viti 2002-2006. Aktualisht është ligjërues i Universitetit "Hasan Prishtina" të Prishtinës dhe Universitetit Shtetëror të Tetovës në Shkup dhe Tetovë. Ka magjistruar në Tiranë, në vitin 2005,

Ka doktoruar në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, më 1 Shtator 2009, me temën: *Intervenimi i NATO-s në Kosovë*, në departamentin e shkencave politike dhe administrimit publik. Në vitin 2011 i botohet në gjuhën angleze, libri, *NATO Intervention in Kosova* me recensentët: Ambasadorin amerikan William G.Walker, Prof. dr. Christopher G.L.Hall dhe Prof. Julia Norrgard.

Libri i tij *The Terror of Invading Serbia over Albanians 1844-1999*, i sajuar në tetë gjuhë, është botuar në: Prishtinë, Tiranë, Tetovë, Shkup, Oslo, Stokholm, e vende tjera.

Është redaktor dhe recensent i disa librave të autorëve të ndryshëm.


Libri i tij *Terrori i Serbisë Pushtuese mbi Shqiptarët 1844-1999*, ka arrit të futet në Bibliotekat më të njohura evropiane e botërore. Ky libër në vitin 2013 ka marrë mirënjohje nga Biblioteka Botërore e Kongresit Amerikan dhe Biblioteka Botërore e Britanisë së Madhe në Londër, në vitin 2015.

Është autor i dhjetëra punimeve shkencore, filmave dokumentar, ekspozitave, monografive, librave publicistiko historik etj.

Veprat:

- Ekspozitën me fotografi dokumentare “*Rruga e Kosovës së Lirë*”, 1999.
- Filmin dokumentar: “*Pas dymijë vjetësh rrugëtim*”, 2000 (Fitues i çmimit të publikut në Festivalin Ndërkombëtar të Filmave dokumentar, 2001),
- “*Hasan Prishtina*”, vepër publicistike, 2000,
- “*Gjenocidi serb në Kosovë 1840-1999*”, ekspozitë dokumentare, 2001,
- Filmin dokumentar: “*Nëna e vetmisë së madhe- kushtuar Nënë Ajshe Gërvallës*”, 2006,
- “*Krimet që kërkojnë drejtësi*” I, dokumentar, 2002,
- “*Krimet që kërkojnë drejtësi*” II, dokumentar, 2002,
- Dokumentar: “*Kur masakrohen fëmijët*” (*Masakra e Llashticës*), 2003,
- Filmin dokumentar: “*Lajmëtarët e Lirisë*”, 2004,
- Filmin dokumentar: “*Nga Arkivi i UÇK-së*”, 2004
- Filmin dokumentar: “*Zëri i Lirisë*”, 2004,
- Filmin dokumentar: “*Shpendi i UÇK-së*”, kushtuar dëshmorit të kombit Basri Canolli, 2004,
- Ekspozitën dokumentare: “*Maska lufte, fytyra paqeje*”, Romë, Itali, 2007,
- “*Intervenimi i NATO-s në Kosovë*”, vepër publicistike dokumentare, Prishtinë, 2010,
- “*NATO Intervention in Kosova*”, vepër publicistike dokumentare (në gjuhën angleze), 2011,
- Librin Monografi: “*Uragani i UÇK-së*”, -kushtuar dëshmorit të kombit Feriz Guri, 2014,
- Ekspozitën me fotografi dokumentare: “*Gjurmët e një libri nëpër botë*”, e hapur në disa vende, në vitin 2014,
- Filmin dokumentar: “*Dëshmitë e Heshtura*”, kushtuar masakrës së Krushës së Madhe, 2016,
- Filmin dokumentar: “*Shoqata kulturore atdhetare KOSOVA*”-Shkodër, i realizuar në vitin 2015,
- Lufta çlirimtare në Kosovë dhe roli i KFOR-it, Diskutime, viti II, nr.3/4, prill-maj, 2013, Tetovë,
- Programet serbe për shfarosjen kolektive të shqiptarëve, Diskutime, viti IV, Nr.15, shkurt, 2015, Tetovë,
- Strategjia gjeopolitike Amerikano-Evropiane dhe Kosova, Nëntor, Tetovë, 2016. Etj.

ODISE PLAKU



Odise Plaku është shkrimtar, i lindur në qytetin e Fierit, por jeton, punon, ushtron aktivitetin e tij letrar në qytetin e Tiranës.

I njohur në botën e krijimtarisë letrare shqiptare si shkrimtar për fëmijë, të rritur në zhanrin e tregimit, poezisë dhe novelës, kontributi i tij është i prekshëm dhe në veprat dramatike.

Krijimtaria e tij zë një vend të rëndësishëm në letërsinë bashkëkohore shqiptare, por edhe më gjerë. I përkthyer në disa gjuhë, italisht, anglisht, rusisht dhe në gjuhën mandarine, Odise Plaku qëndron plot dinjitet mes lexuesve të tij.


Në krijimtarinë e tij preken temat e ditës duke pasqyruar problematikën reale me të cilat përballen shoqëria në jetë e përditshme. Në letërsinë për fëmijë ai sjell me finesë përballjen e fëmijëve me marrëdhëniet jo vetëm mes tyre, por edhe me familjen, shkollën e shoqërinë.

Në poezinë e autorit Odise Plaku një vend të rëndësishëm zë dhe inspirimi nga kënga folklorike shqiptare.

Veprat:

- “Klithma e një nëne të marrë” - monodramë, Fier, 2006,
- “Ylli i mëngjesit”-dramë vënë në skenën e teatrit Migjeni, Shkodër, 2009,
- “Velloja e bardhë”, monodramë, teatri, “Andon Zako Çajupi”, 2008,
- “Flakët e shpirtit”, dramë në teatrin, “Aleksandër Moisiu”, 2010.
- “Të rendësh i lirë”, dramë për fëmijë, 2009,
- “Moonlight”-film me metrazh të shkurtër, skenarist, 2007,
- “Fëmijët e ndrojtur”-komedi, teatri “Metropol”, Tiranë, 2014,
- “Amaneti”-monodramë teatri “Petro Marko”, Vlorë, 2015,
- “Fëmijët e ndrojtur”-komedi, Teatri i të Rinjve të Prishtinës, 2016,
- “Klithja”-monodramë, Instituti Ndërkombëtar i Teatrit Kosovë, 2016
- “Amaneti”-dramë teatri, “Migjeni”, Shkodër, 2017,
- “Pak gjumë o njerëz”, monodramë, Kosovë, 2018,
- “Qullaci” novelë-përrallë për fëmijë, 1999,
- “Lotin nuk e fal”- vëllim me tregime për të rritur, 1995,
- “...dhe gjethet bien”-vëllim me poezi për të rritur, 2005,
- “Kthimi i Samantës”-vëllim me tregime e novela, 2005,
- “Kur qeshen ëndërrbukurat”-novelë për fëmijë, 2009,
- “Zhguni i Gjinkallëdhredhakut”-novelë për fëmijë, 2011, etj.

OSMAN IMAMI (1936-1996)



Dr. Osman Imami, u lind më 16 qershor 1936, në fshatin Singjeliq-Shkup. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse gjimnazin në Pejë.

U diplomua në Fakultetin e Mjekësisë të Shkupit, më 1961. Specializimin në mikrobiologji e kreu në Beograd, më 1966, ndërsa në infektologji, në Zagreb më 1969.

Në vitin 1968, magjistroi në Fakultetin e Mjekësisë të Zagrebit, kurse më 1971 doktoroi, po ashtu në Fakultetin e Mjekësisë të Zagrebit.

Më 1965 u emërua drejtor i Entit Higjienik të Pejës, ndërsa më 1966 drejtor i përgjithshëm i Qendrës Medicinale të Pejës.

Më 1969 u emërua drejtor i Repartit Infektiv të Spitalit të Përgjithshëm të Prishtinës.

Më 1971 u zgjodh dekan i parë i Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinës.

Gjatë vitit shkollor 1971-73 qëndroi në specializim në Baylor College of Medicine të Hjustonit, kurse në vitin shkollor 1974-75 në Institutin Nacional të Suedisë, në Stokholm. Punoi në Institutin Mikrobiologjik dhe në Entin Krahinor për Mbrojtjen Shëndetësore, në cilësinë e drejtorit të tij. Njëherazi ishte edhe profesor ordinar i Mikrobiologjisë në Fakultetin e Mjekësisë të Prishtinës.

Ishte sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës të ASHAK. Ka botuar më se 40 punime shkencore dhe profesionale, dy tekste origjinale universitare dhe dy tekste të përkthyer universitare nga gjuha angleze dhe shqipe, ka marrë pjesë në simpoziume. Ishte laureat i Çmimit të Nëntorit të qytetit të Prishtinës dhe i Çmimit të Dhjetorit të KSA të Kosovës. Vdiq në Amerikë, në dhjetor të vitit 1996.

Bibliografia

Imami O., 1969, "Fauna crvenih parazita-helminata kod nekih skupina stanovništva Kosova i njezin epidemiološki znaj", (tezë e magjistraturës),

Imami O., "Ispitivanje prokuženosti toksoplazmom stanovništva Kosova uporednim serološkim i alergijskim reakcijama s posebnim osvrtom na epidemiološke aspekte", (tezë e doktoratës),

Imami O., 1977, "Neki novi aspekti antibioterapije, Praxis Medica",

Imami O., 1978, "HB s antigenima u kliničkom materijalu, dobrovoljnih davalaca krvi i stanovništvu uopšte, Praxis Medica", v. XV, nr. 1-2,

Imami O., 1970, "Trbušni tifus i meningealni sindrom", Praxis Medica, 23,

- Imami O., 1976, "Rasprostranjenost rezidualnog titra antitela na Toxoplasmu gondii na području SAP Kosova utvrđenog metodom indirektno imunofluorescenije", Praxis Medica, v. XII, 9,
- Imami O., 1971, "Icterus kod tromesečnog deteta sa kongenitalnim luesom", Praxis Medica, v. II, 21,
- Imami O., 1973, "Naša iskustva u lčenju bolesnika od meningitisa", Praxis Medica, v., 31
- Imami O., 1977, "Antibodies to R. Prowazeki and C. Burneti in the population of Kosovo", Acta Biol. Med. Exp., 2, 93-96,
- Imami O., 1978, "HB s antigenima u nekim grupacijama stanovništva Kosova", Prvi dani preventive Kosova, Priština, 1978. Godine,
- Imami O., 1976, "Detakcija pozitivnih reaktora na Treponemu pallidum primenom indirektnog FTA testa", Prvi simpozijum lekara opšte medicine Kosova, Brezovica, 1976,
- Imami O., 1972, "Terapija velikih boginja na Kosovu" 1972. godine, Zbornik Jugoslovenskog simpozijuma o varioli, održanog u Primoštenu, 1970.

Tekstet originalne:

- "Mikrobiologija dhe parazitologija medicinave",
Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK, Prishtinë, 1977,
- "Sëmundjet akute infektive",
Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK, Prishtinë, 1977.
- "Imunologija",
Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK, Prishtinë, 1977,
- "Imunoprofilaksa",
Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK, Prishtinë, 1980,

Përkthimet nga gjuha angleze në gjuhën shqipe:

- Jawetz, E., Melnick, J.L., Adelberg, E. A.,
"Vështrim mbi mikrobiologjinë medicinave", Prishtinë, 1979.
- Wistrich, G.A., Lexhtman, M.D.
"Praktikumi eksperimental nga mikrobiologjia", Prishtinë, 1979.
- Dedushaj, O. Imami:
"Vdekshmëria e foshnjave nga sëmundjet akute infektive"
në KSA të Kosovës gjatë periudhës 1961-1981, 1985.

PAJAZIT NUSHI (1933-2015)



Pajazit Nushi, u lind në Gjakovë më 1933, ku kreu shkollën fillore dhe të mesme. Studimet e larta i ndoqi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Beogradit. U diplomua në degën e Psikologjisë më 1955. Më 1958 dha provimin shtetëror për profesor të psikologjisë dhe psikologjisë pedagogjike. Në qershor 1983, mbrojti doktoratën.

Në vitet 1956-1995 punoi profesor i psikologjisë në Shkollën Normale të Prishtinës, në Shkollën e Lartë Pedagogjike dhe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës.

Ka qenë dhe drejtor i Entit Krahinor për Përparimin e Arsimit dhe Edukimit, ndihmës kryetari i Këshillit Federativ për Arsim e Kulturë të ish-Jugosllavisë; nënkryetar i Këshillit Ekzekutiv të Kosovës, kryetar i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave e Lirive të Njeriu dhe redaktor i Enciklopedisë së Jugosllavisë. Ishte dhe rektor i Kolegjit Universitar “Iliria”.

Në vitin 2000 u zgjodh anëtar korrespondent i ASHAK, ndërsa më 2008 anëtar i rregullt. Ka qenë sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore të ASHAK-ut (2008 – 2011).


Ka botuar trajtesa të veçanta shkencore dhe artikuj nga fusha e psikologjisë sociale, e sociologjisë, e leksikologjisë shqipe të psikologjisë së religjionit, etj. Ka qenë kryetar i Shoqatës së Psikologëve të Kosovës dhe nënkryetar i Shoqatës Mbarëshqiptare të Psikologëve. Më 23 shtator 1970 është shpallur qytetar nderi i shtetit Teksas me vendim të Guvernatorit, kurse më 10 tetor 1970 qytetar nderi i shtetit Nebraska. Më 2005 u zgjodh anëtar nderi i Institutit të Sociologjisë në Tiranë. Më 14 qershor 2011 u shpall “Nderi i Qytetit të Gjakovës” Në marsin e vitit 2011 u zgjodh këshilltar i lartë shkencor në Institutin e Hulumtimeve të Krimeve të luftës në Kosovë. Nënkryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës u zgjodh në dhjetor 2011. Ka qenë zv Kryetar i Asamblesë së Akademisë së Edukimit nga shtatori i vitit 2011.

Është shpërblyer me falënderime nga shumë organizata profesionale e shtetërore në vend dhe jashtë. Më 1957 mori Çmimit e Dhjetorit për të arritura arsimore e shkencore në Kosovë. Është bartës i disa dekoratave -e fundit ajo e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit nga Presidenti i Republikës së Kosovës në vitin 2001. Vdiq në Prishtinë më 2015.

Nga fusha e psikologjisë:

- “Bazat psikologjike të kulturës së të folurit të nxënësve të shkollës fillore”, Prishtinë, 1964,
- “Fjalor i psikologjisë”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1987,
- “Sistemi i grafisë së tingujve të shqipes dhe vetitë perceptive e përmasat e lexueshmërisë së shkronjave të alfabetit të gjuhës shqipe”, Prishtinë, 1987,
- “Psikologjia për klasën e dytë gjimnaz”, Prishtinë, 1986. Ky libër mori çmimin “Naim Frashëri” - U ribotua në vitet 2000, 2001 dhe 2003,
- “Psikologjia e përgjithshme I”, Prishtinë, 1997, “Psikologjia e përgjithshme II”, Prishtinë, 1999,
- “Të nxënit e lëndëve shkollore dhe zotërimi i tyre”, Prishtinë, 1997,
- “Psikologjia e përgjithshme I”, “Libri Shkollor”, Prishtinë, 2002,
- ”Inteligjenca dhe masa e zhvillimit të saj ndër shqiptarët e moshës madhore”, Prishtinë, 2004,
- “Kujtesa dhe trajtimi i saj në literaturën shqipe normotike”, ASHAK, Prishtinë, 2008,
- “Fjalor shpjegues i psikanalizës”, ASHAK, Prishtinë, 2010,
- “Leksikoni i psikologjisë”, vëllimi I, ASHAK, Prishtinë, 2014,
- “Leksikoni i psikologjisë”, vëllimi II, ASHAK, Prishtinë, 2014,
- “Nga enciklopedistika, në bashkëpunim me të tjerë: Enciklopedia e Jugosllavisë” 1 A-Bib, Zagreb, 1984,
- “Enciklopedia e Jugosllavisë 2 Bib-Çif, Zagreb, 1987 etj.
- Përktheu nga serbokroatishtja këta libra shkollorë:
- Vështrime, trajtesa, kumtesa dhe studime:**
- “Psikologjia e sotme në shërbim të organizimit të drejtë të procesit edukativo-arsimor”, “Përparimi” 6/1960,
- “Motivet psikologjike të mërgimit të shqiptarëve në vitet 1946-1966”, botuar në librin “Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë shekujve”, Prishtinë, 1990,
- “Krijimtaria e Lasgush Poradecit dhe psikanaliza e Zigmund Frojdit”, kumtesë e lexuar në Simpoziumin kushtuar 100-vjetorit të lindjes së Lasgush Poradecit, Prishtinë 1999,
- “Konferencën e Parë Mbarëshqiptare të Unionit të Ekonomistëve Shqiptar”, që u mbajt në Tiranë prej 15-17 nëntor 1999 botuar në, Tiranë-Prishtinë-Shkup, 2000, etj.
- “Integriteti dhe identiteti i personalitetit dhe dyzimi i tij”, Prishtinë, 2001.
- “Etiologjia e krimit mbi njerëzimin të pushtetit serb ndaj shqiptarëve në Kosovën e viteve '90 të shekulli XX”, Prishtinë, 2001.

PËLLUMB KULLA



Prof. Pëllumb Kulla u lind në Zëmlak të Korçës, më 10 janar 1940. Përfundoi arsimin e mesëm në degën mekanike të Politeknikut "7 nëntori" (1957) dhe studimet e larta i kreu në Shkollën e Lartë Teatrale "Aleksandër Moisiu" më 1964. U emërua regjisor i Estradës së Vlorës. Më 1967, bie viktimë e luftës së klasave.

Më 1972 emërohet aktor në Teatrin e Fierit, më pas regjisor; dhe punoi aty 18 vjet, si regjisor i Estradës dhe Teatrit. Kulla deri më tash ka shkruan më se 300 skeçe dhe komedi një akteshe,

40 kuplete dhe 23 monologje, shumica e të cilëve shfaqen në TV.

Një pjesë e kësaj krijimtari voluminoze botohet nga Shtëpia Botuese "Naim Frashëri":

"Lipe Shtogu në listë", (1979), "Shoku Niqifor", (1981), "Portrete pa makiazh" (1983), "Po martojmë Malon" (1984),

"Këshilla për fëmijët e moshave nga 5 deri 55 vjeç" (1988).

Më 1987 i jepet Çmimi "Naim Frashëri" i Klasit të Dytë. Paralelisht me punën në Estradë, realizon dhjetë produksione dramatike, të gjitha drama ose komedi të shkruara prej tij, nga të cilat shquhen:

"Shoku Niqifor", "Dy krismat në Paris", "E bukur shtëpi e vjetër", "Sa shumë gjethe të thata atë vjeshtë", (komedi) vënë në skenë në Teatrin "Skampa" të Elbasanit, fitoi çmimin e parë në Festivalin Kombëtar të vitit 1989. Në vitet '80, humori i Kullës bëhet i kërkuar edhe në kinema. Me skenar të tij xhirohen kinokomeditë: "Telat për violinë" dhe "Stolat në park" pa llogaritur pastaj angazhimin si autor dhe regjisor i skenarëve me metrazh të mesëm televiziv, në televizionin e vetëm shtetëror. Më 1990 largohet nga Fieri, për të nisur punën si pedagog, e më pas Dekan i Fakultetit të Artit Skenik, në Tiranë.

Më 1992 emërohet Sekretar për Kulturën dhe Shtypin në Ambasadën e Shqipërisë në Bonn, Gjermani dhe në Nju Jork pranë OKB (1993-1997).

Gjatë qëndrimit në SHBA prodhimtaria e tij u pa e begatë. Botoi veprat:


"Si qeshnim nën diktaturë", "Rrëfenja nga Amerika", "Lejlekët nuk vijnë më" dhe "Vdekja e Enver Hoxhës".

Pëllumbi botoi shumë tregime dhe novela:

"Pushtimi i Amerikës" (2005),

"Rrëmbimi i nuses në Nju Jork", (2012) etj.

PETRAQ RISTO



Petraq Risto është i lindur në Durrës, më 9 qershor 1952.

Ka kryer studimet e larta për gazetari dhe një vit pasuniversitar për kritik teatri. Ka punuar si gazetar dhe libretist.

Pas vitit 1990, shtëpia e tij botuese “Globus R”, ka publikuar me qindra libra e autorë seriozë. Është autor i shumë vëllimeve me poezi, romane, tregime etj.

Librat e tij më të spikatur në poezi janë:

“Zgjohu, princesha ime”,
“Mollë zhvirgjëruar nga rrufetë”, “Lojë shahu në shekullin XXI”,
“Engjëlli me virus H5N1”,
“Hallelulja”, “Apo-ka-lypsi”, “Miq të dyshimit”,
“Udhëtar me pluhur ferri”, “Unë quhem Dje”,
“Avioni 'Madam Baterflaj 9/11'(roman),
“Bukuroshja fantazmë dhe unë zoti Prek Vdek”, (roman),
“Një grua me Urdhrin e Ujku”,

Vëllimet me tregime:

“Vdekja e palaços”,
“Ndalohet vrasja e ujqërve”, etj.

Librat e tij poetikë janë përkthyer në vende të ndryshme të botës si në Francë dhe kanë arritur lexueshmëri të mirë:

“Amer est le miel des tombes” (“I hidhur mjalti i varreve”),
përkthyer nga Solange d'Angely dhe Luan Rama, botuar nga
“L'Harmattan”, Paris, 2009,

“El guardian de las golondrinas (“Kujdestar i dallëndysheve”), botuar në dy gjuhë, spanjisht dhe shqip, përkthyer nga Xhevdet Bajraj dhe Ricardo Romero Vallejo, botuar nga Géiser dhe Toshka, Meksiko, 2008,

Në Rumani, “Vânatul câlușilor de mare” “Gjuetia e kuajve të detit”,
përkthyer nga Kopi Kyçyku, botuar nga Librarium Haemus,
Bukuresht, 2008,

“Lojë shahu në shekullin XXI”, në SHBA publikuar në sistemin e librit elektronik Kindle, shpërndarë nëpërmjet amazon.com, 2011.

Gjithashtu, poezia e akademik Petraq Ristos është publikuar në revista dhe në antologji të ndryshme në ShBA, Spanjë, Itali, Angli, Meksikë, Maqedoni, Rumani, etj.

PETRAQ ZOTO (1937-2015)



Petraq Zoto, u lind në Ziçisht të Devollit, më 20 dhjetor 1937. Kreu studimet e larta për gjuhë-histori dhe gjuhë-letërsi. Afro 10 vjet punoi mësues në Devoll e në Korçë. Në mars të vitit 1969, u emërua drejtor i pallatit të kulturës të Korçës, më pas drejtor i teatrit “Andon Zako Çajupi”. Për 10 vjet kryesoi edhe degën e Korçës të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë.

Nga viti 2000 jetoi në Tiranë. Në vitet 2001-2005, punoi në shtëpinë botuese “Mësonjëtorja”, redaktor i botimeve letrare. Ndërroj jetë më 6 shtator 2015.

Tregime:

“Tirka”, botuar në dy vëllime, SHB "Naim Frashëri, Tiranë 1966,
“Mësuesi im i parë”, SHB "Naim Frashëri", Tiranë, 1966,
“Ndërgjegjja”, SHB "Naim Frashëri", Tiranë, 1967,
“Dritat nuk u shuan”, SHB "Naim Frashëri", Tiranë, 1967,
“Tregimet e një nxënësi”, SHB "Naim Frashëri", Tiranë, 1968,
“Taksia u ndal te kthesa”, SHB "Naim Frashëri", Tiranë, 1968,
“Mëngjesi i Fuklakur”, SHB "Naim Frashëri", Tiranë, 1971,
“Tregime të zgjedhura”, SHB "Naim Frashëri", Tiranë, 1975,
“Kumbimi i një krisme”, SHB "Naim Frashëri", Tiranë, 1975,
“Dy buzëqeshje”, SHB "Naim Frashëri", Tiranë, 1981,
“Bredhi i gjelbër”, SHB "Naim Frashëri", Tiranë, 1981,
“Gjahu i dielës”, SHB "Naim Frashëri", Tiranë, 1984,
“Nesër bëhet vonë”, SHB "Naim Frashëri", Tiranë, 1986,
“Universi man”, SHB "Mësonjëtorja", Tiranë, 2007,
“Enigma e një ftese”, tregime të zgjedhura, SHB "Naimi", Tiranë, 2014,

Novela:

“Verka”, SHB "Naim Frashëri", Tiranë 1971,
“Sot erdhi dita”, SHB "Naim Frashëri", Tiranë, 1978,
“Kali fluturues”, SHB "Mësonjëtorja", Tiranë, 2001,
“Bishti i dhelprës”, SHB "Mësonjëtorja", Tiranë, 2003,
“Burimi i drerit”, SHB "Mësonjëtorja", Tiranë, 2001,
“Genta”, SHB "Mësonjëtorja", Tiranë, 2004,
“Vetja tjetër”, SHB "Uegen", Tiranë, 2010.

PETRIT RUKA



Petrit Ruka, është i lindur në Tepelenë, më 21.08.1954. Ka kryer studimet e larta për Gjuhë e Letërsi Shqipe dhe studimet pasuniversitare për dramaturgji filmike, Akademia e Arteve të Bukura, Tiranë 1985-1986. Ka punuar si pedagog në Shkollën e Mesme të Përgjithshme, Tepelenë gjatë viteve 1976-1984. Petrit Ruka ka punuar edhe si skenarist dhe regjisor në Kinostudio “Shqipëria e Re” dhe Alba Film Studio, Tiranë, gjatë viteve 1986-1996.

Ishte edhe Drejtor në Teatrin Kombëtar të Fëmijëve, Tiranë gjatë vitit 2000, kryetar i Qendrës Kombëtare Kinematografike Shqiptare, 2000-2005.

Veprat:

1. “Rinia ime” vëllim me poezi, 1978,
2. “Atdheu fillon tek zemrat”, vëllim me poezi, 1983,
3. “Mirupafshim, hënë e vendlindjes!”, vëllim me poezi, 1990,
4. “Vërtitu, Kokë e prerë!” vëllim me poezi, 2000,
5. “Në zemër bie shi”, vëllim me poezi, 2003,
6. “Shtatë mijë shirat e mi”, poezi të zgjedhura, 2008,
7. “Kalorësi mbi det“, ese monografike për Kadri Roshin, 2009,
8. “Iso dashurie“, Ars Poetika dhe Petrit Ruka, poezi e zgjedhur, 2015,
9. “Nëntë vjet e nëntë ditë“, Poemë baladeske, 2015.

Ka realizuar më shumë se 40 vepra të suksesshme kinematografike si skenarist dhe regjisor.

Vepra të ekranizuara:

1. “Eja”, në vitin 1986, skenari për film artistik, regjisor, Piro Milkani,
2. “Një i tretë“, në vitin 1987, skenar për film artistik, metrazhi i shkurtër, regjisor, Fatmir Koçi,
3. “Lumi që nuk shteron”, në vitin 1988, skenar për film artistik, regjisor Fatmir Koçi,
4. “Një djalë dhe një vajzë”, 1989. skenar, film artis, regjisor I. Muça. K. Mitro,
5. “Vazhdojmë me Bethovenin”, 1995 skenar për film artistik, regjia S. Pecani.

Filma dokumentarë.

1. “Shembja e idhujve”, 1994 skenar, regjisor K. Gjonaj,

2. “Të burgosurit e galerisë”, 1994, skenar për film dokumentar, regjisor Sajmir Kumbaro,
3. “Nënë Tereza”, 1999, skenar për film dokumentar, regjisor K. Gjonaj,
4. “Butrinti i gjallë”, 1996 skenar për film dokumentar, regjisor P. Ruka,
5. “Në fillim ishte Ademi”, skenar për film dokumentar, regjisor P. Ruka,
6. “Braktisja e Madhe”, skenar për film dokumentar, regjisor P. Ruka,
7. “Qyteti mbi gur”, 2002, skenar për film dokumentar, regjisor Eli Bici,
8. “Qyteti mbi naftë”, 2003 skenar për film dokumentar, regjisor P. Dervishi,
9. “Nënë Tereza”, 2004 skenar për film dokumentar, regjisor K. Gjoni,
10. “Drama Fadil Paçrami“, 2006 skenar, regjisor N. Ajazi,
11. “Atdheu lind nga të rënët”, 2006 skenar për film doku, regjia Esat Ibro,
12. “Kur vriteshin poetët”, 2007 skenar për film doku. Regjia N. Ajazi,
13. “Poet i ekranit”, skenar për film dokumentar. regjia P. Ruka,
- 14 “Aleksandër Moisiu“, skenar për film dokumentar. regjia N. Ajazi,
15. “Unë jam Ismail Qemali“, skenar për film dok. regjia Viktor Gjika.

Filma vizatimorë:

1. “I vdekuri i gjallë”, 1993, skenar për film vizatimor, regjia Albert Malltezi,
2. “Ekuilibër”, 1994 skenar për film vizatimor, regjia Albert Malltezi,
3. “Nëntë vjet e nëntë ditë” 2001, skenar për film vizatim, regjia Artur Dauti.

Si regjisor ka realizuar: (skenari dhe regjia)

- 1 “Njëqind për qind” 1994 film artistik, skenar e regji P. Ruka, A. Minarolli.
2. “Plumbi prej plasteline” 1995 film artistik P. Ruka, A. Minarolli.
3. “Butrinti i gjallë” 1998. dok. për Kadri Roshin, skenari Petrit Ruka.
4. “Në fillim ishte Ademi” 1999 dok. për A, Jasharin, skenar e regji P. Ruka.
- 5 “Braktisja e Madhe” 2001 dok për emigrimin, Petrit Ruka.
6. “Kapedani i këngëve”, 2005 dok. poetit Maliq Lila. P. Ruka.
7. “Amanet Labërinë” 2006. Dok. për Enver Guga. skenari e regjia P. Ruka,
8. “Me varrin hapur” 2006 dok për L. Mërkurin. skenar e regji P. Ruka,
9. “Bolenë, trimja Bolenë” 2007 dok. skenari e regjia Petrit Ruka,
10. “Poeti i ekranit, Viktor Gjika” 2009 film dokumentar Petrit Ruka,
11. “Aulona Folk Inernacinal Festival“ I 2009 dok. skenar e regji P. Ruka,
12. “Folk Inernacinal Festival“ II film dokumentar skenari e regjia, Petrit Ruka,
13. “Folk Inernacinal Festival“ III film dokumentar, skenari e regjia Petrit Ruka etj.

PREMTIM RASHITI



Prof. Premtim Rashiti, u lind 6 Janar 1978, në Gjilan. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Prishtinë. Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës e kreu në vitin 2004. Ishte bursist i Universitetit të Prishtinës për 4 vite me radhë. Përveç saj, ishte edhe përfitues i bursës nga Fondacioni i Republikës së Kosovës “Xhavit Ahmeti”, gjatë viteve 1996-1999. Në vitin 2006 zgjidhet Asistent i rregullt në Fakultetin e Mjekësisë në Katedrën e Anatomisë.

Njëkohësisht punoi edhe mjek i përgjithshëm në Zonën e IV të Trupave të Mbrojtjes së Kosovës (TMK).

Specializimin nga Mjekësia Interne dhe Subspecializimin nga Kardiologjia i mbaroi në intervalin kohor 2007-2013. Në vitin 2013 është punësuar në Kardiologji-Emergjencë në QKUK-së. Gjatë stazhit specialistik dhe studimeve të Doktoratës ka qëndruar në shumë qendra të njohura universitare jashtë vendit.

Studimet e Doktoratës i përfundoi në Universitetin e Prishtinës, ku mori titullin doktor i shkencës me temën: “Roli i adiponektinës në parashikimin e sëmundjeve të arterieve koronare dhe raporti i saj me parametrat antropometrik relevant”, në vitin 2018. Në të njëjtin vit akademik zgjidhet-avancohet në titullin Profesor Asistent i lëndës së Anatomisë në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës.


Ka publikuar numër të konsiderueshëm të punimeve shkencore si autor dhe koautor. Rashiti është pjesëmarrës aktiv në shumë simpoziume, kongrese, konferenca, takime profesionale, debate, prezantime shkencore me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar.

Më 2017 në Tiranë, fitoi çmimin e parë “Ylli Popa” nga Shoqata Shqiptare e Kardiologjisë në Konferencën e XXI Kombëtare. Është anëtar i Shoqatë Evropiane të Kardiologjisë (ESC), anëtar i Shoqatës së Kardiologëve të Kosovës (SHKK), është pjesëtar i FSK-së.

Botimet:

“A New Horizontal Plane of the Head”, Open Access Macedonian Journal of Medical Sciences, Shkup 2018, - “Anatomic Variations of pancreaticobiliary Union” Open Access Macedonian Journal of Medical Sciences, Shkup 2018, - “Cardiac Myxomas A single center experience with 33 cases”, OAMJMS, Shkup 2018, etj.

PREND BUZHALA



Prof. Prend Buzhala, u lind më 1 nëntor 1951, në Çabiq të Klinës.

Filloren e kreu në Ujëmirë, gjimnazin në Klinë, fakultetin filologjik (gjuhë e letërsi shqipe) në Prishtinë.

I ndoqi edhe studimet postdiplomike, po për shkak të burgosjes politike më 1982, iu ndërpre në nga regjimi i kohës, ashtu siç iu ndalua edhe botimi i shkrimeve dhe e drejta e punësimit. Shkrime letrare botoi prej vitit 1967.

Shkruan poezi, prozë, kritika e studime letrare, publicistikë.

Gjatë tri dekadave të fundit ishte i angazhuar në lëvizjet nacionale, politike e kulturore të kohës. Kështu që gjatë viteve '90 të shekullit që e lamë pas, u arrestua e u keqtrajtua dhjetëra e dhjetëra herë nga milicia e paramilitarët serbë.

Punoi profesor i gjuhës e letërsisë shqipe në shkollën e mesme të Klinës (1976-1982, 1992-1996), drejtues i arsimit komunal të Klinës (1995-1999), redaktor në gazetën “Fjala” (1990) e “Bashkimi” (1991) të Prishtinës, korrespondent i gazetave “Bujku” e “Rilindja” (1995-shkurt 2002), pastaj te “Epoka e re”, Radio Rilindja, “Express” i Prishtinës, redaktor i faqeve të kulturë në të përjavshmen “Focus” të Prishtinës (2006-2008). Punoi edhe zyrtar arsimit (2001-2003).

Prend Buzhala ishte drejtues i Bibliotekës Publike të qytetit “Kongresi i Manastirit” në Klinë.

Ka qenë ndër themeluesit e disa revistave lokale të Klinës, si “Jehona e Dukagjinit” (vitet '70 e kënde), “Ylli”, “Synimet”, “Tribuna”, “Profil” e tjera.

Librat e botuar:

1. “O Amë, o Amë”, 1995,
2. “Për kë bie kabanë e re”, 1998,
3. “Shtatë seanca pranë Apokalipsit”, 1998,
4. “Këpucët e rënda të lirisë”, 2010, botimi II, 2012,
5. “Çaste lirike” (1-90), vëllimi i parë, 2014.

Kritika, studime monografike, vështrime:

1. “Metafora e vendlindjes”, 1999. Botimi II 2012,
- 2 “Përfaqje estetike”, 2000,

3. “Ex libris” - I, 2003,
4. “Odeoni i fjalës”, 2003,
5. “Shkrimtari pranë buzëqeshjes”, (Studim monografik për letërsinë për fëmijë të Ali Huruglicës, 2005. Botimi II 2012).
6. “Muza e zemrës”, 2006. Botimi II 2012.
7. “Temë dhe tekst”, 2006.
8. “Muza e Kujtesës”, 2007. Botimi II 2012,
9. “Aty ku krizat i besohen engjëllit”, (Ndërkomunikime estetike: arti - literatura - lufta, 2008. Botimi II 2012),
10. “Res Publica e shkrimtarit”, (Ese, trajtesa), 2008. Botimi II botuar në vitin 2012,
11. “Kode poetike të mbijetesës shpirtërore” (Mbi romanet për të rritur të Anton Nikë Berishës, Argeta LMG, Tiranë, 2009),
12. “Gjenitivi i lirikës” (Poezia e Mirko Gashit), studim monografik, 2009,
13. “Të folurit e kryqëzimit shqip/ poezia e sotme shqipe”, 2011,
14. “Amëza e rrëfimit” – Shkrime kritiko-letrare / proza e sotme shqipe, “Rozafa”, Prishtinë 2012.
15. “Dëshmia për plagën e ftohtë”, (libri dokumentar, shkrime metakritike, ese, 2012
16. “Klasiku modern i tekstit – Letërsia e Ramiz Kelmendit”, (studim monografi), 2013. Botimi II, 2014,
17. “Në mbrojtje të imagjinatës”, (Nga letërsia shqipe për fëmijë),
18. “Gjakimi i bukurisë”, (Letërsia e Ramadan Mehmetit), 2014.

Roman, Prozë:

1. “Moisiu fluturonte me Qerren e Zjarrtë”, roman, 2003,
2. “Tregime të shenjta”, Shkup, 2014, Botimi II, Prishtinë 2014.

Publicistikë historike

1. Lartësimi i lirisë, (Monografi për mësuesin dëshmor Ismet Rrahmani, botuar në vitin 2002).

Përgatiti për shtyp:

1. Testament letrar, (Mendimi kritik për veprën e Ramadan Mehmetit, me komente, Prishtinë 2008.
2. Të kuvendosh nën shenjën e Euterpë, (Intervista të Akil Mark Kocit dhënë mediave 1976-2008, Prishtinë 2009).
3. Kurorë lirie (përzgjedhje nga poezia e poetëve të komunës së Deçanit, FOCUS, Prishtinë 2012) etj.

RABIT SADIKU



Dr. Rabit Sadiku, u lind më 15 korrik 1966, në Shurdhan, Gjilan, shkollën e mesme Drejtimi Natyror-Biologji, Gjilan (1991-1985). Studimet në “Fakultetin e Mjekësisë” në Prishtinë i regjistroi me 1997. Diplomoi në “The Open International University for Complimentary Medicine”, Kolombo me 1993 dhe mori titullin “Doktor i Mjekësisë (Mjekësisë Tradicionale)”.

Në vitin 1994 anëtarësohet në “Federatën Botërore për Akupunkturë dhe Moxibustion, WFAS me seli në Peking të Kinës. Në vitin 1995-1997 Punoi në Klinikën “Diagnoza” në Gjilan.

Në vitin 1998-1999 Mjek Sportiv në Klubin Hendbollistik “Drita”, Gjilan. Në vitin 2003, përfundoi specializimin holistik në programin për Diagnostikë Kompjuterike, “AMSAT” në Beograd.

Në vitin 2004 merr pjese në “Forumin e II Evropian për emergjenca” në qytetin Ingolstadt Bayern, Germany.

Ne vitin 2005 specializon në Trajtimin me “Rezonancë Mikrovalore (53-78Ghz)” Nizhni Novgorod, Rusi.

Ne vitin 2005 fiton Certifikatën për “Humanizëm” për trajtim falas të fëmijëve jetim në Kosovë nga Aid of Orphaned Children in Kosovo-Islamic Relief Kosova.

Në vitin 2006 publikoi fibrin e parë në gjuhën shqipe nga lëmi e Akupunkturës me titull: “Akupunktura”. Në vitin 2006 fiton Gradën Universitare PhD (Acupuncture) Kolombo Sri Lanka.

Në Vitin 2008 fiton “çmimin për Paqe, kooperim dhe Solidarity nga Kombet e Bashkuara” në një ceremoni madhështore, organizuar në Bandaranaike Memorial International në prani të 4 Ministrave të Sri Lankës. Ky çmim ndahet nga Kombet e Bashkuara nën Patronatin e komitetit “Dag Hammarskjöld”.

Në vitin 2008 pjesëmarrës aktiv në kongresin Botëror për Mjekësi Alternative në Kolombo. Në vitin 2008 “Honorary Member” of World Wellness Organization India.

Në Vitin 2009, Certifikata anëtarësisë së përhershme pranë “Akademisë Evropiane për Akupunkturë dhe Aurikulo medicine”. Munihi, Gjermani. Në vitin 2010 gradohet me titullin PhD (Alternative Medicine) Kolkata, Indi.

Në vitin 2010 në International Academy of Medical Acupuncture merr titullin “Anëtar i Akademisë” FIAMA, pas provimit ndërkombëtar në Phoenix Arizona.

Nga 2010-2013 merr gradën “Bachelor ne Fizioterapi” Tiranë, Shqipëri.

Në 2015 merr titullin MA në “Nutricion dhe Dietologji” Kolegji FAMA.

Në vitin 2016 emërohet “Ambasador” për të drejtat e njeriut pranë organizatës ndërkombëtare NOHE-UN për Kosovë dhe Shqipëri. Në vitin 2017 emërohet “shef” i zyrës së Komitetit Botëror të Paqes të 202 vendeve të Botës për Kosovë dhe Shqipëri.

Në vitin 2017 emërohet “Ambasador i URGC” për Kosovë dhe Shqipëri.

Në vitin 2017 merr “Grateful Appreciation”- nga Global Institute of Alternative Science, India.

Në vitin 2017 merr titullin “Chanceler honorario” IEP Institute for Education for Peace, Brazil.

Në vitin 2017 ECPD European Center for Peace and Development, “Laser Therapy Specialization”.

Në vitin 2017 “Certificate of Appreciation” International Meditation and Yoga Academy Pakistan.

Në vitin 2018 “Certificate of Merit” Peace Mission from MWPHR.

Në vitin 2018 “Certificate of Excellence”-United National University for Global Peace USA.

Në Vitin 2018 “Honorary Adviser” of the Global Academy India.

Në vitin 2018 “Honorary Medal”-Peace Illuminated Mind.

Në vitin 2018 emerohet “Deputy President” of the World Peace Committee 202 Countries, Jakarta Indonesia.

Në vitin 2019 “Certificate of Recognition” '5 International Meetings Roma, Italy.

Në vitin 2019 “Ambasador of SHAFI CENTER”, Egypt. Në vitin 2019 Certificate “Ambassador of WHC International” for Republic of Kosovo.

Në vitin 2019 “Certifikate Mirnjohje Ambasador Paqeje”-Agjensia STOPKRIMIT, Tiranë, Shqipëri.

Në vitin 2019 “Honorary Doctorate” at the Global Academy, India. Është anëtar i rregullt i Akademisë së Shkencave dhe Arteve Shqiptaro-Amerikane dhe mbanë titullin shkencor Akademik Prof. Dr. Rabit Sadiku, Ph.D.

RAGIP SYLAJ (1959-2018)



Ragip Sylaj, u lind më 1959, në Sllapuzhan të Suharekës, ku ka mbaruar mësimet e fillores dhe të gjimnazit. Ka të kryer studimet master për teknologji në Universitetin e Prishtinës. Ragip Sylaj, kishte punuar mësimdhënës në shkollën e mesme teknike Skënder Luarasi” në Suharekë, pastaj gazetar e redaktor në gazetën e studentëve “Bota e re”, e më pas në të përditshmet “Bota sot” e “Zëri”. Në vitin 2009 u punësua zyrtar i lartë për publikime në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ragip Sylaj ka shkruar poezi, prozë, dramë, ese dhe kritikë letrare.

Veprat:

“Hije e gjallë” (poezi), “Rilindja”, 1986,
“Anatomia e rrënjës” (poezi), “Rilindja”, 1989,
“Obsesioni” (tregime), “Rilindja”, 1992,
“Lisi i shenjtë” (poezi), “Fjala”, 1993,
“Përhitja” (tregime), “Plejada”, 1996,
“Mëngjes qumështor me akull” (poezi), Rozafa, 2000,
“Humbella e fërgëllisë” (tregime), “Rilindja”, 2001,
“S’kam kohë të jetojë me vdekjen” (tregime), “Rozafa”, 2004,
“Eliksir” (poezi), “Rozafa”, 2007,
“Estetika e misterit” (ese), Elena Gjika-Dora d’Istria, 2008,
“Hija e shtëpisë”, (tregime), “Rozafa”, 2008,
“Ma jep dorën” (poezi për fëmijë), “Rozafa”, 2010,
“Dy drama (drama), “Rozafa”, 2012,
“Hiri i fjalës” (poezi), Klubi Letrar “De Rada”, Ferizaj, 2014,
Ky libër me titull të ri “Kam drojë për ty” dhe i ripunuar, është ribotuar nga SHB Armagedoni, Prishtinë, 2017.
“Harmonia estetike” (ese), Parnas, 2015,
Për librin e poezive “Hije e gjallë” është laureuar me çmimin “Hivzi Sulejmani”, që jepej për librin më të mirë të autorëve të rinj nga gazeta “Zëri i rinisë” (1986). Në vitin 1999 u nderua me “Penën e artë” të revistës për kulturë, art dhe letërsi “Fjala”.
Gjithashtu libri i tij “Hiri i Fjalës” ka marrë çmim të parë në një konkurs vjetor të organizuar nga Klubi Letrar De Rada, Ferizaj, 2014.
U nda nga jeta më 31 korrik 2018.

RAJMONDA MALEÇKA



Rajmonda (Bujar) Maleçka, është e lindur në Tiranë, më, 11.03. 1970. Ka mbaruar Fakultetin në Tiranë, dega Histori-Filologji, në degën e Gazetarisë dhe në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, dega Gjuhë dhe Letërsi, më 1997. Ka kryer studimet pasuniversitare në Akademinë Diplomatike kursin Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci Shqiptare, 2006. Ajo ka punuar që nga viti 1993, në shumë organe të Shtypit shqiptar si gazetarë “Atdheu”, gazeta “Rilindja”, gazeta “Kosova”, “Koha e Re” etj.

Më 1998, së bashku me babain e saj Bujar Maleçka, merr pjesë në Luftën e shenjtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe në të njëjtën kohë ajo vazhdon të jetë dhe korrespondente e revistës “Mbrotjtje“ organ i Ministrisë së Mbrotjtjes Tiranë.

Ajo burgoset së bashku me babain nga sllavo-maqedonasit në vitin 2005, duke i dënuar nga pesë vjet.

Veprat:

“Ëndërra lozonjare”, poezi , botuar në vitin 1998.

“Tungjatjeta Kosovë“, poezi, botuar në vitin 1998.

“Prelud pavarësie“, poezi, botuar në vitin 2000.

“Nëpër ditët e dhimbjes dhe lirisë së Kosovës”, analizë, 2001.

“Shqiptarët e kanë brenda vetes së tyre lirinë”, libër analitik, 2003.

“Tokë arbnore” antologji poetike për të rënë e luftës, 2004.

“Ora e Kombit”, monografi , botuar në vitin 2005.

“Jasharët, kujtesa jonë e përjetshme”, 2006.

“Prelud kujtese për familjen Jashari”, botuar në vitin 2006.

“Haradinaj dhe Rendi i Ri Botërorë”, analizë, 2007.

“Hashim Thaçi dhe beteja e fundit”, analizë monografike, 2008.

“Hasi mes Luftës dhe Lirisë”, libër historik-monografik, 2010.

“Mbollën gjak, mbijnë këngë”, baladë për 383 dëshmorë të Kombit, botuar në vitin 2013.

“Safet Peci-Boletini dy herë i pavdekshëm“, botuar në vitin 2013,

“Një President në Bllaçë”, 2016,

Redaktore e disa librave historik të shkruar për luftën dhe UÇK-në.

Është anëtare e përhershme e Akademisë Amerikano-Shqiptare të Shkencave dhe Arteve me seli në Nju Jork, SHBA.

RAMADAN QEHAJA



Ramadan Qehaja, u lind me 16 shtator 1942 në Roganë të Dardanës, shkollën fillore e kreu në vendlindje, shkollën e mesme të Nënoficerëve në Sarajevë, ndërsa shkollën e Oficerëve në Beograd. Në vitin 1958 Qehaja, në moshën 16 vjeçe e mori rrugën për Akademi Ushtarake.

Ramadan Qehaja, i përballoi të gjitha pengesat dhe provokimet që ia bënin eprorët. Gjenerali shqiptar Ramadan Qehaja në librin e tij *“Të bësh një karrierë ushtarake”* thotë: *“Ishte paksa i çuditshëm gradimi im!”*.

Ramadan Qehaja ishte nxënës me nota të larta në shkollë, në çdo drejtim dallohej nga të tjerët. Ai ia doli të ngjitet në karrierë.

Gjenerali gjatë Luftës së Kosovës, por edhe në ditët e para të çlirimit të Kosovës, kontribuoi në formimin e Institucioneve të Republikës së Kosovës.

Ai u vlerësua me mirënjohje të shumta nga institucionet e Kosovës, po edhe nga Misionet ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë.

Gjeneral Qehaja është ekspert për çështje të sigurisë. Ai deri tash ka botuar 3 libra nga lëmi i sigurisë, dhe me dhjetëra artikuj shkencor në lëmin ushtarak.

Libri i tij *“Të bësh një karrierë ushtarake”*, Prishtinë, 2012, ngërthen në vete ngjarje dhe momente të shumta gjatë periudhave të ndryshme kohore, në të cilat ka jetuar e vepruar Gjenerali Ramadan Qehaja, i cili reflekton shumë ngjarjeve që nga fëmijëria e hershme e tij e deri në ditët e sotshme.

Në fakt, i gjithë zhvillimi i karrierës së tij kalon nëpër faza shumë sfiduese që ndërlidhen me faktorët social-ekonomik në familje e deri të sfidat politike në ish-Jugosllavi, Serbi dhe Kosovë.

Libri *“Kosova në gjeopolitikën e Ballkanit Perëndimor”* ngërthen në vete një numër vështrimesh analitike të cilat i ka publikuar në periudha të ndryshme të shtetndërtimit tonë, në çështjet gjeopolitike, ushtarake e të sigurisë.

Libri si i tillë përbën kontribut në korpusin e varfër të publikimeve e hulumtimeve të kësaj fushe në Kosovë.

Ka edhe shumë artikuj të botuar në shumë revista dhe gazeta ditore lidhur më çështjen e sigurisë në vend, Ballkan dhe Botë.

RAMADAN ZEJNULLAHU



Prof. Dr. Ramadan Zejnullahu, i lindur më 8 maj 1957, në Llapashticë të Poshtme, Podujevë. Është matematikan dhe ish-ректор i Universitetit të Prishtinës. Ai mori mandatin dyvjeçar në periudhën 2014-2016, të lënë përgjysmë nga dorëheqja e rektorit Ibrahim Gashi.

Zejnullahu është lauruar magjistër i matematikës dhe doktor i shkencave matematike më 1988 në Universitetin e Prishtinës. Nga viti 2000 punon si profesor i rregullt në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore në UP.

Është autori i librave shkollor të matematikës për klasët 1-9. Është po ashtu autor i shumë librave universitar mbi analizën matematike.

Në periudhën 1997-2001 ishte Dekan Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore të UP-së, në periudhën 2000-2001, anëtar i Këshillit Drejtues të UP-së dhe Këshillit për Edukim të Kosovës në periudhën 2006-2009, Kryetar i Këshillit Kombëtar të Cilësisë. Ramadan Zejnullahu u zgjodh rektor i Universitetit të Prishtinës më 2 shtator 2014.

Libra shkollor:

- “Përmbledhje detyrash nga matematika”, 8. “Libri shkollor”, 2003,
- “Përmbledhje detyrash përgatitore për provim kualifikues në shkollat e mesme”, ETMM i Kosovës, 2002,
- “Përmbledhje detyrash përgatitore për garat e matematikës për kl. 7, 8 dhe 9”. Matrix, Tetovë, 2004,
- “Përmbledhje detyrash nga matematika për klasën e IV të shkollës së mesme”, ETMM i Kosovës,
- “Matematika” 8. ETMM i Kosovës, 2003,
- “Përmbledhje detyrash nga matematika për klasën e I të shkollës së mesme”, 1999,
- “Matematika 1”, Dukagjini, botimi i nëntë, 2011, etj.

Publikimet shkencore:

- Një teoremë mbi pikat fikse në Hapësirat metrike probabile të tipit të Mengerit, BULETINI i punimeve shkencore i FSHMN, (1983-1986).
- Pikat proximale dhe plotësi ortogonal në hapësirat e Hilbertit, KËRKIME. ASHA e Kosovës, (1986).
- On a problem of minimisation in Banach spaces; RAD. MAT. ANU BiH, Sarajevë, Nr.4. 1988. Etj.

RAMIZ KELMENDI (1930-2017)



Ramiz Jakup Kelmendi, u lind më 20 dhjetor 1930 në Pejë, vdiq më 12 janar 2017, në Prishtinë. Ramiz Kelmendi shkollën fillore dhe gjysmëmaturën e mbaroi në vendlindje. Në kohën kur duhej të regjistrohej në shkollën e mesme, ai u burgos për motive politike.

Ishte në grupin e patriotëve pejanë, që në vitin 1945 besonin në idenë e Bashkimit të Kosovës me Shqipërinë. Dënohet në të njëjtin proces gjyqësor të montuar, bashkë me Marije Shllakun dhe krejt grupin e patriotëve, në Prizren (1946), por me qenë se ishte i mitur (16-vjeç), i mban vetëm 30 ditë burg dhe lirohet.

Pas shumë vështirësish, iu mundësua të regjistrohej vetëm në shkollën e mesme bujqësore në Prishtinë, në serbisht. Më 1950 regjistron Fakultetin Filozofik në Beograd, Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Diplomon në vitin 1955 me temën “Proza e Migjenit”. Me të mbaruar të studimeve rikthehet në gazetën “Rilindja”, ku për 12 vjet rresht punon redaktor. Në vitin 1967 emërohet kryeredaktor i Redaksisë së Botimeve në ndërmarrjen botuese “Rilindja”. Për katër vjet me radhë ishte Drejtor i Teatrit Popullor Krahinor. Në vitin 1969 zgjidhet profesor i letërsisë shqipe në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Në vitin 1975 kreu magjistraturën me temën “*Humori dhe satira në letërsinë shqipe*”.

Botoi 12 vëllime me tregime, 8 romane, dhjetëra udhëpërshkrime, 3 radiodrama, 3 drama televizive, 39 tekste satirike, një skenar filmi, 4 tekste shkollore. Ai shkroi edhe monografinë “*Shqipëria e Marije Shllakut*”, dhe me mija shkrime publicistike natyrash të ndryshme.

Kelmendi njihej edhe si një nga përkthyesit më produktiv të Shtëpisë Botuese “Rilindja”.

Ishte njëri nga themeluesit e Këshillit për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut, dhe njëri nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar i së cilës nuk u bë kurrë. Ishte shkurti i vitit 1990, kur ai dhe Anton Çetta ishin të parët që përkrahën iniciativën e rinisë progresive kosovare për t'i pajtuar gjaqet në Kosovë.

Kelmendi në javën tjetër fton edhe miqtë e tij Mark Krasniqin, Bajram Kelmendin dhe Azem Shkrelin për t'ju bashkuar dhe kështu fillon një lëvizje historike mbarëpopullore për pajtimin e gjaqeve, që përfundon me një manifestim madhështor në Verat e Llukës.

Ramiz Kelmendi ishte edhe njëri nga ideatorët dhe nënshkruesit e parë në dokumentin e njohur “Apeli i 215 intelektualëve” dhe anëtar i Kryesisë së Forumit Mbarëkombëtar të Intelektualëve.

Kur pensionohet, Kelmendi nuk ndalet. Më 1996, Ramiz Kelmendi fillon një ide të padëgjuar dhe të re në krejt hapësirat shqiptare që po dilnin nga komunizmi: idenë për hapjen e një institucioni privat arsimor. Ramiz Kelmendi vendos të hapi Fakultetin e parë privat të Gazetarisë në krejt hapësirat shqiptare, “Faik Konica”, që ka funksionuar deri më 2007.

Me hapjen e këtij fakulteti, Kelmendi u bë nismëtari i arsimimit privat shqiptar.

Ramiz Jakup Kelmendi vdiq si njëri nga emrat më të shquar të krejt një brezi intelektualësh, të kulturuar në ish-Jugosllavi, që mbrojtën identitetin shqiptar dhe ndryshuan imazhin dhe recepcionin për shqiptarët në sytë e kombeve dhe kulturave që formonin Federatën Jugosllave.

Gjatë viteve '70-'80 ka përkthyer nga serbishtja kryeveprat e autorëve si: Dostojevski, Gogoli, Orwell, Markes, Kafka, Kundera, Grass, Castaneda, Sabato, Krlezha, Danillo Kish, etj.

Ramiz Kelmendi, përveç si shkrimtar, njihej edhe si publicist e gazetar. Ai ka shkruar disa romane, tekste shkollore, tregime, drama, fejtone, skenarë, skeçe, reportazhe, shkrime humoristike dhe është shquar për origjinalitet krijues në të gjitha lëmenjtë dhe zhanret letrare të cilat i ka trajtuar me profesionalizëm, kompetencë dhe korrektësi.

Veprimtaria letrare:

“Bazeni”,
”Vdekja e poetit”,
“Rrëfimi i njeriut me samar”,
“Rrëfimi i studenteshës”,
“Xhita në qiell”,
“Vija e vrragë”, dy rrëfime;
“Ahmet Koshutani, Heshtja e armëve”,
“Shqipëria e Marie Shllakut”,
“Shtatë persona ndjekin autorin”,
“Akrabakr”,
“Humori dhe satira në letërsinë shqipe”,
“Kapuç me mëngë”,
“Letra prej Ulqini”,
”Kokrra kripe”, Etj.

RASIM BEBO (1926-2017)



Prof. Dr. Rasim Bebo u lind më 14 prill të vitit 1926, në Shalë të Çamërisë, në territorin shqiptar. Ai ka përfunduar studimet në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë dhe ka qenë viktimë e luftës së klasave gjatë regjimit komunist. Prej vitesh deri sa vdiq në moshën 91 vjeçare (12 dhjetor 2017) ai vijoi aktivitetin e tij si studiues në mërgim, në Çikago të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Me një jetë tepër aktive, luftëtar trim në Bata-lionin “Çamëria”, tankist i shkathët, oficer i paepur i ushtrisë popullore, mësues i devotshëm në disa shkolla të vendit, dhe aktivist shoqëror i palodhur në SHBA, ku emigroi dy dekadat e fundit, ai iu kushtua tërësisht atdheut dhe Çamërisë martire. Me përgatitjen e tij intelektuale, me studime të larta për histori-geografi dhe gjuhë gjermane, jeta dhe vepra e tij madhështore, bëri që ai të pushtojë shpirtin patriotik të gjithë atdhedashësve në të dy kontinentet.

Botime historike:

1. “Dodona”
2. “Zeusi”
3. “Artikuj dhe ngjarje -pjesa 1”
4. “Artikuj dhe ngjarje -pjesa 2”
5. “Shqipëria në gjurmët e kohës”
6. “Histori me shkronja gjaku”
7. “Amerika me rrënjë shqiptare”
8. “Shala e kalit të jetës” (roman autentik), etj.

Ka botuar edhe disa qindra artikuj historiko-problematik në organet e shtypit dhe në vebsite të internetit.

Ishte bashkëpunëtor i shumë agjencioneve informative: "Dielli", "Floripress", VOAL (Voice of Albanians), "Zemra shqiptare", "Ilyria", «Epoka e re», "Bota sot". etj.

Rasim Bebo, i cili nëpër vite në Çikago u bë pjesë e lëvizjes së madhe kombëtare për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës dhe të demokratizimit të Shqipërisë.

Me profesor Rasim Bebo në takimet kombëtare temë bosht e bisedës ishte Çamëria, që ishte plaga e përgjakur në orët vrastare fashiste greke, që në Filat me rrethinë e vranë pranverën shqiptare!

RASIM SELMANAJ



Rasim Selmanaj, u lind më 8 mars 1963, në Glllogjan të Deçanit. Me profesion është Bachelor i Biologjisë-Kimisë.

Është deputet dhe nënshkruar i Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, kryetar i Komunës së Deçanit (2009-2017), njëri ndër veprimtarët më të dalluar të viteve '80-të dhe promotor i organizimeve me karakter kombëtar, kulturor e sportiv gjatë viteve '90-të të shekullit të kaluar.


Veprimtaria e tij atdhetare përthekon katër dekada përkushtim dhe përpjekje për liri; mbi katër herë i burgosur e i dënuar, dhjetëra herë i torturuar nga forcat policore serbe, herë i vetëm, e herë bashkë me vëllezër dhe miq të idealit. Për shkak të veprimtarisë politike e atdhetare është arrestuar dhe dënuar në vitet 1981, 1983 dhe 1992. Tetë vite me radhë (1990-1998) ka punuar në arsim, mësimdhënës për lëndët Biologji dhe Kimi.

Në vitet '80-ta ishte njëri ndër themeluesit e grupit ilegal "Shqiponja", grup i cili kreu një sërë aktivitetesh të rëndësishme politike dhe propaganduese kundër sistemit represiv serb. Rasim Selmanaj ka qenë themelues dhe kryeredaktor i revistës "Zgjimi". Po ashtu një kohë ka qenë edhe kryetar i rinisë në Deçan (1990-1997) dhe themelues i SHKA "Jusuf Gërvalla" në Deçan. Ndërkaq, më 24 mars 1998, arrestohet nga forcat serbe. Gjykata e Qarkut në Leskoc e dënoi me 6 vjet burg. Selmanaj është i mbijetuar dhe dëshmitar i gjallë i Masakrës së Dubravës së vitit 1999. Është liruar në mars të vitit 2001. Deri në janar të vitit 2003, ka qenë botues dhe kryeredaktor i gazetës së përditshme "24 orë". Gjatë viteve 2001-2009 ishte botues dhe kryeredaktor i të përjavshmes "Focus", njëkohësisht udhëheqës i fushatës "Me Ramushin".

Botimet:

1. "Shtegtar i lirisë", poezi 2001
2. "Melodi shiu në sytë e nënës" poezi 2003
3. "Peizazh i ëndrrës", prozë 2004, 4. "Kur kalërojmë kujtesën", poezi 2005
5. "Kitarë e Krisur", poezi 2006, 6. "Shpirti i lagur më lot", poezi 2006
7. "Haradinaj dhe Haga", publicistikë 2006
8. "Heroi me kitarë", përmbledhje shkencor për Jusuf Gërvallën, 2007
9. "Me Ramushin", publicistikë 200, 10. "Hijet e thyera", poezi 2008
11. "Dekada e Deçanit", kronika dhe ngjarje 2018.

RAUF DHOMI



Rauf Dhomi, u lind në qytetin e Gjakovës, më 1945 në një familje me tradita në këngën qytetare. Shkollën fillore e kreu në Gjakovë, ndërsa studimet për muzikë i filloi në Shkollën e Muzikës në Prizren në degën e teorisë (1961-1965).

Studimet e larta për muzikë i kreu në Akademinë e Muzikës në Sarajevë, në drejtimin e kompozimit dhe dirigjimit në klasën e prof. M. Spiller në vitet 1965-1969. Pas studimeve punoi asistent (lënda e harmonisë) pranë të njëjtës Akademi (1969-1970) në të cilën mbrojti dhe diplomën në vitin 1970.

Më pas, në vitet 1972-1973 kreu studimet pasuniversitare për kompozim pranë Akademisë së Sarajevës, në klasën e prof. M. Spiller.

Pas diplomimit u kthye në Kosovë, ku filloi punën pranë gjimnazit H. Dushi (1969-1970). Krahas punës së pedagogut, u aktivizua dhe në jetën kulturore të Gjakovës duke themeluar Korin e Burrave të qytetit, në vitin 1965 dhe duke bërë me të një jetë koncertore intensive. Në vitin 1971 u punësua pranë Shkollës së Lartë Pedagogjike në degën e Muzikës dhe që prej vitit 1975, kur u hap Fakulteti i Arteve i Prishtinës, e deri në pensionim punoi si profesor pranë këtij institucioni. R. Dhomi është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës që prej vitit 1993. Më 1 mars të vitit 2003, themeloi trupën e Operës së Kosovës, dhe me 1.01. 2004 themeloi Konservatorin Artistik pranë këtij Institucioni.

Krijimtaria e R. Dhomit është e pasur dhe e larmishme. Ka kompozuar në të gjitha gjinitë e muzikës, me një prirje të veçantë për muzikën vokale (koralet e shumta dhe veprat skenike ku përveç operave duhet përmendur muzika për teatër, në një numër impresionues prej rreth 300 shfaqjeve për të cilat ka bërë muzikën në teatrot e Prishtinës, Gjakovës, Pejës, Shkupit, Prizrenit etj.). Muzika e tij është luajtur në të gjitha aktivitetet kryesore të Kosovës dhe të ish Jugosllavisë, si dhe në Shqipëri dhe është botuar në Kosovë dhe në Shqipëri.

Për aktivitetin dhe veprën e tij, është nderuar me çmime, dekorata të shumta, ndër të cilat duhet përmendur: Qytetar nderi i qytetit të Gjakovës (1979), Shpërblimi i Dhjetorit (1980),

Dekorata me merita për popull me rreze të arta (1981) si dhe Shpërblimin për muzikën më të mirë në festivalin e teatrove në Beograd, në vitin 1990 (e refuzuar).

Veprimtaria skenike:

“Goca e Kaçanikut”, operë në dy akte dhe tri tablo, (opera e parë kosovare), libreti A. Dhomi dhe J. Buxhovi sipas novelës së M. S. Gurra, 1971/72, (bot. ShQKP, Tiranë, 1980 dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Prishtinës, 1997).

“Dasma arbëreshe”, operë në tri akte, libreti A. Dhomi, sipas G. del Gaudio, 1982-1983 (bot. Akademia e Shkencave dhe e Arteve, Prishtinë, viti 2004), “E bukura More”, balet në tre akte, muzika dhe libreti R. Dhomi, 1984, Muzat e Kalasë, operë, 2004 (në përfundim).

Vokalo-instrumentale:

Rondo, për violonçel dhe orkestër simfonike, 1965 (SHKQP, Tiranë, 1986), kor dhe orkestër simfonike, 1966-1983,

Rekuiem, e papërfunduar, 1966-1968. Këngë solemne, për solist e orkestër simfonike, teksti A. Dhomi, 1971,

Vatra e urtësisë, kantatë për solist, kor, recitues dhe orkestër simfonike, teksti E. Gjerqeku, 1985,

“Uratë vashave”, kantatë për solist, kor dhe orkestër simfonike, teksti A. Dhomi, 1990, (me rastin e 100-vjetorit të shkollës së parë shqipe në Prizren).

Orkestrale:

“Uvertura solemne, për orkestër simfonike”, 1969,

“Scherzo, për orkestër simfonike”, 1966,

“Epopeja, për orkestër simfonike”, 1978,

“Uvertura, nga opera Goca e Kaçanikut”, 1972,

“Suitë simfonike”, 1993.

Këngë solo për zë dhe piano:

Pranvera, për zë (S apo T) dhe piano, teksti Ajmone Dhomi, 1985,

Këngë pleqërishte, për zë (S apo T) dhe piano, teksti L. Pogradeci, 1985,

Pa lamtumirë, për zë (S apo T) dhe piano, teksti Ajmone Dhomi, 1971,

Dashuri e parë, për zë dhe piano, teksti A. Z. Çajupi, 1969,

Vjeshta, për zë (S apo T) dhe piano, teksti Ndre Mjeda, 1970,

Vajta-kalova, për zë (S apo T) dhe piano, teksti Arbëreshe-popullore, në vitin 1986,


Bandillët në gjumë, për zë (S apo T) dhe piano, teksti R. Dhomi, 1980,

La mia vita, për zë (S apo T) dhe piano, teksti Domenico Randelli, 1995,

Kopshti i dashurisë, për zë (S apo T) dhe piano, teksti A. Z. Çajupi, 1984.

Si dhe muzikë për filma artistik, seriale të ndryshme e tjera.

REMZI BAKALLI (1944-2007)



Prof. Remzi Bakalli, u lind në vitin 1944, në Gjakovë. Shkollën fillore e mbaroi në Prizren, kurse shkollën e mesme bujqësore në Kralevë.

Fakultetin e Bujqësisë e mbaroi në vitin 1967, në Beograd. Në vitin 1971, kreu magjistraturën në Fakultetin e Bujqësisë të Zagrebit. Në vitin 1975, në Fakultetin e Veterinarisë të Zagrebit, mbrojti disertacionin e doktoratës dhe mori titullin doktor i shkencave veterinare në lëmin e të ushqyerit të kafshëve. Në vitet 1967-1970, ishte teknolog në Kombinatin Bujqësor “Progres” në Prizren, 1970-1976 bashkëpunëtor shkencor në lëmin e biokimisë në të ushqyerit e kafshëve, Instituti i Blegtorisë dhe Veterinarisë Prishtinë, 1974-1975 University of Florida, Gainesville, Floride, SHBA, 1976-1983, docent i Fakultetit të Bujqësisë në Prishtinë, 1977-1979, dekan i Fakultetit të Bujqësisë në Prishtinë, 1983-1988, profesor inordinar i Fakultetit të Bujqësisë në Prishtinë, 1987 University of Georgia, Athens, GA, SHBA, 1988 profesor ordinar i Fakultetit të Bujqësisë në Prishtinë; 1992 University of Georgia, College of Veterinary Medicine. Vdiq në vitin 2007.

Libra të botuara:

“Ndikimi i nivelit të manganit në ushqim në aktivitetin e fosfatazës alkalike dhe retencionin e kalciumit dhe të fosforit te pulat vojce”, Botoi Bashkësia e Shkencës e Kosovës, 1979,

”Shpendaria”. Botues: Bujku, Prishtinë, 1985,

“Të ushqyerit e jopërtypësve”, Prishtinë, 1996,

“Të ushqyerit e ripërtypësve”, Prishtinë, 1997,

Publikime në revistat referale:


Bakalli, R. I., G. M. Pesti, and W. L. Ragland, 1995. The magnitude of lead toxicity in broiler chickens (*Gallus domesticus*). *Vet. Human Toxicol*,

Bakalli, R. I., G. M. Pesti, W. L. Ragland, and V. Konjufca. 1995. Dietary copper in excess of nutritional requirement reduces plasma and breast muscle cholesterol in chickens. *Poultry Sci*,

Bakalli, R. I., G. M. Pesti, W. L. Ragland, V. Konjufca, and R. Novak. 1995,-Aminolevulinic acid dehydratase - A sensitive indicator of lead exposure in chickens (*Gallus domesticus*). *Bull. Environ. Contam. Toxicol*.

Remzi Bakalli ka një numër të konsiderueshëm Abstraktesh, si dhe ishte pjesëmarrës në hulumtime apo drejtues i projekteve, etj.

RESHAT ARBANA



Reshat Arbana, u lind më 15 shtator 1940 në Tiranë. Ai është një aktor teatri dhe filmi. Një nga aktoret më popullore të kinemasë shqiptare, me mbi 35 role, duke filluar që nga viti 1963.

Pasi i kreu studimet në shkollën e lartë për aktorë "Aleksander Moisiu", pranë Teatrit Kombëtar në Tiranë, më 1968, filloi punë në Radio Tirana. Nga viti 1977 e deri sa doli në pension ishte aktor i Teatrit Kombëtar të Tiranës.

Ndër rolet më të spikatura në film: Samiu tek Fije që priten 1976, Prefekti tek Gjeneral Gramafoni 1978, Bimbashi tek Liri a cdekje 1979, Isa Boletini, tek Nëntori i dytë 1982, Ahmeti, tek Dora e nfrohtë 1983, Adnani tek Hije që mbeten pas 1985, Aliu, tek Binarët 1987, Emili tek Rikonstrujcioni 1988, Kuke Memini tek Balada e Kurbinit 1990. Për rolet e Dajlan Beut tek Kush vdes në këmbë 1984 dhe Kryetarit të Këshillit tek kur hapen dyert e jetës 1986, ka fituar Medalionin e Festivalit të Filmit më 1985 e 1987.

Në maj 2004 u rikthye në skenën e Teatrit Kombëtar me rolin e protagonistit në dramën; Streha e të harruarve. Më 7 tetor 2011 Presidenti i Republikës, Bamir Topi i akordoi zotit Reshat Arbana Urdhrin "Nderi i Kombit", me motivacionin: "Aktorit të shquar të teatrit dhe kinematografisë, i cili me interpretimin mjeshtëror dhe origjinalitetin e tij u bë një artist popullor e shumë i dashur për publikun, rolet e të cilit kanë pasuruar me vlera të reja kulturën kombëtare. Më 26 nëntor 2011 në koncertin "Nëntori II", organizuar në kuadrin e javës së kulturës shqiptare me rastin e 99 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Shoqata shqiptare në Parma të Italisë "Scanderbeg" i dorëzoi çmimin "*Skënderbeu-Diaspora shqiptare në Itali*", zotit Reshat Arbana të akorduar në emër të 24 shoqatave dhe subjekteve në Itali me motivacionin: *Për personalitetin e jashtëzakonshëm, cilësinë artistike dhe frymëzimin me të cilin ka interpretuar role, histori, ngjarje, duke i pasuruar me humanizmin dhe kulturën që e karakterizon përherë. Çmimi ju dorëzua nga përgjegjësi i organizimit të shoqatës "Scanderbeg Parma" zoti Durim Lika.*

Filmografia

- Në kërkim të kujt (2009)- serial nga Top Channel, Asim Qani,
- Familja moderne (2008)- serial nga Kosova, Gjergji,
- Kaskadori shqiptar (1998) (TV),

- Vite të rëndësishme (1997),
- Jeta në duart e tjetrit (1991)-Profesori,
- Balada e Kurbinit (1990)-Kuke Memini, kryezoti,
- Vetmi (1990)-Andri,
- Flutura në kabinën time (1988)- Xhaxhai,
- Rikonstrukcioni (1988) (TV),
- Binarët (1987),
- Kur hapen dyat e ketës (1986)- Kryetari i këshillit të fshatit,
- Hije që mbeten pas (1985)- Adnan Kodra,
- Të paftuarit (1985),
- Kush vdes në këmbë (1984),
- Shirat e vjeshtës (1984),
- Zambakët e bardhë (1984)- Pedagog Petriti,
- Dora e ngrohtë (1983)- Ahmeti,
- Fundi i një gjakmarrjeje (1983),
- Gracka (1983),
- Kohë e largët (1983),
- Nëntori i dytë (1982)- Isa Boletini,
- Shokët (1982),
- Gjurmë në kaltërsi (1981)- Komandanti,
- Intendenti (1980)- Kryetari i këshillit të fshatit,
- Liri a vdekje (1979),
- Nga mesi i errësirës (1978),
- Gjeneral gramafoni (1978)- Kryetari i baskisë,
- Kur hidheshin themelet (1978) (TV)-Beqir Aga,
- Fije që priten (1976)- Sami Ameni,
- Pylli i lirisë (1976)- Xha Kovi,
- Tinguj lufte (1976)- Mësuesi,
- Kapedani (1972)- Një nga të rinjtë e fshatit,
- Plagë të vjetra (1968) pacienti,
- Duel i heshtur (1967),
- Komisari i dritës (1966)- Nikoll Mustaqeziu,

Si dhe realizoi suksesshëm rolin e Isa Boletinit të filmi i metrazhit të gjatë “Azem Galica” që u xhirua në Republikën e Kosovës.

Artisti i popullit Reshat Arbana, ka të realizuar dhe të regjistruar edhe shumë monologje, të cilat me përkushtim, shpirt artisti e mjeshtri të jashtëzakonshme i ka paraqitur para publikut shqiptarë.

RESMI OSMANI



Prof. Dr. Resmi Osmani, u lind në Mazrek të Çamërisë, më 5 maj 1940. Kreu studimet e larta për Agronomi në Institutin e Lartë Bujqësor në Tiranë, studime të cilat i përfundoi në vitin 1963. Ka kryer detyra të rëndësishme drejtuese në prodhimin bujqësor dhe administratën e lartë shtetërore. Krahas detyrave të tjera ka qenë i angazhuar në veprimtari dhe kërkime shkencore. Ai ka botuar 19 tituj librash të profilit tekniko shkencor, ka shkruar dhe botuar në revista tekniko-shkencore dhe shtypin periodik, brenda e jashtë vendit, mbi 150 tituj artikujsh që përfshijnë mbi tre mijë faqe.

Për kontributin dhe kualifikimin shkencor mban gradën Prof. Dr. i shkencave, më 1985. Ishte Docent në vitin 1992, profesor i asociuar 1995, profesor, 1999.

Vetë dhe me bashkautorë, ka këto botime shkencore e profesionale në fushën e bujqësisë dhe kryesisht ato të specialitetit të pemëtarisë:

“Krasitja e pemëve”, 1973,

“Krasitja e ullirit”, 1983,

“Pjeshka”, 1986,

“Njohuri për Ullirin”, 1988,

“Pemëtaria”, tekst për fakultetin e agronomisë, 1989,

“Pemët drufrutore”, tekst për shkollat e mesme bujqësore, 1991,

“Manuali i ullishtarit”, 2002,

“Luleshtrydhja”, 1994,

“Shërbimet gjithvjetore të ullirit”, 1988,

“Kultivimi modern i mollës”, 2004,

“Pemët subtropikale gjetherënëse”, 2006,

“Agrumet në ultësirën bregdetare perëndimore”, 2005,

“Pemëtaria dhe vreshtaria në Shqipëri dhe në Kosovë”.

Osmani është Anëtar i redaksisë së bujqësisë për “Fjalorin Enciklopedik Shqiptar”, autor i 34 zërave. Ka qenë i angazhuar në referime shkencore në simpoziume dhe konferenca shkencore, në vlerësime dhe opinionenca disertacionesh, biseda në radio-televizione, etj. Ka shkruar mbi 300 artikuj problemorë e shkencorë në organet e specializuara brenda dhe jashtë vendit, pjesëmarrës në disa konferenca ndërkombëtare për ullirin dhe pemëtarinë në Turqi, Itali, Francë, Bullgari, Greqi, Hungari, Bruksel...

RESUL SHABANI



Resul Shabani, u lind në Strugë në vitin 1944. Filloren dhe të mesmen i kreu në vendlindje. Gjuhë dhe letërsi shqiptare studioi në Universitetin e Shkupit dhe të Prishtinës.

Fillimisht punoi arsimtar i gjuhës dhe letërsisë shqiptare.

Prej vitit 1971, u punësua në redaksinë e gazetës "Flaka e vëllazërimit" në Shkup, ku punoi reporter i lirë dhe redaktor i rubrikës së kulturës.

Ka qenë edhe redaktor përgjegjës i revistave "Jehona" dhe "Gëzimi" dhe redaktor përgjegjës i Redaksisë së botimit të librit artistik. Jeton dhe vepron në Shkup.

Veprat e botuara:

- 1974 "Liqeni", tregime (Flaka e vëllazërimit),
- 1975 "Peshk", poezi (Flaka e vëllazërimit),
- 1978 "Hamleti me plis të zi", poezi (Flaka e vëllazërimit),
- 1978 "Shën", tregime (Rilindja),
- 1982 "Anija e vjetër", dy drama (Rilindja),
- 1983 "Ora e liqenit", poezi (Rilindja),
- 1983 "Dashuria e kapitenit", roman (Flaka e vëllazërimit),
- 1986 "Ujëpërshkruesi i fushës", poezi (Flaka e vëllazërimit),
- 1987 "Fani vjen vetëm", tri drama (Flaka e vëllazërimit),
- 1989 "Liqeni", ribotim, lekturë shkolle (Detska Radost),
- 1989 "Oh, Amerika", poezi (Flaka e vëllazërimit),
- 1990 "Dashuria e kapitenit", ribotim-lekturë shkolle,
- 1992 "Oh, Amerika", maqedonisht (Makedonska kniga),
- 1994 "Qerpik i lagur", tregime (Flaka e vëllazërimit),
- 1996 "Mëkat i trilluar", poezi e zgjedhur (Onufri),
- 1997 "Uji i zemrës", poezi (shqip-rumanisht) Rumani,
- 1997 "Ora e liqenit", maqedonisht (Matica),
- 1998 "Erë ftoji", poezi e zgjedhur, (në disa gjuhë) (Goce Delçev),
- 1999 "Shtatë drama" (Shoqata e Shkrimtarëve Shqiptarë),
- 2001 "Nuse vale", tregime (Klubi letrar '94),
- 2003 "Përsëri për shelgun vajtues", poezi të zgjedhura,
- 2004 "Dashuria e Kapitenit", roman (Onufri),
- 2004 "Përsëri për shelgun vajtues", (Onufri),
- 2005 "POEZI, shqip-maqedonisht" (ShSh të Maqedonisë), etj.

REXHEP BOJA



Prof. Dr. Rexhep Boja është i lindur më 20 qershor 1946, në fshatin Kërrnicë të Klinës. Shkollën fillore e ka përfunduar në vendlindje, ndërsa të mesmen, studimet universitare e pasuniversitare dhe doktoratën e ka përfunduar në Universitetin Islamik të Medinës, në Mbretërinë e Arabisë Saudite. Dhe pas përfundimit të doktoratës, është kthyer në Kosovë, ku filloi punën si imam në qytetin e Pejës. Më pas, filloi punën si profesor në “Alaudin”, Medresenë e vetme të mesme në Republikën e Kosovës.

Në vitin 1990 është zgjedhur Kryetar i Bashkësisë Islame dhe më pas është rizgjedhur për tri mandate.

Këtë institucion e ka udhëhequr në kohët më të vështira nëpër të cilat ka kaluar Kosova që nga viti 1990 e deri më 2003. Në vitin 1992 është zgjedhur dekan i Fakultetit të Studimeve Islame. Gjatë kohës sa ishte në krye të Bashkësisë Islame të Kosovës ka marrë pjesë në mbi 150 konferenca, simpoziume e takime të niveleve ndërkombëtare.

Rexhep Boja përfaqëson shumë institucione: Këshilltar i Ministrit të Shëndetësisë të Kosovës; Koordinator zyrtar për aktivitetet bamirëse dhe njerëzore në shtetet arabe; Anëtar në Këshillin e Lartë Botëror për xhamitë në Ligën e Botës Islame; Dekan i Fakultetit të Studimeve Islame në Republikën e Kosovës; Ish-anëtar në Këshillin Transitor kosovar të formuar nga OKB-ja; Ish-anëtar i Kryesisë Fetare në Sarajevë; I ngarkuar me punë i Republikës së Kosovës në Riad; etj.

Më 8 maj 2012, presidentja e Republikës së Kosovës, e ka dekretuar emërimin e Rexhep Bojes ambasador rezident të Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Arabisë Saudite.

Ka shumë studime në fusha të ndryshme, me të cilat është paraqitur në konferenca e simpoziume, dhe gjithashtu artikuj të shumtë që janë botuar në gazeta e revista vendore e ndërkombëtare në disa gjuhë.

Librat e botuara:

1. “Shqiptarët (Arnautët) në Islam” në gjuhën arabe;
2. “Myslimanët në ish-Jugosllavi” në gjuhën arabe;
3. “Për të nesërmen më të mirë” në gjuhën shqipe;
4. “Shteti i Emirateve, donacione dhe zhvillim në Republikën e Kosovës”, në gjuhën arabe. Etj.

REXHEP DOÇI



Prof. Dr. Rexhep Doçi është i lindur më 1943 në katundin Kerrnicë të Komunës së Klinës në një familje me kushte të vështira ekonomike, por me veprimtari të pandalur dhe të përkushtuar atdhetare-shqiptare. Shkollën fillore (tetëvjeçare) e kreu në Klinë, ndërsa Shkollën Normale e kreu në Pejë. Fakultetin Filologjik-Dega Gjuhë e Letërsi Shqipe e kreu në vitin 1968, në Prishtinë. Pas diplomimit në fakultet, për pak vite ka punuar profesor i gjuhës shqipe në shkolla të mesme të Prishtinës dhe përkthyes i gjuhës shqipe në Gjyqi Suprem i Kosovës. Ka magjistruar në Prishtinë në temën: “Antroponimia e Llapushës(Prekorupës)”, që është botuar si vepër prej 207 faqesh nga Instituti Albanologjik, në Prishtinë në vitin 1983. Rexhep Doçi në vitin 1989 ka kryer edhe doktoratën në Prishtinë dhe mori titullin shkencor - Prof. Dr. Rexhep Doçi. Temë e mbrojtur e doktoratës është “Onomastika e Drenicës”, vepër voluminoze prej 475 faqesh. Kjo vepër është botuar si libër me rëndësi të dalluar shkencore në vitin 2005 nga Instituti Albanologjik-Prishtinë. Jeton në Prishtinë me bashkëshorten dhe tre djemtë, të gjithë të ngritur në aspektin profesional e shkencor.

Prof. Dr. Rexhep Doçi pas doktorimit 45 vjet ka punuar në Institutin Albanologjik të Prishtinës dhe në këtë vend të shenjtë të kulturës shqiptare ka punuar me përkushtim të madh atdhetar dhe shkencor për ta dëshmuar realitetin e pamohueshëm historik dhe lashtor të shqiptarëve në trojet e tyre, në Gadishullin Ilirik (Ballkanik), si edhe më gjerë. Nga ky vend i punës, si prioritet parësor e kishte terrenin, mbledhjen e materialit onomastiko-gjuhësor në terren nga emërtimet e ruajtura në vendbanimet e shqiptarëve në Gadishullin Ilirik, të trashëguara prej mija vjetësh nga të parët e tyre Pellasdo-Ilirë. Më vite të tëra ka mbledhur material në terren (Ekspedita kolektive të Institutit Albanologjik, më se 30 sish, si edhe me shumë ekspedita të tjera individuale). Materialin e ka mbledhur nga goja e popullit shqiptar nëpër viset e ndryshme të Kosovës, nëpër fshatrat e banuara me shqiptarë në Maqedoni, në Mal të Zi, Serbi e Greqi, ku kanë jetuar pararendësit e shqiptarëve-ilirët. Një pjesë e shqiptarëve autokton të vendeve të përmendura më lartë, gjatë mesjetës, përmes krishterimit, u konvertuan në popuj të mëvonshëm sllavë e grekë. Ka mbledhur material onomastik-gjuhësor edhe me një ekspeditë të përbashkët të organizuar nga

Instituti Albanologjik në Prishtinë dhe nga Instituti i Gjuhësisë në Tiranë gjatë 25 ditësh në rrethin e Beratit.

Këtë material të mbledhur në terren përmes ekspeditave kolektive dhe individuale e ka përforcuar e konkretizuar në aspektin e thuktë dhe të bindshëm shkencor edhe me hulumtime të shumta nëpër arkiva e biblioteka shkencore në Kosovë, Maqedoni (Shkup), Shqipëri, Greqi (Athinë, Janinë etj), e vende të tjera. Ka hulumtuar edhe nëpër shumë arkiva dhe biblioteka edhe nëpër qendrat e mëdha të Republikave në ish Jugosllavi, si në Zagreb, Lublanë, Titograd, Sarajevë, Beograd, etj.

Me këtë material të mbledhur shkencor deri më tash ka botuar 10 vepra voluminoze shkencore (deri edhe në 500 faqe) nga fusha onomastike-gjuhësore. Në veprat e tij ka përdorur të dhënat historike edhe nga burime historike latine, sllave e turke me vlerë të jashtëzakonshme, të cilat dokumente i ka hulumtuar e fotokopjuar gjatë punës nëpër bibliotekat e Prishtinës, Tiranës, Shkupit, Zagrebit, Beogradit e Sarajevës.

Këto burime historike janë regjistra latin të viteve: 1411-1444, 1416-17; krisobula e karta mesjetare sllave (serbe) të viteve: 1321, 1313, 1318, 1330, 1348(?); defterë osmano-turq të viteve: 1455, 1485, etj.

Prof. Dr. Rexhep Doçi ka marrë pjesë me kumtesa shkencore e diskutime nëpër shumë tubime shkencore shqiptare e ndërkombëtare (Simpoziume e Kongrese) dhe i ka të botuara edhe më se 150 punime shumëfaqëshe shkencore në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja.

Vlen për t'u përmendur tubimet shkencore onomastike në ish-Jugosllavi, që mbaheshin çdo dy vjet, si në Shkup, Dubrovnik, Sarajevë, Portorozh të Sllovenisë, Donji Millanovc të Serbisë dhe në Prishtinë:

Punimet e botuara:

-Antroponimia paraislame e shqiptarëve të Llapushës (Prekorupës) në dritën e burimeve të shkruara dhe të mikrotoponimisë, -"Gjurmime albanologjike"-VIII, Prishtinë, 1979,

-Në gjurmë të antroponimit Plak, lexuar në Lublanë në gjuhën serbokroate, më 1981 dhe në "Gjurmime albanologjike" - Filologji, nr. XII, Prishtinë, 1982, f. 59-68,

-Mbi disa antroponime me prejardhje shqipe, në "Studime filologjike", nr. 3, Tiranë, 1985,

-Onomastika ilire-shqiptare në Maqedoninë e sotme, në përmbledhjen e punimeve të tubimit shkencor në Shkup "Shqiptarët e Maqedonisë", Shkup, 1994,

- Ilirska-albanska baza u funkciji antroponima, patronima i toponima, në revistën jugosllave “Onomastika jugoslavica”, Zagreb, 1982, f. 29-34,
- Illyrian-albanian toponyms, në përmbledhjen e punimeve të 253 autorëve ndërkombëtarë: “Namenforschung - Name Studies - Les noms propres,” Berlin-New York, 1995,
- Onomastika shqiptare-kosovare para Betejës së Kosovës, në “Gjurmime albanologjike” - filologji, nr. 19, Prishtinë, 1990, f. 169-182,
- Onomastika ilire-shqiptare e Shkodrës me rrethina, në përmbledhjen e punimeve shkencore “Shkodra në shekuj”, Shkodër, 2004, f. 77-87,
- Rreth prejardhjes së ojkonimit Gjakova dhe të disa ojkonimeve të Komunës së Gjakovës, në përmbledhjen e punimeve “Toponimia e Gjakovës”, (Sesion shkencor), Gjakovë, 2002.
- Identifikimi i disa antroponimeve mesjetare në patronimet e sotme shqiptare në Kosovë, “Zbornik šeste jugoslovenske onomastike konferencije”, Beograd, 1987, f. 255-262,
- Kontaktet ndërgjuhësore në toponiminë tonë në dritën e fjalës ilire-shqipe mal, në përmbledhjen e punimeve Savez Geografskih Društva Jugoslavije, Sarajevo, 1984.

Me anë të studimeve të tij të pakrahasueshme nga një fushë e vështirë albanologjike, siç është onomastika, autori Prof. Dr. Rexhep Doçi ka vërtetuar bindshëm autoktoninë e shqiptarëve në Dardaninë ilire-antike, si pasardhës të pellasdo-ilirëve, jo vetëm në Gadishullin Ilirik (Ballkanik), po pjesërisht edhe në tri kontinente: Evropë, Azi e Afrikë.

Veprat:

- 1) “Antroponimia e Llapushës”, Prishtinë, 1983, (207 f.)
- 2) “Antroponimia e shqiptarëve të Kosovës-I”, Prishtinë, 1990, (245 f.)
- 3) “Iliro-shqiptarët dhe serbët në Kosovë”, Prishtinë, 1994, (345 f.).
- 4) “Onomastika e Drenicës-I”, Prishtinë, 2005, (407 f.)
- 5) “Onomastikë ilire-shqiptare në Ballkan”, Prishtinë, 2006, (532 f.)
- 6) “Çështje onomastike pellazge-ilire-shqiptare”, Prishtinë, 2009, (368 f.)
- 7) “Shqyrtime dhe polemika onomastike”, Prishtinë, 2012, (349 f.)
- 8) “Rreth prejardhjes së patronimit Doçi”, Prishtinë, 2012, (337 f.)
- 9) “Pellasdët (Pellazgët) gjyshër të ilirëve dhe stërgjyshër të shqiptarëve”, Prishtinë, 2015, (360 f.)
- 10) “Rrënjët pellasde-ilire-thrake-shqipe në vendbanimet e Kosovës”, Prishtinë-2019, (462 f.). Prof. Dr. Rexhep Doçi shquhet me më tepër se 150 vepra e punime shkencore të botuara...

REXHEP FERRI




Prof. Rexhep Ferri, u lind në Kukës, në vitin 1937. Më 1958 mbaroi Shkollën e Mesme të Artit në Pejë. Në vitin 1962 botoi poezitë e para, nga cikli “Shëtitësit e lodhur” në revistën letrare “Jeta e re” në Prishtinë. Në vitin 1966 u diplomua në Degën e Pikturës Monumentale në Akademinë e Arteve në Beograd, ndërsa në vitin 1970 mbaroi studimet pasuniversitare po në Akademinë e Arteve në Beograd. Më 1971 mori çmimin e Dhjetorit të Kuvendit të Kosovës për kontributin e tij në fushën e arteve figurative. Në vitin 1974 zgjidhet pedagog i Akademisë së Arteve Figurative në Prishtinë. Anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në vitin 1996, ndërsa anëtar i rregullt në vitin 2000.

Ka organizuar shumë ekspozita të pavarura në vend dhe jashtë, ka marrë pjesë në manifestime të rëndësishme, ekspozita, bienale, takime kulturore, në Kosovë, në Ish Jugosllavi, por edhe në Francë, Itali, Gjermani, Turqi, Egjipt, e vende tjera. Në vitin 1999, zgjidhet sekretar i Seksionit të Arteve në ASHAK. Në vitin 2010, ASHAK botoi Monografinë ku pasqyrohet i tërë opusi i tij artistik. Ka botuar disa përmbledhje me poezi, si dhe ese e romane dhe ka mbi 15 ekspozita të pavarura si dhe të përbashkëta.

Botimet:

- “Punë gjaku”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë, 1978,
- “Qafa e diellit”, poezi “Rilindja”, Prishtinë, 1981,
- “Këmisha e bardhë”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë, 1984,
- “Trekëndësh me detin”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë, 1988,
- “Në profil”, “Rilindja”, poezi, Prishtinë, 1992,
- “Ndoshta ishte dashuri”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë, 1997
- “Atdheu im torso”, roman, “Rilindja”, Prishtinë, 1998, Onufri, 2009,
- “Portreti i një vetmie”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë, 2003,
- “Frikë nga Gernika”, roman, “Onufri”, Tiranë, 2004,
- “Njeriu po kush tjetër”, roman, Onufri, Tiranë, 2005,
- “Shapo Albane”, Onufri, roman, Tiranë, 2006,
- “Humbës i lumtur”, poezi, “Toena”, Tiranë, 2007
- “Historia e hijeve”, ese, “Onufri”, Tiranë, 2008,
- “Harrimi antik”, poezi, “Onufri”, Tiranë, 2009,
- “Britma e Munkut”, roman, “Onufri”, Tiranë, 20011, etj.

REXHEP HOXHA (1929-2019)




Rexhep Hoxha u lind në Gjakovë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërkaq degën e albanologjisë në Beograd. Një kohë punoi nëpër fshatra e qytete të ndryshme të Kosovës, pastaj një kohë punoi redaktor në Rilindje, ku drejtonte faqet e Rilindjes për fëmijë, pastaj ishte redaktor në emisionet për fëmijë të Radio Prishtinës, dhe në fund ishte pedagog në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Universitetit të Prishtinës, ku mbante lëndën letërsi për fëmijë. Me shkrime letrare për fëmijë, nis të merret që në bankat e para shkollore. Bashkëpunon me të gjitha gazetat dhe botimet e ndryshme të Kosovës dhe të Maqedonisë si Pionieri, Rilindja për fëmijë, Gëzimi e Fatosi etj. Ndërkaq, shumë krijime të tij ribotohen në revistat Pionieri, Fatosi dhe Yllkat në Tiranë, në kohë kur edhe botoheshin në Prishtinë e Shkup. Librin e parë me vjersha për fëmijë e boton në vitin 1953, me titull *Gjethet e reja*. Pason botimi i veprave tjera Poezia e Rexhep Hoxhës, edhe për nga titujt lidhet me moshën e hershme fëmijërore prej 7 deri 12 vjeçare dhe ajo përsërit disa forma dhe mënyra të ndryshme të shkrimit.

Librat e botuar:

”Gjethet e reja”, e botuar në vitin 1953,
“Picimimuli”, e botuar në vitin 1956,
“Vjersha dhe poema për fëmijë”, 1956,
“Mbi krahët e futures”, “Vjersha 1959,
Romani “Lugjet e verdha”, 1959,
“Vjersha”, poezi 1953,
”Lulet e Frashnjetit”, 1965,
“Pika vese”, vjersha 1966,
“Gecatarët”, tregime për fëmijë, 1969,
“Lulëzo vendi im”, vjersha 1973,
“Zëri i pyllit”, vjersha, 1974,
“Micimiri”, poezi, 1976,
“Tokë trëndafilash”, 1979,
“Pipireku”, poemë humoristike, 1980,
“Verorja”, roman, 1984,
“Zogu i qiellit”, zgjedhje poezie, 1984, si dhe 8 vepra tjera letrare.

REXHEP QOSJA



Prof. Rexhep Qosja, u lind më 25 qershor 1936, në Vuthaj të Malit të Zi. Katër klasat e para të fillores i kreu në Vuthaj, kurse gjysmëmaturën në Guci. Më 1959 mbaroi Shkollën Normale në Prishtinë, ndërsa më 1960 u regjistrua në Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe të Fakultetit Filozofik të Prishtinës, ku u diplomua më 1964. Në vitin 1967 u pranua asistent në Institutin Albanologjik të Prishtinës dhe gjatë viteve 1967/68 specializoi shkencën e letërsisë në studimet e shkallës së tretë në Fakultetin

Filologjik të Universitetit të Beogradit. Më 1969 u zgjodh bashkëpunëtor shkencor i Institutit Albanologjik të Prishtinës. Në vitin 1971 mbrojti tezën e doktoratës mbi jetën dhe krijimtarinë e Asdrenit. Pas doktoratës, më 1972, u zgjodh, një herë bashkëpunëtor i lartë e pastaj, këshilltar shkencor në Institutin Albanologjik, si dhe profesor inordinar dhe profesor ordinar në Fakultetin Filozofik të Prishtinës. Ishte drejtor i Institutit Albanologjik prej vitit 1972 deri më 1981, shef shumëvjeçar i Degës së Letërsisë dhe të Gjuhës Shqipe të Fakultetit Filozofik, kurse gjatë viteve 1974-1975, kryeredaktor i jashtëm i revistës letrare Jeta e Re. Është autor i mbi tridhjetë librave me studime për letërsinë dhe kritikë letrare, prozë artistike, tregime, romane dhe drama, publicistikë e shkrime polemike. Ka botuar shumë recensione, vështrime, artikuj, sprova, trajtesa e studime në revista shkencore e letrare, duke trajtuar në to çështje të veçanta të letërsisë shqipe dhe të krijimtarisë letrare në përgjithësi. Disa punime dhe vepra të tij janë përkthyer në gjuhë të tjera. Për krijimtarinë shkencore e letrare është çmuar me Shpërblime si: qytetit të Prishtinës, më 1968, me Shpërblimin Krahinor të Dhjetorit më 1969, me dy shpërblime të SHSH të Kosovës, më 1972 dhe 1974 dhe me Shpërblimin e RS të Serbisë-“7 Korriku”, më 1975, me Çmimin “Pjetër Bogdani”, 2010 për romanin “Bijtë e askujt”, etj. Është marrë edhe me veprimtari politike, në periudhën 1998-2000 drejtoi një parti politike në Kosovë. Në vitin 2000 kryetari i Republikës së Shqipërisë i dha çmimin “Nderi i Kombit”.

Veprimtaria letrare:

“Episode letrare”, “Rilindja”, Prishtinë, 1967.

“Dialogje me shkrimtarët”, “Rilindja”, 1968.

“Kritika letrare”, “Rilindja”, Prishtinë, 1969.
“Antologjia e lirikës shqipe”, “Rilindja”, Prishtinë, 1970.
“Kontinuitete”, “Rilindja”, Prishtinë, 1972.
“Asdreni-jeta dhe vepra e tij”, Prishtinë, 1972.
“Panteoni i rralluar”, “Rilindja”, Prishtinë, 1973.
”Vdekja më vjen prej syve të tillë”, “Rilindja”, Prishtinë, 1974.
“Shkrimtarët dhe periudha”, Prishtinë, 1975,
“Anatomia e kulturës”, “Rilindja”, Prishtinë, 1979.
“Morfologjia e një fushate”, Prishtinë, 1980,
”Historia e letërsisë shqipe”–Romantizmi I-II-III, 1984,
“Antologjia historike e letërsisë shqipe”, 1985,
“Porosia e madhe” Prishtinë, 1986,
“Populli i ndaluar”, Prishtinë, 1990.
“Fjalori demokratik”, Prishtinë, 1997,
“Çështja shqiptare”, “Historia dhe politika”, Prishtinë, 1998,
“Strategjia e bashkimit kombëtar”, Prishtinë, 1998,
“Paqja e përgjakshme”, “Konferenca ndërkombëtare për Kosovën”, Prishtinë, 1999.
“Tronditja e shekullit I”, Tiranë, 2001,
“Tronditja e shekullit II”, Tiranë, 2001
“Një dashuri dhe shtatë faje”, roman, Tiranë, 2001,
“I ringjalluri i penduar”, tregim satirik. 2002,
“Realiteti i shpërfillur”, “Vështrim kritik mbi pikëpamjet e Ismail Kadaresë për identitetin shqiptar”, Tiranë, 2006,
“Nata është dita jonë”, Tiranë, 2007,
“Bijtë e askujt, I dhe II, Valdoli”, 2010.
Në vitin 2010 Instituti Albanologjik i Prishtinës botoi kompletin e veprave në 29 vëllime, i cili në pesë cikle përmban këto vepra:

Veprat historiko-letrare:

1. “Vazhdimësi”,
2. “Panteoni i rralluar”,
- 3.”Asdreni-jeta dhe vepra”,
- 4.”Prej letërsisë romantike deri te letërsia moderne”,
5. “Anatomia e kulturës”,
- 6.” Nociione të reja albanologjike”,
- 7.”Historia e letërsisë shqipe-Romantizmi 1”, ” Historia e letërsisë shqipe-Romantizmi 2”, “Historia e letërsisë shqipe-Romantizmi 3”, etj.

REXHEP SHAHU



Rexhep Shahu u lind në vitin 1960, në Bardhoc të Lumës, mes Kukësit e Prizrenit. Fëmijërinë e kaloi në breg të Drinit të Bardhë me Pikëllimin në shpinë e Pashtrikun në sy, aty, në mesin e dheut, ku pajtohen e bëhen një dy Drinat, i Bardhi dhe i Ziu dhe rendin bashkë me ëndrrat e tyre drejt detit. Në Durrës kreu shkollën e mesme teknike-mekanike. Atje u mëkua me det dhe lau ëndrrat në të. Universitetin "Luigj Gurakuqi" për letërsi e kreu në Shkodër. Ka provuar gjithfarë lloj punësh e profesioneesh në fusha e male me bujq e blegtorë, kosëtarë e korrës gruri. Ka jetuar me mineral kërkuesit, minatorët, vagonistët, ka punuar si motorist e xhenerik, ka bërë sekretarin në prokurori, shpesh duke u dridhur për fatet e të tjerëve, ka qenë drejtues kulture, tregtar, ka themeluar një kompani ndërtimi, ka punuar gazetar në Radio Kukësi, në Radio Tirana, në Top Albania Radio e në organe të shumta shtypi të Tiranës e Prishtinës, zëdhënës në Qarkun e Kukësit, zëdhënës shtypi në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në Tiranë, më pas drejtues i sektorit të Informacionit Bujqësor në këtë Ministri. Ka drejtuar si kryeredaktor revistën kulturore “Dy Drina”, revistën për fëmijë “Kallz”, organe këto të Qendrës Kulturore “Dy Drina”, të përkohshmen “Gazeta e Kukësit”, revistën për kulturë "Illz", dhe shtatë vite edhe revistën kombëtare “Bujqësia Shqiptare”, organ i Ministrisë së Bujqësisë, Tiranë, është editor në revistën letrare të Tiranës ”Illz”.

Libra të botuar:

- “Mali i Hënës”, poezi, Tiranë, 1988,
- “Bregu i Brengës”, poezi, Prizren, 2000,
- “Misioni për Paqen”, kushtuar krizës së Kosovës dhe aktorëve të kohës,
- “Bllaca” monografi,
- “Marsi i Minave”, Tiranë, 2006,
- “Lis i Vetëm në Fushë”, Tiranë 2011,
- “Apologji për Udhën e Kombit”, Tiranë, 2012
- “Bukën Tonë të Përditshme”, Tiranë, 2014,
- “Qyteti i Lutjeve”, Tiranë 2014,
- “Sytë e Lirisë”—monografi, kushtuar heroit kaçanikas Ismail Raka,
- “Shtatë fletoret”, Tiranë 2019, vepër e plotë me 5548 vargje të poetit martir Havzi Nela nga Kukësi (përgatitur nga Rexhep Shahu). Etj.

RIFAT LATIFI



Prof. Dr. Rifat Latifi, u lind në Kllodernicë të Skënderajt më 1955. shkollën fillore e përfundoi në Turiqec, ndërsa Shkollën e mesme të mjekësisë “Ali Sokoli” në Prishtinë.

Në vitin 1982 i përfundoi studimet në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë dhe po atë vit emigroi në SHBA. Fillimisht u vendos në Hjuston, ku punoi në hulumtime shkencore.

Specializimin për kirurgji e filloi në Klinikën e Klivlendit, pastaj e vazhdoi në Universitetin e Jelës, ndërsa specializimin e dytë në traumatologji të përgjithshme dhe reanimacion e kreu në Nju Jork, College of Medicine. Profesor universitar u bë pas 5 vjetve të mbarimit të specializimit dhe mbajti shumë poste akademike dhe organizative me rëndësi në mjekësinë botërore. Gjatë karrierës së tij ai ka punuar në universitete dhe qendra spitalore me emër nëpër Amerikë, si Texas, Filadelfia, New York...

Aktualisht, është profesor i kirurgjisë dhe president i Kolegjit të Kirurgëve Amerikan për shtetin e Arizonës. Prof. Dr. Rifat Latifi, është krijues dhe implementues i Programit të Telemjekësisë në Kosovë dhe Shqipëri, program ky i financuar nga USAID.

Është laureat i çmimit prestigjioz dhënë nga “IDG-s Computer-world Honors Program”, në vitin 2011. Prof. Latifi ka botuar disa libra për mjekësi (kirurgji, nutricion, laparaskopi dhe telemjekësi) si dhe është autor i mbi 130 artikujve shkencorë.

Ai ka kryer specializimin në Kirurgji të Përgjithshme, një vit në Klinikën e Klivlendit, e pastaj në Universitetin Yale, që të dy këto institucione, nga më të mirat në botën mjekësore.

Pas specializimeve, shkon në Richmond, Virxhinia për një kohë të shkurtër, por do të përfundonte shumë shpejt në Tucson, Arizona. Sot, ai punon si profesor i kirurgjisë në Universitetin e Arizonës. Rifat Latifi, M.D., FACS, FICS, punoi më përkushtim në afirmimin e shëndetësisë shqiptare. Kontributi i tij është i madh në themelimin e shërbimit të telemjekësisë në Kosovë dhe Shqipëri.

Si ekspert në lëmin e kirurgjisë, përveç në universitete të ndryshme amerikane, për një kohë punojë edhe në Katar dhe në vende tjera të botës. Në qendrat ku ai punoi u angazhua edhe në edukimin e mjekëve shqiptar. Jeton dhe vepron në SHBA.

Botimet:

1. Thyroidectomy in a Surgical Volunteerism Mission: Analysis of 464 Consecutive Cases. Latifi R, Gachabayov M, Gogna S, Rivera R. *J Thyroid Res.* 2019
2. Recurrence of infection and hernia following partial versus complete removal of infected hernia mesh: a systematic review and cohort meta-analysis. Gachabayov M, Gogna S, George G, Samson D, Latifi R. *Hernia.* 2019
3. Falling Again Falls in Geriatric Adults-Risk Factors and Outcomes Associated With Recidivism. Prabhakaran K, Gogna S, Pee S, Samson DJ, Con J, Latifi R. *J Surg Res.* 2019
4. Different etiopathogeneses in early-onset and late-onset inguinal hernia mesh infections in a prospectively evaluated cohort. Gachabayov M, Latifi R. *Acta Chir Belg.* 2019
5. Nutrition in surgical patients: how soon is too soon? Khan M, Latifi R. *Curr Opin Crit Care.* 2019
6. Pre-hospital shock index correlates with transfusion, resource utilization and mortality; The role of patient first vitals. Jehan F, Con J, McIntyre M, Khan M, Azim A, Prabhakaran K, Latifi R. *Am J Surg.* 2019
7. Patient satisfaction following thyroidectomy in surgical mission: a prospective study. Gachabayov M, Latifi R. *Gland Surg.* 2019
8. Metabolic Syndrome Exponentially Increases the Risk of Adverse Outcomes in Operative Diverticulitis. Jehan F, Zeeshan M, Con J, Hanna K, Tang A, Hamidi M, Latifi R, Joseph B. *J Surg Res.* 2020
9. Females fall more from heights but males survive less among a geriatric population: insights from an American level 1 trauma center. El-Menyar A, Tilley E, Al-Thani H, Latifi R. *BMC Geriatr.* 2019
10. En bloc removal of infected hernia mesh rather than "blue-ectomy". Gachabayov M, Gogna S, Latifi R. *Hernia.* 2019
11. Passive drainage to gravity and closed-suction drainage following pancreatoduodenectomy lead to similar grade B and C postoperative pancreatic fistula rates. A meta-analysis. Gachabayov M, Gogna S, Latifi R, Dong XD. *Int J Surg.* 2019
12. Clinical Presentation and Management of Pelvic Morel-Lavallee Injury in Obese Patients. Muneer M, El-Menyar A, Abdelrahman H, Murad MA, Al Harami SM, Mokhtar A, Khawar M, Awad A, Asim M, Latifi R, Al-Thani H, si dhe shumë botime e studime tjera shkencore...

RIDVAN DIBRA



Ridvan Dibra, u lind më 9 janar të vitit 1959, në Shkodër.

Përfundoi studimet në degën e gjuhës dhe letërsisë shqipe, në Universitetin e Shkodrës. Punoi si mësues i gjuhës dhe letërsisë shqipe në Kukës gjatë periudhës 1982-1987, kurse në vitet 1988-1994 punoi si gazetar në Shkodër. Që nga viti 1994 punon si profesor i letërsisë shqipe në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi".

Dibra është një ndër figurat kryesore të letërsisë së sotme shqipe dhe autor i shumë vëllimeve novatore. Në vitin 2012 fitoi çmimin Rexhai Surroi për romanin më të mirë të vitit në gjuhën shqipe, për veprën e tij Legjenda e vetmisë.

Veprat:

- “Thjesht”, (1989) (poezi), “Eklipsi i shpirtit (1994),
- “Tregime dhe novela”, “Prostituta e virgjër”, (1994),
- “Nudo”, (1995), “Vetmia e diellit”, (1995),
- “Mjerimi i gjysmës”, (1996),
- “Kurthet e dritës”, (1997),
- “Triumfi i Gjergj Elez Alisë”, (1999),
- “Stina e ujkut”, (2000),
- “Të lirë dhe të burgosur”, (2001),
- “Vëlla me centaurët”, (2002),
- “Triumfi i dytë i Gjergj Elez Alisë”, (2003),
- “Kumte dashurie”, (2004),
- “Sesilja ose sexonix”, (2005),
- “Stina e maceve”, (2006),
- “Franc Kafka i shkruan të birit” (2007),
- “Një lojë me emrin postmodernizëm”, (2007), studim,
- “Unë, Franz Kafka dhe Karta e Bolonjës”, (2009),
- “Në kërkim të fëmijës së humbur”, (2010)
- “Kanuni i Lekës së vogël”, (2011),
- “Legjenda e vetmisë”, (2012),
- “Gjumi mbi borë”, (2016),
- “Treni i muzgut”, (2017),
- “Dashuritë e virgjëreshës Madalenë”, (2018),
- “Plagët e Mojsiut”, (2010) (poemë), etj.

RIFAT GJOTA



Dr. Rifat Gjota është zbulues shqiptar. Shkencëtari dhe pedagogu i mirënjohur ka lindur në Pejë, më 5 maj 1939, në një familje të njohur zejtare. Shkollën fillore dhe gjimnazin e kreu në vendlindjen e vet. Në vitin 1965 ka diplomuar në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Shkupit, në vitin 1977 ka magjistruar në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Zagrebit, kurse në vitin 1985 ka doktoruar në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Prishtinës. Prej vitesh dhe aktualisht punon si profesor në Fakultetin e inxhinierisë elektrike në Prishtinë. Mbi njëzet vjet punoi në zbulimin e elektromotorit me veti shumë më të përparuara se ai i gjertanishëm, i cili kursen energjinë elektrike në përqindje të konsiderueshme, sikurse edhe sasinë e bakrit të nevojshëm për ndërtimin e tij.


Zbulimet e veta i regjistroj (patentoj) në Amerikë me emrin “US Patent 4710661-Winding arrangement of a stator and/or rotor of a three-phase generator or electromotor with improved performances”, kurse mënyra e ndërtimit të këtyre elektromotorëve quhet “rifatizim”.

Në vitin 2005 botoi librin “Makinat Elektrike Komplementare-Komplekse“. Kontrata për ndërtimin e këtyre motorëve është nënshkruar me firmën boshnjake “Elir” nga Tuzlla. Zbulimi i fushave elektromagne-tike rrotulluese komplementare, nga ana e Dr Rifat Gjetës e ka plotësuar edhe më tutje shkencën e fushave elektromagnetike rrotulluese.

Kështu është hapur një shteg të ri për mënyrën e përshtjelljes së makinave elektromagnetike rrotulluese. Esenca e zbulimit të Dr. Rifat Gjetës qëndron në plotësimin e përshtjellove me një përshtjellë shtesë të çfazuar për 90 shkallë në hapësirë dhe në kohë. Me këtë arrihet zvogëlimi i forcave të harmonikëve të kundërta d.m.th. se lakorja e fushës rrotulluese i afrohet më tepër ideale. Kjo në praktik i bje kursim i mbi 5% të energjisë.

Motori i parë me fuqi 400 KW është duke punuar në elektroekonominë e Kosovës. Edhe shumë motorë të tjerë janë të ripërshtjellur (rifatizuar) dhe punojnë nëpër shumë fabrika dhe punishte të Kosovës. Puna e Dr. Rifat Gjetës në lëmin e Sferizimit është gjithashtu i rëndësishëm dhe hapë një kapitull të ri në studimet matematikore e hapësinore të të gjithë asaj që ekziston në Hapësirën e pafundme. Është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve Shqiptaro-Amerikane në New York.

RIFAT KUKAJ



Rifat Kukaj u lind më 25 tetor 1939 dhe vdiq më 11 shtator 2005. Lindi në Tërstenik të Drenicës, studioi në Normalen e Prishtinës.

Rifat Kukaj është prozator, poet, dramaturg, përkthyes dhe skenarist i letërsisë për fëmijë dhe të rritur. Shkrimtari Kukaj po ashtu ka udhëhequr programet për fëmijë të Radio Prishtinës dhe ka redaktuar librat për fëmijë të Shtëpisë Botuese "Rilindja".

Përktheu letërsi për fëmijë nga autor slloven, kroat, serb, e hungarez, por edhe botoi shkrime vetanake në shumë nga këto gjuhë. Emrin e tij e mbajnë rreth 100 vëllime librash dhe 30 radio-drama.

Kontribuoi në afirmimin e krijimtarisë letrare sidomos asaj për fëmijë në rrjedhat ndërkombëtare dhe se ndihmoi autorë të shumtë të rinj. Vdiq në Ulqin, u varros në vendlindje.

Veprat:

- “Xhuxhi nga Taxhuxhi” - dramë humoristike,
- “Lepuri me pesë këmbë” - skenarë filmi artistik,
- “Kokërmeli e Pilivesa”, (1971) - roman,
- “Dita e xhufkave”, (1972) - roman,
- “Shkrepi i Diellit”, (1972) - roman,
- “Minaku i përhimët”, (1973) - roman,
- “Vjollca magjike”, (1974) - roman,
- “Rrasa e Zogut”, (1975) - roman,
- “Droja”, (1978) - roman,
- “Dreri me një bri”, (1986) - roman,
- “Xhuxhi nga Xhuxhishta”, (1998) - roman,
- “Zogu i bardhë” - roman,
- “Gogozheli i Gogozhinës” (1999) - roman,
- “Shkurtabiqi më i madh në botë” (2000) - roman (botoi: URA),
- “Fshehtësia e breshkës”, (2002) - roman,
- “Majmuni me kurorë mbretërore”, (2003) - roman,
- “Fshati i Pishës”, (1969) - libër poezish (botoi: Nova Makedonija),
- “Shtëpia ime ka sy”, etj.

Rifat Kukaj ishte shkrimtar dhe autor këngësh shumë i njohur në të gjitha trevat shqiptare.

RIZA SMAKA



Prof. Dr. Riza Smaka u lind në Rugovë të Pejës, në vitin 1943, ku e kreu shkollën fillore katërklasësh, ndërsa, shkollën e mesme, gjimnazin, drejtimin e shkollës normale, e kreu në Pejë më 1963/64. Dy vite më pas, ushtroi mësuesinë dhe gjatë shërbimit ushtarak (1966/67) në Bileqë, Maribor dhe në Zagreb, e kreu shkollën e Oficerëve të Këmbësorisë. Diplomoi në vitin 1971, në Fakultetin Juridik, kurse më 1972, e kreu provimin për Jurisprudencë dhe magjistroi më 1979, e doktoratën e përfundoi më 1987.

Pos gjuhës amtare-shqipe, Riza Smaka korrespondon mirë në kroatisht dhe serbisht, anglisht dhe shërbehet me literaturë edhe gjuhen në Frënge. Më 1989-1999, ka qenë inkuadruar në aktivitete të organizuara për Kauzën e Kosovës. Ishte anëtar i kryesisë së Forumit të Intelektualëve Shqiptarë të Kosovës, anëtar i kryesisë, sekretar e më pastaj kryetar i Shoqatës së Juristëve të Kosovës, anëtar i kryesisë dhe sekretar i përgjithshëm i Lidhjes Shqiptare në Botë, anëtar i Komisionit Kushtetues të Kuvendit të Kosovës për Hartimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të miratuar më 1990, në Kaçanik dhe njëri nga katër konsulentët kosovarë për hartimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të miratuar në vitin 1997.

Pas vitit 1999, në periudha të caktuara, ishte: avokat-koordinator i UNMIK 's NRC CRP, Koordinator i Këshillit të UNMIK-ut për Gjyqësorin e Kosovës, Anëtar i Komisionit Përbashkët të UNMIK-ut për Çështje Ligjore të Kosovë (Joint Advisory Committee on the Legal Matter), etj.

Deri në vitin akademik 2008/9, R.S. ishte profesor ordinar. Në Fakultetin Ekonomik të UP-së ligjëroi lëndën Menaxhmenti në shërbimet publike, ndërsa, në Fakultetin e Shkencave të UP-së, ligjëroi lëndën Zhvillimi i Qëndrueshëm. Nga viti akademik 2009/10, ai është profesor i rregullt për lëndën E Drejta Biznesore.

Tekste universitare:


E Drejta (1995), E Drejta dhe Shteti (1997),

E Drejta Biznesore (2003) dhe

E Drejta Biznesore Ndërkombëtare (2009).

Ai ka botuar mbi 191 punime profesionale dhe studime dhe ka marrë pjesë në shumë tryeza profesionale, tryeza të rrumbullakëta, simpoziume dhe në konferenca shkencore. Etj.

ROBERT NDRENIKA



Robert Ndrenika u lind në Tiranë, në vitin 1942. Në vitet 1960-1964 ka studiuar për aktor ne Shkollën e Larte "Aleksander Moisiu". Nga ky vit, deri më 1970, punon si aktor në Teatrin "Skampa" të Elbasanit. Në vitet 1970-1974 punoi si aktor në Teatrin e Institutit të Lartë të Arteve (sot Akademia e Arteve), më pas në Teatrin Kombëtar, deri sa doli në pension. Ai është emërua Artist i Popullit në vitin 1988.

Dramaturgjia kombëtare:

Ka interpretuar te: "Besa", "Ura", "Prefekti", "Familja e peshkatarit", "Bashkë me agimin", "Midis dy njerëzve", "Skënderbeu", "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" etj.

Dramaturgjia e huaj:

Nga dramaturgjia e huaj mund te përmendim "Shumë zhurme për asgjë", "Nata e dymbëdhjetë" dhe "Zbutja e kryeneçes" te Shekspir, "I sëmuri për mend" dhe "Kopraci" të Molierit, "Udha e largët" e Arbuzovit, "Luiza Miler" e Shilerit, "Prometeu" dhe "Njeriu që pa vdekjen me sy" të Viktor Eftimiut, "Dashuri e tillë" e Kohoutit, "Banja" e Majakovskit, "Arturo Ui" e Brehtit, "Vdekja e një komisioneri" e Millerit, "Vizita e damës plake" e Dyrrenmatit, "Magjia e madhe" etj.

Kinematografia:

Në kinematografi ka interpretuar mbi 30 filma, midis të cilëve mund të përmendim "Horizonte te hapura", "I teti në bronz", "Kapedani", "Shtigje lufte", "Në shtëpinë tonë", "Koncert ne vitin 1936", "Bolero" etj.

Nderimet:

Në vitin 1979 i është akorduar titulli "Artist i Merituar", në vitin 1988; "Artist i Popullit". Më 1994 është nderuar me Kupën për Aktorin më të Mire në Festivalin Kombëtar te Teatrit. Është nderuar me titullin "Nderi i Kombit".

Filmografia:

Oshtimë në bregdet, 1966, Horizonte të hapura, 1968, Kryengritje në pallat, 1972, Shtigje të luftës, 1974, Rrugë të bardha, 1874, Duke kërkuar 5-orëshin, 1974, Shembja e idhujve, 1977, Koncert në vitin 1936, 1878, Në shtëpinë tonë, 1979, Vëllezër dhe shokë, 1982, Kohë e largët, 1983, Tre njerëz me guna, 1985, Gurët e shtëpisë sime, 1085, Parullat, 2001, Njerëz dhe fate, 2002, Tifozët, 2004, Kronikë provinciale, 2009, etj.

ROVENA VATA



Dr. Rovena Vata u lind më 26.05.1985, është diplomuar për gjuhë-letërsi në Universitetin e Tiranës, në vitin 2008. Ka përfunduar studimet e masterit të shkencave në vitin 2010. Më 17 qershor 2013 ka fituar gradën shkencore “Doktor” në “Studime Letrare”, në Tiranë. Veprimtarinë e mësimdhënies e ka filluar pranë Universitetit “Justicia” dhe Universitetit Ndërkombëtar të Tiranës, më pas në Qendrën e Studimeve Albanologjike, Tiranë, në Universitetin e Arteve, në Tiranë, në Universitetin e Durrësit, në Universitetin e Prizrenit, në Universitetin e Gjakovës, etj.


Që prej vitit 2011 ka marrë pjesë në shumë konferenca, seminare e simpoziume kombëtare e ndërkombëtare dhe me botime e studime artikujsh shkencorë në revista shkencore, brenda dhe jashtë vendit. Është autore e 4 librave shkencorë. Dy monografi studimore dhe dy libra më përmbledhje studimore:

“Fantastikja në rrëfenjat e Kutelit, Gogolit dhe Turgenievit”, Identitet kulturor përmes vlerash”, “Urë fjalësh midis letërsisë dhe antropologjisë”, “Miti i malit në letërsinë shqipe: Fishta, Koliqi, Migjeni, Camaj”.

Krijimtaria shkencore:

Doket, ritet e kultet shqiptare në romanin “Karpa” të Martin Camajt,
Lef Nosi si mbledhës i folklorit në arkivin e IAKSA-ës,
Lojërat tradicionale popullore të Rugovës,
Pleqnia në Kanunin e Lekë Dukagjinit, Pjesa teorike dhe ajo e përgjithshme
Folklori, amza e ndërtimit të rrëfenjave kuteliane,
Roli i ëndrrës si element psikologjik në rrëfejat e Mitrush Kutelit,
De Rada's Position in the Albanian Literature
Qyteti hije e provincës në romanin “Qyteti pa reklama”, të Ismail Kadaresë,
Erosi i Migjenit në letërsinë shqipe,
Periodikët si histori e letërsisë dhe kodifikuese letrare, Rasti i SHËJZAVE,
Kthimi i letërsisë në qytet dhe shembja e kulteve në veprën migjeniane
The Feeling of Being Free Among Cultures that Collide ADDENDA
(Things that should be added, because if not they can be forgotten)-A Story
by Eris Rusi.
Elementët fantastik dhe gjysmë-fantastike në historitë e shkurtra të Kutelit
dhe krijime tjera shkencore.

RUSHIT RAMABAJA



Rushit Ramabaja është i lindur në katundin Marec, ngjitur me Damastionin antik, më 20 nëntor 1948. Ka kryer Fakultetin e Filologjisë në Universitetin e Prishtinës. Punoi kryesisht në gazetën “Rilindja” si reporter i lirë, redaktor kulture e redaktor përgjegjës. I dha vulë të veçantë gazetarisë shqiptare, sidomos me reportazhet, fejtonet dhe satirën gazetareske, të nënshkruar me pseudonimin Nonda Bulka-i Riu.

Ishte editor e kryeredaktor i revistës satirike-humoristike “Ironia”. Drejtoi emisionin “Bota e librit” në Radio-Kosovë, etj. Jeton në Prishtinë.

Ka botuar romanet:

“Çupërlina”, “Rilindja”, Prishtinë, 1976, “Gjegj Elez Alia”, Rilindja, Prishtinë, 1978, dhe shtëpia botuese, Naim Frashëri, Tiranë, 1984, “Grigja”, Rilindja, Prishtinë, 1982, “Daullet e varrimit”, gazeta Rilindja, Prishtinë, 1984, “Të dielën erdhi Rozafa”, Rilindja, Prishtinë, 1990, “Kuarti i lavireve”, LSHK, 1994, “Murtaja në tetorin e dashurisë”, botoi, Renesanca, Prishtinë, 1995, “Rrëmbimi i vajzës së këngës”, Dukagjini, Prishtinë, 2001, “Fajnitë e apostujve”, Rilindja, Prishtinë, 2002, “Amazanat në prillin e pushtimeve”, Forumi i Krijuesve të Artit, Prishtinë, 2002, “Kangjelja e Damastionit”, Nositi, Prishtinë, 2009, “Gruaja e Jezusit”, Orfeu, Prishtinë, 2010, “Kryezoti i fermës së qenve”, Orfeu, Prishtinë, 2011, “Galab Ahmati”, Orfeu, Prishtinë, 2011, “Dashnaja dhe misteret e saj”, Orfeu, Prishtinë, 2011 dhe “Sagë e qyqes”, Orfeu, 2017.

Ka botuar dramat:

“Heronjtë e Salmakidës”, Kumanovë, 1992; “Perëndeshat vdesin në pranverë”, Prishtinë, 1995, “Dekreti i zhvirgjërimit”, LSHK, Prishtinë, 2010, “Zoti maskohet si mëzat”, 2010, “Vjeshta e lehjeve”, 2010.

Vëllimet poetike:

“Shqiponjat e agimit”, botoi, Rilindja, Prishtinë, 1971, “Pse ma preve Mollën e Kuqe”, FKA, Prishtinë, 2005 “Kobra e Kleopatres”, Prishtinë, 2012, “Perëndia e Ylberit”, Prishtinë, 2015. Poezi e përkthyer: “Euridika në mollën e ndaluar – Η Ευρυδική Στην Απαγορευμένη Μηλιά”, shqip - greqisht, 2017. Autori ka shkruar edhe kritikë letrare e eseistike: “Shtatë ditët e krijimit të botës”, 2010, “Katër kalorësit e Apokalipsit”, Prishtinë, 2015, e tjera.

RUZHDI JASHARI



Prof. Dr. Ruzhdi Jashari shkollimin e lartë e kreu në Shkollën e Lartë Teknike, Drejtimi i Makinerisë, Universiteti i Prishtinës dega në Ferizaj, 1982.

Kursi i pedagogjisë dhe psikologjisë për arsimtarët e profileve teknike, Ferizaj, 1990.

Ishte arsimtar i lëndëve të makinerisë pranë Shkollës së Mesme “Nikolla Teslla” në Ferizaj, 1982-1997. Fakultetin e Gazetarisë, në Kolegjin “Faik Konica”, Prishtinë e përfundoi më 2007. Magjistroi në drejtimin Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci në Universitetin “ILIRIA” në Prishtinë në vitin 2010.

Merret me publicistikë, aktivitete humanitare, e të tjera dhe është mbikëqyrës kryesor shtetëror në Agjencinë Shtetërore për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Kosovës. Doktoratën në Shkenca Sociale dhe të Edukimit, programi “Shkenca Sociale”, profili “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”, UET, Tiranë, më 2017.

Koordinator dhe Hetues Kryesor në Ekipin e Avokatëve Mbrojtës për Kosovë, i autorizuar nga familjet e të akuzuarve të UÇK-së, për mbrojtjen e të akuzuarve të UÇK-së, 2003-2006.

Zëdhënës për Informim, i ngarkuar për informim për ZON-ës gjatë luftës së UÇK-së, i emëruar nga SHP i UÇK-së, gjatë vitit 1999 deri në përfundim të luftës në Kosovë. Gazetar-Reporter gjatë Luftës së UÇK, për shumë media, Redaksia në Tiranë, Kosovapressin, Radiokosovën e Lirë, Dojçe Welle-në, gjatë vitit 1998-1999. Bartës kryesorë i aktivitetit për themelimin e Muzeut Historik të Shtimes. Njëri ndër themeluesit e KMDLNJ-së në Komunë të Shtimes dhe Udhëheqës i këtij Këshilli.

Librat e botuar:

“Reçak-Kosovë”, 2000, Shkrola, Prishtinë, “Masakra e Reçakut-krim kundër njerëzimit”, Prishtinë, 2004, bashkautorësi, “Zëri i Lirisë”, Prishtinë, 2009. Monografia 1: “Krimet e Luftës në Kosovë -1998/1999”, botoi, KMDLN, Prishtinë, bashkëpunëtor për territorin e Komunës së Shtimes, Prishtinë, 2010, “Diplomacia e Forcës dhe Forca e Diplomacisë-lufta e UÇK-së dhe Intervenimi Ndërkombëtar”, Prishtinë, 2011, “Dokumente Sekrete Serbe-Planifikim i gjenocidit, krimit të organizuar dhe spastrimit etnik - sfidë për drejtësinë ndërkombëtare”, botoi “Shkrola”, Prishtinë, 2013, etj.

SABILE KEÇMEZI-BASHA



Prof. Dr. Sabile Keçmezi-Basha, u lind në Koretin, të Dardanës më 1954. Shkollën fillore dhe gjimnazin e kreu në Dardanë. Më 1977 ajo mbaroi Fakultetin e Shkencave Politike në Beograd. Vazhdoi studimet pasuniversitare në Degën e Historisë të Universitetit të Prishtinës, ku dhe doktoroi më 1984.

Botoi mbi 300 njësi bibliografike zhanresh të ndryshme për të cilat mori shumë mirënjohje, shpërblime dhe çmime letrare. Mori pjesë në tubime të ndryshme shkencore në Kosovë dhe jashtë saj. Më 1987, në “Akordet e Kosovës”, u shpërblye me “Pendën e Artë” për tekstin më të mirë të Akordeve. Që nga viti 1978 punon në Institutin e Historisë “Ali Hadri” të Kosovës...

Vepra Historike:

“Zhvillimi historik i PKJ-LKJ-së në Kosovë më 1945-1966 (nga viti 1945 deri te Plenumi i Brionëve)”, Instituti i Historisë, Prishtinë, 1987, “Lëvizja ilegale patriotike shqiptare në Kosovë më 1945-1948”, Prishtinë, 1998 (ribotuar në Shkodër), 1999, “Organizatrat dhe grupet ilegale në Kosovë 1981-1989”, Prishtinë, 2003, “Shtypi ilegal shqiptar në Kosovë (1945-1999), I”, Prishtinë, 2009, “Kosova në shtypin e mërgatës shqiptare, (1945-1990) II”, Libri Shkollor, Prishtinë, 2011, “Formimi dhe veprimtaria e NDSH-së-Procesi gjyqësor i Prizrenit, 1946”, Prishtinë, 2018, “Ngjarjet, dëshmitë dhe identiteti kombëtar”, Prishtinë, 2018, “Ballafaqim me dëshmitë historike”, Prishtinë, 2018, “40-Vjet veprimtari shkencore (Biografia dhe bibliografia)”, Prishtinë, 2018, etj.


Poezi:

“Këmisha e Atdheut”, 2013, “Metaforë iberike”, 2011, “Kujtesën e ka kapur skleroza”, 2011, “Nusja e gurtë”, 1989, “Kohë epileptike”, 1996, “Dy lule ka mami”, 1993, “Ëndrrat e trishta”, 2000, “Hadri” (dramë), 2005, “Nata pa kornizë”, 2008, “Malli për Itakën”, 2008, “Anatomia Iubiri”, 2009, “Kodi i pritjes”, 2010, “Në klasën e parë”, 2016, “Testament”, 2018, “Beni e qenushi”, 2018, “Çka do pritja pa mua”, 2018.

Bashkautore në veprat shkencore:

1. “Feja, Kultura dhe Tradita islame ndër shqiptarët” (Simposium ndërkombëtar i mbajtur Prishtinë, më 15, 16 Tetor 1992), Prishtinë 1995,
2. “Dëbimet e shqiptarëve dhe kolonizimi i Kosovës” (1877-1995), etj.

SABRI FEJZULLAHU



Sabri Fejzullahu, u lind në Besianë, më 16 shtator 1943. Shkollën fillore dhe të mesmen e kreu në vendlindje. Ai ka mbaruar studimet e gjuhës dhe letërsisë shqipe në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, si dhe aktrimin në Fakultetin e Arteve të Bukura.. Punoi si aktor në Teatrin Popullor Krahinor të Prishtinës. Sabri Fejzullahu i takon gjeneratës së vjetër të këngëtarëve. i cili ka arritur që edhe në kohën e re të zë vendin e vet në muzikën argëtuese të Kosovës, por edhe më gjerë. Ka fituar 18 "Okarina të Arta", në "Akordet e Kosovës", ka incizuar më se 800 këngë, ka marr pjesë në shumë festivale dhe ka fituar shpërblime, brenda dhe jashtë vendit. Ka bashkëpunuar gjithmonë me kompozitorët më të mirë të vendit.


Sabriu ka luajtur në disa TV- dhe video-filma. Ndër të tjerë ai luajti me Ibrahim Krajkovën "Lecin" dhe Rasim Thaqin "Cimën". Ai luajti edhe në serialët "Kur pranvera vonohet" dhe "Autobusi". Po ashtu edhe në TV-komedinë "Qesh e ngjesh" me Xhevat Qenën, Leze Qenën, Ali Ahmetin dhe Adem Mikullovcin. Në filmografinë e tij gjenden mbi 20 filma, shumica të zhanrit komedi. Karakteristikë e xhirimeve filmike të këngëve të Sabriut është përdorimi i tyre për të fuqizuar këngën, që ai këndon. Këtë ai e arrin duke e injoruar kamerën dhe në momente të caktuara e përdorë atë për t'iu drejtuar shikuesit. Zakonisht këto momente janë të shkurta dhe ndodhin gjatë ngritjes së zërit.

Ai deri me tani, ka gjithsej 14 albume, shumë role të iniciuara në videokaseta dhe disa këngë edhe me videoklipe.

Filmografia:

- Një buqetë buzëqeshje
- Migjeni (1990) (serial televiziv)
- Autobusi (1985) (mini serial), si Shoferi
- Mixha Ramë (1985) (televizion), Djali
- Qesh e ngjesh (1982) (televizion)
- Kur pranvera vonohet (1980) (mini serial televiziv)
- Gëzuar Viti i Ri 1976 (1976) (televizion)
- Në orët e vona (1982) (serial televiziv)
- Jugovizija (1981) (televizion)
- Këndon Sabri Fejzullahu (1976) (televizion) etj.

SABRI HAMITI



Prof. Sabri Hamiti, është i lindur më 1950, në Dumnicë të Podujevës, ku kreu shkollën fillore. Më 1968 mbaroi gjimnazin në Podujevë dhe u regjistrua në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, ku u diplomua në vitin 1972, me sukses të shkëlqyeshëm, në Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe. Regjistroi studimet pasuniversitare në Universitetin e Sorbonës, në Paris, mirëpo për mungesë parash u kthye në Prishtinë. Në vitin 1973 hyn në punë në shtëpinë botuese “Rilindja” të Prishtinës. Në këtë vit nis studimet pasuniversitare në Fakultetin Filozofik të Zagrebit, të cilat i kreu pas dy vjetësh. Për një vit akademik (1980/81) specializoi teorinë e formave letrare në Ecole des Hautes Études en Sciences Sociales, në Paris. Mori diplomën e Shkollës së lartë për letërsi frënge e qytetërim frëng në Universitetin e Sorbonës, në Paris. Në vitin 1987 doktoroi në Universitetin e Prishtinës

Më 1993 zgjidhet profesor i letërsisë shqipe në Universitetin e Prishtinës. Po ashtu ligjërues në studimet postdiplomike të letërsisë. Në vitin 2000 zgjidhet anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave e të Arteve të Kosovës, ndërsa në vitin 2008 anëtar i rregullt.

Veprat e botuara:

- “Njeriu vdes i ri”, Rilindja, Prishtinë, 1972,
- “Faqe e fund”, Rilindja, Prishtinë, 1973,
- “Variante”, Rilindja, Prishtinë, 1974.
- “Thikë harrimi”, Rilindja, Prishtinë, 1975, 1979,
- “Njëqind vjet vetmi”, Rilindja, Prishtinë, 1976, 1980, 1990,
- “Teksti i dramatizuar”, Rilindja, Prishtinë, 1978,
- “Trungu ilir”, Rilindja, Prishtinë, 1979, 1983,
- “Kritika letrare”, bashkë me I. Rugovën, Rilindja, Prishtinë, 1979,
- A-ZH, “Romanet e Nazmi Rrahmanit”, Rilindja, Prishtinë, 1982,
- “Arti i leximit”, Rilindja, Prishtinë, 1983,
- “Leja e njoftimit” 1985, Rilindja, Prishtinë, 1985, 1990,
- “Lind një fjalë”, Naim Frashëri, Tiranë, 1986,
- “Njeriu kryengritës”, Rilindja, Prishtinë, 1987,
- “Futa”, Rilindja, Prishtinë, 1988, Naim Frashëri, Tiranë, 1990,
- “Vetëdija letrare”, Rilindja, Prishtinë, 1989,
- “Kaosmos”, Rilindja, Prishtinë, 1990. Etj.

SADIK BICAJ



Sadik Bicaj, u lind në Vrellë të Istogut, më 21.10.1958. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Pejë, SHLP në Gjakovë, ndërsa Fakultetin Filologjik, Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, në Universitetin e Prishtinës në Prishtinë.

Përveç poezisë merret edhe me gjuhësi, kritikë letrare dhe publicistikë.

Para luftimeve bashkëpunuar me të gjitha revistat dhe gazetatat që dilnin në gjuhën shqipe në Kosovë, ndërsa, krahas punës në arsim, ka qenë edhe korrespondent i rregullt i gazetës “Rilindja”, “Koha ditore” dhe revistës arsimore “Shkëndija”.

Sadik Bicaj është anëtar i Shoqatës së Gjuhës Shqipe të Kosovës, bashkëpunëtor i jashtëm i Institutit Albanologji të Prishtinës dhe kryetar i Klubit letrar “Podguri” në Istog, si pjesëmarrës i shumë simpoziumeve shkencore nga fusha e gjuhësisë dhe e letërsisë të organizuara në Kosovë dhe në Shqipëri.

Një kohë të gjatë punoi në shkollën fillore “Fazli Graiçevci” të Hades, komuna e Obiliqit, pastaj edhe në Gjimnazin “Haxhi Zeka” në Istog, ndërsa tash e disa vjet është drejtor në shkollën fillore e të mesme të ulët “Hysni Zajmi” në Vrellë.

Ka botuar këta libra:

- “Plaga e kurbetit” (dramë, 1992),
- “Zëri i pikëllimit” (poezi, 1994),
- “Artikuj gjuhësorë praktikë” (artikuj gjuhësorë, 1996),
- “Historiku i shkollave fillore shqipe të komunës së Istogut” (1997),
- “Vështrime letrare” (ndihmës për lekturë shkollore, 2000),
- “Rrugët drejt lirisë” (ditar nga lufta, 2002),
- “Sylë Vrella, mjek i njohur popullor” (monografi, 2006),
- “Teste nga Gjuha Shqipe dhe Letërsia” (2008),
- “Fadil Ferati, veprimtar i denjë i lirisë dhe pavarësisë” (monografi, 2014),
- Vështrime gjuhësore dhe letrare (2019).
- “Antologji e poezisë moderne shqipe”.

Sadik Bicaj ka qenë pjesë e manifestimit letrar “Flaka e janarit”, mbajtur në Pejë dhe organizuar nga Shoqata e Shkrimtarëve të Pejës dhe Klubi Letrar “Podguri” të Burimit, is-Istogut.

SADRI FETIU



Prof. Sadri Fetiu, u lind në fshatin Peçan të Therandës, më 7.2.1942. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje dhe në Therandë, gjimnazin në Prizren dhe Fakultetin Filozofik-Grupin e Albanologjisë në Prishtinë, më 1965. Për 12 vjet me radhë (në vitet 1965-1977) ishte mësimdhënës i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në qendrën shkollore teknike “19 Nëntori” të Prishtinës dhe shkollën e Bibliotekarisë në Prishtinë.

Pas kryerjes së studimeve pasuniversitare (1972-1974), në vitin 1976 e mbrojti temën e magjistraturës. Më 1977 angazhohet në fushën e studimeve të letërsisë popullore në Institutin Albanologjik të Prishtinës. Disa nga studimet e tij janë botuar edhe në gjuhën frënge në revistat shkencore të Tiranës dhe në revistën “Recherches albanologique” të IAP-së.

Më 1987 në Fakultetin e Filologjisë së Universitetit të Prishtinës e ka mbrojtur tezën e doktoratës “*Poetika e baladës popullore shqiptare*”. Ka qenë anëtar shumëvjeçar i redaksisë së revistës shkencore “Gjurmime albanologjike”-Seria folklor dhe etnologji, si dhe në redaksitë e botimeve të veçanta të botimeve të IAP-së. Është zgjedhur gjithashtu anëtar i redaksisë së botimit shkencor “Çështje të folklorit shqiptar” të Institutit të Kulturës Popullore të Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë. Duke filluar nga viti 1991 ka qenë ushtrues i detyrës së drejtorit e më vonë për dy mandate radhazi është zgjedhur drejtor i Institutit Albanologjik të Prishtinës, duke kryer këtë detyrë për 16 vjet (1991-2007).

Vepra shkencore:

“Këngë popullore të Rilindjes Kombëtare” (bashkë me dr. Sh. Pllanën dhe mr. Rr. Berishën) IAP, Prishtinë, 1978; “Romani shqiptar i luftës” Redaksia e Botimeve e “Rilindjes”, Prishtinë, 1979; “Ninulla”, IAP, Prishtinë, 1982; “Këngë dhe lojëra të fëmijëve”, IAP, Prishtinë, 1983; “Poetika e baladës popullore shqiptare”, IAP, Prishtinë, 1987; “Këngë kreshnike II”, IAP, Prishtinë, 1991 (bashkë me dr. Rr. Berishën dhe dr. A. Zejnullahun); “Rizah Bllaca këngë popullore”, I dhe II, IAP, Prishtinë, 1997 (bashkë me dr. Rr. Berishën dhe mr. J. Ahmetin); “Vargje satirike” (vjersha), “Dija”, Prishtinë, 1998; “Balada popullore shqiptare-Aspekte krahasimtare”, IAP, Prishtinë, 2000; “Udhëkryqet e Kosovës” (përmbledhje artikujsh dhe recensionesh) “Elta BS” dhe “Artini”, Prishtinë, 2005; “Këngë popullore historike”, etj.

SALI KELMENDI



Prof. dr. Sali Kelmendi Ph.D, u lind në Qyshk të Pejës, më 5 mars 1946. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa gjimnazin e kreu në "11 Maji", në Pejë (1968). Diplomoi në Fakultetin Filozofik-Histori, Universiteti i Prishtinës (1974), më vonë diplomoi edhe në Fakultetin e Arteve, Universiteti i Prishtinës (1975).

Është Magjistër i Shkencave Politike-Marrëdhënies Ndërkombëtare, Universiteti i Zagrebit (1983), si dhe Dr. sc. i Shkencave Politike, Marrëdhënie ndërkombëtare, Universiteti i Zagrebit (2012). Profesor i lëndëve: Marrëdhënies Ndërkombëtare, Teorive të marrëdhënies ndërkombëtare, Integritimeve Evropiane dhe Filozofisë Politike, në Kolegjin Iliria,

Hyrje në Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Organizatat Ndërkombëtare, Kolegji Evropian, Dukagjini, Pejë nga 2006-20016, Hyrje në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomacia Ekonomike në Kolegjin Victory, Prishtinë nga 2007-2016; Organizatat Ndërkombëtare, në Departamentin e Shkencave Politike në Fakultetin Filozofik, Universiteti i Prishtinës, 2005/06, 2010/11. Etj. Ishte kryeredaktor i Televizionit të Prishtinës (TVP) 1989-1997, në Prishtinë dhe Tiranë, redaktor i redaksisë së politikës së jashtme, TVP-së, 1978-1989, si dhe punoi profesor në shkollën e mesme, Pejë 1973-1977. Ka një numër të madh të publikimeve me impakt faktor ndërkombëtar dhe kombëtar:

1. "Ndërtimi i shtetit të Kosovës", Yearbook, Sipan 2008, Politicka Kultura, Zagreb, 2009, (botim anglisht), 2. "Kosova: Rast unik (në Marrëdhëniet Ndërkombëtare) jo Presedan", Yearbook Sipan 2007, Politicka Kultura, Zagreb, 2008, faqe, 253-265 (botim anglisht), 3. "Çështja e Kosovës-Problemet historike e aktuale", Instituti i Historisë-Prishtinë, Instituti i Historisë-Tiranë, Eurorilindja, Tiranë, 1996, faqe 427-432,, 4. "Krizat e Qipros në kontekst të Marrëdhënies Ndërkombëtare" (punim i magistraturës), Rilindja 1984, Prishtinë (fejton), 5. "Trokitje në ndërgjegjen e Evropës", Evidence dhe Dokumentacion i Kosovës, Këshilli për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut 1992, Prishtinë, (grup autorësh).

Kelmendi është anëtarë i organizatave profesionale: Shoqata e Gazetarëve të Botës, (Organizata Ndërkombëtare e Gazetarëve) (IOJ), 1992, Shoqata e Gazetarëve të Kosovës, 1980, etj.

SALIH KRASNIQI



Dr. Salih Krasniqi Dr. Sc. kirurg-laparoskopist, është i lindur më 2.06.1956, në Tuxhec të (Kamenicë) Dardanë-Kosovë. Shkollën fillore, të mesmen dhe Fakultetin e Mjekësisë ka mbaruar në Prishtinë. Specializimin nga kirurgjia ka mbaruar në Zagreb 1991. Studimet pasuniversitare i ka mbaruar në Zagreb, 1988-1989. Temën e magistraturës e ka mbrojtur në Prishtinë në Fakultetin e Mjekësisë më 2002 me titull:

“Korrelacioni ndërmjet të dhënave klinike, radiologjike, endoskopike, histopatologjike dhe të tretmanit kirurgjik te kanceri i lukthit”, kurse doktoratën e ka mbrojtur në Universitetin e Mjekësisë në Tiranë, 2013, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, me titull: *“Eksperiencia jonë në trajtimin e kalkulozës biliare me laparoskopji dhe roli i laparoskopisë në trajtimin e rasteve të avancuara”*. Është pjesëmarrës dhe bashkëkoordinator i 7 (shtatë) Spitaleve Ushtarake në tri luftërat në trojet Shqiptare: Kosovë, Preshevë, Bujanoc, Medvegjë dhe në Maqedoni-Likovë 1998-2001.

Ka qenë asistent i autorizuar i lëndës së kirurgjisë 1996-2011 në Klinikën e Kirurgjisë në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Ka qenë mësimsdhënës i kirurgjisë në Universitetin Shtetëror të Tetovës në FSHMN në vitin 2008-2010. Ishte mësimsdhënës i kirurgjisë në Universitetin Kristal-Fakulteti i infermierisë dega në Kukës.

Vepra në bashkautorësi:

1. Bashkautor i librit “Kujdesi Shëndetësor” për klasën e 4 të shkollave të mesme, shtëpia botuese “Libri Shkollor” 1999, 2. Bashkëpunëtor i librit “Urgjenca Mjekësore”, botuar nga Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore të Kosovës, më 2002, 3. Bashkautor i librit “Ndihma e Parë” (Prishtinë, 2010).

Autor i dy monografive:

1).“Korrelacioni ndërmjet të dhënave klinike, radiologjike, endoskopike, histopatologjike dhe të tretmanit kirurgjik te kanceri i lukthit”, 2013,
2).“Përvoja në trajtimin e kalkulozës biliare me laproskopi dhe roli i laparoskopisë në trajtimin e rasteve të avancuara”, 2013. Është autor edhe i librit: “Krimet dhe keqtrajtimet e pacientëve dhe personelit mjekësore në qendrën klinike universitare të Kosovës nga forcat policore dhe ushtarake të Serbisë gjatë luftës në Kosovë 1998-1999”, prill 2018, Prishtinë.

SAMI FRASHËRI (1850-1904)



Sami Frashëri, u lind në fshatin Frashër të Vilajetit të Janinës, sot rrethi i Përmetit.

Samiu ka qenë shkrimtar, filozof, publicist, gazetar, dramaturg dhe njëri nga ideologu themelor i Rilindjes Kombëtare. Është autor i njërit prej romaneve më të hershme në gjuhën osmane, titulluar: *Ta'aşşûk-ı Tal'at ve Fitnât*, (shqip *Dashuria e Talatit me Fitneten*), botuar më 1872. Mësimet e para i mori në fshatin e lindjes së bashku me Naimin në Teqenë e Frashërit.

Pas vdekjes së prindërve më 1865, familja u shpërngul në Janinë, ku aty e mbaroi gjimnazin grek “Zasimea” më 1869. Përgjatë rrugëtimit shkollor ra në kontakt me filozofinë perëndimore, greqishten e lashtë dhe të renë, latinishten, frëngjishten dhe italishten. Më pas në një shkollë po lokale, nxori mësoi arabisht, persisht dhe turqisht.

Më 1872, u vendos në Stamboll, ku nisi punë në administratën osmane. Samiu i dhënë pas kulturës e gjuhës frënge nisi të përkthei “Të Mjerët” në osmanisht. Më vonë, në Stamboll, u emërua kryeredaktor i gazetës “Tercümân-i Şark”. Samiu i drejtoi dhe redaktoi disa gazeta, duke shkruar mbi dymbëdhjetë libra në osmanisht si “Insan” (Njeriu), “Medeniyet-i Islamiye” (Qytetërimi islam) and “Kadınlar” (Gratë). Hartoi një pamflet për çështjen e alfabetit të gjuhës shqipe, një gramatikë dhe traktatin politik mbi çështjen shqiptare, të titulluar “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet”. Më 1874 Samiu kishte shkruar dramën “Besa yahud Ahde Vefa” (shqip: Besa ose Mbajtja e Fjalës). Sami Frashëri drejtoi revistat e para në gjuhën shqipe “Drita” dhe pastaj “Dituria” (Stamboll, 1884-85). Për nevojat e shkollës shqipe hartoi librat “Abetare e gjuhës shqipe” (1886), “Shkronjtore e gjuhës shqipe” (gramatika, 1886)...

Veprat:

Taaşşuk-i Tal'at ve Fitnat (*Dashuria e Talatit me Fitneten*)-romani i parë në turqisht (1872), “*Besa yahud Ahde Vefâ*” (*Besa ose Mbajtja e premtimit*)-dramë në gjashtë pamje (1875), “*Gâve*“ (*Gjave*)-dramë me pesë pamje (1876), “*Medeniyet-i-l islamiyye* (*Qytetërimi islam*)-nga seria “*Biblioteka e xhepit*” (1879, 1885), “*Kamus-i Fransevî*”-fjalor turqisht-frëngjisht (1882/85), “*Abetare e gjuhës shqipe*”, (1886), “*Shkronjtore e gjuhës shqipe*” (1886), “*Dheshkronjë*”-libër gjeografie, (1888), “*Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e çdo të bëhet*”, (1899).

SAMI REPISHTI



Prof. Sami Repishti është shkencëtar, shkrimtar, humanist dhe historian shqiptar.

U lind më 6 prill 1925. Në vendlindje kreu mësimet fillore në shkollën "Oso Kuka" dhe të mesmen pranë gjimnazit të Shkodrës. Më 1942 mbaron maturën.

Themloi me shoqërinë e tij një Organizatë të Rinisë Demokratike, shpërndanë trakte dhe i dorëzuan një Memorandum një deputeti anglez që vizitoi Shkodrën dhe ndihmonin familjet e të arratisurve.

Samiu iu nënshtua hetimeve intensive. Dënohet nga pretenca e gjyqit me 15 vjet heqje lirie, në burg do shoqërohej me P. Çiprian Nikën dhe vëllanë e prof. Kolës, Markun.

Më 28 nëntor 1947 dërgohet në Burgun e Madh, dhe më tej në kampin e Vloçishtit, në Beden të Kavajës më 1948. Mbas daljes nga burgu më 1956, punoi si pastrues, në kanalizimin e tokave të Qendrës Zooteknike.

Ai arratiset nga Shqipëria dhe përfundon në kampin e refugjatëve të Gerovës, Kroaci. Më 1 shtator 1961, arratiset nga kampi i Gerovës dhe vendoset në Itali, kurse më 9 prill 1962, emigroi për në SHBA.

Është autor i më shumë se 100 studimeve e artikujve me tema shqiptare dhe të Drejtat e Njeriut. Në nëntor të vitit 1982, me Arshi Pipën organizuan Konferencën Ndërkombëtare për Kosovën. Punimet e kësaj konferencës janë botuar në librin "Studies on Kosova" (C.U.P.1984).


Është bashkëthemelues i Lidhjes Qytetare Shqiptaro-Amerikane (1986) dhe drejtor ekzekutiv (1989-1992), bashkëthemelues i American Friends of Albania e sekretar/arkëtar i saj (1992-1996), bashkëthemelues i Këshillit Kombëtar Shqiptaro-Amerikan (NAAC 1996) dhe president i parë (1996-1998)-grupi i lobimit më me ndikim në Washington.

Vazhdon të merret me studime shqiptare dhe mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Profesori shqiptaro-amerikan, Sami Repishti u nderua me titullin "Qytetar Nderi i Shkodrës.

Profesor Repishti luajti rol të dorës së parë në krijimin e tri organizatave shqiptare në SHBA; Rinia Shqiptare Kosovare në Botën e Lirë, Lidhja Qytetare Shqiptaro-Amerikane dhe Këshilli Kombëtar Shqiptaro-Amerikan.

SANDËR PROSI (1920-1985)



Sandër Prosi u lind në Shkodër më 6 janar 1920 në Shkodër. Familja e tij u shpërngul drejt Tiranës kur qe katërmbëdhjetë vjeç, atje mbaroi shkollën fillore vazhdoi Gjimnazin e Tiranës.

Drama e parë në të cilën merr pjesë është "Vilhelm Teli". Me bursë shtetërore shkoi për studime në Austri për stomatologji, të cilat nuk i mbaroi. Më 1947 merr pjesë në konkursin pranë Teatrit Popullor dhe e fiton atë. Që këtu fillon dhe veprimtaria e tij e gjerë dhe e larmishme artistike.

Për herë të parë interpretoi në vitin 1948 në kome-dinë "Prefekti" të Besim Levonjës në rolin e Shaqir Agës. Luajti përkrah Mihal Popit, Loro Kovaçit, Marie Logorecit. Më pas vazhdoi me role të tjera nga dramaturgjia kombëtare dhe botërore. Më 25 mars 1985, Sandër Prosi ndahet nga jeta ndërsa ishte me xhirimet e filmit "Pranverë e hidhur". Prosi krijoi mbi 85 role në 75 vepra të autorëve tanë, si dhe të autorëve të huaj si Shekspiri, Shileri, Çehovi, Karaxhale, Gorki, Brehti etj.

Interpretoi në rreth 30 filma. Ai është nderuar me titullin e lartë "Artist i Popullit", me Çmime të Republikës dhe urdhra e medalje të tjera. Në 25-vjetorin e vdekjes së aktorit Sandër Prosi, Presidenti i Republikës e nderon me Urdhrin "Nderi i Kombit". Në 24 shkurt 2017, aktori Sandër Prosi u nderua me urdhrin "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" pas vdekjes.

Ka interpretuar në teatër dhe film:

"Cuca e maleve", "Orët e Kremlinit", "Hamleti", "Fytyra e dytë", "Doktori pacient", "Otello", "Makbethi", "Epoka para gjyqit", "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Familja e peshkatarit", "Çatia e të gjithëve", "Revizori", "14 vjeç dhëndër", "Gratë gazmore të Uindsorit", "Rrënjët e thella", "Xhaja Vanja" etj. Pas vitit 1961, rolet e tjera i takojnë kinematografisë në filmat "Debatik", "Detyrë e posaçme" (1963), "Vitet e para" (1965), "Horizonte të hapura" (1968), "Plagë të vjetra" (1968), "Guximtarët" (1970), "Gjurma" (1970), "I teti në Bronz" (1970), "Mëngjese luftime" (1971), "Yjet e netëve të gjata" (1972), "Shtigje luftime" (1973), "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" (1975), "Në fillim të verës" (1976), "Përballimi" (1976), "Fijet që priten" (1977), "Njeriu me top" (1977), "Gjeneral Gramafoni" (1978), "Udha e shkronjave" (1979), "Yje mbi Drin" (1979), "Vajzat me kordele të kuqe" (1980), "Plumba perandorit" (1980), "Plaku dhe hasmi" (1981), "Qortimet e vjeshtës" (1981), "Nëntori i dytë" (1982), "Dora e ngrohtë" (1983), "Kush vdes në këmbë" (1984), etj.

SARË GJERGJI



Sarë Gjergji është i lindur në vitin 1965, në Stubëll të Vitisë. Pas shkollimit të mesëm dhe universitar, aktualisht është doktorant në fushën e shkencave filologjike në Universitetin “Shën Çirili e Metodi” të Shkupit. Është anëtar aktiv i Akademisë Evropiane të Arteve, Paris (Academie Europeen nedes Artes), i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës dhe i shumë asociacioneve kulturore.

Ka botuar një varg veprash poetike:

Golgotë, Ferizaj, 1994; Kontrast ngjyrash, Prometheus, Graz - Prishtinë, 1996; Terapia e vdekjes - requiem për Kosovën?, Ura & Martin Segoni, Gjilan, 2000; Peizazh toke, “Eurorilindja”, Tiranë, 2004; Focnestnis (Zjarr i pashuar, në gjuhën rumune), Bukuresht, 2007; Dashuri e pambarim, T-Kom, Shkup, 2007; dhe Legjenda e tërfilit, “MediaPlusArt”, Prishtinë, 2012. Gjithashtu ka botuar udhërrëfyesin Vitia 2009 (shqip, serbokroatisht e anglisht), Viti, 2009; Të tjerët për veprën letrare të Isak Ahmetit ose letërsia ndryshe e tij (bashkautor me Zef Ahmetin, kritikë letrare), Albanisches Institut, St. Gallen, Zvicër, 2011; Stublla me shkollën e parë shqipe, 1584-1905 (monografi) LSHK, 2014; Stublla (monografi), 2005 (grup autorësh). Ka botuar edhe shumë shkrime nëpër revista e gazeta të ndryshme.

Sarë Gjergji ka marrë edhe disa çmime letrare: Çmimin vjetor për krijimtari, 1992 (Shoqata e Letrarëve të Rinj të Kosovës); Çmimin kombëtar: Imazhi Shqiptar në Arsim (Forumi Imazh&Media), Tiranë, 2014; “Agim Ramadani”, 2003, 2005; “Flaka e Janarit”, 2003, 2007, 2009, 2015; “Muza e Agimit”, 2012, 2014; “Esad Mekuli”, 2012. etj.

Poezia e Sarë Gjergjit është e përfshirë në disa leksikone e antologji brenda e jashtë vendit. Ka publikuar poezi edhe në gjuhën angleze, kurse autorë të ndryshëm kanë dhënë vlerësime për krijimtarinë e tij poetike. Po ashtu ka paraqitur edhe kumtesa në veprimtari të ndryshme shkencore.

Aktualisht është redaktor Faktit shkencor, Prishtinë, kurse ka udhëhequr edhe revistën Identiteti (Prishtinë), Lajmëtarin (Graz), por ishte edhe redaktor përgjegjës i revistës Kalendari letrar (Prishtinë), si dhe organizues i veprimtarive kulturore (“Takimet e Dom Mikelit” etj.).

SEJDI BERISHA



Sejdi (Bajram) Berisha, u lind më 10 qershor 1947. Që në shkollën fillore, filloi të shkruajë poezi, të cilat, së pari i botohen te gazeta “Flaka e Vëllazërimit” të Shkupit e pastaj, te “Pionieri” dhe te “Rilindja për fëmijë”. Nga këtu zë fill edhe zhvillimi i talentit të tij edhe si shkrim-tar edhe si gazetar. Si nxënës i gjimnazit të Pejës bashkëpunon me gazetën studentore “Bota e Re”, kurse që nga viti 1970 bëhet bashkëpunëtor mjaft produktiv i gazetës “Flaka e Vëllazërimit”. Në vitin 1972, punësohet në Radiotelevizionin e Prishtinës, përkatësisht në Radio-Prishtina si korrespondent nga Peja.

Gjatë punës në Radio-Prishtinë ka arritur titullin e “Redaktor i Kategorisë së Parë”. Ka raportuar nga shumë manifestime kulturore, që zhvilloheshin në ish-Jugosllavi. Në ndërkohë, pesë vite ka qenë edhe gazetar-korrespondent i Televizionit të Prishtinës, kurse pas vitit 1980, edhe gazetar i “Rilindjes”. Sejdi Berisha, në nëntor të vitit 1982 nxori numrin e parë të gazetës “Peja” dhe ishte themelues i Radio-Pejës (1981). Në vitin 1982 ishte drejtor i këtij institucioni. Sejdi Berisha është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës dhe i Lidhjes së Gazetarëve të Kosovës.

Të botuara dyzetë e një vepra:

- ”Kombinati i lëkurë-këpucëve në Pejë” (monografi, 1984),
- ”Tronditje” (poezi, 1991),
- ”Çmendia në rreth” (prozë, 1993),
- ”Feniksi” (poezi, 1993),
- ”Simfoni pritjeje” (poezi, 1995),
- ”Zejtarët e Pejës” (monografi, 1995),
- ”Gabim stinësh” (poezi, 1996),
- ”Në cep koha” (poezi, 1997),
- ”Vrasësi i gjumit” (roman, 1999),
- ”Heraldika” (poezi, 2000),
- ”Lumturia e dhembjes” (eseistikë, 2002),
- ”Freskia e pluhurit” (poezi, 2002),
- ”Piramida e ironisë” (eseistikë, 2004),
- ”Plagë në pikturë” (poezi, 2005),
- ”Fjala e gjakut” (poema kushtuar Prekazit, Gllogjanit dhe Koshares-2006),
- ”Shpërputhje kohe” (ese, shkrime kritiko-letrare, vështrime jete, 2006),

- "Kaq shumë vetmi" (poezi të zgjedhura-2007),
 "Dashuro një minutë" (poezi dashurie-2007),
 "Homazhe tek mendja" (eseje-2008),
 "E bukura e rrugëtimit" (këndvështrime letrare-2008),
 "Fjalë e pathënë" (poezi-2009),
 "Zejtarët e Pejës" (monografi-Botimi i Dytë-2010),
 "Kërkoj dhembjen time" (poezi-2011),
 "Mallkimi i heshtjes" (Shkrime refleksive-2011),
 "Teatri i Pejës" (monografi-2012),
 "Vargje të këputura" (poezi-2012),
 "Përtej shkrimit" (Shkrime të plasura, baladë shkrimesh, kujtime, mendime, vlerësime dhe biseda për njeriun, dhe të tjerët për mua) (2013),
 "Gjethet e hirta të zemërimit" (poezi-2014),
 "Në lumë bie shi" (poezi-2015),
 "Konflikti me vetveten" (Ese dhe shkrime të tjera-2016),
 "Gërshetimi krijues dhe urat letrare" (Analiza dhe këndvështrime 2016),
 "Kthim në shtëpinë që nuk ekziston" (Poezi të përkthyer në gjuhën greke-2016-Επιστροφή στο σπίτι που δεν υπάρχει (Ποιήματα),
 "Varrtarët kush do t'i varrosë" (poezi-2017),
 "Zejtarët e Pejës", roli dhe kontributi i tyre në zhvillimin ekonomik dhe kulturor (Monografi)-Botimi i Tretë (2017),
 "Peizazh i jetës sime" (poezi-2018),
 "Njeriu pa vendlindje", libër autobiografik (2019),
 "Ofelia" nuk kthehet më."-Poemë, baladë apo gjerdan ironie- (Poezi-2019),
 "Valsi i kuq" (dramë-1976),
 "Vdekja e bardhë" (monodramë-1985),
 "Misteria" (monodramë-1987), dhe "Obelisku pa adresë" (dramë-2005).

Sejdi Berisha, që nga viti 2002, disa herë ka qenë anëtar i Bordit të Teatrit Profesionist "Istref Begolli" të Pejës, po ashtu, ka qenë anëtar i Këshillit Artistik të Galerisë së Arteve të Qytetit në Pejë dhe për një kohë të shkurtër edhe Kryetar i Bordit të Qendrës për Mirëqenien e Gruas (QMG-së) në Pejë. U nderua me Çmimin "Krijues i dalluar i vitit". Ndërsa, në Poetikën Mbarëkombëtare "Ndue Bytyçi", që u mbajt në Tiranë me 26 gusht 2012, u nderua me Çmimin e Dytë për poezinë më të mirë. Është fitues i Çmimit "Din Mehmeti", në Mitingun e Poezisë në Gjakovë, për librin me poezi, "*Gjethet e hirta të zemërimit*", më 9 maj 2014. etj.

SEVDAI RADOGOSHI



Sevdai Radogoshi u lind në Gjakovë, më 26 shkurt 1958, roli më i njohur i Sevdait është Qumili por ai ka luajtur më shumë se 40 role. Suksesi me i madhi i tij filloj në vitet 90, shumë humorist të tjerë janë bërë të njohur në programet e Sevdai Radogoshit, si Besim Dina e tjerë.

Ai është prezent në mediat të ndryshme si në radio po ashtu edhe në TV stacionet mbarë kombëtare. Ka marrë pjesë në mijëra koncerte në botë. Ka tre vajza dhe një djalë.

Fëmijet e Sevdait kanë luajtur në disa filma të tij. Mirëpo humoret e para në estradë kishte punuar në vitin 1973, për t'u popullarizuar në mesin e viteve 1980-të me "Qumilin" e paharruar.

“Zybaja”: Ska mo plazma e serce merce...

“Zybaja” fillon talljet me taksën 100% ndaj produkteve serbe. Qeveria e Kosovës para disa dite mori vendim, që ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës, të rrisë taksën për 100%.


Barcoletat, dizajnet e produkteve serbe me simbole të shqiptarëve e deri tek videot qesharake, u bënë virale në rrjetet sociale. Këtyre njerëzve që u tallën iu bashkua edhe humoristi i njohur, Sevdai Radogoshi.

"Qumili" mbetet një nga aktorët shqiptar më të pëlqyer. Më shumë se 40 vjet karrierë kanë bërë që aktori nga Gjakova Sevdai Radogoshi, të jetë shumë i dashur e i adhuruar për publikun shqiptar.

Filma dhe pjesë humori:

1. Qumili i paharruar, (1980), 2. Qumili - Treshi Përsheshi, (Humor 1988),
3. Dallandyshe '97, (1997), 4. Goja Kapak vuxhuti Rahat, (1998)
5. Dik Kompozitori, (2000), 6. “8 Marsi”, (2000),
7. Qumili - Gazuzi & Besimi "Gazuzi dance", (Humor 2001),
8. Qumili - Binaki dhe Adelina Ismajli "Ineksioni", (Humor 2001),
9. Gëzuar më Qumilin, (2002), 10. Marsi (2002),
11. Qumili - Uka "autobusi", (Humor 2002),
12. Qumili - Binaki "Dugoja qelë", (Humor 2004),
13. Qumili - "Autoshkolla", (Humor 2004), 14. Sylja del azil, (2005),
15. Sylja dhe Naim haxhiam 16. S'je tue dhanë lopë po çikë o kali,
17. Gjakovari tu ble pastërm, 18. Lyta 'ta...benzinin më uj',
19. Qumil Siki, (Humor), 20. Qumili-Sa i përket, (Humor 3),
21. Qumili - Lyta e marton qikën, 22. A po don me dalë më hupë a?,
23. Mos u gëzo i gëzum mos u idhno o i idhnum, (Humor), etj.

SKËNDER BUÇPAPAJ




Skënder Buçpapaj, u lind më 25 maj 1953, në një fshat të rrethit të Tropojës. Arsimin tetëvjeçar e ka kryer në fshatin e lindjes, arsimin e mesëm në qytetin Bajram Curri, ndërsa studimet e larta për gjuhë e letërsi në Universitetin e Tiranës. Ka kryer studimet mastër në Universitetin e Tiranës në fushën e kritikës letrare. Krijimtarinë e ka filluar që në shkollën tetëvjeçare, kur ka botuar edhe krijimet e para në shtypin për fëmijë. Nga viti 1970 pothuajse në të gjitha të përditshmet dhe periodikët shqiptarë ka botuar poezi, përkthime nga poezia botërore prej italishtes, anglishtes dhe gjermanishtes, shënime për librat, kritika, studime monografike etj. Nga viti 1976 është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Nga viti 1986 deri në vitin 1991 ka qenë redaktor në gazetën e Lidhjes së Shkrimtarëve të Artistëve të Shqipërisë, ku ka mbuluar kryesisht sektorin e kritikës. Në fillim të vitit 1991 ka qenë iniciator dhe bashkëthemelues i Lidhjes së Pavarur të Gazetarëve të Shqipërisë, më vonë Lidhja e Gazetarëve. Në vitin 1991, në dhjetor, emërohet zëvendës drejtor i përgjithshëm i Radiotelevizionit Shqiptar, ndërsa më 1992 drejtor i përgjithshëm i RTSH, detyrë që e kreu deri në gusht të vitit 1995. Nga viti 1998 filloi në gazetën e përditshme "Bota sot", kryeredaktor i së cilës ishte për dhjetë vjet rresht me redaksinë qendrore në Cyrih të Zvicrës. Ka lëvruar pothuaj të gjitha zhanret e shkrimeve publicistike dhe letrare, që nga informacioni, kronika, reportazhi, përshkrimi, analiza, komenti, fejtoni, replika, vëzhgimi, polemika, biseda, intervista etj, si dhe ka realizuar shumë dokumentarë televizivë. Është përfshirë në antologji të ndryshme të poezisë shqipe.

Vëllime poetike: "Zogu i bjeshkës" (1973), "Epikë" (bashkautor, 1979), "Poezi" (1986), "Frika nga Atdheu" (2009).

Studime: "Përmbajtja filozofike dhe morale e poezisë së Fatos Arapit" (1979), "Poetika e simbolikës" (poezia shqipe e Kosovës) (1986), "Zana e Fishtës dhe trillet e saj" (1991).

Eseistikë: "Në vetë të parë Hasan Prishtina, një patraes patriae" (1995), "Këndo, hyjneshë, mëninë e Faik Konicës" (2001). Tekste shkollore (bashkautor), "Historia e letërsisë shqipe", tekst për shkollat e mesme të Republikës së Shqipërisë (1993), "Antologjia e letërsisë shqipe", tekst për shkollat e mesme të Republikës së Shqipërisë (1993), etj.

SKËNDER HOXHA



Skënder R. Hoxha, u lind në vitin 1949, në Jabllanicë (tash Shqiponjë), e Dushkajës, komuna e Gjakovës. Në vendlindje dhe në disa fshatra përreth kryen shkollimin fillor. Në Gjakovë kryen Gjinnazin dhe SHLP-dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe. Në Universitetin e Prishtinës mbaroi Fakultetin Filozofik-dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe. Ndërsa në Universitetin Shtetëror të Tetovës ka mbaruar Studimet Pasuniversitare. Ka gradën shkencore magjistër i letërsisë shqipe dhe gjatë gjithë karrierës, deri kur u pensionua, punoi profesor i lëndës Gjuhë dhe Letërsi Shqipe. Skënder Hoxha dha kontribut të pamohueshëm edhe në sferën e shkencës së gjuhësisë, sidomos në atë të onomastikës. Kështu, kontributi i tij shtrihet në shumë fusha.

Shkroi dhe shkruan poezi për të rritur e për fëmijë, kritika letrare, studime shkencore, monografi, shkrime publicistike, etj, me rreth 30 vepra gjinish të ndryshme të botuara.

Vepra letrare:

- “Pëllumbi në fluturim” (poezi), Pejë, 1990,
- “Kalorësit e mortit” (poezi), Prishtinë, 1993,
- “Bilbili i Dushkajës” (poezi për fëmijë), Pejë, 1995,
- “Dy akte të dramës së pakryer” (poezi), Pejë, 1997,
- “Vjersha dhe poema” (poezi), Pejë, 2004,
- “Poemë e dhimbjes krenare” (poezi), Pejë, 2007,
- “Në mes meje e dhimbjes”, (poezi), Pejë, 2010,
- “Këndimi i muzave” (poezi, haiku dhe sibila, shqip-anglisht), Tiranë, 2011,
- “Udhëkryqet e Fatamorganës” (poezi, shqip-rumanisht), Bukuresht, 2012,
- “Lirikë për këngë harrimi” (poezi), Cërmjan, 2015.

Vepra studimore:

- “Kontribut për studimin e toponimisë së Dushkajës (I)”, Prishtinë, 1992,
- “Kontribut për studimin e toponimisë së Dushkajës (II)”, Pejë, 2000.
- “Toponimia e Dushkajës”, Gjakovë, 2007,
- “Fitonimia dhe zoonimia e Dushkajës”, Pejë, 2010,
- “Prozat e dramatizuara të Azem Shkreliit-shtresime gjuhësore, letrare e stilistike”, Pejë, 2016.

Vepra publicistike:

- “Tridhjetë vjet punë të shkollës së mesme - “Shaban Spahija” të Pejës” (monografi), Pejë, 2002, edhe 10 vepra tjera, si dhe vepra historike...

SKËNDER KODRA



Prof. Dr. Skënder Kodra, është i lindur më 13.05.1946, në Istog të Kosovës, ku edhe kreu shkollën fillore. Shkollën e mesme e vazhdoi në Gjakovë dhe Pejë. Autoritetet qeveritare serbe e burgosën për motive patriotike. Në shumë raste kaloi nëpër burgjet e Prishtinës, Gjakovës, Ferizajt, Suharekës në Ce Zenë e Beogradit dhe veçanërisht, në burgun e Pejës.

Më 1969 emigroi në Itali e pas një viti në SHBA, ku edhe mori statusin e refugjatit politik. Në SHBA më 1980 mbaron shkollën e mesme.

Më 1986 përfundon studimet e larta në Universitetin “Mercy College”, në degën e psikologjisë dhe pas një viti kreu studimet pasuniversitare në “Long Island University” dhe laureohet me titullin Master degry. Në vitin 1991 mbron doktoratën me temën “Shkaqet që çojnë në skizofreni” dhe merr titullin më të lartë shkencor në SHBA Ph.D. Më tej u specializua në një profil më të ngushtë në fushën e Psikologjisë Klinike.

Veprimtaria e tij është e larmishme si profesor, psikolog e shkencëtar. Ligjëron në tri universitete me studentë nga e gjithë bota. Ai ka një veprimtari të begatë, veçanërisht në Psikologjinë klinike, të cilën e ka pasuruar edhe me përvojën e madhe në spitalet ushtarake të psikiatrisë në New York, pasi që, aty kishte punuar për dhjetë vjet me pacientë të Luftës së Dytë Botërore dhe të Luftës së Vietnamit.

Diturinë dhe përvojën e tij si psikolog dhe shkencëtar, Prof. Dr. Skënder Kodra e ka përcjellë në tetë libra si: “*Evoluimi i Trurit Dje, Sot dhe Nesër*” Library of Congress (June 11. 2001), “*Definition of personality*”, Tiranë (Library of Congress (2003), “*Drugs and its Impact*”, Tirane Library of Congress (June, 11.2004), “*Road Map Opportunities in Cilinical Psychology*”, Tiranë Library of Congress (June 12.2006) Library of Congress 101 Independence Ave, S.E. Uashington D.C. 20559-6000.

I brumosur me ndjenja të larta atdhedashurie dhe si intelektual i përgatitur në SHBA, Skënder Kodra ka dhënë një kontribut të çmuar edhe për popullin shqiptar.

Në vitin 1995 ai themeloi Akademinë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Arteve me qendër në New York dhe vazhdon të jetë aktiv si kryetar i kësaj Akademie.

Me ndryshimet demokratike në Shqipëri, Prof. Dr. Skënder Kodra vazhdoi të kontribuojë edhe në dheun amë.

Ai punoi dy vjet në Tiranë si klinikist, pranë Klinikës psikiatrike të Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Tiranës, ku përgatiti dhe ligjëroi leksione të ndryshme.

Me kënaqësi ai i dhuroi kësaj klinike një bibliotekë të pasur me literaturë masive të psikiatrisë klinike amerikane.

Gjatë kësaj kohe në Radio Tirana ai mbajti një rubrikë të përjavshme me temë nga psikiatria.

Në këtë periudhë, Prof. Dr. Skënder Kodra viziton sërish vendlindjen e tij Kosovën, ku zhvilloi një veprimtari të dendur shkencore dhe patriotike, aq sa siç thoshin dhe vendasit, klinika e tij u kthye në një istikam lufte. Pushtuesit serbë ia bastisën klinikën dhe e arrestuan për ta detyruar të pajisej me dokumente serbe, por zoti Skënder Kodra nuk pranoi dhe largohet i detyruar nga atdheu i tij.

Në verën e vitit 1999, të Luftës në Kosovë, Prof. Dr. Skënder Kodra u shkoi në ndihmë të dëbuarve kosovarë, në kampet e shumta në Shqipëri, si dhe në spitalin Ushtarak në Tiranë. Djali i tij Isai, ushtarak dhe i lindur në SHBA, u radhit në radhët e UÇK-së në Kosovë, ashtu si dhe shumë të tjerë nga të afërmit e familjes Kodra.

Personaliteti i Prof. Dr. Skënder Kodra është i njohur në SHBA, në vende të ndryshme të Evropës dhe në të gjitha trojet shqiptare.


Ai ka qenë këshilltar pranë Ministrisë së Shëndetësisë në Shtetin e New Yorkut, është anëtar i Shoqatës së Doktorëve në Shtetin e New Yorkut, anëtar i Shoqatës të Sëmundjeve Psikike “Sigmund Frojd” të Austrisë, nënkryetar i Akademisë së Intelektualëve Shqiptarë të Shkencës dhe Artit në Kosovë, anëtar i Shoqatës së Psikiatërve në Shqipëri, etj.

Prof. Dr. Skënder Kodra vazhdon të jetë aktiv si mjek, si pedagog, dhe si shkencëtar. *“Në çdo vend të botës, akademikët orientojnë vendin dhe udhën ku duhet të shkelë një komb i caktuar.”* - kështu përgjigjet me një zë të shtruar profesor Skënder Kodra, një nga psikiatërët klinikë më të shquar shqiptarë i cili jep mësim në tre Universitete në Shtetet e Bashkuara.

Ai vazhdon të publikojë libra dhe studime shkencore në revistën “Dituria”, organ i Akademisë Shqiptaro-Amerikane me qendër në New York, Akademi të cilën e drejton me pasion dhe profesionalizëm, si dhe në shumë revista e gazeta prestigjioze në SHBA dhe Shqipëri.

Figura poliedrike e Prof. Dr. Skënder Kodra, është kthyer në një simbol për komunitetin shqiptar në SHBA, Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni, si një njeri me energji të pashtershme humane e patriotike.

SKËNDER RIZAJ



Prof. Skender Rizaj, u lind në Pejë më 14 mars të vitit 1930. Pasi që rrjedh nga një familje autoritare hoxhallarësh të asaj ane, ata njihnin mirë gjuhët orientale, arabisht, persisht, osmanishte. Në Shkup e ka kryer Fakultetit Filozofik-Dega e Historisë, (1956), në Beograd provimin shtetëror për profesor të gjimnazit, (1960), në Sarajevë studimet pasuniversitare dhe doktoratën, (1965). Në moshë 17-vjeçare angazhohet në ilegalitet, ku mbante pseudonimin "Fishkëllima" dhe i takonte organizatës ilegale "Besa Kombëtare". Gjykata e Qarkut në Prizren në nëntor të vitit 1946 (si nxënës) i shqiptoi dënimin me 1 vit burgim të rëndë, në bazë të nenit 3/1 të ligjeve të atëhershme në fuqi (Shih: Arkivi i Kosovës, Fondi: Gjykata e Qarkut në Prizren, Lënda Penalja nr. 20).

Ndër kontributet më të çmueshme të Skënder Rizajt, veçojmë:

"Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumente angleze", Prishtinë, 1978,

"Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII- Administrimi, ekonomia, shoqëria dhe lëvizjet popullore", Prishtinë, 1982,

"Historia e Përgjithshme-koha e re (1453-1789)", Prishtinë, 1985, (tekst universitar).

"Burimet osmane nga shekulli XV deri në shekullin XVIII për banoret e Deçanit dhe të rrethinës" (kumtese),

Simpozium Ndërkombëtar me temë "Deçani dhe arti në shekullin XIV në botën bizantine" (Beograd dhe Deçan 10-15 shtator 1985), (organizuar nga Akademia Serbe e Shkencave dhe Arteve si dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës).

Publikimi i kësaj kumtese do t'i kushtoj me largimin nga puna në universitet, por jo edhe me largimin nga shkenca. Prof. Skënder Rizaj assesi nuk do të demoralizohet, por përkundrazi ai do të vazhdojë edhe më intensivisht të merret me punën e vet kërkimore shkencore në fushën e historiografisë shqiptare, ku pasuan librat studimor:

"Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1877-1885)", dy vëllime-dokumente/"The Albanian League of Prizren" (1877-1885), Prizren, 1998,

"E drejta historike e shqiptarëve për vetëvendosje", "The Albanians' Historical Right to Self-Determination", Prishtinë, 2005,

"Falsifikimet e historiografisë Serbe", "The Falsifications of Serbian Historiography", Prishtinë, 2006.

SKËNDER TAJAJ (1947-2017)



Skënder Tafaj, u lind më 8 maj 1947, në fshatin Isniq nga një familje bujare dhe patriotike, e dëshmuar për vlera të mirëfillta kombëtare.

Shkollën fillore, Skënder Tafaj e kreu në vendlindjen e tij në Isniq për të vazhduar me Shkollën normale “Ali Hadri “ në Pejë . SHLP drejtimin e Dramaturgjisë e kreu në Universitetin e Prishtinës. Pas përfundimit të studimeve u angazhua në Teatrin Kombëtar në Prishtinë 1969, ku punoi deri në vitin 1989. Ai në atë kohë u përndjek nga organet serbe për aktivitetet e tij ilegale për krijimin e shtetit të pavarur të Republikës së Kosovës.

Skënder Tafaj u detyrua të emigroi në Zvicër. Ai qëndroi deri në këto vitet e fundit. Bëri përpjekje të rikthehet në Teatrin, ku kishte nisur karrierën e tij, por nuk arriti ta merrte veten, sado që shumë regjisorë dhe aktorë patën mirëkuptim për të. Në Nëntor të vitit 2012, Skënder Tafaj u angazhua në shfaqjen e Haqif Mulliqit, ku luajti me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë në Tirane. Talenti i tij, bëri që të renditet ndër aktorët më të mëdhenj të Kosovës.

Qindra role të realizuara mrekullisht rangojnë mbi supet e tij nëpër në dërrasat e këtij teatri, kryesisht role të karakterit kombëtarë. Në shumicën e tyre barte rolet kryesore: Zenitin e tij e arriti më dramën “Vërbimi i Samsonit”. “Izrael e Filistine” të Nolit, ku u nderua edhe më çmimet më të larta. Duke parë talentin e tij të rrallë, regjisorët e kohës e angazhojnë edhe në dhjetëra filma të cilët i finalizojë kinematografia e Kosovës.

Rolet e tij në filmat artistik:

"Njeriu prej dheut"
"Tre vetë kapërcejnë malin",
"Lepuri më pesë këmbë",
"Si të vdiset".

Zhvillimet politike, demonstratat dhe ngjarjet e viteve të 80-ta, e rëndojnë gjendjen në Teatrin kombëtar i cili cilësohej si vatër e nacionalizmit. Skënder Tafajn shumë role tjera e ngritën në pedestalin më të lartë prej artisti. Artisti i madh Skënder Tafaj, vendosi të mos e ndalë punën.

Në Isniq, atëbotë, ishte aktive SHKA “Mehmet Riza”, kështu që në gjirin e saj funksiononte edhe trupa e teatrit.

Në vitin 1982, në regji të Skënder Tafajt, inskenohet drama “Hakmarrja” e Jusuf Kelmendit. etj. Skënder Tafaj ndërroi jetë me 4 gusht të vitit 2017.

SKËNDER TEMALI



Skënder Temali, u lind në Shkodër më 30 korrik 1946, në një familje të vjetër shkodrane. Ka kryer Universitetin "Luigj Gurakuqi", në degën gjuhë shqipe-letërsi dhe për 15 vjet (1966-1981), punoi gazetar në Radio Shkodra, revistën "10 korriku" e gazetën "Jeta e re", ku ka transmetuar e botuar me qindra artikuj problemorë, reportazhe letrare, përshkrime, portrete, skica, etj. Prej një çerek shekulli, drejtues e mësues në shkolla të mesme të vendlindjes së tij, ku prej 20 vitesh e aktualisht jep lëndën e gjuhës shqipe e letërsisë në shkollën teknike 5-vjeçare pyjore të Shkodrës. Ka botuar cikle poetike e tregime që gjimnazist në almanakët letrarë "Shkodra", në shtypin letrar të kohës "Zëri i rinisë", "Drita", "nëntori" e revistat për fëmijë.

Disa nga këto krijime kanë zënë vend edhe në botime të zgjedhura dhe janë vlerësuar me çmime lokale e kombëtare.

Në vitin 2001, në konkursin e 7-të ndërkombëtar, të shpallur nga shoqata e artistëve dhe shkrimtarëve "Cristalide" në Padova të Italisë, mes 462 shkrimtarëve nga Italia e shumë shtete të botës, ai u nderua me çmimin special të jurisë, me tregimin "Këpucët e turpit".

Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë që nga viti 1967 si dhe Ambasador i Paqes e anëtar i Komitetit Drejtues të Federatës Ndërkombëtare të Paqes. Është autor i 12 librave dhe redaktor i dhjetëra librave artistikë të shkrimtarëve të rinj.

Veprat e botuara:

- "Këngë cigane" (vjersha e poema), 1971,
- "Kjo ndodhi në Lis" (roman), 1982,
- "Ballo në mbrëmjen e maturës" (novela), 2001,
- "Ishte një lajthishte" (poemë për fëmijë), 2001,
- "Këpucët e turpit" (tregime), 2002,
- "Nesër do të them mirëmengjes", (novelë) 2002,
- "Studentja e Bolonjes" (novelë) 2004,
- "Gjuha shqipe" (tekst alternativ mësimor) me bashkautor, 2003,
- "Shtëpia pa pasqyra" (tregime) 2006,
- "Askushi" (roman, botuar në Maqedoni), 2006,
- "Tre shokët" (vjersha e poema për fëmijë), 2007,
- "Lirika të hershme dhe të vona", 2009, etj.

SKËNDER ZOGAJ



Skënder Zogaj, është lindur më 23.01.1950, në katundin Lladroc të komunës së Malishevës. Shkollën fillore dhe gjimnazin i ka mbaruar në Prizren, ndërsa studimet për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe në Prishtinë dhe në Tiranë. Punën e ka nisur si mësimdhënës i gjuhës shqipe në shkollën tetëvjeçare të Carrallukës dhe në Gjimnazin “Naim Frashëri” të Malishevës (1972-1974). Në shtator të vitit 1974 kalon në Prishtinë dhe i përkushtohet gazetarisë: redaktor përgjegjës në gazetën e studentëve “Bota e re”, (1974-1978), gazetar e redaktor në gazetën “Rilindja” në Prishtinë dhe në Tiranë (1987-1997).

Gjatë viteve 1993-1995 ka përfaqësuar Zyrën e Republikës së Kosovës në Shqipëri, redaktor në “Revista ushtarake” të FARK-ut e njëkohësisht edhe Këshilltar për informim i kolonel Ahmet Krasniqit, ministër i Mbrojtjes dhe shef i Shtabit të Përgjithshëm të FARK-ut në Tiranë (1997-98). Pas përfundimit të luftës kthehet në Kosovë dhe vazhdon punën e gazetarit në gazetën “Rilindja”, mirëpo, pas dy muajsh jep dorëheqje, e lëshon “Rilindjen” dhe shkon në gazetën “Bota sot” në Prishtinë, ku caktohet redaktor i kulturës (1999-2000). Skënder Zogaj është ndër themeluesit e parë të LDK-së dhe bartës i shumë detyrave me përgjegjësi të kësaj partie në nivel lokal dhe qendror: Themelues i Degës së Parë të LDK-së në Kosovë (Degës së LDK-së në Fushë Kosovë) dhe kryetari i parë i saj (1990-93), Krahas punës gazetarisë dhe angazhimeve politike, intensivisht është marrë edhe me krijimtari letrare dhe publicistikë.

Veprat e botuara:

“Zogu i ekspozitës”-poezi për të rritur, “Rilindja”, Prishtinë 1983,
“Merrmë vëlla përdore”-vjersha për fëmijë, “Naim Frashëri”, Tiranë 1994,
“Ora e qoftëlargut”-poezi për të rritur, Tiranë 1996,
“Adresa e dallëndyshes”-vjersha për fëmijë, 1999,
“Jusuf Uka Bregu”-monografi, Prishtinë, 2004,
“Mali i tejdukshëm”-poezi për të rritur, Prishtinë, 2005,
“Puthjet e puhisë”-vjersha për fëmijë, Prishtinë, 2007,
“Lacrima dureri” (Loti i dhembjes), poezi në gjuhën rumune, Bukuresht, 2011 etj. Krijimet poetike të Zogajt janë përkthyer dhe botuar në shumë gjuhë. Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës dhe i Shoqatës Mbarëkombëtare të Shkrimtarëve për Fëmijë dhe të Rinj, me seli në Tiranë.

SOKOL PLAKOLLI



Sokol Plakolli, është i lindur në fshatin Letanc komuna e Besianës. Shkollën fillore e kreu në fshatin e lindjes, ndërsa të mesmen në gjimnazin e përgjithshëm "Aleksandër Xhuvani" në Podujevë. Aktualisht jeton në Prishtinë. Në vitin 1997-1998 u regjistrua në Fakultetin Juridik dega e Kriminalistikës Prishtinë. Në vitin 2001 u regjistrua në kolegjin privat, Akademia e Arteve Prishtinë, në degën e aktrimit, ku edhe diplomoi në vitin 2003. Gjatë viteve 2011-2013 studioi dhe diplomoi në studimet post diplomike në fushën e regjisë teatrale. Ai themeloi asociacionin "Lista e Zezë", në vitin 2013. Është autor i disa dramave dhe skenarëve, ndër të cilat po veçojmë: "Karrigia e nxehtë", dhe librin me poezi "Sytë e Shpirtit".

Shfaqjet e realizuara si regjisor:

"Komedia e keqkuptimeve", "Tregtari i Venedikut", "Heroina", "Kush po i sjell mickojat në Kosovë", "Droga vret", "Ëndërrimtarët e harruar", "Raketa", "Dy ditëlindje", "Semafori i prishur", "Kompania e Riciklimit", "Fundi i Fillimit", etj. Sokol Plakolli u shpërblye në "Festivalin e teatrove shqiptarë në Dibër" me çmimin aktori më i mirë i festivalit.

Kritika-Vështrime-Opinione:

Është autor i dhjetëra kritikave dhe vështrimeve në lëmin e teatrit, ndër të cilët po veçojmë: "E bukura e ka vulën e përjetësisë", "Aktorja ideale", "Monstrumët e birucave të djallit e pushtuan sërish tempullin e quajtur teatër", "Ku i ka rrënjët plagjiatura".

Sokol Plakolli protestoi i vetëm edhe kundër shfaqjes "Bordel Ballkan" (Shfaqje e cila fyen vlerat e luftës së shenjtë të UÇK-së dhe vlerat tona kombëtare).

Çmimet-Vlerësimet dhe Kritikat:

"Tregimi Zoologjik", Festivali SKAMPA Elbasan, (Shfaqje Inovative),
"Tregimi Zoologjik", (Pjesëmarrëse në festivalin internacional CIFET, Kairo Egjipt),
"Laokoonti", Festivali MONOAKT, (Çmimi i mediave),
"Shtëpi Kukulle", Festivali monodramës Korçë, (Aktorja më e mirë),
"Shtëpi Kukulle" Festivali, Podujevë, (Regjia më e mirë),
"Kanuja", Festivali "Etno FEST" (Çmimi Aktori më i mirë)
"Karrigia e nxehtë", Festivali i teatrit shqiptarë Maqedoni (Aktori më i mirë).

SOTIR ANDONI (1925-2013)



Sotir Andoni, është i lindur në vitin 1925, në Ziçisht të Devollit. Mësimet e para i mori në vendlindje, më pas vazhdoi shkollën qytetse dhe teknike në Korçë. Në vitin 1943, si shumë studentë, ndërpreu studimet, sepse u bashkua me rezistencën antifashiste.

Ai ka filluar të shkruajë qysh në radhët e partizanëve. Pas lufte punoi si Drejtor i Shtëpisë së Kulturës në Korçë dhe kryeredaktor i gazetës lokale "Përpara".

Në verë të vitit 1948, u arrestua për "agjitacion - propagandë dhe tentativë arratisje" dhe dënohet me 5 vjet burg.

Pas lirimit nga burgu, ai u dënua gjithë jetën me punë të rëndomta. I hoqën të drejtën e krijimtarisë, e lanë pa punë, "e dëbuan" nga antologjitë, gjithfarësoj. Por ai megjithatë shkëlqeu me tregimet dhe novelat e rralla, plot jetë e të vërteta.

Periudhën pas viteve 90, Sotiri e jetoj aktivisht, duke u zgjedhur anëtar i Këshillit Bashkiak të Korçës. Për disa vjet kryesoi Degën e Korçës të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë.


Pas emigrimit në SHBA me 1997, apartamenti i tij në "Illyrian Gardens", u bë studioja ku vazhdoi krijimtarinë letrare dhe publicistikë.

Shumë prej botimeve të tij janë vlerësuar me çmime letrare Kombëtare. Në vitin 2004 është shpallur "Qytetar nderi" i qytetit të Korçës. Ndërroi jetë më 19 korrik 2013 në Worcester-SHBA.

Veprat:

"Maleve në Shenendre", tregime, "Lufta partizane", tregime,
"Tregime nga Morava", tregime, "Dasme e çuditshme", tregime,
"Kur merrnim fluturim", tregime,
"Shënime të shkruara natën", roman,
"Guguçja", tregime, "I vogli e mund të madhin", tregime,
"Tregime nga Voskopoja", tregime,
"Trokthet e kuajve neper natë", tregime, "Fletë të kuqe qershie", tregime,
"I fundmi i kavalioteve", tregime, "Tregime të zgjedhura", tregime,
"Hëna kishte marrë tatëpjetën", tregime,
"Hije, flakë dhe dritë", tregime,
"Pranvera e madhe", tregime, "Milingonat e verdha", tregime,
"Tri novela", novela, "Kandili i shuar", roman,
"Kohë e largët", skenar filmi. etj.

SULEJMAN ABAZI



Prof. Dr. Sulejman Abazi (Neshaj), u lind në qytetin e Vlorës, më 7 maj 1954.

Shkollën e mesme Ushtarake të përgjithshme më Tiranë (1969-1972).

Arsimin e lartë e kreu në Akademinë Ushtarake “Skënderbej”, Tiranë (1972).

Titullin Oficer e mori në Fakultetin Gjitharmësh (26 qershor 1976).

Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura e bëri në periudhën shkollore nga viti 1985-1986.

Ka qenë Komandant i ishullit të Sazanit, 3 korrik 1986-3 korrik 1992. Ka gradën ushtarake gjeneral dhe është diplomuar në Kursin e Lartë të Shtatmadhorisë.

Mban titullin “Doktor i Shkencave në Psikologji”. Është autor i disa librave të botuara dhe është “Ambasador i Paqes”. Ai ka kryer Kursin e Lartë të Shtatmadhorisë pranë SHPFA (Master) (1988-1989) si dhe kursin e Drejtimit të Brendshëm që e kreu në Akademinë e Bundesverit, Berlin, Gjermani (2001). Ishte pjesëmarrës në luftën për çlirimin e Kosovës.

Kontributi shkencor:


- “Hapësira social psikologjike në Forcat e Armatosura”, Tiranë 1999,
- “Psikologjia e ndryshimit në Forcat e Armatosura të RSH”, Tiranë 2001,
- “Psikologjia e luftës kundër luftës”, Tiranë, 2003,
- “Psikologjia e luftës kundër luftës”, Tiranë, 2003,
- “Strategjia e Sigurisë në Filozofinë e Bashkimit Kombëtar” Tiranë 2004,
- “Kombi Shqiptar në Udhëkryq” Botuese “Arbëria”, Tiranë 2005,
- “Çamëria, rikthimi tek lavdia e etërve të dikurshëm”, Tiranë 2007,
- “Psikologjia në Drejtim” Tiranë 2007,
- “Çështja Çame në Strategjinë tonë Kombëtare”, Prishtinë, 2012,
- “Sazani–Ishulli i Perëndive”, Tiranë 2015,
- “Mbi Edukimin Qytetar - Adoleshenca”, (bashkautorë) Tiranë 2017,

Abazi ishte pjesëmarrës në nëntë simpoziume shkencore në Republikën e Shqipërisë, Kosovë, Mali i Zi dhe Maqedoni.

I ka të botuar mbi 300 komente, analiza, speciale në publicistikë, në shtypin e ditës dhe revista shkencore.

Është redaktor shkencor dhe redaktor i 12 botimeve, materialeve shkencore të nivelit universitar dhe autor i 7 parathënieve të librave të autorëve të ndryshëm.

SYLEJMAN LOKAJ (1933-2018)



Sylejman Lokaj, u lind më 28 qershor 1934, në fshatin Lëbushë të komunës së Deçanit dhe vdiq më 3 Gusht të vitit 2018 në Gjakovë.

Shkollën fillore progjimnazin e kreu në Strelc të Epërm dhe në Isniq, komuna e Deçanit.

Shkollën e mesme të artit figurativ e kreu në Pejë, ndërsa Shkollën e Lartë Pedagogjike, dega e Arteve figurative i kreu në Prishtinë. Në vitet 1955-1964 punoi në arsim, ndërsa prej vitit 1964 deri më 1976 punoi si aktor në Teatrin e Kombësive në Shkup.

Prej vitit 1976-1992, kur doli në pension, punoi në Teatrin popullor të Gjakovës.

Pos ekspozitave individuale, ka marrë pjesë edhe në shumë ekspozita kolektive. Pos roleve të shumta teatrore, ka luajtur edhe shumë role filmike e televizive.

Sylejman Lokaj ka qenë mjaftë aktiv edhe me studentet e Universitetit të Prishtinës, Shkollat e Larta Pedagogjike dhe nxënësit e shumë shkollave të mesme. Sukseset e tij janë ngushtë të lidhura me përvojën e fituar nga dyzet regjisor e kritik të njohur të botës shqiptarë e të tjerë. Më së shumti ka mësuar nga regjisori i ndjerë Kujtim Spahi i vogëli, i cili gjatë vitit 1972 në Shkup bëri regjinë e komedisë “Karnevalet e Korçës” të Spiro Çemorës.


Ky aktor i mirënjohur në vjetet e fundit, qysh se patë dalë në pension me të madhe e ka ndihmua amatorizmin në komunat e Deçanit, të Gjakovës, të Prizrenit, të Istogut, të Klinës, të Shkupit, të Tetovës, të Shqipërisë e vende të tjera.

Sylejman Lokaj i ndihmoi me shume së dyzet student pa asnjë kompensim të Universitetit të Prishtinës që t'i kryejnë me sukses provimet e diplomës në drejtimin e Teatrit skenik.

Ky dhe shumë shembuj të tjerë flasin së këto aktivitete të pa ndërprera në Teatrin profesional dhe atë të amatorizmit mirë tregojnë se ky regjisor, ky aktor, ky piktor, ky aktivist dhe humanist i vyeshëm deri në fund të jetës së tij në asnjë moment nuk u largua nga aktivitetet e skenën teatrore. Në vitet e fundit Sylejman Lokaj punoi në nxjerrjen e një vepre prej pesëmijë faqesh me titullin “Mitologjia-dëshmia e parë e gjuhës shqipe”, duke filluar që nga koha e pellazge.

Aktroi Sulejman Lokaj luajti në filmin: "Kur pranvera vonohet" (1980), "Anglezët e largët" (2017), "Lufta është e gjatë" (2010) etj.

SYLË TAHIRSYLAJ



Prof. Dr. Sylë Ramë Tahirsylaj, u lind në Isniq të Deçanit, më 15 gusht 1949. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa Shkollën e Mesme Teknike e kreu në Prishtinë në vitin 1968. Studimet për fizikë i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore (FSHMN) në Universitetin e Prishtinës në vitin 1976. Studimet pasuniversitare i filloi në Fakultetin e Fizikës Teknike të Universitetit e Beogradit, dhe i përfundoi për Fizikë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës. Tezën e doktoratës e mbrojti në vitin 1996, në të njëjtin universitet, nga fusha e Fizikës së Atmosferës-Meteorologjisë fizike. Në vitin 1997 u punësua si pedagog i fizikës, në Fakultetin e Bujqësisë në Universitetin e Prishtinës.

Ka qenë drejtor i Institutit hidrometeorologjik të Kosovës (1999-2013), si dhe profesor i parë nga Kosova në Organizatën Botërore të Meteorologjisë (WMO) dhe CIMO, etj.

Pushtetarët serb, që ishin instaluar dhunshëm në Entin Meteorologjik të KSAK, e larguan profesorin dhe shkencëtarin Sylë Tahirsylajn me studiues tjerë që punonin në Entin Meteorologjik të KSAK (1990). Pas largimit nga puna profesor Tahirsylaj u punësua në arsim si dhe i vazhdoi studimet pasuniversitare të fizikës në Tiranë.

Pas përfundimit të luftës në vitin 1999, Sylë Tahirsylaj, kthehet dhe emërohet drejtor në Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës (IHM).

Fill pas kthimit në IHM, për shkaqe dhe rrethana të panjohura digjet më qëllim i tërë dokumentacioni meteorologjik, i cili datonte nga Vjetari i parë i vitit 1925 e deri në çlirimin e tij nga pushtuesi serb në vitin 1999.

Drejtori i Institutit Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK), në tetor të vitit 2013 dha dorëheqje në favor të vazhdimin të punës akademike në Universitetin e Prishtinës.

Si një ndër institucionet e para të Kosovës të rikrijuara pas luftës, IHMK nën drejtimin e Prof. Dr. Sylë Tahirsylaj, ka luajtur rol të rëndësishëm në ndërtimin e shtetit të ri, duke kryer detyrat dhe përgjegjësitë ndaj institucioneve shtetërore dhe kërkesave të qytetarëve.

Në ngritjen e sistemit të monitorimit, Sylë Tahirsylaj ka zhvilluar edhe rrjetin hidrometrik të Kosovës, që aktualisht ka 22 stacione që bëjnë matjen e nivelit dhe sasisë së ujërave, rrjetin e monitorimit të cilësisë së ajrit

dhe pajisjen e laboratorit me mjetet më moderne për analizat e cilësisë së ujërave, tokës dhe ajrit.

Falë profesor Tahirsylaj, është afirmuar puna shkencore në IHMK në skenën ndërkombëtare si dhe është bërë anëtarësimi i këtij institucion (IHMK-së) në Organizatat Ndërkombëtare të meteorologjisë, si dhe është bërë certifikimi i tij në "EUMETSTAT".

Botimet:

-Tahirsylaj S. Punimi; “desertacionit of protection against hail and hail clouds forming in Kosovo 1987-1990”, Tirana 1996.

-Tahirsylaj S. “system and the effects of anti- hail protection in Kosovo”, Bulletin of the Faculty of Sciences in Tirana, 1997.

-Tahirsylaj S. “The impact of the Argjenit iodide in the of Mathematics and Natural Sciences” Tirana, 1999.

-Tahirsylaj S. etc. State of Polarization of the ligh Pasing through two uniaxial crystal plates, Bulgarian Journal of Physics, Sofia, 2000.

-Tahirsylaj S. “Menagment Resource water, Soil and aer in Kosovo. Bulletin of the World Organization of globalization issue of natural resources, Prague, 2002.

-Tahirsylaj S. Shala A. "Natural environmental disturbances from 18 Sitnica River . 01 . until 21.02.2003", Dardanica Scence Pristina, 2003.

-Tahirsylaj S. etc. Depedence of the Azimuth of the Eliptic on the Thickness of Plates, After the Pasing of the Linearly Polarozoid TW light through uniaxial Crystal Plane – Parallel Plates, sent to Japan edition, 2004.

-Tahirsylaj S. Shala A. "Pollution of surface water by the Kosovo Basin (2000-2003)", Dardania scence number 4, Pristina, 2004.

-Tahirsylaj S. Shala A.. "Pollution of surface water in the basin of the White Drin April-August 2004", Published in the journal magazine "ACOUA" Miliniumi of Peja, 2004.


-Avdullahu S. S. Tahirsylaj, Fejza I. A. Syla, "Water Resources in Kosovo" s Bilten of Balwois, Ohrid, 2004.

-Syla A. J.Abraham. S.Tahirsylaj; Air pollution particles from suspenduarta in the Mitrovica region, technologists and Bulletin of Kosovo, Pristina - Kosovo, 2005.

-Tahirsylaj S. Krasniqi Sh . "Monitoring of water resources in Kosovo", REC, Bulletin17, Pristina, 2005.

-Tahirsylaj S, "The use of wind power and renewable sources like the sun in Kosovo" Bulletin of the Ministry of Energy and Mines, Pristina, 2005...

SHABAN BAKSI



Shaban Baksi, u lind më 26. korrik 1950, në fshatin Baks të Skenderajt. Shaban Baksi pas shkollës fillore vazhdoi shkollën normale në Prizren, në vitin 1965. Në vitin 1972 Shaban Baksi erdhi në Prishtinë dhe u inkuadrua në Shoqërinë Kulturore-Artistike "Ramiz Sadiku". Në vitin 1974, Shaban Baksi u inkuadrua në Shoqërinë Kulturore-Artistike "KOSOVA" të Prishtinës, ku edhe u zgjodh udhëheqës i seksionit të folklorit. Shabani jo vetëm në shoqërinë "Kosova", por mori pjesë edhe në shumë Shoqëri Kulturore-Artistike tjera, si në "Shotë Galica" të Drenasit, në Ansamblin shtetëror "SHOTA" të Prishtinës, në Shoqërinë Kulturore Artistikë "Hasan Prishtina" të Bardhoshit. Ishte edhe këngëtar i muzikës popullore në orkestrën e Radio Prishtinës. Ai në vitin 1975 u inkuadrua në Radio Prishtinë në programin e dytë të Radios. Këngët e Shabanit në atë kohë kaluan pastaj edhe në valët e Radio Shkupit, Radio Tiranës, Radio Kukësit, Radio Gjilanit e tjera. Shaban Baksi nuk pushoi së kënduari. dhe së krijuari tekste këngësh, melodi të reja për dashamirët, adhuruesit e shumë të këngëve të tij, siç janë këngët: "Tash përgjigjen po ta kthej", "Tash kaluan plot tri pranvera", "Ah, moj vajzë me njat trup si bolla", "Qifteslisë me i ra u mësova", "Si mbarë vendit mbas çlirimit", "Janë ulun do trima nën hije të blinit", "Këngë për Mic Sokolin", "Marama një kafe", etj. Është kryetar dhe udhëheqës artistik i ShKA, "Qamilit të Vogël". Shabani është autor i 483 këngëve si dhe është autor i 16 librave.

Veprat:

1. "Këngë për dëshmoret e kombit", 2006, 2. "Ju kujtoj me këngë", 2007, 3. "Biografi për Qamilin e Vogël", -2007, 4. "Për të gjithë nga pak"-2004, 5. "Përmbledhje këngësh folklorike"-2006, 6. "Përmbledhje këngësh popullore"-2006, 7. "Monografi për SH.K.A " Qamili i Vogel-Prishtine-2009, 8. "Këngë për dëshmoret e kombit"-2012, 9. "Ka vra kafja jote"-2012, 10. "Historiku tragjik i Radiotelevizionit të Prishtinës" -2013, 11. "Rapsodet e trojeve shqiptare", në vëllime 1.2.3.4.-2015/2017, 12. "M'dridhet zani n'qifteli", 2019, 13. " Monografi për fshatin Baks", 2019.

Shaban Baksi është dhe mbetet këngëtar popullor, poet, krijues, dhe kompozitor popullor me 50 vite në skenën muzikore, i cili tërë jetën e shkriu dhe ia kushtoi këngës, kulturës tonë shqiptare.

SHAHBAZE VISHAJ GRAJÇEVCI



Prof. Shahbaze Vishaj Grajçevci, është e lindur më 27.6.1961 në Pejë. Shkollën fillore dhe të mesmen e kreu në vendlindje, ndërsa studimet për Gjuhë dhe letërsi shqipe i kreu në universitetin e Prishtinës. Punon në Shkollën e Mesme të Ulët: "Hasan Prishtina", në Kastriotit.

Për punën edukativo-arsimore për një çerek shekulli, si profesoreshë e gjuhës dhe e letërsisë shqipe ka marrë disa mirënjohjeje në mesin e të cilave edhe atë "Mësimdhënës i dalluar", në kuadër të komunës së Kastriotit. Me shkrime filloi të merret si nxënëse e shkollës fillore. Botoi në gazeta dhe revista që dalin te ne, Shqipëri dhe Maqedoni.

Është laureate e shumë shpërblimeve letrare, në mesin e të cilave edhe çmimin për vepër më të mirë, 2016 dhe për vepër jetësore viti 2019, Kastriot. Shkruan poezi e prozë për fëmijë dhe të rritur, si dhe kritikë letrare, ese, publicistikë etj.

Është anëtare e Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, anëtare e Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikane, anëtare e Shoqatës së Shkrimtarëve "Fahri Fazliu", Kastriot, anëtare e redaksisë së revistës letrare për fëmijë "Pionieri", si dhe anëtare e Akademisë së Shkencave dhe Arteve Shqiptaro-Amerikane në New York.

Vepra letrare:

"Shenjë dhe vragë" 2000, (poezi për të rritur),
"Shtjellë dhe vurratë" 2004, (poezi për të rritur),
"Shend e verë" 2006, (poezi për fëmijë),
"Shiu i harresës" 2007, (poezi për të rritur),
"Shtrezë në vetulla" 2010, (poezi për të rritur),
"Shegë vjeshte" 2010, (poezi për fëmijë),
"Shtatori me violinë" 2010, (tregime për fëmijë),
"Shtigje vashërie" 2011, (roman për të rritur),
"Shfletim veprash" 2011, (kritika letrare),
"Shpalim vlerash" 2011, (kritika letrare),
"Letërsia si art dhe interpretim poetik" 2011.

Libri me poezi për fëmijë "*Shporta me vishnje*" është libri më i ri dhe i dymbëdhjeti me radhë i kësaj autoreje.

Shahbaze Vishaj Grajçevci jeton dhe vepron në Prishtinë e New York.

SHAIP GRABOVCI



Shqipëri Grabovci, u lind në Pejë, më 3 dhjetor 1936, ku mbaroi shkollën fillore dhe Shkollën e mesme ekonomike. Një kohë punoi si zejtar, ushtroi zejen e fotografit dhe sërish iu kthye shkollimit. Ka mbaruar Shkollën Normale në Prishtinë e mandej studio gjuhën dhe letërsinë angleze në Fakultetin Filozofik, në Prishtinë. Ka punuar si mësimdhënës i gjuhës angleze, mirëpo në pjesën më të madhe të jetës punoi në gazetari. Ka punuar në Radio Prishtinë, në gazetën: “Rilindja”, RTV 21, si dhe ka bashkëpunuar me revistat që janë botuar në Kosovë. Krahas punës në gazetari, Shqipëri intenzivisht është marr edhe me krijimtari letrare. Shkroi mbi 40 drama për të rritur, por edhe për fëmijë.


Ato i ka bërë joshëse si për shikuesit ashtu edhe për regjisorët, kështu dramat e Grabovcit u vuan në skenë nga regjisorët e njohur vendas dhe të huaj si Muharrem Qena, Besim Sahatçiu, Abdurrahman Shala, Melihate Qena-MELI, David McTier. (Sam Houston University), Borislav Mërkshiq (Zagreb), Slobodan Popiq e të tjerë.

Vepra të botuara:

1.- “Njerëz me shpresa të thyera” (dy drama) botoi, Rilindja, 2.-“Infektimi” (Komedi) botoi: Rilindja), 3.-“Besimi i humbur” (Katër drama) botoi: Rilindja, 4.-“Macja në dritare”, (Përmbledhje humoreskash) botoi, Rilindja,5.-“Arrna për thes” (Tri komedi e dy drama) botoi, Fad, 6.-“Tomi dhe Xheri” (7 Drama për fëmijë) botoi, Fad, 7.-“Memoaret” (Dramë) botoi "Jeta E Re", 8.-“Ditelindja e Barbit” (Tregime për fëmijë) botoi, Fad, 9.-“Çupa me ombrellë” (Tregime për fëmijë) botoi, Fad, 10.-“Labirinti” (Dramë) botoi, "Verbi", 11.-“Lajthimi” (Dramë) botoi: Jeta E Re, 12.-“Frika” (dy drama) botoi, Fad, 13.-“Banketi” (dy drama) botoi, Fad, 14.-“Kozmosi” (Roman për fëmijë) botoi Fad, 15.-“E bukura e dheut” (Roman për fëmijë) botoi, Fad, 16.-“Aventurat e Dejzit” (Roman për fëmijë).

Ai shkroi shumë radiodrama për të rritur e për fëmijë, një pjesë e të cilave janë përkthyer dhe transmetuar edhe në gjuhët e huaja, si: “Rrotacioni i perëndive”, “Dora”, “Një natë e turbull”, “Shkruaj Halim”, “Udhëtimi i Don Kamishit” dhe “Aksident”. Radiodrama, “Aksidenti”, (në regjinë e Xhevdet Gashit), në vitin 1998, në Festivalin e Ohrit u shpall radio-drama më e mirë, në ish-Jugosllavi.

SHANI PALLASKA (1928-1999)



Shani Pallaska ishte aktor kosovar i teatrit, filmit televiziv dhe ekranit të madh. Ai u lind në Gjakovë, në vitin 1928, por artin e tij e përkreu në Teatrin Krahinor të Prishtinës (TKP) dhe në studion filmike Kosovafilmi.

Shani Pallaska ishte mik i mirë dhe bashkëpunëtor me aktorët e njohur si; Abdurrahman Shala, Istref Begolli dhe Muharrem Qena, me të cilë kishte bashkëpunuar e realizuar suksesshëm shumë projekte.

Shaniu ishte pionier i aktrimit kosovar. Pas suksesit në Kosovë, Shaniu mori pjesë edhe në projekte filmike në pjesë tjera të ish-Jugosllavisë, duke u dalluar për realizimin e suksesshëm të shumë roleve, si dhe duke qenë i kërkuar nga regjisorë të njohur të kinematografisë jugosllave.

Ai para publikut kosovar la gjurmë të pashlyera në kinematografinë filmike, i cili luajti role të ndryshme në skenën filmike dhe atë dramatike. Rolet dhe karakteret që ai luajti në teatër dhe në film edhe sot përmendën nga publiku kosovar dhe ai i ish-Jugosllavisë. Vdiq më 13 janar 1999.

Filmografia

- “Era e mollës”, (1995) (Video),
- “Tre vetë kapërcejnë malin”, (1981) (TV),
- “Gjurmët e bardha”, (1980),
- “I ikuri”, (1980) (TV),
- “Kur pranvera vonohet”, (1980) (Mini seri televizive),
- “Era e Lisi”, (1979) (Mini seri televizive),
- “Epoka para gjyqit”, (1978) (Dramë televizive),
- “Poseta u noci”, (Vizite në Natë) (1978),
- “Duke pritur Godonë”, (1977),
- “E kafshoja terrin”, (1977) (TV),
- “Crveni udar”, (Sulmi i Kuq) (1974),
- “Hleb”, (Bukë) (1973) (TV),
- “Si të vdiset”, (1972),
- “Të ngjuarit” (1971) (TV),
- “Uka i Bjeshkëve të Nemura”, (1968),
- “Kapedan Lleshi”, (1960).
- “Atje ku nuk lind dielli”, (1996).

SHEFIK SHKODRA



Shefik Shkodra, u lind më 1948, në Desivojcë të Kamenicës, ku kreu shkollën fillore, kurse të mesmen në Gjilan, ndërsa studimet në Fakultetin Filozofik (filologjik) në Prishtinë, Dega Gjuhë dhe Letërsi Frënge, gjenerata e parë (1970/1974). Punoi mësimdhënës i gjuhës frënge në Gjimnazin e Vitisë, ndërsa pas tre muajve në Shkollën e Mesme Teknike në Gjilan, ku punoi deri në gusht të vitit 1982. Nga viti 1983, pas largimit nga arsimit, me urdhër partiak, iu lejua të punojë në EK, inkasant, ku punoi deri në tetor të vitit 1990.

Në vitin 1993 sërish u kthye në shkollën teknike, por jo më nën sistemin arsimor të Serbisë. Prandaj prej vitit 1994 e deri në vitin 2010 punoi në Shkollën e Mesme të Mjekësisë. Pastaj kaloi në Drejtorinë Komunale për Arsim. Punoi edhe si kryetar i Komisionit për çështje sociale, i Komisionit për informim dhe kulturë pranë KK të Gjilanit. Gjatë karrierës së tij zhvilloi shumë aktivitetet tjera, kurse më 2013 u pensionua.


Me botimin e vjershave ka filluar si nxënës i shkollës së mesme. Poezitë e tij kanë zënë vend në disa përmbledhje me bashkautorë. Ka botuar studime dhe monografi. Po ashtu ka shkruar një mori artikujsh për libra, si dhe për artet pamore në të përditshmen Rilindja. Ka botuar edhe në revistat tjera si: “Jeta e re”, “Zëri i rinisë”, “Flaka e Vëllazërimit”, etj.

Veprimtaria letrare:

1. “Agurrona” (grup autorësh), Klubi letrar "Rexhep Elmazi", Gjilan, 1993,
2. “Studimin monografik Albania e Konicës-Pergamenë shqiptar”, 1995,
3. “Agurrona”, Vëllimin letrar (grup autorësh), Gjilan, si dhe redaktoi revistën "Sogjitime" Nr. I, II, III, 1995-98,
4. “Kohë ngjeshje bamirësie”, Libër dokumentar, grup autorësh, 2000,
5. “Rrëfejza satirike Demoniane”, Gjilan, 2001,
6. “Shtjella”, ShB, Era, Prishtinë, 2006,
7. “Erëverë”, poezi, botoi, Era, Prishtinë,
8. “Zjarri poetik”, ShB. “Sogjitime”,
9. “Qëndresa në mbrojtjen e Shqipërisë Verilindore dhe Lam Hasan Shahiqi”, 2014,
11. “Ëndrra shekullore dhe fantazmat”, 2016,
12. “Aureolë e përhitur”, 2019, etj.

Shkroi e botoi edhe një varg esesh, kritika e vlerësime letrare.

SHEFKI SEJDIU



Profesor Shefki Sejdiu, u lind më 8.6.1936, në Albonë (ish-Pakashticë), Komuna e Besianës (ish-Podujevës). Shkollën fillore e ka kryer në vendlindje, Progjimnazin në Besianë, Shkollën Normale në Prishtinë (1956), Filologjinë romane në Shkup (1962) dhe studimet pasuniversitare në Zagreb (1975), ku edhe u doktorua me temën: *Përkimet formale dhe semantike në proceset emërtuese në fitoniminë e gjuhëve romane me fitoniminë shqipe dhe kroato-serbe*, (1985). Ishte mësues në rrethinën e Kumanovës (1956-1957), mësimdhënës në Gjimnazin e Podujevës (1961-1967) dhe në Gjimnazin e Prishtinës (1967-1972). Prej vitit 1972 është ligjërues, docent (1985) dhe profesor ordinar (1991), pranë Degës së Gjuhës dhe Letërsisë Frënge, të Fakultetit (Filozofik) Filologjik të Universitetit të Prishtinës.

Ka mbajtur ligjërata në disa institucione shkencore, si në: Universitetin e Sofjes (1987) dhe në atë të Veliko Tërnovo-s të Bullgarisë (1987), në Universitetin e Zagrebit (1990) dhe në Universitetin e Elbasanit (2000). Profesor Shefki Sejdiu, në komunikimin shkencor përdor (me gojë dhe me shkrim) përveç gjuhës amtare edhe kroatishten dhe frëngjishten, kurse literaturën profesionale dhe shkencore e shfrytëzon edhe në latinishtë, italishtë, portugeze, spanjolle, rumane (dhe katalone, sardie, retoromanie), por edhe në anglishtë, rusishtë, bullgarishtë, sllovenishtë dhe polonishtë. Profesor Shefki Sejdiu përktheu dhe përshtati tekste të gjuhës frënge për shkollat fillore dhe të mesme dhe recensoi tekste të latinishtes për shkolla të mesme dhe fakultete. Sejdiu është autor edhe i pesë veprave të domenit të onomasiologjisë: *“Fitonimia shqipe e Kosovës-lënda, ndarja, etimologjia”*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1972; *“Fjalorth etnobotanik i shqipes”*, Prishtinë 1984; *“Çështje të onomasiologjisë fitonimike romane dhe ballkanike”*, Prishtinë, 1989; *“Sisteme, struktura, raporte (etnolinguistikë)”*, Prishtinë, 2002; *“Sprova etimologjike”*, Prishtinë, 2002, *“(Iliro-arbroro) shqiptarët dhe gjuha e tyre në Universin globalist”*, Prishtinë, 2017, *“Studime dhe diskutime”*, Prishtinë, 2019.

Mori pjesë me kumtesa dhe ligjërata në dhjetëra tubime shkencore të mbajtura në Kosovë dhe jashtë saj (Tiranë, Zagreb, Sofje, Zarë, Elbasan, V. Tërnovë, Donji Milanovac). Ka botuar në revistat “Gjurmime albanologjike” (IAP), “Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare” (Prishtinë), etj.

SHEFKIJE ISLAMAJ



Prof. Dr. Shefkije Islamaj, u lind më 25 tetor 1953, në fshatin Likovc të Skenderajt. Shkollën fillore e kreu në vendlindje më 1968, ndërsa shkollën Normale në Mitrovicë më 1972.

Më 1977 mbaroi Fakultetin Filozofik-Dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe në Prishtinë, ndërsa në vitin vijues 1978 u regjistrua në studimet pasuniversitare të këtij fakulteti.

Magjistroi më 1982, ndërsa në vitin 1999 doktoroi. Prof. Dr. Shefkije Islamaj gjatë studimeve ka punuar në arsim, një kohë në shkollën fillore “Liria” në Isniq, pak kohë në Qendrën e Shkollimit të Mesëm “Vëllezërit Frashëri” në Deçan.

Ka punuar si ligjëruese e lëndës Kulturë gjuhe në Fakultetin e Arteve Dramatike gjatë viteve 2001-2004.

Fill pas përfundimit të studimeve, në vitin 1977 filloi punën në Institutin Albanologjik të Prishtinës, në Degën e Gjuhës, në Sektorin e Leksikografisë, në fillim si asistente, më vonë si hulumtuese e pavarur, bashkëpunëtore shkencore, bashkëpunëtore e lartë shkencore, ndërsa në vitin 2002 është zgjedhur këshilltare shkencore.

Ajo deri në pensionim punoi në Institutin Albanologjik dhe kishte titullin Këshilltare shkencore.

Më 3 mars të vitit 2014 u zgjodh anëtare e Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës.

Veprimtaria shkencore:

Prof. Dr. Shefkije Islami ka botuar 200 studime, artikuj, trajtesa e kritika për çështje të ndryshme të leksikologjisë, të leksikografisë, të stilistikës gjuhësore e të kulturës së gjuhës, të botuara në organet shkencore e profesionale në Kosovë, Shqipëri e Maqedoni. Është pjesëmarrëse më shumë se 40 sesione, simpoziume e konferenca shkencore të organizuara nga akademitë, institutet shkencore, universitetet në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni e në Mal të Zi. Është redaktore e recensuese e shumë botimeve shkencore të Institutit e jashtë tij.

Redaktore e fjalorëve:

“Fjalori suedisht-shqip”, “Fjalori kroatisht-shqip”, 2010, Zagreb, “Fjalori shqip-serbokroatisht” i (M. Ndreca) 1988, Prishtinë, “Glosar” (Fjalorth i detarisë i së folmes së Ulqinit), 2003, Prishtinë,

Anëtare e Këshillit Ndërkademiç për Gjuhën dhe kryetare e Grupit për Çështje të Leksikut-Shefe e Degës së Gjuhës në Institutin Albanologjik. Nënkyetare e Shoqatës së Gjuhës Shqipe, 2002,

Pjesëmarrëse në një numër ekspeditash gjuhësore e shkencore, organizuar nga IA (Prishtinë), dhe IGjL, (Tiranë).

Botimet-Veprat:

1. “Çështje të sinonimeve në gjuhën shqipe”. Monografi, Prishtinë, 1985,
2. “Fjalor i fjalëve të huaja”, (bashkautorë), Prishtinë, 1987,
3. “Gjuha e Jakov Xoxës”, Monografi. Prishtinë, 2000,
4. “Kultura gjuhësore dhe përdorimi estetik i gjuhës”, Tiranë, 2002,
5. “Gjuha, ligjërimi dhe fjala”, Prishtinë, 2004,
6. “Mos më thuaj se më ke parë ëndërr”, Roman, Tiranë, 2004,
7. “Gjuha dhe identiteti”. Përmbledhje studimesh e trajtesash, Tiranë, 2008,
8. “Gjuha e Gjergj Fishtës”. Monografi, Prishtinë, 2009.

Studime, artikuj vështrime dhe recensione:

1. “Sinonimia-gurrë e pashtershme për pasurimin e gjuhës”, Fjala, 1979, Prishtinë,
2. “Roli i sinonimeve në pasurimin e gjuhës”, “Gjurmime albanologjike”, SSHF, XI, 1981,
3. “Çështje të sinonimisë shqipe”, në Fjala, gusht, 1986, Prishtinë,
4. “Pasqyrimi i sinonimeve në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe”, në vëllime. “Çështje të studimeve albanologjike I”, Prishtinë, 1987,
5. “Çështje të sinonimisë stilistike në gjuhën shqipe”, “Gjurmime albanologjike”, SSHF. 1983,
6. “Sinonimia frazeologjike në gjuhën shqipe”, Studime filologjike, 1986, Tiranë,
7. “Roli i sinonimisë në pasurimin e gjuhës”, në vëll. Studimi mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhë shqipe, III, Tiranë, 1989,
8. Për një leksikografi bashkëkohore, përmb. Leksikografia shqipe, Tiranë, 2005,
9. Kultura gjuhësore dhe terminologjia islame, Tryeza shkencore, ASHAK, 2005,
10. Kultura gjuhësore dhe shkrimet fetare islame, Zëri, 13.5.2006.
11. Lumi i vdekur, monument gjuhësor, Shekulli, Tiranë, 19.3.2006,
12. Fjalori i Benedikt Demës, Zëri, janar, 2006 etj.

SHTJEFËN GJEÇOVI (1873-1929)



Shtjefën Gjeçovi, u lind më 12 korrik 1873, kurse ka ndërruar jetë më 14 tetor 1929. Ishte frat françeskan, veprimtar i lëvizjes kombëtare, etnograf, arkeolog dhe shkrimtar.

Familja e tij ishte me prejardhje nga Kryeziu, një fshat i Pukës. Prindërit e dërgojnë më 1884 në kolegjin françeskan të Troshanit në Vilajetin e Shkodrës, ku mori mësimet e para që e çuan në rrugën e meshtarisë. Vijoi studimet në Dervent dhe Banja Llukë, ndiqte mësimet edhe në Kreshevë. Ndërmerr punimin për një studim mbi

Arqipeshkvinë e Tivarit, me titullin në latinisht “*Metropolis Antibarensis*”.

Kryen studimet në korrik të 1896, kur edhe kthehet në atdhe dhe meshon për herë të parë në Troshan. Këtu në Troshan ai ndërron emrin në Shtjefën-Kostandin. Shërben si famullitar në Rubik dhe verën e vitit 1897 në Pejë emërohet famullitar në Zllakuqan. Shtjefën Gjeçovi në korrik të vitit 1897 e hapë shkollën e parë në Zllakuqan. Nga mesi i 1899 deri më 1905, rihap shkollën shqipe në Laç, ku shërbeu si mësues dhe i siguronte materialet e para përmes Konicës. Merr pjesë me krerët e Mirditës, Pukës, Lezhës, Zadrimës dhe malësorëve të Bregmatës në kuvendin që u mbajt në Lezhë, më 7 korrik 1913. Më 1915 kthehet prapë në Troshan, e më pas e emërojnë më 1916, anëtar korrespondent për materiale të marra nga goja e popullit. Në vitin 1920 dërgohet famullitar në Vlorë, e më pas në vitin 1923, emërohet sekretar i Provincës Françeskane. Më 1926 emërohet në famullin e Zymit të Hasit të Thatë, ku vritet më 14 të tetorit 1929.

Veprat:

Botimet e para të Gjeçovit janë dymbëdhjetë poezi tek “Albanica” e Konicës me emër pende Lkëni i Hasit. Shkroi dramën: “Dashtunija e atdheut” më 1901, “Kushtrimi asé Mark Kuli Kryeqitas” 1903, “Shqiptari ngadhënjyes” 1904, “Princi i dy Dibrave asé Mojs Golem” 1904, “Shqiptari ngadhënjyes, 1904, ”Katër të lumtun, Edipi i Shqipnis”, 1926.

Gjeçovi na ka lënë si trashëgim gjithsej tridhjetë e tetë vepra origjinale ende të pabotuara, ndër to shtatë pjesë teatrore dhe disa tregime. Kryevepra e tij, “Kanuni p Lekë Dukagjinit”, është përmbledhja më e përmendur e ligjit zakonor shqiptar. I kopsitur në 1263 nene, nisi të botohej së pari tek “Albania” e Konicës më 1897-98 dhe më pas në organin e shtypit të françeskanëve që nga dalja e “Hyllit” më 1913 gjer më 1924. etj.

SHYQRI GALICA



Prof. dr. Shyqri Galica u lind më 2 nëntor 1951, në Rashincë të Shtimes. Tetëvjeçaren e ka kryer në Muzeqinë, kurse gjimnazin në Ferizaj. Gjuhën dhe letërsinë shqipe e ka mbaruar më 1975, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku dhe ka kryer shkallën e tretë të studimeve.

Më 1986 ka magjistruar me temën “Poezia e Fatos Arapit”, kurse më 1997, në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, ka mbrojtur tezën e doktoratës me titull “Faik Konica-eseist dhe kritik letrar”, të cilën e ka botuar po atë vit.

Si student i vitit të tretë, më 1974, ka filluar të punojë si spiker (folës) në Radio-Prishtinë, ndërsa nga viti 1978 derisa është mbyllur gazeta “Rilindja” e Prishtinës (2002) ka punuar gazetar, redaktor e zëvendës-kryeredaktor.

Ndërkaq, në vitin akademik 1998-1999 ka mbajtur lëndën fillet e gazetarisë në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës, kurse më pas ka kaluar në Fakultetin e Arteve të UP-së.

Në vitin 2000 është zgjedhur docent, më 2004 profesor i asocuar për lëndën histori e letërsisë, kurse më 2009 profesor i rregullt.

Ka dhënë lëndët histori e letërsisë botërore, letërsi kombëtare I, II, letërsi I, II e III, si dhe dramatologji.

Gjithashtu në Fakultetin e Edukimit të UP-së ka dhënë edhe shkrim akademik dhe kulturë gjuhe, si dhe lëndët bazat e gazetarisë dhe mediet dhe komunikimi publik.

Në Universitetin Internacional të Prishtinës ka mbajtur lëndën shkrim akademik, e po këtë lëndë e ka ligjëruara edhe në Fakultetin Ekonomik të UP-së.

Ka qenë shef i Katedrës së Dramaturgjisë të Fakultetit të Arteve të UP-së, kurse një mandat edhe anëtar i Senatit të UP-së.

Shyqri Galica gjatë punës së tij si pedagog ishte i përkushtuar në lëminë e gjuhës dhe letërsisë shqipe.

Ka botuar shkrime letrare-poezi e prozë, pastaj ka shkruar punime kritike për letërsinë e artin, ka publikuar artikuj studimorë, kumtesa e studime për letërsinë; ka bërë biseda me personalitete të shkencës e të artit, ka shkruar artikuj për kulturën, përkatësisht për librin, muzikën, radio-

televizionin, jetën teatrale e atë kulturore; për figurat historike dhe të kulturës kombëtare e të asaj botërore, si dhe shkrime për aspekte të ndryshme të shkencës, të letërsisë dhe të artit.

Ka marrë pjesë me kumtesa në disa tubime letrare e shkencore në Kosovë dhe jashtë.

Veprat e botuara:

- “Koha flet me brezni”, poezi, 1979,
- “Poezia e Fatos Arapit”, studim monografik, 1990,
- “Amësia”, tregime, 1991,
- “Simbolika e sundimit”, kritika dhe ese, 1995,
- “Konica–moderniteti, eseistika, kritika”, studim monografik, 1997,
- “Mesazhi kritik”, ese dhe kritika, 1999,
- “Dashuria vdekërisht”, roman, 2003,
- “Identiteti artistik”, kumtesa shkencore dhe vështrime kritike, 2005,
- “Gazetarë dhe publicistë shqiptarë”, fjalor enciklopedik (bashkautor), Tiranë, 2005,
- “Bota magjike e fëmijës”, kritikë letrare, 2007,
- “Mesazhi intelektual”, studime, 2012.


Gjatë kësaj periudhe ka hartuar tridhjetë e gjashtë zëra nga fusha e letërsisë dhe e shtypit shqiptar për “Fjalorin enciklopedik shqiptar” (tri vëllime) të Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, si dhe rreth tridhjetë zëra për projektin e përbashkët “Enciklopedia e artit shqiptar” të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Republikës së Kosovës.

Në vëllimin “Sovremenija albanistika” është botuar studimi i tij me titull “Vetëdija kritike dhe eseistike e Konicës” (“Konica's critical and esthetic awareness”) (më 2012) në vëllimin e veçantë të punimeve të Institutit të Studimeve Gjuhësore të Akademisë së Shkencave të Rusisë.

Gjithashtu ka paraqitur një varg punimesh shkencore e letrare në tubime të ndryshme brenda e jashtë Republikës së Kosovës.

Shyqri Galica për një kohë të gjatë mbajti postin e sekretarit të Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, kurse tash është kryetar i kësaj shoqate. Shyqri Galica me Lidhjen e Shkrimtarëve të Kosovës organizon Festivalin ndërkombëtar të poezisë “Drini poetik” në qershor, Orën Letrare “Ora e lirisë” në mars, Manifestimin letrar “Esad Mekuli: si dhe orë tjera letrare nëpër shkolla fillore në Kosovë. Gjithashtu është aktiv në manifestime letrare që organizohen në trojet shqiptare.

SHYQRI NIMANI



Prof. Shyqri Nimani u lind në Shkodër më 6 maj 1941. Shkollën e Mesme të Artit e kreu në Pejë me sukses të shkëlqyeshëm. U diplomua në Akademinë e Arteve Aplikative në Beograd në vitin 1967, me notën maksimale 10. Studimet pasuniversitare i kreu më 1969 në të njëjtën Akademi. Nimani ishte profesor ordinar në Fakultetin e Arteve të Prishtinës. Në vitet 1976-1978 ka qëndruar në Japoni si bursist i Qeverisë japoneze për hulumtim artistik. Në vitet 1979-1989 ka qenë drejtor i Galerisë së Arteve të Kosovës. Ka qenë dekan i Fakultetit të Arteve nga viti 1991-1994. Merret me pikturë, grafikë, dizajn dhe me disiplina të tjera të arteve figurative. Ka botuar monografi për artin mesjetar dhe bashkëkohor shqiptar. Ka përkthyer edhe libra nga gjuhë të huaja. Ka ligjëruar në Akademinë e Arteve në Tiranë (Shqipëri), në Universitetin e Tetovës (Maqedoni) dhe tani në Kolegjin AAB.


Ekspozitat personale në vend dhe në botë:

1971 - Galeria e SHAFAS, Beograd; Galeria “Kamen Mali”, Cavtat (Kroaci), 1975 - Muzeu i Arteve Aplikative, Beograd; 1978, - “Gyarari 5610” Tokio (Japoni); Galeria e Universitetit “Gakugei Daikagu”, Tokio; 1980 - Galeria e Arteve e Kosovës, Prishtinë; 1983 - Galeria YU-KIC, Nju Jork; 1984 - Galeria “Forum”, Zagreb; 1986 - Galeria e PK “Asim Vokshi”, Gjakovë; 1988 - Muzeu i Arteve Aplikative, Beograd; 1993 - Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë. 2003 - Galeria e Arteve e Kosovës, Prishtinë; 2008 - Galeria „Zlatni Konj“, Zagreb, Kroaci; etj.

Monografitë reprezentative mbi trashëgiminë kulturore shqiptare:

“Onufri dhe piktorë të tjerë mesjetarë shqiptarë” (Onufri and Other Albanian Medieval Artists), Prishtinë, 1987
“Arti bashkëkohor i Kosovës”, (Contemporary Art of Kosova), 1988
“Përgatitja e librit” (Book Design), Prishtinë, 1990
“10×10 - Ars Longa Vita Brevis”, Prishtinë, 1994
“Trojet shqiptare në harta dhe stema”, (Albanian Lands in Maps and Emblems), (Albanische Gebiete auf Karten und Wapen), Prishtinë, 1997
“Arnavud- Artistët Shqiptarë në Perandorinë Osmane”, (Arnavud-Albanian Artists in the Ottoman Empire), Prishtinë, 2003
“Gurë të Mozaikut Shqiptar” (Stones of Albanian Mosaic), ArsAlbanica,

TAHIR DESKU (1957-2005)



Tahir Desku, u lind më 1957 në Siqevë të Klinës. Filloren e kreu në Ujmirë, të mesmen në Klinë, kurse studimet për Gjuhë e letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës. Gjatë rinisë së hershme ka ëndërruar të bëhet aktor, mbasi kishte luajtur në disa pjesë teatrore. Por, ai gjatë gjithë jetës së tij ishte poet. Sa ishte student, punoi katër vite gazetar në gazetën e studentëve “Bota e re”. Pastaj punoi gazetar në TVP gjatë viteve '80, ku disa herë e larguan nga puna. Kur e larguan përfundi-misht nga puna, ia mësyn eksodit në SHBA dhe atje qëndroi tetë vite. Atje kontribuoi në lëvizjen kombëtare e politike të diasporës shqiptaro-amerikane. Kthehet në Prishtinë pak vite para luftës dhe nis e boton revistën kulturore, shkencore e letrare me titullin “Tribuna”. Pastaj kyçet në radhët e luftës çlirimtare të UÇK-së, duke raportuar gjatë viteve 1998-1999, deri në çlirim. Pas luftës zgjidhet kryetari i parë në liri i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Ndërkaq, më tre dhjetor të vitit 2005 vdes tragjikisht në fatkeqësi komunikacioni. Vdekja e gjeti duke e kryer detyrën e redaktorit të kulturës në Radio Kosova.

Për të gjallë ai botoi librat poetikë:


- “Prejardhja e dashurisë”, (1982),
- “Nga biografia e pashkruar”, (1984),
- “Idil e vetmi”, (1989) dhe
- “Engjëjt e lirisë” (2000).

Një libër poezish të tij u përkthye edhe anglisht (2001), nga Fadil Bajraj, me titullin “Love and spring”.

Tahir Desku pas vdekjes, më 2006, nga LKSH-ja, iu botua libri poetik, “*Në cilin gjet e kam vdekjen*”.

Tahir Desku është laureuar me rastin e 15-vjetorit të revistës së studentëve “Bota e re” me çmimin “Gazetari më i mirë i vitit”. Ndërsa me rastin e 30-vjetorit të kësaj gazete studentore, më 1998, kur ai gjendej në vijat e frontit, merr çmimin “Gazetari më i mirë në 30 vjetët e fundit”. Ai u laureua me të gjitha çmimet letrare të Kosovës, si në manifestimet Mitingu i Poezisë në Gjakovë, Takimet e Gjeçovit, ndërsa në vitin 2000 shpërblehet nga LKSH për librin më të mirë të botuar brenda vitit në Kosovë. Ndërsa për kontributin e tij në Luftën Çlirimtare të Kosovës, ai merr dekoratën “Urdhëri i Adem Jasharit”.

TAHIR BERISHA (1928-2013)




Tahir Z. Berisha, u lind në Vërban të Vitisë më 31 korrik 1928. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, maturën e mësuesisë në Pejë, kurse Shkollën e Lartë Pedagogjike (Gjuhë Shqipe dhe Letërsi) dhe Fakultetin Filozofik në Shkup. Më pas vijoi studimet pasdiplomike në Degën e Informatikës në Zagreb. Veprimtarinë arsimore e vazhdoi si arsimtar në gjimnaz, drejtor i Shkollës së Mesme Ekonomike dhe drejtor i Entit Arsimor Pedagogjik, në Gjilan. Në vitin 1956, gjatë aksionit famëkeq për mbledhjen e armëve u përjashtua nga mësimi si "i papërshtatshëm politikisht". Pas Plenumit të Brionëve dhe rënies së A. Rankoviqit, më 1966, rehabilitohet dhe kthehet prapë në arsim, ku punoi si inspektor dhe kryeinspektor i arsimit, si dhe sekretar shumëvjeçar i Shoqatës së Veteranëve të Arsimit të Kosovës. Në vitin 1986 regjimi shovinist i Millosheviqit, përsëri e përjashtoi nga Lidhja e Luftëtarëve të LNÇ dhe del në pension. Gjatë shërbimit aktiv dhe më vonë vazhdimisht është marrë me shkrime letrare e publicistike. Vdiq në Londër, më 12 dhjetor 2013.

Veprat:

1. "Monografia e Shkollës së Mesme Ekonomike në Gjilan", Shkup, 1961,
2. "Dhjet Vjet të Shërbimit të Inspeksionit të Arsimit në KSA të Kosovës (1970-1980)", Prishtinë, 1981,
3. "Trojet që nuk shuhen-Shënime nga Vërbani dhe Anamorava", Prishtinë, 1993 (ribotimi 1995),
4. "Emra që nuk harrohen-Arsimtarët veteranë (1941-1951) dhe arsimi shqip në Kosovë", Vëllimi I, Prishtinë, 1994,
5. "Emra që nuk harrohen-Arsimtarët veteranë (1941-1951)", V. II, 1996,
6. "Rrëfime në veten e parë", Prishtinë, 1998,
7. "Shënime dhe ecejake të një refugjati nga Kosova", Londër, 2001,
8. "Emra që nuk harrohen-Arsimtarët veteranë (1941-1951)", V. III, 2005,
- 9.) "Në fokus të ngjarjeve-Bisedë me Sinan Hasanin", Prishtinë, 2005,
10. "Emra që nuk harrohen-Arsimtarët shqiptarë në diasporë", Prishtinë, 2006, (si koautor me Hamza Halabakun dhe Çerkin Bytyqin).
Është i përfshirë në Antologjinë e krijuesve shqiptarë në Angli, "Lërmini pak atdhe", Tiranë, 2004, si dhe në librin "100 Shqiptarët e Britanisë", Londër, 2013.

TEKI DERVISHI (1943-2011)



Teki Dervishi, u lind më 16 Janar 1943, në Gjakovë dhe vdiq me 29 qershor 2011 në Prishtinë. Është shkrimtar dhe publicist shqiptar nga Kosova. Deri në vdekjen e tij ishte drejtor i gazetës ditore "Bota Sot". Teki Dervishi gjatë gjithë jetës së tij u mor me shkrime letrare e publicistikë. Është autor i rreth 90 veprave letrare artistike, romane, poezi, drama. Në vitin 1981 Teki Dervishin e larguan nga Flaka e Vëllazërimit, sepse refuzoi të shkruante kundër Ismail Kadaresë, që i bie se ai refuzoi të del kundër vetvetes. Ishte po ai që i takonte Grupit të Demaçit, si përfaqësues i Rrafshit të Dukagjinit dhe i dënuar si 17 vjeçar me burg të rëndë në ishullin famëkeq të Goli Otokut.

Veprat letrare:

“Pirgu i Lartë”, 1972,
“Padrona”, 1973, “Skedarët” 1974,
“Herezia e Dervish Mallutës”, 1981,
“Palimpsest për Dush Kusarin”, 1993,
“Etje dhe Borë”, (pëmbledhje tregimesh).

Poezi:

“Nimfa”, 1970,
“I Varun me Vargje për Drunin e Blertë” 1971,
“Shtëpia e Sëmurë” 1978,
“Thashë”, 1981,
“Nimfa”, 1986.

Drama:

“Zbutësi i njerëzve me sy prej zymrydi”, 1979,
“Bregu i Pikëllimit”, 1985,
“Pranvera e Librave”, 1990,
“Zhvarrimi i Pjetër Bogdanit”, 1990,
“Kufiri me atdhe”, 1996,
“Vojceku”, 1996,
“Eshtrat që kthehen vonë”, 2000,
“Nesër nisemi për Parajsë”, 1999,
“Ku është Populli?”, 2003.

TINKA KURTI



Tinka Kurti, u lind në Sarajevë. Aktualisht jeton në Tiranë. Familja e saj u shpërngul në Shkodër, kur ajo ishte në moshë të vogël. Pjesën më të madhe të jetës e kaloi në Shkodër, ku edhe iu bashkua teatrit në moshë të re. U ngjit për herë të parë në skenë kur ishte vetëm 16 vjeç. Më 1947, u përjashtua nga Liceu Artistik i Tiranës dhe nuk mori asnjëherë ndonjë diplomë shkolle, por kjo nuk e pengoi të bëhet një aktore e madhe dhe shumë e kulturuar. Që nga viti 1949 e deri sa doli në pension ishte aktore e Teatrit “Migjeni” të Shkodrës, ku interpretoi rreth 120 role. Veçanërisht e suksesshme doli në rolet dramatike të nënave, por po kaq e suksesshme në komedi. Shkëlqeu me role protagoniste në “Gjaku i Arbrit”, “Histori Irkutase”, “Toka jonë”, ku luan në fillim Filen e pastaj Loken, “Fisheku në pajë”, apo “Fejesa e Çehovit”. Kurti ka interpretuar edhe në kinema, në rreth 35 filma artistik, duke filluar me filmin e parë shqiptar të metrazhit të gjatë, “Tana”, më 1958. Ndër rolet e tjera janë: Nënë Pashako, tek “Yjet e netë të gjata” (1972), nëna tek “Çifti i lumtur” (1975), Sinjorina Mançini, tek “Vajzat me kordele të kuqe” (1978), Gjyshja, tek “Zemra e nënës”. Tinka Kurti ka marrë çmime të shumta, si në festivalet kombëtare të filmit, ashtu edhe në ato të teatrit. Këtyre çmimeve u shtohen edhe vlerësime të tjera të rëndësishme, si medalja “Mjeshtër i Madh i Punës”, akorduar nga Presidenti i Republikës. Dy kinema, një në Tiranë dhe një në Durrës mbajnë emrin e saj. Gjithashtu, emrin e Tinka Kurtit mban edhe një shkollë në fshatin Lekbibaj. Në vitin 2003, regjisori Esat Teliti realizoi një dokumentar të titulluar “Tinka” kushtuar jetës së saj. Ajo është aktive edhe në ditët e sotme.

Filmografia:

“Bota café”, 2014, “Në kërkim të kujt”, 2012, “Familjet”, 2009, “Filumena Marturano”, 2009, (teatër), “Ne dhe Lenini”, 2008, “Mira”, 2008, “Etjet e Kosovës”, 2006, “Dasma e Sakos”, 1998, “Nata”, 1998, “Zemra e nënës”, “Vdekja e kalit”, 1992, “Unë e dua Erën”, 1991, “Telefoni i një mëngjesi”, “Në emër të lirisë”, 1987, “Hije që mbeten pas”, 1985, “Besa e kuqe”, 1982 “Qortimet e vjeshtës”, 1982, “Si gjithë të tjerët”, 1981, “Mëngjese të reja”, 1980, “Nusja”, 1980, “Gjeneral gramafoni”, 1978, “Vajza me kordele të kuqe”, 1978, “Emblema e dikurshme”, 1976, “Çifti i lumtur”, 1975, “Lum drite”, 1975.

TYRAN PRIZREN SPAHIU



Tyran Prizren Spahiu, u lind në vitin 1954. Arsimin fillor dhe të mesëm e ka ndjekur në shkollën fillore “Mustafa Baku”, gjegjësisht arsimin e mesëm në gjimnazin e Prizrenit.

Diplomoi në Gjuhë dhe letërsi angleze në Universitetin e Prishtinës. Ai është një artist i mrekullueshëm, pasionant, posedon njohuri të thella dhe aftësi të larta letrare në artin e prozës.

Në veprat e tij ai zbulon çështjet kryesore të ditës, sjell kohë në dimensionet e tij, duke ndërtuar një botë të fuqishme të mendimeve, psikikës dhe ideve të shkëlqyera. Filozofia e tij është e thjeshtë, por kapëse dhe mjaft transparente. Ai u sjell lexuesve të vërtetën e madhe, vjen me një stil të vërtetë në poezinë-prozën moderne shqiptare, poashtu edhe në atë angleze, me një pamje shumë depërtuese dhe plot ngjyra psikoanalitike. Ndërton fraza mjaft të qarta dhe u jep atyre liri me shumë art, mjeshtëri krijuese dhe padyshim shumë lloje jetësore të nektarit.

Vjen midis nesh si një romancier i shquar dhe inovator, ku vepra e tij krijuese artistike ndërthuret me shumë aftësi me realitetin e kohës dhe njerëzve. Romani i tij “Prapa kurrë më!” është padyshim një kontribut i vlefshëm dhe serioz në prozën moderne shqiptare dhe mbarëbotërore. Tyran Prizren Spahiu, dëshmon të jetë një artist krijues dhe mjaft i kërkuar. Proza e tij është një arritje e re, e cila i jep autorit të drejtën të renditet në mesin më të njohurve nga emrat e rinj të letrarëve modernë në Kosovë dhe më gjerë. Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës.

Veprat letrare:

- “Vargje poetike I”, 1999 ; “Vargje poetike II”; “Jeta është dhunti”;
- “Vargje poetike III”; “Mbaje ëndrrat gjallë”; “Vargje poetike IV”;
- “Poezia buron nga zëri i brendshëm”; “Vargje poetike V”; “Pesë shtylla”;
- “Vargje poetike VI”; “Kalldrëmi”; “Vargje poetike VII”;
- “Jetëshkrimi burimor”; “Vargje poetike VIII”; “Kështjella e poezisë”;
- “Vargje poetike IX”; “Ikonë”; “Vargje poetike X”; “Bohemi”;
- “Vargje poetike XI”; “Lidhja”; “Vargje poetike XII”; “E-dita”;
- “Vargje poezike XIII”; “Buron”; “Vargje poetike XIV”; “Shkronjtari”;
- “Vargje poetike”, në gjuhën Angleze; “The Bohemian”.
- “Prapa kurrë më”, roman (Vëllimi I); “Prapa kurrë më” (Vëllimi II);
- “Mort”; dhe “Learn Your Dream Language” (Mëso gjuhën e ëndrrave).

UKSHIN HOTI



Mr. Ukshin Hoti, u lind më 17 qershor 1943, në Krushë të Madhe të Rahovecit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në Prizren dhe më pas në Prishtinë. Në moshën 15 vjeçare, prindërit e regjistrojnë në “Shkollën Normale”. Pasi kryen katër vitet e para në Prizren dhe të fundit në Prishtinë, ky nivel arsimor i mundëson atij të japë mësim në vitin 1963, në fshatin e tij të lindjes. Megjithatë Ukshin Hoti dëshiron të ndjekë studime universitare. Në vitin 1964 regjistrohet fillimisht në fakultetin e mjekësisë në Zagreb, pastaj, shumë shpejtë riorientohet në shkencat politike. Në Zagreb, Ukshin Hoti organizon protesta kundër luftës në Vietnam. Pas përfundimit të studimeve në Zagreb, në vitin 1968 i filloi studimet pasuniversitare në Beograd, në drejtimin e marrëdhënieve politike dhe ekonomisë ndërkombëtare. Në vitin 1975 nisi të jepte lëndën Të drejtën ndërkombëtare, në Universitetin e Prishtinës. Më 1978/1979 vijoi specializime postdiplomike për Shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare, në Chicago, Harvard dhe Washington. Me protestat studentore të 19 mars 1981, mbështeti kërkesat e studentëve shqiptarë për shpalljen e Kosovës Republikë, ku më pas u dënua me 9 vite burg. Më 1984, Gjykata Supreme e Jugosllavisë në Beograd ia zbriti dënimin në 3,5 vite burg. Më 1985 lirohet nga burgu por izolohet në fshatin e tij të lindjes në Rahovec. Në prill të vitit 1994, partia Unikomb i ofron Ukshin Hotit që të bëhet lider i saj. Ukshin Hoti arrestohet rrugës në Prishtinë, më 17 Maj të vitit 1994, ku pas disa muajsh Ukshini dënohet me 5 vjet burg. Kështu, kur fillon lufta në Kosovë në mars 1998, bëhet një kërkesë në Këshillin Evropian që autoritetet e Beogradit ta bëjnë lirimin e parakohshëm të Ukshin Hotit.

Më 16 maj 1999, ai lirohet nga burgu i Dubravës, ditën e diel. Që atëherë nuk dihet gjë për fatin e tij. Tre ditë më vonë, më 19 maj 1999, burgu i rrethuar me tanke dhe me armë antiajrore të ushtrisë serbe, bombardohet nga NATO. Pas bombardimit të objektit, paramilitarët serbë masakrojnë 176 të burgosurë shqiptarë dhe plagosin mbi 200 të tjerë.

Veprat:

“Lufta e ftohtë dhe detanti”, 1975;

“Filozofia politike e çështjes shqiptare”, 1995;

“Bisedë përmes hekurash”, 2000.

VILSON CULAJ



Vilson Culaj, u lind më 6 gusht 1973, në Klinë. Shkollën fillore dhe të mesme i ka mbaruar në Klinë, kurse Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës. Studimet pasuniversitare i ka përfunduar, po ashtu në Prishtinë, në drejtimin Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci. Me shkrime filloi të merret që nga bankat e shkollës së mesme. Ka bashkëpunuar me revista e shumë gazeta të ndryshme anekënd Kosovës, si "Studenti"-Fakulteti Juridik, "Oaza", Biblioteka ndërkomunale "Hivzi Sylejmani" e Prishtinës, "Bota e re", revistë studentore e Universitetit të Prishtinës, Klubi i Shkrimtareve "Vora Ukjo" Klinë, "Epoka e re", "Kosova Sot", "Zemra shqiptare", "Drita", gazetën, "Iliria Post", etj.

Është aktiv në jetën kulturore dhe letrare në mbarë Kosovën dhe më gjerë, që nga vitet e '90 ta. Ka marrë pjesë në takimet e ndryshme letrare, ku ka marrë disa çmime e shpërblime letrare. Ka punuar si mësimdhënës në Shkollën fillore, "Atë Gjergj Fishta", në Jagodë, kurse aktualisht është sekretar në shkollën fillore, "Ismet Rraci", në Klinë.

Vilsoni ka shkruar analiza, recensione, vështrime dhe studimore letrare, diku 50 sosh. Është bashkëpunëtor i revistës kulturore dhe letrare, "Mirdita", ku në vitin 2015 është shpërblyer më çmimin, "Prozator i vitit", me romanin "I Dëbuari".

Në vitin 2019 është shpërblyer me, "Çmimin e Karrierës" në lëmin e letërsisë, nga Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu" nga Kastrioti. Është i përfshirë në disa Antologji dhe shumë libra autorial me shkrimet dhe studimet e tij.

Botimet:

1. "Tinguj të padëgjuar", poezi, Klinë, 1998,
2. "Furra e Nabukodonozorit", roman, Klinë, 2001,
3. "Daho Dh Ve", poezi, Prishtinë 2003,
4. Përgatiti për shtyp librin antologjik, "Zhbërja e Ikjes", poezi përkushtuese nga poetë të ndryshëm (101 të tillë) për shkrimtarin Rifat Kukaj, Prishtinë, 2006,
5. "Stuhi e fjetur", prozë, Prishtinë, 2009,
6. "Dy kohë", Prishtinë, 2013,
7. "I dëbuari", roman, Prishtinë, 2015. etj.

VLERA BYTYQI EJUPI



Vlora Bytyçi Ejupi, u lind në Tetovë, më 16 maj 1965. Shkollën fillore e kreu në Shkup. Në vitin 1983 kreu edhe shkollën e mesme në Shkup dhe paralelisht të gjitha kurset nga gjuha angleze për katër vite, në Qendrën për gjuhë të huaja në Shkup, krahas shkollës së mesme të përgjithshme "Zef Lush Marku".

Diplomoi në Universitetin e Shkupit në katedrën për Gjuhë dhe letërsi angleze, në drejtimin pedagogjik dhe atë përkthyes. Në vitin 2002, kreu studimet pas universitare në Universitetin Shtetërorë të Tiranës, duke fituar titullin magjistër nga proza bashkëkohore angleze, pas mbrojtjes me sukses të dalluar të tezës "Love, sex and marriage, in the novel "Lady Chatterley's Lover" by D.H.Lavrence"- "Dashuria, seksi dhe martesë në novelën "dashnori i Zonjës Çetërli" nga D.H.Lavrence".

Në vitin 2009, fitoi titullin Doktor i Shkencave të Filologjisë pas mbrojtjes me sukses të dalluar të tezës së doktoratës me titull "The relation among male and female protagonist in the novels "Women in love" and "Sons and Lovers" By D.H.Laawrence"- "Raporti mes protagonistëve në novelat "Gratë e dashuruara" dhe "Bijtë dhe dashnorë" në UEJL në Tetovë. Vlora Bytyçi Ejupi, ka ligjëruar në shkollën e mesme "Zef Lush Marku" dhe "Nikolla Karev" në Shkup.

Ka qenë pjesëmarrëse në shumë konferenca shkencore nëpër botë, është përkthyes e disa librave, si dhe përkthyes simultane dhe konsektive. Ka ligjëruar në universitetet në vijim në Universitetin e Tetovës, në Universiteti Ndërkombëtar të Evropës Juglindore, në Tetovë, në IBT në Shkup, në AAB në Prishtinë dhe për momentin Vlora Bytyçi Ejupi, ligjëron gjuhë angleze, si dhe Letërsinë Moderne dhe Postmoderne Anglo-Amerikane në UBT, në Kosovë.

Botimet:

1. "Dashuria, seksi dhe martesë në novelën "dashnori i Zonjës Çetërli" nga D.H.Lavrence", Tiranë, 2002,
2. "Raporti mes protagonistëve në novelat "Gratë e dashuruara" dhe "Bijtë dhe dashnorë", Tetovë, 2009,
3. "Pakti me djallin", Konica Press, Shkup, 2011,
4. "Qelqi", (poezi dhe ese), SHB "Rugova Art", Prishtinë, 2019.

VILHEME VRANA HAXHIRAJ



Vilheme Vrana Haxhiraj, u lind në Kaninë, më 08 dhjetor 1944. U arsimua me shumë vësh-tirësi. Në vitin 1966 i ndalohet diplomimi vetëm për tri lëndë.

I burgosin babanë e xhaxhanë. Internohet dhe i mohojnë ushtrimin e profesionit. Rifitoi të drejtën e studimeve, në degën Histori-Gjeografi, u diplomua më 1975, por pa të drejtën ushtrimit të mësuesisë. Punoj 25 vjet punëtore e vetëm më 1990 rifilloi punën në arsim dhe vazhdoi pa punë si demokrate.

Është “Mjeshtre e Madhe e Punës. Është anëtare e ASHASHA (New York). Njihet si shkrimtare me shumë kontribute, me krijimtari letrare të bollshme në disa gjini, në studime, publicistikë, si brenda dhe jashtë atdheut dhe një vlerë e pamohueshme që nderon kombin.

Vilheme Vrana Haxhiraj i ka dhuruar lexuesit në 23 vite, 47 libra në gjini të ndryshme, letërsi për fëmijë, studime dhe publicistikë. Krijimtaria e Vranarit është e përfshirë në 24 antologji si: shqiptare, italiane, arbëreshe, Mali i Zi, Kosovë, Rumani, Angli, Suedi, Greqi etj.

Ajo për krijimtarinë e pasur dhe cilësore është nderuar me 24 vlerësime dhe çmime kombëtare e ndërkombëtare, si në: Shqipëri, Kosovë, Mali i Zi, Greqi, Rumani, Itali, Suedi dhe Amerikë.

Vitin e kaluar ajo shkroi librin studiues “Elitat e mohura..., Krenari kombëtare” që po le gjurmë te intelektualët e vërtetë, sepse dirigjentja nuk harron të përmendë edhe të shquarit e sotëm të intelektualitetit shqiptar.

Vilheme Vrana merr guximin e paparë për t'i sjellë në këtë libër veprimtaritë e tyre, veprimtari që i shërbejnë veç të mirës së Shqipërisë dhe shqiptarëve, në kundërshtim me veprimtaritë e politikanëve...

Poezi:

“Loti nuk ka faj”, 1996;

“Të pres”, 2000;

“Rādācinile”-Rrënjët, shqip/rumanisht, 2009.

Prozë e shkurtër:

“Mamaja”, novelë 2000;

“Kush e vrau Kaftanazin”, (skica, tregime, novela, 2001);

“Rrugë pa kthim”, 2009;

“Mamaja”, novelë rumanisht, 2011;

“Çmimi i Dualizmit”, novelë, 2012 SHB Nacional;
“Një mall i pashuar”, novelë, 2014, SHB Nacional.

Romane:

“Dhembje nëne”, 1998;
“Jetë në udhëkryq”, 2001;
“Ringjallur si Krishti”, 2002;
“Amanti i Arbërisë”, 2003;
“Rrëfim në të perënduar”, 2007;
“Unaza e Prangosur”, 2008;
“Zonja me karafila të bardhë”, 2009;
“Dritëhijet e medaljes...”. enigmë, 2010- SHB Nacional ;
“Vonë tejet vonë”, 2011- SHB Nacional ;
“Ankthi i së Vërtetës”, botoi LULU-USA, 2011;
“Pa Titull”, Ese-publicistikë, SHB Nacional, 2011;
“Rikthim i Ismail Qemalit,” botoi Lulu-USA, 2012;
“Bashkë në dashuri dhe atdhetari”, studim-Bukuresht, 2012;
“Rikthim i Ismail Qemalit”, botimi i II- SHB Nacional, 2012;
“Ankthi i së Vërtetës, botoi - botimi i dytë, SHB Nacional, 2013;
“Bashkë në dashuri dhe atdhetari”, botim i dytë, Bukuresht, 2014;
“Loja e Mëkatit”, SHB Nacinal, 2015;
“Unikale”, SHB Nacinal, 2015;
“Prolog Jete”, roman I, 2007;
“Vështroni Meduzën”, roman II, 2005;
“Dilema e së Nesërmes”, roman III, 2006.


Ese-publicistikë:

“Pa Titull”, 2011;
“Elitat e mohuara...,krenari kombëtare”, 2019.

Letërsi për fëmijë:

“10 Fabula“, 2000;
“Bëmat e dhelprës“, fabula, 2002;
“Ne jemi lulet e jetës“, fabula, 2003;
“Vogëlushja Bianka dhe kafshët e saj“, përralla, 2008;
“E dini se ç'emër kam“, fabula e gjëgjëza , 2009;
“Përrallat e vendit Blu“, cikël me përralla;
“Kuçedra dhe Dragoi“ -libri i I- përralla, SHB Nacional-2010;
“Xhuxhi dhe Gjiganti“ -libri i II-përralla, SHB Nacional 2011;
“Shoku im arushi“ -përralla - SHB Nacional -2013.

VULLNET MATO



Vullnet Mato, u lind në Sarandë më 1937. Mësimet e para i mori në qytetin e lindjes. Mbaroi Liceun Artistik të Tiranës për pikturë dhe studimet e larta në Fakultetin Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës, në degën gjuhë-letërsi shqipe. Filloi të shkruaj në vitin 1965. U pranua anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë në vitin 1970. Botoi publicistikë dhe letërsi artistike në disa organe të shtypit.

Bëri disa skenarë filmash dokumentarë dhe kronika të TVSH. Mori pjesë në festivalet kombëtare të Radiotelevizionit shqiptar, ku fitoi disa çmime për tekstet e tij letrare. Më tej, punoi mësues në gjimnazin e Librazhdi.

Me ndërrimin e sistemit u emërua shef në drejtorinë arsimore të këtij rrethi dhe u zgjodh kryetar i degës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të këtij qyteti.

Vitet e fundit jeton e punon në Tiranë. Romani i tij “Lakmia” u nderua me çmim në konkursin e Ndërmarrjes Botuese “Gjon Buzuku” të Kosovës. I janë përkthyer jashtë shtetit tregime dhe poezi të ndryshme. Punoi një kohë kryeredaktor i gazetës periodike “Domosdova” dhe më pas kryeredaktor i revistës “Obelisk”.

Vëllimeve poetike:

“Tinguj malesh” (1969), “Krahët e erës” (1972),
“Ninullat e hekurit” (1984),
“Dritaret e prillit” (1994),

Vëllime me poema:

“Katër plagë të Shqipërisë” (1999), “Nënëmadhe Fterra” (2007),

Vëllime me tregime:

“E fshehta tronditëse” (1999), “Klithmat e mishit të bardhë” (2006),
“Herbare njerëzore” (2013),

Romane:

“Ujësitor”, (1976), “Era e kësaj kohe”, (1984), “Lakmia”, (2000),
“Maturantët”, (2002), “Damkosja e engjëjve”, (2004),
”Vajza e Kyçur”(2007), “Marrëzia e madhe”, (2008),
“Nënëmadhe Fterra”, (2012, “Matura e paharruar”(2009).

Në vitin 20112, me rastin e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, iu dha titulli: Personaliteti i shquar në fushën e letërsisë dhe “Nderi i Lirisë”.

XHELADIN MJEKU



Xheladin Mjeku, u lind më 1.02.1961, në Graboc të Epërm të Prishtinës (tash nën juridiksionin kadastral të komunës së Kastriotit) Republika e Kosovës. Pas mbarimit të shkollës së mesme të mjekësisë, ka studiuar letërsi dhe gjuhë shqipe, në Universitetin e Prishtinës.

Në vitin 1978, revista letrare “Pionieri”, ia botoi vjershën e parë “*Qershori historik*” që i kushtojë 100-Vjetorit të Lidhjes së Prizrenit. Ka shkruar e botuar pothuajse në të gjitha gazetat e revistat në gjuhën shqipe, që botoheshin në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, etj, duke mos anashkaluar edhe prezantime të shumta në ëeb-faqe elektronike, që e bëjnë të pranishëm me lexuesin për katër dekada rresht. Ai është prezantuar në antologji dhe përmbledhje të përbashkëta poetike, ku mund të veçojmë: “Bedri Dedja në kujtesën tonë”, (2010), “...me Dritëronë”, (2011), “Lotët e virgjër”, (2012), në Fjalorin enciklopedik “Autorë të Letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj–1886–2017”, në Monografinë “Drenica djep i UÇK-së dhe Batalioni I i Brigadës 114 “Fehmi Lladrovci”, (2017), etj.

Është shpërblyer me shumë çmime letrare, ndër të cilat: për tregim, nga revista “Jehona” e Shkupit, Takimet poetike “Esad Mekuli” nga LSHK, nga Klubi i shkrimtarëve dhe artistëve “Drita” në Athinë dhe Klubi letrar “Petro Marko” nga Vlora. Po ashtu, ka fituar edhe disa çmime tjera, si: “Pranvera poetike-2016”, në Tiranë, çmimi vjetor për cikël poezish nga revista “Pelegrin”, për vitin 2017, në Athinë, “Sofra poetike-Ymer Elshani” - Drenas, “Peja poetike”, “Ora e Lidhjes” në Prizren, “Ora e Tahir Deskut-2019”, etj. Përveç me krijimtari letrare, autori u angazhua edhe në aktivitete të ndryshme, si në SHHB “Nëna Terezë”, pastaj në formacionet ushtarake, në Batalionin e Mjekësisë, në ZO të Drenicës, ku me përfundimin e luftës përsëri kthehet në vendin e tij të punës, në IKSHPK, etj.

Ka botuar këta libra:

“Prelud poetik”, poezi, (në bashkautorësi), 1997, “Nëna e lirisë”, tregime për fëmijë, 2012, “Në kopshtin e muzave”, poezi, 2013, “Prekja e pikëllimit”, monografi, (në bashkautorësi) 2013, “Mëkatet e Orfeut”, poezi, 2015, , “Pranvera në shtator”, poezi për fëmijë, 2015, “Panteoni i fjalës”, kritikë letrare, 2019 dhe “Hapekrah”, poezi, 2019, Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës.

XHEMIL BYTYQI



Prof. Dr. Xhemil Bytyçi, u lind në Billushë të Prizrenit, më 5 janar të vitit 1941. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në Prizren, ndërsa Fakultetin e Mjekësisë e kreu në Universitetin e Beogradit në vitin 1968. Paralel me të absolvoi edhe në degën e stomatologjisë të po këtij universiteti. Xhemili ka filluar të merret me shkrime letrare kur ishte gjimnazist. Pas kryerjes së fakultetit filloi të jep mësim në Shkollën e Mesme të Mjekësisë në Prizren. Në vitin 1973 nis punën në Klinikën e Urologjisë të Universitetit të Prishtinës. Specializimin e urologjisë e kreu në Spitalin “Rebro” të Zagrebit. Më 1986 mbron tezën e doktoratës në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës me titull *“Kontributi në etiologjinë e nefrolitiazës - studim kliniko-epidemiologjik në rajonin e Kosovës”* dhe avancohet në gradën e doktorit të shkencave mjekësore. Prof. dr. Xhemil Bytyçi ishte për shumë vjet pedagog i rregullt i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës me gradën më të lartë-profesor ordinar. Ka të botuar mbi 110 artikuj, studime e punime në revistat e specializuara profesionale nga fusha e urologjisë dhe e kirurgjisë. Në këtë institucion mjekësor dhe arsimor punoi deri në kohën e pensionimit të vitit 2006.

Përmbledhje me poezi dhe drama:

“Dëgjoj shushurimën”, botuar më 2007, “Zjarr i lënë në harresë”, më 2008, “Fijet e fjalëve”, më 2009, “Rreze yjesh”, më 2010. Më 2011 boton dramën “Martesa”, të cilën e kishte shkruar më 1960. Në vitin 2012, me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, në SHBA, në Shtëpinë botuese “Amazon” botohet përzgjedhja e 100 vjershave të tij në përmbledhjen me titull “Në brendinë e fjalës”. Më 2011 disa poezi të tij përkthehen dhe botohen në Varshavë në gjuhën polake. Në 2014 ka botuar përmbledhjen me poezi të titulluar “777 haiku - shtigjeve të shpirtit”. Në vitin 2015 po ky libër i është botuar edhe në “Amazon”. Xhemil Bytyçi poashtu është prezantuar me një numër të konsiderueshëm të poezive në gjuhën angleze në “Antologjinë e poezisë botërore”. Në vitin 2015 botoi përmbledhjen me tri drama “Gjurmët e shpirtit të heshtur”, “Kontejnerët e qytetit tim” dhe “Sokrati i vuajtur”. Përmbledhja me poezi lirike e tipit japonez Tanka e titulluar “Vallëzim yjesh”, e botoi më 2016, Xhemil Bytyçi është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës.

XHEVAT LIMANI



Xhevat Limani është i lindur më 1 janar 1953, në Fierishtë-Strugë. Shkollën fillore e kreu në Frëngovë-Strugë. Tetëvjeçaren në Ladorisht, Gjimnazin e kreu në Strugë. Studioi Aktrim dhe Gjuhë e letërsi shqiptare. U diplomua në vitin 1974 (Student i parë shqiptar i Aktrimit në Maqedoni. Gjatë vitit shkollor 1974-1975 punoi si profesor i gjuhës dhe letërsisë në gjimnazin e Strugës. Nga 1975-2002 punoi si Aktor profesionist në Teatrin shqiptar në Shkup. Nga viti 2002 jeton dhe vepron në SHBA, ku themeloi Teatrin shqiptar në Amerikë (Albanian Theater in America).

Ka luajtur mbi 100 projekte teatrore dhe mbi 7000 shfaqje në mbi 50 shtete të botës. Maqedoni, Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë, Mali i Zi, Slloveni, Itali, Albanesi, Kosenza, Austri, Zvicër, Gjermani, Holandë, Belgjikë, Francë, Spanjë, Suedi, Norvegji, Poloni, Çekosllovakia, Rumani, Greqi, Angli, Turqi, Egjipt, Burkina Faso, SHBA. Etj.

Rolet që kanë lënë gjurmë në historikun e Teatrit shqiptar:

Lulashi-drama “GOF”, 1979, Besniku tek “Jeta”, Sekretari “Përtej vdekjes”, Rudolfo-tek drama “Pamja nga ura”, Nuri budalla tek drama “Ditët për ikje”, Dhëndrri tek “Gomari”, Burri në Pikturë “Muzeu” Skënderbeun tek “Skënderbeu”, tragjedi, Paralajmëruesi tek “Mësuesi”, Kapiten Misho-drama “Muri i lotëve”, “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” etj.

Ka luajtur në filmat:

“Rruga pa kthim”, “Nata”, “Kolonel bunkeri”, “Rrugët që vrasin”, “The Journey”, “Privat life of pipa lee”, “Proof”, etj.

Filma dokumentarë skenarist dhe regjisor

“Frëngova në dimër”-RTM, “Nositi në vallen e vdekjes”-RTM, “Dhembja blu”-RTM, “Të parët”-RTM, “Ëndrra dhe lot”-RTM, “Sulm e lot”-RTM, “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu”-Qendra Radiodifuzive republikane, Fitues i konkursit për skenar-RTM, “Faleminderit Amerikë”-AA Vision, “Ethe dhe gjethe”-RTM, “Virtuozët në Zamare”-Albanian cultural TV, “Shqiptarët e Amerikës”-Albanian TV, “Demir Lena”-RTM-Shkup etj.

Ka botuar librat:

“Pranverë dimërore” - poezi, “Albaniada” - tetë drama, “Varrtarët”-dramë, “Anatema”-dramë, “Muri i lotëve”- dramë, “Ora shqiptare”, - poemë, “Antimemorandum”-Ese dhe dramë, “Agron Mirdita”-poemë, etj.

XHEVDET SHALA



Prof. Asistent Xhevdet Shala, u lind në Loxhë të Pejës më 3.08.1958. Shkollën fillore dhe Gjimnazin e mbaroi në Prishtinë. Studimet themelore dhe ato të magjistraturës i kreu në Fakultetin Juridik në Prishtinë. Ka arritur titullin Doktor i të drejtës civile me temë: “*Komasacioni i tokës bujqësore*”. Nga viti 1986 ka filluar punën në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Ishte pjesë e zhvillimeve për demokratizimin e jetës në vend. Ishte njëri nga themeluesit e Sindikatës së pavarur të punëtorëve të shëndetësisë së Kosovës. Pas largimit masovik nga puna në vitin 1990, u angazhua në krijimin e institucioneve të Kosovës, ashtu që në vitin 1991 ishte në krye të administratës së Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Për shkak të aktivitetit të tij në jetën publike në vitin 1994 ishte i detyruar të largohet nga vendi. U vendos në Shqipëri ku mbajti lidhjet në mes Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë dhe Sindikatës së Pavarur të punëtorëve të shëndetësisë dhe me shumë institucione homologe jashtë Kosovës. Pas gjashtë muajsh kaloi provimet për ushtrim të profesionit të avokatit dhe u bë anëtarë i Dhomës së Avokatisë së Republikës së Shqipërisë. Nga viti 1999 ishte pjesë e liritimit dhe themelimit të institucioneve të Kosovës. Pas vitit 1999, u përzgjedhë Zëvendës Drejtor i Qendrës Klinike Universitare në Prishtinë. Pastaj udhëhoqi zyrën Ligjore në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Aktualisht është Dekan i Fakultetit Juridik në Kolegjin Universitar “Iliria” në Prishtinë, ku mban titullin Akademik Profesor Asistent i të Drejtës civile dhe Sendor.

Është anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës dhe Arbitër i përherëshëm në Këshillat e Arbitrazhit të Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës Ekonomike Amerikane të Kosovës.

Publikime:

1. Shala Xh., Land consolidation in Kosovo (legal obstacles) PhD Thesis, February 2017, European University of Tirana,
2. Shala Xh., Vertical organization of cadastral services, European Academic Research, 2016,
3. Meha M., Shala Xh., and Kadiri Q., Border between Kosovo and Montenegro According to official documents and international agreements, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës-Vjetar 52, Pristina, 2016, si dhe dhjetë punime tjera me vlerë shkencore, etj.

YMER ELSHANI (1948-1999)



Ymer Elshani, u lind më 1948, në Korroticë të Poshtme të Drenasit. Kreu fakultetin për gjuhë dhe letërsi shqipe, në vitin 1972 dhe një kohë të gjatë punoi në arsim. Filloi të shkruante poezi që në moshën 10 vjeçare. Në fillim e nxiti dhe i ndihmoi daja i tij, mësuesi Fazli Greiçevci. Si nxënës i klasës së shtatë botoi poezinë e pare, “Për gjah” në revistën ”Pionieri”, nr. 6 të vitit 1962.

Botoi dhjetëra libra për fëmijë me poezi, tregime dhe romane.

U vra dhe u masakrua më 17 prill 1999 nga forcat ushtarake policore serbe në fshatin Poklek të Vjetër, të Drenasit bashkë me gruan, katër djemtë, nënën, kunatën dhe me afro gjashtëdhjetë bashkëfshatarë të tij. Veprat e tij janë ribotuar edhe pas lufte.

Veprat:

1. “Anija e miqësisë”, (vjersha)-Rilindja, Prishtinë, 1972,
2. “Çka ëndërrojnë lulet”, (vjersha)-Rilindja, Prishtinë, 1971,
3. “Ndodhitë e Hundëkarrotës”, (roman)-Rilindja, Prishtinë, 1971, 1979, 2000, Naim Frashëri, Tiranë, 1987,
4. “Loti udhëtar” (tregime)-Rilindja, Prishtinë, 1977,
5. “Ishulli i lumturisë” (tregime)-Rilindja, Prishtinë, 1973,
6. “Aventurat mbi trotinetin e vjetër”, (roman)-Rilindja, Prishtinë, 1975,
7. “Guri i çmueshëm” (tregime)-Rilindja, P.1977, OSCE, Sh. 1999,
8. “Unaza magjike” (vjersha)-Rilindja, Prishtinë, 1980,
9. “Plaku me violinë”, (tregime)-Rilindja, Prishtinë, 1984 1,
10. “Kalorësi i bardhë”, (poemë)-Rilindja, Prishtinë 1987,
11. “Përjetimet e bardhoshit”, (tregime)-Rilindja, Prishtinë, 1989,
12. “Ylli ëndërrimtar” (vjersha)-Rilindja, Prishtinë, 2000,
13. “Vajza e diellit” (tregime)-Rilindja, Prishtinë, 2000,
14. “Njohja e trimave” (tregime e përralla), Rozafa, P.2000,
15. “Përralla për ylberin” (poemë), Rozafa, Prishtinë, 2000,
16. “Gjeli i kuq” (tregime të zgjedhura), Asdreni, Sh, 2000,
17. “Zogu i lirisë” (vjersha), Zef Serembe, P, 2001,
18. “Le të vijë në Sharr pranvera”, (poema), Rozafa, P. 2002,
19. “Gjelastreni mendjelehtë” (vjersha), Gutenberg, 2001,
20. “Flokargjendta”, (tregime të zgjedhura), Rozafa, Prishtinë, 2004,
21. “Udhëtimet e Xhuxhimaxhuxhit”, (roman), Prishtinë, 2008 etj.

ZEF KAKOCA



Giuseppe Cacoza (i njohur artistikisht si Pino Cacoza dhe në shqip Zef Kakoca), u lind më 27 shtator 1957, në Shën Mitër, katund arbëresh i Kalabrisë në Itali.

Studimet klasike te Kolegji i Shën Adrianit i mori në Gjuhë dhe Letërsi të Huaj, në vitin 1980, tek Universiteti i Kalabrisë. Punon si profesor i gjuhës franceze në Rossano. Është linguist, letrar, shkrimtar, poet, aktor dhe kant-autor i Arbërisë. Ai fitoi gjashtë herë në Festivalin e Këngës Arbëreshe. Bëri aktivitete kulturore, artistike,

këngëtare e teatrale në të gjitha komunitetet arbëreshe, në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni në Malëzi (Ulqin).

Ka qenë ideatori i Festivalit të Fëmijëve Arbëreshë në vitin 1985. Është President i Shoqatës Arbitalia, e para gazetë arbëreshe. Në vitin 2009 mori në Napoli “Çmimin Mesdhetar për Artin dhe Kreativitetin”. Në vitin 2010, si përfaqësues i letërsisë arbëreshe, merr pjesë në eventin “Struga Poetry Evenings”.


Është anëtar i Komitetit Shkencor për Vlerësimin e Komuniteteve Arbëreshë në Zyrën Rajonale të Shkollës në Kalabri. Ka qenë anëtar i Komitetit Shkencor i Institutit Regjionale të Kalabrisë për Komunitetin Arbëresh. Është president i Shoqatës “Arbëreshë në Corigliano-Rossano. Në vitin 2015 Presidenti i Republikës së Shqipërisë Bujar Nishani e dekoron me Titullin “Naim Frashëri”.

Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Në muajin korrik 2017 boton romanin e parë “La Terra di Yll”, Ferrari Editore.

Bibliografia:

AA. VV. “Këngë popullore nga Shën Benedhiti”, 1984, “Elmo Italo (a cura di), S. Benedetto Ullano-La storia attraverso le immagini”, 1985, “Università della alabria, Omaggio a De Rada-Homazh” për De Radën, 2004, AA. VV., “Spigolature, II ed. recital di poesie”, 2007, “Rrënjat e Arbërisë” - “Le radici dell'Arberia”, 2009, “Antologia della letteratura degli Albanesi di Calabria”-“Antologji e letërsisë së arbëreshëve të Kalabrisë”, 2009, “Rrënjat e Arbërisë Le radici dell'Arberia”, 2013, “Një fjetë jete”-“Un foglio di vita”, 2016, “Rrënjat e Arbërisë” (Le radici dell'Arberia), “IV Edizione”, “Arbitalia Edition”, 2019. “I percorsi dell'Arberia” (Udhëtimet e Arbërisë), Infinity Books Ltd, Malta, 2019 etj.

ZEF MULAJ



Zef Mulaj, u lind në Nikaj-Mërtur të Malësisë së Gjakovës (Tropojë), në fshatin Qeresh-Mulaj. Ka shkruar poezi qysh në rininë e tij. Ka mbaruar studimet e larta në Fakultetin e Mjekësisë, Tiranë (Dega Farmaci). Ka punuar shumë vite në zonat e vendlindjes. Veç punës si farmacist, është marrë gjithnjë me kërkime shkencore në fushën e tij, sidomos në studimin e bimësisë mjekësore të alpeve të Shqipërisë. Në vitin 1994 vendoset në mënyrë legale në Itali, me një bashkëpunim shkencor në fushën e tij. Në vitin 1998, mbaroi përsëri studimet e larta në universitetin Camerino të Italisë, ku mbrojtiti titullin Doktor në shkencat farmaceutike, pikërisht në studimin e bimësisë mjekësore të alpeve të Shqipërisë. Specialist në farmakonjozin, e fitoterapin. Ekspert internacionale për bimët mjekësore. Specialist në toksikologjinë klinike e ambientale, Toksikologjinë forense. Specialist në farmakovigjilancën mjekësore. Master universitar në "Metodat Analitike Forense" Universiteti La sapienza Roma. Specialist në kontrollin kimik të prodhimeve dhe lëndës së parë në medikamentet mjekësore. Ka publikuar mbi 40 artikuj dhe studime shkencore në fushën e tij. Në vitin 2009 publikoi studimin me 880 bimë mjekësore në alpet e Shqipërisë. Specialist në informatikën aplikative. Anëtar i disa shoqatave kulturore e shkencore në Evropë, si "Leopardian Community", etj.

Është Anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve në qytetin ku jeton, në Itali. Anëtar i organizatës botërore të poetëve (world poets Society W.P.S.). Anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Merr pjesë në koncertet recitale dhe konkurset e organizuara në Itali në fushën e poezisë. Në vitin 2017 mbron përsëri titullin Dr. në "Metodologie Analitiche Forense" në Universitetin "La Sapienza", Roma.

Vepra letrare dhe shkencore:

"Emri që lind diellin", poezi, Tiranë 2004, "Mjegull varur mbi Ballkan," poezi, Tiranë 2006, "880 bimë mjekësore në Alpet e Shqipërisë", Tiranë, 2009, "Imazh", roman, 2011, "Prendi per mano la mia ombra" (Merr për dorë hijen time), poezi, botuar italisht në Simple Macerata, 2011, "Lulet e shpirtit", poezi, Tiranë, 2012, "Memory" - Roman, Tiranë, 2012, "Altri occhi all'orizzonte" poezi, "Pieni di sogni i fiumi", Itali, 2014, "Hëna nuse e poetit" 2015, Tiranë, "Sguardo oltre i confini romanizo", Itali 2015. etj.

ZEF PËRGEGA



Zef Pergega, u lind në Lezhë më 1957. Shkollën fillore e kreu në Rubik, të mesmen në shkollën “7 Nendori” në Tiranë, ndërsa fakultetin për Gjuhë dhe Letërsi shqipe e kreu në Universitetin “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës. Zefi, punoi në gazetën e parë të pavarur “Koha Jonë” (1990 dhe më pas 1998 -1999). Ishte kryetar e më pas Zëvendëskryetar i këshillit botues te saj. Redaktor në ATSH (Angjensia Telegrafike Shtetërore e lajmeve në Tiranë,1993-1998). Nga viti 1990-1993, ishte gazetar i jashtëm për gazetën “Rilindja Demokratike” në Tiranë, si dhe botues i gazetës periodike “Kaltërsia” në Lezhë. (1994).

Në mars të vitit 2002, Zef Pergega themeloi në Detroit “Albanian-American Institute”, të cilin e drejton me objektivin e qartë, promovimin e vlerave kulturore të të dy popujve tanë. Është President i “Albanian-American Institute” 2002, në Amerikë.

Botoi revistën periodike “Shqiptari” në Amerike. Është në bordin e gazetës shqiptaro-amerikane “Illiria” dhe redaktor i revistës “Trojet Tona” New-York. Zef Pergega në televizionin e shqiptarëve në Detroit ACTV, drejton programin “Ora Shqip” si dhe anëtar i “Amnesty International”. Prej 18 vitesh drejton rubrikën editoriale dhe emisionin shqip “Jetë mërgimi” në Albdreams TV.


Mban dekoratën e lartë “Naim Frasheri”, në Shqipëri si dhe “Pontifika”, nga Shteti i Vatikanit, Itali si dhe vlerësime e çmime të tjera. Shkrimet e tij janë botuar në shtypin botëror në disa gjuhë si anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, etj. Jeton në Detroit nga viti 1999.

Librat e botuar:

1. “Deti dhe Peshku” Fabula. 1998,
2. “Vigan në Krisht e vatan”. Monografi, kushtuar Dr. Zef Oroshit, 2003,
3. “Këmbana e mërgimtarit”, Publicistikë në Amerikë, 2003,
4. “Simbolikë në Michigan” Publicistikë, 2004,
5. “Dheu i Atit”, poezi, 2006,
6. “Sarajat” (Vështrim historiko-letrar për kapedanët e Mirditës), 2008,
7. “Kallnori në Detroit”, poezi, 2009,
8. “Djepi i thyer” (Vështrim historiko-letrar për vendlindjen), 2010,
9. “Ylberet e Shêjzave”, 2010, (kushtuar Prof. Ernest Koliqit e M. Camaj),

10. "Lerëni kohën të flasë", poezi, 2011,
11. "Zjarri shqip regetin", publicistikë, 2011,
12. "Zëri im Prishtinë", publicistikë, 2012,
13. "Ora e Rodit", Publicistikë,
14. Triptik "Prilli në Bronx", tregime,
15. "Përtej lotit",
16. "Valesi i Delfineve", (Poezi të zgjedhura),
17. "Fabula", 2013,
18. "Kristale Dukagjini", 2010,
19. Vështrim letrarohistorik kushtuar Dom Prek Ndevashaj.
20. "Çamëri moj Çamëri",
21. "Krahu i Shqiponjes" 2014,
22. "100 Vjet shqiptar në Amerikë", 2014,
23. "Dritë Françeskane", (në Malësi të Madhe) Vështrime, 2014,
24. "Shqiponjat fluturojnë lartë", kushtuar vizitës së Papa Franceskut në Shqipëri, 2015,
25. "Vokacioni i Premtuar", 2016,
26. "Malesoret" 2017,
27. Vështrim etno-kulturor kushtuar traditës së malësoreve në Mal të Zi dhe në Amerikë, 28. "Lisi i Tamlit", 2019,
29. "Mrizet e lotit", poezi dhe skica poetike,
30. "Arkemortja e ishullit mbi gjak", kushtuar persekutimit të shqiptarëve në trevat e tyre në Mal të Zi,
31. "Abat Doci një djalë Shypnije", kushtuar veprimtarisë së Abatit të Mirditës Prend Doçi, kryesisht në Newfoundland të Kandasë (1883 -1888),
32. "Nanat lindin kapedanë", kushtuar të kapedanit të Mirditës Gjon Marka Gjoni,
33. "Bijtë e Pajtores", kushtuar veprimtarive fetare e patriotike në Detroit,
34. "Mendja bletë nën kësulë të mirditorit",
35. "Shtrebat" (roman që ka temë emigracionin),
36. "Diçka gdhenda me emrin tënd", (kushtuar poetit Ded Shkurti),
37. "Pergega në Floripress", publicistikë për Kosovën,
39. "Dheu i salvimit", Një studim mbi krishterimin në trevat shqiptare në Mal të Zi, etj.,
40. "Doktor Theologu", krijimtari poetike dhe publicistikë e Dr. Zef Oroshit.

ZEF ZOBRA (1920-1993)



Zef Zorba, u lind më 1920, në Kotorr të Malit të Zi në një familje shqiptare. Mbas mbarimit të gjimnazit në Shkodër, më 1941 regjistrohet në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, dega e Studimeve Politike në Universitetin e Padovas në Itali. I ndërpret studimet më 1943 për shkak të Luftës së Dytë Botërore dhe kthehet në Shkodër, ku fillon punën si nëpunës banke. Në vitet 1945-1946 punësohet si regjisor në Shtëpinë e Kulturës së Shkodrës, ku vë në skenë mjaft pjesë dramatike me tingëllim të qartë desident si "Juda Makabe" e Fishtës, "Armiku i Popullit" i Ibsenit etj. Ndoshta edhe për këtë arsye arrestohet më 1946 dhe burgoset nën akuzën e agjitacion e propagandës. Vuan dënimin ndër kampet e punës dhe "riedukimit" deri në vitin 1951. Më vonë punoi në ndërmarrje të rrethit të Shkodrës si llogaritar deri në vitin 1980, kur dhe del në pension. Ndërron jetë më 6 janar 1993, në Shkodër.

Zef Zorba është një nga poetët më të shquar të letrave shqipe të gjysmës së dytë të shekullit të njëzetë, pra e asaj periudhe, që është quajtur si kohë e komunizmit shqiptar. Ai zgjodhi rrugën e krijimit të poezisë, që nuk do të shihte dritën e botimit.

Libri i tij i parë, "*Buzë të ngrira në gaz*", u botua pas vdekjes pasi kishte shkruar tinëz përgjatë diktaturës komuniste në Shqipëri, cilësuar si "letërsia e sirtarit". Çmohet si një poet i veçantë i letërsisë shqiptare dhe përfaqësues kyç i modernizmit dhe hermeticizmit.

Është cilësuar ndër autorët klandestinë me Kasëm Trebeshinën, Daut Gumenin, Primo Shllakun që në qerthullin e vogël të tyre rimerin fillin e këputur të vazhdimësisë së letërsisë shqiptare dhe e rimëkëmbnin lidhjen me autorë si Mitrush Kuteli, Ernest Koliqi e Lasgush Poradeci.

Zef Zorba , është një poet antologjik. Ai ka refuzuar të botojë në kohën e diktaturës dhe refuzimin e kishte estetik. Ndërkohë që gjithë poetët e tjerë merreshin me poezinë totalitare, ai ka përkthyer poetët më të mëdhenj të shekullit njëzet, si Ungareti, Montale, Kuazimodo, Eliot, Frost, etj, përkthime këto që Zorba i ka lënë si libra të përfunduar, gati për botim". "Zorba është një zë i vetmuar në shkretëtirën e asaj kohe.

Poezia e tij është e rrallë në të gjithë Evropën Lindore, pasi në asnjë nga vendet ish-komuniste nuk është shkruar në këtë mënyrë dhe s'ka pasur refuzime të kësaj natyre si rasti i Zorbës.

ZEJNULLAH RRAHMANI



Zejnullah (Sadri) Rrahmani është i lindur më 1952 në Ballofc të Podujevës. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në Podujevë. Ka studiuar dhe është diplomuar në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, në Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Studimet pasuniversitare dhe magjistraturën i kreu në Degën e Letërsisë Shqipe, 1984. Më 1985 doktoroi në shkencat filologjike në Prishtinë. Ka punuar në revistën “Fjala” katër vjet si gazetar dhe redaktor. Në Fakultetin Filozofik (tash Fakulteti i Filologjisë) punon prej vitit 1977, ku është profesor për lëndën Teori e letërsisë. Nga viti 1992 deri më 1996 ka qenë dekan i Fakultetit të Filologjisë. Nga viti 1970 është anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Në fushën e krijimtarisë letrare shkruan zhanret e prozës (roman, novelë, tregim). Nga viti 1992 ka qenë anëtar i Këshillit Nacional për programet e letërsisë si dhe anëtar i Këshillit për unifikim të teksteve e të programeve nacionale të Kosovës e të Shqipërisë 1992-1998. Aktualisht është kryetar i Këshillit të Doktoratës të Fakultetit të Filologjisë. Anëtar korrespondent i ASHAK-ut 2012.

Tekste mësimore:

“Njohuri nga teoria e letërsisë”, Tiranë, Libri shkollor, 1996,97,98, 2000,
“Teoria e letërsisë për shkollat e mesme”, Prishtinë, 1997, 1999,
“Teoria e letërsisë”, Fakulteti Filologjik, Prishtinë 1996,
“Si të shkruhet disertacioni”, Prishtinë, 2001,
“Arti i poezisë”, Prishtinë, 2001,
“Shkrimi dhe leximi”, Prishtinë, 2003.

Vepra letrare:

“Zanoret e humbura”, roman, 1974, 1979, “Udhëtimi i një pikë uji”,
novelë, 1976, “Sheshi i unazës”, roman, Prishtinë, 1978, Tiranë 1982,
Prishtinë 1985, “E bukura e dheut”, roman, 1987, “Udhëtimi arbdhetar”,
roman, 1992, “Mjeshtri i vetmisë”, tregime, 1995, “Jusufi”, roman, 1999,
“Romani për Kosovën”, roman, 1999, “99 Rruzaret prej smaragdi”, 2006.

Vepra - studime:

“Nga teoria e letërsisë shqipe”, Prishtinë, 1986, “Teoritë letrare klasike”,
Prishtinë, 2001, “Malësorja e Nazmi Rrahmanit ose Arti i interpretimit”,
Prishtinë, 2001, “Arti i poezisë”, Prishtinë, 2001, “Letërsia e Mesjetës”,
Prishtinë, 2002, “Teoritë letrare moderne”, Prishtinë, 2005, etj.

ZEKË SINANAJ



Zekë S. Sinanaj, u lind më 2 korrik 1957, në fshatin Isnîq të Deçanit. Ka mbaruar studimet bazike të juridikut, në Universitetin e Prishtinës. Nga viti 1984 ka punuar si gazetar në Radio Televizionin e Prishtinës (RTP), deri në korrik të vitit 1990, kur ai dhe kolegët e tij u larguan dhunshëm nga regjimi serb. Gjatë 90-tave ka shkruar për gazetat: "Bujku", "Gazeta Shqiptare", "Kombi" dhe "Dielli". Reporter për Radio Zagrebin, në emisionin informativ në gjuhën shqipe, ku po ashtu gjatë kësaj kohe ka qenë ndër drejtuesit e Qendrës për Informim të Kosovës – QIK, në Deçan. Për shkak të veprimtarisë së tij, disa herë është arrestuar dhe maltretuar nga forcat e regjimit të atëhershëm. Gjatë luftës së fundit në Kosovë, ka raportuar për zonën e Dukagjinit në medime të ndryshme, si reporter i rregullt në Radio Televizionin Shqiptar - Programi Satelitor. Ka bashkëpunuar edhe me Radio Deutsche Welle, Radio Zëri i Amerikës, Radio Free Europa dhe me agjencione të ndryshme për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Me raportimet dhe xhirimet e tij ka arritur ta sensibilizojë opinionin vendor e ndërkombëtar rreth dhunës dhe masakrave që ushtronte pushteti serb i kohës. Në veçanti, raportimet për masakrën e 25 Majit 1998 dhe 1 Prillit 1999, të dyja në fshatin Lybeniq, ku u masakruan rreth 100 persona. Pastaj masakrën e Belegut, atë të Mejës si dhe zhvillimet luftarake që bëheshin në mes të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave serbe. Pas luftës ka vazhduar punën si gazetar/redaktor në Radio Televizionin e Kosovës. Me shpërthimin e luftës në Luginë të Preshevës është angazhuar si reporter në luftimet e drejtpërdrejta. Njëherit ka përcjell edhe bisedimet e palës shqiptare dhe serbe për arritjen e marrëveshjes në Konqul dhe Lluçan. Ka realizuar rreth 20 filma dokumentarë, po ashtu ka realizuar shumë emisione-reportazhe nëpër treva të ndryshme shqiptare dhe me gjerë, si në Plavë e Guci, Tuz, Rozhaj, Zarë të Kroacisë, Maqedoni dhe Shqipëri.

Dokumentarë Televiziv në RTK:

“Kthimi i heroit Rrustem Bruqi”, “Arkivolet e Tmerit” (kushtuar ushtarëve të vrarë në ish APJ-në), “Ora e Babës” (dedikuar familjës Januzi të fshatit Mazhiq të Shalës së Bajgorës), “Ora e Atdheut” (dedikuar atdhetarit Hoxhë Zekë Berdynaj), “Mbijetesa” (kushtuar shqiptarëve në Rozhajë të Malit të Zi), “Arbneshët e Zares”. etj.

ZEKERIJA IDRIZI



Zekerija Idrizi, u lind në vitin 1969, në lagjen e Dizhonit në Shkup. Shkollën fillore dhe të mesmen "Medreseja Isa Beu" i kreu në Shkup. Studimet e larta i ndoqi në Fakultetin e Shkencave Islame, në Sarajevë. Botoi qindra shkrime në revistën informative, kulturore e shkencore islame "Hëna e re", organ ky i Bashkësisë Fetare Islame, në Maqedoni. Herë pas herë, botoi edhe në gazetat tjera shqipe si në: "Flaka" (Shkup), "Fakti" (botimi në diasporë dhe Shkup), "Koha ditore" (Prishtinë) dhe "Bota sot" (Cyrih). Gjithashtu botoi edhe në revistat: "Familja" (Tiranë) dhe "Dituria Islame", organ ky i Bashkësisë Islame të Kosovës. Deri më tani ka përkthyer nga gjuha boshnjake veprën kapitale "E drejta islame" (Islamsko pravo) të autorit dr. Jusuf Kardavi (botoi BI, Shkup, 1995) dhe si bashkëpërkthyes nga arabishtja veprën "Të vërtetat esenciale të Islamit" (El-Hakaiku-l-Esasiyyetu lil-islam) të autorit Abdullah Sead (botoi BI, Shkup, 1994). Romani i tij "Arratisja nga "vdekja" është ribotuar disa herë.

Veprat:

"Mozaiku fetar dhe çështja kombëtare", botoi KShM, Shkup, 1997,
"Xhamia në analet e historisë-Hoxhallarët dhe tempujt fetarë në shërbim të çështjes kombëtare", Cyrih, 2009,
"Letër bijave të mia", botoi, Amanda Edit, Bukuresht, 2015,
"Veprimtaria universale e imamit në kurbet", SHB "Shkupi", Shkup, 2015
"Fundamentalizmi islamik i fiksion dhe myslimanët antifundamentalistë", botoi Bashkësia Fetare Islame në RM, Shkup, 2015,
"Letra shpirti", SHB "Shkupi", Shkup, 2016,
"Tradhtia me profil dhelprë , Megaintervistë me H. Sulejman ef. Rexhepin, Reisul Ulema i BFI në RM", Biblioteka "Hëna e Re", Shkup, 2017, po këtë vit u botua edhe në gjuhë maqedone "Predavstvo so profil na lisica - Megaintervju so H. Sulejman ef. Redzepi, Reisul Ulema na IVZ vo RM"
"Stop dukurive negative në shoqëri", Biblioteka "Hëna e Re", Shkup, 2017,
"Letër bijave të mia", ribotoi SHB "SHKUPI", Shkup, 2017,
"Në botën e artit", Bukuresht, 2017,
"Arratisja nga vdekja", roman psiko-filozofik, SHB ProkultPress, Prishtinë 2017 dhe SHB Grand Print, Tiranë, 2017.
"Vështrime estetike e letrare", SHB ProkultPress, Prishtinë, 2017.

ZEQIR BEKOLLI



Zeqir Bekolli, është lindur, më 26.6.1956, në fshatin Korroticë e Epërme, komuna e Drenasit. Shkollën fillore dhe atë të mesmen e kreu në vendlindje. Fakultetit Filozofik, dega e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe e mbaroi në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” në Prishtinë, në vitin 1981.

Më pastaj, ka kryer shkollën e tretë-Master, më 2007, me ç'rast mori titullin: Master i Komunikimeve Masive.

Në periudhën 198-1882 ka punuar në gjimnazin “Skënderbeu“, në Drenas.

Në këtë periudhë ka rënë në konflikt me strukturat politike të sistemit totalitar dhe për tre vjet me radhë mbetet i pa punë.

Nga viti 1985, deri te viti 2002 ka ushtruar profesionin e gazetarit te gazeta “Rilindja” (“Bujku”) dhe “Radio Rilindja”-Prishtinë.

Një vit (2002-2003) ishte redaktor te gazeta “24 Orë”. Në Ministrinë e Shërbimeve Publike, nga viti 2003-2008, ishte në cilësinë e Zyrtarit të Lartë të Raportimit. Nga vitit 2008 punon në MAP, si drejtor i Zyrës për Komunikim me Publikun.

Gjatë punës në gazetari ka shkruar qindra artikuj, reportazhe e intervista të ndryshme. Kurse gjatë luftës në Kosovë ishte reporter lufte me ç'rast publikoi librin publicistik “Drenica në Stinët e UÇK-së” (1998).

Botimet:

“Gani Helshani luftëtar- artist-shkrimtar”, monografi, (2002),

“Bejta Trimi i tigrave të zinj”, monografi, (2002),

“Krismat e Lirisë”, dramë, (2001),

“Fatet tragjike”, roman, (2006), dhe

“Të pathënat për luftën e Kosovës”, publicistikë, (2013).

Meqë ishte pjesë e luftës në Kosovë, ka publikuar edhe albumin e luftës me mbi 500 fotografi te titulluar:


“Dëshmi për krimin serb në Kosovë”, (2014).

Zeqir Bekolli ishte gazetari i parë që raportoi për Betejën dhe masakrën e forcave serbe në Likoshan e Qirez.

Gjatë periudhës sa ishte gazetar aktiv dy herë është shpallur gazetar viti nga gazeta “Rilindja” (“Bujku”), më 1996 dhe 1998.

Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës.

ZEQIR BERDYN AJ



Zeqir A. Berdynaj, u lind më 6 qershor 1934, në Firzë, ish katundi i Ri i komunës së Pejës.

Shkollën fillore dhe të mesmen e kreu në vendlindje, ndërkaq Fakultetin e Drejtësisë e kreu në Sarajevë në vitin 1965.

Ishte ndër shqiptarët e parë që punoi mësues nga viti 1958, në Ujmirë të Klinës, pastaj punojë në disa shkolla të Drenicës dhe në Llapushë, kurse në vitet e '60-ta ishte mësues në Jabllanicë.

Zeqir Berdynaj i kthehet profesionit të tij prej juristi, profesion ky i rëndë, i vështirë por që ishte me rëndësi të veçantë që edhe shqiptarët të gjenden aty për ta ndihmuar çështjen e shqiptarëve nën një regjim të rëndë e të egër të pushtuesit serb.

Prandaj, Zeqiri, këtë profesion e kreu me e nder dinjitet të lartë prej shqiptari sepse, më në fund, Zeqiri rrjedhë nga një familje me virtyte të larta kombëtare nga familja e Mulla Zekë Berdynajt, familje shumë e njohur në Rrafshin e Dukagjinit dhe më gjerë.

Zeqir Berdynaj me krijimtari letrare ka filluar të merret që nga shkolla e mesme, por që krijimtarinë e tij, deri në vitin 2004 nuk e nxori në dritë, ndoshta për shkak të kohërave të liga...

Veprat:

- 1."Lisi", Sh.B."Albi", Prishtinë, 2004
- 2."Dri ,o Dri", Sh.B."Albi", Prishtinë, 2005
- 3."Delfina", Sh.B." Druck Art", Prishtinë, 2005
- 4."Rruga e kombit", "Illyricum", Prishtinë-Zagreb, 2017
- 5."Djali nga Gllogjani", "Illyricum", Prishtinë-Zagreb, 2017.

Vepra publicistike:

"Mërgimi rrugë e dështuar", "Fjala jonë", Prishtinë, 1997.

Si dhe dy librat e tij që janë në botim: "Drenusha" dhe

"Dega dhe Lisi", janë vazhdimësi poetike, që gjithsesi shënojnë nivele të reja në krijimtarinë e tij poetike.

Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, si dhe anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve Shqiptare Amerikane në Nju Jork, Prishtinë, Tiranë dhe Shkup.

Zeqir Berdynaj krahas profesionit të tij si avokat, ai nuk ndalon së shkruari, duke e pasuruar krijimtarinë e tij letrare... jeton dhe vepron si avokat në Pejë.

ZYMER NEZIRI



Prof. Dr. Zymer Ujkan Neziri, u lind më 6 nëntor 1946, në Siparant (Zahaq) të Pejës.

Në vendlindje dhe në Pejë kreu shkollën fillore në vitin 1960. Gjinnazin e kreu në Pejë (1964) dhe Shkollën Normale e kreu në Prishtinë (1966).

Kreu studimet e larta në Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe në Shkollën e Lartë Pedagogjike, në Prizren (1969) dhe studimet e shkallës së dytë në Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe në Fakultetin Filozofik të Prishtinës (1971). Në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, gjatë viteve

1972-1974, vijoi edhe mësimet e studimeve të shkallës së tretë në Degën e Letërsisë dhe mbrojti magjistraturën. Në Fakultetin Filozofik të Prishtinës mbrojti disertacionin e doktoratës, 1995.

Puna gjatë studimeve:

Gjatë studimeve, 1967-1971, punoi përkohësisht në dy shkolla fillore (Zllakuqan dhe Klinë) dhe në katër shkolla të mesme (Lipjan, Pejë, Prizren dhe Prishtinë). Për shkak të veprimtarisë në Lëvizjen Studentore të vitit 1968 në Kosovë, e larguan nga puna .

Më 1971, pas mbarimit të studimeve themelore, u pranua asistent në Degën e Folklorit dhe të Etnologjisë të Institutit Albanologjik të Prishtinës, nga e cila e përjashtuan më 1973.

Për shkak të veprimtarisë së tij atdhetare, ka qenë tri herë i arrestuar dhe pesë herë i përjashtuar nga puna.

Shumë vite punoi përkthyes dhe lektor në Bankën e Kosovës (1977-1990). Në revistën shkencore të Institutit Albanologjik të Prishtinës ka filluar të botojë tek në fund të viteve 80.

Puna në Institut pas vitit 1992:

Pas zhbërjes së Federatës Jugosllave, organet drejtuese të Institutit e lejuan që të kthehet sërish në Institut, pas 19 vjetësh, në qershor 1992.

Ka qenë udhëheqës i Degës së Folklorit dhe anëtar i Këshillit Drejtues të IAP-it (1996-2003). Ka qenë edhe anëtar i redaksisë të revistës. “Gjurmime albanologjike, Folklor dhe etnologji”, 2006-2013, ku ishte sekretar shkencor më 1972-1973.

Ka marrë tituj, bashkëpunëtor shkencor, profesor asistent, më 1996, bashkëpunëtor i lartë, profesor i asociuar, më 2000, këshilltar shkencor-profesor i rregullt, nga viti 2003.

Puna në fakultete, profesor i jashtëm:

1998-1999, SHLP, Prizren. 2002-2004, Universiteti i Tetovës, FF, Tetovë. 2003-2006, Universiteti i Prishtinës, FF, Prishtinë. 2010-2012, Universiteti i Prishtinës, FE, Prizren. 2011-2014, Universiteti i Prishtinës, AKM, Prishtinë. 2012-2014, Universiteti i Shkupit, FF, Shkup.

Vepra të botuara:

Ndër veprat e tij të botuara janë: vëllimi “Epika legjendare e Rugovës”, V (1997), antologjia “Këngë të kreshnikëve”, (1999, 2001, 2003, 2009, 2011, 2013), monografia “Poetika e krahasimit. Figura e krahasimit në këngët tona lirike të dashurisë” (2004), përmbledhja “Studime për folklorin, I: Eposi i Kreshnikëve dhe epika historike” (2006), përmbledhja “Studime për folklorin, II: Epika gojore dhe etnokultura” (2008), vëllimi “Epika legjendare e Rugovës”, I (2009), vëllimi “Epika legjendare e Rugovës”, II (2011), përmbledhja “Studime për folklorin, III, Eposi i Kreshnikëve”, botuar në vitin 2018, në Prishtinë.

Është bashkëpërgatitës për shtyp i veprave të Institutit Albanologjik të Prishtinës: libri “30 vjet të Institutit Albanologjik, 1967-1997”,

Bashkëredaktor, përmbledhja e kumtesave “Rëndësia e veprës së Gustav Majerit për studimet albanologjike” (1998), “Pajtimi i gjaqeve 1990-1991” (1999, 2001), “Rëndësia e veprës së prof. Eqrem Çabejt për studimet albanologjike” (2003), “Anton Çetta, figurë poliedrike e kulturës shqiptare” (2011), dhe vepra tjera.

“Opoja-Aspekti folklorik” (2017), redaktor; përmbledhja e kumtesave “Demonstratat e vitit 1968, I,” (2018); redaktor dhe bashkëpërgatitës për shtyp; përmbledhja e kumtesave “Demonstratat e vitit 1968, II,” (2018), redaktor dhe bashkëpërgatitës për shtyp; libri për 40-vjetorin e SHKA Rapsha (2018), kryeredaktor dhe përgatitës për shtyp, përmbledhja e kumtesave, redaktor dhe përgatitës për shtyp të librit, “Folklori në krahinën e Llapushës”, botuar në vitin 2019.

Nga publicistika historike, për brezin 1968, ka botuar veprat:

“Isa Demaj-jeta dhe veprimtaria atdhetare” (2000); “Avdi Kelmendi-jeta dhe veprimtaria atdhetare” (bashkautor, 2002, 2016), bashkëpërgatitës për shtyp; libri i Xhevat Hasanit, “Me Selman Lajçin nëpër Sanxhak” (2015), redaktor; përmbledhja e kumtesave “Demarkacioni Kosovë-Mali i Zi”, (2015, tri botime), libri i Bedri Tahirit, “Drenica, djep i trimërisë”, (2015), redaktor; libri i Meriman Brahës “Goli Otoku” (2018) etj.

Hyrje

Për Leksikonin enciklopedik.....	5
Adem Demaçi.....	11
Abdyl Kadolli.....	15
Abdullah Konushevcu.....	16
Abdulla Mehmeti.....	18
Abdullah Troshupa.....	20
Abdurrahman Shala.....	22
Adem Kica.....	23
Adem Avdia.....	25
Adem Harxhi.....	26
Adem Mikullovcu.....	28
Adem Zaplluzha.....	29
Adem Zejnullahu.....	30
Afrim Spahiu.....	31
Ag Apolloni.....	33
Agim Çavdarbasha.....	34
Agim Ramadani.....	36
Agron Fico.....	37
Agron Beka.....	38
Agron Shele.....	39
Ahmet Kelmendi.....	40
Ahmet Maloku.....	41
Ahmet Qeriqi.....	43
Akil Koci.....	44
Alban Daci.....	46
Aleks Buda.....	47
Aleksandër Moisiu.....	49
Aleksandër Stipçeviç.....	51
Ali Berisha.....	53
Ali Daci.....	55
Ali Hadri.....	56
Ali Podrimja.....	58
Ali Prebreza.....	60
Ali Sutaj.....	61
Anton Pashku.....	63
Arben Bajraktaraj.....	64
Arben Puto.....	65
Arif Molliqi.....	66
Arjan Hamiti.....	67
Arjetë Miftari.....	69
Arshi Pipa.....	70
Asllan Krasniqi.....	72
Asllan Qyqalla.....	74
Astrit Memia.....	75

Avdush Canaj.....	77
Avdush Hasani.....	78
Avdyl Krasniqi.....	79
Avni Dehari.....	81
Avni Mula.....	82
Azem Shkreli.....	83
Aziz Rexhepi.....	84
Bajram Ibraj.....	85
Bardhyl Çaushi.....	87
Basri Lenjani.....	88
Basri Sejdiu.....	89
Bedri Halimi.....	90
Bedri Tahiri.....	91
Bedri Zahiti.....	93
Bedri Zyberaj.....	94
Begzad Baliu.....	95
Behlul Brestovci.....	97
Behram Hoti.....	99
Bejtullah Destani.....	100
Bekim Berisha.....	102
Bekim Fehmiu.....	104
Beqë Cufaj.....	106
Beqir Kastrati.....	107
Beqir Musliu.....	108
Berat Luzha.....	110
Berim Ramosaj.....	111
Besim Bokshi.....	112
Betim Muço.....	114
Bilal Xhaferri.....	116
Branisllav Sinadinovski.....	117
Bujar Dugolli.....	118
Burbuqe Bruqi.....	119
Çun Lajçi.....	120
Dashnim Hebibë.....	121
Daut Dauti.....	122
Daut Demaku.....	123
Demir Reshiti.....	124
Dervish Rozhaja.....	125
Dervish Shaqa.....	127
Destan Bajraktari.....	128
Dibran Fylli.....	130
Dibran Tahiri.....	134
Dijana Toska.....	135
Dritan Korumi.....	136

Dritëro Agolli.....	137
Erza Voca Mulaj.....	139
Edmond Hajrizi.....	140
Ejup Statovci.....	141
Ekrem Kryeziu.....	143
Emin Kabashi.....	145
Engjëll Berisha.....	147
Engjëll Koliqi.....	148
Enver Petrovci.....	149
Eqrem Çabej.....	151
Ermira Ymeraj.....	153
Ernest Koliqi.....	154
Esad Mekuli.....	156
Esat Stavileci.....	158
Esat Loshaj.....	159
Eshref Ymeri.....	160
Fadil Maloku.....	163
Fadil Sulejmani.....	165
Faik Ballanca.....	167
Faik Konica.....	168
Faruk Begolli.....	170
Fatmir Halimi.....	172
Fatmir Terziu.....	174
Fatos Daci.....	176
Fehmi Agani.....	177
Fejaz Drançolli.....	179
Ferdinand Laholli.....	180
Ferid Murati.....	181
Fitim Selimi.....	183
Flora Brovina.....	185
Flori Bruqi.....	186
Frashër Demaj.....	189
Fritz Radovan.....	191
Gani Mehmetaj.....	193
Gani Halilaj.....	195
Gani Xhafolli.....	197
Gaqo Çako.....	198
Gazmend Shaqiri.....	200
Gazmend Zajmi.....	201
Gëzim Ajgeraj.....	203
Gëzim Alpion.....	205
Gëzim Mekuli.....	207
Gjin Kol Musa.....	208
Gjon Boriçi.....	209

Gjon Françesk Albani.....	210
Gjyle Mulliqi-Osmani.....	213
Gonxhe Bojaxhiu.....	215
Hadi Shehu.....	218
Hajdar Salihu.....	219
Hajdin Morina.....	220
Hajro Ulqinaku.....	221
Hakif Bajrami.....	222
Halil Kajtazi.....	225
Halil Xani.....	227
Haqif Mulliqi.....	228
Hasan Prishtina.....	230
Hasan Hasani.....	232
Hasim Rushiti.....	234
Hava Shala-Qyqalla.....	236
Hilmi Dauti.....	238
Hivzi Muharremi.....	239
Hydajet Hyseni.....	241
Hysni Daka.....	242
Ibrahim Kodra.....	243
Ibrahim Rugova.....	244
Idriz Ajeti.....	246
Idriz Berisha.....	248
Illir Muharremi.....	249
Illir Shaqiri.....	250
Iliriana Hoxha-Ana Oxa.....	252
Iliriana Sulkuqi.....	254
Iliaz Bobaj.....	255
Iljaz Prokshi.....	257
Inva Mula.....	259
Irma Hasan Kurti.....	261
Isak Shema.....	263
Islam Lauka.....	265
Islam Qerimi.....	267
Ismail Dreshaj.....	269
Ismail Kadare.....	272
Istref Begolli.....	274
Isuf Bajrami.....	276
Isuf Dedushaj.....	277
Ibush Reçica.....	279
Izet Sadiku.....	280
Isuf Krasniqi.....	281
Izet Duraku.....	283
Jahja Drançolli.....	284

Jahja Lluka.....	286
Jakov Xoxa.....	287
Jakup Krasniqi.....	289
Jashar Rexhepagiqi.....	290
Juljana Mehmeti.....	292
Jusuf Bajraktari.....	293
Jusuf Gërvalla.....	295
Jusuf Osmani.....	297
Kadrush Radogoshi.....	298
Kastriot Tusha.....	301
Katarina Josipi.....	303
Kopi Kyçyku.....	304
Kosovare Ukshini.....	305
Kozeta Zavalani.....	306
Kristaq Turtulli.....	308
Kristo Frashëri.....	309
Kujtim Mateli.....	311
Kujtim Shala.....	312
Lasgush Poradeci.....	313
Latif Berisha.....	314
Leonora Bruçaj.....	316
Liman Rushiti.....	318
Lisen Bashkurti.....	319
Luigj Gurakuqi.....	320
Lule Alidema.....	322
Lush Gjergji.....	323
Mahmud Hysa.....	327
Majlinda Kelmendi.....	328
Margarita Xhepa.....	330
Marin Mema.....	332
Marjan Dema.....	333
Martin Camaj.....	335
Masar Stavileci.....	336
Maxhun Bruqi.....	337
Mehmet Gjevori.....	338
Mehmet Kajtazi.....	339
Mehmet Kraja.....	340
Melihate Ajeti.....	342
Migena Arllati.....	343
Milazim Kadriu.....	344
Milazim Krasniqi.....	345
Mira Meksi.....	347
Miradije Ramiqi.....	349
Mirlind Bruqi.....	351

Mirush Kabashi.....	353
Mitrush Koteli.....	355
Muhamed Kërveshi.....	357
Mixhait Reçi.....	359
Muhamet Mjeku.....	360
Muharrem Berisha.....	362
Muharrem Blakaj.....	364
Muharrem Qena.....	365
Murteza Nura.....	366
Murteza Osdautaj.....	367
Musa Haxhiu.....	369
Musa Ramadani.....	371
Muslim Mulliqi.....	373
Mustafë Musa.....	374
Mustafë Haziri.....	375
Merita Emni.....	376
Myrvete Dreshaj-Baliu.....	377
Naim Frashëri.....	378
Naim Kelmendi.....	380
Namik Shehu.....	382
Naxhije Doçi.....	384
Nazmi Maksutaj.....	386
Nazmi Rrahmani.....	387
Nebih Bunjaku.....	388
Nehat Jahiu.....	389
Neritan Ceka.....	391
Nexhat Daci.....	393
Nexhat Rexha.....	395
Nexhmije Pagarusha.....	396
Nijazi Halili.....	397
Nikolla Spathari.....	399
Nimon Muçaj.....	401
Nuri Dragoj.....	403
Nikë Gjeloshi.....	404
Nusret Pllana.....	405
Odise Plaku.....	407
Osman Imami.....	408
Pajazit Nushi.....	410
Pëllumb Kulla.....	412
Petraç Risto.....	413
Petraç Zoto.....	414
Petrit Ruka.....	415
Premtim Rashiti.....	417
Prend Buzhala.....	418

Rabit Sadiku.....	420
Ragip Sylaj.....	422
Rajmonda Maleçka.....	423
Ramadan Qehaja.....	424
Ramadan Zejnullahu.....	425
Ramiz Kelmendi.....	426
Rasim Bebo.....	428
Rasim Selmanaj.....	429
Rauf Dhomi.....	430
Remzi Bakalli.....	432
Reshat Arbana.....	433
Resmi Osmani.....	435
Resul Shabani.....	436
Rexhep Boja.....	437
Rexhep Doçi.....	438
Rexhep Ferri.....	441
Rexhep Hoxha.....	442
Rexhep Qosja.....	443
Rexhep Shahu.....	445
Rifat Latifi.....	446
Ridvan Dibra.....	448
Rifat Gjota.....	449
Rifat Kukaj.....	450
Riza Smaka.....	451
Robert Ndrenika.....	452
Rovena Vata.....	453
Rushit Ramabaja.....	454
Ruzhdi Jashari.....	455
Sabile Keçmezi-Basha.....	456
Sabri Fejzullahu.....	457
Sabri Hamiti.....	458
Sadik Bicaj.....	459
Sadri Fetiu.....	460
Sali Kelmendi.....	461
Salih Krasniqi.....	462
Sami Frashëri.....	463
Sami Repishti.....	464
Sandër Prosi.....	465
Sarë Gjergji.....	466
Sejdi Berisha.....	467
Sevdai Radogoshi.....	469
Skënder Buçpapaj.....	470
Skënder Hoxha.....	471
Skënder Kodra.....	472

Skender Rizaj.....	474
Skënder Tafaj.....	475
Skënder Temali.....	476
Skënder Zogaj.....	477
Sokol Plakolli.....	478
Sotir Andoni.....	479
Sulejman Abazi.....	480
Sylejman Lokaj.....	481
Sylë Tahirsylaj.....	482
Shaban Baksi.....	484
Shahbaze Vishaj Grajçevci.....	485
Shaip Grabovci.....	486
Shani Pallaska.....	487
Shefik Shkodra.....	488
Shefki Sejdiu.....	489
Shefkije Islamaj.....	490
Shtjefën Gjeçovi.....	492
Shyqri Galica.....	493
Shyqri Nimani.....	495
Tahir Desku.....	496
Tahir Berisha.....	497
Teqi Dervishi.....	498
Tinka Kurti.....	499
Tyran Prizren Spahiu.....	500
Ukshin Hoti.....	501
Vilson Culaj.....	502
Vlera Bytyqi Ejupi.....	503
Vilheme Vranari.....	504
Vullnet Mato.....	506
Xheladin Mjeku.....	507
Xhemil Bytyçi.....	508
Xhevat Limani.....	509
Xhevdet Shala.....	510
Ymer Elshani.....	511
Zef Kakoca.....	512
Zef Mulaj.....	513
Zef Pergega.....	514
Zef Zobra.....	516
Zejnullah Rrahmani.....	517
Zekë Sinanaj.....	518
Zekerija Idrizi.....	519
Zeqir Bekolli.....	520
Zeqir Berdynaj.....	521
Zymer Neziri.....	522

Flori Bruqi
LEKSIKON ENCIKLOPEDIK
I AKADEMISË SHQIPTARE AMERIKANE

Shtëpia botuese
“Flomed”

Formati 24 cm

Tirazhi 1000 copë

Shtypi “Office Printy”
Prishtinë, 2020

Katalogimi në botim - **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

929(=18)(038)

Bruqi, Flori

Leksikon enciklopedik i Akademisë Shqiptare
Amerikane : shkencë, art, kulturë, letërsi / Flori Bruqi.
– Prishtinë : Flomed, 2020. - 532 f. : ilustr. me ngjyra ;
24 cm.

ISBN 978-9951-415-08-8